

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i gjashtëmbëdhjetë)

Nga ajeti 75 i sures “El Kehf” deri në fund të sures “Ta Ha”

TIRANË, 2018

Titulli: **KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT**

(Xhuзи i gjashtëmbëdhjetë)

Autori: *Eruditi, juristi dhe komentuesi*

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: **Vullnet MERJA**

E përktheu: **H. Selim STAF**A *(Allahu e mëshirofië!)*,

Rajmonda FEZA & Valbona HOROZOVA

E redaktoi: **Dorina BASHA, Jerida KULLA & Esat BUNGURI**

Korrektura letrare: **Vjollca KARAJ**

Përkujdesja grafike: **Sabrie FEZA**

Kapaku: **Sabrie FEZA**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

Copyright: **Shoqata "FLLADI"**

Shtypshkronja e shtëpisë botuese **LILLO**

Ajetet 75 - 78

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

❦ قَالَ أَلَمْ أَقُلْ لَّكَ إِنَّكَ لَنْ تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صَبْرًا ﴿٧٥﴾ قَالَ إِنْ سَأَلْتُكَ
عَنْ شَيْءٍ بَعْدَهَا فَلَا تُصَحِّبْنِي ۖ قَدْ بَلَغْتَ مِن لَّدُنِّي عُذْرًا ﴿٧٦﴾
فَانْطَلَقَا حَتَّىٰ إِذَا أَتَيَا أَهْلَ قَرْيَةٍ اسْتَطْعَمَا أَهْلُهَا فَأَبَوْا أَنْ يُضَيِّفُوهُمَا
فَوَجَدَا فِيهَا جِدَارًا يُرِيدُ أَنْ يَنْقَضَ فَأَقَامَهُ ۖ قَالَ لَوْ شِئْتَ لَتَّخَذْتَ
عَلَيْهِ أَجْرًا ﴿٧٧﴾ قَالَ هَذَا فِرَاقُ بَيْنِي وَبَيْنِكَ ۚ سَأُنَبِّئُكَ بِتَأْوِيلِ مَا لَمْ
تَسْتَطِعْ عَلَيْهِ صَبْرًا ﴿٧٨﴾

Me emrin e All'Ilahut, Mëshirëplotit, të Gjithëmëshirshmit

“Ai (i dituri) tha: ‘A nuk të thashë ty se nuk mund të bësh
durim me mua.’”

“Ai (Mùsài) tha: ‘Nëse pas kësaj do të të pyes për ndonjë gjë, atëherë mos më lejo të të shoqëroj, ke marrë shumë justifikime nga unë.’”

“Vazhduan të ecin derisa arritën te banorët e një vendbanimi të cilëve i kërkuan t’i jepnin ushqim, por ata nuk i pranuan si mysafirë; aty gjetën një mur që ishte gati të shembej, prandaj ai (i dituri) e ndërtoi murin dhe ai (Mùsài) tha: ‘nëse do të kishe dashur, do të merrje shpërblim për këtë.’”

“Ai (i dituri) tha: ‘Tani erdhi koha të ndahemi, prandaj unë po të tregoj domethënien e asaj që ti nuk mundet të bësh durim.’”

Komentimi

Ajetet e fundit të xhuzit pesëmbëdhjetë (71-74) flisnin për udhëtimin e Profetit Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) me hazreti Hidrin. Edhe ajetet e para të xhuzit gjashtëmbëdhjetë vazhdojnë me këtë tregim.

Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*) u kujtua për premtimin e dhënë dhe që ai e shkeli për herë të dytë, prandaj e ndjeu veten të turpëruar, edhe për shkak të harresës. Në mënyrë graduale filloi të ndiejë vërtetësinë e fjalisë së mësuesit se Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*) s’kishte mundësi të mbante punët e tij, prandaj filloi t’i rëndohej shoqërimi me

mësuesin dhe ai vetë i kërkoi ndjesë duke i thënë: “Nëse do të kundërshtoj e do të pyes edhe një herë tjetër, mos më bëj më shoqëri dhe nga ana ime je i lirë të mos rrish me mua”, ashtu siç njofton ajeti: “(Mūsàì) **tha: ‘Nëse pas kësaj do të të pyes për ndonjë gjë, atëherë mos më lejo të të shoqëroj, ke marrë shumë justifikime nga unë.’**”.

Forma si ka ardhur këtu fjala “udhren” - “justifikim” tregon një maturi të madhe nga ana e Mūsàsë (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*) dhe sa largpamës ishte ai në të gjitha punët. Kjo fjalë e tij shpjegon qartë se Mūsàì (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*) dorëzohej para të vërtetave. Thënë ndryshe, fjalia shpjegon qartë se pas tri etapave të provimit, misioni i këtyre dy burrave ishte i ndryshëm.

Pas kësaj fjale dhe pas premtimit të ri, ata të dy: **“Vazhduan të ecin derisa arritën te banorët e një vendbanimi të cilëve u kërkuan t’i jepnin ushqim.”**

S’ka dyshim se Mūsàì dhe shoku i tij nuk ishin prej atyre që u thonë njerëzve vetëm një fjalë, por del qartë se në këtë udhëtim atyre u kishin mbaruar furnizimet dhe paratë, prandaj ata kërkuan të ishin mysafirë të banorëve të atij vendbanimi. (Ka mundësi që burri i ditur u bëri atyre këtë propozim me qëllim që t’i jepte Mūsàsë (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*) edhe një mësim tjetër të madh.)

Këtu duhet të tërheqim vëmendjen se fjala e ajetit “karjetin”, në gjuhën e Kur’ànit ka një kuptim të përgjithshëm dhe përfshin të gjitha zonat e banuara në fshat e në qytet. Kurse në ajetin tonë qëllimi me fjalën *fshat* është ose për banorët e një qyteti, ose për

banorët e ndonjë fshati, ashtu si e shpjegojnë këtë çështje ajetet vijuese.

Interpretuesit e Kur'anit kanë cituar prej Ibni Ab'bàsit se qëllimi me fjalën *fshat* në këtë ajet është për qytetin e Antiokisë¹ (në tekstin arabisht Entakij'jeh) .

Interpretues të tjerë të Kur'anit kanë thënë se qëllimi është qyteti Ejleh, që në ditët e sotme quhet porti detar i mirënjohur Ejlat në Detin e Kuq pranë Gjirit të Akabes. Pjesa e tretë e interpretuesve të Kur'anit kanë thënë se qëllimi me fjalën *fshat* është qyteti Nàsireh (Nazareti), që ndodhet në veri të Palestinës dhe është vendlindja e zotërisë tonë Mesihut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*). Dijetari poliedrik Et Tabresij ka cituar një transmetim prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) që e mbështet këtë mundësi.

Duke u rikthyer në qëllimin e fjalës **“vendi ku bashkohen dy detet”**, ne thamë se kjo fjalë tregon vendin ku bashkohet Gjiri i Akabas me Gjirin e Suezit. Nga ky shpjegim bëhet më e qartë se *“fshati”* i përmendur në ajetin tonë objekt studimi mund të jetë qyteti Nàsireh ose porti detar Ejleh, që janë më afër atij vendi, sesa Antiokia.

E rëndësishme në këtë çështje është fakti se ne konkludojmë prej asaj që i ngjau Mùsàsë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) dhe shokut të tij prej banorëve të atij

¹ Antiokia është prej qyteteve të Sirisë dhe ndodhet 96 km larg qytetit Haleb (Alepo) dhe 59 km larg qytetit të Aleksandrisë (Iskenderij'jeh). Qyteti i Antiokisë është me famë për prodhimin e drithërave dhe farërave vajore. Ai ka një port detar që quhet Suvejdi'jeh që ndodhet 27 km larg qendrës së qytetit. (Për këtë referohu në librin “Dàiretu ferijd ue xhed’dij”, vëll. 1, f. 835).

qytet, të cilët ishin njerëz të mbyllur e me vullnet shumë të ulët, ashtu siç e lexojmë në një transmetim të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në vijim të përshkrimit të banorëve të atij qyteti, ai ka thënë: “Ishin banorë të një qyteti të mbyllur.”¹

Më pas, ajeti vijues shton: “**Ata gjetën aty një mur që ishte gati të shembej, prandaj ai (i dituri) e ndërtoi murin.**”² Mùsàì (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) po ndiente lodhje dhe uri, por më e rëndësishme është se ai u prek shumë ngaqë banorët e atij vendbanimi me sjelljen e tyre e fyen shumë autoritetin e respektin ndaj mësuesit, kur ata nuk i pranuan si mysafirë. Nga ana tjetër shikojmë se Hidri riparoi murin, pavarësisht nga sjellja e keqe e banorëve të atij qyteti ndaj atyre të dyve. Me veprimin e tij, Hidri kishte qëllim të shpërblente banorët e atij vendbanimi për sjelljen e tyre të keqe. Mùsàì (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) besonte se shoku i tij kishte të drejtë të kërkonte shpërblim për punën që bëri, kështu që ata të dy do të kishin mundësi të siguronin ushqim.

Ky ishte shkak që Mùsàì (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) e harroi edhe një herë tjetër premtimin dhe filloi të kundërshtojë, megjithëse kundërshtimi i tij kësaj here filloi me tone shumë më të ulëta kur tha: “...dhe ai (Mùsàì) tha: ‘Nëse do të kishe dashur, do të merrje shpërblim për këtë.’”.

Në fakt, Mùsàì besonte se sakrifica që bën njeriu për njerëz të këqij, është një punë së cilës i mungon fryma e drejtësisë. Thënë

¹ “Mexhmaul Bejàn”, në komentimin e ajetit.

² Përdorimi i fjalës vullnet për murin është alegorik dhe kuptimi është se muri ishte gati në të rënë.

ndryshe: puna e mirë është e bukur, me kusht që të bëhet aty ku duhet.

Pikërisht këtu burri dijetar i tha Mùsàit fjalën e tij të fundit: “Në ngjarjet e ndryshme ti nuk tregove durim ndaj meje”, prandaj ai i njoftoi vendimin e tij të fundit: **“Ai (i dituri) tha: ‘Tani erdhi koha të ndahemi, prandaj unë po të tregoj domethënien e saj që ti nuk munde të bësh durim.’”**.

Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) natyrisht që nuk e kundërshtoi vendimin, sepse ishte ai që e kishte propozuar ndarjen kur ndodhi ngjarja e mësipërme. Kështu Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) nuk mund të vazhdonte shoqërimin me këtë dijetar. Megjithëkëtë, ndarja mes atyre të dyve që ndarja më e mirë që erdhi me një realitet të fuqishëm në zemrën e Mùsàsë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*). Pra, ndarja prej një mësuesi, zemra e të cilit ishte mbushur me sekrete, ishte ndarje prej shoqëruesi të mbuluar me begati. Fjala e atij mësuesi ishte mësim, trajtimi nga ana e tij mbante vulën e inspirimit, drita e All'llahut rrezaton prej ballit të tij dhe zemra e tij ishte një depozitë prej diturive Hyjnore.

Ndarja prej një burri me këto karakteristika të veçanta është shumë e vështirë, por për Mùsàinë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) s'kishe rrugë tjetër veçse të dëgjonte me vëmendje të madhe këtë të vërtetë të hidhur.

Interpretuesi i njohur i Kur'anit Famëlartë Ebul Futùh Err Rràzij thotë: “Në njoftimet tregohet se Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) kur është pyetur për problemin më të vështirë me të cilin është ndeshur gjatë gjithë jetës së tij, është përgjigjur: ‘Jam përballur me probleme e me vështirësi të shumta

(duke pasur parasysh ato që pësoi prej Faraonit dhe vuajtjet që i shkaktuan atij Beni Israilët), por asnjëra nga ato vështirësi nuk ka qenë më e vështirë dhe me më shumë dhimbje në zemrën time sesa vendimi i Hidrit që të ndahej me mua.”¹.

¹ Ebul-Futùh Err Rràzij në “Rùhul Xhinàn”, vëll. 3, gjatë komentimit të ajetit në fjalë.

Ajetet 79 - 82

أَمَّا السَّفِينَةُ فَكَانَتْ لِمَسْكِينٍ يَعْمَلُونَ فِي الْبَحْرِ فَأَرْدَتْ أَنْ أَعْيَهَا وَكَانَ
وَرَاءَهُمْ مَلِكٌ يَأْخُذُ كُلَّ سَفِينَةٍ غَصْبًا ﴿٧٩﴾ وَأَمَّا الْغُلَامُ فَكَانَ أَبَوَاهُ
مُؤْمِنَيْنِ فَخَشِينَا أَنْ يُرْهَقَهُمَا طُغْيَانًا وَكُفْرًا ﴿٨٠﴾ فَأَرْدْنَا أَنْ يُبَدِّلَهُمَا
رَبُّهُمَا خَيْرًا مِّنْهُ زَكَاةً وَأَقْرَبَ رُحْمًا ﴿٨١﴾ وَأَمَّا الْجِدَارُ فَكَانَ لِغُلَامَيْنِ
يَتِيمَيْنِ فِي الْمَدِينَةِ وَكَانَ تَحْتَهُ كَنْزٌ لَهُمَا وَكَانَ أَبُوهُمَا صَالِحًا فَأَرَادَ
رَبُّكَ أَنْ يَبْلُغَا أَشُدَّهُمَا وَيَسْتَخْرِجَا كَنْزَهُمَا رَحْمَةً مِّن رَّبِّكَ وَمَا فَعَلْتُهُ
عَنْ أَمْرِي ﴿٨٢﴾ ذَلِكَ تَأْوِيلُ مَا لَمْ تَسْطِعْ عَلَيْهِ صَبْرًا ﴿٨٣﴾

“Për sa i përket anijes, ajo ishte pronë e disa të varfërve që punojnë në det; (por) desha ta bëj atë me të meta, sepse para tyre është një sundimtar që rrëmben çdo anije (në gjendje të mirë, pa të meta).”

“Për sa i përket djaloshit, të dy prindërit e tij ishin besimtarë, por kishim frikë se ai do t'i detyronte ata me dhunë të hynin në rrugën e humbjes e në mosbesim.”

“Ne deshëm që Zoti i tyre t’ua zëvendësojë atë me një më të mirë se ai e më të afërm në respekt e në mëshirë (ndaj prindërve).”

“Për sa i përket murit, ai ishte (pronë) e dy djemve jetimë të atij qyteti dhe poshtë murit gjendet një thesar që u takon atyre të dyve. Babai i atyre ishte njeri i mirë dhe Zoti yt shfaqti vullnetin e Tij që ata të dy (jetimët) të arrijnë moshën e pjekurisë dhe të nxjerrin vetë thesarin e tyre. Kjo ishte mëshirë prej Zotit tënd për ata të dy (jetimët) dhe, unë nuk e bëra atë (punë) sipas bindjes sime (por sipas udhëzimit të All’llahut). Pra, ky është sqarimi i asaj për të cilën ti nuk munde të bësh durim!”

Komentimi

Sekretet e brendshme të atyre ngjarjeve

Pasi ndarja e Mùsàsë (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*) prej Hidrit u bë e pashmangshme, duhej që mësuesi hyjnor të shpjegonte sekretet e punëve të tij ndaj të cilave Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*) nuk mundi të tregohej i durueshëm. Në fakt, përfitimi që pati Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*) nga shoqërimi me Hidrin përfaqësohet në njohjen nga ana e tij me sekretet e atyre tri ngjarjeve të çuditshme, të cilat mund të jenë çelësi për shumë çështje, si dhe përgjigje për shumë pyetje.

Ne fillim, ai përmendi ngjarjen e anijes dhe tha: **“Për sa i përket anijes, ajo ishte pronë e disa të varfërve që punojnë në det; (por) desha ta bëj atë me të meta, sepse prapa tyre është një sundimtar që rrëmben çdo anije (në gjendje të mirë, pa të meta).”**.

Me këtë renditje të punës së tij, domethënë me vlerësimin e anijes kishte një qëllim shumë të mirë, megjithëse veprimi i tij dukej një punë e keqe. Madje dukej një punë e përbindshme, pavarësisht se qëllimi i tij ishte që ata të shpëtonin prej rrëmbimit që praktikonte ai mbret cub. Ai e dinte që mbreti nuk i rrëmbente anijet me të meta, pavarësisht se si ishin ato. Kjo do të thotë se thelbi i qëllimit në ngjarjen e parë ishte ruajtja e interesave të një grupi njerëzish të varfër.

Fjala e ajetit *“veràe”* - *“prapa”* nuk është në kuptimin e ndajfoljes së vendit, por në kuptimin e rrezikut që i priste ata (rreziku prej mbretit), për të cilin ata nuk dinin asgjë. Është normale që njeriu nuk ka si t'i dijë ngjarjet e ndodhitë nëpër të cilat mund të kalojë në atë ardhmen. Pikërisht ky është edhe shkaku që në ajet është përdorur fjala *“prapa”*.

Përveç kësaj, kur njeriu gjendet nën presionin e një individi ose të një grupi, ai përdor fjalën *“prapa”*, ashtu siç thuhet në fjalën e poetit: “Ata që e dinë se femrat e familjes së tyre janë të pandershme dhe heshtin ishin prapa meje dhe nuk po më linin”, ose ashtu siç lexojmë fjalën e të Lartit në ajetin 16 të sures “Ibrahim”: **“...prapa tij (mendjemadhit) është Xhehennemi, ku i jepet të pijë ujë i ndyrë.”**¹

¹ Në lidhje me kuptimin e fjalës së ajetit *“veràe”* - *“prapa”* lexo komentimin e fundit të ajetit 16 të sures “Ibrahim” të këtij tefsiri.

Nga ana tjetër përdorimi i fjalës “mesàkijne”, është në kuptimin e personit, i cili në mënyrë absolute nuk ka as para e asnjë lloj pasurie që mund të plotësojë ndonjë nevojë që plotësohet me anë të pasurisë.

Gjithashtu ka mundësi që përshkrimi i njerëzve të anijes me fjalën “mesàkijne” të mos jetë për shkak të varfërisë së tyre, por për shkak se ata ishin njerëz që nuk kishin përkrahje e forcë. Gjendja e njeriut të zhveshur nga të gjitha llojet e pasurive në gjuhën arabe shprehet me fjalën “miskijn”, që në rrënjën e saj “sukùn” do të thotë *heshtje dhe dobësi*.

Në “Nehxhul Belàga” lexojmë fjalën e Prijësit të Besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*): “Njeriut të varfër i shkaktajnë dhimbje tartabiqet, atë e vret kolla e mirë dhe uji; edhe djersa i jep atij erë të keqe.”.¹

Më pas, mësuesi i ditur kalon në shpjegimin e ngjarjes së dytë, domethënë të vrasjes së djalit të ri. Ajeti njofton: **“Për sa i përket djaloshit, prindërit e tij ishin besimtarë, por kishim frikë se ai do t’i detyronte ata me dhunë të hynin në rrugën e humbjes e në mosbesim.”**.

Një grup interpretuesish të Kur’anit kanë thënë se qëllimi nuk është ai që shpreh ana e jashtme e fjalëve të ajetit, domethënë, se ai i ri jobesimtar e mëkatar mund të ishte shkak për devijimin e prindërve të tij prej rrugës së besimit. Jo, qëllimi është se dhuna e atij të riu dhe mosbesimi që ai manifeston do të fyente shumë prindërit e tij. Gjithsesi, interpretimi i parë është shumë më afër së vërtetës.

¹ “Nehxhul Belàga”, Fjalët e shkurtra, fjalë nr. 419.

Sido që të jetë, burri i ditur e vrau atë djalë, duke pasur parasysh se ai do të ishte shkak për atë që do të ndodhte me prindërit e tij, nëse ai djalë do të mbetej gjallë.

Më poshtë në një paragraf të studimeve do të shikojmë temën: (ekzekutimi para kryerjes së krimit), ku u jepet përgjigje këtyre veprimeve të Hidrit.

Edhe fjala e ajetit "*khashijnà*" - "*kishim frikë*" në brendinë e saj ka një kuptim shumë të madh. Kjo fjalë sqaron se burri i ditur e konsideronte veten përgjegjës për të ardhmen e njerëzve dhe nuk mund të pranonte që një nënë dhe një babë, të dy besimtarë, të pësonin të keqen për shkak të daljes të birit të tyre prej rrugës së besimit.

Gjithashtu fjala "*khashijnà*" - "*kishim frikë*" këtu ka ardhur në kuptimin: nuk dëshironim dhe jo në kuptimin e frikës, pasi frika për një person të këtij niveli të lartë diturie e fuqie, nuk ka vend të thuhet.

Me fjalë të tjera, në të vërtetë qëllimi me vrasjen e djalit është: me anë të kësaj ngjarjeje të keqe ne dëshirojmë që prindërit e tij të jenë krejtësisht të pastër prej veprimeve të liga të djalit të tyre, patjetër duke pasur parasysh dashurinë prindërore të atyre të dyve.

Mundet që fjala "*khashijnà*" - "*kishim frikë*" të jetë edhe në kuptimin "*ne e dinim*", ashtu siç është cituar prej Ibni Ab'bàsit, domethënë: ne e dinim mirë se i riu, nëse do të mbetej gjallë, do të bëhej shkak për ngjarje shumë të dhimbshme që do të binin mbi babanë dhe nënën e tij në të ardhmen.

Për sa i përket shkakut përse përemri i është bashkëngjitur foljes “*khashijnà*” – “*kishim frikë*” - është përdorur në vetën e parë dhe në numrin shumë, në një kohë që folësi është një individ i vetëm. Në të vërtetë, edhe shkakut për këtë është fare i qartë, sepse kjo formë e fjalës nuk përdoret në Kur’ânin Famëlartë për herë të parë dhe vetëm në këtë rast. Në gjuhën arabe, kur personalitetet flasin për veten e tyre, përemrin vetor e përdorin në numrin shumë. Kjo për arsye se ata njerëz kanë vartës, të cilëve u japin urdhra për zbatimin e punëve, ashtu siç u jep urdhra All’llahu i Lartësuar engjëjve dhe ashtu siç u jep njeriu urdhra vartëseve të tij.

Më pas me gjuhën e burrit të ditur, ajetet tregojnë fjalën e të Lartit: **“Ne deshëm që Zoti i tyre t’ua zëvendësojë atë me një më të mirë se ai e më të afërm në respekt e në mëshirë (ndaj prindërve).”**.

Fjala “*erednà*” dhe fjala “*rab’behumà*” në ajetin në fjalë kanë kuptime të mëdha, mbi të cilat do të qëndrojmë pas pak.

Edhe fjala tjetër e ajetit “*zekàten*” në kuptimin e pastërtisë, ka një kuptim më të gjerë dhe përfshin pastërtinë e besimit, pastërtinë në punën e mirë; domethënë që kuptimi i pastërtisë shtrihet në të gjitha punët fetare e materiale. Në këtë fjalë mund të jetë edhe përgjigjja për kundërshtimin nga ana e Mûsàsë (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*), kur i tha burrit të ditur: “A vrave një shpirt të pastër”, por dijetari në përgjigje të këtij kundërshtimi i tha: “Ai (djali që ai vrau) nuk ishte shpirt i pastër, por ne kishim qëllim që Zoti t’u jepte atyre të dyve në vend të atij një djalë me të vërtetë të pastër.”.

Në shumë transmetime lexojmë: “All’llahu ua zëvendësoi atë me një vajzë prej së cilës lindën shtatëdhjetë Profetë.”.¹

Në ajetin objekt i këtij studimi, burri i ditur zbulon edhe sekretin e tretë në lidhje me rindërtimin e murit dhe tha: **“Për sa i përket murit, ai ishte (pronë) e dy djemve jetimë të atij qyteti dhe poshtë tij gjendet një thesar që u takon atyre të dyve; babai i tyre ishte njeri i mire.”**.

“Zoti yt shfaqti vullnetin e Tij që ata të dy (jetimët) të arrijnë moshën e pjekurisë dhe të nxjerrin vetë thesarin e tyre.”

“Rahmeten min rab’bikë”, “kjo ishte mëshira prej Zotit tënd për ata të dy (jetimët).”.

Burri i ditur shpjegon: “Unë isha i urdhëruar të rindërtoja këtë mur, për një shkak të një cilësie shumë të vlerësuar, që ishte bamirësia e prindërve të këtyre dy jetimëve. E rindërtova murin, me qëllim që thesari të mos zbulohej tani dhe të mos vihej në rrezik”.

Jemi në fundin e kësaj bisede dhe, që të shuhet çdo lloj dyshimi që mund të ishte te Mūsà (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) dhe që ai të ishte i bindur plotësisht se të gjitha ato punë u bënë sipas një planifikimi e orientimi të lartë e të veçantë, dijetari tha: **“unë nuk e bëra atë (punë) sipas bindjes sime”**, por me urdhër të All’llahut.

Ky është sekreti për të cilin Mūsà (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) nuk mundi të bënte durim, prandaj

¹ “Nüruth Thkalejn”, vëll. 3, f. 286 dhe f. 287.

mësuesi i tha: “Ky pra është sqarimi i asaj për të cilën ti nuk munde të bësh durim!”.

Hulumtime

1- Misioni i Hidrit ishte në kuadrin e sistemit ligjor apo në kuadrin e sistemit struktural?

Këto tri ngjarje kanë shqetësuar mendjet e dijetarëve të mëdhenj dhe kanë hapur shumë debate ndërmjet tyre.

Pyetja e parë: si mund të shkatërrohet një pjesë prej pasurive të një personi pa lejen e pronarit, me pretekstin se diku qenka një rrëmbyes që ka qëllim ta uzurpojë atë pasuri?

Si është e mundur të dënohet një djalë i ri me pretekstin e punëve që ai do të bëjë në të ardhmen?

A ka këtu ndonjë domosdoshmëri të punohet vullnetarisht me qëllim për të ruajtur pasuritë e një personi që dihet se kush është?

Gjatë këtij tregimi kur'anor pamë se Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!*) e kundërshtoi burrin e ditur, por pasi dëgjoi sqarimet dhe u informua për brendinë e punëve, hoqi dorë nga kundërshtimi dhe u bind.

Tani para nesh ka vetëm dy rrugë, për t'iu përgjigjur pyetjeve, të cilat po i shpalosim të detajuara si më poshtë:

Rruga e parë: të përputhim ngjarjet dhe veprimet e dijetarit me krahasuesit e ligjit të fesë e me legjislacionin. Një grup interpretuesish të Kur'anit kanë ecur mbi këtë rrugë.

Ngjarjen e parë e kanë konsideruar në përputhje të plotë me ligjin dhe kanë thënë: "Ruajtja e anijes si tërësi, pa dyshim që është një punë shumë më e rëndësishme se dëmtimi pjesor që ai i shkaktoi anijes nga ana e jashtme e saj. Me fjalë të tjera, Hidri veproi sipas aksiomës: sprapsja e më të keqes me një të keqe më të vogël, sidomos po të marrim parasysh se ishte plotësisht e mundur të arrihej miratimi prej njerëzve të anijes, kur ata të mësonin qëllimin e asaj prishjeje të pjesshme të anijes së tyre. Pra, nga këndvështrimi i dispozitave të ligjit të fesë e i rregullave të këtij ligji, Hidri kishte arritur të merrte miratimin për punën e tij".

Për sa i përket djalit, interpretuesit e Kur'anit këmbëngulin para atij që ndjek këtë rrugë, duke thënë se i riu në fjalë kishte arritur moshën madhore dhe se ai në të vërtetë ishte renegat, shkatërrues e ngatërrestar. Nisur nga punët e tij konkrete, ai ishte prej atyre që ligjërisht lejohen të vriten.

Për sa i përket bisedës së Hidrit rreth krimeve të ardhshme të djalit, me këtë ai kishte qëllim të thotë se krimet e këtij djali nuk mund të reduktohen vetëm në faktin se tani është shkatërrues me punët që ai bën aktualisht dhe se në të ardhmen ai do të bëjë krime shumë më të mëdha. Prandaj, vrasja e tij është në përputhje me ligjin, domethënë se vrasja e tij është e lejuar për shkak të krimeve që ai ka bërë.

Në lidhje me ngjarjen e tretë, askush s'ka mundësi të kundërshtojë sakrificën që dikush mund të bëjë për të tjerët, sidomos kur është fjala që atyre të tjerëve të mos u humbë pasuria dhe kur sakrifikuksi nuk kërkon asnjë shpërblim për punën e bërë, ashtu siç veproji Hidri. Në të vërtetë, puna që ai bëri nuk është prej punëve obligim, por ishte një punë që pa dyshim konsiderohet sjellje e mirë.

Nga ana e ligjit të fesë mund të thuhet se ndikimi për të mirë dhe sakrifica në disa raste është edhe obligim, si për shembull: një pasuri e madhe e një fëmije jetim ndodhet para rrezikut se mund të humbë, por është e mundur ruajtja e asaj pasurie vetëm më pak punë. Në këtë rast nuk përjashtohet që kryerja e asaj pune, sido që të jetë, është obligim.

Rruga e dytë: diskutimi i disa elementeve të ligjit të fesë që u trajtuan në rrugën e parë. Nëse sqarimet e mësipërme janë bindëse për sa i përket thesarit dhe murit, vrasja e djalit nuk është në harmoni në kuptimin e jashtëm të fjalëve të ajetit, që për vrasjen e djalit merr në konsideratë punët që ai do të bënte në të ardhmen dhe jo punët e tij konkrete.

Në lidhje me argumentin e çarjes së anijes, edhe ky argument nuk mbetet jashtë mendimit nëse nga ana e ligjit të fesë mund të lejohet shkatërrimi i një pjese të një pasurie, ose i një pjese të një shtëpie, pa pasur dijeni pronari i pasurisë, ose i shtëpisë, me qëllim për të shpëtuar atë pasuri apo pronë prej një rreziku të çfarëdoshëm. Madje, edhe kur e dimë mirë se rrëmbimi i asaj pasurie do të ndodhë në të ardhmen, vallë a e lejojnë juristët e ligjit të fesë (fukahatë) këtë lloj gjykimi?!

Mbështetur mbi këtë bazë, për ne bëhet detyrim të ecim në një rrugë tjetër.

Rruga e tretë: në këtë botë, dy sistemet e lartpërmendura, sistemi konstruktiv e sistemi ligjor, dhe pavarësisht se janë në harmoni me njëri-tjetrin në bazat e përgjithshme, të dy kanë dallime në pjesëzat.

Për shembull, All'llahu i Gjithëfuqishëm vë njerëzit në provë me anë të frikës, me pakësim të pasurive e të prodhimeve, me vdekjen e të afërmve ose me humbjen e tyre. Të gjitha këto me qëllim që të dallohet ai që bën durim prej atij që nuk bën durim, kur mbi atë bien ngjarje e pësime të rënda.

Pyetja që lind këtu është: a mundet një jurist i ligjit të fesë ose një Profet ta bëjë këtë sprovim? Pra, a ka mundësi që dikush të vërë njerëzit në sprovë me pakësim të pasurive e të prodhimeve, me humbjen e njerëzve të dashur, me mungesë sigurie e stabiliteti?

Shikojmë se All'llahu i Lartësuar i paralajmëron, i frikëson dhe i edukon disa prej Profetëve të Tij dhe disa prej robve të Tij të mirë me vështirësi të mëdha. Këtë e bën për shkak se ata kenë lënë pa bërë më të mirën e mundshme, ashtu siç u sprovua Hazreti Jakubi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) sepse u kushtonte pak vëmendje atyre që nuk kishin asnjë lloj pasurie, ose sprovua në të cilën u vu Hazreti Jùnus (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) sepse nuk bëri më të mirën e mundshme në disa punë, qoftë edhe për një kohë farë të shkurtër. Vallë, a ka të drejtë ndokush të bëjë të këtilla punë nën titullin e

dënimit të atyre Profetëve të nderuar dhe të atyre njerëzve të mirë?

Në vërejmë se All'llahu i Gjithëfuqishëm në disa raste e heq mirësinë që i është dhënë njeriut sepse ai nuk e falënderon për atë mirësi, si për shembull i mbyl pasurinë atij në det, ose i humb pasuritë e tij; ose njeriu preket prej një sëmundjeje sepse nuk e falënderon Zotin e tij për mirësinë e madhe që i ka dhënë kur ai gëzonte shëndet të plotë.

Pyetja këtu është: a ka mundësi që dikush, nisur nga ana ligjore, të heqë të mirën prej të tjerëve ose të lëshojë mbi ata sëmundje që dëmtojnë shëndetin e tyre sepse ata nuk kanë falënderuar dhe me pretekstin se po i vë ata në sprovë?

Shembuj si këta janë të shumtë dhe në vija të përgjithshme nxjerrin në dukje se bota e ekzistencës, sidomos krijimi i njeriut është realizuar në sistemin më të mirë, sistem në të cilin All'llahu i Lartësuar ka vënë një grup ligjesh e rregullash konstruktive, me qëllim që njeriu të ecë në rrugën e plotësimit. Kur njeriu mbetet prapa këtyre ligjeve e rregullave, menjëherë mbi atë do të bien veprime të kundërta të ndryshme.

Por nga pikëpamja e ligjeve dhe e rregullave të dispozitave, ne s'kemi mundësi të kategorizojmë punët në kuadrin e këtyre ligjeve konstruktive.

Për shembull, ne shikojmë se mjeku mund të presë gishtin e një personi me argumentin për të ndaluar që helmi të mos arrijë deri në zemrën e tij. Por a ka mundësi që çdo person të presë gishtin e një personi tjetër me argumentin e edukimit të tij, sepse ai nuk është treguar i durueshëm ose si dënim për shkak se nuk

ka falënderuar për mirësitë që i janë dhënë? (Natyrisht që vetëm Krijuesi mund ta bëjë këtë gjë, sepse vetëm veprimi i Tij është në harmoni me sistemin më të mirë.)

Tani, pasi u vërtetua e u sqarua se në botë janë dy sisteme, sistemi konstruktiv dhe sistemi ligjor, dhe se vetëm All'llahu është Gjykatësi e Sunduesi mbi këto dy sisteme, vetëkuptohet se s'ka asnjë pengesë që i Larti të urdhërojë një grup të zbatojë sistemin ligjor dhe në të njëjtën kohë të urdhërojë një grup engjëjsh ose disa njerëz (si për shembull Hidrin) të zbatojnë sistemin konstruktiv.

Nga këndvështrimi i sistemit konstruktiv s'ka asnjë ndalues që All'llahu i Lartësuar të vërë në sprovë një fëmijë që nuk ka arritur ende moshën e pjekurisë me një ngjarje të caktuar dhe më pas ky fëmijë të vdesë për shkak të asaj ngjarjeje. S'ka dyshim që All'llahu i Lartësuar ka dijeni të plotë për rreziqet e mëdha që do të vijnë prej këtij fëmije në të ardhmen. Gjithashtu, edhe qëndrimi në jetë i personave të kësaj kategorie plotësohet për një interes të përcaktuar, siç mund të jetë sprovimi e të tjera punë.

Gjithashtu s'ka asnjë ndalues që All'llahu të më vërë sot në sprovë me një sëmundje të rëndë dhe të bëjë që unë të qëndroj në shtrat me dijeninë e Tij të Lartësuar. Nëse do të dal prej shtëpisë, do të jem i ekspozuar ndaj një ndodhie shumë të rrezikshme, të cilën nuk e meritoj, prandaj ky është shkak që i Larti më mban larg asaj ndodhie.

Me fjalë të tjera, një grup prej njerëzve të dashur tek All'llahu janë të obliguar në këtë botë me punët e brendshme, ndërsa një grup tjetër janë të obliguar me punët e jashtme. Për të obliguarit me punët e brendshme ka rregulla, baza, e programe të

veçanta, ashtu siç ka edhe për të obliguarit me punët e jashtme rregulla dhe baza të veçanta.

Është e vërtetë që linja e përgjithshme e këtyre dy programeve e çon njeriun drejt plotësimit, gjithashtu është e vërtetë që këto dy programe janë në harmoni nga pikëpamja e rregullave të përgjithshme, por ato kanë dallime në pjesëzat, ashtu siç e pamë në shembujt e mësipërm.

Natyrisht, askush nuk mund të veprojë sipas qejfit brenda këtyre dy linjave, pa pasur leje prej Sunduesit të Gjithëfuqishëm, të Urtit, Krijuesit të Lartësuar, prandaj ne shikojmë që Hidri (mësuesi i madh) e shpjegon qartë këtë të vërtetë duke thënë: **“Unë nuk e bëra atë (punë) sipas bindjes sime.”**. Domethënë, në të gjitha punët kam vepruar në përputhje me programin Hyjnor dhe me rregullat që më ishin vënë.

Me këtë shpjegim bie edhe kontradikta në pyetjet e në problemet që u theksuan rreth qëndrimeve të Hidrit në të tria ngjarjet.

Edhe mospërmbajtja nga ana e Mùsàsë (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!*) kundrejt punëve të Hidrit ka të bëjë me misionin e Mùsàsë, që ishte krejtësisht i kundërt me misionin e Hidrit në këtë botë. Prandaj, Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!*) fillon të kundërshtojë punët e Hidrit, që janë në kundërshtim me rregullat e ligjit të fesë. Ndërsa Hidri vazhdonte në rrugën e tij me gjakftohtësi, sepse detyra e secilit prej këtyre dy të Dërguarve të Zotit është e ndryshme, sepse roli i çdo njeri prej atyre të dyve është me përcaktimin Hyjnor, prandaj ata të dy nuk mund të bashkëjetojnë. Pikërisht për këtë, Hidri i tha Mùsàsë

(*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*): **“Tani erdhi koha të ndahemi.”**

2- Kush është Hidri?

Ne pamë se Kur'ani Famëllartë flet për dijetarin dhe nuk e përmend emrin Hidër, por e cilëson mësuesin e Mūsasë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) me fjalën e të Lartit: “një rob prej robërve Tanë”: **“...një rob prej robërve Tanë, të cilit nga ana Jonë i kemi dhuruar mëshirë dhe prej Nesh atij i është mësuar dituri e posaçme.”**. Ajeti e shpjegon qartë pozitën e lartë të nënshtrimit të plotë ndaj All'llahut dhe ndaj diturisë, prandaj edhe ne, në shumicën e rasteve e kemi përmendur atë me epitelin burri i ditur.

Në transmetimet islame të ardhura nga burime të shumta, ky burrë njihet me emrin Hidri. Gjithashtu, në disa prej këtyre transmetimeve mësohet se emri i tij i vërtetë ishte Jelija bin Melkàn, kurse emri Hidër është një epiteli i tij, në analogji me kuptimin e fjalës “hidër” – “gjelbërim” për shkak se kudo që shkelte këmba e tij mbi tokë, vendi poshtë këmbëve të tij gjelbëronte.

Disa kanë shprehur mundësinë që emri i këtij burri të ditur ishte Iljas, prej këtui del qartë mendimi se Iljas dhe Hidër janë dy emra për të njëjtin person.

Megjithëkëtë në mesin e interpretuesve të Kur'anit dhe të përcjellësve të transmetimeve më i përhapur është emri i parë.

Është normale që të themi se emri i burrit të ditur, sido që të quhej ai, nuk është i rëndësishëm as për përmbajtjen, as për qëllimin e tregimit. E rëndësishme është që të dimë se ai ishte

dijetar Hyjnor, të cilin e kishte përfshirë mëshira e veçantë e Zotit dhe ishte i obliguar me të brendshmen e sistemit konstruktiv të botës. Ai njihte disa sekrete dhe ishte mësuesi i Mùsà bin Imrànit, megjithëse Mùsà (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) është më i lartë e më i mirë se ai nga disa anë.

Gjithashtu ka pikëpamje e transmetime të ndryshme nëse ishte Hidri profet apo jo.

Në vëllimin e parë të librit “Usùlul Kàfij” janë përmendur transmetime të ndryshme që tregojnë se ky burrë nuk ishte profet, por ishte dijetar ashtu si Dhulkarnejni dhe Àsef bin Berkhijà.¹

Prej disa transmetimeve të tjera mësojmë se ai ishte Profet, madje edhe disa prej ajeteve të lartpërmendura e tregojnë këtë kuptim, sepse ato thonë me gjuhën e tij: **“Unë nuk e bëra atë (punë) sipas bindjes time.”**. Më sipër ka ardhur edhe fjala tjetër e tij: **“Ne deshëm që Zoti i tyre t’ua zëvendësojë atë me një më të mirë se ai.”**.

Gjithashtu prej disa transmetimeve të tjera mësojmë se Hidri ka jetuar shumë gjatë.

Këtu mund të shtrohet pyetja: a është përmendur tregimi i Mùsàsë dhe i këtij dijetari të madh në burimet e jehuditëve dhe të krishterëve?

Në përgjigje themi: nëse qëllimi është për dy librat qiellorë (Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re), domethënë Teuràti dhe Inxhili

¹ “Usùlul Kàfij”, vëll. 1, kapitulli: “Imamët dyshojnë për ata që kanë kaluar”, f. 210.

(Ungjilli), ky tregim nuk përmendet në asnjërin nga këta dy libra. Por, për sa u përket librave të dijetarëve jehuditë të shkruar në shekullin e njëmbëdhjetë të erës së re, aty gjendet një tregim shumë i ngjashëm me tregimin e takimit të Mūsasë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) me dijetarin e kohës së tij. Gjithashtu duhet theksuar se dy heronjtë e përmendur në tregimin e shkruar në shekullin e njëmbëdhjetë të erës sonë quhen Iljās dhe Jùsheë bin Lāvij. Të dy janë interpretues të Talmudit në shekullin e trembëdhjetë të erës tonë. Vetëkuptohet që ky tregim ndryshon në disa anë prej tregimit të Kur'anit në lidhje me takimin e Mūsasë me Hidrin. Tregimi i shkruar në shekullin e njëmbëdhjetë është si vijon:

“Ai, domethënë Jùsheë, i kërkoi All'llahut të takohej me Iljasin. Sapo lutja e tij u pranua dhe ai pati fatin e mirë të takohej me të, filloi t'i lutej atij që t'i mësonte disa prej sekreteve. Iljasi i përgjigjet atij: 'Ti s'ke fuqi të mbash këtë'. Por Jùsheë këmbënguli në kërkesën e tij dhe kështu Iljasi ia plotësoi atë, duke i vënë kusht që të mos e pyesë për asgjë që do të shohë. Kur, Jùsheë nuk do t'i përmbahet këtij kushti, atëherë Iljasi është i lirë të ndahet prej tij. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, Jùsheë dhe Iljasi morën rrugën së bashku.

Gjatë udhëtimit të tyre, ata hynë në një shtëpi ku i zoti i shtëpisë i priti shumë ngrohtë dhe me respektin më të madh. Ata mësuuan se pasuria e vetme për të gjithë njerëzit e kësaj shtëpie ishte vetëm një lopë, me të cilën siguronin ushqimin, duke shitur qumështin që merrnin prej saj. Megjithëkëtë, Iljasi e urdhëron të zotin e shtëpisë ta thërë këtë lopë. Ndërkaq, Jùsheë u çudit prej këtij veprimi dhe pyeti për shkakun përse duhej bërë kjo. Mirëpo,

Iljasi i kujtoi marrëveshjen që kishin bërë dhe e kërcënoi se do të ndahej prej tij, kështu që Jùsheë heshti.

Prej këtui, të dy vazhduan udhëtimin në drejtim të një fshati tjetër dhe hynë në shtëpinë e një personi të pasur. Iljasi u drejtua nga një mur i kësaj shtëpie që ishte gati të rrëzohej dhe e riparoj atë. Në një fshat tjetër ata takuan disa banorë të fshatit që ishin mbledhur në një vend të caktuar. Banorët e fshatit nuk i kushtuan asnjë vëmendje dy të ardhurve dhe nuk i pritën me respekt. Iljasi ngrihet e bën një lutje që ata të gjithë të arrijnë kryesinë. Në një fshat të katërt, banorët e fshatit i presin ata me respekt të lartë dhe Iljasi lutet që vetëm një person prej atyre të arrijë në kryesi. Ndërkaq Jùsheë bin Làvij nuk po duronte më shumë, prandaj filloi të pyesë për katër ndodhitë. Iljasi i përgjigjet: ‘Në shtëpinë e parë, gruaja e të zotit të shtëpisë ishte e sëmurë dhe nëse ajo lopë nuk do të therej dhe mishi i saj të shpërndahej si sadaka, gruaja do të vdiste dhe i zoti i shtëpisë do të pësonte një humbje shumë më të madhe sesa humbja që do të kishte prej therjes së lopës. Në shtëpinë e dytë kishte një thesar që duhej ruajtur për një fëmijë jetim prej tyre. Iljasi i tha se ai u lut për banorët e fshatit të parë që ata të gjithë të arrinin kryesinë, me qëllim që punët e tyre të mos trazoheshin dhe sistemi i tyre të mos prishej. Por, ai bëri një lutje të kundërt për banorët e fshatit tjetër, të cilët nëse do t’i besonin drejtimin e punëve të tyre vetëm një njeriu, me siguri që punët e tyre do të sistemoheshin dhe do të shkonin si s’ka më mirë’’.¹

Del detyrë të mos pandehim se ne në të dy tregimet shikojmë një tregim të vetëm, pasi qëllimi ynë është të theksojmë se ka mundësi që tregimi që kanë përmendur dijetarët jehuditë, të

¹ Pjesa e mësipërme është cituar prej librit “A’lâmul Kur’ân”, f. 213.

jetë një tregim i ngjashëm ose i deformuar i ngjarjes origjinale të takimit të Mùsàsë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) me Hidrin. Tregimi mund të ketë ndryshuar edhe për shkak të kohës së gjatë, derisa është bërë në formën që u tha më sipër.

3- Legjendat e sajua

Bazë në tregimin e takimit të Mùsàsë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) me Hidrin është vetëm ajo që thuhet në Kur'an. Por, për fat të keq ka edhe shumë legjenda që janë pranuar rreth këtij tregimi dhe dy heronjve të tij (Mùsàsë dhe Hidrit). Madje, disa shtesa i japin tregimit karakter mitik, prandaj patjetër duhet të dimë se e ardhmja e shumë tregimeve nuk ndryshon shumë nga e ardhmja e këtij tregimi, mbi të cilin janë sajuar e janë thënë shumë fjalë.

Kriteri ynë matës për të përcaktuar vërtetësinë e tregimit është që të kemi parasysh njëzet e tre ajetet e mësipërme të kësaj sureje, madje edhe në raport me hadithet e me transmetimet islame që flasin për tregimin e takimit të Mùsàsë me Hidrin, me kusht që ne i gjejmë ato hadithe e transmetime në përputhje me ajetet e Kur'anit. Kur një hadith ose një transmetim nuk përputhet me ajetet e Kur'anit, pa dyshim që ne atë e refuzojmë. Do të ishte shumë mirë që ndër këto hadithe e transmetime të mos kishte prej atyre që merren në konsideratë.

4- A mund të preken Profetët nga harresa?

Më sipër u ballafaquam disa herë me harresën nga ana e Mùsàsë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*), kur ishte fjala për peshkun që ata kishin përgatitur për të drekuar, si dhe me harresën e tij edhe tri herë të tjera gjatë ngjarjeve që ndodhën pas takimit të tij me Hidrin, kur ai e harroi premtimin e dhënë!

Atëherë jemi para pyetjes: a ndodh të harrojnë Profetët?

Disa mendojnë se një harresë e tillë u ka ndodhur Profetëve, sepse kjo lloj harrese s'ka asnjë lidhje as me bazën e thirrjes, as me degët e thirrjes dhe as me kumtimin e thirrjes së Profetëve. Pasi, harresa ka ndodhur për probleme të zakonshme që kanë të bëjnë me jetën e përditshme. Është aksiomë që nuk mund të diskutohet që Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk mund të preket nga harresa në bazën e thirrjes profetike, gjithashtu ai nuk gabon, as nuk dyshon në kumtimin e Mesazhit, pasi kujdesi i veçantë i All'llahut e ruan atë prej dukurive të tilla.

Por, s'ka asnjë ndalues që Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) të harrojë ushqimin e tij, që është prekur nga kjo lloj harrese, veçanërisht kur kjo harresë është diçka e natyrshme, sidomos kur marrim parasysh se Mùsài ishte krejtësisht i përqendruar me të gjitha shqisat e tij në kërkim të burrit të ditur.

Pastaj, cili është penguesi që Mùsài të mos preket prej zemërimit që e bën të harrojë dhe premtimin e dhënë shokut të tij të ditur, kur ai pa ato ndodhi të rënda, siç qe vrasja e fëmijës, çarja e anijes dhe ndërtimi i murit në qytetin e njerëzve koprracë?

Burimet e kësaj harrese nuk janë në kundërshtim me pozitën e ruajtjes prej gabimeve (ismet), prandaj prej kësaj harrese nuk përjashtohet asnjë Profet.

Disa interpretues të Kur'anit janë shprehur se këtu harresa ka kuptim alegorik, domethënë heqje dorë, sepse kur njeriu lë një send ose heq dorë prej tij, është si ai që e ka harruar atë send. Për sa i takon pyetjes se përse Mùsài e la ushqimin e tij, kjo ka të bëjë me faktin se ai nuk ishte i interesuar për punë të tilla. Ndërsa në lidhje me premtimin që ai i bëri shokut të tij dijetar, patjetër duhet theksuar se thyerja e tij nga Mùsài erdhi vetëm atëherë kur ai pa ngjarjet e rënda të ndodhin para syve të tij. Nuk është veprim i zakonshëm që një person të vërë në rrezik jetët e pasuritë e tjerëve ose të dëmtojë njerëzit e pasuritë që ata kanë, për më tepër kur ky person është dijetari i madh. Prandaj, Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!*) e konsideronte veten të obliguar të kundërshtonte, sepse ishte i bindur që kjo nuk mund të kushtëzohej me premtimin.

Është e qartë që këto interpretime dhe opinione nuk janë në harmoni me kuptimin e jashtëm të fjalëve të ajetit.

5- Përse shkoi Mùsài të takohej me Hidrin?

Në një hadith të transmetuar prej Ibni Ab'bàsit tregohet se ai ka thënë: “Më njoftoi Ubej bin Ka'b e më tha: ‘I Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) na mbajti një predikim dhe tha: “Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!*) gjatë një bisede me Beni Isràilët është pyetur se cili është njeriu më i ditur dhe ai u përgjigj: ‘Unë’.

All'llahu i Lartësuar e qortoi, pasi atij nuk i është dhënë dituria, prandaj i zbriti Revelatën dhe e njoftoi: 'Një robi Im gjendet aty ku bashkohen dy detet , ai është më i ditur se ti'.

Mùsàì tha: 'O i madhi Zot, si do të takohem me atë?'

I tha: 'Merr me vete një peshk...'¹, deri në fundin e tregimit dhe i Larti e udhëzoi Profetin e Tij Mùsà si të arrinte te ky burrë i ditur''.

Një transmetim i ngjashëm është edhe transmetimi i ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*).²

Kuptimi kësaj ngjarjeje është paralajmërimi e qortimi i Mùsàsë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*), që të mos e konsiderojë veten njeriun më të mirë, pavarësisht nga dituria e njohja që ai kishte.

Këtu lind edhe pyetja vijuese: a nuk duhet që Profeti të jetë më i dituri i njerëzve të kohës së tij? Këtu bëhet fjalë për një profet prej atyre që janë cilësuar "zotërues të vendosmërisë" (ulul-azmi) dhe mbajtës të një mesazhi qiellor.

Në shpalosje të përgjigjes themi: po, patjetër duhet të jetë njeriu më i ditur për sa i përket misionit të tij, domethënë është më i dituri në fushën e sistemit ligjor. Mùsàì (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) ishte njeriu më i ditur i kohës së vet në këtë fushë. Për sa i përket burrit të ditur Hidri, ashtu siç kemi thënë edhe më lart, ai kishte një mision të kundërt me misionin e Mùsàit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) pasi misioni i

¹ "Mexhmaul Bejàn", vëll. 3, f. 481.

² "Nüruruth Thekalejn", vëll. 2, f. 285.

Hidrit nuk kishte asnjë lidhje me legjislacionin. Me fjalë të tjera, burri i ditur kishte dijeni për sekrete mbi të cilat nuk mbështetej thirrja profetike.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) tregohet se Imami ka thënë: “Mùsàì ishte më i ditur se Hidri”¹; domethënë ishte më i ditur se ai në fushën e legjislacionit.

Këtu konstatojmë se ky dyshim dhe çështja e harresës nga ana e Mùsàsë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) i kanë shtyrë disa interpretues të Kur'anit të thonë se Mùsàì i përmendur në këtë tregim nuk është Mùsà bin Imràñ, por një person tjetër. Gjithsesi, krahas zgjidhjes së këtij problemi, nuk mbetet më vend të flitet për këtë çështje.

Në një transmetim të ardhur prej Imamit Ali bin Mùsà Err Rridà theksohet qartë se misioni dhe detyra që mbante Mùsàì dhe misioni e detyra që mbante Hidri ishin të ndryshme. Dikush i shkroi Imamit Rrida (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e pyeti për dijetarin tek i cili shkoi Hazreti Mùsàì se cili prej atyre të dyve ishte më i ditur. Imami (*Paqja qoftë mbi të!*) i përgjigjet kësaj pyetjeje me këto fjalë: “Mùsàì shkoi te dijetari dhe e gjeti tek rrinte ndenjmur ose mbështetur në një ishull prej ishujve të detit. Mùsàì e përshëndeti me selam, por ai nuk e pranoi selamin, sepse toka aty nuk ishte tokë paqeje, por e pyeti: ‘Kush je ti?’ Ai u përgjigj: ‘Unë jam Mùsà bin Imràñi’; ai tha: ‘Ti qenke Mùsà bin Imràñ, të cilit All'llahu i ka folur drejtpërdrejt?’ Ai tha: ‘Po’; ai e pyeti: ‘Ç’nevojë ke?’ Ai i tha: ‘Erdha te ti që të mësosh udhën e drejtë’. Ai i tha: ‘Unë jam

¹ Tefsiri “El Mizàn”, vëll. 13, f. 356.

obliguar me një punë që ti nuk e mban dot, por edhe ti je obliguar me një punë që unë nuk e mbaj dot.”¹

Është e përshtatshme të mbyllim këtë paragraf me transmetimin e ardhur në librin “Ed’durr’rrul-Menthùr”, prej El Hàkim En Nijàsaurij’jit, ku tregohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kur u takua Mùsài me Hidrin erdhi një shpend dhe e futi sqepin në ujë. Hidri i tha Mùsàsë: ‘Ç’na thua për këtë shpend?’ Ai tha: ‘Çfarë thotë ai?’ Ai tha: ‘Shpendi thotë: dituria jote dhe dituria e Mùsàsë në diturinë e All’llahut është aq sa sasia e ujit që merr sqepi im.”².

6- Ç’ishte thesari?

Prej pyetjeve që shtrohen rreth këtij tregimi janë edhe pyetjet: “I ç’natyre ishte thesari? Përse shoku i Mùsàsë këmbënguli që ta fshihte atë? Përse burri besimtar, domethënë baba i jetimëve e kishte mbledhur dhe fshehur atë thesar?”

Disa interpretues janë të mendimit se thesari simbolizon diçka morale dhe nuk është në kuptim material.

Ky thesar, ashtu siç njoftojnë transmetimet e shumta të përcjella me rrugët e njohura të Ehli Sun’netit dhe të Imamive, s’ishte gjë tjetër veçse një pllakë mbi të cilën ishin gdhendur disa fjalë të urta.

¹ “Mexhmaul Bejàn”, vëll. 6, f. 480 dhe “El Mizàn”. Vëll. 13, f. 356.

² “Ed Durrul Menthùr” dhe burime të tjera, në përputhje me atë që ka cituar autori i tefsirit “El Mizàn” në vëll. 13, f. 356.

Por, ç' shih këto fjalë të urta? Në lidhje me këtë çështje, ndër interpretuesit e Kur'anit ka shumë thënie.

Në librin “El Kàfij”, cituar prej Imamit në përgjigjen që ai dha për pyetjen e bërë në lidhje me natyrën e thesarit, thuhet: “Ai thesar nuk ishte as flori, as argjend, por në të vërtetë ishin katër fjali: *“lâ ilâhe il'llëll'illâh”* – *“s'ka zot tjetër përveç All'llahut”*; *“kush bindet për vdekjen nuk qesh”*; *“kush bindet se do të japë llogari, zemra e tij nuk gëzohet”* dhe *“kush bindet për kaderin, ai ka frikë vetëm All'llahun”*¹.

Në një transmetim tjetër thuhet se pllaka ishte prej floriri. Në fakt këtu s'kemi asnjë kontradiktë në mes dy transmetimeve, sepse qëllimi i transmetimit të parë ishte të bënte të qartë se thesari nuk ishte as monedha flori e as monedha argjendi.

Sikur të supozojmë se ne po marrim kuptimin e jashtëm të fjalës thesar, këtë fjalë ne e shpjegojmë se është një sasi floriri dhe me këtë shpjegim nuk përballemi me asnjë lloj problemi, sepse thesari i ndaluar ligjërisht është kur njeriu mbledh një sasi të madhe parash dhe e ruan atë për një kohë të gjatë, në një kohë kur shoqëria ka nevojë për ato para, por nëse dikush gropos në tokë paratë e tij për një ditë, ose për disa dit, ashtu siç ishte zakoni në kohët e përparshme për shkak të mungesës së sigurisë, por më pas ky njeri vdes aksidentalisht, në këtë gjendje s'ka asnjë problem në lidhje me marrjen e një thesari të këtillë.

¹ “Nüruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 287.

7- Mësimet e këtij tregimi

Prej këtij tregimi përfitojmë një tubë mësimesh, të cilat ne mund t'i rendisim si më poshtë:

a: Rëndësia e madhe e gjetjes së një udhëheqësi dijetar dhe përfitimi prej diturisë së tij. Ne pamë se edhe një Profet i madh prej Profetëve të cilësuar “*zotërues të vendosmërisë*” (ulul-azmi), siç ishte Hazreti Mūsai (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!*) ndjek këtë rrugë të gjatë dhe derdh jo pak mund për të realizuar këtë qëllim. Ky është një mësim për të gjithë njerëzit e çdo shkalle diturie dhe të çdo moshe qofshin.

b: Thelbi i diturisë Hyjnore buron prej nënshtrimit të plotë ndaj All'lahut të Lartësuar, ashtu siç e lexuam në ajetet e mësipërme fjalën e të Lartit: **“Një rob prej robërve Tanë të cilit prej Nesh i është mësuar dituri e posaçme.”**.

c: Është detyrim të mësohet dituria për të punuar, ashtu siç i thotë Mūsai shokut të tij: **“që të më mësosh prej diturisë së vërtetë që të është mësuar (dhuruar) ty”**; domethënë, më mëso mua një punë e cila më afron te qëllimi im, sepse unë nuk të kërkoj dituri për veten time, por për të arritur te qëllimi.

d: Është detyrim mosnxitimi në punë, pasi shumë punë kanë nevojë të bëhen në raste të përshtatshme (punët janë peng i kohëve të tyre), sidomos kur bëhet fjalë për probleme të rëndësishme ashtu siç veproi burri i ditur, i cili priti rastin e përshtatshëm që t'i fliste Mūsasë për sekretin e punëve.

e: Ana e jashtme dhe e brendshme e çështjeve që mësojmë prej tregimit na ngarkon me detyrimin për të mos marrë vendime

të shpejta kundrejt ngjarjeve që mund të rrjedhin në jetën tonë, madje edhe kundrejt ngjarjeve që na çudisin. Janë të shumta ngjarjet që ne i urrejmë, por, pas një kohe bëhet e qartë se ato ngjarje nuk ishin gjë tjetër veçse një lloj i dashamirësisë së fshehtë Hyjnore. Kur'ani Famëllartë e deklaroi përmbajtjen e kësaj të vërtetë Hyjnore në fjalën e të Lartit: **“Mbase ju mund të urreni një send, por ai është shumë i dobishëm për ju; mbase ju mund të doni një send, por ai është dëm për ju; All'Ilahu e di dhe ju nuk e dini.”** (sure “El Bekareh”, ajeti 216).

Ajo që përfitohet prej këtij tregimi është se njeriu nuk duhet të bjerë në dëshpërim kur mbi të vërshojnë ngjarje të rënda. Me këtë rast do të lexojmë një transmetim të këndshëm e shumë domethënës, të cilin e përcjell Abdullahu nga dijetari e juristi i shquar Zeràreh bin A'jun. Abdullahu tregon: “Ebù Abdullahu (Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*)) më tha: ‘Bëji shumë selam prej meje babës tënd dhe i thuaj: ‘Të qortoj që më mbrojte’. Njerëzit nxitojnë të shkojnë te cilido që është i afërt me ne; ne e falënderojmë atë që futi mundimin e fyerjen në atë që ne e duam dhe e mbajmë afër. Ata e shajnë atë pse ai ka dashuri për ne dhe pse është i afërmi ynë e rri pranë nesh; ata mendojnë si ta fyejnë e si ta mundojnë atë, madje edhe ta vrasin, ata lavdërojnë cilindo që na qorton ne. Unë të qortoj sepse ti je burrë i shquar në mesin tonë, ti anon nga ana jonë dhe je me autoritet te ne, por për këtë ti je i poshtëruar te njerëzit, ti nuk je i lavdëruar për punët që ke bërë për hir të dashurisë që ke për ne dhe për shkak se je i prirur të jesh me ne. Unë dua të të qortoj kur ata lavdërojnë punën tënde në fe me të metën tënde, sepse kjo është sprapsja e të keqes së tyre prej teje. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Për sa i përket anijes, ajo ishte pronë e disa të varfërve që punojnë në det; (por) desha ta bëj atë**

me të meta, sepse prapa tyre është një sundimtar që rrëmben çdo anije (në gjendje të mirë, pa të meta).”. Kjo ka zbritur prej All’llahut, pasha All’llahun unë e shpova anijen vetëm e vetëm që ta shpëtoj prej mbretit dhe anija nuk pësoi ndonjë gjë prej duarve të mija; falënderimi e lavdërimi i takojnë vetëm All’llahut që anija mbeti në gjendje të mirë, pavarësisht nga çarja që i bëra unë. All’llahu të mëshiroftë, kuptoje shembullin që të solla, sepse ti, betohem në All’llahun, je njeriu më i dashur për mua dhe më i dashuri i shokëve të babait tim, të gjallë e të vdekur! Në të vërtetë, ti je anija në detin e dallgëzuar, prapa teje qëndron një mbret mizor e rrëmbyes që kontrollon kalimin e çdo anije të mirë që lundron në detin e udhëzimit në rrugën e drejtë. Mbreti ka qëllim të rrëmbejë atë anije, së bashku me njerëzit që janë në atë anije. All’llahu të mëshiroftë tani që je në këtë jetë dhe mëshira e kënaqësia e All’llahut qoftë për ty edhe pas vdekjes!”.¹

f: Prej mësimave të tregimit është njohja e të vërtetave dhe marrja e qëndrimeve në përputhje me to.

Kur Mūsai nuk e mbajti premtimin që i kishte dhënë shokut të tij dijetar tri herë më radhë, mësoi se nuk ishte e mundur të vazhdonte të shoqërohej më shumë me atë, ndonëse ndarja prej këtij mësuesi ishte shumë e vështirë për Mūsanë (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*). Kjo për arsye se ai nuk tregoi maturi për të respektuar mësuesin e madh ashtu siç e meritonte. Megjithatë, ai u nda prej tij vetëm pasi arriti të mësojë të vërtetat e mëdha dhe vetëm pasi mori thesare morale kaq të larta prej këtij shoqërimi kaq të shkurtër me dijetarin.

¹ “Mu’xhemu Rixhālul Hadijthi”, vëll. 7, f. 226.

Njeriu ka detyrë të mos vazhdojë të vërë në provë veten deri në fundin e jetës së tij, në atë mënyrë që jeta e tij të kthehet në një laborator për punët që ai do të bëjë në të ardhmen, punë të cilat mbase ai nuk do t'i bëjë kurrë. Por, kur e provon një problem të çfarëdoshëm disa herë, ka detyrim të përkushtohet të punojë sipas rezultateve më të mira të dala nga kjo provë dhe të mbetet i kënaqur me provën e bërë.

g: Ndikimi i besimit të prindërve te fëmijët.

Hidri mbajti përgjegjësinë e ruajtjes së fëmijëve në atë masë që ai kishte mundësi dhe kjo për shkak të babait të mirë e të përkushtuar. Fëmija mund të jetë i lumtur nën hijen e besimit, besnikërisë dhe përkushtimit të prindërve. Rezultati i punës së mirë që bën babai, i kalon edhe fëmijës.

Në disa transmetime lexojmë se ky burrë i mirë nuk ishte baba natyral i jetimëve, por ishte prej gjyshërve të tyre shumë të largët. (Ja kështu e ka efektin e saj puna e mirë¹). Një nga shenjat që tregon se ky baba ishte njeri i mirë është edhe thesari moral i fjalëve të urta që ai kishte lënë për fëmijët e tij.

h: Shkurtimi i jetës për shkak të lëndimit të dy prindërve.

Kur vdekja shtrin krahun e saj mbi djalin për shkak të fyerjeve që ai do t'u bëjë prindërve të tij në të ardhmen, për shkak të mundimeve që ai u shkaktonte atyre apo për shkak të sjelljeve të tij të liga ndaj tyre, madje ai edhe do të tentojë t'i devijojë prindërit e tij nga rruga e së vërtetës Hyjnore, ashtu siç e pamë në tregimin tonë, transmetimet islame bëjnë lidhjen mes jetës së shkurtër dhe

¹"Nûruth Thekalejn", vëll. 3, f. 289.

mbajtjes së lidhjeve me të afërmit (në mënyrë të veçantë fyerja e prindërve dhe shkelja e të drejtave të tyre). Disa nga këto çështje i kemi trajtuar në fundin e bisedës rreth ajetit 23 të sures “El Isrà”.

Duhet patjetër të përvetësojmë mësimet në kuadrin e kësaj ane të tregimit; fëmija u vra për shkak të dëmit e të fyerjeve që do t’u bënte prindërve të tij në të ardhmen. Pa mendo pak si do të jetë gjendja e atij që ushtron dhunë mbi prindërit e tij, i fyen e i mundon ata dhe nuk i kryen detyrimet që fëmija ka detyrë të plotësojnë ndaj prindërve të tij.

i: Njerëzit janë armiq të asaj që nuk e dinë e nuk e njohin.

Ndodh që një person tregohet bamirës ndaj nesh, megjithëkëtë ne e konsiderojmë atë armik, sepse ne nuk e dimë si është brendia e punëve, por nxitohemi dhe humbin durimin, veçanërisht kundrejt ngjarjeve e punëve që nuk i njohim e nuk dimë si janë, madje as që kemi dijeni fare për shkaqet e atyre punëve. Është e natyrshme që njeriu të humbë durimin kundrejt ngjarjeve e problemeve për të cilat ai s’ka dijeni, por mësimi që përfitohet prej tregimit na thotë të mos nxitohemi për të dhënë gjykimin tonë për të tilla probleme, derisa atë problem ta shoshitim nga të gjitha anët.

Në një transmetim të ardhur prej Prijësit të Besimtarëve Ali bin Ebù Tàlibit lexojmë fjalën e tij: “Njerëzit janë armiq të asaj që nuk e njohin”.¹ Prandaj sa herë që te një njeri ngrihej ndërgjegjësimi, qëndrimi që ai mbante ndaj këtij njeri ishte edhe më shumë logjik. Pra, baza e durimit është të kuptuarit mirë të punëve.

¹ “Nehxhul Belàga” – fjala e urtë, nr. 438.

Natyrisht që shqetësimi i Mùsàsë (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!*) kishte edhe justifikues: kur ai shikonte tejkalim të kufijve të ligjit të fesë në veprimet që bënte shoku i tij, që në pjesën më të madhe vinin në rrezik vetë ligjin. Në ngjarjen e parë u vu në rrezik paprekshmëria e pasurive të njerëzve; në të dytën u vu në rrezik jeta e njerëzve, kurse në ngjarjen e tretë, kundërshtimi i Mùsàsë kishte të bënte me domosdoshmërinë e trajtimit logjik të të drejtave të njerëzve. Prandaj, ai kundërshtoi dhe e harroi premtimin që i kishte dhënë shokut të tij dijetar, por sapo mësoi edhe brendinë e punëve të tij, menjëherë hoqi dorë nga kundërshtimi. Ky veprim i Mùsàsë tregon se mospasja dijeni në vetvete është një problem shumë shqetësues.

j: Edukata e nxënësit dhe e mësuesit.

Disa konstatime të këndshme që kanë të bëjnë me edukatën e nxënësit dhe mësuesit, bëhen të qarta në disa pjesë të bisedës që zhvilloi Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!*) me dijetarin hyjnor. Ja disa prej këtyre konstatimeve:

1- Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!*) e konsideroi veten e tij ndjekës të Hidrit dhe kjo shihet qartë në fjalën e tij: **“A të të ndjek ty?”**.

2- Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!*) e shpalli këtë ndjekje në formën e kërimit të lejes kur i tha: **“A pranon që unë të vij me ty?”**.

3- Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!*) pohon se mësuesi i tij është dijetar dhe se ai ka nevojë të mësojë, prandaj i thotë **“të më mësosh mua”**.

4- Nga modestia, ai e konsideron diturinë e mësuesit të tij të shumtë, prandaj kërkon vetëm diçka prej asaj diturie dhe thotë: **“prej asaj...”**.

5- E konsideron diturinë e mësuesit të tij dituri Hyjnore dhe thotë: **“që ti u mësove”**.

6- Kërkon prej mësuesit të tij udhëzimin në rrugën e drejtë dhe i thotë: **“diturisë së vërtetë”**.

7- Me një mënyrë të kamufluar shumë bukur i thotë mësuesit të tij: All’llahu shfaq mirësinë e Tij dhe të mësoi ty, prandaj edhe ti shfaq mirësi ndaj meje dhe: **“të më mësosh prej diturisë së vërtetë që të është mësuar (dhuruar) ty”**.

8- Frazja: **“A pranon që unë të vij me ty?”** zbulon një të vërtetë të madhe: nxënësi jo vetëm që e kërkon mësuesin, por kërkon që edhe të ndjekë mësuesin. Domethënë nuk është detyrë e mësuesit të ndjekë nxënësin e tij, me përjashtim të gjendjeve e rasteve të veçanta.

9- Pavarësisht nga pozita e lartë që kishte (ishte prej Profetëve *“zotërues të vendosmërisë”* (ulul-azmi), ishte mbajtës i Mesazhit Hyjnor dhe kumtues i një libri qiellor), Mūsai (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*) ishte shumë kryeulët. Kjo do të thotë: sido që të jesh e pavarësisht se çfarë posti mban, ke detyrë të jesh kryeulët, veçanërisht kur kërkon dituri e mësim.

10- Mūsai (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*) nuk e tha me fjalë të prera nga ana e tij premtimin që i bëri mësuesit të tij, por tha: **“Dashtë All’llahu do të shikosh se do të jem i durueshëm”**. Kjo formë shprehjeje është e mbushur me edukatë

ndaj Krijuesit të Gjithëfuqishëm dhe ndaj mësuesit. Prandaj, edhe mosmbajtja e premtimit nuk tregon mungesë respekti ndaj mësuesit.

Është e domosdoshme të kujtojmë në mbyllje të kësaj bisede se edhe dijetari hyjnor tregoi ndaj Mùsàsë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) shkallën më të lartë të butësisë gjatë dhënies së mësimit. Kur Mùsài (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*) harronte premtimin e dhënë, kur revoltohej kundër tij dhe e kundërshtonte, mësuesi i përgjigjej atij me qetësi e gjakftohtësi në formë pyetje: **“A nuk të thashë ty se nuk mund të bësh durim me mua?”**.

Ajetet 83 - 91

وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ ذِي الْقَرْنَيْنِ ^ط قُلْ سَأَتْلُوا عَلَيْكُمْ مِنْهُ ذِكْرًا ﴿٨٣﴾ إِنَّا
 مَكَّنَّا لَهُ فِي الْأَرْضِ وَءَاتَيْنَاهُ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ سَبَبًا ﴿٨٤﴾ فَاتَّبَعَ سَبَبًا ﴿٨٥﴾
 حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ مَغْرِبَ الشَّمْسِ وَجَدَهَا تَغْرُبُ فِي عَيْنٍ حَمِئَةٍ وَوَجَدَ
 عِنْدَهَا قَوْمًا ^ظ قُلْنَا يَذَا الْقَرْنَيْنِ إِمَّا أَنْ تُعَذِّبَ وَإِمَّا أَنْ تَتَّخِذَ فِيهِمْ حُسْنًا
 ﴿٨٦﴾ قَالَ أَمَّا مَنْ ظَلَمَ فَسَوْفَ نُعَذِّبُهُ ثُمَّ يُرَدُّ إِلَىٰ رَبِّهِ فَيُعَذِّبُهُ عَذَابًا
 نُكَرًا ﴿٨٧﴾ وَأَمَّا مَنْ ءَامَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَلَهُ جَزَاءٌ أَحْسَنُ ^ط وَسنَقُولُ لَهُ
 مِنْ أَمْرِنَا يُسْرًا ﴿٨٨﴾ ثُمَّ أَتْبَعَ سَبَبًا ﴿٨٩﴾ حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ مَطْلِعَ الشَّمْسِ
 وَجَدَهَا تَطْلُعُ عَلَىٰ قَوْمٍ لَمْ لَجْعَلْ لَهُم مِّنْ دُونِهَا سِتْرًا ﴿٩٠﴾ كَذَٰلِكَ وَقَدْ
 أَحَطْنَا بِمَا لَدَيْهِ خُبْرًا ﴿٩١﴾

“Nëse të pyesin ty për Dhulkarnejnin, thuaj: ‘Do t’ju rrëfejë për punën e tij me Kur’àn.”

“Ne i mundësuam atij në tokë forcë dhe i dhamë prej çdo sendi një mundësi.”

“Ai e ndoqi mundësinë.”

“Derisa arriti në vendpërdimin e diellit, të cilin e gjeti të perëndojë në një burim me llum të zi dhe, aty gjeti një popull. Ne i thamë: ‘O Dhulkarnejn ose do t’i dënosh, ose do t’i marrësh me të mirë dhe t’i udhëzosh.’”

“Ai (Dhulkarnejn) tha: ‘Ai që bën padrejtësi, atë do ta dënojmë, pastaj do të kthehet te Zoti i tij dhe Ai do ta ndëshkojë me një dënim shumë të rëndë.’”

“Kurse ai që besoi dhe bëri punë të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë dhe, nga ana Jonë, atij do t’i bëjmë lehtësira.”

“Pastaj ai ndoqi mundësinë.”

“Derisa arriti në vendin ku lind dielli, të cilin e gjeti të lindë mbi një popull, të cilit nuk i kemi dhënë mbulojë prej tij (diellit).”

“Ne kemi dijeni për gjendjen e tij.”

Komentimi

Tregimi i çuditshëm i Dhulkarnejnit

Në fillim të bisedës sonë rreth banorëve të shpellës (as’hàbul-kehfi), thamë se një grup prej kurejshëve vendosën të vinin në provë të Dërguarin e All’llahut (*Paqja dhe bekimet e*

All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ky grup i kurejshëve në marrëveshje me jehuditë, sipas këshillës së tyre, shtruan tri çështje që ishin: historia e banorëve të shpellës, ç'është shpirti dhe çështja e tretë, tregimi rreth Dhulkarnejnit.

Në Kur'anin Famëlartë përgjigjja për shpirtin erdhi në suren "El Isrà", kurse përgjigjja për çështjen e dytë dhe të tretë erdhi në suren "El Kehf".

Tani le të trokasim në tregimin rreth Dhulkarnejnit.

Më sipër kemi thënë se në suren "El Kehf" trajtohen tri tregime që nga ana e jashtme ndryshojnë nga njëri-tjetri, por në disa anë të caktuara kanë edhe të përbashkëta. Siç kemi thënë më sipër, këto tri tregime janë: tregimi për banorët e shpellës, tregimi i takimit të Mûsàsë me Hidrin dhe tregimi për Dhulkarnejnin.

Përmbajtjet e këtyre tri tregimeve na çojnë përtej jetës sonë të zakonshme, na çojnë në horizontin më të fundit dhe zbulojnë për ne se bota me të vërtetat e saj nuk kufizohet në kuadrin e gjërave me të cilat ne jemi mësuar, gjërat që dimë dhe që për ne janë bërë të zakonshme.

Tregimi i Dhulkarnejnit vërtitet rreth një personi që ka nxitur interesin e filozofëve e të studiuesve qysh në kohët e hershme. Është bërë punë shumë e madhe për ta njohur këtë person.

Në radhë të parë do të merremi me interpretimin e gjashtëmbëdhjetë ajeteve të veçanta që kanë të bëjnë me Dhulkarnejnin, nga pikëpamja se jeta e tij, krahas hedhjes së shikimit mbi anët e saj historike, përbën një mësim të madh të

mbushur me këshilla. Më pas do të kalojmë në studimet për t'u njohur me personin e Dhulkarnejnit, duke përfutur prej atyre që tregohen në transmetimet islame dhe prej asaj që kanë thënë historianët në lidhje me këtë çështje.

Me fjalë të tjera, në radhë të parë, ne na intereson biseda rreth personit të Dhulkarnejnit, ashtu siç ka ardhur në Kur'an dhe ku i Larti thotë: **“Të pyesin ty për Dhulkarnejnin.”**.

Përgjigjja do të jepet me gjuhën e të Dërguarit të përzgjedhur (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“Thuaj: ‘Do t’ju rrëfej për punën e tij me Kur'an.’”**.

Sipas rregullave të gramatikës së gjuhës arabe, kur para foljes gjendet shkronja “s”, siç është në foljen “se’etlu” – “do t’ju rrëfej” tregon se puna do të bëhet në një të ardhme të afërt dhe i Dërguari këtu flet drejtpërdrejt për Dhulkarnejnin. Kjo fjalë e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shpreh respekt e kujdes të madh për anën edukative të shoqëruar me qetësi e maturi, sepse edukata që ai mëson e ka frymëzimin prej diturisë që i vjen atij prej All'llahut të Lartësuar, me qëllim që ai t’ia transmetojë edhe njerëzve.

Fillimi i ajetit na e bën të qartë se tregimi i Dhulkarnejnit ishte i njohur dhe qarkullonte ndër njerëzit, por si tregim ishte i veshur me paqartësi e me dyshime, për këtë shkak i kërkuan të Dërguarit më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) - të bënte sqarimet e duhura.

Në fillim të bisedës rreth Dhulkarnejnit, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ne i mundësuaam atij në tokë”**, do të thotë: **“Ne i dhamë atij rrugët e forcës, fuqisë dhe urtësisë.”**.

“I dhamë prej çdo sendi një mundësi.”

Fjala **“mundësi”** e ajetit në tekstin e Kur’anit ka ardhur me fjalën **“sebeben”** që do të thotë **“litar që përdoret për t’u ngjitur në pemën e hurmës”**. Disa prej interpretuesve të Kur’anit e kufizojnë kuptimin e kësaj fjale në përdorimin e mjeteve për realizimin e punëve, por dihet se kjo fjalë e ajetit ka një kuptim shumë më të gjerë, do të thotë se All’llahu i Gjithëfuqishëm i dha Dhulkarnejnit mundësitë e shkaqet për të arritur të gjitha sendet: i dha mendje, dituri të mjaftueshme, vullnet të shëndoshë, forcë e fuqi, i dha ushtri e fuqi njerëzore, përveç mundësive materiale; me fjalë të tjera i dha atij të gjitha shkaqet e rrugët materiale e morale të duhura për realizimin e objektivave të caktuar.

Pas kësaj, Kur’ani tregon se Dhulkarnejni përfitoi prej këtyre mundësive e rrugëve dhe thotë: **“Ai e ndoqi mundësinë.”**

Në vijim ajeti thotë: **“Derisa arriti në vendpërendimin e diellit.”**

Ai pa se dielli perëndoi në një det të errët, ose në një burim me ujë të nxehtë: **“...të cilin e gjeti të perëndoje në një burim me llum të zi.”**¹

¹ Fjala e ajetit **“hamietin”**, në origjinën e saj do të thotë **“baltë e zezë me erë të keqe”**, ose ujë i ndenjtur që gjendet nëpër kënetë. Ky cilësim shpjegon për ne se toka ku arriti Dhulkarnejni ishte moçalishte, prandaj Dhulkarnejni iu krijua përshtypja se Dielli perëndonte në këto kënetë, ashtu siç i krijohet përshtypja edhe atij që udhëton në det, apo banorëve të bregdetit, të cilëve u krijohet përshtypja se Dielli perëndon në det ose del prej detit!

“Aty gjeti një popull...”, domethënë një grup njerëzish, ndër të cilët kishte njerëz të mirë dhe të këqij, ishte ai popull, për të cilin All’llahu i flet Dhulkarnejnit drejtpërdrejt: “Ne i thamë: O Dhulkarnejn ose do t’i dënosh, ose do t’i marrësh me të mirë dhe t’i udhëzosh.”¹

Disa interpretues të Kur’anit mendojnë se fraza e ajetit **“Ne i thamë”**, është argument që vërteton se Dhulkarnejni është Profet, porse ka mundësi që qëllimi me këtë frazë të jetë frymëzim në zemër, të cilin Krijuesi i Gjithëfuqishëm ua jep edhe të tjerëve që nuk janë Profetë, por kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë që të mohohet mundësia që kjo fjalë të jetë edhe argument për profetësinë e tij.

Ajeti vijues tregon përgjigjen e Dhulkarnejnit: **“Ai (Dhulkarnejni) tha: ‘Ai që bën padrejtësi, atë do ta dënojmë, pastaj ai do të kthehet te Zoti i tij dhe Ai do ta ndëshkojë me një dënim shumë të rëndë.’”²**, do të thotë se ata që bëjnë padrejtësi, padyshim, do të marrin dënimin në këtë botë dhe në Botën e Tjetër.

“Kurse ai që besoi dhe bëri punë të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë.”

“Nga ana Jonë atij do t’i bëjmë lehtësira.”

¹ Megjithëse kjo fjali nga ana e jashtme është fjali pyetëse, në të vërtetë është fjali kallëzore.

² Fjala e ajetit *“nukren”* është marrë prej origjinës *“munker”* në kuptimin e sendit të panjohur, domethënë një dënim që nuk dihet si është dhe as që mund të përfytyrohet.

Domethënë, atë do ta trajtojmë me fjalë të mira, gjithashtu do ta lehtësojmë dhe do të bëjmë që ai të mos përballet me probleme e me vështirësi, përveç kësaj, nuk do të vjelim prej tij edhe shumë taksa.

Del qartë se Dhulkarnejni me këto fjalë thotë se njerëzit kundrejt thirrjes sime për të besuar se All'Ilahu është Zoti Një e i Vetëm (Teuhid) dhe për të ndaluar padrejtësinë, korrupsionin, imoralitetin e shthurjen, do të ndahen në dy grupime. Grupi i parë do të përshëndesë programin e tij hyjnor dhe thirrjen për të besuar se All'Ilahu është Zoti Një e i Vetëm. Ky grupim do të ketë shpërblimin më të mirë dhe do të bëjë një jetë të sigurt, kurse grupimi i dytë do të marrë qëndrim armiqësor kundrejt thirrjes së Dhulkarnejnit dhe do të qëndrojë në frontin kundërshtar, do të vazhdojë në politeizëm e në padrejtësi. Gjithashtu, në këtë grup, korrupsioni e shthurja nuk do të marrin fund asnjëherë, prandaj për shkak të këtij qëndrimi dhe për shkak të punëve të liga që ata bëjnë, ata do të pësojnë dënimin më të rëndë.

Duke krahasuar dy frazat e ajetit: *“men dhaleme”* - **“ai që bën padrejtësi”** dhe *“men àmene ue amile sàlihan”* - **“ai që besoi dhe bëri punë të mira”**, për ne bëhet e qartë se fjala *“dhaleme”* - **“bën padrejtësi”**, këtu është në kuptimin e vënies shok e ortak All'Ilahut (shirk) dhe të punës së keqe, e cila konsiderohet prej frutave të pemës së urryer të politeizmit.

Pasi Dhulkarnejni e përfundoi udhëtimin e tij në anën perëndimore, u drejtua nga ana e lindjes dhe Kur'ani njofton: **“Pastaj ai ndoqi mundësinë”**, domethënë vuri në përdorim mjetet e mundësitë që i ishin vënë në dispozicion.

“Derisa arriti në vendin ku lind dielli” dhe: “e gjeti të lindë mbi një popull, të cilit nuk i kemi dhënë mbulojë prej tij (diellit).”. Fjalët e ajetit në mënyrë alegorike tregojnë se ata njerëz bënë një jetë shumë të thjeshtë, ata vishnin fare pak rroba që nuk mjaftonin të mbulonin trupat e tyre dhe kështu nuk ishin të mbrojtur prej nxehtësisë së diellit.¹

Disa interpretues të Kur'anit, kanë shtruar edhe një mundësi tjetër dhe kanë thënë se ata njerëz mund të ishin banorë të ndonjë shkretëtire të rrafshët, në të cilën nuk kishte as male, as pemë, as vende ku të strehoheshin, prandaj në këtë shkretëtim ata njerëz nuk kishin asnjë lloj mbulese apo diçka tjetër që të mbronin veten prej diellit.²

Natyrisht që mes komentimeve të përmendura nuk ka kontradiktë, sepse vendimtare është fjala e të Lartit: **“Ne kemi dijeni për gjendjen e tij”**, domethënë, kështu qëndron puna e Dhulkarnejnit dhe Ne i dimë mirë mundësitë e tij.

Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se ky ajet thekson udhëzimin e All'llahut në rrugën e drejtë të programit e të punës së Dhulkarnejnit.³

¹ Transmetime të ardhura me rrugën e Ehli Bejt (Paqja qoftë mbi ta!) e vënë theksin në komentimin e parë, kurse disa transmetime të tjera e vënë theksin në komentimin e dytë. Gjithsesi në mes dy grupeve të transmetimeve nuk ka asnjë kontradiktë. (Referoju “Nûruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 306).

² Tefsiri “Fij Dhilâlil-Kur'an” dhe tefsiri i Fakhru Râziut në komentimin e ajetit objekt studimi.

³ Tefsiri “El Mizàn”, vëll. 13, f. 391.

Ajetet 92 - 98

ثُمَّ أَتْبَعَ سَبِيلًا ﴿٩٢﴾ حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ بَيْنَ السَّدَّيْنِ وَجَدَ مِنْ دُونِهِمَا قَوْمًا
لَّا يَكَادُونَ يَفْقَهُونَ قَوْلًا ﴿٩٣﴾ قَالُوا يَبْنَؤُا الْقَرْنَيْنِ إِنَّ يَأْجُوجَ وَمَأْجُوجَ
مُفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ فَهَلْ نَجْعَلُ لَكَ خَرْجًا عَلَىٰ أَنْ تَجْعَلَ بَيْنَنَا وَبَيْنَهُمْ
سَدًّا ﴿٩٤﴾ قَالَ مَا مَكَّنِّي فِيهِ رَبِّي خَيْرٌ فَأَعِينُونِي بِقُوَّةٍ أَجْعَلْ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ
رَدْمًا ﴿٩٥﴾ ءَاتُونِي زُبَرَ الْحَدِيدِ ۖ حَتَّىٰ إِذَا سَاوَىٰ بَيْنَ الصَّدَفَيْنِ قَالَ
أَنْفُخُوا ۖ حَتَّىٰ إِذَا جَعَلَهُ نَارًا قَالَ ءَاتُونِي أُفْرِغْ عَلَيْهِ قِطْرًا ﴿٩٦﴾ فَمَا
أَسْطَبَعُوا أَنْ يَظْهَرُوهُ وَمَا اسْتَطَبَعُوا لَهُ نَقْبًا ﴿٩٧﴾ قَالَ هَذَا رَحْمَةٌ مِنْ رَبِّي
فَإِذَا جَاءَ وَعْدُ رَبِّي جَعَلَهُ دَكَّاءَ ۖ وَكَانَ وَعْدُ رَبِّي حَقًّا ﴿٩٨﴾

“Përsëri ai (Dhulkarnejni) ndoqi mundësinë.”

“Derisa arriti në mes dy maleve, prapa tyre (dy maleve), ai gjeti një popull që gati nuk i kuptonte fjalët.”

“Ata (banorët e vendit) thanë: ‘O Dhulkarnejn, je’xhùxhë e me’xhùxhët bëjnë shkatërrime në tokë, a të japim ty një tribut (taksë) që të ndërtosh një pendë në mes nesh e në mes atyre.’”

“Ai (Dhulkarnejni) tha: ‘Ajo që më ka dhënë Zoti im është shumë më e mirë (nga ajo që më ofroni ju), por ju më ndihmoni me krah pune që unë të bëj një pendë të fortë në mes jush dhe atyre.’”

“Më sillni pllaka hekuri dhe pasi i niveloi në mes dy maleve tha: ‘Ndizeni’, dhe kur zjarri u ndez mirë, atëherë tha: ‘Më sillni bakër të shkrirë ta hedh mbi të.’”

“Ata (je’xhùxhë-me’xhùxhët) nuk kishin mundësi as ta kapërcenin e as ta shponin.”

“Ai (Dhulkarnejni) tha: ‘Kjo është mëshirë prej Zotit tim dhe, kur vjen caktimi i Zotit tim, Ai e rrafshon atë, caktimi i Zotit tim është i sigurt.’”

Komentimi

Si u ndërtua diga e Dhulkarnejnit?

Ajeti i parë i ajeteve objekt studimi njofton për një udhëtim tjetër të Dhulkarnejnit dhe thotë: **“Përsëri ai (Dhulkarnejni) ndoqi mundësinë.”**

Domethënë se ai pas kësaj ngjarjeje përfitoi prej mjeteve shumë të rëndësishme që ishin në dispozicion të tij dhe u nis për një udhëtim tjetër, derisa arriti në një vend në mes dy maleve, ashtu siç njofton ajeti: **“Derisa arriti në mes dy maleve, prapa tyre (dy maleve), ai gjeti një popull që gati nuk i kuptonte fjalët.”**.

Ajeti tregon se ai arriti në një zonë malore, ku gjeti njerëz me një nivel shumë të ulët qytetërimi (jo ato dy grupimet që gjeti në anën lindore e në anën perëndimore). Ata kishin nivel të ulët veçanërisht nga ana gjuhësore, por dihet se gjuha është njëra prej treguesve të qytetërimit të njerëzimit.

Disa janë shprehur për mundësinë se fraza **“që pothuaj nuk kuptonte asnjë fjalë”**, nuk është në kuptimin që ata nuk njihnin gjuhët, por ata nuk kuptonin përmbajtjen e fjalëve, do të thotë se ishin të prapambetur nga ana ideore. Për sa i përket vendit ku ndodhen këto dy male dhe anëve historike e gjeografike të kësaj ngjarjeje, në fundin e komentimit të ngjarjes do të vëmë një bisedë të detajuar.

Ndërkaq, banorët e vendit e shfrytëzuan ardhjen e Dhulkarnejnit, pasi vuanin vazhdimisht prej armiqve të tyre je’xhùxhë e me’xhùxhëve, prandaj kërkuan ndihmë prej tij dhe i thanë: **“Ata (banorët e vendit) thanë: ‘O Dhulkarnejn, je’xhùxhë e me’xhùxhët bëjnë shkatërime në tokë, a të japim ty një tribut (taksë) që të ndërtosh një pendë në mes nesh e atyre?’”**.

Ka të ngjarë që kjo bisedë të jetë zhvilluar me shenja, pasi banorët e atij vendi nuk e dinin gjuhën e Dhulkarnejnit, ose biseda është zhvilluar me fjalë e fraza të cinguar, prandaj ata e kishin pothuaj të pamundur të merreshin vesh.

Gjithashtu ka mundësi që biseda midis tyre të jetë zhvilluar nëpërmjet përkthyesve, ose me metodën e frymëzimit të Zotit, ashtu siç kanë folur disa shpendë me Hazreti Sulejmànin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!*).

Sido që të jetë zhvilluar ajo bisedë, ne mësojmë prej ajeteve të nderuara se ai grupim njerëzish ishin në një gjendje shumë të mirë nga ana e mundësive ekonomike, por ata ishin të dobët në fushën industriale, ideore dhe të planifikimit, prandaj pranuan të përballojnë shpenzimet për ndërtimin e asaj pende shumë të rëndësishme për ata, me kusht që Dhulkarnejni të merrte përsipër anën inxhinierike dhe ndërtimore të pendës.

Për sa u përket je'xhùxhë e me'xhùxhëve, dashtë All'llahu, do të flasim në fundin e këtij studimi.

Dhulkarnejni iu përgjigj atyre duke thënë: **“Ai (Dhulkarnejni) tha: Ajo që më ka dhënë Zoti im është shumë më e mirë** (nga ajo që më ofroni ju).”. Me këto fjalë, ai u thoshte atyre se unë nuk kam nevojë për ndihmën tuaj financiare, por: **“ju më ndihmoni me krah pune që unë të bëj një pendë të fortë mes jush dhe atyre.”**.

Fjala e ajetit *“redmen”* në origjinën e saj do të thotë *“mbushja e çarjes me gurë”* dhe më vonë ka marrë një kuptim më të gjerë dhe ky kuptim i ri përfshin të gjitha pendat e digat, madje përfshin edhe punët më të imta në relief që bëhen në veshjet.

Disa interpretues të Kur'ânit janë shprehur se fjala “redm” thuhet për digat e forta.¹ Sipas këtij komentimi, në të vërtetë, Dhulkarnejni, u premtoi atyre më shumë nga sa ata prisnin.

Gjithashtu duhet të tërheqim vëmendjen se fjala “sed'd” është në kuptimin “vetëm një digë”, një ndarës midis dy sendeve, kurse disa të tjerë, ashtu siç thotë edhe Ragibi, janë shprehur se ka dallim ndërmjet dy fjalëve. Fjala e parë lë të kuptosh se ndarësi është prej punës së njeriut, kurse fjala e dytë përdoret kur ndarësi është natyral.

Më pas, Dhulkarnejni urdhëroi: “**Më sillni pllaka hekuri.**”.

Fjala e ajetit “zuber” do të thotë “*pllakë e madhe dhe e trashë prej hekuri*”.

Kur hekuri u përgatit, ai urdhëroi që pllakat e hekurit të vireshin njëra mbi tjetrën, derisa çarja në mes dy maleve u mbush plotësisht, ashtu siç njofton ajeti: “**Derisa ai e niveloi midis dy maleve.**”.

Fjala e ajetit “sade’f” këtu është në kuptimin e *shpatit të malit*. Nga kjo shprehje del qartë se atje ishte një grykë në mes dy maleve, prej ku je’xhùxhë e me’xhùxhët hynin dhe që Dhulkarnejni e mbylli këtë grykë.

Gjëja e tretë që kërkoi Dhulkarnejni prej atyre, ishte që të sillnin dru, ose lëndë të tjera të ngjashme që ai i vuri në të dyja anët e kësaj pende, pastaj në të ndezi zjarr dhe i urdhëroi ata t’i

¹ El Âliüsij’ji në “Ruhul Meânij”; El Fejd El Kâshâniy në tefsirin “Es’sâfij”, Fakhrru Rrâziy në “Et tefsijrul Kebijr”.

frynin zjarrit, derisa hekuri të skuqej prej zjarrit të fortë, ashtu siç njofton ajeti: “...**tha: Ndizeni, derisa zjarri u ndez mire.**”.

Qëllimi i Dhulkarnejnit me këtë ishte të lidhte copat e hekurit njëra me tjetrën që e gjithë penda të bëhej një copë e vetme. Me këtë veprim, Dhulkarnejni bëri edhe punën e saldatorit, i cili në ditët e sotme lidh pjesët e hekurta njëra me tjetrën.

Së fundi, Dhulkarnejni i urdhëroi ata edhe herë dhe u tha: “*Më sillni bakër të shkrirë që ta derdh mbi këtë digë*”, ashtu siç njofton ajeti: “**tha: Më sillni bakër të shkrirë ta hedh mbi të.**”.

Me këtë mënyrë Dhulkarnejni e mbuloi digën e hekurt me një shtresë bakri, me qëllim që hekuri të mos kishte kontakt me ajrin dhe ta ruante atë prej korrozionit.

Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë: “Në ditët e sotme, shkenca ka vërtetuar se kur në hekur shtohet një sasi e caktuar bakri, kjo gjë shton rezistencën e hekurit ndaj korrozionit”, çka vërteton se Dhulkarnejni e dinte këtë të vërtetë, prandaj edhe e zbatoi në pendën që ndërtoi.

Kuptimi më i përhapur i fjalës së ajetit “*kitr*”, është ashtu siç e shpjegojmë: “*bakër i shkrirë*”, por disa interpretues të Kur'anit e kanë shpjeguar me kuptimin “*dy vathët e shkrirë*”, por ky kuptim është në kundërshtim me atë që kuptohet zakonisht me këtë fjalë, ashtu siç thamë: “*bakër i shkrirë*”.

Më në fund, diga u bë aq e fortë e aq e përsosur sa: “**nuk kishin mundësi as ta kapërcenin e as ta shponin**”.

Në të vërtetë, Dhulkarnejni bëri një punë të madhe e shumë të rëndësishme dhe, sipas logjikës së mendjemëdhenjve, ai duhej të mburrej, dhe për punën e bërë të kërkonte favore, porse ai me edukatën më të lartë e më të plotë tha: *“Kjo është mëshirë prej Zotit tim”*, ai tha kështu, sepse morali i tij ishte hyjnor.

Me këto fjalë, ai kishte qëllim të thoshte: “Unë zotëroj dituri dhe kam shumë informacion, me këto dy dhunti unë kam mundësi të hedh hapa shumë të rëndësishëm, por e gjitha kjo është prej Krijuesit të Gjithëfuqishëm dhe, nëse me të vërtet ke aftësinë të thuath fjalë të pranueshme dhe të bësh biseda mbresëlënëse, thuaj edhe ti: “Kjo është vetëm prej Krijuesit të Gjithëfuqishëm”.

Nëse këto mjete dhe këto ide janë vënë që unë t’i përdor sipas zgjedhjes sime, e gjitha kjo është prej mirësisë së All’llahut dhe prej mëshirës së Tij që nuk njeh anë e kufi.

Dhulkarnejni me këto fjalë kishte qëllim të thoshte: “Unë nga vetja ime nuk zotëroj asgjë që të krenohem me atë që bëra, veç kësaj, unë nuk e bëj punën që t’ua përmend robve të All’llahut që e bëra për ata.”.

Më pas ai vazhdoi të thotë: Mos kujtoni se kjo digë do të jetë e përhershme dhe përjetshme: **“dhe, kur vjen caktimi i Zotit tim, Ai e rrafshon atë”**.

“Caktimi i Zotit tim është i sigurt.”

Në të vërtetë, Dhulkarnejni e thekson këtë në fjalën e tij, në kuadrin e çështjes së asgjësimit të kësaj bote dhe shkatërrimit të sistemit të ekzistencës në kohën e Ringjalljes.

Megjithëkëtë, disa interpretues të Kur'anit, fjalën e ajetit **“caktimin Hyjnor”** e komentojnë me përparimin shkencor të njerëzimit dhe thonë se, në saje të këtij përparimi, nuk ka kuptim të thuhet që ndonjë digë të mbetet përgjithmonë, apo që ajo është e pamundur të shembet, ose është e pamundur që ajo të kapërcehet, pasi aeroplanët e mjete të tjera të ngjashme kanë mundësi të kapërcejnë të gjitha pengesat, por ky komentim është shumë larg nga ajo që kuptohet prej fjalëve të ajetit.

Hulumtime

1- Konstatime edukative në këtë tregim historik

Më pas, dashtë All'llahu, në studimin tonë do të shtrojmë pyetjet: Cili është Dhulkarnejni?; Si u realizua udhëtimi i tij në lindje e në perëndim?; Ku gjendet diga që ai ndërtoi?, përfshirë edhe pyetje të tjera. Pavarësisht nga anët historike, tregimi përmban në përgjithësi mësimë edukative të shumta, prandaj është e domosdoshme të tërheqim vëmendjen kah këto mësimë, me qëllim që të përfitojmë prej mësimëve të këtij tregimi dhe, në fakt ky është edhe qëllimi që ky tregim ka ardhur në Kur'anin Famëlartë. Këto mësimë kemi mundësi t'i rendisim sipas pikave vijuese:

a- Mësimi i parë që na mëson ky tregim është se puna në këtë botë nuk mund të realizohet pa i pasur të gjitha mjetet e duhura, prandaj All'llahu i Lartësuar dhuroi të gjitha mjetet dhe

bëri të gjitha shkaqet që Dhulkarnejni të përparonte e të triumfonte me diturinë që Ai i kishte dhënë **“dhe i dhamë prej çdo sendi një mundësi”**; në të njëjtën kohë, Dhulkarnejni përfitoi prej këtyre mundësive në mënyrën më të mirë dhe **“dhe ai e ndoqi mundësinë”**.

Prandaj kushdo që mendon se do të arrijë fitore pa përgatitur mjetet, shkaqet e elementet paraprake, ai kurrë nuk arrin qëllimin që i ka vënë vetes, qoftë edhe vetë Dhulkarnejni!

b- Megjithëse shkak i perëndimit të diellit në një burim me ujë të ndenjur me erë të keqe është gabim me shikimin e parë dhe i dyshimtë, porse kuptimi që ne marrim prej këtij shembulli është mundësia e mbulimit të diellit me një burim uji të ndenjur, edhe pse dielli është aq i madh. Ky shembull ngjason me një njeri të madh, i cili ka rënë poshtë për shkak të një gabimi të vetëm dhe personaliteti i tij ka perënduar në sytë e njerëzve.

c- Asnjë qeveri nuk mund të triumfojë pa inkurajuar ata që e duan dhe e ndjekin, dhe pa dënuar fajtorët e ata që gabojnë. Edhe Dhulkarnejni u mbështet mbi këtë bazë kur tha: **“Ai që bën padrejtësi, atë do ta dënojmë ... Kurse ai që besoi dhe bëri punë të mira, atij i takon shpërblimi më i mire.”**.

Prijësi i besimtarëve, Imami Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka kristalizuar këtë kuptim në letrën që i drejtoi Mâlik Eshterit dhe që është një program i plotë për administrimin e vendit. Në atë letër, Imami (*Paqja qoftë mbi të!*) i thotë atij: **“Ai që bën punë të mirë dhe ai që bën punë të keqe, kurrë nuk janë në pozitë të barabartë te ti, nëse ti i barazon ata të dy, punëmirin e bën të mos**

e dëshirojë të mirën për veten e tij, por është edhe edukim e mësimdhënie për punëkëqijtë për të keqen që ata bëjnë.”.¹

ç- Ngarkimi me punë të rënda e të vështira i njerëzve që nuk janë në gjendje t’i mbajnë. Të gjitha këto punë kurrë nuk janë në përshtatje me qeverinë hyjnore të drejtë, prandaj edhe Dhulkarnejni, pasi u prononcua për dënimin e atyre që bëjnë padrejtësi dhe për shpërblimin e njerëzve të mirë, shtoi: **“Nga ana jonë atij do t’i bëjmë lehtësira”**, derisa të mundësohet realizimi i punëve me dashuri e me dëshirë.

d- Qeveria e madhe dhe me mundësi të mëdha e ka të pamundur të ketë në qendër të vëmendjes së saj dallimet e ndryshimet që ekzistojnë në jetën e njerëzve dhe të përkujdeset për fillin e jetës së secilit prej tyre. Pikërisht për këtë shkak edhe Dhulkarnejni, autori i **qeverisë hyjnore** që u përball me popuj të ndryshëm, çdo grupim e trajtoi në përputhje me gjendjen e tyre specifike, prandaj të gjithë ishin rreshtuar nën flamurin e tij.

dh- Dhulkarnejni nuk e la jashtë vëmendjes as edhe atë grupim, të cilëve u kuptohej fjala me vështirësi, ose ashtu siç i ka cilësuar Kur’ani: **“që gati nuk kuptonte asnjë fjalë”**, por ai i dëgjoi problemet e tyre dhe punoi me ngulm për të plotësuar kërkesat që ata shtruan, të çdo natyre që ato të ishin. Ai ndërtoi për ata një digë të përkryer që i ndante prej armiqve të egër (je’xhuxhë e me’xhuxhëve). Ai i plotësoi punët e tyre pa bërë asnjë dallim ndërmjet atyre njerëzve, megjithëse e bëri të qartë se njerëz të kësaj kategorie që nuk kuptojnë nuk i sjellin qeverisë asnjë dobi.

¹ “Nehxul Belàgah”, letra nr. 53.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut ((*Paqja qoftë mbi të!*)), lexojmë fjalën e tij: “Të bësh shurdhin të dëgjojë pa shtrembëruar fytyrën, është një sadaka e shumë e bukur.”.¹

e- Siguria është kushti numër një e më i rëndësishmi prej kushteve të jetës shoqërore të shëndoshë. Për këtë shkak edhe Dhulkarnejni mori përsipër të bëjë punët më të vështira e më të rënda, për të siguruar ata njerëz prej armiqve të tyre. Njerëzit përfituan prej digës së lartë e të fortë. Ajo digë u bë shembull në histori, u bë simbol për llogoret që vazhdojnë të mbeten të qëndrueshme, ashtu siç thuhet kur duam të theksojmë një punë të mirë e të qëndrueshme të bërë prej dikujt. Ajo që ka bërë ai është si diga e Aleksandërit, megjithëse Aleksandri nuk është Dhulkarnejni e as Dhulkarnejni nuk është Aleksandri.

Zakonisht, shoqëria nuk mund të jetë e lumtur pa i prerë rrugën elementëve shkatërrues, ngatërrestarë e të korruptuar, prandaj gjëja e parë që kërkoi Ibrahim (i) (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!*) kur përfundoi ndërtimin e Qabesë, që siguria, ashtu siç thotë ajeti 35, i sures “Ibràhim”: **“O Zoti im, bëje këtë qytet të sigurt.”**.

Për të njëjtin shkak edhe ligji i fesë islame ka vënë dënimet më të rënda për ata që vënë në rrezik sigurinë e shoqërisë. (Referoju komentit të ajetit 33 të sures “El Màide” të këtij tefsiri.)

ë- Një mësim tjetër që mund të mësojmë prej këtij tregimi është se, në radhë të parë, vetë ata që kanë problemin, duhet të jenë pjesëmarrës në frontin e punës për të zgjidhur problemin e

¹ “Sefijnetul Bihâr”, vëll. 2, lënda “sameme”.

tyre, prandaj edhe Dhulkarnejni i urdhëroi ata që u ankuan tek ai për punën e je'xhùxhë e me'xhùxhëve që të sillnin pllaka hekuri, pastaj i urdhëroi të ndiznin zjarr në të dyja anët e digës me qëllim që pllakat të ngjiteshin njëra me tjetrën dhe më pas i urdhëroi të përgatisnin bakër të shkrirë. Zakonisht, puna që bëhet me ndihmesën dhe me praninë e palëve të interesuara për zgjidhjen e problemit, çon në shfaqjen e gatishmërisë nga ana e tyre dhe i jep një vlerë të veçantë rezultateve të arritura në atë punë. Nga ana tjetër i shton shumë vlerën edhe vetë punës së bërë për realizimin e atij objekti, gjithashtu bën që të gjithë të jenë të interesuar për ruajtjen e atij objekti që të qëndrojë sa më gjatë, pasi të gjithë kanë parasysh mundin e derdhur dhe shpenzimet që kanë përballuar për ndërtimin e tij.

Në këtë pikë bëhet e qartë se edhe një shoqëri e prapambetur mund të realizojë punë shumë të rëndësishme e të mëdha kur ka një program të saktë dhe një vullnet të sinqertë.

f- Udhëheqësi hyjnor nuk shikon përfitimin material dhe paratë që do të marrë, pasi ai është i kënaqur me atë çka i ka dhënë All'Ilahu, ashtu siç e pamë te Dhulkarnejni kur ata i ofruan atij para dhe ai tha: **“Ajo që më ka dhënë Zoti im është shumë më e mirë** (nga ajo që më ofroni ju).”. Kjo mënyrë sjelljeje është në kundërshtim të hapur me metodat e me maninë e çuditshme që kanë sundimtarët për të grumbulluar sa më shumë pasuri e para.

Në Kur'anin Famëlartë shpesh lexojmë në tregimet rreth Profetëve se ata kurrë nuk kanë kërkuar pasuri e para për punët që kanë bërë dhe për thirrjen e tyre dhe kjo e vërtetë është përmendur në njëmbëdhjetë vende në Kur'anin Famëlartë, qoftë në tregimet që kanë lidhje me Profetin e Islamit (*Paqja dhe bekimet e*

All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), qoftë për Profetët e përparshëm (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi ta!). Disa herë, Kur'ani përdorë shprehjen "in'nemà exhrij alell'llàh" "shpërblimin mua ma jep All'llahu", herë tjetër, Kur'ani vë bazë për shpërblimin dashurinë për Ehli Bejtin (Paqja qoftë mbi ta!) sepse ata janë kolona e udhëheqjes së ardhshme, ashtu siç thotë ajeti 23 i sures "Esh Shùrà": **"Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për këtë (thirrjen time) vetëm respektin e dashurisë për hir të asaj që jemi të afërm."**

g- Përsosja e punëve është një mësim tjetër që ne mësojmë prej këtij tregimi. Dhulkarnejni përfitoi prej pllakave të mëdha të hekurit në ndërtimin e digës. Këto pllaka pasi i nxehu në zjarr, i mbuloi edhe me bakër të shkrirë me qëllim që të ndalohej korrozioni që do të shkactohej për shkak të kontaktit të hekurit me ajrin e me lagështirën.

gj- Sado i fuqishëm të jetë njeriu dhe sado mundësi e fuqi të ketë për të realizuar punët, ka detyrë të mos i rritet mendja e të mos mburret për aftësitë e tij. Ky është një mësim tjetër që mësojmë prej tregimit të Dhulkarnejnit, i cili në të gjitha punët e tij mbështetej vetëm në fuqinë e Krijuesit të Gjithëfuqishëm, prandaj ai pasi e ndërtoi pendën tha: **"Kjo është mëshirë prej Zotit tim"**, gjithashtu kur ata i propozuan Dhulkarnejnit ndihmë financiare ai tha: **"Ajo që më ka dhënë Zoti im është shumë më e mirë** (nga ajo që më ofroni ju)" dhe, së fundi, kur Dhulkarnejni flet për asgjësimin e kësaj dige të përkryer, ai nuk harron që edhe këtë t'ia atribuojë caktimit të All'llahut të Lartësuar.

h- Të gjitha gjërat shkojnë drejt asgjësimit, sado e përpiktë, e përsosur dhe e fortë të jetë. Ky është mësimi i fundit në këtë

tregim për ata që shpresojnë, ose kujtojnë se pasuria e tyre do të jetë e përjetshme, ose shpresojnë e kujtojnë se postin e autoritetin që kanë do ta kenë vazhdimisht. Në të vërtetë, diga që ndërtoi Dhulkarnejni është një punë fare e lehtë në krahasim me shuarjen e diellit e me rrafshimin e maleve të larta, atëherë si do të jetë puna me njeriun e ekspozuar ndaj dëmeve e rreziqeve më shumë se çdo gjë tjetër?

A nuk është i mjaftueshëm mendimi rreth këtyre të vërtetave që të jetë një shtytës për të kundërshtuar tiraninë?

2- Kush është Dhulkarnejni?

Interpretuesit e Kur'anit kanë përmendur shumë fjalë rreth personit të Dhulkarnejnit të përmendur në Kur'anin Famëlartë: Cili është ai? Me cilin prej personaliteteve historike të njohura përputhen cilësitë e tij të përshkruara në Kur'anin Famëlartë? Për të mësuar përgjigjet për këto pyetje, ne kemi mundësi të lexojmë opinionet e shprehura në tri teori themelore, që janë:

Teoria e parë: disa mendojnë se Dhulkarnejni nuk është askush tjetër përveçse Aleksandri i Maqedonisë, prandaj edhe në gjuhën arabishte, ai quhet Iskenderi dy brirësh (Dhulkarnejni). Këta mendojnë se ai, Aleksandri, ka sunduar pas vdekjes së babait të tij mbi shtetet e rumëve, të Magrebit dhe Egjiptit dhe se ka ndërtuar qytetin e Aleksandrisë në Egjipt, më pas ka vënë nën sundimin e tij zonën e Shamit e të "Bejti Mukad'desit" (Jeruzalemit) dhe, prej këtu, u hodh në Armeni, pushtoi Irakun dhe vendin e persëve dhe më pas synoi Indinë e Kinën dhe më

pas u kthye në Khorasan. Ai ka ndërtuar shumë qytete, më pas u kthye në Irak, ku u sëmur dhe vdiq në qytetin Zur të Irakut.

Disa të tjerë kanë thënë se ai nuk ka jetuar më shumë se 36 vjet dhe se trupin e tij e kanë transportuar për në Aleksandri dhe aty është varrosur.¹

Teoria e dytë: të gjithë historianët mendojnë se Dhulkarnejni është njëri prej mbretërve të Jemenit (mbretërit e Jemenit emërtoheshin me fjalën “tub’beë” dhe shumësi i kësaj fjale është “tubàbeah”). Në mbrojtje të kësaj teorie kanë dalë El Asmeij’ji në librin “Historia e arabëve para Islamit”, Ibni Hish’shàmi në historinë e njohur me emrin “Biografia e Ibni Hish’shàmit” dhe Ebù Rejhàn El Bijrunij’ji në librin “El Àthàrul Bàkijeh” – “Monumentet e qëndrueshme”.

Gjithashtu mund të shikojmë se poetët e Humejrive, që janë prej tribuve të Jemenit, si dhe disa poetë të tjerë të kohës së injorancës para Islamit, në poezitë e tyre krenoheshin që Dhulkarnejni ishte prej tribusë së tyre.²

Sipas kësaj teorie diga e njohur Me’reb është diga e Dhulkarnejnit.

Teoria e tretë: është teoria më e re në këtë fushë e shtruar prej ideologut të njohur islam Ebul Kelàm Àzàd, i cili në ditët e sotme mban postin e ministrit të kulturës në Hindi. Opinionin e tij

¹ Këtë mund ta shikojmë në tefsirin e Fahrri Rraziut dhe në “El Kàmil” të Ibni Ethijrit, vëll. 1, f. 287. Disa mendojnë se i pari që ka folur me këtë teori është shejhi Ibni Sijnà në librin e tij “Esh’shifàu”.

² “El Mizàn”, vëll. 13, f. 414.

për këtë teori e ka shprehur në një libër të shkruar prej tij në këtë fushë studimesh.

Sipas kësaj teorie, Dhulkarnejni është mbreti akhmejnij, Kurshi i Madh.

Teorinë e parë dhe teorinë e dytë nuk e mbështet asnjë argument i fuqishëm, shto edhe faktin që cilësitë e Aleksandërit të Maqedonisë, ose të mbretërve të Jemenit, nuk përputhen me cilësitë që përmend Kur'ani për Dhulkarnejnin.

Nga një anë e tretë, Aleksandri nuk ka ndërtuar ndonjë digë që të jetë bërë e njohur, gjithashtu edhe cilësitë e digës Me'reb në Jemen nuk përputhen me cilësitë e digës së Dhulkarnejnit, e cila u ndërtua prej hekuri e bakri dhe u ndërtua për të pritur sulmet e popujve primitivë, në një kohë që diga Me'reb është ndërtuar me materiale të zakonshme për të depozituar ujin dhe për të ndaluar inondatat. Në lidhje me digën Me'reb, Kur'ani Famëllartë ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në suren "Sebe".

Për të gjitha këto shkaqe, në studimin tonë do të përqendrohemi në teorinë e tretë, por, paraprakisht, e shikojmë të domosdoshme të tërheqim vëmendjen rreth çështjeve të mëposhtme:

a) Përse Dhulkarnejni u emërtua me këtë emër (dy brirësh)?

Disa besojnë se shkaku i emërtimit të tij me këtë emër ka të bëjë me arritjen e tij në lindje e në perëndim, si dhe me faktin se arabët, këto dy anë të horizontit, i quanin dy brirët e diellit.

Disa të tjerë mendojnë se ai ka jetuar ose qeverisur dy shekuj, por duhet theksuar se sa vjet llogaritej një shekull në atë

kohë. Dihet se për çështjet, sa vjet ishte një shekull në atë kohë ka mendime të ndryshme.

Një palë e tretë kanë thënë se në të dyja anët e kokës së tij gjendeshin dy brirë dhe, për këtë shkak, ai është quajtur Dhulkarnejn, “dy brirësh”.

Së fundi, disa të tjerë besojnë se kurora e tij e veçantë ishte e punuar me dy brirë.

Natyrisht që këtu ka edhe mendime të tjera në lidhje me emërtimin e tij Dhulkarnejn, por përmendja e këtyre mendimeve e zhvlerëson qëllimin e studimit tonë. Më poshtë do të shikojmë se vënësi i teorisë së tretë (Ebul Kelâm Âzâd) ka përfituar shumë prej këtij epiteti për ta vërtetuar teorinë e tij.

b) Nëse do të shikojmë me hollësi në ajetet e Kut’ânit Famëlartë, patjetër që do të mësojmë se Dhulkarnejni kishte cilësi të shkëlqyera dhe që janë:

* All’llahu i Lartësuar kishte përgatitur për atë shkaqet e fuqisë dhe faktorët që garantojnë fitoren dhe, të gjitha këto i kishte vënë që ai t’i përdorte sipas nevojës që kishte.

* Ai përgatiti tri ushtri të rëndësishme. Ushtrinë e parë e nisi për në perëndim, të dytën e nisi për në lindje dhe të tretën e drejtoi për në rajonin ku përfshihet ngushtica në mes maleve. Në këto udhëtime, ai pati një bashkëpunim të veçantë me popuj të ndryshëm, ashtu siç e pamë në ajetet e sipërpërmendura.

* Ai ishte njeri besimtar, ku shkëlqenin cilësitë e besimtarit monoteist dhe dashamirësia. Ai nuk u shmang kurrë nga rruga e drejtësisë dhe, për këtë shkak, atë e përfshiu mëshira e veçantë e

Zotit. Ai ishte ndihmues për punëmirët dhe ishte armik i atyre që bënë padrejtësi. Ai kurrë nuk aspiroi e kurrë nuk deshi të kishte pasuri të shumta në këtë botë.

* Ai besonte në All'llahun edhe në Ditën e Fundit.

* Ai ndërtoi njërën prej digave më të forta dhe atë digë e ndërtoi prej hekuri e bakri në vend që ta ndërtonte me beton e me gurë. (Nëse atje kishte materiale të tjera të përdorura për ndërtimin e asaj dige, ato materiale nuk merren në konsideratë në krahasim me hekurin e me bakrin). Qëllimi i tij me ndërtimin e digës përfaqësohet në ndihmën e të pafuqishmëve përballë mizorisë së je'xhùxhë e me'xhùxhëve.

* Ai ishte person me famë në mesin e një grupi njerëzish, fama e tij njihej edhe para zbritjes së Kur'anit, prandaj edhe kurejshët, ose jehuditë e pyetën të Dërguarin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) – për Dhulkarnejnin, ashtu siç shprehet për këtë çështje Libri Famëlartë me fjalën e të Lartit: **“Të pyesin ty për Dhulkarnejnin”**.

Nuk është e mundur të mësohet ndonjë gjë prej fjalëve të Kur'anit nëse ai ishte Profet, pavarësisht nga ekzistenca e shprehjeve nga të cilat ndihet ky kuptim, ashtu siç e pamë gjatë komentimit të ajeteve të mësipërme.

Në disa transmetime islame të ardhura prej të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) si dhe prej Imamëve të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) lexojmë: “Ai nuk ishte Profet, por ishte rob i mire.”¹

¹ Referohu në tefsirin “Nùruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 294 dhe f. 295.

c) Baza e fjalës në teorinë e tretë që Dhulkarnejni është Kurshi i Madh, mbështetet mbi dy baza që janë:

Baza e parë: në përputhje me mjaft transmetime të ardhura në lidhje me shkakun e zbritjes së ajeteve objekt studimi, thuhet se ata që pyetën për Dhulkarnejnin ishin prej jehudëve, ose ishin prej kurejshëve, të cilët e shtruan atë pyetje me urdhër të jehudive dhe të nxitur prej tyre, prandaj del detyrë të gjurmojnë rrënjën e kësaj çështjeje në librin e jehudive.

Prej librave të njohur ndër jehuditë, është libri i Danielit. Në kapitullin e tetë të këtij libri lexojmë: “Kur ai mbretëroi (madje shpoi me brirë), unë, Danieli, pashë disa ëndrra njëra pas tjetrës dhe kjo më ndodhi kur ai banoi në pallatin Shùshàn në vendin Ajlâm. Unë pashë në ëndërr se isha afër një lumi (Ulàj) dhe se një dash kishte qëndruar pranë lumit; dashi kishte dy brirë të gjatë dhe godiste me brirët e tij nga perëndimi, nga veriu e nga jugu dhe askush nuk dilte para tij, sepse nuk kishte njeri para tij, prandaj ai vepronte ashtu siç donte, ai dash madhëronte Zotin (thoshte All’llahu Ekber).¹

Më pas në këtë libër citohet prej Danielit fjala e tij: “Atij iu shfaq Gabrieli (Xhibrili), i cili e shpjegoi ëndrrën e tij kështu: “Dashi është Dhulkarnejni që ti ke parë në ëndërr, ai është prej mbretërve të vendeve të persëve (ose mbretërve madu dhe persë)”.

¹ Libri i Danielit, kapitulli i tetë, fjalitë 1-4.

Jehuditët e morën si përgëzim ëndrrën e Danielit dhe mësuan prej saj se periudha e robërisë së tyre nën babilonasit kishte përfunduar.

Nuk kaloi shumë kohë dhe Kurshi mori qeverisjen në Iran, ai bashkoi vendin e maduve e të persëve dhe prej këtij bashkimi formoi një mbretëri të madhe dhe, siç thotë Danieli, dashi godiste me bririn e tij perëndimin. Kurshi ndërmori fushata luftarake të mëdha në tri drejtime, ai çliroi jehuditë dhe i lejoi ata të kthehen në Palestinë.

Është me vlerë të theksohet edhe ajo që ne lexojmë në Teuràt, në librin “Esh’ijà”, kapitulli 44, nr. 28. “Më pas në lidhje me Kurshin thotë: Ai ishte bari tek unë (domethënë te Zoti) dhe ai do të vërë në zbatim dëshirën Time”.

Duhet të tërheqim vëmendjen se përsëkrimi i Kurshit ka ardhur në Teuràt në disa shprehje, ku thuhet se ai është “shqiponja e lindjes” dhe burri sistemues i ardhur prej një vendi të largët. (Libri “Esh’ijà”, kapitulli 46, nr. 11).

Baza e dytë: në shekullin nëntëmbëdhjetë të erës sonë u zbulua një shtatore e Kurshit me gjatësinë e njeriut të zakonshëm, pranë qytetit Istakhar, në afërsi të lumit Mergàb. Prej kësaj shtatoreje duket se Kurshi kishte dy flatra që i ngjanin flatrave të shqiponjës dhe në kokën e tij shiheshin dy brirë të ngjashëm me brirët e dashit.

Përveç këtyre që u thanë, shtatorja ka edhe vlera të rralla të artit të skulpturave të vjetra që kanë tërhequr interesin e shkencëtarëve, madje një grup dijetarësh gjermanë erdhën në Iran vetëm për ta parë këtë shtatore.

Duke bërë përputhjen e asaj që ka ardhur në Teurat me cilësitë e shtatores, në mendjen e dijetarit të madh Ebul Kelàm Àzàd u kristalizua mundësia se ka një të përbashkët ndërmjet Dhulkarnejnit dhe Kurshit, dhe se ky i fundit nuk është askush tjetër, por vetë Dhulkarnejni. Shtatorja e Kurshit ka dy flatra si flatrat e shqiponjës dhe në këtë mënyrë, për një grup dijetarësh, bëhet i qartë personi historik i Dhulkarnejnit.

Në këtë teori lënë mbresë cilësitë morale që përmend historia për Kurshin.

Historiani i Greqisë së vjetër Herodoti thotë: “Kurshi i urdhëroi forcat e tij të mos godasin me shpatat e tyre asnjë tjetër përveç luftëtarëve dhe të mos vrasin asnjë ushtar të armikut kur ai përulet dhe, ushtria iu bind urdhrave të tij, për rrjedhojë, masa e njerëzve nuk i ndjeu fare vështirësitë e luftës e pësimet e rënda që shkakton ajo”.

Gjithashtu Herodoti shkruan për atë: “Kurshi ishte një mbret i ndershëm, bujar dhe i mëshirshëm, ai nuk ishte si mbretërit e tjerë që kujdesin më të madh e kanë të grumbullojnë pasuri, ai bënte shumë kujdes të vendoste drejtësinë, dallohej për vetinë e dhënies e të bujarisë, mbronte të dhunuarit nga padrejtësitë dhe e donte të mirën”.

Historiani Dë Nufen thotë: “Kurshi ishte një mbret i drejtë e i mëshirshëm, në të ishin mbledhur virtytet e të urtëve dhe nderi i mbretërve, vullneti i lartë ishte zotërues mbi të gjithë qenien e tij. Parulla e tij ishte: ‘Shërbimi ndaj njerëzimit’, morali i tij ishte përhapja e drejtësisë, gjithashtu kryeultësia e toleranca tek ai dilnin mbi mendjemadhësinë e mbi vetëpëlqimin”.

Në këtë çështje vlen të theksohet se historianët që e kanë përmendur Kurshin me cilësitë që u thanë më sipër ishin shumë larg prej popullit të Kurshit dhe nuk ishin bij të atdheut të tij, por ata ishin grekë. Dihet se grekët pësuan një disfatë shumë të rëndë prej Kurshit kur u pushtua Lidia.

Përkrahësit e këtij mendimi thonë se cilësitë e përmendura në Kur'anin Famëlartë për Dhulkarnejnin përputhen me cilësitë historike të Kurshit.

E rëndësishme në këtë çështje është edhe fakti se Kurshi ka ndërmarrë udhëtime në drejtim të veriut, lindjes e perëndimit. Tregimi për këto udhëtime të ndara njëra nga tjetra që ka bërë Kurshi gjatë jetës së tij, përputhen me tri udhëtimet e Dhulkarnejnit të përmendura në Kur'anin Famëlartë.

Ushtrinë e parë e nisi për në vendin e quajtur Lidi, që ndodhet në veri të Azisë së vogël. Ky vend ishte pranë qendrës së qeverisë së Kurshit.

Kur vëmë përpara hartën e bregdetit perëndimor të Azisë së vogël, shikojmë se pjesa më e madhe e këtij bregdeti ka shumë gjire të vegjël, sidomos në afërsi të Izmirit, ku gjendet një gji deti i ngjashëm me syrin. Kur'ani Famëlartë shpjegon qartë se Dhulkarnejni në udhëtimin e tij në drejtim të perëndimit kishte përshtypjen se dielli u mbyt në një burim me ujë të ndotur.

Kjo ishte edhe panorama që pa Kurshi kur dielli zhytej në gjiret e bregdetit dhe, ai që e shikonte këtë pamje i duket sikur dielli mbytet në ato gjire bregdetare.

Ushtria e dytë u nis në drejtim të lindjes. Këtë ushtri Herodoti e përshkruan me këto fjalë: “Ky sulm në lindje ishte pas pushtimit të Lidisë, sidomos mbas mosbindjes së disa tribeve primitive, dhe ishte kjo mosbindje e atyre tribeve që e detyroi Kurshin të ndërmarrë këtë sulm”.

Ndërsa ajeti i Kur’anit thotë: **“Derisa arriti në vendin ku lind dielli, të cilin e gjeti të lindë mbi një popull, të cilit nuk i kemi dhënë të mbulohet prej tij (diellit).”**. Fjalët e ajetit janë një shenjë që tregon se udhëtimi i Kurshit në drejtim të lindjes ishte aq i largët sa Kurshi pa që dielli lindi mbi disa njerëz, të cilët nuk kishin bërë as ndonjë hije që të ruheshin prej rrezeve të tij dhe, kjo tregon se ata ishin banorë nomadë të shkretëtirës.

Ushtrinë e tretë e nisi nga ana veriore në drejtim të maleve Kaukaz, derisa arriti në një ngushticë në mes dy maleve dhe aty me kërkesën e banorëve të atij vendi ndërtoi një digë të përsosur që ata të mbroheshin me atë digë prej sulmeve të tribeve primitive që ishin prej popujve je’xhùxhë e me’xhùxhë.

Në ditët e sotme, kjo ngushticë quhet ngushtica Darjal, e cila mund të shihet edhe në hartat e botuara në ditët e sotme dhe që ndodhet në mes Valàdij Kjukez dhe Telfijs, në vendin ku ende vazhdon të duken mbetjet e një muri të hekurt dhe që është në të njëjtin vend ku Kurshi ndërtoi digën. Në këtë vend ka një përputhje të qartë në mes asaj që përmendet në Kur’anin Famëlartë me cilësitë e me karakteristikat e digës së Dhulkarnejnit.

Këto ishin një përmbledhje e argumenteve që mbështesin teorinë e tretë rreth personit të Dhulkarnejnit.¹

Është e vërtetë se në këtë teori ka pika të paqarta, megjithëkëtë, në ditët e sotme ajo konsiderohet teoria më e mirë në lidhje me personin e Dhulkarnejnit, gjithashtu edhe cilësitë me të cilat e përshkruan Kur'ani Famëlartë Dhulkarnejnin, përputhen me cilësitë e këtij personaliteti historik, Kurshit të madh.

3) Ku gjendet diga e Dhulkarnejnit?

Pavarësisht përpjekjeve të bëra për ta përputhur digën e Dhulkarnejnit me murin e madh kinez, mur që vazhdon të jetë edhe në ditët tona, gjatësia e të cilit arrin qindra kilometra, është fare e qartë se në ndërtimin e tij nuk hyn as hekuri e as bakri, përveç kësaj muri kinez nuk gjendet në ngushticën në mes dy maleve, por është një mur i ndërtuar me lëndë ndërtimi të zakonshme. Siç u tha, gjatësia e këtij muri arrin disa qindra kilometra dhe që vazhdon të ekzistojë edhe në ditët e sotme.

Disa mendojnë se diga e Dhulkarnejnit është diga Me'reb në Jemen, por kjo digë, megjithëse gjendet në një ngushticë malore, është ndërtuar për të ndaluar vërshimin e ujërave dhe për të mbledhur ujin, përveç kësaj, as hekuri e as bakri nuk është prej materialeve që janë përdorur për ndërtimin e digës Me'reb.

Por, bazuar në dëshmitë e dijetarëve dhe të njerëzve me përvojë, siç theksuam pak më sipër, diga për të cilën po flasim

¹ Për më shumë hollësi mund të lexoni librin "Dhulkarnejni ose Kurshi i madh".

ndodhet në Kaukaz, në mes të detit Kaspik dhe detit të Zi, ku gjenden vargmale që ndajnë si mur veriun prej jugut dhe gryka e vetme që gjendet në këto vargmale është gryka e mirënjohur Darjal. Pikërisht në këtë ngushticë shihen gjurmët e një muri prej hekuri. Për të gjitha këto, shumë dijetarë besojnë se diga e Dhulkarnejnit ndodhet në këtë grykë mali, gjithashtu përshkrimet arkeologjike të atij muri janë një argument përforcues që diga e Dhulkarnejnit është pikërisht në këtë ngushticë malore.

Vlen të theksohet se një lumë rrjedh në afërsi të vendit të quajtur Sàirs, domethënë Kursh, pasi grekët e vjetër Kurshin e quanin Sàirs.

Edhe në monumentet arkeologjike të Armenisë, ky mur njihet me emrin “Bihak Kuràij”, që do të thotë “ngushtica e Kurshit”, ose “vendkalimi i Kurshit” dhe, ky është një argument tjetër që vërteton se Kurshi është ndërtuesi i digës.¹

4) Kush janë je’xhùxhë e me’xhùxhët?

Kur’ani Famëlartë i përmend je’xhùxhë e me’xhùxhët në dy sure. Herën e parë i përmend në ajetet object studimi dhe herën e dytë i përmend në suren “El Enbijà”, në ajeti 96.

Ajetet kur’anore shpjegojnë qartë se këta dy emra janë emrat e dy tribeve primitivë që i sillnin shumë mundime banorëve të zonave përreth.

¹ Për më shumë hollësi referohu në dy burimet e mësipërme.

Në librin “Hazkijli” të Teuràtit, kapitulli tridhjetë e tetë dhe kapitulli tridhjetë e nëntë, gjithashtu edhe në librin “Ëndrra e Joanit”, kapitulli njëzet, je’xhùxhë e me’xhùxhët janë përmendur me titullin “kodek” dhe “màkùk”, që në gjuhën arabe përkthehen je’xhùxhë e me’xhuxhë.

Dijetari poliedrik Et Tabàtàij, në tefsirin “ElMizàn”, thotë: “Nga tërësia e asaj që është përmendur në Teuràt mësohet se me’xhùxh, ose je’xhùxhë e me’xhùxhë, janë një grup ose grupe të mëdha që banonin pikën më të largët të veriut të Azisë, ishin njerëz luftëtarë dhe ndryshonin nga banorët e vendeve të afërta me ata.”.¹

Disa besojnë se këto janë dy fjalë hebraike, por që në origjinë kanë ardhur prej greqishtes së vjetër në hebraishten, pasi në greqishte shqiptoheshin “Kàk” dhe “Màkàk dhe më pas në këtë formë kaluan në të gjitha gjuhët evropiane.

Argumentet historike vërtetojnë se rajoni verilindor i krahinës së Mongolisë, në kohët e kaluara kishte popullsi të dendur, njerëzit aty shtoheshin shumë dhe shpejt dhe, pasi u shtuan shumë ata u nisën në drejtim të lindjes, ose në drejtim të jugut dhe arritën të sundojnë në vendet ku hynë dhe gradualisht filluan të banojnë në ato vende.

Kanë ardhur fragmente të ndryshme të historisë rreth lëvizjeve dhe emigrimeve të këtyre tribuve. Njëri prej sulmeve të tyre ka ndodhur në shekullin e katërt të erës sonë nën udhëheqjen

¹ Shiko në vëll. 13, të tefsirit “El Mizàn”, f. 411.

e Atilës dhe ky sulm i Atilës i dha fund qytetërimit të Perandorisë Romake.

Sipas historisë, sulmi i dytë i atyre tribuve ka ndodhur në shekullin dymbëdhjetë të erës sonë nën udhëheqjen e Xhengizhanit, i cili sulmoi vendet lindore islame dhe shkatërroi shumë qytete, veçanërisht Bagdadin, kryeqendrën e kalifatit të Ab'bàsive, gjithashtu këto tribu kanë ndërmarrë një sulm të fuqishëm edhe në kohën e Kurshit rreth vitit 500 para erës sonë, madje kanë ndërmarrë disa sulme, porse qëndrimi i qeverisë Mād e Farsi kundrejt atij sulmi, bëri që gjendja të ndryshojë e të vendoset qetësia në Azinë perëndimore, e cila shpëtoi prej inkursioneve të atyre tribuve.

Me këtë shpjegim, del qartë se je'xhùxhë e me'xhùxhët ishin prej atyre tribuve barbare, prandaj banorët e Kaukazit i kërkuan Kurshit, kur ai erdhi tek ata që t'i shpëtonte prej sulmeve të atyre tribuve dhe, bazuar në kërkesën e tyre, u plotësua ndërtimi i digës së njohur me emrin "diga e Dhulkarnejnit".¹

¹ Për më shumë hollësi referoj librit "Dhulkarnejni ose Kurshi i Madh".

Ajetet 99 - 102

وَتَرَكْنَا بَعْضَهُمْ يَوْمَئِذٍ يَمُوجُ فِي بَعْضٍ وَنُفِخَ فِي الصُّورِ فَجَمَعْنَاهُمْ جَمْعًا
 ﴿٩٩﴾ وَعَرَضْنَا جَهَنَّمَ يَوْمَئِذٍ لِلْكَافِرِينَ عَرْضًا ﴿١٠٠﴾ الَّذِينَ كَانَتْ أَعْيُنُهُمْ فِي
 غِطَاءٍ عَنِ ذِكْرِي وَكَانُوا لَا يَسْتَطِيعُونَ سَمْعًا ﴿١٠١﴾ أَفَحَسِبَ الَّذِينَ
 كَفَرُوا أَنْ يَتَّخِذُوا عِبَادِي مِنْ دُونِي أَوْلِيَاءَ إِنَّا أَعْتَدْنَا جَهَنَّمَ لِلْكَافِرِينَ
 نُزُلًا ﴿١٠٢﴾

“Atë Ditë Ne i lëmë ata të hipin njëri mbi tjetrin (si dallgët e detit); i fryhet surit dhe Ne ata i tubojmë të gjithë.”

“Atë Ditë Ne ua paraqesim Xhehennemin jobesimtarëve fare hapur.”

“Ata që i kishin sytë të mbuluar ndaj argumenteve të Mia dhe nuk mund të dëgjonin.”

“A mos menduan jobesimtarët se mund të marrin për zota robtë e Mi? Ne e kemi përgatitur Xhehennemin vendprirje për jobesimtarët.”

Komentimi

Përfundimi i jobesimtarëve

Ajetet e mësipërme trajtuan mbylljen e je'xhùxhë e me'xhùxhëve dhe shembjen e digës që ndërtoi Dhulkarnejni në kohën e Ringjalljes, kurse ajetet object studimi trajtojnë çështje të Kiametit dhe ajeti i parë i këtij grupi ajetesh thotë: *“Atë Ditë’, domethënë ditën kur të marrë fund bota, ‘Ne do t’i lëmë ata të hipin njëri mbi tjetrin.’”*:

“Atë ditë Ne i lëmë ata të hipin njëri mbi tjetrin.”

Përdorimi i fjalës *“jemùxhu”* – *“mbi njëri-tjetrin”* është për shkak se në atë ndodhi, njerëzit janë të shumtë. Kjo mënyrë shprehjeje ngjason me fjalën tonë kur themi: “Në filan ngjarje u mblodhën shumë vetë, sa njerëzit kishin hipur njëri mbi tjetrin”. Kjo mënyrë shprehjeje përdoret për të treguar se ishin mbledhur aq shumë njerëz, sa nuk kishte vend ku të rrinin; ose kjo fjalë është përdorur për të treguar gjendjen e trazuar të njerëzve dhe frikën që i ka mbërthyer në atë Ditë, aq sa trupat e tyre duken sikur lëkundën si dallgët e ujit.

Natyrisht që ka një kontradiktë midis dy kuptimeve, por gjithashtu ka mundësi që shprehja në ajet të përfshijë të dyja gjendjet.

Më pas ajeti shton: **“i fryhet surit dhe Ne ata i tubojmë të gjithë”**. Nuk ka asnjë dyshim që të gjithë njerëzit do të tubohen në atë shesh dhe askush nuk do të përjashtohet, sepse vetë fraza **“i tubojmë të gjithë”** e tregon qartë këtë të vërtetë.

Prej këtij grupi ajetesh mësojmë se do të ndodhin dy ndryshime të mëdha në kohën e mbarimit të kësaj bote dhe fillimit të botës së re.

E para: asgjësimi i të gjitha qenieve dhe i njerëzve në njëjtën kohë.

E dyta: ringjallja e të vdekurve, gjithashtu në të njëjtën kohë.

Ne nuk e dimë se sa është koha ndërmjet dy ndodhive, porse Kur'ani shprehet për këto dy ndryshime me frazën "*ue nufikha fis'sùri*" – "*i fryhet surit*". Me dashjen e All'llahut kuptimin e frazës "*i fryhet surit*" do ta shpjegojmë në fundin e komentimit të ajetit 68 të sures "Ez Zumer".

Në një transmetim të përcjellë prej Asbag bin Nebàteh, prej Imam Sadikut (*Paqja qofte mbi të!*), i cili në këtë transmetim shpjegon se qëllimi me fjalën e të Lartit: "**Atë ditë Ne i lëmë ata të hipin njëri mbi tjetrin**" është për Ditën Kiametit.¹

Disa përfytyrojnë se këtu kemi një kontradiktë ndërmjet transmetimit dhe asaj që thamë më sipër në komentimin e ajetit, ku theksuam: "Kjo është në kuptimin e periudhës së asgjësimit të kësaj bote", ashtu siç kuptohet prej fjalëve të ajeteve që ishin para këtij ajeti dhe të ajeteve që vijnë pas tij; porse kjo kontradiktë bie kur ne të shikojmë në vërejtjen fjala "*Dita e Kiametit*" disa herë përdoret në një kuptim shumë të gjerë që përfshin edhe faktorët paraprakë, domethënë, faktorët paraprakë të Kiametit, në një kohë kur ne dimë se asgjësimi i shpejtë i kësaj bote është njëri prej këtyre faktorëve.

Më pas ajetet shpjegojnë faza prej gjendjes së jobesimtarëve (mohuesve) duke shpjeguar përfundimin e punëve të tyre, si dhe

¹ Tefsiri i El Ijashij'jit, cituar prej tefsirit "El Mizàn", në komentimin e ajetit në fjalë.

të cilësive që çojnë në këtë përfundim. Ajeti vijues thotë: **“Atë ditë Ne ua paraqesim Xhehennemin jobesimtarëve fare hapur.”**.

Xhehennemi do të jetë para syve të tyre dhe për ata do të bëhen të qarta llojet e ndryshme të ndëshkimeve në Xhehennem. Vetëm kjo pamje është në vetvete ndëshkim shumë i dhimbshëm, por, si do të jetë ndëshkimi kur ata të jenë brenda në Xhehennem?! Cilët janë jobesimtarët (kafirët)? Përse dënohen me këtë ndëshkim?

Të gjitha këto ajeti i bën të njohura vetëm me një fjali të shkurtër dhe thotë: **“Ata që i kishin sytë të mbuluar ndaj argumenteve të Mia...”**, megjithëse veshët i kishin, porse ata e kishin humbur fuqinë për të dëgjuar dhe ajeti shpjegon: **“...dhe nuk mund të dëgjonin.”**.

Realisht ata e kishin humbur mjetin më të rëndësishëm për njohjen e së vërtetës dhe kuptimin e saj. Ata e lanë pas dore këtë mjet kaq të rëndësishëm që e çon njeriun në gjendjen më të keqe, ose në gjendjen më të lumtur, domethënë se ata i mbyllën sytë e veshët e tyre me një perde, për shkak të mendimeve të gabuara që kishin, për shkak të fanatizmit, si dhe për shkak të urrejtjes që kishin së zemrat e tyre, patjetër edhe për shkak të veseve të tjera të këqija që ata manifestonin.

Është shumë domethënëse fakti se ajeti për çështjen e syrit në veçanti thotë: “Syri ishte i mbuluar dhe ishte larg që të shikojë argumentet e Mia”. Kjo mënyrë shprehjeje tregon se ata nuk kishin mundësi të shikonin argumentet e Krijuesit të Gjithëfuqishëm, në një kohë që prej njeriut kërkohet të ketë sy që shikojnë dhe veshë që dëgjojnë!

Me fjalë të tjera, përmendja e All'llahut dhe besimi në argumentet e Tij nuk është diçka që mund të shihet me sy, pasi ato që sheh syri janë vetëm argumente të Tij dhe janë pikërisht këto argumente që i kujtojnë njeriut Krijuesin e tij.

Ajeti që vjen më pas e vë theksin mbi shmangien ideore të jobesimtarëve. Në të vërtetë, shmangia ideore është origjina e shmangieve të tjera të shfaqura tek ata, ashtu siç thotë ajeti: **“A mos menduan jobesimtarët se mund të marrin për zota robtë e Mi?”**

Mos vallë të adhuruarit e tyre, si Mesihun dhe engjëjt, i kanë për t'u mbrojtur me ta prej të tjerëve, pavarësisht nga pozita e tyre shumë e lartë, ose puna është e kundërta e kësaj, domethënë se të gjitha sa janë tek ta, janë prej All'llahut dhe se ata vetë kanë nevojë për udhëzimin e Tij në rrugën e drejtë?

Kjo e vërtetë është fare e qartë, porse ata e harruan këtë të vërtetë dhe u ngatërruan në kurthet e vënies shok e ortak All'llahut (në kurthet e shirkut).

Në fundin e ajetit dhe për të theksuar edhe më shumë përfundimin e mosbesimit, i Larti thotë: **“Ne e kemi përgatitur Xhehennemin vendpritje për jobesimtarët.”**

Fjala e ajetit *“nuzulen”* është në kuptimin e *vendbanimit*, gjithashtu ka edhe kuptimin e *përgatitjeve për të qerasur mysafirët që të vijnë shtëpi*. Disa të tjerë kanë thënë se kjo fjalë përdoret për qerasjen e parë me të cilën pritet miku, kur ai hyn në shtëpi, si fruta, apo një pije.

Ajetet 103 - 108

﴿ ١٣ ﴾ قُلْ هَلْ نُنَبِّئُكُمْ بِالْأَخْسَرِينَ أَعْمَالًا ﴿ ١٤ ﴾ الَّذِينَ ضَلَّ سَعِيَّهُمْ فِي الْحَيَاةِ
 الدُّنْيَا وَهُمْ يَحْسَبُونَ أَنَّهُمْ يُحْسِنُونَ صُنْعًا ﴿ ١٥ ﴾ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ كَفَرُوا
 بِآيَاتِ رَبِّهِمْ وَلِقَائِهِمْ فَحَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فَلَا نُقِيمُ لَهُمْ يَوْمَ الْقِيَمَةِ وَزَنًا
 ﴿ ١٦ ﴾ ذَٰلِكَ جَزَاؤُهُمْ جَهَنَّمُ بِمَا كَفَرُوا وَاتَّخَذُوا آيَاتِي وَرُسُلِي هُزُوًا ﴿ ١٧ ﴾
 إِنَّ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ كَانَتْ لَهُمْ جَنَّاتُ الْفِرْدَوْسِ نُزُلًا ﴿ ١٨ ﴾
 خَالِدِينَ فِيهَا لَا يَبْغُونَ عَنْهَا حِوَلًا ﴿ ١٩ ﴾

“Thuaj: ‘A t’ju njoftojmë se kush janë më të humburit në punët e tyre?’”

“Janë ata që me punën e tyre ranë në rrugën e humbjes në jetën e kësaj bote, megjithëse mendojnë se bëjnë punë të mirë.”

“Janë ata që nuk besuan argumentet e Zotit të tyre dhe takimin me Të; prandaj punët e tyre shkuan kot dhe Ditën e Gjykimit atyre (punëve) nuk do t’u japim asnjë peshë.”

“Dënimi për ta është Xhehennemi për shkak se nuk besuan dhe u tallën me argumentet e me të Dërguarit e Mi.”

“Kurse për ata që besuan dhe bënë punë të mira, vendprirja për ta do të jenë Xhenetet Firdeus.”

“Aty do të jenë përgjithmonë dhe nuk do të kërkojnë që të largohen prej andej.”

Komentimi

Njerëzit që pësojnë humbjen më të madhe

Këto ajete dhe ajetet që vijnë më pas në fundin e kësaj sureje të bekuar, flasin për cilësitë e jobesimtarëve dhe konsiderohen një lloj përmbledhjeje për të gjitha studimet që kanë ardhur në këtë sure, veçanërisht studimet që kanë lidhje me banorët e shpellës (as'hàbul-kehfi), me Mùsà në Hidrin, me Dhulkarnejnin dhe me punën e madhe që ata kanë bërë përballë kundërshtarëve të tyre.

Në radhë të parë, ajetet object studimi flasin për njerëzit që pësojnë humbjen më të madhe. Çështjen e humbjes më të madhe, ajeti e shtron në formë pyetjeje me qëllim që të ngjallë te dëgjuesi kureshtjen rreth çështjes dhe fjala i drejtohet të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i cili urdhërohet të thotë: **“Thua: ‘A t’u njoftojmë se kush janë më të humburit në punët e tyre?’”**.

Përgjigjja vjen menjëherë, me qëllim që dëgjuesi të mos mbetet i hutuar dhe ajeti shton: **“Janë ata që me punën e tyre ranë**

në rrugën e humbjes në jetën e kësaj bote, megjithëse mendojnë se bëjnë punë të mire.”.

Koncepti i humbjes nuk është për humbjen e fitimeve, por për humbjen reale të origjinës së kapitalit. Por a ka kapital më fitimprurës, më të privilegjuar e më të mirë se mendja, zgjuarsia dhe kapacitetet Hyjnore që i janë dhuruar njeriut, siç janë jeta, rinia e shëndeti?

Rezultat i të gjitha këtyre kapaciteteve të dhuruara janë punët që bën njeriu dhe punët në fakt janë një pasqyrim dhe konkretizim i fuqive dhe i kapaciteteve tona.

Kur këto kapacitete transformohen në punë shkatërruese, ose në punë pa ndonjë qëllim, në të vërtetë, ato janë si punë të asgjësuar, ose punë të humbura, janë si ai njeriu që mban me vete një pasuri të madhe, por gjatë rrugës për në treg e humb këtë pasuri dhe kthehet pa asgjë në dorë.

Ndodh që humbja e pasurisë të mos jetë humbje e madhe kur njeriu nxjerrë prej humbjes së saj mësim të mëdha, të cilat në disa raste si vlerë mund të jetë të barabarta me pasurinë e humbur, madje edhe më shumë, prandaj është sikur ai person nuk ka pësuar asnjë humbje.

Gjithësesi humbja e vërtetë dhe e shumëfishuar është atëherë kur njeriu e humb kapitalin e tij material e moral në rrugë të gabuara dhe në fusha që shmangin nga rruga e drejtë. Megjithëse ai mendon se po bën punën më të mirë dhe, pavarësisht se nuk merr i frutat e punës së tij, nuk e kthen kokën të shikojë se në ç’ gjendje është, por vazhdon të përsërisë të njëjtën punë.

Është një shprehje shumë e bukur që Kur'ani Famëlartë për të treguar punëhumburit përdor frazën *“akhserijne a'màlen”* - **“më të humburit në punët e tyre”**, megjithëse sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe fjala *“punët”*, që në këtë fjali është plotësor dallimi, zakonisht vjen në numrin njëjës, megjithëkëtë në tekstin e Kur'anit ka ardhur në numrin shumës. Fakti që në këtë ajet fjala ka ardhur në numrin shumës, tregon se ata nuk humbin vetëm në një punë të caktuar, porse injoranca e tyre e shumëanshme bëhet shkak që të dalin me humbje në të gjitha programet e jetës dhe në të gjitha punët e tyre.

Me fjalë të tjera, njeriu mund të fitojë në një lloj tregtie dhe humb në tregtitë e tjera, prandaj në bilancin e fundvitit nuk do të ketë ndonjë humbje të madhe, ndërsa njeriu që ndjek udhën e gabuar, pëson humbje në të gjitha punët që ndërmerr.

Në ajet është përdorur fjala *“dal'le”* - *“bie në rrugën e humbjes”*. Kjo fjalë tregon pikërisht këtë të vërtetë. Domethënë se punët që bën njeriu në këtë botë nuk zhduken në asnjë formë, ashtu siç nuk zhduken lënda e fuqia, por transformohen e shndërrohen, megjithëse ndodh që disa herë qëndrojnë të fshehura për shkak se nuk është e mundur që shenjat e lëndës e të fuqisë të shikohen me sy, prandaj është e pamundur që prej atyre të përfitohet në asnjë mënyrë. E njëjta gjë ndodh edhe me kapitalin e humbur dhe që nuk është më në dispozicionin tonë që të përfitojmë prej tij, megjithëse ai kapital që nuk është më në dorën tonë, nuk është asgjësuar.

Atëherë përse njeriu bie shpirtërisht në të këtilla në gjendje? Këtë çështje do ta trajtojmë në mënyrë të detajuar në paragrafin e studimeve.

Ajetet e tjera përmendin cilësitë dhe besimet e këtij grupi të humburish dhe fillojnë me cilësitë negative që janë themeli i pësimeve të tyre dhe ajeti thotë: **“Janë ata që nuk besuan në argumentet e Zotit të tyre.”**. Ata nuk besojnë në argumentet që hapin sytë e veshët, nuk besojnë në argumentet që ngrenë perden e mendjemadhësisë e arrogancës dhe që konkretizojnë të vërtetat para njeriut. Ata nuk besojnë që ato janë argumente drite e ndriçimi, argumente që e nxjerrin njeriun prej errësirave të iluzioneve e përfytyrimeve të gabuara, ata nuk besojnë se ato janë argumente që e çojnë njeriun në botën e të vërtetave.

Veç kësaj, ata e harruan All’llahun dhe nuk besojnë as në Ringjalljen e as se do të takohen me All’llahun, ashtu siç njofton ajeti: **“...dhe takimin me Atë.”**.

Por, derisa besimi në Ringjalljen nuk qëndron përkrah besimit për fillimin e krijimit dhe derisa njeriu nuk ndien se ka një Fuqi që i kontrollon punët e tij dhe që i ruan të gjitha gjërat për kohën e gjykatës së madhe, asaj gjykate të hollësishme e të ashpër. Në këtë gjendje, jobesimtari as nuk do t’i kushtojë rëndësi punëve që bën dhe as nuk do të përmirësojë veten e tij.

Më pas, ajeti njofton se ata më të humburit, për shkak se nuk besojnë as në fillimin e krijimit e as në Ringjalljen, rrjedhojë e mosbesimit, edhe punët e tyre patjetër janë pa asnjë vlerë dhe janë punë të humbura: *“fehabitat a’ mālūhum”*- *“punët e tyre shkuan kot”*, domethënë se punët e tyre janë bërë si pluhuri përballë furtunës së fuqishme.

Ndodh kështu, sepse ata nuk zotërojnë asnjë punë të vlefshme, prandaj edhe Ne, njofton i Larti me fjalën e Tij: **“...dhe**

në Ditën e Gjykimit, atyre (punëve) nuk do t'u japim asnjë peshë."

Ndodh kështu sepse vlerësohen me peshore vetëm punët që ekzistojnë, kurse ata nuk kanë asgjë prej punëve që kanë bërë, prandaj punët e tyre nuk kanë as peshë e as vlerë. Në kuadrin e dënimit të punëhumburve, ajeti zbulon edhe shkakun e tretë të shmangies e të humbjes së tyre dhe njofton se shkakun për këtë humbje të madhe është tallja që ata i bënin argumenteve të zbritura prej All'llahut dhe ajeti njofton: **"Dënimi për ta është Xhehennemi për shkak se nuk besuan dhe u tallën me argumentet e me të Dërguarit e Mi."**

Me këtë veprim të tyre, ata shkuan deri në mohimin e tri bazave themelore të besimit fetar: fillimin e krijimit, Ringjalljen dhe Mesazhin e Profetëve, për më tepër, ata jo vetëm mohuan, por edhe u tallën me argumentet e All'llahut e me të Dërguarit e Tij.

Tani që u njohëm me shenjat e jobesimtarëve, si dhe të atyre që janë më të humburit me punët e tyre dhe, pasi u bë e qartë edhe përfundimi i punëve të tyre, ajetet i drejtohen besimtarëve dhe tregojnë përfundimin e tyre. Duke bërë krahasimin midis besimtarit e jobesimtarit, ne kemi mundësi të specifikojmë çdo palë në mënyrë të plotë dhe ajeti njofton: **"Kurse për ata që besuan dhe bënë punë të mira, vendprirja për ata do të jenë Xhennetet Firdeus."**

Interpretuesit më në zë të Kur'anit Famëlartë, në lidhje me fjalën e ajetit *"Firdeus"* në kuptimin *"lulishte"* kanë thënë se kjo fjalë përfshin të gjitha mirësitë e dhuntitë më të bukura. Me këtë kuptim fjala *"Firdeus"* tregon lulishten më të mirë e më të bukur të Xhennetit. Meqenëse mirësitë në Xhennet janë të plota e të

vazhdueshme dhe kurrë nuk do të zhduken, ajeti, menjëherë pa asnjë presje më tepër nga fjala pararendëse thotë: “*Khàlidine fihà*”, “**Aty do të jenë përgjithmonë.**”.

Pavarësisht se natyra e njeriut është ndërtuar mbi ndryshimin e shumëllojshmërinë, banorët e Xhennetit Firdeus nuk kërkojnë kurrë, as ndryshimin e vendit ku janë e as ndryshimin e gjendjes në të cilën ndodhen, ashtu siç njofton ajeti: “**dhe nuk do të kërkojnë që të largohen prej aty**”, sepse aty gjejnë e kanë çdo gjë që kërkojnë, madje aty kanë edhe shumëllojshmërinë e plotësimin, ashtu siç do të shpëgojmë në vijim.

Hulumtime

1- Cilët janë më të humburit në punët e tyre?

Në jetën tonë e në jetën e të tjerëve, vërejmë se njeriu kur merret me një punë të gabuar dhe kujton se ajo punë është e mirë, kjo injorancë nga ana e tij nuk vazhdon më shumë se një çast, ose vazhdon për njëfarë kohë, ose edhe për një vit, por nëse injoranca tek ai vazhdon gjatë gjithë jetës së tij, kjo është fatkeqësi dhe humbje fare e qartë.

Prandaj ne shikojmë se Kur’ani Famëllartë këta persona i ka cilësuar me fjalën “**më të humburit**”, sepse ai që bën një faj dhe e di që bëri faj, ai menjëherë vë një kufi aty ku është dhe fajin e kompenson me pendim (teube) e me punë të mirë. Ndërsa ata që

kujtojnë se fajet e tyre janë adhurim dhe se punët e këqija janë të mira, ose mendojnë se shmangiet e tyre janë rruga e drejtë, persona të këtyrë jo vetëm që nuk kanë mundësi të kompensojnë fajet e tyre, por vazhdojnë të thellohen në faje deri në fund, prandaj ata janë ashtu siç i përshkruan Kur'ani me frazën: **“më të humburit në punët e tyre”**. Në hadithet e në transmetimet islame kanë ardhur interpretime të shumta në lidhje me fjalën e ajetit **“më të humburit në punët e tyre”** dhe secili prej këtyre haditheve e transmetimeve e vë theksin mbi njërin prej vërtetuesve të qartë të këtij kuptimi të gjerë, pa e kufizuar në asnjë cak. Ja edhe transmetimi i ardhur prej Asbeg bin Nebàteh, i cili njofton se ka pyetur Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) për komentimin e këtij ajeti dhe Imami tha: “Janë mohuesit (jobesimtarët) prej ithtarëve të librave të përparshëm, jehuditë dhe kristianët, të cilët ishin në të vërtetën, por ata bënë sajesa në fetë e tyre dhe mendonin se po bëjnë punë të mirë”.¹

Në një transmetim tjetër të ardhur prej Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë fjalën e tij, pasi përmend përgjigjen e mësipërme tha: “Sa larg prej tyre janë njerëzit e lumit?”, domethënë khavàrixhët.²

Në një transmetim të tretë lexojmë se ai vë theksin veçanërisht te murgjit (burra e gra që kanë hequr dorë prej kësaj bote), si dhe grupet e myslimanëve që bënë sajesa.³

A nuk janë murgjit ata që e kalojnë gjithë jetën në ndonjë qoshe (për shembull, në manastir) dhe e privojnë veten nga të

¹ Referoju tefsirit “Nùruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 311-312.

² Burimi i mësipërm.

³ Burimi i mësipërm.

mirat e jetës, nuk martohen, nuk hanë ushqime të mira e nuk veshin rroba të mira, por parapëlqejnë të banojnë në manastir dhe, mbi të gjitha këto, mendojnë se kjo mënyrë jetese i afron ata pranë All'llahut. A nuk janë këto një vërtetim i qartë për **“më të humburit në punët e tyre”**.

A ka këtu ndonjë medh'heb, ose ndonjë fe Hyjnore që mund të bëjë thirrje në kundërshtim me ligjin e mendjes dhe me ligjin e krijimit, që t'i bëjë thirrje njeriut, kësaj qenieje shoqërore, të largohet prej jetës dhe të konsiderojë këtë punë burim për t'u afruar tek All'llahu i Lartësuar?

Ata që bënë sajesa në fenë e All'llahut të tipit të trinisë kundrejt besimit se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm (Teuhid), apo që e konsiderojnë Mesihun, të birin e Merjemit, “bir i Zotit” dhe që kanë futur në fenë e All'llahut shmangie të shumta, duke menduar se po bëjnë punë të mirë! A nuk janë këta dhe të ngjashmit me këta më të humburit e njerëzve?

Si përmbledhje, ajeti ka një kuptim shumë të gjerë dhe përfshin grupe të shumta njerëzish të kësaj kategorie që kanë jetuar në të kaluarën, jetojnë në të tashmen e do të jetojnë në të ardhmen.

Tani kemi arritur në pikën ku do të shtojmë pyetjen: “Cili është burimi për këtë shmangie kaq të madhe?”

Në të vërtetë, fanatizmi i fuqishëm, arroganca, mendjemadhësia dhe amaorpropi, të gjitha këto janë disa prej faktorëve që çojnë në të këtilla përfytyrime të gabuara. Disa herë miklimi, servilizmi, ose mbyllja në vetvete për një kohë të caktuar, është shkak për shfaqjen e kësaj gjendjeje, në të cilën njeriu

përfytyron se të gjitha punët e tij të gabuara janë të gjitha punë të bukura, punë me të cilat ai ndien krenari, mburret e tregohet deri arrogant, në vend që të turpërohej për punët e tij të këqija. Kur'ani Famëlartë, duke e përshkruar këtë lloj gjendjeje, në ajetin 8 të sures "Fàtir" thotë: **"Mos vallë atij që puna e keqe i është zbukuruar, ai e sheh atë të mirë?"**. Në ajete të tjera lexojmë se djalli është ai që zbukuron për njeriun punët e tij të këqija dhe bën që ato t'i duken atij punë të mira, madje djalli bën që ata të shpresojnë se me punët e tyre të këqija do të dalin mbi të tjerët dhe do të triumfojnë, ashtu siç thotë i Larti në fjalën e Tij në ajetin 48 të sures "El Enfâl": **"Kur djalli ua hijeshoi punët e tyre dhe u tha: Askush nuk u mposht ju sot, unë jam mbrojtës për ju."**

Gjithashtu Kur'ani në ajetin 37 të sures "Gàfir", pas tregimit në lidhje me kullën e njohur të Faraonit thotë: **"Kështu Faraonit iu duk e bukur puna e tij e keqe."** Ajeti shpjegon punën e Faraonit kur i kërkoi Hàmànit që t'i ndërtonte një kullë, që ai të ngjitej lart dhe sipas pretendimit të tij të rremë, të shikonte Zotin e Mùsàsë, ashtu siç thuhet në ajetet 36 dhe 37 të sures "Gàfir".

2- Çfarë do të thotë takimi me All'llahun?

Disa gjysmëdijetarë kanë përfituar prej shembujve të këtyre ajeteve dhe janë shprehur për mundësinë e shikimit të Krijuesit të Gjithëfuqishëm në Botën Tjetër dhe takimin me All'llahun e komentojnë takim me shqisa. Dihet se takimi me anë të shqisave kërkon që Krijuesi i Gjithëfuqishëm të marrë formën e një trupi, nga ana tjetër, trupëzim do të thotë kufizim të fuqisë dhe nevojës, mirëpo i kufizuari e nevojtori janë të asgjësueshëm, në një kohë

kur të gjithë e dinë dhe besojnë se këto cilësi nuk mund të thuhen për All'llahun e Lartësuar.

Prandaj qëllimi me takimin, ose me shikimin në ajetet kur'anore nuk është shikimi me shqisa, por shikimi i brendshëm moral.

Domethënë se njeriu në Ditën e Gjykimit do të shohë argumentet e Krijuesit shumë më mirë se në çdo kohë, prandaj ai e shikon Atë shumë qartë me syrin e zemrës së ndërgjegjësuar që shikon në thellësi. Në përputhje me ajetet kur'anore edhe njerëzit që e kanë mohuar Krijuesin me mënyrën më të ashpër e me mllefin më të madh, Ditën e Gjykimit do të shikojnë praninë e Krijuesit, dhe atëherë nuk do të ketë më vend për mohimin e Tij.¹

Disa interpretues të Kur'anit e kanë komentuar kuptimin e takimit me All'llahun, në mënyrën e shikimit të mirësive dhe shpërblimit, si dhe shikimit të dënimit dhe i ndëshkimit Hyjnor, duke shpjeguar se fjala *shpërblim* e *dënim* në ajetet e Kur'anit kanë ardhur në trajtën e shquar.

Megjithëse, këto dy komentime nuk kanë asnjë kontradiktë ndërmjet tyre, duhet thënë se komentimi i parë është shumë më i qartë.

¹ Mund të lexoni suren "El Mu'minune", në ajetin 106 e sipër.

3- Peshimi i punëve

Ne nuk kemi nevojë të komentojmë çështjen e peshimit të punëve me rrugën e mishërimit të fjalës dhe të themi se puna e njeriut atje do të trupëzohet dhe do të ketë peshë, për faktin se fjala “peshë” ka një kuptim shumë më të gjerë dhe përfshin të gjitha përmasat. Për shembull për njerëzit pa personalitet thuhet se ata persona nuk kanë peshë, ose janë të lehtë dhe me këtë shprehje kuptohet dobësia e personalitetit të tyre dhe jo fakti që peshon pak si trup.

Është shumë e bukur ajo që thotë ajeti për ata që janë më të humbur në punët e tyre kur njofton se Ditën e Kiametit Ne nuk do të vëmë në peshore për t'i peshuar ata. Por a është në kundërshtim ky ajet me fjalën e të Lartit në ajetin 8 të sures “E A’râr”, ku i Larti njofton: **“Pesha atë Ditë është e drejtë.”**.

Patjetër që është e drejtë, sepse pesha i takon atyre që kanë bërë punë të tilla që meritojnë të peshohen, kurse personi që punët e mendimet e të cilit nuk peshojnë as sa një fletë mushkonje, a ka nevojë një person i këtillë të peshohet?!

Në transmetimin mjaft të njohur të ardhur prej të Dërguarit më të madh (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexojmë: “Patjetër do të vijë burri i madh e i shëndoshë, por Ditën e Kiametit, ai nuk do të peshojë as sa një fletë mushkonje.”¹

¹ Marrë prej tefsirit “Mexhmaul Bejân”, në komentimin e ajetit.

Përse? Sepse punët e njerëzve të këtillë, mendimet dhe personaliteti i tyre në jetën e kësaj bote ishin pa asnjë vlerë e pa asnjë dobi.

Prej këtu bëhet e qartë se njerëzit atje do të jenë në disa kategori që janë:

a- Një grup do të jenë të rëndë për shkak se ishin besimtarë dhe për shkak të punëve të mira që kanë bërë, këta njerëz nuk është nevoja as të peshohen e as të merren në llogari, por do të hyjnë në Xhennet pa dhënë llogari.

b- Grupi i dytë janë ata që u kanë shkuar kot punët e tyre, ose ata që nuk kanë asnjë punë të mirë. Edhe këta nuk është e nevojshme të peshohen, por futen në zjarr pa dhënë fare llogari.

c- Grupi i tretë janë ata që kanë bërë punë të këqija, por kanë bërë edhe punë të mira; ata do të përfshihen në peshimin e në dhënien llogari. Shumica e njerëzve janë prej kësaj shtrese.

4- Komentimi i fjalës së të Lartit: “là jebgùne anhà hivelen” – “dhe nuk do të kërkojnë që të largohen prej aty”

Fjala e ajeteit “hivelen” do të thotë “ndryshim dhe ndërrim i vendit”, ashtu siç thamë në komentimin e ajetit, sepse në “Firdeusi”, që është njëra prej lulishteve të Xhennetit gjenden mirësitë më të bukura dhe të gjitha dhuntitë e All’llahut , prandaj Firdeusi konsiderohet vendi më i parapëlqyer në atë botë dhe për këtë shkak banorët e asaj lulishte kurrë nuk dëshirojnë të largohen prej aty dhe të shkojnë në ndonjë vend tjetër.

Disa mund të thonë se një jetë e këtillë atje mund të jetë rutinë dhe amulli. Në të vërtetë, një thënie e këtillë, në vetvete do të thotë se atje ka të meta dhe mangësi të mëdha!

Në përgjigje themi se nuk ka asnjë ndalim që ndryshimi i plotë të bëhet në të njëjtin vend, aty ku janë të gjitha shkaqet e plotësimit dhe që patjetër që aty janë të gjitha me bollëk, sipas punëve që ka bërë njeriu në këtë botë dhe, në sajë të dhuntive Hyjnore, ai do të vazhdojë në rrugën e plotësimit të vazhdueshëm e të përhershëm.

Dashtë All'Ilahu në fundin e komentimit të ajeteve objekt studimi do të bëjmë një komentim më të detajuar për plotësimin e njeriut deri në Xhennet.

5- Për cilin është Firdeusi?

Ne thamë se Firdeusi¹ është zona më e mirë e zonave të Xhennetit dhe se do të jetë vendbanim vetëm për besimtarët që kanë bërë punë të mira, atëherë pyetja do të jetë: “Kush do të banojë në zonat e tjera të Xhennetit, kur ai është vendbanim vetëm për besimtarët dhe jo për të tjerët”?

Në përgjigje të pyetjes themi: “Në Firdeus nuk do të banojë çdo besimtar që ka bërë punë të mira, por Firdeusi do të jetë për atë që besimi e puna e tij e mirë ka arritur në një gradë të lartë dhe

¹ Disa kanë thënë se fjala “*Firdeus*” në origjinë është marrë prej gjuhës së rumëve; të tjerë kanë thënë se rrënjët e fjalës “*Firdeus*” janë në gjuhën abisinase, dhe pastaj kjo fjalë është mbartur në gjuhën araba. (Tefsiri i Fihri Rrëziut dhe tefsiri “*Mexhmaul Bejan*”).

është kjo gradë e lartë kriteri për të arritur Firdeusin për të gjithë individët, në të njëjtën kohë është një argument që vërteton se banorët e Firdeusit përveç dy kushteve: besimit dhe punës së mirë, kanë edhe cilësi të dalluara”.

Këtu qëndron edhe shkakun që ne pamë se i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) na mëson në hadithin e mësipërm se kur të kërkojmë Xhennetin, kemi detyrë të lutemi veçanërisht që të arrijmë Firdeusin, sepse Firdeusi është vendi më i plotësuar e më i mirë i Xhennetit.

Gjithashtu kjo tregon se është domosdoshmëri që besimtari në të gjitha punët të veprojë deri në shkallën më të lartë, madje edhe në Xhennet, domethënë se besimtari të mos kënaqet me etapat e punës së tij në këtë botë, pavarësisht nga mirësitë e dhuntitë që janë në këto etapa.

Është e natyrshme se ai që kërkon këtë pozitë prej All’llahut të Lartësuar, patjetër duhet ta ketë përgatitur veten e tij për të merituar atë që kërkon, prandaj ai ka detyrë të bëjë gjithçka që ka mundësi të bëjë që të fitojë cilësitë më të mira dhe të bëjë punët me të cilat fitohet më shumë kënaqësia e All’llahut.

Nga këto që u thanë, ne mësojmë se kushdo që thotë se e rëndësishme është hyrja në Xhennet, qoftë edhe në vendin më të ulët të Xhennetit, është person që kërkon të shuajë vullnetin e lartë te besimtarët e vërtetë.

Ajetet 109 - 110

قُلْ لَوْ كَانَ الْبَحْرُ مِدَادًا لِّكَلِمَتِ رَبِّي لَنَفِدَ الْبَحْرُ قَبْلَ أَنْ تَنفَدَ كَلِمَتُ
 رَبِّي وَلَوْ جِئْنَا بِمِثْلِهِ مَدَدًا ﴿١٠٩﴾ قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ يُوحَىٰ إِلَيَّ أَنَّمَا
 إِلَهُكُمْ إِلَهٌ وَاحِدٌ ۖ فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا
 يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ ۚ أَحَدًا ﴿١١٠﴾

“Thuaj: Sikur deti të ishte bojë për të shkruar fjalët e Zotit tim, deti do të thahej para se të mbaronin fjalët (kuptimet e fjalëve) e Zotit tim edhe sikur të sillnim një det tjetër si ai.”

“Thuaj: Unë jam vetëm njeri ashtu si ju; mua më shpallet se Zoti juaj është Një Zot i Vetëm dhe kush shpreson të takohet me Zotin e vet le të bëjë punë të mirë dhe në adhurimin kushtuar Zotit të tij të mos i bëjë Atij ortak e shok asnjë tjetër.”

Shkaku i zbritjes

Transmetohet prej Ibni Ab'bàsit se ai ka thënë se kur jehuditë e pyetën Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në lidhje me ajetin 85 të sures "El Isrà": **"u është dhënë fare pak dituri"** dhe i thanë: "Si është kështu, kur ne na është dhënë Teuràti dhe atyre që u është dhënë Teuràti i është dhënë mirësi e madhe? Menjëherë zbriti fjala e të Lartit: **"Thuaj sikur deti të ishte bojë për të shkruar fjalët e Zotit tim, deti do të thahej."**

Gjithashtu tregohet se jehuditë thanë: "Ty të është dhënë urtësia dhe atij që i është dhënë urtësia i janë dhënë mirësi të shumta, por ti vazhdon të thuash – bashkëbiseduesi këtu është i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se nuk ke dijeni për shpirtin? All'llahu i Lartësuar e urdhëroi që t'i përgjigjej atyre me këto fjalë: "Edhe pse mua më është dhënë Kur'ani dhe ju u është dhënë Teuràti, këto në raport me fjalët e All'llahut të Lartësuar janë fare pak".¹

¹ Tefsiri i "Kurtubij'jit", vëll. 6, f. 107-108; gjithashtu edhe tefsiri "Es'sâfij", fundi i ajetit në fjalë.

Komentimi

Ata që shpresojnë takimin me All'llahun

Në ajetet e mësipërme ka edhe një studim të pavarur, por që është i lidhur me studimet e kësaj sureje, në atë mënyrë që secili prej tri tregimeve të ardhura në këtë sure, ngre perden e një subjekti të ri e të çuditshëm, sikur Kur'ani ka qëllim të thotë me këto ajete se informacioni që merret prej tregimit të banorëve të shpellës, prej tregimit të takimit të Mūsàsë me Hidrin dhe prej tregimit për Dhulkarnejnin, nuk konsiderohen asgjë kundrejt ditorisë së pakufizuar të All'llahut, sepse ditoria e të Gjithëpushtetshmit dhe njohuritë e Tij përfshijnë të gjitha qeniet që gjenden në gjithësi, ato që ishin në të kaluarën, ato janë tani dhe ato që do të jenë në të ardhmen.

Kur'ani Famëlartë i flet drejtpërdrejt të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qysh në fillim të ajetit dhe e urdhëron të thotë: **“Thua: Sikur deti të ishte bojë për të shkruar fjalët e Zotit tim, deti do të thahej para se të mbaronin fjalët (kuptimet e fjalëve) e Zotit tim, edhe sikur të sillnim edhe një det tjetër si ai.”**.

Fjala e ajetit *“midàden”* do të thotë *“bojë shkrimi”*, ngjyra që përdoret për të shkruar librat. Kjo fjalë në origjinën e saj është marrë prej fjalës *“med'd”* që do të thotë *“tërheqje”*, domethënë se

vijat e rreshtat e shkrimit bëhen të qarta në saje të tërheqjes së lapsit.¹

Edhe fjala e ajetit “*kelimât*” është shumë e fjalës “*kelimetun*”, që në origjinën e saj ka kuptimin e fjalës me të cilën realizohet bisedimi, thënë ndryshe, fjalë që ka një kuptim; por çdo gjë që gjendet në botën e gjithësisë është një argument që vërteton diturinë dhe fuqinë e Krijuesit, prandaj fjala “*kelimetun*”, ndonjëherë, përdoret si emër për çdo qenie dhe thuhet “*kelimetull’llàh*” – “*fjalë e All’llahut*” por duhet theksuar se kjo fjalë përdoret në mënyrë të veçantë për qeniet shumë të rëndësishme e të mëdha.

Për sa i përket Mesihut, Isasë të birit të Merjemes (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!*) Kur’ani Famëlartë thotë: **“Në të vërtetë Mesihu, Isai i biri i Merjemes ishte një i dërguar i All’llahut, ishte një fjalë e Tij (bëhu) që Ai i drejtoi asaj (Merjemes).”**²

Në ajetin tonë objekt studimi fjala “*kelimetun*” është përdorur në këtë kuptim, do të thotë se secila prej qenieve që janë në gjithësi tregon cilësi të ndryshme të All’llahut të Gjithëpushtetshëm.

Në të vërtetë Kur’ani Famëlartë me këtë ajet tërheq vëmendjen tonë ndaj së vërtetës së madhe: “Mos mendoni se bota e ekzistencës është e kufizuar në ato që ju shikoni dhe në ato që

¹ Fahrru Rraziu në lidhje me kuptimin e fjalës së ajetit “*midàden*” e ka shpjeguar në kuptimin e vajit që vihet në kandilat dhe që është shkak i dritës, por të dyja kuptimet e kësaj fjale kanë një kuptim të vetëm.

² Sure “En Nisà”, ajeti 171.

dini e në ato që i kapni me anë të shqisave, jo, ajo është aq e gjerë e aq e madhe sa edhe sikur detet të bëheshin bojë shkrimi dhe me atë bojë të shkruheshin cilësitë e veçantitë e qenieve të gjithësisë, detet do të thaheshin para se të numëroheshin të gjitha qeniet e botës së ekzistencës”.

Këtu është e domosdoshme të tërheqim vëmendjen se fjala “det” shpreh llojin, gjithashtu edhe fjala tjetër e ajetit “*mithlehu*” – “*të ngjashëm me të*”, përsëri shpreh detin, ashtu siç ka ardhur në fjalën e të Lartit: “*ue leu xhi’nà bimithlihi mededen*” - **“Edhe sikur të sillnim një det tjetër si ai.”**. Me këtë fjalë, siç thamë më sipër, përsëri qëllimi është lloji, domethënë: sado që ne të shtojmë të ngjashëm me këto dete, përsëri fjalët e All’llahut nuk përfundojnë e nuk mbarohen.

Për këtë shkak nuk ka asnjë kontradiktë në mes këtij ajeti dhe në mes ajetit 27 të sures “Lukmàn”: **“Sikur të gjithë drunjtë në tokë të jenë lapsa dhe sikur detit t’i shtohen edhe shtatë dete (që të ishin bojë shkrimi), fjalët e All’llahut nuk do të mbaronin”**, domethënë se ata lapsa do të thyheshin duke shkruar dhe detet do të thaheshin deri në pikën e fundit, megjithëkëtë, sekretet e krijesave dhe të vërtetat e botës së ekzistencës nuk do të mbaronin.

Këtu duhet të tërheqim vëmendjen se ajeti objekt studimi, në të njëjtën kohë që konkretizon gjerësinë e botës së ekzistencës pa anë e pa fund me ato që ishin në të kaluarën, me ato që janë në kohën e sotme dhe me ato që do të jenë në të ardhmen, shpjegon qartë se dituria absolute e Krijuesit nuk ka anë e cak. Në një kohë kur ne dimë se dituria e Krijuesit të Gjithëpushtetshëm përfshin gjithçka që ka qenë, gjithçka që është e gjithçka që do të jetë në të

ardhmen në botën e ekzistencës dhe në të njëjtën kohë dituria e All'llahut të Lartësuar konsiderohet dituri aktuale e pandarë prej qenieve të botës së ekzistencës. (Mendo mirë në këtë çështje.)

Atëherë ne mund të themi: “Sikur të gjithë oqeanet e detet e globit të shndërroheshin në bojë shkrimi dhe sikur të gjithë drunjtë e botës të bëheshin lapsa, të gjitha këto nuk do të mjaftonin për të përshkruar qeniet që gjenden në botën e Krijuesit të Gjithëpushtetshëm”.

Sqarimi i konceptit të pafundësisë

Kur’ani Famëlartë e konkretizon numrin pafund dhe e afron kuptimin e diturisë absolute të All'llahut të Lartësuar, afron gjerësinë e madhe të botës së ekzistencës pranë mendimeve tona dhe për këtë Kur’ani përdor një shpjegim shumë të lartë, duke përmendur numra të gjallë me shpirt.

Vallë ka numra të gjallë dhe numra të vdekur?

Po, në matematikë, nëse para një numri shtojmë disa zero, realisht ky numër shpreh vetëm numra të vdekur që nuk kanë mundësi të konkretizojnë madhësinë e një sendi të caktuar.

Ata që janë të interesuar për çështje të matematikës e të llogarisë, dinë se një numri të vetëm, për shembull numrit 1, sikur nga e djathta e këtij njëshi të vihen një varg zerosh me gjatësi një kilometër, do të rezultonte një numër shumë i madh që trazon mendjen, madje as që është e mundur të përfytyrohet sa i madh është si numër. Porse për cilin? Ky numër i madh është për

matematikantë dhe jo për masën e njerëzve, të cilët e kanë të pamundur të përfytyrojnë madhësinë e këtij numri.

Numri i gjallë është numri të cilin mendjet tona e kapin si numër, është ai numër që konkretizon të vërtetat, ashtu siç ato janë, pra është numër që ka shpirt, që ka gjuhë të flasë dhe që shpreh një madhësi.

Prandaj edhe Kur'ani Famëllartë në vend që të thotë se krijesat në botën e ekzistencës në tërësinë e vet tejkalojnë edhe numrin nga e djathta e të cilit janë vënë qindra kilometra zerosh, Kur'ani thotë: *“Sikur të gjithë drunjtë të bëheshin lapsa dhe sikur të gjitha detet të shndërroheshin në bojë shkrimi, padyshim që lapsat do të thyheshin duke shkruar dhe uji i deteve do të mbarohej, por nuk do të përfundonin sekretet, simbolet dhe të vërtetat e botës së ekzistencës, sepse këto sekrete janë të përfshira në diturinë e All'llahut të Lartësuar”*.

Mendoni mirë dhe mundohuni të kuptoni sa fjalë mund të shkruajë një laps, dhe pastaj mendoni përsëri sa lapsa mund të prodhohen vetëm prej një dege peme të çfarëdoshme?

Dihet se ne kemi mundësi të prodhojmë mijëra e miliona lapsa prej një peme të madhe, gjithashtu ne mund të përfytyrojmë sasinë e lapsave që mund të prodhojmë me të gjitha drunjtë e pyjet e botës!

Nga ana tjetër ne mund të përfytyrojmë numrin e fjalëve që mund të shkruhen vetëm me një pikë bojë shkrimi, por sikur të përfytyrojmë sa fjalë do të shkruhen me ujin e një pellgu të shndërruar në bojë shkrimi dhe kështu me radhë me bojën e një deti, me bojën e një oqeani dhe pastaj me bojën e të gjithë detarëve e oqeanëve të botës!

Rezultati pa dyshim do të dalë një numër i çuditshëm e fantastik!

Shembulli kur'ânor bëhet fare i qartë kur ne dimë se numri shtatë nuk është për të kufizuar, por për të treguar shumicën, atëherë kuptimi i kësaj fjale do të ishte: edhe sikur ne të shtojmë mbi një det disa dete të tjera, përsëri fjalët e All'llahut nuk do të mbarojnë.

Tani le të përfytyrojmë gjallërinë dhe shpirtin tejet të madh të shprehur në këtë numër, do të përfytyronim atë dëshmues të gjallë që ngjallë zgjimin në shpirtin e njeriut, që shqetëson mendjen e tij dhe e bën njeriun të mendojë në horizontet e pafundësisë!

Numri që përmban shembulli kur'ânor e ndiejnë në mënyrë të barabartë të gjithë, matematikanë e analfabetë.

Po, padyshim që dituria e All'llahut është më e lartë dhe më e gjerë se ky numër.

Dituri e pakufizuar, dituri pa anë e pa fund.

Dituri që përfshin të gjithë ekzistencën, në të kaluarën, në ditët e sotme dhe në të ardhmen, dituri që në brendësi të saj janë të gjitha sekretet dhe të gjitha të vërtetat.

Ajeti i dytë në këtë studim, që është edhe ajeti i fundit i sures "El Kehf", shpreh një grup bazash të besimit e të fesë, baza që kanë si bosht qendror Njësimin e All'llahut (besimin se All'llahu është Zoti Një e i vetëm), Ringjalljen dhe Mesazhin e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Përmbajtja e këtij ajeti tregon se është e njëjtë me

përmbajtjen e ajetit të parë të kësaj sureje të bekuar. Në fillim të sures flitet për All'llahun, Revelatën, shpërblimin, dënimin dhe për Ditën e Kiametit, gjithashtu edhe ajeti i fundit është një përmbledhje për sa ka ardhur në këtë sure, e cila në një pjesë të rëndësishme të saj përfshin tri bazat e lartpërmendura duke i konsideruar ato boshte rreth të cilave vërtitet kuptimi i sures.

Në fakt, çështja e profetësisë është vënë karshi formave të ekstremizmit gjatë gjithë historisë, prandaj edhe ajeti thotë: **“Thuaj: Unë jam njeri ashtu si ju; mua më shpallet...”**.

Kjo shprehje kur'anore hedh në erë të gjitha privilegjet që shoqërojnë politeizmin (shirkun), i cili i nxjerrë Profetët prej cilësisë njerëzore dhe i vesh me cilësi Hyjnore.

Më pas, ajeti nga tërësia e çështjeve të Revelatës Hyjnore e vë theksin mbi çështjen e Njësimit të All'llahut (Teuhidit) dhe thotë: **“...se Zoti juaj është një Zot i vetëm.”**.

Përse theksohet kjo çështje? Sepse Njësimi i All'llahut (Teuhidi) është esenca e të gjitha besimeve, është qëllimi më i lartë i të gjithë programeve individuale e shoqërore që sjellin lumturinë për njeriun.

Më sipër kemi theksuar se Njësimi i All'llahut (Teuhidi), jo vetëm që është njëri prej bazave të fesë, por në të vërtetë është esenca për të gjitha bazat dhe degët e dispozitave të Islamit.

Për shembull, sikur ne të duam të ngjasojmë mësimet islame - të bazave e të degëve - dhe të themi se ato janë copa prej diamantesh, këtu kemi mundësi të themi se Njësimi i All'llahut, Teuhidi (besimi se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm), është peri

që lidh të gjitha këto copa njëra me tjetrën për të formuar prej kësaj tërësie një gjerdan të bukur e shumë të çmuar.

Kur ne duam të ngjasojmë mësimet islame - të bazave e të degëve - me gjymtyrët e trupit, patjetër që Njësimi i All'llahut (Teuhidi) do të jetë shpirti i njeriut dhe prej këtij shpirti jeta troket në të gjitha gjymtyrët.

Në studimet tona rreth Ringjalljes e profetësisë kemi vërtetuar se këto dy baza janë të ndara prej Njësimit të All'llahut, domethënë, kur ne njohim Krijuesin me të gjitha cilësitë e Tij të larta, në të vërtetë ne mësojmë se një Krijues i këtillë patjetër do të dërgojë Profetë, gjithashtu do të mësojmë se urtësia e Tij kërkon që të ketë një gjykatë të drejtë dhe se për këtë patjetër do të ketë Ringjallje.

Gjithashtu kemi vërtetuar se problemet shoqërore, e gjithë shoqëria njerëzore dhe gjithçka që ka lidhje me shoqërinë njerëzore, për të gjitha këto patjetër duhet të ndriçojë pishtari i Njësimit të All'llahut (besimi se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm) dhe rreth këtij pishtari njerëzit të bashkohen, të sistemohen dhe të vendosin.

Këtë të vërtetë ne e lexojmë në një hadithi kudsij ku thuhet: fjala "*lâ ilâhe il'lell'illâh*" - "*nuk ka Zot tjetër përveç All'llahut*", është kështjella Ime dhe kush hyn në kështjellën Time, ai është i siguruar prej dënimit Tim".

Të gjithë ne kemi dëgjuar se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në fillimet e Islamit ka thënë: thuani "*lâ ilâhe il'lell'illâh*" - "*nuk ka Zot tjetër përveç All'llahut*", që të shpëtoni".

Megjithëse takimi me All'llahun në kuptimin e shikimit të brendshëm dhe pamja e Qenies së shenjtëruar më syrin e zemrës, në raport me besimtarët e vërtetë, është e mundshme edhe në këtë botë, por kjo çështje Ditën e Kiametit fiton një dimension të përgjithshëm për shkak të shikimit të shenjave të mëdha, të qarta e të hapura të Krijuesit të Gjithëpushtetshëm, prandaj edhe Kur'ani e ka përdorur këtë shprehje si një veçanti e Ditës së Kiametit.

Nga një anë tjetër, njeriu që mendon për një punë të caktuar dhe prej asaj pune ai shpreson diçka, është e natyrshme që ai të përgatisë veten e tij dhe vetëm pas kësaj përgatitje ai pret të ketë atë që shpreson, kurse personi që vetëm pretendon dhe nuk bën asnjë përgatitje, personi që rri në pritje dhe nuk punon, në realitet ai nuk është gjë tjetër veçse një pretendues gënjeshtar.

Ky është edhe shkakun që ajeti i mësipërm thotë: *"felja'mel amelen sàlihan"* - **"le të bëjë punë të mirë"**. Siç shihet në këtë ajat folja ka ardhur në mënyrën urdhërore **"le të bëjë"** që do të thotë se puna e mirë është për shkak të shpresës e dëshirës për të takuar All'llahun.

Në fjalinë e fundit, vjen me një frazë të shkurtër edhe sqarimi për punën e mirë në fjalën e të Lartit: **"...dhe në adhurimin kushtuar Zotit të tij të mos i bëjë Atij ortak e shok asnjë tjetër."**

Me fjalë të tjera, puna nuk mund të jetë e mirë përderisa në atë punë nuk rrezaton e vërteta e sigurtë e Njësimit të All'llahut.

Qëllimi Hyjnor i jep punës së njeriut një thellësi rrezatuese të veçantë dhe e orienton atë në kahen më të drejtë dhe, kur humb përkushtimi i sigurtë, atëherë puna do të ketë një anë të jashtme

që tregon dobi të veçanta, por ajo punë ka humbur thellësinë e origjinalitetin e saj nga ana e vlefshmërisë.

Në të vërtetë puna e mirë që buron prej qëllimeve Hyjnore dhe e shoqëruar me përkushtim të sinqertë e në bashkëveprim me të, kjo punë është një dëftesë që mundëson takimin me All'Ilahun e Lartësuar.

Më sipër kemi theksuar se puna e mirë përfshin një kuptim shumë të gjerë, përfshin programe dobisjellëse e konstruktive, programe individuale e shoqërore për çdo problem prej problemeve të jetës.

Sinqeriteti ose shpirti i punës së mirë

Nijeti zë një vend të veçantë në transmetimet islame, por edhe Islami e ka kushtëzuar pranimin e punës bazuar në nijetin e në qëllimin që synohet të arrihet me punën e bërë.

Hadithi mjaft i njohur i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) njofton se ai ka thënë: “Nuk ka punë pa nijet”, domethënë se puna vlerësohet sipas nijetit. Hadithi e thotë shumë qartë këtë të vërtetë.

Pas nijetit menjëherë vjen sinqeriteti. Sikur të bëjmë së bashku nijetin edhe sinqeritetin, atëherë puna do të jetë shumë e vlefshme, kurse puna pa sinqeritet, është një punë pa asnjë vlerë; nga ana tjetër sinqeritet do të thotë që shtytësit për një punë te njeriu të jenë pa asnjë ferrë e pa asnjë gjemb, pasi vetëm kështu mund të quhet sinqeriteti “Njësimi i nijetit” (Teuhidu-n’nij’jeti), që

do të thotë: puna është bërë duke pasur mendjen vetëm te All'llahu dhe që të fitohet kënaqësia e Tij në të gjitha gjendjet.

Është shumë domethënëse në këtë çështje edhe transmetimi i ardhur për shkakun e zbritjes së këtij ajeti dhe ku tregohet se një burrë erdhi te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i cili i tha: “Unë jap sadaka, mbaj lidhje me të afërmit dhe këtë e bëj vetëm për hir të All'llahut”. Ai e përmend këtë dhe unë e falënderoj, sepse kjo më gëzon, madje jam i mahnitur më këtë. I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) heshti e nuk tha asnjë fjalë, ndërkaq zbriti ajeti: **“Kush shpreson të takohet me Zotin e vet le të bëjë punë të mirë dhe në adhurimin kushtuar Zotit të tij të mos i bëjë Atij ortak e shok asnjë tjetër.”**¹

Qëllimi me këtë transmetim, nuk është kënaqësia e gëzimi i pavullnetshëm, por është gjendja në të cilën kënaqësia e gëzimi janë qëllim për punën e njeriut, njëkohësisht ajeti tregon se gëzimi i pavullnetshëm çon në mungesën e sinqeritetit në nijetin.

Në Islam puna e sinqertë konsiderohet punë shumë e rëndësishme, madje aq e rëndësishme sa i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush është i përkushtuar me sinqeritet për hir të All'llahut dyzet ditë, All'llahu bën që prej zemrës e prej gjuhës së tij të shpërthejnë burimet e urtësisë.”.

¹ Referoju “Mexhmaul Bejân”, në komentimin e ajetit në fjalë, si dhe në tefsirin e “Kurtubij’jit”.

Lutja mbyllëse

O Zoti im, bëji nijetet tona të singerta në të gjitha punët tona, në atë mënyrë që të mos kemi në mendje asnjë tjetër përveç Teje dhe të mos nxitojmë të shkojmë tek asnjë tjetër përveçse te Ti. Atë që ne duam e ata që nuk duam bëji të jenë në ndjekje të bindjes sonë ndaj madhërisë Sate dhe bëj që të fitojmë kënaqësinë Tënde. AMIJJN JA RAB" BEL ÀLEMIJJN – Pranoje lutjen tonë o Zot i botëve.

Fundi i sures "El Kehf"

Sure “Merjem”

Sure “Merjem” është surja e 19-të e renditur në Kur'anin Kerim, e cila ka 98 ajete dhe ka zbritur në Mekë.

Përmbajtja e sures “Merjem”

Kjo sure, përmban disa pika të rëndësishme, të cilat po i listojmë më poshtë:

1- Pjesa më e rëndësishme e kësaj sureje, është e kaluara e njerëzve të përzgjedhur të Zotit, si: Zekerijas, Merjemes, Profetit Isa, Jahja, Ibrahim, Ismail, Idris dhe e disa Profetëve të tjerë (*Paqja qoftë mbi ta!*). Secili me veti të veçanta edukative.

2- Pjesë tjetër e rëndësishme e kësaj sureje, është çështja e Ditës së Ringjalljes dhe mënyra se si njerëzit do të ringjallen, si do të dënohen keqbehësit dhe si do të shpërblehen punëmirët.

3- Në një pjesë të kësaj sureje do të ketë këshilla të ndryshme plotësuese.

4- Ajetet e fundit të Kur’anit mohojnë se Zoti ka fëmijë; tregojnë se çështja e ndërmjetësimit (shefaet) është një program edukativ dhe ndikon që njeriu të ketë besim të pastër te Zoti dhe të jetë i devotshëm.

Mirësitë e leximit të sures

Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kushdo që e lexon këtë sure, Zoti do t’i japë nga dhjetë mirësi, me numrin e atyre që kanë besuar dhe kanë

përgënjeshtroar Zekerian, Jahjan, Merjemen, Isain, Musain, Harunin, Ibrahimin, Ismailin, Is'hakun dhe Jakubin (Paqja qoftë mbi ta!).”¹

Në të vërtetë, ky hadith fton për të bërë përpjekje në dy drejtime të ndryshme: në atë të mbështetjes së Profetëve dhe në atë të luftimit me politeistët dhe me të devijuarit. Ne e dimë shumë mirë, se të gjitha këto shpërblime nuk janë vetëm që ne të lexojmë fjalët, por duhet t'i lexojmë dhe duhet t'i zbatojmë ato.

Kështu, në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: “Ai që e lexon (a këndon) vazhdimisht suren ‘Merjem’, nuk do të shkojë nga kjo botë pa i dhënë Zoti të gjitha të mirat, atij dhe fëmijëve të tij.”²

Sigurisht, këto mirësi dhe shpërblime janë për atë që e zbaton këtë sure, për atë që reflekton në të, për atë që flet dhe vepron sipas porosive të saj.

¹ “Mexhmaul Bejan”, fillimi i sures “Merjem”.

² “Mexhmaul Bejan”, fillimi i sures “Merjem”.

Ajetet 1 - 6

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

كَهَيَّعَ ۝ ذَكَرُ رَحْمَتِ رَبِّكَ عَبْدَهُ زَكِرِيَّا ۝ إِذْ نَادَىٰ رَبَّهُ
نِدَاءً خَفِيًّا ۝ قَالَ رَبِّ إِنِّي وَهَنَ الْعَظْمُ مِنِّي وَاشْتَعَلَ الرَّأْسُ شَيْبًا وَلَمْ
أَكُنْ بِدُعَائِكَ رَبِّ شَقِيًّا ۝ وَإِنِّي خِفْتُ الْمَوَالِيَ مِنْ وَرَائِي
وَكَانَتِ امْرَأَتِي عَاقِرًا فَهَبْ لِي مِنْ لَدُنْكَ وَلِيًّا ۝ يَرِثُنِي وَيَرِثُ مِنْ
ءَالِ يَعْقُوبَ ۖ وَأَجْعَلْهُ رَبِّ رَضِيًّا ۝

“Kâf, Hâ, Jâ, Ajn, Sâd.”

“Ky është rrëfim për mëshirën e Zotit tënd ndaj robit të Tij - Zekerijas.”

“Kur ai e thirri Zotin e vet me lutje të fshehtë”,

“(duke thënë): ‘O Zoti im! Eshtrat tashmë më janë dobësuar, koka më ndriçon nga thinjat dhe asnjëherë nuk kam mbetur i zhgënjyer nga lutja ime për Ty, o Zoti im!’”

“Unë u frikësohem (sjelljeve të) të afërmve të mi pas meje, ndërsa bashkëshortja ime është beronjë; andaj, më dhuro nga ana Jote një pasardhës”,

“që të më trashëgojë mua dhe familjen e Jakubit. O Zoti im, bëje atë të pëlqyeshëm (për Ty)!”

Komentimi

Lutja bindëse e Zekerijas (Paqja qoftë mbi të!)

Edhe në këtë sure, si në disa sure të tjera të Kur'anit, jemi ndeshur me “shkronjat e ndërprera”: **Kâf, Hâ, Jâ, Ajn, Sâd.**

Edhe më parë, si: në fillim të sures “El Bekare”, në fillim të sures “Ali Imran” dhe në suren “El A’raf”, kemi bërë komentimin e hollësishëm të këtyre germave. Kështu që nuk është e nevojshme që edhe në këtë sure të përsërisim të njëjtën gjë. Është e rëndësishme të shtojmë këtu, se “shkronjat e ndërprera” të kësaj sureje ndahen në dy kategori, përse u përket haditheve nga burimet islame:

Së pari, është hadithi ku thuhet se çdonjëra prej këtyre shkronjave i referohet njërit prej emrave të All’llahut të Lartësuar (esmaul husna).

Kâf, i referohet emrit të lartësuar **“Kafij”**, që do të thotë: **“i Mjaftueshëm”**.

Hâ, i referohet emrit të lartësuar **“Hadij”**, që do të thotë: **“Udhëzues”**.

Jâ, i referohet emrit të lartësuar **“Uelijj”**, që do të thotë: **“Kujdestar”**.

Ajn, i referohet emrit të lartësuar **“Alimu”**, që do të thotë: **“i Ditur”**.

Ndërsa shkronja **Sád**, i referohet emrit të lartësuar **“Sadikel ue`di”**, që do të thotë: **“i Drejti në premtim”**.¹

Së dyti, është hadithi në të cilin thuhet se këto shkronja të ndërprera i referohen historisë së revolucionit të nipit të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*): **Kâf**, i referohet **“Kerbelasë”**.

Hâ, i referohet **“Helalk”**, që do të thotë: **“shkatërrimi i familjes së Profetit** (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)”,

Jâ, i referohet **“Jezidit”**.

Ajn, i referohet **“Atesh”**, që do të thotë: **“etje”**.

Shkronja **Sád**, i referohet fjalës **“Sabër”**, që do të thotë: **“durimi dhe qëndrueshmëria”** që kishte Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe shokët e tij.²

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 320.

² Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 320.

Ashtu siç thamë, ajetet e Kur'anit kanë kuptime të ndryshme. Ndonjëherë shpjegojnë kuptime, si nga e kaluara, ashtu edhe nga e ardhmja, në të njëjtën kohë nuk kanë asnjë lloj ndryshueshmërie me njëra-tjetrën. Nëse kuptimin e tyre do e kufizonim në një interpretim, mund të hasim probleme, përse i përket mënyrës dhe kohës së zbritjes së ajetit.

Pas citimit të shkronjave të ndara, nis fjalimi i parë me Profetin Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*), si ka rrjedhur jeta e tij.

All'illahu thotë: **“Ky është rrëfim¹ për mëshirën e Zotit tënd ndaj robit të Tij – Zekerijas.”**

Kur ishte shumë i mërzhitur dhe i trishtuar, sepse nuk kishte fëmijë, Zekerija iu drejtua All'illahut. Duke qenë i vetëm, iu lut me zë të butë e të ulët Zotit.

“Kur ai e thirri Zotin e vet me lutje të fshehtë.”, Zekerija tha: **“O Zoti im! Eshtrat tashmë më janë dobësuar, koka më ndriçon nga thinjat dhe asnjëherë nuk kam mbetur i zhgënjyer nga lutja ime për Ty, o Zoti im!”**.

Zekerija bën një krahasim të çuditshëm për mënyrën e plakjes së njeriut. Thinjat e flokëve i krahason me flakën, duke thënë, se, ashtu si flaka përhapet shpejt, edhe thinja përhapet shpejt dhe merr përpara gjithçka ka për rreth.

Nga ana tjetër, flaka e zjarrit ka një shkëlqim të veçantë, që të tërheq vëmendjen nga larg. Kur një vend përfshihet nga zjarri, ajo çka mbetet, është vetëm hiri i tij.

¹ Në të vërtetë, fjala “*dhikr*” është “*lajm*”, për kryefjalën e hequr, që mund të ishte “*Hadha dhikrun Rahmeti Rabbik*”.

Zekerija, pleqërinë e tij dhe thinjat e flokëve, i krahason me flakët e zjarrit dhe me shkëlqimin që ka ky zjarr. Ky krahasim është shumë shprehës dhe i bukur.

Më tej shton se prej lutjeve që ka bërë, asnjëherë nuk ka mbetur duarbosh.

“(duke thënë): ‘O Zoti im! Eshtrat tashmë më janë dobësuar, koka më ndriçon nga thinjat dhe asnjëherë nuk kam mbetur i zhgënjyer nga lutja ime për Ty, o Zoti im!’”.

Ti gjithmonë i ke plotësuar lutjet e mia dhe nuk më ke braktisur kurrë. Tashmë që jam plakur dhe jam i pamundur, do të ishte mirë që të ma pranoje lutjen dhe të mos më ktheje të pashpresë.

Fjala *“shekauet”*, ka kuptimin *“lodhje”* dhe *“vuajtje”*, që do të thotë se unë nuk i kam marrë me lodhje dhe mundim kërkesat dhe lutjet që të kam bërë ty, o All’llah, sepse ato pranoheshin shumë shpejt nga Ti.

Më tej, nevojën e tij e zbërthen në këtë mënyrë: Zoti im! I frikësohem të afërmve të mi (ka mundësi që të bëhen të korruptuar dhe të vënë dorë në punë të liga), bashkëshortja ime është sterile, më fal nga ana Jote një fëmijë dhe një zëvendës.

“Unë u frikësohem (sjelljeve të) të afërmve të mi pas meje,¹ ndërsa bashkëshortja ime është beronjë; andaj, më dhuro nga ana Jote një pasardhës.” .

¹ Zekerija kishte frikë se, pas vdekjes së tij, adhurimi i All’llahut nuk do të kryhej në mënyrën e duhur. Ai nuk kishte një bir që ta trashëgonte funksionin e

Zekerija i lutet Zotit që t'i falë një zëvendës, i cili të trashëgojë prej tij, të jetë trashëgimtar i familjes së Jakubit dhe të jetë i pëlqyer prej Zotit.

"Të më trashëgojë mua dhe familjen e Jakubit. O Zoti im, bëje atë të pëlqyeshëm (për Ty)!"

Hulumtime

1- Cili është qëllimi i përdorimit të fjalës "irth" - "trashëgimi", në këtë rast?

Komentuesit myslimanë kanë mendime të ndryshme për këtë pyetje. Një grup besojnë se fjala "irth" - "trashëgimia" është tregues i gjërave materiale, mallra. Të tjerë thonë se ka të bëjë me pozitën e profetësisë.

Pjesa tjetër është e mendimit se ka kuptim më të gjerë e që i përfshin të dy mënyrat.

Shumë dijetarë shi'ia kanë përzgjedhur kuptimin e parë, ndërkohë që shumë prej dijetarëve të Ehli Syneetit kanë përzgjedhur kuptimin e dytë. Disa të tjerë, si Sejfid Kutbi, në librat

tij prej kujdestari të Tempullit të Sulejmanit, prandaj iu lut All'llahut, që t'i dhuronte një trashëgimtar të ndriçuar nga ana e Tij.

e tij “Fi Dhilal” dhe “Alusi”, në komentimin “Ruhul Meani” ka përzgjedhur kuptimin e tretë.

Personat që kuptimin e saj e kushtëzuan më trashëgiminë materiale, janë mbështetur te kuptimi i jashtëm i fjalës “*irth*” - “*trashëgimi*”. Fjala “*trashëgimi*”, kur është në numrin njëjës dhe e pashoqëruar me shembuj të tjerë, merr kuptimin “*trashëgimi materiale*”. Nëse shikojmë në një pjesë të ajeteve kur’anore, fjala “*trashëgimi*” ka kuptim shpirtëror. Këtë e shikojmë në ajetin 32 të sures “Fatir”: **“Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur** (nga ndjekësit e Muhammedit). **Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes** (duke bërë vepra të ndaluara), **disa janë në rrugë të mesme** (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat), **ndërsa disa, me lejen e All’llahut, shkojnë përpara me të mira** (përtej detyrimeve); **kjo është dhuntia e madhe.”**

Ne, Librin Qiellor ua trashëguam robve të përzgjedhur. Në këtë rast, fjala “*urethna*” - “*ua trashëguam*”, tregon fakte. Po ashtu, një pjesë transmetimesh tregojnë se në periudhën e Beni Izraelitëve, dijetarëve jehudi u sillnin dhurata të shumta dhe Zekerija ishte kryetari i dijetarëve jehudi.¹

Po ashtu, bashkëshortja e Zekarijas, e cila ishte prej dinastisë së Profetit Sulejman bin Davud trashëgoi nga pasuria e tyre.

Zekerija kishte frikë se trashëgimia e tij mund të binte në duar të njerëzve jo të mirë dhe nga Krijuesi i tij kërkoi fëmijë të mirë, që të jenë mbikëqyrës të pasurisë, që ta përdornin atë në mënyrën më të mirë të mundshme.

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 323.

Edhe Fatime Zehra (*Paqja qoftë mbi të!*) kur kërkoi të merrte “Fedekun” nga halifi i parë, u bazua në këtë ajet. I ndjeri Tabarsi, në librin “Ihtixhaxh” transmeton: “Në kohën kur halifi i parë vendosi t’i marrë të nderuarës Fatime (*Paqja qoftë mbi të!*) “Fedekun”, ajo vajti pranë Ebu Bekrit dhe i tha: “O Ebu Bekër, a është shkruar në Librin e All’llahut që ti të trashëgosh nga babai yt e unë jo? Sa e çuditshme është! A mos vallë e ke braktisur qëllimisht Librin e All’llahut?” Aty do të shikosh se si Profeti Jahja ibn Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) trashëgon nga babai i tij.

Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: **“O All’llah, më fal mua një fëmijë, që të jetë zëvendës dhe trashëgimtar i imi dhe i familjes së Jakubit (*Paqja qoftë mbi të!*).”**¹

Personat që besojnë se “*erth*” - “*trashëgimia*” është me kuptimin “*trashëgimi shpirtërore*”, janë mbështetur në fakte që janë jo vetëm brenda ajetit, por edhe jashtë tij, sikurse:

a- Është paksa vështirë të mendosh se Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*), Profeti i All’llahut, në një moshë të tillë, të mendojë për një gjë të rëndësishme, e cila është trashëgimia, veçanërisht kur, pasi citon fjalën **“Të trashëgojë nga unë dhe nga familja e Jakubit”** më tej shton edhe këtë fjalë: **“O All’llah, ti qofsh i kënaqur me të!”**. Padyshim që kjo fjali flet për cilësitë shpirtërore të trashëguesit.

b- Në ajetet e ardhshme, kur All’llahu e përgëzon Profetin Zekarija (*Paqja qoftë mbi të!*) me ardhjen në jetë të Jahjas (*Paqja qoftë mbi të!*) i tregon po ashtu pozitën shpirtërore, sikurse është pozita e profetësisë.

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 324.

c- Në suren “Ali Imran”, në ajetin 38, kur flet për lutjen që bën Profeti Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*), thotë: **“Atëherë Zekerija iu lut Zotit të vet e tha: ‘Zoti im! Dhuromë nga ana Jote një pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes!’”**.

Profeti Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) kur pa pozitën e Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*), mirësitë që All’llahu i kishte dhuruar, ushqimin që i sillej nga Xhenneti etj., iu lut All’llahut që t’i dhurojë një fëmijë, që të ishte prej të mirëve.

d- Në një pjesë të haditheve të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është trajtuar një çështje, që e vërteton trashëgiminë shpirtërore.

Hadithi është: Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) transmeton nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Profeti Isa, i biri i Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*), kaloi pranë një varri. Personi i varrosur ishte duke vuajtur. Pas një viti, i ra rruga po andej, nga ai varr dhe pa se personi nuk po vuante më. Ai pyeti Krijuesin për këtë gjë. All’llahu i Madhëruar i thotë se personi i varrosur kishte fëmijë të mbarë dhe të dëgjuar. Kishte rregulluar një rrugë, kishte mbrojtur dhe kishte mbështetur një jetim. All’llahu, për shkak të veprave të mira që fëmija e tij kishte bërë, e fali.’ Më tej Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: ‘Trashëgimia e All’llahut të Madhëruar për robërit e tij besimtarë është kjo: Të fal fëmijë të bindur, të cilët zbatojnë urdhrin e All’llahut.’” .

Më tej, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), në kohën e transmetimit të këtij hadithi, recitoi ajetin në lidhje me Zekerijan (*Paqja qoftë mbi të!*): **“Atëherë Zekerija iu lut Zotit të vet e tha:**

‘Zoti im! Dhuromë nga ana Jote një pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes!’¹

Nëse themi se kuptimi i jashtëm i fjalës “trashëgimi” është po ajo trashëgimi e pasurisë, atëherë mund të themi se kjo shfaqje nuk është përfundimtare, sepse në Kur’an është përdorur shpesh kuptimi i fjalës “trashëgimi” (ajeti 32 i sures “Fatir” dhe ajeti 53 i sures “Mu’minun”). Edhe sikur të supozojmë të kundërtën, që të ketë kuptim të jashtëm, nuk do të kishte problem, nëse do të kishte shenjat dhe faktet e mësipërme.

Mbështetësit e mendimit të parë mund t’u përgjigjen këtyre argumenteve, që kishin shqetësuar mendjen e Profetit Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*). Çështja e pronësisë nuk ishte një çështje personale, por kishte të bënte me burimin e korrupsionit ose të korrigjimit të shoqërisë. Ashtu siç e thamë më lart, njerëzit u sillnin shumë dhurata dhe u bënë shumë zotime udhëheqësve të jehudive, të cilat dorëzoheshin në dorën e Zekerijas. Po ashtu, Profeti Zekerija mund të kishte edhe pasuri nga bashkëshortja e tij. Ajo rridhte nga dinastia e Profetit Sulejman (*Paqja qoftë mbi të!*). Është e pamundur që një person jo i mirë, në krye të tyre, të bëhej shkak i një korrupsioni të madh. Kjo gjë e shqetësonte Zekerijan (*Paqja qoftë mbi të!*).

Cilësitë shpirtërore, që janë cituar për Jahjan (*Paqja qoftë mbi të!*) jo vetëm në këto ajete, por edhe në ajetet e tjera të Kur’anit, jo vetëm që nuk kanë asnjë kundërshtim me këtë çështje, por përputhen me të, sepse Zekerija dëshironte që kjo trashëgimi e madhe të binte në dorën e një burri të zgjedhur nga Zoti, i cili ta përdorte atë për lumturinë e shoqërisë.

¹ Sure “Ali Imran”, ajeti 38.

Por sipas besimit tonë, nëse do të merrnim këtë përfundim për çështjen e trashëgimisë, që ajo ka një kuptim të gjerë, atëherë do të përfshinte edhe trashëgiminë materiale, edhe atë shpirtërore. Është e dukshme që për çdo anë ekzistojnë shenja. Duke u mbështetur te ajetet e mësipërme dhe te ajetet e ardhshme, si dhe te një pjesë transmetimesh, ky komentim duket plotësisht i afërm me mendimi tonë.

Fjala: **“Unë u frikësohem (sjelljeve të) të afërmve të mi pas meje.”**, është e pajtueshme me të dy kuptimet. Nëse njerëz të korruptuar do të merrnin në kontroll pasurinë e Zekarijas (*Paqja qoftë mbi të!*), në të vërtetë do të ishte një çështje shumë shqetësuese. Po ashtu, nëse udhëheqësi shpirtëror i njerëzve do të ishte një njeri jo i mirë dhe jo i devotshëm, atëherë kjo çështje do të ishte shumë shqetësuese. Prandaj, frika që kishte Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*), në të dy rastet, është për t’u pasur në qendër të vëmendjes. Po ashtu, edhe hadithi i njohur i Fatime Zehras (*Paqja qoftë mbi të!*) është gjithashtu i përshtatshëm me këtë kuptim.

2- Ndërsa fjalia: **“Idhnada Rrabbehu Nidaen Khafijja”** është trajtuar nga komentuesit.

Kjo fjali na bën të pyesim: Fjala *“nada”* ka kuptimin *“lutje me zë të lartë”*, ndërkohë që fjala *“hafi”* ka kuptimin *“zë të ulët, në qetësi”*. Këto dy fjale nuk përputhen me njëra-tjetrën. Si mund të jetë kuptimi i ajetit?

Por duke pasur parasysh që fjala *“hafi”* nuk ka kuptimin *“qetësi”*, por *“i fshehur”*, andaj është e mundur që Profeti Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) ka folur me Krijuesin e tij në vete, duke mos

qenë askush i pranishëm dhe e ka thirrur Zotin me zë të lartë. Disa janë të mendimit se kjo kërkesë e Profetit Zekarija (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte përgjatë natës, kur njerëzit e tjerë ishin në gjumë.¹

Disa të tjerë po ashtu fjalinë: **“Zekerija doli nga vendi i faljes dhe shkoi te populli i tij”** e kanë marrë si argument për lutjen që bëri kur ishte në vetmi.²

3- Fjalja: “Ve Jerithu min Ali Jakub” - “Më fal mua një fëmijë që të trashëgojë trashëgimi nga familja e Jakubit”, tregon se bashkëshortja e Profetit Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte tezja e Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*), ndaj dhe lidhja e saj familjare ishte prej Profetit Jakub.³

¹ Tefsiri “Kurtubi”, vëll. 6, në vazhdim të ajetit që trajtuam.

² Tefsiri “El Mizan”, vëll. 14, në vazhdim të ajetit që trajtuam.

³ Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 6, në vazhdim të ajetit që trajtuam.

Ajetet 7 - 11

يَزَكِّرِيَا إِنَّا نُبَشِّرُكَ بِغُلَامٍ أَصْمُهُ تَحْيَىٰ لَمْ نَجْعَلْ لَهُ مِنْ قَبْلُ سَمِيًّا ﴿٧﴾
 قَالَ رَبِّ أَنَّىٰ يَكُونُ لِي غُلَامٌ وَكَانَتِ امْرَأَتِي عَاقِرًا وَقَدْ بَلَغْتُ مِنَ
 الْكِبَرِ عِتِيًّا ﴿٨﴾ قَالَ كَذَلِكَ قَالَ رَبُّكَ هُوَ عَلَىٰ هَيْنٍ وَقَدْ خَلَقْتُكَ
 مِنْ قَبْلُ وَلَمْ تَكُ شَيْئًا ﴿٩﴾ قَالَ رَبِّ اجْعَلْ لِي آيَةً قَالَ ءَايَتُكَ إِلَّا
 تُكَلِّمَ النَّاسَ ثَلَاثَ لَيَالٍ سَوِيًّا ﴿١٠﴾ فَخَرَجَ عَلَىٰ قَوْمِهِ مِنَ الْمِحْرَابِ
 فَأَوْحَىٰ إِلَيْهِمْ أَنْ سَبِّحُوا بُكْرَةً وَعَشِيًّا ﴿١١﴾

“O Zekerija, Ne po të japim lajmin e mirë për një djalë që do të quhet Jahja. Askujt nuk ia kemi dhënë këtë emër më parë.”

“Ai tha: ‘O Zoti im, si mund të kem unë djalë, kur bashkëshortja ime është beronjë dhe unë kam arritur pleqërinë e thellë?!’”

“I tha: ‘Ashtu ka thënë Zoti yt. Kjo për mua është lehtë. Unë të kam krijuar edhe ty më parë, ndërkohë që nuk ekzistojë.’”

“(Zekerija) tha: ‘O Zoti im, më jep ndonjë shenjë!’ Ai tha: ‘Shenja jote do të jetë se nuk do të mund të flasësh me njerëzit për tri net, ndonëse do të jesh i shëndoshë.’”

“Ai doli nga faltorja para popullit të vet dhe u bëri me shenjë atyre të lavdëronin All’llahun në mëngjes dhe në mbrëmje!”

Komentimi

Zekerijas iu plotësua dëshira

Këto ajete flasin për plotësimin e lutjes së Profetit Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*), që iu bë nga ana e All’llahut të Madhëruar. Ato nisin kështu: O Zekerija! Ne të përgëzojmë Ty me një djalë. Emri i tij do të jetë Jahja, këtë emër nuk e ka pasur askush para tij.

“O Zekerija, Ne po të japim lajmin e mirë për një djalë që do të quhet Jahja. Askujt nuk ia kemi dhënë këtë emër më parë.”

Është e habitshme, që Zoti t’ia pranojë lutjen robit të tij. Në këtë mënyrë jo vetëm që e përgëzon duke ia plotësuar dëshirën, por edhe e njofton, duke i thënë se ky fëmijë është shumë i veçantë në disa fusha. Po ashtu, All’llahu i tregon për gjininë e fëmijës, si dhe emrin e tij ia vendos vetë All’llahu.

Edhe Ragibi, në fjalorin “Mufredat” ka përzgjedhur këtë kuptim për këtë fjali.

Padyshim që para Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte Profetë të tjerë të mëdhenj, edhe shumë më të lartë se ai, por edhe Jahja kishte cilësitë e tij të veçanta. Këtë gjë do ta trajtojmë më tej.

Por Profeti Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*), që nuk e dinte se përse ishte i favorizuar, kërkoi shpjegim më të hollësishëm nga All'llahu i Madhëruar, duke i thënë se si mund të kem unë fëmijë, ndërkohë që bashkëshortja ime është sterile dhe unë jam në moshë të madhe.

“Ai tha: ‘O Zoti im, si mund të kem unë djalë, kur bashkëshortja ime është beronjë dhe unë kam arritur pleqërinë e thellë?!’”

Fjala *“aakir”* vjen nga rrënja *“akr”* dhe ka kuptimin *“rrënjë”*, *“bazë”*, ose ka kuptimin *“burgosje”*. Ndaj dhe gratë që nuk lindin dhe janë sterile, i quajnë *“aker”*.

Fjala *“itije”* ka kuptimin *“i tharë”*, *“i plakur për shkak të kohës së gjatë”*. Plakja shfaqet te njeriu për shkak të moshës së madhe që ka mbi supe.

Por Profeti Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) shumë shpejt, në përgjigje të pyetjes, merr këtë mesazh nga All'llahu, se një çështje e tillë është e lehtë për Mua.

“I tha: ‘Ashtu ka thënë Zoti yt. Kjo për mua është lehtë.’”

Kjo çështje nuk është e çuditshme, që një i moshuar sikurse ti dhe një grua, sikurse bashkëshortja juaj, e cila është sterile, të lindë fëmijë, pasi Unë ty të krijova më parë, ndërkohë që nuk ishe asgjë.

“Unë të kam krijuar edhe ty më parë, ndërkohë që nuk ekzistojë.”

All'Ilahu i Madhëruar krijoi çdo gjë, edhe pse këto nuk ekzistonin më parë. Atëherë, ku ka vend për t'u habitur, në këtë rast, që All'Ilahu të të falë ty një fëmijë në këtë moshë?

Padyshim që përgëzuesi dhe folësi në këtë ajet është All'Ilahu i Madhëruar. Në ajetin 9 ka vend për të diskutuar, sepse fjalia e ajetit është:

“I tha: ‘Ashtu ka thënë Zoti yt.’”

Disa komentues mendojnë se te ky ajet, fjala e engjëjve është mjet përgëzimi që i bëhet Profetit Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*). Edhe si dëshmi mund të shohim ajetin 39 të sures “Ali Imran”.

“E ndërsa lutej në këmbë, në faltore, engjëjt e thirrën (Zekerijan): ‘All'Ilahu të jep lajmin e mirë për Jahjain, i cili do të vërtetojë Fjalën e All'Ilahut (Isain / *Paqja qoftë mbi të!*), do të jetë një fisnik, i dëlirë dhe Profet, një prej të mirëve.”

Në pamje të jashtme, folësi i gjithë fjalisë është All'Ilahu dhe nuk kemi arsye ta ndryshojmë pamjen e jashtme të ajetit. Po ashtu, nëse engjëjt do të ishin ndërmjetësim i përgëzimit, nuk ka asnjë pengesë që All'Ilahu i Madhëruar mesazhin ia atribuon Vetes së Tij. Këtë e shikojmë edhe në ajetin 40 të sures “Ali Imran”: **“(Zekerija) tha: ‘Zoti im! Qysh do të kem djalë, kur mua më ka zënë pleqëria, e gruaja ime është shterpë?! (Engjëlli i) tha: ‘Kështu! All'Ilahu bën çfarë të dojë.’”**

Sidoqoftë, Profeti Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*), kur dëgjoji bisedën e mësipërme, u gëzua shumë dhe gjithë trupin e tij, nga koka deri te këmbët, e përfshiu lumturia e gëzimi. Edhe pse ky

mesazh për Profetin Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte shumë i rëndësishëm dhe me fat, ai përsëri kërkoi nga All'llahu i Madhëruar t'i tregojë një shenjë për këtë gjë: “(Zekerija) **tha: ‘O Zoti im, më jep ndonjë shenjë!’**”.

Padyshim që Profeti Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte i sigurt dhe kishte besim te premtimi i Zotit, por për të qenë më i sigurt, ashtu sikurse edhe Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) që, për të forcuar edhe më tepër zemrën e tij, kërkoi nga All'llahu i Madhëruar t'i shfaqë mënyrën se si do të ringjallë të vdekurit.

Po ashtu, edhe Profeti Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) kërkoi të njëjtën gjë. All'llahu i Madhëruar i tha: “**Ai tha: ‘Shenja jote do të jetë se nuk do të mund të flasësh me njerëzit për tri net, ndonëse do të jesh i shëndoshë.’**” (Ti mund ta përdorësh gjuhën tënde vetëm për t'i bërë dhikr dhe lutje All'llahut).

Por sa shenjë e çuditshme që ishte ajo! Kjo shenjë, nga një anë, ishte e përputhur me gjendjen e lutjeve dhe, nga ana tjetër, atë e ndante nga të gjitha krijesat, duke e afruar pranë Krijuesit. Në këtë mënyrë, Profeti Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) mund të falënderonte për këtë mirësi të madhe që All'llahu i Madhëruar i dhuroi.

Kjo është prej shenjave shumë të qarta. Njeriu, duke qenë i shëndetshëm, duke e pasur gojën dhe fuqinë për çfarëdolloj urate e lutje për Krijuesin e Tij, këtë shenjë dhe urtësi nuk e ka me njerëzit, pra, Profeti Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk mund të fliste me njerëzit, ishte i privuar të fliste me ta.

Pas këtij përgëzimi dhe këtyre shenjave të qarta, Profeti Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) del nga vendi ku po bënte ibadet dhe

shkon pranë njerëzve. Duke ua bërë me shenjë, thotë se çdo mëngjes dhe çdo darkë e lartësojnë dhe e madhërojnë All'llahun.

“Ai doli nga faltorja para popullit të vet dhe u bëri me shenjë atyre të lavdëronin All'llahun në mëngjes dhe në mbrëmje!”

Kjo mirësi e madhe, që All'llahu ia dhuroi Profetit Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) përfshinte të gjithë popullin e tij, si në jetën e përditshme, ashtu edhe në të ardhmen e tyre. Për këtë arsye, ishte e pëlqyeshme që të gjithë të falënderojnë për këtë mirësi të dhënë nga All'llahu i Madhëruar.

Ky bekim konsiderohet mrekulli dhe mund të forcojë shtyllat e besimit në zemrat e njerëzve, ndaj dhe konsiderohet si një tjetër bekim.

Hulumtime

Jahja, Profeti i devotshëm i All'llahut

Emri Jahja është cituar pesë herë në suret “Ali Imran”, “El En’am”, “Merjem” dhe “El Enbija”. Ai është një ndër Profetët e mëdhenj të All'llahut. Një nga veçoritë e këtij Profeti është të qenit Profet në moshë të vogël. All'llahu i ka dhuruar atij inteligjencë të shkëlqyer në një moshë shumë të vogël. Edhe pse i vogël, kishte dinjitetin e pranimit të këtij mesazhi të madh.

Ndër veçoritë që ka ky Profet (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilën e citon Kur'ani në ajetin 39 të sures "Ali Imran" është epiteti "*hesur*" – "*i matur*", "*i pastër*", "*i çiltër*".

Fjala "*hesur*" vjen nga rrënja "*heser*" dhe ka kuptimin "*person i vendosur në bllokadë*". Në disa prej transmetimeve ka kuptim "*refuzim martese*".

Kjo gjë, nga një anë, ishte një favor për të, që tregonte pastërtinë dhe dëlirësinë. Edhe ndoshta për shkak të kushteve të veçanta të jetës, ishte i detyruar të kryente udhëtime të ndryshme, për të përhapur fenë e Zotit. Gjithashtu, Isai-Mesihu (*Paqja qoftë mbi të!*) u detyrua të mbetej beqar.

Ky komentim është i afërm me fjalën "*husur*". Në ajetin e mësipërm ka kuptimin "*braktisje të pasioneve të kësaj bote*". Në të vërtetë, është një periudhë e shkëlqyer e të qenit mistik.¹

Po ashtu, nga burimet e fesë islame dhe burimet e fesë katolike kuptohet se Profeti Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte djali i tezes së Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*). Në burimet katolike është përcaktuar se Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka pagëzuar Profetin Mesih-Isa. Për këtë arsye Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) është quajtur edhe si pagëzuesi. (Pagëzimi është i posaçëm për katolikët. Ata i pagëzojnë fëmijët e tyre dhe besojnë se nëpërmjet pagëzimit ata pastrohen nga mëkatet). Në kohën kur Profeti Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) shprehu profetësinë e tij, Profeti Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) e besoi atë.

¹ Braktisja e martesës nuk mund të konsiderohet si cilësi, sepse ligji Islam e thekson shumë çështjen e martesës. Kjo temë është trajtuar edhe më shumë në "Komentimin e Përkryer", në faqen 402.

Padyshim që Profeti Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk kishte libër të veçantë qiellor. Kur thuhet: **“Ej, Jahja merre librin dhe mbaje me forcë!”**, kuptohet se flitet për Teuratin, librin e Profetit Musa (*Paqja qoftë mbi të!*).

Faktikisht, disa nga ndjekësit e Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) janë të mendimit se libri është i Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*).

Profeti Jahja dhe Profeti Isa (*Paqja qoftë mbi ta!*) kishin shumë gjëra të përbashkëta: kishin një mistikë të jashtëzakonshme, braktisën martesën për shkaqet që i thamë, lindja e tyre si bekim, kishin lidhje shumë të afërt familjare.

Nëpërmjet transmetimeve islame kuptohet se Imam Hysejni dhe Profeti Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) kanë gjëra të përbashkëta. Nga Imam Ali bin Hysejn Zeinul Abidini (*Paqja qoftë mbi të!*) është transmetuar: “Kur po shkonim drejt Kerbelasë shoqëroheshim nga Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*). Qëndruam larg saj. Imami, në çdo shtëpi që qëndroi dhe në çdo rrugicë që eci, kujtonte se si e kanë vrarë Profetin Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*)”. Shpeshherë thoshte: “Në pavlefshmëri të dynjasë, pranë Zotit është e mjaftueshme kjo gjë që, kokën e Jahja bin Zekerias (*Paqja qoftë mbi të!*) e prenë dhe e dërguan pranë një të pamoralshmi dhe të ligu, te Beni Izraelitët.”.¹

Martirizimi i Imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) është i ngjashëm me vrasjen e Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) në disa drejtime. (Mënyrën e vrasjes së Profetit Jahja do e komentojmë më vonë).

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 34.

Emrat e tyre, emri i Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i Jahjasë (*Paqja qoftë mbi të!*) ishin të pashembullt. Po ashtu, periudha e qëndrimit të tyre në barkun e nënës ishte më e pakët.

1- Faltorja ishte një vend i veçantë, që i takonte Imamit dhe personave të zgjedhur. Fjala “faltore” ka dy kuptime.

Së pari, fjala “faltore” vjen nga rrënja e fjalës “herb”, që ka kuptimin “luftë”, sepse lufta në të vërtetë është përballje me shejtanin dhe egon.

Fjala “faltore” - “mihrab”, në fjalor, ka kuptimin e një pike sipër të tjerëve. Vendi i “mihrabit” - “faltore” është sipër, prandaj është quajtur me këtë emër.

Disa janë të mendimit se “mihrabi” në mesin e Beni Izraelitëve ka kuptim të kundërt me atë që kemi ne. Ai është vendosur në pikën më të lartë të tokës, ka shkallë dhe është i rrethuar me mure, që personat që qëndrojnë brenda, të mos shikohen nga të tjerët, që janë jashtë.

Bazimi ynë është te fjala “*Feherexhe Ala Keumihi minel Mihrab*” që lexuam në ajetet e mësipërme. Gjithashtu, bazohemi në fjalën “ala”, që zakonisht përdoret për rastet e mësipërme dhe e vërteton këtë kuptim.

Ajetet 12 - 15

يَجِيْ حُذِ الْكِتٰبِ بِقُوَّةٍ ۖ وَءَاتَيْنٰهُ الْحُكْمَ صَبِيًّا ﴿١٢﴾ وَحَنَانًا مِّنْ لَّدُنَّا
وَزَكٰوَةً ۖ وَكَانَ تَقِيًّا ﴿١٣﴾ وَبَرًّا بِوَالِدَيْهِ وَلَمْ يَكُنْ جَبَّارًا عَصِيًّا ﴿١٤﴾
وَسَلَّمَ عَلَيْهِ يَوْمَ وُلِدَ وَيَوْمَ يَمُوتُ وَيَوْمَ يُبْعَثُ حَيًّا ﴿١٥﴾

“(Pasi lindi djali, iu tha): ‘O Jahja, rroke fort Librin (Teuratin). Dhe Ne, kur ende ishte fëmijë, i dhamë mençuri,”

“butësi prej Nesh dhe dëlirësi. Ai ishte besimtar i përkushtuar,”

“dhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, nuk ishte i ashpër dhe i padëgjueshëm.”

“Paqja qoftë mbi atë ditën kur ka lindur, ditën kur të vdesë dhe në ditën kur do të ringjallet.”

Komentimi

Cilësitë e shquara të Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*)

Në ajetet e kaluara kemi parë se si All'Ilahu i Madhëruar e përgëzoi Profetin Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) në një moshë të moshuar. Në ndjekje të saj, në ajetin 12 lexojmë një urdhër të Zotit, që i drejtohet Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*): **“O Jahja, rroke fort Librin (Teuratin).”** Komentuesit janë të mendimit se fjala *“kitab”* - *“libër”*, në këtë rast është *“Teurati”*.¹

Disa komentues kanë dhënë këtë mundësi komentimi: Profeti Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte një libër të veçantë (sikurse ishte edhe Zeburi i Daudid / *Paqja qoftë mbi të!*). Por sigurisht nuk bëhej fjalë për një libër, që të sillte fe të re.²

Komentimi i parë është më i pranueshëm.

Qëllimi i theksimit të marrjes së librit me forcë dhe fuqi është që ajo që thuhet në libër, të merret me seriozitet, duke e vepruar dhe duke e zbatuar atë që është shkruar në Teurat.

Gjithashtu, të përdorë të gjithë fuqitë e tij, si ato materiale, ashtu edhe ato shpirtërore, personale dhe shoqërore në rrugën e përhapjes së saj.

Në parim, asnjë libër dhe asnjë shkollë nuk mund të realizohet pa pasur forcë dhe fuqi të mjaftueshme. Po ashtu, është shumë e rëndësishme edhe vendosmëria e ndjekësve të shkollave.

¹ Për këtë ajet mund t'i drejtoheni tefsirit “Alusi”, tefsirit “Kurtubi”.

² Tefsiri “El Mizan”, në vazhdim të ajetit që cituam.

Ky është mësim për të gjithë besimtarët dhe për ata që duan të ecin në rrugën e All'llahut.

Pas këtij urdhri dhe mirësive që All'llahu i dha Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) ajeti flet për mirësitë e Zotit, që Profeti Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka arritur me ndihmën e All'llahut.

“(Pasi lindi djali, iu tha): ‘O Jahja, rroke fort Librin (Teuratin)’. ‘Dhe Ne, kur ende ishte fëmijë, i dhamë mençuri butësi prej Nesh dhe dëlirësi. Ai ishte besimtar i përkushtuar.’”.

Fjala *“henan”* ka kuptimin *“mëshirë”, “dhembshuri”, “dashuri”*.

Ndërsa fjala *“zekat”*, ka kuptime të ndryshme në mesin e komentuesve. Disa i japin kuptimin *“vepër e mirë”*, disa *“bindje”* dhe *“sinqeritet”*, disa *“mirësi ndaj prindërve”*, disa *“njohje e mirë”* e të tjerë janë të mendimit se ka kuptimin *“pastërti në ndjekje”*. Fjala *“zekat”* ka kuptim të gjerë dhe të gjitha këto që u thanë i përfshin kjo fjalë.

Ai ishte i pastër. Rrinte larg çdo papastërtie, ishte i sjellshëm ndaj nënës dhe babait, punëmirë dhe i dashur.

“Ai ishte besimtar i përkushtuar dhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, nuk ishte i ashpër dhe i padëgjueshëm.”

“Paqja qoftë mbi atë ditën kur ka lindur, ditën kur të vdesë dhe në ditën kur do të ringjallet.”

Hulumtime

1- “Librin qiellor rroke fort!”

Fjala “*kuvet*” në ajet: **“Ja Jahja Hudhil Kitabe Bi Kuveti” - “O Jahja, librin qiellor rroke fort”**, sikurse edhe e kemi cituar, ka një kuptim të plotë dhe të gjerë, që përfshin të gjitha forcat, si materiale, ashtu edhe ato shpirtërore. E gjitha kjo është treguese e një realiteti, që ruajtja e fesë së All’llahut, Islami dhe Kur’ani, nuk bëhet duke qenë i dobët dhe i pafuqishëm, por duke qenë i fortë dhe i vendosur për t’i ruajtur ato.

Edhe pse këto fjalë i drejtohen Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*), në raste të tjera të Kur’anit të Shenjtë u drejtohen edhe Profetëve të tjerëve.

Në ajetin 145 të sures “El Araf”, Profeti Musa ka si detyrë që ta rrokë e ta mbrojë Teuratin: **“Ne i shkruam në Pllaka udhëzime dhe shpjegime për gjithçka: ‘Merri këto me bindje dhe urdhëroje popullin tënd që t’i përvetësojë në mënyrën më të mirë. Unë do t’ju tregoj shtëpinë e të pabindurve.”**.

Në ajetin 63 dhe 93 të sures “El Bekare” po kjo gjë u kërkohet të gjithë Beni Izraelitëve, duke treguar se ky është një urdhër i gjerë për të gjithë dhe nuk është gjë personale apo për një person të caktuar.

“Kujtoni (o hebrej) kur morëm besën tuaj dhe ngritëm mbi ju malin Tur, duke thënë: ‘Merreni seriozisht atë që ju dhamë dhe mbani në mendje rregullat e saj, në mënyrë që të ruheni nga gjynahet!’”

“Kur morëm besën tuaj dhe ngritëm mbi ju malin e Turit, thamë: ‘Merreni seriozisht atë që ju kemi dhënë dhe dëgjoni!’ Ju thatë: ‘Ne dëgjuam, por kundërshtojmë!’ Për shkak të mohimit, atyre u ishte rrënjosur në zemra dashuria (dhe adhurimi) për viçin. Thuaju: ‘Nëse jeni vërtet besimtarë, sa gjë të keqe po ju urdhëruaka besimi juaj!’”

Po ashtu, rastësisht, po këtë kuptim, e shikojmë me një tjetër interpretim, në ajetin 60 të sures “Enfal”: **“Përgatisni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e All’llahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që All’llahu i njeh. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e All’llahut, do t’ju shpërblehet dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.”.**

Gjithsesi, ky ajet është përgjigje për të gjithë ata që mendojnë se mund të kryhet punë e mund të zgjidhen probleme, duke qenë të dobët.

2- Tre ditë të vështira në të ardhmen e njeriut

Le të analizojmë interpretimin e ajetit:

“Paqja qoftë mbi atë ditën kur ka lindur, ditën kur të vdesë dhe në ditën kur do të ringjallet.”

Në historinë e jetës së njeriut dhe të transformimit të tij nga një botë në një botë tjetër, ka tre ditë të vështira. Njëra është dita kur vijmë në këtë botë, dita e dytë është dita e vdekjes dhe e kalimit nga kjo botë në Botën Tjetër. Ndërsa dita e tretë është dita kur do të ringjallemi në Botën Tjetër.

Për shkak se këto tre ditë janë ditët e transformimit, që përballen me kriza, All'llahu i Madhëruar përfshin te këto ditë shëndetin dhe bekimin e Tij, duke i vendosur ata nën hijen e mbështetjes së Tij.

Ky interpretim është përcaktuar vetëm në dy raste në Kur'anin e Shenjtë, për rastin e Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*). Por për rastin e Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*), Kur'ani ka një vlerësim të veçantë, sepse folësi, në këtë rast, është All'llahu. Ndërkohë që në rastin e Isait (*Paqja qoftë mbi të!*), folësi është vetë Isai (*Paqja qoftë mbi të!*).

Është e qartë se këta dy njerëz të mëdhenj kanë ngjashmëri dhe janë të përfshirë në këtë mirësi.

Në një transmetim të Imam Ali bin Musa Ridhas (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: *“Në jetën e njeriut janë tre periudha të frikshme: periudha e parë është momenti kur njeriu lind dhe vjen në këtë botë. Periudha e dytë është kur njeriu vdes dhe kur takon njerëzit që ndodhen atje. Periudha e tretë është kur njeriu ringjallet dhe përballlet me ligjet dhe shikon, nëse i ka zbatuar ato çka All'llahu ka urdhëruar. All'llahu, Profetin Jahja, në të tre këto raste, e ka ruajtur duke e përgëzuar me paqe.”*¹

O Zot! Na përfshi edhe ne në mëshirën Tënde në këto tre periudha të gjata.

¹ “Ujun Ekhbar Redha”.

3- Profetësia në moshë të vogël

Është e vërtetë që periudha e lulëzimit të mendjes së njeriut, ka një kufi të veçantë. Dimë se gjithmonë në mesin e njerëzve ekzistojnë edhe njerëz të veçantë. Ç'kuptim do të kishte që All'llahu i Madhëruar këtë periudhë, për disa nga robtë e Tij, ta ngjishte më shumë dhe ta përmbledhonte në vite më të shkurtra?!

Zakonisht fëmija fillon të flasë përafërsisht nga mosha dy vjeçare. Ndërsa në rastin e Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk është kështu. Ai nis të flasë disa ditë, pasi kishte lindur. Fjalët e tij ishin me shumë kuptim dhe shumë të dobishme, që një person në moshë madhore nuk i thotë. Pra, e folura e Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte një gjë e jashtëzakonshme. Në dashtë All'llahu, këtë gjë do ta komentojmë në ajetet e ardhshme.

Nga këtu bëhet e qartë një nga kritikak që u bëhen disa prej Imamëve shi'ia, se përse Imamët janë përcaktuar dhe kanë marrë pozitën e imamatit në moshë të vogël. Në një transmetim nga Ali bin Esbati thuhet: *"Një nga shokët e Imam Xhevad Muhammed bin Ali Taki (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: 'Vajta pranë Imamatit, (ndërkohë që mosha e Imamatit ishte e vogël). I qëndrova pranë dhe po e vështroja me vëmendje, duke i fiksuar të gjitha përmasat e tij, me qëllim që t'u tregoja shokëve për të në kohën që do të kthehesha në Egjipt. Në këtë moment, që isha duke menduar, se çfarë do të thosha, Imami u ul. (A thua e kishte lexuar të gjithë mendjen time.) U drejtua nga unë e më tha: 'O Ali bin Esbati! All'llahu ka bërë të njëjtën gjë me Imametin, ashtu sikurse ka bërë edhe me Profetët (Paqja qoftë mbi ta!)'". Herë (All'llahu) ka*

thënë: **“Ne i dhamë Jahjas në moshë të vogël urdhrin e profetësisë, mendjen e taktin.”**¹

Dhe herë rreth njerëzve thotë: **“Kufiri i pjekurisë së plotë të mendjes së njeriut është në moshën dyzetvjeçare....”**²

Prandaj, ashtu sikurse është e mundur që All’llahu t’ju japë urtësi njerëzve në moshë të vogël, është në Fuqinë e Tij që t’jua japë edhe në moshën dyzetvjeçare.³

Ky ajet është përgjigje për ata që besojnë në moshë të vogël, ashtu siç ishte besimi i Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) në moshë të vogël. Ata mendojnë se Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk mund të jetë besimtari i parë që ka pranuar fenë islame, sepse ishte fëmijë dhjetë vjeç, kur pranoi fenë islame.

Citimi i kësaj çështjeje nuk është pa shkak. Në një hadith të Imam Ali bin Musa Ridhas (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: *“Një grup fëmijësh, në periudhën e fëmijërisë, u afruan pranë Imamit dhe thanë: ‘Eja të ikim të luajmë!’”*

Ai u përgjigj: *“Ne nuk jemi krijuar për të lozur!”* Në këtë rast All’llahu tha për të: **“Ne i dhamë Jahjas në moshë të vogël urdhrin e profetësisë...”**⁴

Duhet të jemi të vëmendshëm se qëllimi i përdorimit të fjalës *“lojë” - “lehtë”*, është theksimi i lojës së kotë dhe të pavlefshme, lojëra që nuk kanë të bëjnë me zhvillimin e intelektit.

¹ Sure “Merjem”, ajeti 12.

² Sure “Ahkaf”, ajeti 15.

³ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 325.

⁴ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 325.

4- Martirizimi i Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*)

Jo vetëm lindja e Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) është shumë e befasishme, por edhe vdekja e tij është e tillë. Në historinë islame, si dhe në burimet e njohura krishtere rrjedha e këtij martirizimi është përshkruar kështu (edhe pse midis tyre ka ndryshime në disa veçori): Profeti Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) është bërë kurban i një lidhjeje jo të rregullt martesore të një prej tiranëve, i cili dashurohet me vajzën e vëllait të tij. Herodi, mbreti i Palestinës, dashurohet me Hirodën, vajzën e vëllait. Bukuria e saj bëri që zemra e sytë e Herodit të verbohen, duke vendosur të martohet me vajzën e vëllait. Këtë lajm e dëgjoji Profeti i madh i All'llahut, Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e kundërshtoi, duke thënë se kjo martesë është e paligjshme dhe në kundërshtim me urdhrat e Teuratit. Kjo ngjarje u bë e njohur në të gjithë vendin dhe të gjithë nisën thashethemet.

Kjo gjë e mërziti shumë Hirodën dhe vendosi të hakmerret. Ajo, lidhjen e saj e përforcoi edhe më shumë me xhaxhanë e saj, duke përdorur bukurinë e saj. Një ditë, xhaxhai i saj, Herodi, që tashmë ishte edhe burri i saj, i thotë se do t'i plotësonte çdo dëshirë. Ajo i thotë se nuk do asgjë përveç kokës së Jahjas. Ai bëri që emri im të përflitej në të gjithë vendin dhe të gjithë njerëzit të na kritikonin ne. Nëse dëshiron që zemra ime të jetë e qetë dhe të gëzojë, duhet të kryesh këtë gjë!

Herodi, duke mos i kushtuar asgjëje vëmendje, përveç dashurisë së çmendur që kishte për mbesën e tij, vendosi dhe

shumë shpejt i solli asaj, në shenjë dashurie, kokën e Jahjas (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo vepër e tij i solli një të ardhme shumë të keqe.¹

Imam Hysejri (*Paqja qoftë mbi të!*) në një hadith ka thënë: “Një ndër gjërat më të liga të kësaj bote ishte vrasja e Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe prerja e kokës së tij si dhuratë për gruan më të ligë të Beni Izraelitëve.

Unë kam shumë ngjashmëri me Profetin Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*). Një nga qëllimet tona të kryengritjes dhe të kundërshtimit ishte lufta kundër veprave të këqija që i kryejnë tiranët. Unë kam tiran Jezidin.”.

¹ Në disa nga biblat dhe një pjesë të transmetimeve thuhet se Herodi u martua me gruan e vëllait, që në ligjin e Teuratit ishte e ndaluar kjo lloj martese. Më tej kjo grua përdori bukurinë e vajzës së saj që të shtyjë Herodin e të vrasë Jahjan (*Paqja qoftë mbi të!*). (Bibla e Mateut, kapitulli 14, nga numri 4 deri tek 12; Bibla e Markut, kapitulli 6, paragrafi i 17 e më tutje).

Ajetet 16 - 21

وَأَذْكُرْ فِي الْكِتَابِ مَرْيَمَ إِذِ انْتَبَذَتْ مِنْ أَهْلِهَا مَكَانًا شَرْقِيًّا ﴿١٦﴾ فَاتَّخَذَتْ مِنْ دُونِهِمْ حِجَابًا فَأَرْسَلْنَا إِلَيْهَا رُوحَنَا فَتَمَثَّلَ لَهَا بَشَرًا سَوِيًّا ﴿١٧﴾ قَالَتْ إِنِّي أَعُوذُ بِالرَّحْمَنِ مِنْكَ إِنْ كُنْتَ تَقِيًّا ﴿١٨﴾ قَالَ إِنَّمَا أَنَا رَسُولُ رَبِّكِ لِأَهَبَ لَكِ غُلَامًا زَكِيًّا ﴿١٩﴾ قَالَتْ أَنَّى يَكُونُ لِي غُلَامٌ وَلَمْ يَمَسِّنِي بَشَرٌ وَلَمْ أَكُ بَغِيًّا ﴿٢٠﴾ قَالَ كَذَلِكَ قَالَ رَبُّكَ هُوَ عَلَى هَيْنٍ ۖ وَلَنَجْعَلَنَّ آيَةً لِلنَّاسِ وَرَحْمَةً مِّنَّا ۚ وَكَانَ أَمْرًا مَّقْضِيًّا ﴿٢١﴾

“Dhe trego (o Muhammed) në Libër për Merjemen, kur u tërhoq nga familja e saj në një vend në lindje”,

“duke e fshehur veten nga ata. Ne i dërguam Shpirtin Tonë, i cili iu paraqit asaj si një njeri i plotë.”

“Ajo i tha: ‘Unë kërkoj që të më mbrojë i Gjithëmëshirshmi prej teje, nëse i frikësohesh All’Ilahut.”

“Ai tha: ‘Në të vërtetë, unë jam vetëm një i Dërguar i Zotit tënd, që të të dhuroj ty një djalë të pastër.’”

“Ajo tha: ‘Si mund të kem unë djalë, kur asnjë mashkull nuk më ka prekur e nuk jam as e pacipë?!’”

“Tu përgjigj: ‘Kështu është!’ Zoti yt ka thënë: ‘Kjo për Mua është e lehtë. Ne do ta bëjmë atë shenjë për njerëzit dhe mëshirë nga ana Jonë’. Dhe kjo është punë e kryer.”

Komentimi

Fillimi i lindjes së Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*)

Pas shpjegimit të së kaluarës së Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) All’llahu i Madhëruar nis të flasë për lindjen e Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe për historinë e nënës së tij, Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*). Midis këtyre dy ngjarjeve ka një lidhje shumë të afërt. Nëse lindja e Profetit Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte nga një baba i vjetër dhe një nënë sterile, lindja e Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte nga një nënë e virgjër dhe pa baba. Kjo e fundit, është edhe më e habitshme dhe më e çuditshme.

Nëse përzgjedhja si Profet në moshë të vogël është për t’u habitur, atëherë, të flasësh në djep për librin dhe profetësinë, është edhe më e habitshme.

Sidoqoftë, që të dyja këto janë prej shenjave të All’llahut të Madhëruar. Një tjetër lidhje që i afronte këta dy Profetë të mëdhenj është lidhja familjare që kishin këta të dy. Nëna e Profetit

Jahja (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte motra e nënës së Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*). Të dyja këto gra ishin sterile dhe luteshin gjithmonë që All'lahu t'u falte fëmijë të mirë.

Ajeti 16 thotë: **“Dhe trego (o Muhammed) në Libër për Merjemen, kur u tërhoq nga familja e saj në një vend në lindje.”**.

Në të vërtetë, Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) dëshironte të gjente një vend bosh, pa shqetësime, që të mund t'i thoshte Krijuesit të saj atë që kishte nevojë. Për këtë arsye u drejtua nga Kudsi, që të ishte me e qetë dhe dielli rrezatonte më fort.

Fjala “*intebedhet*” vjen nga rrënja “*nebedh*”. Sipas gjuhëtarit dhe leksikologut Ragibi, ka kuptimin “*të largosh gjëra që nuk kanë shumë vëmendje, nuk janë të rëndësishme*”.

Po ky interpretim, në ajetin e mësipërm, ndoshta ka për qëllim të tregojë për Hazreti Merjemen (*Paqja qoftë mbi të!*), e cila u largua në mënyrë të thjeshtë, pa lënë gjurmë dhe pa asnjë vepër, që mund të tërhiqte vëmendjen e të tjerëve. Ajo u tërhoq nga njerëzit dhe atë shtëpi e bëri vend adhurimi të Zotit.

Kështu, në këtë moment, Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) vendos një perde midis vetes dhe njerëzve, në mënyrë që vendi ku ajo qëndronte e vetme, të ishte i plotë.

“...duke e fshehur veten nga ata. Ne i dërguam Shpirtin Tonë, i cili iu paraqit asaj si një njeri i plotë.”

“...duke e fshehur veten nga ata.” Në këtë fjali nuk është përcaktuar qëllimi i kësaj fshehjeje. Prandaj me të drejtë mund të lindin disa pyetje: A mos vallë ajo u fsheh që të ishte e qetë, që të mund të adhuronte All’llahun e Madhëruar pa iu tërhequr vëmendja? Mos vallë u fsheh se donte të lahej, të bënte gusul?

Ajeti hesht për këtë gjë.

Sidoqoftë, në këto momente, All’llahu i Madhëruar dërgon te ajo Shpirtin e Shenjtë (një prej engjëjve të mëdhenj) në formën e njeriut, formë e përsosur, pa asnjë mangësi.

“Ne i dërguam Shpirtin Tonë,¹ i cili iu paraqit asaj si një njeri i plotë.”

Është mëse e dallueshme se në ç’gjendje vihet Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) në ato momente. Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*), e cila kishte jetuar gjithmonë e pastër, e ndershme, ishte rritur në mesin e njerëzve të pastër. Kur ajo pa që në vendin ku qëndronte, ishte një burrë i huaj dhe i bukur, u tremb shumë.

Ndaj, sapo pa atë njeri, thirri me zë të lartë se i mbështetej Zotit të Madhëruar dhe kërkoi mbrojtjen e All’llahut nga ai, nëse je prej atyre që i frikohesh Zotit.

“Ajo i tha: ‘Unë kërkoj që të më mbrojë i Gjithëmëshirshmi prej teje, nëse i frikësohesh All’llahut.’”

¹ D.m.th. engjëllin Xhebrail. All’llahu e ka quajtur atë **“Shpirtin Tonë”** për ta nderuar dhe për ta ngritur lart, jo se Xhebraili është pjesë e Qenies Hyjnore. Ai është një prej shpirtave më të nderuar që ka krijuar All’llahu.

Ky ishte tërmeti i parë që pushtoi gjithë qenien e Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*). Të citosh emrin e All'Ilahut, si dhe të këshillosh të tjerët me mëshirën e All'Ilahut, si dhe t'i ftosh ata që të jenë të devotshëm dhe punëmirë, bën që të gjithë problemet të zgjidhen. Nëse ai person do të ishte përfitues dhe keqbërës, Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*), me fjalët e saj dhe me mbështetjen që kërkoi te Zoti i Madhëruar, bëri që ta kontrollonte atë. Po ashtu, Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*), duke thënë këto fjalë, po priste reagimin e personit të panjohur, pritje që i ishte bashkuar ankthit, frikës, terrorizimit. Por pritja nuk zgjati, personi reagon, duke thënë atë për çka All'Ilahu e kishte dërguar.

“Ai tha: ‘Në të vërtetë, unë jam vetëm një i Dërguar i Zotit tënd, që të të dhuroj ty një djalë të pastër.’”

Kjo fjali i dha qetësi Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*), por kjo qetësi nuk zgjati shumë, sepse shumë shpejt i vjen lajmi përgëzues, se do të kishte një fëmijë.

Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*), kur dëgjoji këtë fjalë, e kapi një drithërimë e tmerrshme, saqë iu rikthye edhe një herë shqetësimi i thellë. Ajo tha se si është e mundur që unë të kemë fëmijë, ndërkohë që asnjë njeri nuk ka pasur kontakt me mua, e as nuk kam bërë kurrë punë të liga.

“Ajo tha: ‘Si mund të kem unë djalë, kur asnjë mashkull nuk më ka prekur e nuk jam as e pacipë?!’”

Ajo, kur u gjend në këtë situatë, mendoi se, që një grua të mbetet shtatzënë, duhet të plotësohet një kusht: ose duhet të jetë e martuar dhe fëmijën ta ketë me bashkëshortin e saj, ose të jetë e përlyer dhe ka zgjedhur rrugën e keqe. Unë që e njihja më mirë se

çdokush veten time, as jam martuar e as nuk jam vajzë imorale. Kurrë nuk është dëgjuar që një femër të lindë një fëmijë pa pasur një prej këtyre dy gjendjeve.

Por shumë shpejt shqetësimi dhe trishtimi do ia linin vendin një madhështie, pasi Zoti thotë: **“Kështu është! Zoti yt ka thënë: ‘Kjo për Mua është e lehtë.’”**.

Ti e njeh shumë mirë fuqinë Time, je ushqyer me fruta Xhenneti, në kohën kur ato nuk kishin stinën në dynja. Ti ke dëgjuar zërin e engjëjve, kur ata dëshmonin për njerëzit e pastër.

Ti e di më së miri se si e krijuam Ademin prej dheu. Atëherë çka këtu për t’u habitur?! Më pas shtoi! Ne duam që Ai të jetë shenjë bekimi për njerëzit, ne duam që ai të jetë mëshirë për krijesat. Gjithsesi, ky urdhër është i përfunduar, nuk ka vend për të folur.

“Ne do ta bëjmë atë shenjë për njerëzit dhe mëshirë nga ana Jonë’. Dhe kjo është punë e kryer.”

Hulumtime

Cili është përdorimi i fjalës “Shpirt i Zotit”?

Përafërsisht, të gjithë komentuesit e njohur, fjalën “shpirt” e kanë komentuar për engjëllin e madh, Xhebrailin. Është përdorur fjala “ruh” për shkak se është jetëdhënës, zbret shpalljen e Zotit

për Profetët, të cilët janë rigjallërues të jetës së njerëzimit. Në këtë rast, shtimi i fjalës “*ruh*” është argument për madhështinë e All'llahut. Po ashtu, nga ky ajet kuptohet se Xhebraili nuk ka zbritur veçanërisht për Profetin Tonë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por ai është përzgjedhur edhe për të sjellë mesazhe të tjera, sikurse është mesazhi i mësipërm i Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ç' do të thotë “*temthil*”?

Fjala “*temthil*” vjen nga rrënja e fjalës “*methul*”, që ka kuptimin “*të qëndrosh përballë një personi apo diçkaje*”. Ndërsa fjala “*mumeth' thel*” ka kuptimin e diçkaje, e cila shfaqet në mënyrë tjetër.

Ndaj, “*...iu paraqit asaj si një njeri i plotë*”, ka kuptimin që engjëlli iu paraqit në formë njeriu.

Kur themi se engjëlli erdhi në formën e njeriut, padyshim që një ndryshim i tillë nuk është i mundur, por ai mori formën e njeriut për nga pamja, edhe pse ai ishte engjëll. Mirëpo Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk e dinte dhe mendonte se përballë saj është një njeri.

Në hadithet dhe në historinë islame fjala “*temethul*” ka kuptime të shumta. Ndër to është edhe shndërrimi i Iblisit, shejtanit të mallkuar, në ditën kur jobesimtarët ishim mbledhur në Darul Neduh, duke thurur plan se si të vrasin Profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ai u paraqit si një dashamirës në rrethin e kurejshëve.

Në një tjetër rast, i shfaqet Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) në formën e dynjasë dhe si një grua e bukur. Kjo ngjarje është e njohur.

Në disa hadithe lexojmë: *“Në kohë kur njeriu është duke vdekur, veprat e tij, pasuria e tij dhe fëmijët e tij i shfaqen në forma të ndryshme.”*.

Po ashtu, veprat e njeriut shfaqen kur ai është në varr dhe në Ditën e Kiametit, në mënyra të ndryshme dhe të veçanta.

Kuptimi tjetër mund të jetë: Veprat e njeriut do të shfaqen në mënyrë të veçantë në Ditën e Kiametit. Të gjitha këto tregojnë se fjala *“temethul”*, në të gjitha rastet, ka kuptimin *“gjë”* apo *“person që shfaqet në mënyrë të ndryshme”*.¹

¹ Tefsiri “El Mizan”, vëll. 14, f. 37.

Ajetet 22 - 26

﴿ فَحَمَلَتْهُ فَانْتَبَذَتْ بِهِ ۖ مَكَانًا قَصِيًّا ۚ ﴾ فَأَجَاءَهَا الْمَخَاضُ إِلَى
 جِذْعِ النَّخْلَةِ قَالَتْ يَلَيْتَنِي مِتُّ قَبْلَ هَذَا وَكُنْتُ نَسِيًّا ۚ ﴿ ٢٢ ﴾
 فَنَادَاهَا مِنْ تَحْتِهَا أَلَّا تَحْزَنِي قَدْ جَعَلَ رَبُّكِ تَحْتَكِ سَرِيًّا ۚ ﴿ ٢٣ ﴾ وَهَزِيَ إِلَيْكَ
 الْجَذْعُ النَّخْلَةُ تُسْقِطُ عَلَيْكَ رَطْبًا جَنِيًّا ۚ ﴿ ٢٤ ﴾ فَكُلِي وَاشْرَبِي وَقَرِّي عَيْنًا
 فَإِمَّا تَرَيْنَ مِنَ الْبَشَرِ أَحَدًا فَقُولِي إِنِّي نَذَرْتُ لِلرَّحْمَنِ صَوْمًا فَلَنْ أُكَلِّمَ
 الْيَوْمَ إِنْسِيًّا ﴿ ٢٥ ﴾

“Ajo mbeti me barrë e u tërhoq me të në një vend të largët.”

“Dhembjet e lindjes e detyruan atë që të shkonte te trugu i një hurme. Ajo tha: ‘Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!’”

“Një zë e thirri nga poshtë: ‘Mos u pikëlllo, se Zoti yt të ka bërë një burim uji poshtë teje!’”

“Shkunde trugun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta!”

“Ha, pi dhe qetësohu. Nëse vëren ndonjë njeri, i thuaj: ‘Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.’”

Komentimi

Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) në vështirsinë më të madhe të jetës

Si përfundim, Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) mbeti shtatzënë. Fëmija që ishte vendosur në mitrën e saj, ishte fëmija i premtuar.

Përsa i përket faktit se si është krijuar ky fëmijë dhe se mos vallë Xhebraili i ka fryrë Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*), nuk është folur në Kur'an, sepse nuk ishte e nevojshme, edhe pse komentuesit për këtë gjë kanë përdorur fjalë të ndryshme.

Sidoqoftë, ky urdhër u bë shkak që ajo të largohej nga Shtëpia e Shenjtë në një vend të largët.

“Ajo mbeti me barrë e u tërhoq me të në një vend të largët.”

Në këtë rast, ajo u gjend përballë një frike dhe një shprese. Ishte e shqetësuar, sepse në një moment kjo shtatzëni do të merrej vesh, kështu që do të ishte më mirë që disa ditë apo disa muaj të qëndronte larg e të jetonte në një vend ku nuk e njihnin. Ajo

mendonte se ç'do të bëhej me të. Kush do ta besonte që ajo, një grua e pamartuar, të mbetet shtatzënë, pa pasur marrëdhënie me njeri. Tashmë do ta akuzonin se është e përdalë. Si do t'u përgjigjej këtyre akuzave?!

Në të vërtetë, ajo ishte një vajzë e pastër, që kishte jetuar gjithmonë me nder dhe me devotshmëri, si dhe ishte shembull për adhurimin dhe bindjen ndaj All'llahut. Adhuruesit dhe mistikët e Beni Izraelitëve krenoheshin me të, që në vogëlinë e saj, sepse ajo ishte rritur nën kujdesin e një Profeti të madh, si Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*). Ndaj dhe ishte e njohur për shenjtërinë e saj, kështu që do të ishte shumë e dhimbshme që një ditë të ndiente, që e gjithë kjo pasuri shpirtërore të vihej në rrezik. Akuzat konsiderohen si gjërat më të ligat, që në këtë rast për Hazreti Merjemen (*Paqja qoftë mbi të!*) do të ishte një tjetër tërmet, që përfshiu për së treti trupin e saj (Merjemes) (*Paqja qoftë mbi të!*).

Por nga ana tjetër, ajo ndiente se ky fëmijë është bekim, Profet i All'llahut. Ndaj edhe All'llahu i Madhëruar, që e kishte bekuar me një fëmijë të tillë, si do ta linte vetëm?

A është e mundur që të mos e mbrojë nga një akuzë e tillë? Ajo e kishte provuar gjithmonë mirësinë e Tij, kështu që e ka ndier mëshirën dhe dorën e mirësisë së All'llahut mbi kokën e saj.

Ndërsa përsa i përket periudhës së shtatzënisë së Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe sa kohë zgjati, në mesin e komentuesve ka shumë për të thënë, edhe pse në Kur'an është cituar në mënyrë të mbyllur.

Disa janë të mendimit se shtatzënia ishte një orë, disa nëntë orë, disa gjashtë muaj, disa shtatë muaj, disa tetë muaj dhe të tjerë

mendojnë nëntë muaj, si të gjitha gratë e tjera. Por kjo çështje nuk është se ka një ndikim të madh në këtë tregim.

Përsa i përket kësaj çështjeje, janë transmetuar hadithe të shumta.

Por vendi, ku ajo qëndroi, ku ishte? Shumë komentues janë të mendimit se vendqëndrimi i Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte Nazareti. Ndoshta ajo, në atë qytet, ka qëndruar vazhdimisht në shtëpi dhe shumë pak dilte jashtë.

Pasi mbaroi periudha e shtatzënisë, nisi një tjetër tufan i ri për Hazreti Merjemen (*Paqja qoftë mbi të!*), ajo e lindjes. Filluan dhimbjet e rënda të lindjes. Ajo kishte dhimbje aq të mëdha, saqë ecte nga një vend i shkretë në një tjetër. Vendi ishte i thatë, pa pikë uji.

Në të tilla raste, gratë shkojnë pranë të afërmeve të tyre, ose pranë shoqeve, për të kërkuar ndihmë, që lindja e fëmijëve të tyre të bëhet më e lehtë. Por në rastin e Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte ndryshe, sepse shtatzënia e saj qe ndryshe. Ajo nuk dëshironte ta merrte vesh njeri shtatzëninë e saj. Kur pa se dhimbjet e lindjes po afroheshin, u largua në një vend të shkretë, pa ujë, pa asgjë.

Në Kur'anin e Shenjtë, përsa i përket vendit ku Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) kaloi dhimbjet e lindjes, thuhet se ishte një pemë hurme.

“Dhimbjet e lindjes e detyruan atë që të shkonte te trangu i një hurme.”

Fjala “*xhidhin nehil*” - “*pema e hurmës*”, në këtë rast, ka kuptimin e trungut të pemës së hurmës. Kjo tregon se vetëm trangu i pemës kishte mbetur, ndërsa pjesa tjetër e pemës ishte tharë.¹

Kur Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) u gjend në këtë gjendje, të gjithë qenien e saj e kishte përfshirë trishtimi dhe hidhërimi, ndjeu se iu afrua momenti kur njerëzit do të flisnin për të, ndjeu se u afrua çasti kur njerëzit pa besim do të përballeshin me të. Sa e vështirë ishte për të kjo gjendje! Pa pasur mendjen dhe pa ndier tha: “Ah, sikur të kisha vdekur, para se të më ndodhte kjo gjë, të isha shndërruar në dhë e të isha harruar!”.

“Ajo tha: ‘Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!’”.

Është pak e vështirë për t’u pranuar se Merjemen (*Paqja qoftë mbi të!*) e hidhëronte dhe e trishtonte vetëm çështja e thashethemeve, edhe pse kjo çështje ishte e para që e mbante të ngarkuar mendjen e saj. Përveç kësaj ishin edhe problemet e tjera, si gjendja e shtatzënisë dhe përjetimi i saj, pa asnjë të afërm dhe pa asnjë shoqe e mik, e gjendur e vetme në shkretëtirë, nuk kishte një vend ku të qetësohej apo të pushonte, nuk kishte ujë për të pirë e as ushqim për të ngrënë, nuk kishte asnjë mjet për të vendosur fëmijën, që do të lindte. Të gjitha këto çështje e kishin vendosur Merjemen (*Paqja qoftë mbi të!*) në një situatë të vështirë.

Ka njerëz që thonë se si është e mundur që Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*), me gjithë njohjen që kishte për Krijuesin, me gjithë mirësitë që kishte parë prej Zotit të

¹ Fjala “*xhidhe*” vjen nga fjala “*xhedhe*” dhe ka kuptimin “*pres*” dhe “*ndaj*”.

Madhëruar, të thoshte këtë fjali: “Ah, sikur të kisha vdekur e të isha harruar nën dhë!”.

Ata që kritikojnë kështu, nuk kanë përfytyruar asnjë prej problemeve të saj e as në mendje nuk u ka shkuar se sa probleme po kalonte ajo. Gjendja në të cilën ishte Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe çfarë po kalonte ajo, bënin që ajo ta harronte vetveten.

Por kjo gjendje nuk zgjati shumë. Drita dhe shpresa që ajo kishte në thellësinë e zemrës, ndriçoi. Papritur u dëgjua një zë që i thotë Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*): “Mos u trishto, mendo për mirë! Zoti poshtë këmbëve të tua ka ndërtuar një burim uji, që ti të pish e të pastrohesh me të.”.

“Një zë e thirri nga poshtë: ‘Mos u pikëlllo, se Zoti yt të ka bërë një burim uji poshtë teje!’”

Më pas i thuhet që të ngrejë kokën e të shikojë se si trangu i tharë i hurmës mbushet plot me fruta dhe degët e saj janë plot bukuri. Pas shndërrimit të pemës së hurmës, udhëzohet që të tundë pemën e hurmës e të ushqehet me hurmat e freskëta.

“Shkunde trangun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta!”

Këshillat vazhdojnë njëra pas tjetrës. Më pas këshillohet të hajë nga këto hurma që të marrë forcë. T’i gëzohet fëmijës që po lind.

Dhe nëse shikonte ndonjë njeri që i afrohej, të mos frikësohej, por të rrinte e qetë dhe t’i fliste me shenja, duke i treguar agjërimin me heshtje, për hir të All’llahut.

“Ha, pi dhe qetësohu. Nëse vëren ndonjë njeri, i thuaj: ‘Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.’”

Përfundimisht, nuk është e nevojshme që ti të mbrosh veten, Ai që të ka dhënë Ty këtë fëmijë, e ka marrë vetë përsipër mbrojtjen tënde.

Ndaj qëndro e qetë për çdo gjë dhe mos rri e trishtuar, mos lër që në zemrën tënde të qëndrojë trishtimi. Kjo gjë i dha qetësi Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*). Zemra e saj u gëzua. Nga një gjendje shumë e trishtuar, kaloi në gjendje të qetë.

Hulumtime

Ngjarjet që kaloi Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) përgjatë kësaj periudhe të shkurtër, si dhe skenat e bekimit që ajo kaloi, ishin prej mirësisë së All’llahut të Madhëruar. Padyshim, të gjitha këto ngjarje po përgatishnin një profet që do të vinte me libër qiellor. E në këtë mënyrë, do të mund të kryente sa më mirë detyrën materiale të saj.

Ajo e kaloi deri në çastin e fundit rrugën e problemeve, saqë nuk shikonte edhe një hap midis fundit të jetës. Por letra u kthye papritur dhe gjithçka, me ndihmën e All’llahut, u rregullua. Ajo u vendos në një vend të qetë dhe të sigurt nga të gjitha anët.

Fjala që e urdhëron Merjemen (*Paqja qoftë mbi të!*), që të godasë pemën e hurmës e të ushqehet prej saj, është fjali mësimdhënëse për të gjithë njerëzit, që të mos heqin dorë nga përpjekjet, edhe në momentin e fundit të jetës së tyre.

Kjo fjalë është përgjigje për ata që mendojnë se çfarë nevojë kishte Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*), që, në atë gjendje, të ngrihej e të tundte pemën e hurmës.

A nuk do ishte më mirë që All'llahu, me urdhër të Tij, të bënte që burimi i ujit të ishte pranë saj e hurmat të binin me urdhër të Zotit nëpërmjet një filladi?

Çfarë ngjau që u ndryshua situata, kur Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte shëndoshë e mirë, kur ajo falej e lutej, frutat i vinin pranë saj, ndërsa tani, kur ajo ndodhet përballë një tufani, duhet t'i këpusë vetë frutat?!

Kjo gjë tregon Urdhrin e All'llahut. All'llahu i Madhëruar i tregon Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*) se, nëse nuk lëviz, nuk do të ketë bereqet. Me fjalë të tjera, nëse dikush gjendet para vështirësisë, nëse nuk përpiqet apo nuk arrin rezultatet e dëshiruara, apo nuk ka fuqinë për ta zgjidhur problemin, atëherë, të paktën, të kërkojë ndihmën e All'llahut.

Përse Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) kërkoi vdekjen nga All'llahu?

Padyshim, që t'i kërkosh vdekjen Zotit, nuk është punë e drejtë. Ndonjëherë njeriu kalon ngjarje të vështira dhe të hidhura, të cilat ia hidhërojnë jetën, sidomos kur nuk mund të mbrojë qëllimet e tij të shenjta apo ndershmërinë e tij. Në të tilla raste,

ndonjëherë, për t'u çliruar nga torturat shpirtërore, kërkojmë vdekjen.

Edhe Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) u gjend në një situatë shumë të vështirë. Nuk dinte si t'i përballonte thashethemet e njerëzve, do të turpërohej në mesin e njerëzve me lindjen e fëmijës, ndaj dhe kërkoi nga Zoti vdekjen, që të harrohej. Argumenti i saj ishte se donte ndershmërinë dhe dëlirësinë para shpirtit të saj. Por të tilla mendime, qoftë edhe për një moment të shkurtër, u larguan prej saj, kur All'llahu i dhuroi burimin e ujit dhe pemën e palmës me hurma. Këtu Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) u qetësua dhe fitoi siguri në vetvete.

Përgjigjja e një pyetjeje

Disa pyesin: Nëse mrekullia është e veçantë për Profetët (*Paqja qoftë mbi ta!*) dhe për Imamët (*Paqja qoftë mbi ta!*), atëherë shfaqja e mrekullive të tilla, si ishin për Hazreti Merjemen (*Paqja qoftë mbi të!*)?

Disa komentues, për ta zgjidhur këtë problem, e kanë konsideruar si pjesë e mrekullisë së Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e kanë konsideruar si mrekulli hyrëse. Por unë mendoj se nuk është fare nevoja për të tilla përgjigje, sepse shfaqja e gjërave të jashtëzakonshme te njerëz të tjerë, përveç Profetëve dhe Imamëve, është e mundur dhe ne i quajmë bujari e mirësi.

Mrekulli është ajo që vjen me sfidim dhe fton në mbrojtje, si dhe vjen me pretendimin e të qenit Profet apo Imam, ndërsa kjo është tjetër gjë.

Ditët e agjërimit me heshtje

Ajetet e mësipërme tregojnë se Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*), për shkak të disa mirësive, ishte mirë të heshte dhe me urdhër të All'llahut ajo heshti, derisa djali i saj nisi të flasë për të mbrojtur nënën e tij.

Por, sipas interpretimit të ajetit, kuptohet se të bërit nijet për të agjëruar me heshtje për atë popull dhe vend ishte diçka e njohur, ndaj edhe ata nuk e kritikuan Hazreti Merjemen (*Paqja qoftë mbi të!*) për këtë gjë.

Por ky agjërim, në rregullat islame, nuk është i ligjshëm.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Ali bin Hysejn (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: “Agjërimi me heshtje është haram.”. Kjo për shkak të ndryshimit të kushteve të asaj periudhe me periudhën e ardhjes së Islamit. Një nga rregullat e të agjëruarit në fenë islame është që njeriu duhet të agjërojë me të gjitha shqisat. Po ashtu, në një hadith të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: “Nuk është agjërim vetëm të mos hash e të mos pish. Kur agjëroni, agjëroni edhe me gjuhë, edhe me sy. Të mos keni xhelozë dhe të mos ngatërroheni.”.¹

Përse All'llahu i Madhëruar përzgjedhi hurmën si ushqim për Hazreti Merjemen (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të porsalindurin e saj? Komentuesit e Kur'anit, përse i përket këtij ajeti, janë të mendimit se hurma është një ndër ushqimet më të mira për gratë pas lindjes.

¹ “Vesailush Shiah”, vëll. 7, f. 390; “Alul Beit”, vëll. 10, f. 513.

Po ashtu, në hadithe është cituar kjo çështje: “Imam Ali ibn ebi Talibi (*Paqja qoftë mbi të!*) transmeton nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “*Gruaja pas lindjes, të parën gjë që duhet të hajë, është hurma*”. Prandaj All'llahu i Madhëruar i tha Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta!*”.¹

Nga ky hadith kuptohet se të ngrënit e hurmave pas lindjes jo vetëm për nënën është e nevojshme dhe e dobishme, por është shumë e dobishme edhe për qumështin e saj.

Po ashtu, në një pjesë të transmetimeve, përsa i përket këtij rasti, thuhet se ushqimi më i mirë për gratë gjatë shtatzënisë dhe pas lindjes, është hurma.²

Por sigurisht, në të gjitha rastet, përmbajtja është e nevojshme në të ngrënë.

Po ashtu, nëse nuk gjenden hurma të freskëta, mund të përdoren edhe hurma të zakonshme.

Shkencëtarët ushqimorë thonë: Sheqeri që ndodhet në hurmë, është sheqeri më i shëndetshëm. Në shumë raste, personat që vuajnë nga sëmundja e sheqerit, mund t'i përdorin hurmat. Po këta shkencëtarë thonë se te hurma janë gjendur trembëdhjetë burime jete dhe pesë lloje vitaminash. Ndaj për këtë arsye hurma konsiderohet si fruti që përmbledh një shumicë burimesh ushqimore.³

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 330.

² “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 330.

³ Marrë nga libri “Avelin Daneshgah ve Aherin Pejgamber”, vëll. 7, f. 65.

Po ashtu, dihet se, gratë pas lindjes, kanë shumë nevojë për ushqim të shëndetshëm dhe të fortë, i cili të përmbajë proteina e vitamina. Me zhvillimin dhe përparimin e dijes dhe të shkencës së mjekësisë është parë me rëndësi mjekimi që bën hurma. Ajo përmban shumë kalcium, i cili ndikon shumë në forcimin e kockave. Gjithashtu, përmban fosfor, i cili është një nga përbërësit kryesorë për formimin e trurit, si dhe është parandalues i lodhjes dhe i krizave mendore. Po ashtu, te hurma gjendet edhe potasi, i cili është i nevojshëm për stomakun. Kur potasi humbet, shkaktohet ulcera.¹

¹ Marrë nga libri “Avelin Daneshgah ve Aherin Pejgamber”, vëll. 7, f. 65.

Ajetet 27 - 33

فَأَتَتْ بِهِ قَوْمَهَا تَحْمِلُهُ ۖ قَالُوا يَمْرِئٌ لَقَدْ جِئْتَ شَيْئًا فَرِيًّا ﴿٢٧﴾
يَأْتُحَتَّ هَدْرُونَ مَا كَانَ أَبُوكِ امْرَأَ سَوْءٍ وَمَا كَانَتْ أُمُّكِ بَغِيًّا ﴿٢٨﴾ فَأَشَارَتْ
إِلَيْهِ قَالُوا كَيْفَ نُكَلِّمُ مَنْ كَانَ فِي الْأَمْهِدِ صَبِيًّا ﴿٢٩﴾ قَالَ إِنِّي عَبْدُ اللَّهِ
ءَاتَنِي الْكِتَابَ وَجَعَلَنِي نَبِيًّا ﴿٣٠﴾ وَجَعَلَنِي مُبَارَكًا أَيْنَ مَا كُنْتُ
وَأَوْصَانِي بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ مَا دُمْتُ حَيًّا ﴿٣١﴾ وَبَرًّا بِوَالِدَتِي وَلَمْ يَجْعَلْنِي
جَبَّارًا شَقِيًّا ﴿٣٢﴾ وَالسَّلَامُ عَلَيَّ يَوْمَ وُلِدْتُ وَيَوْمَ أَمُوتُ وَيَوْمَ أُبْعَثُ حَيًّا



“Dhe u kthye te populli i vet, duke mbajtur fëmijën. Ata i thanë:
‘O Merjeme, ke bërë diçka të turpshme!’”

“O motra e Harunit! Babai yt nuk ka qenë njeri i keq, as nëna
jote nuk ka qenë grua e shthurur.”

“Ajo bëri me shenjë nga i biri. Ata thanë: ‘Si t’i flasim ne
fëmijës që është në djep?’”

“Ai (Isai në djep) tha: ‘Unë jam rob i All’lilaut. Ai më ka dhënë
Librin (Ungjillin), më ka bërë Profet’”,

“dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zekat sa të jem gjallë”,

“dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm.”

“Le të jetë paqja e shpëtimi mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallem!”

Komentimi

Isai flet në djep

Si përfundim, Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*), duke mbajtur fëmijën në krahë, u kthye nga shkretëtira dhe erdhi në qytet, te të afërmit dhe familjarët e saj.

“Dhe u kthye te populli i vet, duke mbajtur fëmijën.”

Kur ata e panë Hazreti Merjemen (*Paqja qoftë mbi të!*) me fëmijë në krahë, mbetën gojëhapur nga habia. Të gjithë e njihnin Hazreti Merjemen (*Paqja qoftë mbi të!*) për ndershmërinë dhe për devotshmërinë që kishte. Po ashtu, ishin shumë të njohura dhuntitë e saj. Të gjitha këto bënë që ata të shqetësoheshin, saqë disa filluan të dyshonin shumë. Të tjerë nxituan ta gjykojnë, duke i thënë: “Sa keq! Vajti dëm e gjithë puna e bërë në të kaluarën! Me këtë që bëre, prishe gjithçka! Keq, shumë keq që u përlyve në këtë mënyrë!”.

“Ata i thanë: ‘O Merjeme, ke bërë diçka të turpshme!’”¹

Të tjerë i kujtuan Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*) ndershmërinë e familjarëve të saj, duke kujtuar mirësinë e babit të saj. Ndërsa për nënën, i kujtuan asaj pastërtinë morale. Duke pasur të tillë prindër, ç’ishte kjo që bëre?! Ç’të keqe pe nga rruga e prindërve të tu, që ua ktheve shpinën?!

“O motra e Harunit!² Babai yt nuk ka qenë njeri i keq, as nëna jote nuk ka qenë grua e shthurur.”

Përsa i përket çështjes se si e thirrën Hazreti Merjemen (*Paqja qoftë mbi të!*): **“O motra e Harunit!”**, shumë komentues janë të mendimit se Haruni ishte burrë i ndershëm, i bindur e i mirë. Në mesin e Beni Izraelitëve ishte bërë si fjalë e urtë, që të përshkruhej një njeri i mirë me emrin e Harunit. Ata, kur shikonin një njeri të mirë, në të gjitha sjelljet, e përshkruanin duke e krahasuar me Harunin, qoftë mashkull apo femër.

Këtë kuptim e hasim në një hadith të shkurtër të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi*

¹ Fjala “ferija”, sipas Ragibit, në librin e tij “Mufredat” ka kuptimin “e madhe”, “e çuditshme” apo “gjë e ndërtuar”. Në origjinal, fjala “feri” ka kuptimin “të heqësh lëkurën për ta riparuar atë”.

² D.m.th. “O grua e virtytshme”. Meqenëse Haruni është një Profet i nderuar, i përmendur në Kur’an dhe, meqenëse Hazreti Merjemja rridhte nga fisi i tij, ajo thirret me shprehjen: **“O motra e Harunit”**. Në arabisht dhe, në përgjithësi, në gjuhët semitike (hebraisht, armenisht, etj.) shprehje të tilla idiomatike, si: “O babai i ...”, “O biri i ...”, “O vëllai i ...” etj., nuk nënkuptojnë një lidhje të drejtpërdrejtë gjaku, por përdoren për të treguar një përkatësi fisnore, ose një përkatësi fisnike.

familjen e tij!), cituar nga i ndjeri Tabersi, në librin “Mexhmaul Bejan”.¹

Në një hadith tjetër, që është sjellë në librin “Seadul Seud” thuhet: “Profeti (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) kishte dërguar Mugiren në Nexhran për të ftuar të krishterët në fenë islame. Kur ai vajti atje, disa nga të krishterët e kritikuan (për ta ofenduar), duke i thënë: ‘A nuk thoni ju në librin tuaj se Hazreti Merjemja (Paqja qoftë mbi të!) është motra e Harunit?! Ndërkohë që ne e dimë se ajo nuk ka asnjë lidhje me Harunin, vëllain e Musait (Paqja qoftë mbi të!), pra, ka shumë largësi midis tyre.’”. Mugire nuk mundi të përgjigjej vetë dhe për këtë pyeti Profetin (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Profeti (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i përgjigjet: “Përse nuk u the se në mesin e Beni Izraelitëve ishte traditë të thirrreshin kështu?!”.²

Kur Hazreti Merjemen (Paqja qoftë mbi të!) po e pyesin të gjithë, ajo nuk u ktheu përgjigje, por heshti, duke bërë me shenjë kah foshnja e saj, që ta pyesin atë. **“Ajo bëri me shenjë nga i biri.”**

Por kjo gjë ata i habiti edhe më shumë. Shumë prej tyre u nevrifikosën, duke thënë se Hazreti Merjemja (Paqja qoftë mbi të!), edhe pse ka gabuar dhe ka bërë punë të shthurur, kërkon të tallet me ne.

Gjithsesi, ata i thanë se si mund t’i flasim ne një foshnjeje të vogël, të porsalindur.

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 333.

² “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 333.

“Ata thanë: ‘Si t’i flasim ne fëmijës që është në djep?’

Komentuesit kanë diskutuar shumë, për kuptimin e fjalës “*kane*”, e cila nënkupton kohën e shkuar. Por në këtë rast duket se nënkupton nevojshmërinë e përshkrimit. Me fjalë të tjera, ata i thanë më qartë Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*): **“Si mund të flasim me një foshnjë të sapolindur?”**. Këtë gjë e dëshmojnë më së miri ajetet e tjera të Kur'anit: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni All’llahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.”**.

Fjala “*kuntum*” - “*ishit*”, në këtë rast, nuk ka kuptimin e kohës së shkuar, por tregon vazhdimësi dhe qëndrueshmëri. Këto janë cilësi për shoqërinë islame.

Po ashtu, është diskutuar edhe për djepin. Profeti Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) akoma nuk ishte vendosur në djep. Pamja e jashtme e ajeteve tregon se, kur Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) u fut në mesin e njerëzve, mbante në krahë Isain (*Paqja qoftë mbi të!*).

Duke u bazuar te fjalori arab, për kuptimin e fjalës “*djep*” është e qartë përgjigjja e kësaj pyetjeje. Ragibi, në fjalorin e tij “Mufredat”, e shpjegon kështu këtë fjalë: “Djep është vendi ku vendoset fëmija i sapolindur, qoftë ky vetë djepi apo prehri dhe krahu i nënës. Pra, fjala “*djep*”, në të dy rastet, ka kuptimin “*vend për t’u rehatuar*”.

Kur grumbulli i njerëzve e dëgjoji këtë fjalë nga Hazreti Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*), u shqetësua dhe u nevrikos shumë.

Por ajo çka i shqetësoi ata më shumë, sikurse shikohet në disa prej transmetimeve, është çështja e nderit.

Por kjo gjendje nuk zgjati shumë, sepse foshnja e sapolindur nisi të flasë: “Unë jam rob i Zotit, Zoti më ka dhënë mua Libër Qiellor e më ka përcaktuar Profet. Zoti më ka dhuruar një qenie plot me mirësi. Më ka këshilluar për namaz e për dhënie zekati sa të jem gjallë. All’llahu më ka dhuruar mirësi, vlerësim dhe dashamirësi ndaj nënës sime. Zoti nuk më ka bërë prej të dhunshmëve.

Gjithashtu, All’llahu më ka thënë se jam prej popullit më të mirë dhe rrjedh nga shoqëria më e mirë e njerëzimit.”.

“Ai (Isai në djep) tha: ‘Unë jam rob i All’llahut. Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin), më ka bërë Profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zekat sa të jem gjallë dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm.”

“*Xhebar*” i thonë një personi që pretendon shumë nga të tjerët, por vetë nuk zbaton asnjë lloj të drejte.

Po ashtu “*xhebar*” i thonë edhe një personi që qëllon të tjerët nga zemërimi dhe i zhduk ata, duke mos pasur në kontroll mendjen e tij; ose dëshiron t’i fshehë mangësitë e tij, duke pretenduar se është udhëheqës dhe ecën me mendjemadhësi. Të

gjitha këto janë cilësi të tiranëve dhe të arrogantëve, të cilët janë në çdo kohë.¹

Ndërsa “sheki” i thonë një personi që e përgatit vetë terrenin e dënimit dhe të belave.

Të tjerë janë të mendimit se “sheki” është ai person që nuk pranon të këshillohet. Të dyja këto kuptime nuk janë të ndara nga njëra-tjetra.

Në një transmetim lexojmë: “Profeti Isa (Paqja qoftë mbi të!) thotë: ‘Zemra ime është e butë dhe unë jam prej të bindurve.’”²

Më pas, foshnja e sapolindur thotë se “paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi mua ditën që linda, ditën që do të vdes dhe ditën që do të ngrihem i gjallë”.

“Le të jetë paqja e shpëtimit mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallem!”

Sikurse thamë edhe në komentim e ajeteve që flisnin për Profetin Jahja (Paqja qoftë mbi të!), këto tre ditë janë tre ditët më të vështira të jetës së tij. Në këto tre ditë shkruhet e ardhmja e njeriut, prandaj janë edhe ditët më të vështira. Shëndeti dhe mirësia e këtyre tre ditëve është vetëm me mirësinë e All’llahut. Ndaj kjo fjali është cituar edhe për Profetin Jahja (Paqja qoftë mbi të!), edhe për Profetin Isa (Paqja qoftë mbi të!). I vetmi ndryshim është se në rastin e parë, All’llahu e thotë këtë fjalë dhe në rastin e dytë bën këtë kërkesë.

¹ Për të shpjeguar edhe më shumë fjalën “xhebar” dhe për t’iu përgjigjur pyetjes se përse një nga cilësitë e All’llahut është “Xhebar”, mund të shikoni vëllimin 9, të tefsirit “Nemune”.

² Tefsiri “Fahri Razi”, në vazhdim të ajetit që folëm.

Hulumtime

Pasqyrimi më i mirë i lindjes së Profetit Isa (Paqja qoftë mbi të!)

Elokuenca e përdorur në Kur'anin e Shenjtë, në raste të tilla të rëndësishme, është mjaft e pëlqyeshme. All'llahu i Madhëruar e trajton në mënyrë të bukur, elokumente çështjen e lindjes së Profetit Isa (Paqja qoftë mbi të!), që thashethemet e çfarëdolloj hipoteze tjetër, në lidhje me këtë ngjarje, të qartësohen një herë e mirë.

Është për t'u habitur se si në ajetet e mësipërme janë cituar shtatë cilësi, dy programe dhe një lutje. Këto shtatë cilësi janë: Të qenit rob i Zotit, citimi i tij në fillim të çdo cilësie. Pozita më e lartë e njeriut është pozita e të qenit "rob".

Një tjetër cilësi e tij është të pasurit e "Librit Qiellor". Më pas pozita e të qenit "Profet". (Dimë se të pasurit pozitën e Profetit, nuk do të thotë se duhet të kesh edhe Librin Qiellor).

Një cilësi tjetër e përmendur për Profetin Isa (Paqja qoftë mbi të!) është "udhëheqja". Ai ishte njeri "i bekuar" dhe "i dobishëm" për gjendjen e shoqërisë.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) lexojmë: "*Kuptimi i fjalës 'i bekuar', në këtë rast është të kesh shumë mirësi.*".

Më pas është cituar cilësia e "butësisë", sidomos me nënën e tij. Pra, ai nuk është as i dhunshëm e as tiran, por shumë i butë. Ai është fatlum e njohës i së vërtetës.

Midis të gjitha programeve që ekzistojnë në këtë ajet, janë këshilluar dy prej tyre, “namazi” dhe “zekati”. Është mbështetur te këto dy programe, sepse kanë një rëndësi shumë të madhe. Ato janë sekreti i marrëdhënies së Krijuesit me krijesën. Po ashtu, nga ana tjetër, mund ta përshkruajmë të gjithë programin fetar te këto dy raste, sepse një pjesë e saj ka të bëjë me lidhjen e njeriut me Krijuesin, kurse pjesa tjetër ka të bëjë me krijesat.

Edhe lutjen që e bën për veten, kërkesën që ka për fillimin e jetës, për ditën që do të vdesë dhe për ditën kur do të ringjallet, të tre këto kërkesa janë për të qenë i sigurt dhe i përfshirë në mëshirën e All'llahut.

Pozita e nënës

Edhe pse Profeti Isa (*Paqja qoftë mbi të!*), me urdhër të All'llahut, lindi pa baba, ai tregon jo vetëm krenarinë e tij në mënyrën më të përkryer për nënën e tij, por edhe mirësinë ndaj saj. Kjo gjë është një argument i qartë, përse i përket pozitës së nënës.

Po ashtu tregon se ky fëmijë, foshnjë i sapolindur, është një mrekulli, që tregon një të vërtetë, që vetë ai është një fëmijë shembull në mesin e njerëzve, që është i lindur nga nëna, pa baba.

Gjithsesi, edhe pse në botën e sotme flitet shumë për pozitën e nënës, duke i caktuar asaj edhe një ditë të veçantë, “Ditën e gruas”, fatkeqësisht gjendja e qytetërimit është një makinë e tillë, që marrëdhënien e baballarëve dhe të nënave e ndërpresin shumë shpejt fëmijët e tyre. Kjo gjë shikohet kur ata

rriten dhe kanë shumë më pak marrëdhënie emocionale midis tyre.

Po ashtu, ne kemi një transmetim shumë të habitshëm për këtë çështje: “Myslimanët këshillohen që të përpiqen për prindërit e tyre, jo vetëm me të folur, por edhe në vepra.”

Në një hadith të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: “U afrua një burrë pranë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thotë: ‘O i Dërguari i All’llahut! Kujt t’i bëj mirësi? Cilit person t’i bëj mirë?’

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: ‘Nënës tënde!’

Burri e pyeti sërish: ‘Po pas nënës, kujt t’i bëj mirësi?’

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përsëri tha: ‘Nënës!’

Përsëri ai e pyeti: ‘Po pas nënës?’

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përsëri tha: ‘Nënës!’

Kur e pyeti për herë të katërt, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: ‘Babait!’¹

Në një tjetër hadith lexojmë: “Një djalë i ri u afrua pranë Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i kërkoi për të marrë pjesë në xhihad. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pyeti: ‘E ke nënën?’

¹ “Vesailush Shiah”, vëll. 15, f. 207 (vëll. 21, f. 491, botim i “Ehli Bejtit”)

Djali iu përgjigj: 'Po.'

*Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: 'Qëndro pranë nënës, sepse Xhenneti është poshtë këmbëve të nënës.'"*¹

Padyshim që përpjekjen dhe mundin që bën nëna përgjatë shtatzënisë, përgjatë periudhës së dhënies së gjirit dhe derisa fëmija rritet janë të panumërta. Ajo duron shumë vuajtjet, pagjumësinë, kujdesin e shumë e shumë mundime të tjera. Sado që njeriu të përpiqet, nuk mund t'ia shpërblejë mundin nënës së tij. Gjithmonë do të jetë borxhli ndaj saj.

Është për t'u habitur ajo që lexojmë në një hadith: "Umi Seleme vajti pranë Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i tha: 'Të gjitha krenaritë u janë bërë kismet vetëm burrave. Gratë e shkreta, çfarë pjesa kanë për t'u krenuar?'

Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: 'Edhe gratë kanë me se të krenohen. Kur janë shtatzanë, ato, për gjatë gjithë shtatzanisë, kanë mirësinë sikur kanë agjëruar, sikur të rrinin zgjuar natë e ditë dhe sikur të jenë duke bërë xhihad natë e ditë, me shpirt dhe me pasurinë e tyre. Kur ato janë shtatzana, Zoti u fal aq shumë mirësi, saqë askush nuk e di masën dhe madhështinë e mirësive. Kur ato i ushqejnë fëmijët e tyre me qumështin e gjirit, All'llahu, për secilën thithje që bën fëmija, u jep shpërblim sikur të kishin çliruar një rob nga fëmijët e Ismailit (Paqja qoftë mbi të!). Kur kjo periudhë mbaron, periudha e dhënies së qumështit, një prej engjëjve të mëdhenj të All'llahut vjen pranë saj dhe e qëllon në shpatull, duke i thënë

¹ "Xhamel Seadat", vëll. 2, f. 261.

se programi i veprave të tua nis nga fillimi, sepse All'llahu i fal të gjitha mëkatet!" (Duket sikur Libri¹ veprave nis nga fillimi).

Këtë diskutim e kemi pasur në vëllimin e dymbëdhjetë të tefsirit "Nemune" të komentimit të përkryer të Kur'anit të Shenjtë, në vazhdim të sures "Isra", në ajetin 23.

Një tjetër pyetje që lind nga ajetet e mësipërme, është lindja e një fëmije nga një e virgjër. Sipas shkencës, a është e mundur të lindë një fëmijë pa pasur baba?

A mos vallë, çështja e lindjes së Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) vetëm nga nëna është në kundërshtim me kërkimet e shkencëtarëve përreth kësaj fushe?

Në përgjigje duhet të themi: Padyshim që kjo çështje është prej mrekullive. Por as shkenca e këtyre ditëve nuk e ka mohuar këtë gjë. Ajo çka ata nuk kanë mundur të bëjnë, ka qenë përfytyrimi i saj. Veçanërisht çështja e lindjes së fëmijës nga një femër e virgjër është e papërfytyruar.

Kjo çështje, e vënë përballë ligjeve të krijimit dhe fuqisë së All'llahut, është ashtu si thuhet në Kur'an: **"Rasti i Isait për All'llahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: 'Bëhu!' - dhe ai u bë."**²

Ademi u krijua nga balta dhe më pas atij iu dha urdhër që të ishte genie dhe Ai u bë genie e plotë.

¹ "Vesailush Shiah", vëll. 15, f. 175.

² Sure "Ali Imran", ajeti 59.

Si mund të flasë një i sapolindur?

Është e qartë dhe e dukshme që asnjë foshnjë nuk flet në orët e para apo në ditët e para të lindjes. Që të flasë fëmija, truri i fëmijës duhet të ketë zhvillim të mjaftueshëm. Muskujt e gjuhës, si edhe laringu duhet të jetë i aftë për këtë gjë.

Po ashtu, edhe pjesët e tjera të trupit duhet të jenë në përputhje me njëra-tjetrën. Për t'u zhvilluar muskujt dhe çka u tha më lart te një foshnjë, duhet të kalojnë muaj, që ato të marrin formën e duhur. Nuk kemi asnjë argument që kjo gjë të jetë e pamundur. Kjo është vetëm një gjë e pazakontë. Prandaj edhe mrekullitë janë të tilla, që do të thotë se, të gjitha gjërat e jashtëzakonshme, nuk janë të paarritshme. Këtë çështje e kemi trajtuar më gjerësisht te mrekullitë e Profetëve (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Ajetet 34 - 36

ذَٰلِكَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ ۚ قَوْلَ الْحَقِّ الَّذِي فِيهِ يَمْتَرُونَ ﴿٣٤﴾ مَا كَانَ لِلَّهِ
 أَنْ يَتَّخِذَ مِنْ وَلَدٍ ۚ سُبْحَانَهُ ۚ إِذَا قَضَىٰ أَمْرًا فَإِنَّمَا يَقُولُ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ
 وَإِنَّ اللَّهَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَأَعْبُدُوهُ هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ ﴿٣٥﴾

“Ky është Isai, i biri i Merjemes. Kjo është fjala e vërtetë, për të cilën ata dyshojnë dhe diskutojnë.”

“All’llahu nuk ka mbetur të marrë dikë për bir. Qoftë i lavdëruar Ai! Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të ‘Bëhu!’ dhe ajo bëhet.”

“(Isai tha): ‘Vërtet, All’llahu është Zoti im dhe Zoti juaj; andaj adhuroni vetëm Atë! Kjo është udha e drejtë.’”

Komentimi

A është e mundur të ketë fëmijë Zoti?!

Pas përshkrimit të qartë të ngjarjes së lindjes së Profetit Isa (Paqja qoftë mbi të!), do të mohojmë paragjykimet dhe mendimet që

të çojnë në shirk për Profetin Isa (*Paqja qoftë mbi të!*). Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: **“Ky është Isai, i biri i Merjemes.”**

Në këtë ajet theksi vendoset te mëmësia e Isait, djali i Hazreti Merjems (*Paqja qoftë mbi të!*), duke mohuar kështu faktin që Zoti i Madhëruar ka fëmijë. Më tej shton: **“Kjo është fjala e vërtetë, për të cilën ata dyshojnë dhe diskutojnë.”**

Këto janë fjalë të vërteta. Ata që dyshojnë po hedhin hapa në rrugën e devijuar.

“All’Ilahu nuk ka mbetur të marrë dikë për bir. Qoftë i lavdëruar Ai! Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të ‘Bëhu!’ dhe ajo bëhet.”

Ky ajet thekson vërtetësinë për gjithçka u tha më parë për Profetin Isa (*Paqja qoftë mbi të!*). Në të nuk ka asnjë kundërshtim.

Kur’ani, shprehjen: **“Ata dyshojnë dhe diskutojnë”**, e drejton për shokët dhe armiqët e Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*). E thënë ndryshe, janë të krishterët dhe jehudinjtë.

Nga ana tjetër, një grup i humbur dhe i devijuar, dyshoi te ndershmëria e nënës së tij. Të tjerë shprehën dyshim nëse ai është njeri apo jo. Këto grupe u transformuan në degëzime. Një palë e quajti Isain (*Paqja qoftë mbi të!*) djalë të Zotit (pra, bir i Zotit në të gjitha aspektet, jo vetëm në aspektin virtual. Më tej lindi edhe çështja e trinitetit dhe u krijuan tre Zota.

Disa e konsideruan si të pakuptimtë çështjen e trinitetit dhe besuan se duhet ta pranojmë atë si tabu.

Të tjerë, për t' u justifikuar logjikisht, nisën të flisnin fjalë të pabazuara. Me pak fjalë, ata, duke mos parë të vërtetën, ose duke mos e dëshiruar të vërtetën, nisën të trillonin.¹

Për këtë All'Ilahu u përgjigjet në ajetin 35 dhe 36 të cilat i kemi objekt studimi.

“All'Ilahu nuk ka mbetur të marrë dikë për bir. Qoftë i lavdëruar Ai! Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të 'Bëhu!' dhe ajo bëhet.”

“(Isai tha): ‘Vërtet, All'Ilahu është Zoti im dhe Zoti juaj; andaj adhuroni vetëm Atë! Kjo është udha e drejtë.’”

Kjo tregon se ajo çka pretendonin dhe mendonin të krishterët, përsa i përket Krijuesit për të pasur fëmijë, nuk është aspak në përputhje me pozitën e All'Ilahut. Nëse do të ishte e tillë, do të ishte e nevojshme që të ishte trup. Nga ana tjetër, do të ishte i kufizuar.

Si përfundim, Zoti nuk do të kishte pozitën e shenjtërisë. Do të ishte i njëjtë me ligjet e botës materiale, si dhe do të trajtohej si një qenie e dobët dhe e kufizuar materialiste.

Zoti, i cili ka gjithë këtë fuqi, kur dëshiron një gjë, e bën, edhe sikur të ketë me mijëra botë si kjo.

A nuk është devijim dhe shirk (të bërit shok, të ngjashëm) që ne ta konsiderojmë Zotin të njëjtë me njerëzit, duke menduar se Zoti ka fëmijë, duke i dhënë pozitën e babait?

¹ Për të ditur më shumë rreth trinitetit, si dhe trillimeve që janë kryer për këtë çështje, shikoni vëllimin e katërt të “Komentimit të Përkryer”, si dhe ajetin 171 të sures “En Nisa”.

Shprehja: **“Bëhu!”**, në Kur'anin e Shenjtë është cituar në tetë ajete. Kjo tregon pasqyrimin shumë të gjallë të fuqisë dhe të pushtetit të All'llahut në krijim.

Hulumtime

Mohimi i të pasurit fëmijë, është mohim për çfarëdolloj nevoje nga Zoti

Në parim, përse krijesat e gjalla kanë nevojë për fëmijë? Kjo vjen ngaqë jeta e tyre është e kufizuar. Ndaj, për të mos u zhdukur gjenerata dhe jeta e re, është e nevojshme të ketë vazhdimësi lindja e fëmijëve.

Nga ana tjetër, shoqëria ka nevojë për forca më të mëdha njerëzore për të kryer punë të ndryshme, ndaj edhe njerëzit dëshirojnë të kenë sa më shumë fëmijë.

Përveç nevojës emocionale dhe shpirtërore, një tjetër dëshirë për të pasur fëmijë është dhe largimi i vetmisë.

Por a mund të kemi të njëjtin perceptim për Krijuesin e gjithësisë? Ai nuk ka nevojë as për dashuri e as për ndihmë, janë larg Tij të gjitha këto, sepse qenia e Tij është e pastër, Ai është i përhershëm dhe i pafundmë.

Ata që menduan se Krijuesi ka fëmijë, e krahasuan Krijuesin me veten e tyre dhe panë se Ai atë çka shohin te vetja e

tyre, ndërkohë që asgjë e jona nuk është e ngjashme me Krijuesin tonë.¹

Një shënim i rëndësishëm historik

Kur ndodhi emigrimi i parë i myslimanëve, një grup prej tyre, si burra ashtu edhe gra, u drejtuan drejt tokës së Etiopisë, për t'i shpëtuar kthetrave të jobesimtarëve të kurejshëve. Gjithashtu po përgatiteshin sa më shumë për programin e ardhshëm islam.

Ata e braktisën Mekën për t'u vendosur në Etiopi, ashtu siç e kishin paramenduar, ata mund të jetonin në qetësi. Ata nisën të ndjekin programin islam dhe iu përkushtuan edukimit islam.

Kryetarët e kurejshëve në Mekë dëgjuan për migrimin e këtyre myslimanëve dhe u frikësuan se ata do të kthehen në Mekë, pasi të forcohen dhe kështu do të sillnin shumë probleme. Kështu ata u këshilluan me njëri-tjetrin dhe vendosën të përzgjedhin dy burra prej tyre, të cilët ishin shumë aktivë. I dërguan drejt Etiopisë, që t'i bindnin udhëheqësit e atij vendi për t'i dëbuar myslimanët nga toka e tyre.

Kështu Omer bin As dhe Abdullah ibn ebi Rabijeh u ngarkuan me dhurata të shumta dhe morën rrugën drejt Etiopisë, që të bindnin mbretin e Etiopisë, që t'i largojë myslimanët nga vendi i tij.

¹ Përsa i përket kuptimit të fjalës “*kun fejekun*” - “*bëhu*” dhe argumenteve të mohimit të prindërimit të Zotit, mund të shikoni vëllimin e parë të tefsirit “*Nemune*”, në vazhdim të ajeteve 116-117 të sures “*El Bekare*”.

Umi Seleme, bashkëshortja e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tregon: “Kur ne u futëm në tokën e Etiopisë, u përballëm me kulturën dhe sjelljen e etiopianëve. Ata nuk na kufizuan për asgjë, nuk na bezdisnin kur ndiqnim ritet tona të fesë. Por kur kurejshët dëgjuan për këtë gjë, nisën dy persona, plot dhurata, me qëllim që të bindnin mbretin e Etiopisë për të na dorëzuar te ata, pa thënë asnjë fjalë!

Ata e kryen detyrën e tyre me shumë kujdes, duke u thënë se këtu ka ardhur një grup njerëzish nga Meka, me një fe tjetër e që duan ta praktikojnë e ta përhapin edhe në vendin e tyre. Kjo fe, edhe për ne, edhe për ju, është e panjohur. Të mëdhenjtë e kurejshëve ne na kanë dërguar këtu që t'i ndalojmë këta njerëz dhe t'i kthejmë në vendin e tyre. Ata i kishin marrë besën një prej udhëheqësve, se, nëse mbreti do të kërkonte të këshillohej me të për të dëbuar mekasit, ai do ta miratonte këtë gjë. Kështu, të dërguarit kurejsh, kur u paraqitën pranë mbretit të Etiopisë, nisën dhe thanë mendimet e tyre. Të gjithë po i dëgjonin fjalët e tyre dhe i panë dhuratat që kishin sjellë. Po u ecte mirë loja. Por nuk zgjati shumë, sepse mbreti nuk pranoi kërkesën e tyre. Ai tha se këta njerëz kanë kërkuar mbrojtje nga unë, përzgjedhën vendim tim dhe nuk shkuan në një vend tjetër, kështu derisa t'i studioj se ç'bëjnë dhe me se merren, unë nuk i dëboj nga vendi im. Nëse ata do të jenë ashtu sikurse thoni ju, atëherë unë do t'i dorëzoj te ju. Nëse jo, unë do t'i lë të lirë. Mbreti i Etiopisë dërgoi njerëz që të vijnë myslimanët pranë tij. Myslimanët u këshilluan me njëri-tjetrin se çfarë do të thonë. Vendimi i tyre ishte që të thonë të vërtetën dhe të vepronin sipas urdhrit të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Atë ditë u mbloodhën të gjithë klerikët fetarë të librave të shenjtë. Mbreti i Etiopisë iu drejtua myslimanëve: ‘Ç’është kjo fe që ju keni përzgjedhur dhe jeni ndarë nga populli juaj dhe nuk i jeni bashkuar as fesë sonë?’

Xhafer bin ebi Talibi nisi i pari të flasë: ‘O mbret! Ne ishim në errësirë dhe të paditur, adhuronim idhuj, hanim mish të ngordhur, kryenim punë të këqija, silleshim keq jo vetëm me të afërmit tanë, por edhe më fqinjët. Të gjitha këto e shumë të tjera ishin fatkeqësitë tonat. Zoti na dërgoi Profet në mesin tonë. Ne e njohim shumë mirë atë, kemi besim te ai, te pastërtia dhe besnikëria që ai ka treguar. Ai na ka ftuar të adhurojmë një Zot, të lëmë larg adhurimin e gurëve. Ai na fton të jemi të mirë e të sjellshëm, të mos themi gënjeshtër, të shlyejmë amanetin, të mbajmë afër të afërmit, të ndihmojmë fqinjët, të nxitim të tjerët në punë të mira, të rrimë larg veprave të liga, të mos dëshmojmë gënjeshtër, të mos hamë mallin e jetimit, si dhe të mos i mveshim pandershmëri një gruajë të ndershme.

Të adhurojmë Zotin Një dhe të mos i vëmë asnjë shok, të falim namazin, të agjërojmë dhe të japim zekatin...

Ne i besuam atij, i vumë në zbatim të gjitha rregullat e tij, një për një. Por populli ynë u kundërvu, duke na dhunuar e duke na mërzhitur, si dhe këmbëngulte që të largoheshim nga feja e drejtë e t’u ktheheshim idhujve, që të ndiqnim shembullin e të parëve tanë.

Në kohën që na vunë në vështirësi dhe na vendosën para presionit, ne u kthyem në vendin tuaj, duke dashur të ishim fqinji juaj, me shpresën që këtu të mos na dhunojë asnjë njeri.’

Mbreti i Etiopisë e mendoj shumë këtë gjë dhe iu kthye Xhaferrit: 'A mban mend ndonjë gjë nga ky Libër Qiellor?'

Xhaferri tha: 'Po.'

Mbreti i Etiopisë i tha: 'Lexo për mua!'

Xhaferri, i cili kishte zgjuars, inteligjencë e besim të jashtëzakonshëm, zgjodhi të recitoi për të ajetet e para të sures 'Merjem'. Ai i recitoi ato për mbretin e Etiopisë dhe për të gjithë të pranishmit, të cilët ishin ndjekës së rrugës së Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*).

Kur Xhaferri i recitoi këto ajete, preku shumë zemrën e mbretit të Etiopisë, si dhe të të gjithë dijetarëve që ishin grumbulluar aty. Atyre u rrodhën lot mallëngjimi nga sytë.

Kështu, mbreti i Etiopisë u kthye drejt tyre dhe tha: 'Betohem në Zot, atë çka e ka sjellë Profeti Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe këto ajete që ju cituat, e kanë të njëjtë burimin. Ikni dhe jetoni të lirë dhe të qetë, sepse unë nuk do t'ju dorëzoj në dorë të askujt.'

Më pas, të dërguarit kurejsh nisën përpjekje të tjera për të bindur mbretin e Etiopisë, që t'i largojë myslimanët, por asgjë nuk ndikoi te shpirti i tij i pastër. Ai i largoi ata dhe ua ktheu mbrapsht dhuratat, duke u kërkuar ndjesë."¹

¹ Mbështetur te "Jetëshkrimi i Ibn Hishamit", vëll. 1, f. 356-361.

Ajetet 37 - 39

فَاخْتَلَفَ الْأَحْزَابُ مِنْ بَيْنِهِمْ^ط فَوَيْلٌ لِلَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ مَّشْهَدِ يَوْمٍ
عَظِيمٍ ﴿٣٧﴾ أَسْمِعْ بِهِمْ وَأَبْصِرْ يَوْمَ يَأْتُونَنَا^ط لَكِنِ الظَّالِمُونَ الْيَوْمَ فِي
ضَلَالٍ مُبِينٍ ﴿٣٨﴾ وَأَنْذِرْهُمْ يَوْمَ الْحَسْرَةِ إِذْ قُضِيَ الْأَمْرُ وَهُمْ فِي
غَفْلَةٍ وَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿٣٩﴾

“E megjithatë, sektet u përçanë në lidhje me atë. Mjerë ata që nuk besojnë për takimin e një Dite të madhe (Ditës së Kiametit)! ”

“E sa mirë do të dëgjojnë e do të shohin atë Ditë, kur do të vijnë te Ne! Por, sot keqbërësit janë në humbje të qartë!”

“Paralajmëroji ata (o Muhammed) për Ditën e Pikëllimit, kur do të japin llogari, ndonëse tani ata janë të shkujdesur dhe nuk besojnë.”

Komentimi

Ringjallja, Dita kur do të ndihet keqardhje

Fjala e fundit e Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*), pasi prezantoi vetveten me të gjitha cilësitë që u thanë më lart, foli në veçanti për çështjen e njëshmërisë dhe të adhurimit të All'Ilahut. "All'Ilahu është Zoti im dhe Zoti juaj; andaj adhuroni vetëm Atë! Kjo është udha e drejtë." ¹

"(Isai tha): 'Vërtet, All'Ilahu është Zoti im dhe Zoti juaj; andaj adhuroni vetëm Atë! Kjo është udha e drejtë.'"

Në këtë mënyrë, Profeti Isa (*Paqja qoftë mbi të!*), që nga fillimi i jetës së tij luftoi me të gjitha llojet e shirkut. Ai predikoi gjithë kohën për njëshmërinë e All'Ilahut. Ndaj ajo çka predikohet nga të krishterët, përse i përket trinitetit, nuk është gjë tjetër vetëm se gjë e shtuar, pasi triniteti është predikuar pas largimit të Isait (*Paqja qoftë mbi të!*). Për këtë çështje është folur në ajetin 171 të sures "En Nisa".²

Disa prej komentuesve mendojnë se kjo fjali mund të ketë qenë nga goja e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Me kuptimin që All'Ilahu e urdhëron atë në këtë që t'i ftojë ata në Njëshmërinë e Tij dhe ta prezantojë atë si rrugën e drejtë.

¹ Për nga ana e rendit të fjalisë, ky ajet i është bashkëngjitur fjalëve të Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilat u thanë më lart, në momentin kur ai tha: **"Unë jam rob i All'Ilahut"**... dhe më pas ato përfunduan me këtë fjali.

Rikthehu te vëllimi 4, faqe 224, tefsiri "Nemune".

² Shiko komentimin e tefsirit "Nemune", vëll. 4, f. 224.

Por ajete të tjera të Kur'anit dëshmojnë se kjo fjalë është ndër fjalët e Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ndjekin fjalët e kaluara. Në suren “Zuhruf”, në ajetet 63-64 lexojmë: **“E, kur Isai solli prova të qarta, tha: ‘Ju kam sjellë urtësinë (profecinë) dhe do t’ju shpjegoj disa gjëra, për të cilat nuk po pajtoheni. Andaj, frikësojuni All’llahut dhe bindmuni mua!’”**

“Pa dyshim, All’llahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj adhuroni vetëm Atë! Kjo është rruga e drejtë!”.

Profeti Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) u solli atyre argumente të qarta, duke u thënë se ka sjellë për ta dije dhe urtësi, si dhe qartësoi disa çështje, mbi të cilat ishin në konflikt. Ai u thoshte të kishin frikë All’llahun dhe t’i bindeshin atij, sepse All’llahu ishte Zoti i tij dhe i tyre. Kjo është rruga e drejtë.

Këtu shikojmë po të njëjtën fjali, por të thënë nga gjuha e Isait (*Paqja qoftë mbi të!*). Të njëjtin kuptim e shikojmë edhe në ajetet 50-51 të sures “Ali Imran”. All’llahu thotë: **“Dhe (kam ardhur te ju) për t’ju vërtetuar Teuratin, që është para meje dhe që t’ju lejoj disa gjëra që i keni pasur të ndaluara. Ju kam sjellë një provë nga Zoti juaj, prandaj kijeni frikë All’llahun dhe bindmuni!”**

“Me të vërtetë, All’llahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj adhurojeni Atë. Kjo është rruga e drejtë!”.

Pavarësisht këmbënguljes së Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*), përse i përket njëshmërisë dhe adhurimit të All’llahut, fjalët e tij u ndryshuan pas tij nga grupet që e ndoqën. Gjithashtu, ata shprehën besim të ndryshëm nga besimi i Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*).

Mjerë ata që përzgjedhën rrugë e kufrit dhe të shirkut!

Historia e katolicizmit e tregon shumë qartë se si u devijua feja që shpalli Profeti Isa (*Paqja qoftë mbi të!*). Ata patën shumë kundërshtime mes veti, përse i përket çështjes së njëshmërisë. Kundërshtimet e tyre arritën në pikën më të lartë, sa që Kostandini, perandori i Romës mbledhi një grup priftërinjsh (dijetarët më të mëdhenj të katolicizmit) dhe formoi një grup prej tre konventash, të njohura në historinë e tyre.

Numri i anëtarëve të kësaj konvente arriti shifrën dymijë e njëqind e shtatëdhjetë. Të gjithë ishin personalitete të mëdhenj. Në kohën kur diskutuan për Profetin Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) të gjithë dhanë mendime të ndryshme për të, çdo grup kishte një besim të ndryshëm.

Disa thanë se ai është Zot, i cili ka zbritur në tokë. Të tjerë thanë se është gjallë. Pjesa tjetër tha se ka vdekur dhe është kthyer prapë në qiell.

Të tjerë thanë se ai është fëmijë i Zotit.

Ndërsa disa të tjerë dhanë mendimin se ai është realiteti i trinitetit (i tre qenieve të shenjtë): "*Babai, biri dhe shpirti i shenjtë*" (Zoti baba, Zoti bir dhe shpirti i shenjtë).

Të tjerë thanë se ai është i treti i këtyre tre personave: Zoti i adhuruar, ai dhe nëna e tij janë të adhuruar.

Si përfundim, disa thanë: "*Ai është rob i Zotit dhe i dërguari i Tij*".

Kështu që nuk pati asnjë mendim të përbashkët, që të përputhej me besimin e tyre dhe me atë që tha secili.

Grupi më i madh i kësaj konvente, që kishin të njëjtin mendim, ishte i përbërë prej 308 personash, kështu që perandori e konsideroi atë grup si shumicën dhe e quajti si besimin zyrtar. Ai e mbrojti këtë besim dhe të tjerët i largoi. Fatkeqësisht, grupi që mendonte se Isai është rob i Zotit, ishte i pakët në numër dhe nuk pati shumë përkrahës, kështu që nuk u pranua.¹

Te të krishterët ngjarja më e madhe e tyre është devijimi, ndaj edhe në ajetin e mësipërm pamë se si Zoti i kërcënon ata, që në Ditën e madhe të Ringjalljes do të përballen me gjykatën më të madhe të drejtësisë së All'llahut. Atë Ditë ata do të përballen me turpin dhe me një të ardhme shumë të dhimbshme.

Ajeti i mëposhtëm do të shpjegojë gjendjen e tyre në fushën e Ringjalljes: Ata atë ditë, kur të shkojnë pranë All'llahut, do të gjejnë vesh shumë të dëgjueshëm dhe sy që shikojnë shumë mirë.

“E sa mirë do të dëgjojnë e do të shohin atë Ditë, kur do të vijnë te Ne! Por, sot keqbërësit janë në humbje të qartë!”

Është e qartë se në Ditën e Ringjalljes do të largohen perdet. Sytë e veshët do të shikojnë e do të dëgjojnë shumë qartë. Në ato momente, kur njeriu do të paraqitet pranë gjyqësorit, i ka të gjitha shqisat shumë të ndjeshme, sidomos shqisën e të dëgjuarit dhe të të parit. Aty do të njihet me bëmat e tij. Por sa keq, nuk do të ketë asnjë përfitim zgjimi dhe dëgjimi i tij.

Disa komentues janë të mendimit se fjala “*el jeum*” në fjalinë:

¹ Tefsiri “Fi Dhelal Kur’an”, vëll. 5, f. 436.

“...atë Ditë, kur do të vijnë te Ne! Por, sot keqbërësit janë në humbje të qartë!”, ka kuptimin *“Dita e Kiametit”*. Në këtë rast, kuptimi i ajetit bëhet: Atje do të dëgjojnë dhe do të shikojnë, por ky dëgjim dhe ky shikim nuk do t’u japë asnjë përfitim. Kështu që do të jenë të humbur.

Nga këto komentime, komentimi i parë është më i përshtatshëm dhe më i mirë.¹

Përsëri është mbështetur te fatet e njerëzve pa besim dhe zullumqarë, duke thënë se këta që kanë zemrën të verbër, frikësoi nga Dita e Ringjalljes. Në këtë Ditë, kur ata do të bëhen pishman, gjithçka do të përfundojë, sepse ata janë të përgjumur dhe nuk besojnë.

“Paralajmëroji ata (o Muhammed) për Ditën e Pikëllimit, kur do të japin llogari, ndonëse tani ata janë të shkujdesur dhe nuk besojnë.”

Dita e Kiametit ka emra të ndryshëm në Kur'anin e Shenjtë, si *“Dita e dhënies llogari”*. Në këtë Ditë edhe punëmirët bëhen pishman, duke thënë: “Ah, sikur të kishim bërë më shumë vepra të mira!”. Po ashtu, edhe punëkëqijtë pendohen për jetën që kanë bërë. I gjithë pendimi vjen për shkak të hapjes së perdeve dhe të gjithë njerëzit do të shikojnë të vërtetën e veprave që kanë bërë.

Disa komentues të Kur'anit të Shenjtë, grupin emëror: **“Në Ditën e pikëllimit”** e kanë cilësuar si fundin e dhënies së llogarisë

¹ “Elifi” dhe “lami”, në fjalën *“el jeum”* është *“elifi”* dhe *“lami”* i dhënies së besës. Sipas komentimit të parë, është një premtim që bëhet në prani, ndërsa, sipas komentimit të dytë, është premtim me fjalë.

dhe e kanë konsideruar si Ditën e Ringjalljes. Ndërsa të tjerë e kanë konsideruar si Ditën e zhdukjes së kësaj bote.

Sipas këtij komentimi, kuptimi i ajetit bëhet: Frikësoi ata o Muhammed nga Dita e Pikëllimit, kur bota do të jetë në gjendje të fjetur (e pavëmendshme). Në ato çaste, mosbesimi i tyre do të përfundojë.

Komentimi i parë duket më i drejtë. Këtë e miratojmë në një transmetim të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) i cili ka thënë: “*Në atë ditë do të jepet urdhri se kush do të hyjë në Xhennet dhe kush në Xhehennem.*”.¹

Në ajetin e fundit që flitet për këtë çështje, u bëhet thirrje edhe një herë të gjithëve zullumqarëve dhe tiranëve: Këto trashëgimi dhe prona që i keni në shërbimin tuaj, nuk janë të përjetshme, ashtu si edhe jeta juaj nuk është e përjetshme. Trashëgimtari i të gjithave është vetë Zoti i Madhëruar.

All’llahu në ajetin 40 të po kësaj sureje thotë se Ne trashëgojmë të gjithë tokën dhe të gjithë ata që: **“Vërtet, jemi Ne që e trashëgojmë Tokën dhe gjithçka gjendet në të dhe ata te Ne do të kthehen.”**.

Në të vërtetë, ky ajet është i përafërt me ajetin 16 të sures “Gafir”: **“Kush është pronari dhe udhëheqësi në këtë Ditë?”**.

Nëse ndokush do të besonte në këtë të vërtetë, atëherë përse do të dhunonte e do të merrte të drejtën e të tjerëve, kur pasuria dhe çdo gjë tjetër materiale është e përkohshme dhe ikën me shumë shpejtësi?

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 337.

Ajetet 40 - 45

إِنَّا خُنْ نَرْتُ الْأَرْضَ وَمَنْ عَلَيْهَا وَإِلَيْنَا يُرْجَعُونَ ﴿٤٠﴾ وَادْكُرْ فِي الْكِتَابِ
 إِبْرَاهِيمَ ۚ إِنَّهُ كَانَ صَدِيقًا نَبِيًّا ﴿٤١﴾ إِذْ قَالَ لِأَبِيهِ يَتَّبِعْ لِمَ تَعْبُدُ مَا لَا
 يَسْمَعُ وَلَا يُبْصِرُ وَلَا يُغْنِي عَنْكَ شَيْئًا ﴿٤٢﴾ يَتَّبِعْ إِنِّي قَدْ جَاءَنِي مِنَ
 الْعِلْمِ مَا لَمْ يَأْتِكَ فَاتَّبِعْنِي أَهْدِكَ صِرَاطًا سَوِيًّا ﴿٤٣﴾ يَتَّبِعْ لَا تَعْبُدِ
 الشَّيْطَانَ ۖ إِنَّ الشَّيْطَانَ كَانَ لِلرَّحْمَنِ عَصِيًّا ﴿٤٤﴾ يَتَّبِعْ إِنِّي أَخَافُ أَنْ
 يَمَسَّكَ عَذَابٌ مِنَ الرَّحْمَنِ فَتَكُونَ لِلشَّيْطَانِ وَلِيًّا ﴿٤٥﴾

“Vërtet, jemi Ne që e trashëgojmë Tokën dhe gjithçka gjendet në të dhe ata te Ne do të kthehen.”

“Trego në Libër për Ibrahimin! Ai ishte njeri i së vërtetës dhe Profet.”

“Ai i tha të atit: ‘O babai im, përse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh e as që mund të të sjellë ndonjë dobi?’”

“O babai im, mua më ka ardhur prej diturisë, çfarë s’të ka ardhur ty; andaj ndiqmë mua dhe unë do të të udhëzoj në rrugën e drejtë!”

“O babai im, mos adhuro djallin, sepse ai është gjithmonë i pabindur ndaj të Gjithëmëshirshmit.”

“O babai im, unë kam frikë se mos të vjen ndonjë dënim nga i Gjithëmëshirshmi e kështu të bëhesh i afërm i djallit!”

Komentimi

E kaluara e Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*), për nga ana e lindjes, ishte e kombinuar me një pjesë të jetës së Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*). Më pas vijnë ajetet që flasin për monoteizmin dhe jetën e guximshme të Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*). Do të shikojmë se si i fton njerëzit në monoteizëm dhe se si nis udhëheqja e Zotit, pra, si nis zanafilla e monoteizmit.

Ajeti 41 e udhëzon të kujtojë Profetin Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*): **“Trego në Libër për Ibrahimin! Ai ishte njeri i së vërtetës dhe Profet.”**

Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte njeri i së vërtetës dhe vërtetues i mësimëve dhe i urdhrave të All’llahut, si dhe ishte Profet i All’llahut.

Fjala “*sidik*” ka kuptimin “*e vërtetë*” dhe i atribuohet një njeriu që mbron të vërtetën.

Disa komentues janë të mendimit se fjala “*sidik*” ka kuptimin “*njeri që nuk thotë kurrë gënjeshtër*”. E thënë ndryshe, i

atribuohet një personi që nuk mendon dhe nuk thotë kurrë gënjeshtër, sepse përgjatë gjithë jetës së tij është mësuar të thotë vetëm të vërtetën.

Të tjerë janë të mendimit se ka kuptimin *“i vërtetë”*, *“veprat, fjalët dhe besimi i tij është i vërtetë”*. Por është e qartë se të gjitha kuptimet kanë një rrënjë dhe ajo është të qenit i vërtetë.

Sidoqoftë, kjo cilësi ka aq shumë rëndësi, saqë në ajetin e mësipërm, edhe para cilësisë së të qenit profet, i është atribuuar Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*). Duket sikur ky njeri është i përgatitur për të mbartur mbi supe profetësinë. Duke i kaluar të gjitha këto cilësi, shikojmë se i është atribuuar një tjetër cilësi, e cila u atribuohet të gjithë Profetëve: Ata e transmetojnë mesazhin e All'lahut pa asnjë cenim.

Më poshtë do të shikojmë komentimin e bisedës së Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) me babanë e tij, Azerin. (Baba në këtë rast ka kuptimin *“xhaxha”*. (Fjala *“ab”*, sikurse e kemi thënë edhe më parë, në fjalorin arab, ka kuptimin edhe *“baba”*, edhe *“xhaxha”*.)¹

Profeti Ibrahim e pyet të atin, se pse adhuron diçka që nuk dëgjon e nuk shikon, që nuk të zgjidh asnjë problem.

“Ai i tha të atit: ‘O babai im, përse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh e as që mund të të sjellë ndonjë dobi?’”

Ky shpjegim i shkurtër është një nga argumentet më të mira të mohimit të shirkut dhe të idhujve. Një nga qëllimet e

¹ Për këtë rast është folur në mënyrë të detajuar në vëllimin 5, në vazhdim të ajetit 74 të sures “El Enam”.

njeriut në jetën e tij, përse i përket njohjes së Krijuesit, është fitimi dhe humbja, që sipas dijetarëve të besimit është largimi i humbjes dhe afrimi nga përfitimi.

Duke u nisur nga ajeti, Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) i thotë se përse adhuron një gjë, që nuk të sjell asnjë dobi, që jo vetëm nuk të zgjidh problemet e tua, por as nuk ka fuqi të të dëgjojë e të të shikojë.

Më fjalë të tjera, adhurimi duhet të jetë për një person që ka fuqi të zgjidhë problemin dhe, për më tepër, të kuptojë dhe të ndiejë adhuresin, pra, Ai dëgjon dhe shikon. Por idhujt nuk i kanë këto cilësi.

Në të vërtetë, Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) ftesën e parë e bën për babanë e tij, për shkak se ndikimi te të afërmit është më i nevojshëm. Edhe Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në fillim u urdhërua të ftonte drejt fesë islame të afërmit e tij. Këtë ftesë e kemi të përshkruar në ajetin 214 të sures "Shuara".

Më pas Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*), me logjikë të qartë, e ftoi babanë e tij, që të adhurojë All'llahun. Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) i thotë se i është dhënë dije, të cilën ai nuk e ka pasur, prandaj duhet ta ndiqte dhe t'ia dëgjonte fjalën, që ta udhëzonte në rrugë të drejtë.

"O babai im, mua më ka ardhur prej diturisë, çfarë s'të ka ardhur ty; andaj ndiqmë mua dhe unë do të të udhëzoj në rrugën e drejtë!"

Mua më është dhënë njohuri e mjaftueshme nga ana e Krijesit dhe me shumë siguri mund të them se nuk do të ndjek rrugën e gabuar dhe ty nuk do të të ftoj kurrë në rrugë të gabuar.

Unë të dëshiroj ty të mirën, ndaj pranoje ftesën time, që të shpëtosh e të ndjekësh rrugën e drejtë, për të arritur te destinacioni i vërtetë.

Në ajetin 42 flet për mënyrën e vërtetimit të ftesës nëpërmjet mohimit, si dhe për pasojat që mund të vijnë nga kundërshtimi i kësaj ftese. Ai i thotë të atit që të mos e adhurojë shejtanin, sepse shejtani është gjithmonë mëkatar ndaj All'llahut.

“O babai im, mua më ka ardhur prej diturisë, çfarë s’të ka ardhur ty; andaj ndiqmë mua dhe unë do të të udhëzoj në rrugën e drejtë!”

Është e dukshme se qëllimi i përdorimit të fjalës “*adhurim*”, në këtë rast, nuk ka kuptimin e të rënit në sexhde, të falësh namazin, apo të agjërosh për shejtanin, por ka të bëjë me bindjen dhe ndjekjen e tij, që është një prej llojeve të adhurimit.

Adhurimi ka kuptim të gjerë, saqë edhe të dëgjosh një njeri, me qëllim që të veprosh atë që ai thotë, përfshihet te adhurimi. Po ashtu, edhe njohja zyrtarisht e një ligji, konsiderohet si adhurim.

Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në një hadith thotë: “Ai që dëgjon fjalët e folësit (ta dëgjosh me kuptimin që t’i bindesh), atë e ka adhuruar. Nëse ky

*folës flet me fjalët e All'llahut, atëherë ka adhuruar All'llahun, por, nëse flet nga ana e shejtanit, atëherë ka adhuruar atë shejtanin."*¹

Gjithsesi, Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) dëshiron t'i mësojë babait të tij këtë të vërtetë, që njeriu nuk mund të ecë në jetën e tij pa pasur një rrugë të drejtë. Ajo rrugë mund të jetë rruga e All'llahut, që është rruga e drejtë, ose mund të ecë në rrugën e shejtanit, rruga që të çon në mëkat dhe në devijim. Kështu që ai duhet ta mendojë mirë se cilën rrugë do të përzgjedhë e të mos ndikohet nga ndjekjet qorrazi.

Edhe një herë tjetër ai e këshilloi dhe i rikujtoi të ardhmen që i sjellin idhujt dhe shirku: Me këtë adhurim dhe me këta idhuj që ti ke, do të të vijë dënimi nga ana e All'llahut të Madhëruar e do të jesh prej ndjekësve të shejtanit.

"O babai im, mos adhuro djallin, sepse ai është gjithmonë i pabindur ndaj të Gjithëmëshirshmit."

Është shumë tërheqëse mënyra se si i flet Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) xhaxhait të tij, Azerit. Ai e thërret disa herë me emrin "baba". Kjo gjë është tregues i edukatës që ai ka, si dhe tregues i respektit që Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) ka për xhaxhanë e tij.

Nga ana tjetër, fjala "*enn jemseke*" tregon se Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) është i shqetësuar që Azerin të mos e cenojë asgjë dhe të mos dënohet.

Kur Profeti Ibrahim i thotë Azerit se do ta dënojë All'llahu, i tregon se puna që bën, duke adhuruar idhujt, do ta çojë në

¹ "Sefinetul Bihar" vëll. 2, f. 115, K. "Abd".

dënim. Edhe pse All'illahu është Mëshirues, Ai do të të dënojë, sepse ti po adhuron idhujt në vend të Tij. Shiko çfarë pune të tmerrshme po bën!

Nga ana tjetër, kjo punë e jotja është nën hijen e shejtanit dhe nuk ka aspak përfundim të mirë.

Hulumtime

Mënyra e ndikimit tek të tjerët

Mënyra dhe cilësia e bisedës së Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) me Azerin, që sipas transmetimeve ka qenë adhurues i idhujve dhe shitës i tyre, gjë e cila është një shkak i madh i korrupsionit në shoqëri, na tregon se, nëse duam të kemi ndikim te njerëzit që kanë dalë nga rruga e drejtë, duhet t'u flasim, së pari, nëpërmjet rrugës së logjikës, me respekt, me dashuri dhe me dhembshuri. Në të njëjtën kohë biseda të jetë e kombinuar edhe me vendosmërinë, sepse shumë grupe do të binden e do të dorëzohen nëpërmjet kësaj rruge, edhe pse një shumicë, përballë kësaj mënyre, bëjnë qëndresë. Sigurish që llogaria e tyre është e ndarë. Ndaj duhet pasur reagim tjetër me ta.

Arsyeja e ndjekjes së kësaj bote

Në ajetet e mësipërme lexuam se Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) e fton xhaxhanë e tij, Azerin, që ta ndjekë atë, edhe pse xhaxhai i tij, për nga ana e moshës ishte shumë më i madh dhe më i njohur në atë shoqëri se ai.

Këtë gjë e argumenton ajeti: **“...mua më ka ardhur prej diturisë, çfarë s’të ka ardhur ty...”** pra, **“Unë kam njohuri të cilat ti nuk i ke.”** Sipas ligjit të përgjithshëm, kush është më i ditur, ndiqet nga të tjerët. Në të vërtetë, ky është një ligj dhe një program që na qartëson edhe me tepër se kë duhet të ndjekim në të gjitha fushat e sidomos në fushën e *“Teklidit”* – *“ndjekjes”* së dijetarit të ligjeve islame.

Në të vërtetë, çështja e Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk kishte të bënte me rregullat e fesë, por është një ndër çështjet më të rëndësishme dhe më me vlerë në parimet e fesë. Pra, edhe në të tilla çështje ne na këshillojnë që të udhëzohemi dhe të ndjekim dijetarin, në mënyrë që udhëzimi drejt rrugës së drejtë të jetë baza jonë.

Surja e mëshirës dhe e rikujtesës

Në këtë sure, është cituar pesë herë fjala *“udhkur”* – *“përkujto”*. Ky përkujtim i është cituar Profetëve të mëdhenj (*Paqja qoftë mbi ta!*), si dhe Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*). Për këtë shkak, këtë sure mund ta quajmë edhe suren e përkujtimit apo të rikujtimit.

Rikujto, Profetët e mëdhenj, burrat dhe gratë e mëdhenj, si dhe lëvizjet e tyre monoteiste. Po ashtu, rikujto përpjekjet e shumta të tyre për t'u mbrojtur nga shirku, nga adhurimi i idhujve e nga dhuna.

Duke ditur që përkujtimi vjen pas gabimit, është e mundur që ky përkujtim të flasë për këtë të vërtetë, që ka të bëjë me rrënjën e njëshmërisë së All'llahut. Pra, rrënja e njëshmërisë dhe dashuria ndaj burrave që mbajnë në gjokset e tyre vetëm të vërtetën, është një lloj përkujtimi në vetvete.

Ajo çka na këshillon All'llahu i Madhëruar, si Mëshirues, në këtë sure, është cituar gjashtëmbëdhjetë herë. Surja nis me Mëshirë. Mëshira e All'llahut ndaj Profetit Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*), mëshira e All'llahut ndaj Hazreti Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*), si dhe mëshira e All'llahut ndaj Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*). Po ashtu, në fund thuhet: **“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t'u dhurojë dashuri.”**¹

¹ Sure “Merjem”, ajeti 96.

Ajetet 46 - 50

قَالَ أَرَأَيْتَ أَنْتَ عَنْ ءَالِهَتِي يَتَابِرَاهِيُمْ ^ط لَئِنْ لَّمْ تَنْتَهِ لِأَرْحَمَنَكَ ^ط وَأَهْجُرْنِي
 مَلِيًّا ﴿٤٦﴾ قَالَ سَلَامٌ عَلَيْكَ سَأَسْتَغْفِرُكَ رَبِّي إِنَّهُ كَانَ بِي حَفِيًّا ﴿٤٧﴾
 وَأَعْتَرُكُمْ وَمَا تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ وَأَدْعُوا رَبِّي عَسَىٰ أَلَّا أَكُونَ بِدُعَاءِ
 رَبِّي شَقِيًّا ﴿٤٨﴾ فَلَمَّا أَعْتَرَهُمْ وَمَا يَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ وَهَبْنَا لَهُ إِسْحَاقَ
 وَيَعْقُوبَ ^ط وَكُلًّا جَعَلْنَا نَبِيًّا ﴿٤٩﴾ وَوَهَبْنَا لَهُمْ مِنْ رَحْمَتِنَا وَجَعَلْنَا لَهُمْ
 لِسَانَ صِدْقٍ عَلِيًّا ﴿٥٠﴾

“Ai u përgjigj: ‘O Ibrahim! Si guxon t’i hedhësh poshtë zotat e mi?! Nëse nuk heq dorë, unë do të të mbys me gurë; andaj, largohu prej meje për një kohë të gjatë!’”

“Ibrahimi tha: ‘Shpëtimi qoftë mbi ty! Do t’i lutem Zotit tim që të të falë. Me të vërtetë, Ai është i mirë me mua.’”

“Po largohem nga ju dhe nga gjithçka që ju adhuronin në vend të All’lilaut. Do t’i lutem Zotin tim, sepse jam i sigurt se nuk do të jem fatkeq me lutjet që ia bëj Zotit tim.”

“Dhe, kur u largua nga ata dhe nga idhujt që i adhuronin në vend të All’Ilahut, Ne i dhuruam atij Is’hakun dhe Jakubin dhe që të dy i bëmë Profetë.”

“Ne u dhuruam atyre mëshirën Tonë dhe bëmë që ata të lavdërohen e të përmenden me nder.”

Komentimi

Rezultati i largimit nga shirku

Në ajetet e kaluara pamë fjalët logjike të Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilat ishin të mbushura me mirësi dhe dashuri të veçantë, rreth mënyrës se si të udhëzonte babanë.

Tashmë ka ardhur radha të shqyrtojmë përgjigjet që Azeri i ktheu Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*). Duke krahasuar këta të dy me njëri-tjetrin, del në pah e vërteta.

Kur’ani i Shenjtë nxjerr në pah jo vetëm dhembshurinë e Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*), por edhe fjalën e Azerit. Ai, i tronditur nga fjalët e Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*), tha: “O Ibrahim! A ua ktheve shpinën zotave të mi?! Nëse nuk heq dorë nga kjo punë, unë do të të mbys me gur. Tashmë largoj nga unë, mos të të shoh më!”.

“Ai u përgjigj: ‘O Ibrahim! Si guxon t’i hedhësh poshtë zotat e mi?! Nëse nuk heq dorë, unë do të të mbys me gurë; andaj, largohu prej meje për një kohë të gjatë!’”

Është për t’u habitur se Azeri, në fillim, nuk dëshironte t’i thoshin ndonjë fjalë të keqe apo të përdornin fjalë mohuese për idhujt e tij. Ai u mjaftua duke thënë vetëm kaq: “A ua ktheve shpinën zotave?”.

Së dyti, Azeri e kërcënoi Profetin Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) me dënimin me gur, ndërkohë që dënimi me gur është një ndër dënimet më të këqija (vrasjet më të këqija).

Së treti, Azeri nuk mjaftohet me këtë kërcënim, por e konsideron Profetin Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) si qenie të padurueshme dhe i kërkon të largohet, që të mos e shikonte më me sy.

Fjala “*melija*” sipas Ragibit, në librin e tij “Mufredat”, vjen nga rrënja “*emla*” dhe ka kuptimin “*jap afat për një kohë apo periudhë të gjatë*”. Në këtë rast, kuptimi i saj: largohu nga unë për një kohë të gjatë, ose përgjithmonë, që të mos të të shoh më.

Ky lloj interpretimi është me të vërtetë shumë ofendues. Këtë e përdorin njerëzit e ligj ndaj kundërshtarëve të tyre. Në gjuhën perse, në vend të saj, ndonjëherë përdorin fjalën “zhduku, mos të të shoh”, që do të thotë, jo vetëm mos të të shoh më, por as varrin mos ta di, pra, zhduku përgjithmonë.

Disa komentues, fjalën “*la rexmeneke*” nuk e kanë komentuar me kuptimin “*vrasje me gur*”, por e kanë komentuar me kuptimin “*ofendim*” apo me kuptimin “*akuzë*”. Por ky

komentim është i largët, sepse, kur shqyrtojmë ajetet e tjera të Kur'anit, të cilat kanë po këtë fjalë apo interpretim, ka kuptimin e asaj që thamë më lart.

Por gjithsesi, me të gjitha ato që kaloi Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*), sikurse të gjithë Profetët dhe udhëheqësit qiellorë, ai e ruajti qetësinë e tij dhe iu përgjigj me fjalët më të bukura dhe më madhështore: **"Paqja qoftë mbi ty!"**.

Ndoshta ky **"Selam"** ishte për t'u përshëndetur dhe për t'i thënë **"Mirupafshim"**, sepse me këtë fjalë dhe me disa të tjera, Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) u nda nga Azeri. Ndoshta ishte një selam për t'u larguar nga një grindje. Kjo citohet në ajetin 55 të sures "El Kasas": **"Kur dëgjojnë ndonjë marrëzi, i shmangen asaj, duke thënë: 'Ne kemi veprat tona, ndërsa ju keni veprat tuaja! Paqja qoftë me ju! Ne nuk duam shoqëri me të paditurit.'"**.

Më pas shton se shumë shpejt do t'i kërkonte Zotit të tij falje për të, sepse Ai është i Mëshirshëm ndaj tij.

"Ibrahimi tha: 'Shpëtimi qoftë mbi ty! Do t'i lutem Zotit tim që të të falë. Me të vërtetë, Ai është i mirë me mua.'"

Në të vërtetë, Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) u përgjigj ndryshe nga veprimet që bëri Azeri me të. Ai nuk e kërcënoi, por përdori butësinë, duke kërkuar falje dhe i premtoi Azerit se do të kërkonte mëshirën e All'llahut për të.

Këtu lind pyetja: Përse Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) i premtoi atij se do të kërkonte nga Zoti, që ta falte? Ne e dimë se Azzeri nuk besoi kurrë. Gjithashtu, dimë se të kërkoshe falje,

pendesë për jobesimtarët, sipas ajetit 113 të sures “Et Teube”, është e ndaluar.

“Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin këta edhe të afërmit e tyre, pasi u është bërë e qartë se ata janë banorë të Xhehennemit.”

Përgjigjen e kësaj pyetjeje e kemi trajtuar në vazhdim të këtij ajeti, në suren “Et Teube”.

Më tej tha: “Unë do të largohem nga ti, nga ky popull idhujtar dhe nga të gjithë ata që duan nuk e duan All’llahun.”.

“Po largohem nga ju dhe nga gjithçka që ju adhuronin në vend të All’llahut. Do t’i lutem Zotin tim, sepse jam i sigurt se nuk do të jem fatkeq me lutjet që ia bëj Zotit tim.”

Ky ajet, nga njëra anë, tregon edukatën e Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) përballë Azerit, që e urdhëroi të largohej. Ibrahim pranoi të largohet. Më pas sqaron se largimi i Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) është për shkak të besimit dhe të qëndresës që bëri Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*).

Po ashtu, Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë se, nëse i kërkoj Zotit diçka, All’llahu e pranon atë që unë kërkoj. Por sa keq për ju, që luteni te zotat tuaj, por asgjë nuk ju plotësohet. Më keq se kaq, as zërin nuk ua dëgjojnë.

Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) e mbajti fjalën e dhënë, i qëndroi besnik besimit të tij. Ai qe gjithmonë adhures i All’llahut, edhe pse e gjithë shoqëria që e rrethonte ishte jobesimtare. Ata u ngritën kundër tij, por ai nuk mbeti vetëm. Profeti Ibrahim, për gjatë gjithë shekujve, u bë shumë i njohur,

saqë të gjithë ata që besojnë në Zot, krenohen me të dhe veprat e tij.

Kur'ani i Shenjtë, përsa i përket kësaj fushe, thotë: “Në kohën që Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) u largua nga ata që adhuronin gjithçka, përveç All'llahut, All'llahu i fali atij Is'hakun dhe pas Is'hakut i fali djalin tjetër, Jakubin. Secilin prej tyre All'llahu e përgëzoi me Profetësi të madhe.”.

“Dhe, kur u largua nga ata dhe nga idhujt që i adhuronin në vend të All'llahut, Ne i dhuruam atij Is'hakun dhe Jakubin dhe që të dy i bëmë Profetë.”

Kaloi kohë e gjatë kur All'llahu i dha Profetit Ibrahim Is'hakun dhe më pas Jakubin (djali i Is'hakut). Të dy këto ishin dhurata të mëdha për të, sepse secili prej tyre pati një pozitë të lartë pranë All'llahut të Madhëruar. I gjithë rezultati ishte qëndresa që pati Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) në rrugën e luftës ndaj idhujve.

Përveç kësaj, All'llahu u fali atyre nga mëshira e Tij, mëshirë që është e veçantë për njerëzit e pastër dhe të devotshëm, si dhe për ata që luftojnë në rrugën e All'llahut. Ndaj edhe për këtë baba dhe fëmijët e tij mbeti një emër i mirë, një gjuhë e mirë dhe një pozitë e shkëlqyer në të gjithë brezat.

“Ne u dhuruam atyre mëshirën Tonë dhe bëmë që ata të lavdërohen e të përmenden me nder.”

Në të vërtetë, kjo është një përgjigje që iu bë kërkesës dhe lutjes që bëri vetë Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo citohet

në suren “Esh Shuara”, në ajetin 84: **“Bëj që të përmendem për të mirë te breznitë e ardhshme.”**.

Në të vërtetë, ata donin që Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) të harrohej përgjithmonë e të mos mbetej asgjë nga e kaluara e tij. Por ndodhi e kundërta e asaj që njerëzit dëshiruan për të. All’llahu e begatoi dhe e bëri të njohur ndër popuj, për shkak të asaj që la pas, për shkak të qëndresës që bëri dhe për shkak të profetësisë, e cila është e përmendur në të gjithë botën për shekuj me radhë. Po ashtu, ai është i njohur për devotshmërinë dhe për besimin e tij të pastër në Zot, te të gjithë brezat e njerëzimit.

Fjala “*lisan*”, në të tilla raste, ka kuptimin “*kujtesë*”, e cila bëhet nga njerëzit. Kur i shtohet fjala “*sidk*” - “*për mirë*”, ajo ka kuptimin njerëzit “*të më kujtojnë për mirë*”.

Ndërsa kur përmendet fjala “*alijen*”, e cila ka kuptimin “*shkëlqyeshëm*”, merr kuptimin “*të kujtohet për mirë në mesin e njerëzve*”. Është e qartë se Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk kishte për qëllim të plotësonte një dëshirë të tij, por kishte për qëllim që armiqtë e tij të mos e bashkonin atë me historinë e tyre si adhures i idhujve, por të ishte një shembull për gjithë njerëzimin.

Në një transmetim të Amirul Mu’minin Ali ibn Ebu Talibit (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: “*Përkujtimi për mirë, që All’llahu ka lënë për një njeri në mesin e të tjerëve, është një pasuri dhe thesar i madh, i cili jo vetëm që i shërben personit në fjalë, por mbetet trashëgimi përgjithmonë dhe ka ndikim të mirë, edhe pasi ai largohet nga kjo jetë*”.¹

¹ “Usul Kafi” (sipas “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 339).

Në parim, të kujtohesh për mirë në mesin e njerëzve ka shumë ndikim pozitiv, si nga ana shpirtërore, ashtu edhe nga ana e pozitës dhe njohjeve që krijohen në mesin e njerëzve. Kjo pozitë konsiderohet një trashëgimi e madhe për vetë personin dhe për fëmijët e tij. Të tillë shembuj i shikojmë shumë përgjatë historisë.

Përgjigjja e një pyetjeje

Në këtë rast lind pyetja: Si është e mundur që në këtë ajet nuk citohet trashëgimtari i parë i Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*), Ismaili (*Paqja qoftë mbi të!*), por emri i Profetit Jakub (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili është nipi i Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*)?

Në një ajet tjetër shikojmë që Profeti Ismail (*Paqja qoftë mbi të!*) citohet si trashëgimtari i Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*).

“Qoftë lavdëruar All’llahu, i cili në pleqëri më dhuroi Ismailin dhe Is’hakun! Vërtet, Zoti im i dëgjon lutjet!”

Përgjigjja e kësaj pyetje është: Në dy apo tre ajete, emri i Profetit Ismail (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe një pjesë e cilësive të tij janë cituar më vete. Qëllimi i ajetit të mësipërm është të tregojë se nëpërmjet tyre, rrjedhin Profetët që e kanë fillin nga Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*).

Po ashtu, tregon se në ç’mënyrë njihen ata në mesin e njerëzve. Është e njohur edhe rrjedha e Profetëve që vijnë nga Is’haku dhe nga Jakubi (*Paqja qoftë mbi ta!*). Edhe pse nga Profeti Ismail (*Paqja qoftë mbi të!*) rrjedh Profeti më i madh, Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), udhëheqjen e kanë pasur fëmijët e Is’hakut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në ajetin 27 të sures “El Ankebut” lexojmë: “Dhe Ne i dhuruam atij Is’hakun dhe Jakubin dhe pasardhësve të tij u dhamë Profecinë dhe Librin. Ne i dhamë atij shpërblim në këtë botë, ndërsa në Jetën Tjetër, me siguri, ai do të jetë prej njerëzve të mirë.”.

Ajetet 51 - 53

وَأَذْكُرْ فِي الْكِتَابِ مُوسَىٰ ۚ إِنَّهُ كَانَ مُخْلَصًا وَكَانَ رَسُولًا نَّبِيًّا ﴿٥١﴾
وَنَدَيْنَاهُ مِنْ جَانِبِ الطُّورِ الْأَيْمَنِ وَقَرَّبْنَاهُ نَجِيًّا ﴿٥٢﴾ وَوَهَبْنَا لَهُ مِنْ
رَحْمَتِنَا أَخَاهُ هَارُونَ نَبِيًّا ﴿٥٣﴾

“Trego në Libër edhe për Musain! Njëmend, Ai ishte i përzgjedhur, ishte i Dërguar dhe Profet.”

“Ne e thirrëm atë nga ana e djathtë e malit Tur, duke e afruar në një bisedë të fshehtë.”

“Dhe, nga mëshira Jonë, i dhuruam të vëllanë, Harunin, si Profet.”

Komentimi

Profeti Musa (Paqja qoftë mbi të!), Profet i singertë dhe i përzgjedhur

Tre ajetet e mësipërme flasin shkurt për Profetin Musa (Paqja qoftë mbi të!). Profeti Musa (Paqja qoftë mbi të!) është prej

fëmijëve të rrjedhës së Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*). All'llahu i Madhëruar i thotë të Dërguarit të Tij (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të shikojë librin e Musait (*Paqja qoftë mbi të!*).

“Trego në Libër edhe për Musain! Njëmend, Ai ishte i përzgjedhur, ishte i Dërguar dhe Profet.”

Më tej flet për pesë pjesë, prej mirësive që iu dhanë këtij Profeti të madh: Ai arriti një pozitë shumë të lartë për shkak të bindjes që kishte ndaj All'llahut të Madhëruar. Andaj edhe All'llahu e bëri prej të përzgjedhurve dhe të sinqertëve.

Sigurisht që një njeri i përzgjedhur dhe i sinqertë, kur arrin në një pozitë të tillë, nuk largohet nga rruga e drejtë. Ai do të jetë i ruajtur nga çfarëdolloj paudhëzimi apo pislleku. Edhe pse shejtani përpiket t'i largojë nga rruga e drejtë besimtarët, vetë e pohon se nuk mund të ketë ndikim te të përzgjedhurit dhe te të sinqertët.

“Ai tha: ‘Betohem në madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj ata të gjithë, përveç robërve të Tu të sinqertë!’”¹

Ai ishte Profet dhe i Dërguar me pozitë të lartë.

E vërteta e dërgesës është: Dërgesën ta mbajë dikush që është i aftë ta kryejë këtë detyrë dhe ta propagandojë atë për të shlyer pozitën që ka. Andaj kjo pozitë është vetëm për Profetët dhe të gjithë Profetët e kanë kryer me sukses detyrën që u është ngarkuar.

¹ Sure “Sad”, ajetet 82-83.

Fjala “nebi” - “i dërguar”, në këtë rast, tregon pozitën dhe udhëheqjen, si dhe madhështinë e këtij Profeti (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo fjalë vjen nga fjala “nebuve”, që ka kuptimin “jap lajmin”.

Edhe Profetët japin informacionin që marrin nga All’llahu i Madhëruar dhe ua transmetojnë atë të tjerëve. Në këtë rast, më i përshtatshëm është kuptimi i parë.

Ajeti tjetër flet për fillimin e profetësisë së Profetit Musa (*Paqja qoftë mbi të!*): **“Ne e thirrëm atë nga ana e djathtë e malit Tur, duke e afruar në një bisedë të fshehtë.”**.

Në atë natë të errët, shumë të tmerrshme e të frikshme, kur po kalonte nëpër shkretëtirat e Medjenit, së bashku me bashkëshorten, për t’u kthyer në Misir, Egjipt, asaj i erdhën dhimbjet e lindjes. Ai nisi të kërkojë zjarr, sepse ishte shumë ftohtë. Papritur u shfaq një dritë e shndritshme dhe një zë lajmëronte për profetësinë e tij. Ky ishte momenti më i ëmbël i jetës së tij, si dhe krenaria më e madhe e jetës.

Përveç kësaj, Ne e afruam atë pranë dhe bëmë me të një bisedë të fshehtë.

Zëri i All’llahut ishte një mirësi për Profetin Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe biseda me Krijuesin e Madhërishëm ishte një tjetër mirësi.

Më pas Ne i dhamë një tjetër mirësi prej mirësive, i dhamë atij Harunin (*Paqja qoftë mbi të!*), vëllanë e tij, i cili edhe ai ishte Profet, në mënyrë që ta kishte si shok, ndihmës dhe bashkëpunues.

“Dhe, nga mëshira Jonë, i dhuruar të vëllanë, Harunin, si Profet.”

Hulumtime

Kush është i singertë?

Në ajetin e mësipërm lexuam se All’llahu i Madhëruar, Musain (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka nga robtë e tij të singertë. Ashtu sikurse edhe e kemi cituar, kjo pozitë është shumë e lartë, nuk mbart asnjë lloj frike, sepse është pozitë e sigurtuar nga vetë All’llahu i Madhëruar. Në këtë pozitë, të cilën e fal All’llahu i Madhëruar, nuk mund të ndikojë as shejtani.

Të mëdhenjtë e dijes së moralit këtë pozitë e konsiderojnë si pozitën më të lartë. Duke u mbështetur në ajetet e Kur’anit të Shenjtë, shikojmë se të singertët kanë cilësi të veçanta. Këto cilësi do t’i citojmë në ajetet e ardhshme, në dashtë All’llahu i Madhëruar.

Ndryshimi midis Resultit dhe Nebiut

Resuli është dërguar për të përmbushur një detyrë. Ndërsa Nebiu, bazuar në një komentim, është një person që ka dijeni për Shpalljen e Zotit dhe lajmëron për të. Po ashtu, bazuar në një tjetër

komentim, ka kuptimin e një personi me pozitë të lartë. Që të dy këto kuptime ishin për nga ana gjuhësore.

Por sipas Kur'anit të Shenjtë dhe hadithit, Resul është ai person që ka mbi supe një fe dhe është përcaktuar ta prezantojë, ta përhapë atë te të tjerët, që do të thotë, Shpalljen e Zotit e merr nga Krijuesi i tij dhe e propagandon te të tjerët.

Ndërsa Nebiu është ai që merr Shpallje, por nuk është i detyruar ta përhapë atë. Ai kryen vetëm detyrën e tij. Nëse dikush e pyet, kthen përgjigje.

Sipas një interpretimi tjetër, Nebiu është si doktori, që është në pritje të të sëmurëve. Nuk shkon për të kërkuar të sëmurët, por, nëse ndonjë i sëmurë i shkon pranë, ai e kuron atë.

Ndërsa Resuli është si doktori që kërkon të sëmurët. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) në “Nehxhul Belaga”, përsa i përket Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thotë: “Ai shkon gjithkund, në të gjitha vendet e qytetet, fshatrat, malet e fushat, shkretëtira etj... që të gjejë të sëmurët, për t'i kuruar ata. Ai është si burimi i ujit, që kërkon të eturit. Nuk është si burimi që të eturit e kërkojnë atë.”.

Ndër transmetimet që na janë cituar, përsa i përket kësaj fushe, si dhe në librat e të ndjerit Koleini, në “Usul Kafi”, në kapitullin “Pozitat e të Dërguarve dhe të Profetëve”, si dhe në kapitullin “Ndryshimi midis Nebiut dhe Resulit”, thotë: “Nebi është ai që shikon të vërtetën e Shpalljes në ëndërr. Sikurse ishte ëndrra e Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*). Po ashtu, përveçse në ëndërr, dëgjon edhe zërin e engjëjve.

Ndërsa Resuli është ai person që, përveç se i shpallet Shpallja, dëgjon edhe zërin e engjëjve, i shikon ata, si dhe Shpallja i shpallet edhe në ëndërr.”.¹

Sigurisht që ajo çka u tha në këto transmetime, nuk ka asnjë kundërshtim me komentimet e thëna më lart.

¹ “Usul Kafi”, vëll. 1, f. 133-134.

Ajetet 54 - 55

وَأَذْكُرْ فِي الْكِتَابِ إِسْمَاعِيلَ إِنَّهُ كَانَ صَادِقَ الْوَعْدِ وَكَانَ رَسُولًا نَبِيًّا ﴿٥٤﴾
وَكَانَ يَأْمُرُ أَهْلَهُ بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ وَكَانَ عِنْدَ رَبِّهِ مَرْضِيًّا ﴿٥٥﴾

“Trego në Libër për Ismailin! Vërtet, ai ishte i singertë në premtimet e veta, ishte i Dërguar dhe Profet.”

“Ai e urdhëronte popullin e vet që të falte namazin e të jepte zekatin dhe ishte i mirëpritur te Zoti i vet.”

Komentimi

Profeti Ismail, Profeti i singertë në premtimet e tij

Pasi u fol për Profetin Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe veprave të mira të tij, si dhe pasi u fol shkurtimisht për një pjesë të jetës së Profetit Musa (*Paqja qoftë mbi të!*), ajetet vijnë të flasin për djalin e Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*), Ismailin (*Paqja qoftë mbi të!*).

Kur kujtohet Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*), kujtohet edhe djali i tij, Ismaili dhe programet e tij plotësohen me të. Po ashtu pesë cilësi të tij citohen si shembull.

Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i thuhet: **“Trego në Libër për Ismailin! Vërtet, ai ishte i sinqertë në premtimet e veta, ishte i Dërguar dhe Profet.”**

“Ai e urdhëronte popullin e vet që të falte namazin e të jepte zekatin dhe ishte i mirëpritur te Zoti i vet.”

Në këto dy ajete tregohet se Ismaili (*Paqja qoftë mbi të!*) është i sinqertë në mbajtjen e fjalës. Është Profet me pozitë të lartë, urdhëron në faljen e namazit dhe gjithmonë ka pasur marrëdhënie me Krijuesin. Me pak fjalë, ka kryer detyrat që e kanë kënaqur Krijuesin. Ka cilësi që i janë përmendur në Kur'anin e Shenjtë.

Një tjetër pikë e rëndësishme, që citohet menjëherë para dhe pas pozitës së profetësisë, është dhënia e besës, asaj çka premtion, kujdesi për familjen dhe edukimi i saj. Këto detyra janë ndër detyrat e Zotit që përmenden.

Është e pamundur që njeriu të arrijë pozitën e Profetit, nëse nuk është i drejtë. Një nga kushtet e kësaj pozite është: Mesazhi e Zotit të përçohet saktë, pa gabime dhe pa hequr e shtuar gjë. Një pjesë e kufizuar personash që e mohojnë pozitën e të qenit i pagabueshëm te Profetët, çështjen e të qenit i besës, i mbajtjes së fjalës, jo gënjeshtar, e konsiderojnë si çështjen më kryesore në çdo gjë.

Në një hadith lexojmë se All'llahu i Madhëruar e ka cituar Profetin Ismail (*Paqja qoftë mbi të!*) si përçues i sinqertë dhe mbajtës i fjalës, sepse ai e mbante premtimin. Profeti Ismail (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte lënë të takohej diku me një person. Ai person nuk u paraqit. Profeti Ismail (*Paqja qoftë mbi të!*) aq shumë i kushtonte rëndësi mbajtjes së fjalës, saqë qëndroi një vit duke e pritur atë person që të vinte në takim. Kur ai erdhi në takim, Profeti Ismail (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: “Unë të kam pritur gjithmonë!”¹

Profeti Ismail (*Paqja qoftë mbi të!*), edhe pse ishte gjithmonë në pritje të ardhjes së këtij personi, nuk i kishte lënë të gjithë punët për të pritur këtë person.

Nga ana tjetër, stadi i parë i nisjes së propagandës së profetësisë është familja, personat më të afërm të njeriut. Për këtë arsye, edhe Profeti i Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të parën ftesë e bëri për bashkëshorten e tij, Hatixhen dhe më pas ftoi djalin e xhaxhait, Aliun. Më tej, sipas urdhrit, e nisi të afërmit e tjerë të tij.

Në ajetin 132 të sures “Ta Ha” lexojmë një ftesë për të falur namazin dhe një këshillë, që të jenë këmbëngulës për këtë...

“Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë! Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë ushqim: jemi Ne që të ushqejmë! Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj All'llahut.”

¹ “Usul Kafi”, vëll. 2, f. 86.

Një tjetër çështje, që është për t'u cituar, është sinqeriteti dhe devotshmëria e Profetit Ismail (*Paqja qoftë mbi të!*). Në të vërtetë, ai, në të gjitha veprat e tij, kishte fituar kënaqësinë e All'llahut të Madhëruar.

Në parim, nuk ka mirësi më të madhe dhe më të lartë se kjo: Krijuesi të jetë i kënaqur nga krijesa e tij.

Në suren "El Maide", ajeti 119, pasi përmenden mirësitë e përhershme të Xhennetit për krijesat e veçanta të All'llahut, thuhet: **"All'llahu thotë: 'Kjo është Dita në të cilën të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre. Atyre u takojnë kopshtet, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. All'llahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është fitorja e madhe!'"**¹.

¹ Për këtë rast është folur në vëllimin e pestë të "Komentimit të Përkryer".

Ajetet 56 - 60

وَأَذْكُرُ فِي الْكِتَابِ إِدْرِيسَ ۚ إِنَّهُ كَانَ صِدِّيقًا نَبِيًّا ﴿٥٦﴾ وَرَفَعْنَاهُ مَكَانًا عَلِيًّا
 أُولَئِكَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّينَ مِنْ ذُرِّيَّةِ آدَمَ وَمِمَّنْ
 حَمَلْنَا مَعَ نُوحٍ وَمِنْ ذُرِّيَّةِ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْرَءِيلَ وَمِمَّنْ هَدَيْنَا وَاجْتَبَيْنَا إِذَا
 تُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ آيَاتُ الرَّحْمَنِ خَرُّوا سُجَّدًا وَبُكِيًّا ﴿٥٧﴾ ۝ خَلَفَ مِنْ
 بَعْدِهِمْ خَلْفٌ أَضَاعُوا الصَّلَاةَ وَاتَّبَعُوا الشَّهْوَاتِ ۖ فَسُوفَ يَلْقَوْنَ غِيًّا ﴿٥٨﴾
 إِلَّا مَنْ تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَأُولَئِكَ يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ وَلَا يُظْلَمُونَ
 شَيْئًا ﴿٥٩﴾

“Trego në Libër për Idrizin! Ai ishte njeri i së vërtetës dhe Profet.”

“Ne e ngritëm atë në vend të lartë.”

“Këta janë ata, të cilët All’llahu i begatoi (me hirin e Tij) nga Profetët pasardhës të Ademit, të atyre që Ne i mbartëm me Nuhun, nga pasardhësit e Ibrahimit dhe të Israelit dhe nga ata që Ne i udhëzuam dhe i zgjodhëm. Kur iu lexoheshin ajetet e të Gjithëmëshirshmit, binin duke bërë sexhde dhe qanin.”

“Pas atyre erdhën brezni, që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epshtet e veta. Ata do të pësojnë dënimin e madh.”

“Përveç atyre që pendohen, që besojnë dhe bëjnë punë të mirë. Këta do të hyjnë në Xhennet dhe nuk do t’u bëhet kurrfarë padrejtësie.”

Komentimi

Në pjesën e fundit të kësaj sureje, flitet për Profetin Idriz (*Paqja qoftë mbi të!*).

Së pari, Kur’ani i Shenjtë thotë: **“Trego në Libër për Idrizin! Ai ishte njeri i së vërtetës dhe Profet.”**

Fjala *“sidik”*, ashtu sikurse e thamë edhe më parë, ka kuptimin e një personaliteti shumë të sinqertë dhe vërtetues i ajeteve të All’llahut. Po ashtu, është edhe i bindur përballë të vërtetës dhe të drejtës.

Më tej në Kur’an flitet për pozitën e lartë të tij. **“Ne e ngritëm atë në vend të lartë.”**

Në mesin e komentuesve ka diskutime dhe mendime të ndryshme përsa i përket qëllimit të pozitës së Profetit Idriz (*Paqja qoftë mbi të!*), në ç’aspekt është folur për të, për pozitën shpirtërore apo për ndjeshmërinë e tij.

Disa prej tyre, ashtu sikurse edhe ne e kemi përzgjedhur, flasin për pozitën shpirtërore dhe gradat e tij si Profet.

Po ashtu, disa komentues të tjerë janë të mendimit se All'llahu i Madhëruar e ngriti Profetin Idriz (*Paqja qoftë mbi të!*), ashtu si ngriti në qiell edhe Profetin Isa (*Paqja qoftë mbi të!*). Prandaj është përdorur edhe interpretimi "*Mekanen Aleina*" - "*e ngritëm atë në vend të lartë*".

Përdorimi i fjalës "*mekan*" - "*vend*", përdoret edhe për gradat dhe pozitat shpirtërore. Po e njëjta gjë është përdorur edhe për Profetin Jusuf (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në suren "*Jusuf*", në ajetin 77, lexojmë se Jusufi (*Paqja qoftë mbi të!*) u tha vëllezërve të tij, të cilët kryen një vepër të keqe: "*Entum Sher'run Mekanen*" - "*Ju jeni në pozitë të keqe për nga ana e pozitës dhe gradës*".

"(Bijtë e Jakubit) thanë: 'Nëse ka vjedhur, më parë ka vjedhur edhe vëllai i tij! Jusufi heshti për këtë dhe nuk shpalli gjë, por mendoi në vetvete: 'Ju jeni në pozitë më të keqe. All'llahu është më i dijshtëm për ato që thoni ju.'"

Sidoqoftë Profeti Idriz (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte ndër Profetët me pozitë të lartë te Zoti.

All'llahu i Madhëruar, në Kur'anin e Shenjtë, pasi tregon për madhështinë, singëritetin dhe gradat e Profetëve, në një përmbledhje citon të gjitha krenaritë e Profetëve të mëdhenj, si dhe cilësitë e gjendjen e tyre. Po ashtu flet edhe për dhuratat që All'llahu i ka dhënë secilit prej tyre. All'llahu i përmend kështu ata: **"Ata ishin Profetë që All'llahu i begatoi me mirësitë e Tij..."**.

Disa prej tyre ishin prej fëmijëve të Ademit, disa ishin prej atyre që i hipëm në varkën e Nuhut, disa ishin prej Ibrahimit dhe disa nga Israili.

Të gjithë këta Profetë, edhe pse ishin prej fëmijëve të Ademit, duke u bazuar me afërsinë e tyre, me njërin prej Profetëve të mëdhenj, i cilësojnë si pjesëtarë të fisit të Ibrahimit dhe të Israilit. Kështu janë përmendur ata. Kur flitet për fisin e Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) në këtë ajet, ka për qëllim Idrizin (*Paqja qoftë mbi të!*). Sipas mendimeve të shumta, ai ishte stërgjyshi i Profetit Nuh (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ndërsa përsa i përket prejardhjes së personave që u ngjiten në varkën e Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*). Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte prej fëmijëve të Samit, i cili kishte për baba Nuhun (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ndërsa kur flet për rrënjët e Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon për Is'hakun, Ismailin dhe Jakubin (*Paqja qoftë mbi ta!*). Ndërsa kur flet për rrënjët e Israilit, ka për qëllim Profetin Musa, Harun, Zekarija, Jahja dhe Isa (*Paqja qoftë mbi ta!*). Në ajetet e mësipërme u fol shumë për cilësitë e tyre.

Më pas këtë diskutim e plotëson me ndjekësit e vërtetë të këtyre Profetëve të mëdhenj. Prej personave që u udhëzuan dhe u përzgjedhën, ka prej tyre që, kur dëgjojnë ajetet e All'llahut Mëshirëplotë, bien në tokë dhe bëjnë sexhde. E prej syve të tyre rrjedhin lot.

“Këta janë ata, të cilët All'llahu i begatoi (me hirin e Tij) nga Profetët pasardhës të Ademit, të atyre që Ne i mbartëm me Nuhun, nga pasardhësit e Ibrahimit dhe të Israilit dhe nga ata

që Ne i udhëzuam dhe i zgjodhëm. Kur iu lexoheshin ajetet e të Gjithëmëshirshmit, binin duke bërë sexhde dhe qanin.”

Disa nga komentuesit kanë mendim ndryshe për pjesën e fjalisë: **“Ne i udhëzuam dhe i zgjodhëm...”**.

Ata janë të mendimit se flitet për ata Profetë që u fol në fillim të ajetit. Por ajo çka u tha më lart, është mendimi më i përafërt. Dëshmi e kësaj fjale është hadithi që transmetohet nga Imam Zejnul Abidin Ali ibn Ali bin Hysejri (*Paqja qoftë mbi të!*). Në kohën që recitoi këtë ajet tha: *“Ne jemi qëllimi i këtij ajeti”*.

Kjo fjali është tregues i qartë për ndjekësit e vërtetë të Profetëve (*Paqja qoftë mbi ta!*). Të tillë tregues ne i kemi hasur shumë herë në këtë komentim.

Pa vëmendja ndaj kësaj çështjeje dhe kësaj të vërtete është bërë shkak që komentues, si Alusi, në *“Ruhul Meani”* të gabojë dhe për këtë ngjarje të përdorë sarkazmin, si argument që hadithet shi'ia janë të pavlefshme.

Ky është edhe rezultati i mosnjohjes dhe të moskuptuarit të haditheve, të cilat janë përdorur në komentim të ajeteve.

Në ajetet e kaluara u fol për hazreti Merjemen, ndërkohë që ajo nuk ishte nga të Dërguarit dhe Profetët. Për të u fol në ajetin **“Ne i udhëzuam...”**. Ky rast është konsideruar si i tillë, sepse në çdo kohë dhe vend ka pasur raste të tilla.

Po për këtë rast, në ajetin 69 të sures *“En Nisa”* shikojmë që bekimet nuk janë posaçërisht për Profetët (*Paqja qoftë mbi ta!*), por ato përfshijnë edhe të vërtetët dhe shehidët.

Në ajetin 75 të sures “El Maide”, gjithashtu përkujtohet e flitet për Merjemen, nënën e Isait (*Paqja qoftë mbi të!*), si “*sidike*” – “*e vërtetë*”, “*e drejtë*”.

“Mesihu, i biri i Merjemes, është vetëm një i Dërguar. Edhe para tij kanë kaluar të Dërguar. Nëna e tij përherë ka qenë e drejtë. Që të dy, hanin ushqim. Shiko si ua shpjegojmë atyre Shpalljet Tona dhe shih si largohen nga e Vërteta!”

Më pas flitet për një grup njerëzish, të cilët u ndanë nga shkolla e Profetëve dhe u bënë ndjekës të së keqes. Ata kryenin vepra të liga. Kur’ani i përshkruan kështu: **“Pas atyre erdhën brezni, që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epsheet e veta. Ata do të pësojnë dënimin e madh.”**

Fjala “*helef*” ka kuptimin “*fëmijë jo të mbarë*”.

Kjo fjali mund të flasë për një grup nga Beni Israilët, të cilët u bënë të paudhë dhe e harruan Zotin. Ata ndoqën epsheet e tyre dhe lanë adhurimin. E mbushën botën plot e përplot me korrupsion.

Si përfundim, ata kryen vepra të liga në këtë botë dhe në Botën Tjetër do të marrin dënimin e tyre. Për sa i përket fjalës “*edhaet salat*” - “*braktisje e namazit*”, në mesin e komentuesve ka mendime të ndryshme. Disa janë të mendimit se bëhet fjalë për kryerjen me vonesë të namazit. Disa janë të mendimit se ata kryenin vepra që e bënin namazin të pavlefshëm. Komentuesit, sikurse edhe e thamë më lart, kanë dhënë mendime të ndryshme, por mendimi i fundit duket se është më i drejtë.

Përse është vënë theksi te namazi, ndërkohë që janë edhe rituale të tjera? Ndoshta, sepse “*namazi*” - “*falja*”, ashtu sikurse edhe e dimë, është si diga mes njeriut dhe mëkateve. Nëse kjo digë do të thyhet, nuk ka kush e mban pritën e mëkateve dhe të epsheve.

Me fjalë të tjera, ashtu sikurse edhe Profeti ynë Muhammedi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lartësimin dhe pozitën e tij e nisi duke kujtuar Zotin dhe, kur për Të lexoheshin ajetet e Kur'anit, kokën e vendoste në sexhde dhe niste e qante.

Edhe këta breza dhe ndjekës jo të bindur, harrimin e filluan me braktisjen dhe të kujtuarit e All'llahut.

Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: “Rruga e kthimit në besim dhe në të vërtetën është e hapur.” Po ashtu, pasi citon brezat që braktisën të vërtetën dhe shkuan pas epsheve të tyre, thotë: “Ata që pendohen dhe besojnë e kryejnë vepra të mira, ata do të futen në Xhennet dhe atyre nuk do t’u bëhet padrejtësia më e vogël.”.

“Përveç atyre që pendohen, që besojnë dhe bëjnë punë të mirë. Këta do të hyjnë në Xhennet dhe nuk do t’u bëhet kurrfarë padrejtësie.”

All'llahu i Madhëruar, i ka dhënë mundësi njeriut, që sa është gjallë, të pendohet e të mos heqë dorë nga mëshira e All'llahut. Edhe nëse ka gabuar dhe ka marrë rrugën e keqe, All'llahu i ka lënë mundësinë e pendimit.

Hulumtime

1- Kush është Idrizi?

Sipas transmetimeve të shumë komentuesve, Idrizi është stërgjyshi i Profetit Nuh (*Paqja qoftë mbi të!*).

Emri i tij në Teurat është Ehnus dhe në gjuhën arabe është Idriz. Disa komentues mendojnë se emri i tij vjen nga rrënja e fjalës “derese”, sepse ishte i pari njeri që shkroi më laps.

Ai, përveçse kishte pozitën e Profetit, përvetësonte edhe shkencën e astronomisë, të ekonomisë dhe të shumë shkencave të tjera. Ai që i pari njeri që u mësoi njerëzve mënyrën e të qepurit të rrobave.

Për këtë Profet, Kur’ani flet dy herë në mënyrë të shkurtër. Një herë është ajeti për të cilin po flasim dhe hera tjetër është në suren “Enbija”, ajetet 75-76. Ndërsa në transmetime e hadithe të ndryshme është folur më gjatë për të. Ne nuk i kemi marrë të gjitha si të vërteta, prandaj u mjaftuam me sa thamë më lart për Profetin Idriz (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në një hadith të shkruar në shumë libra të dijetarëve të Ehli Syneetit, shkruhet se Profeti, kur e recitoi këtë ajet “**Pas atyre erdhën brezni...**”, tha: “*Pas gjashtëdhjetë vitesh, do të udhëheqin persona që do ta humbasin namazin, do të drejtohen pas epsheve. Shumë shpejt do të marrin rezultatin e humbjes dhe të paudhësisë. Më pas do të vijë një grup tjetër, që Kur’anin do ta lexojë (me pompozitet), por nuk do të arrijë më tepër se sa te supet e tyre (sepse nuk e lexojnë me sinqeritet, as nuk kuptojnë e meditojnë e as nuk veprojnë çka thotë Kur’ani, por e*

recitojnë atë nga hipokrizia, ose për t'u mjaftuar me shkronjat, e për këtë shkak, veprat e tyre nuk arrijnë te All'llahu i Madhëruar). Në këtë periudhë do të ketë tri grupe që recitojnë Kur'anin: besimtarët, hipokritët dhe të këqijtë.¹ Problemi i njerëzve është njohja e tyre.”.

Nëse numërimi i gjashtëdhjetë viteve do të nisë që nga hixhreti (migrimi) i Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është saktësisht periudha kur Jezidi ulet në karrigen e pushtetit dhe Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), së bashku me shokët e tij, ra shedid (martir). Pjesa tjetër e mbetur është pushteti i Beni Umajadëve dhe më pas e Beni Abasitëve, të cilët ishin mjaftuar me leximin dhe me recitimin e Kur'anit.

I kërkojmë All'llahut të Mëshirshëm mbrojtjen e Tij, që të mos jemi prej këtyre breznive.

¹ Tefsiri “El Mizan”, vëll. 14, f. 84.

Ajetet 61 - 63

جَنَّتٍ عَدْنٍ الَّتِي وَعَدَ الرَّحْمَنُ عِبَادَهُ بِالْغَيْبِ إِنَّهُ كَانَ وَعْدُهُ مَأْتِيًا

لَا يَسْمَعُونَ فِيهَا لَغْوًا إِلَّا سَلَامًا ۖ وَهُمْ فِيهَا زُرَّاهُمْ فِيهَا بُكَرَةٌ وَعَشِيًا ﴿٦١﴾

تِلْكَ الْجَنَّةُ الَّتِي نُورِثُ مِنْ عِبَادِنَا مَنْ كَانَ تَقِيًا ﴿٦٢﴾

“Në kopshtet e Adnit, që i Gjithëmëshirshmi ua ka premtuar robve të Vet, edhe pse ende nuk e kanë parë. Me të vërtetë, premtimi i Tij është i sigurt.”

“Aty nuk do të dëgjojnë llomotitje, por vetëm fjalë përshëndetjeje për paqe dhe do të ushqehen në mëngjes dhe në mbrëmje.”

“Ky është Xhenneti që Ne ua japim në trashëgim robve Tanë të përkushtuar.”

Komentimi

Përshkrim i Xhennetit

Në këto ajete do të shikojmë përshkrimin e mirësive të Xhennetit. Në ajetet e kaluara është folur për mirësi të tjera.

Në fillim përshkruhet Xhenneti i premtuar, me kopshte të përjetshme që Zoti i Mëshirshëm ua ka premtuar atë robve të Tij. Ata, edhe pse nuk e kanë parë atë, kanë besim te ai.

“Në kopshtet e Adnit, që i Gjithëmëshirshmi ua ka premtuar robve të Vet, edhe pse ende nuk e kanë parë. Me të vërtetë, premtimi i Tij është i sigurt.”

Premtimi i Zotit do të përmbushet dhe do të realizohet. Vihet re se në ajetet e kaluara, kur flitet për pendimin, besimin dhe veprat e mira, pas tyre menjëherë vjen premtimi i Xhennetit. Fjala **“Xhennet”** ka ardhur në numrin njëjës, por në këtë rast është në shumës, sepse Xhenneti është i përbërë prej shumë kopshteve të jashtëzakonshme dhe me plot mirësi e begati, të cilat do të jenë në shërbim të besimtarëve punëmirë.

Kur përshkruhet Xhenneti (Adni), përshkrimi bëhet me kuptimin e përjetshëm dhe të përhershëm. Argumenti për këtë përshkrim është se Xhenneti nuk është si kopshtet dhe begatitë e mirësitë e kësaj bote, të cilat janë për një kohë dhe për një periudhë të caktuar e më pas zhduken.

Ajo çka e shqetëson njeriun në këtë botë, është marrëdhënia e tij me begatitë e mirësitë e mëdha që ka në këtë botë, sepse të gjitha ato janë për një periudhë të caktuar kohore. Në Xhennet ky shqetësim nuk ekziston.¹

Fjala **“ibadet”** ka kuptimin **“rob të Zotit”**, të cilët janë besimtarë dhe nuk përfshin të gjithë robtë.

¹ Fjala **“Adn”**, në fjalor ka kuptimin **“ikamet”** - **“qëndrim”**. Në këtë rast, e përçon plotësisht kuptimin e të qëndruarit, sepse do të qëndrojnë përgjithmonë në Xhennet.

Fjala “*bil gajb*” ka kuptimin “*e fshehtë*”, e fshehtë nga shikimi i tyre, por që besojnë në të. Në ajetin 29 dhe 30 të sures “Fexhr”, lexojmë: **“Bashkohu me robtë e Mi dhe hyr në Xhennetin Tim!”**.

Ekziston edhe një tjetër mundësi për kuptimin e fjalës “*bil gajb*”. Ajo është: Mirësitë e Xhennetit janë të tilla, që asnjë sy nuk i ka parë dhe asnjë vesh nuk i ka dëgjuar. Nuk i kanë mbetur as në kujtesë e as mendje. Ato janë të fshehura nga ndjesia dhe perceptimi ynë. Ajo është më e mirë, më e gjerë dhe e jashtëzakonshme dhe syri ynë nuk arrin t’i shikojë me syrin e lirë.

Më pas flitet për një tjetër mirësi nga mirësitë e Xhennetit: Ata nuk flasin më kot dhe pa qëllim.

“Aty nuk do të dëgjojnë llomotitje, por vetëm fjalë përshëndetjeje për paqe dhe do të ushqehen në mëngjes dhe në mbrëmje.”

As nuk gënjejnë e as nuk ofendojnë, as nuk bëjnë thashetheme, as nuk thumbojnë me fjalë as nuk përqeshin, as nuk flasin kot më kot. Ajo çka bie në sy aty, është vetëm fjala përshëndetëse “*Paqja qoftë mbi ju!*”.

Fjala “*selam*” ka kuptim të gjerë, e nënkupton shëndetin e mirë të shpirtit, të mendjes, të gjuhës, të sjelljes, etj. Të gjitha këto janë sjellje të banorëve të Xhennetit.

Aty është paqe dhe i gjithë mjedisi është Xhennet. Nuk ekziston asnjë lloj ngacmimi. Të gjitha të ligat janë larg tij.

Paqja është shenjë e një vendi dhe mjedisi të sigurt. Një mjedis i mbushur me sinqeritet, me dashuri, me pastërti, me devotshmëri, me paqe e me qetësi.

Këtë të vërtetë e shikojmë edhe në ajetet e tjera të Kur'anit të Shenjtë, por me interpretime të ndryshme.

Në ajetin 73 të sures "Ez Zumer" lexojmë: **"Ndërsa ata që i janë frikësuar Zotit të tyre, do të çohen grupe-grupe në Xhennet. Kur t'i afrohen atij, dyert e tij do të hapen e rojtarët e tij do t'u thonë atyre: 'Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, andaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!'"**.

Ndërsa në ajetin 34 të sures "Kaf" lexojmë: **"Hyni në të (Xhennet) me paqe e siguri. Kjo është Dita e amshimit!"**.

Jo vetëm engjëjt i përshëndesin me paqe, por edhe ata e përshëndesin njëri-tjetrit me paqe, ashtu sikurse është përmendur në suren "Jasin", në ajetin 58.

"Paqe! do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë."

A gjendet gjëkund një mjedis i tillë, me bukuri kaq të plota, të cilat janë të mbushura me begati dhe me mirësi?!

Në vazhdim të këtyre mirësive, citohet një tjetër mirësi, që çdo mëngjes dhe mbrëmje do të dëgjojnë vetëm fjalën "paqe".

"...por vetëm fjalë përshëndetjeje për paqe dhe do të ushqehen në mëngjes dhe në mbrëmje."

Kjo fjali ngre dy pyetje. Pyetja e parë: A mos vallë në Xhennet ka natë e ditë?

Përgjigjja e kësaj fjalie është cituar në transmetimet e haditheve: Edhe pse në Xhenetit ka gjithmonë dritë dhe shkëlqim, banorët e Xhenetit do të mund ta dallojnë ndryshimin, me pakësimin apo me shtimin e dritës.

Një tjetër pyetje: Nga ajetet e Kur'anit kuptohet më së miri se banorët e Xhenetit kanë në dispozicion të tyre çfarëdolloj gjëje që dëshirojnë në çdo çast dhe orë, ç'është ky risk që atyre u vjen në mëngjes dhe në mbrëmje?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje e gjejmë në një hadith të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i cili ka thënë: *"Ata në Xhenetit do të marrin shpërblime dhe dhurata interesante nga All'llahu i Madhëruar për shkak të namazit që kanë falur në këtë botë."*¹

Nga ky hadith kuptohet se këto dhurata të shkëlqyera, të cilat nuk mund të imagjinohen e as nuk mund të përshkruhen, janë prej mirësive me vlerë që, përveç mirësive të zakonshme të Xhenetit, atyre do t'u ndahen edhe këto dhurata në mëngjes dhe në darkë.

A nuk është argument ajeti i mësipërm dhe hadithi që cituam më lart, që banorët e Xhenetit nuk kanë një jetë rutinë, por çdo mëngjes dhe çdo darkë atyre do t'u jepet një dhuratë e mirësi e re. A nuk është kuptimi i kësaj fjale që atje, rrugëtimi i përsosmërisë së njeriut, do të ketë vazhdimësi, edhe pse atje nuk kryhen vepra të reja? Por me kompleksin e besimit dhe të veprave që kanë kryer në këtë botë, rrugëtimi i përsosmërisë së tyre do të ketë vazhdimësi.

¹ Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 16, f. 103.

Pas përshkrimit të shkurtër të mirësive materiale dhe shpirtërore të Xhennetit, banorët e Xhennetit përshkruhen me një fjali të shkurtër: Ky është ai Xhenneti që ne ua trashëguam robve tanë punëmirë e që rrinë larg së keqes.

“Ky është Xhenneti që Ne ua japim në trashëgim robve Tanë të përkushtuar.”

Është e qartë se çelësi i të gjitha mirësive për t'u futur në Xhennet nuk është tjetër vetëm se devotshmëria.

Edhe pse interpretimi i fjalës “*ibadina*” - “*robtë e Zotit*”, në një farë kuptimi, flet shkurtimisht për besimin dhe devotshmërinë, këtu nuk është vendi që të mjaftohemi me këtë përshkrim përmbledhës. Por këtë të vërtetë duhet ta shpjegojmë me saktësi, që Xhenneti është vendi i të virtytshmëve dhe i të devotshmëve.

Përsëri këtu hasim fjalën “*trashëgimi*”. Zakonisht kjo fjalë përdoret kur dikush, pasi vdes, i lë trashëgimi dikujt pasurinë e tij. Ndërkohë që Xhenneti nuk i thotë ndonjërit që atë t'ia lërë një tjetri trashëgimi.

Përgjigjen e kësaj pyetjeje mund ta themi në dy mënyra:

Fjala “*trashëgimi*” ka ardhur me kuptimin të bëhesh pronar i një gjëje dhe nuk është e kufizuar vetëm tek trashëgimia pas vdekjes.

Në një hadith nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexojmë: “Çdokush, pa përjashtim, ka një vendqëndrim (shtëpi) në Xhennet dhe një në Xhehennem. Jobsimtarët trashëgojnë vendqëndrimin e jobsimtarëve në

Xhehennem, ndërsa besimtarët trashëgojnë vendin e jobesimtarëve në Xhennet!"¹.

Është e domosdoshme të sqarohet se trashëgimtarët, në këtë rast, nuk janë familjarë, por janë të bazuar në shkollat, veprat dhe devotshmërinë e tyre.

Shkakun e kësaj zbritjeje, disa prej komentuesve e kanë transmetuar po me këtë kuptim, sepse një prej jobesimtarëve, me emrin As bin Vail nuk e pagoi punëtorin e tij mysliman dhe tha: *"Nëse është e vërtetë ajo që thotë Muhammedi, atëherë ne jemi ata që kemi më shumë merita të mirësitë e Xhennetit, andaj ne do t'ua japim atje shpërblimin e punëve të kryera në këtë dynja."*

Kështu zbriti ajeti kur'anor: **"Ky është Xhenneti që Ne ua japim në trashëgim robve Tanë të përkushtuar."**

¹ "Nuruth Thekalejn", vëll, 1, f. 31.

Ajetet 64 - 65

وَمَا نَنْتَزِلُ إِلَّا بِأَمْرِ رَبِّكَ لَهُ مَا بَيْنَ أَيْدِينَا وَمَا خَلْفَنَا وَمَا بَيْنَ ذَلِكَ
وَمَا كَانَ رَبُّكَ نَسِيًّا ﴿٦٤﴾ رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا فَاعْبُدْهُ
وَأَصْطَبِرْ لِعِبَادَتِهِ هَلْ تَعْلَمُ لَهُ سَمِيًّا ﴿٦٥﴾

“(Xhebraili tha): ‘Ne (engjëjt) zbresim vetëm me urdhrin e Zotit tënd. Atij i përket gjithçka që është para nesh, gjithçka që është pas nesh dhe gjithçka që është në mes. Dhe Zoti yt nuk harron kurrë.”

“Ai është Zoti i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që është midis tyre, prandaj, vetëm Atë adhuroje dhe bëhu i qëndrueshëm në adhurimin ndaj Atij. A njeh ti ndokënd që ka Emrin e Tij?!”

Shkaku i zbritjes

Një grup komentuesish janë shprehur kështu për shkakun e zbritjes të këtij ajeti: “Prej disa ditësh ishte ndërprerë Shpallja, kështu që Xhebraili nuk erdhi për një kohë të gjatë te Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Pasi kaloi kjo periudhë dhe Xhebraili u shfaq te

Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha: 'Përse u vonove? Unë pata shumë mall e dëshirë të të shikoja'.

Xhebraili iu përgjigj: 'Unë pata më tepër se sa ti dëshirë dhe mall të vija! Por unë jam rob i dërguar. Kur kam detyrë për të kryer, vij e, kur nuk kam detyrë për të kryer, nuk mund të vij.'"¹

Komentimi

Edhe pse për këto ajete ka një shkak zbritjeje të veçantë, të cilin e cituam më lart, ky shkak i zbritjes nuk do të pengojë lidhjen logjike me ajetet e mësipërme, sepse theksi vihet mbi faktin se çfarëdo që Xhebraili sjell, është vetëm prej All'llahut dhe asgjë nuk është prej Tij.

Së pari, ajeti thotë se **"Ne nuk të shpallim Ty asgjë përveçse me urdhër të All'llahut."**

Gjithçka është prej Zotit, e ne jemi rob të Zotit. Shpirti dhe zemra, e gjithçka kemi para e prapa syve tanë, në krah të majtë e të djathtë, gjithçka është prej Zotit.

¹ Tefsiri "Kurtubi", vëll. 6, f. 4168; tefsiri "Mexhmaul Bejan" në vazhdim të këtij ajeti, (por me pak ndryshim).

“Atij i përket gjithçka që është para nesh, gjithçka që është pas nesh dhe gjithçka që është në mes.”

Përfundimisht, e ardhmja dhe e shkuara, këtu dhe aty dhe gjithkund, kjo botë dhe Bota e Përtejme, Xhenneti dhe Xhehennemi, të gjitha këto i përkasin vetëm Zotit.

“Dhe Zoti yt nuk harron kurrë.”

Disa komentues, këtë fjali e kanë komentuar në mënyra të ndryshme, duke përfshirë në të njëmbëdhjetë komentime. Por ajo çka sollëm ne më lart, është komentimi më i përshtatshëm.

Më tej shton se të gjitha këto janë me urdhër të All'llahut.

“Ai është Zoti i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që është midis tyre.”

Meqë është kështu, atëherë adhuro vetëm Atë (Zotin një).

Adhurimi duhet të jetë me sinqeritet dhe me besimin te Zoti një. Kjo rrugë është rruga e nënshtrimit dhe e bindjes para Zotit. Të adhurosh dhe të jesh i sinqertë me Zotin, ka vështirësi të madhe. Më pas shton, se në rrugën e adhurimit duhet të jemi të duruar.

“Atë adhuroje dhe bëhu i qëndrueshëm në adhurimin ndaj Atij.”

Në fjalinë e fundit pyet, nëse njeriu njeh ndonjë të ngjashëm me Zotin.

“A njeh ti ndokënd që ka Emrin e Tij?!”

Në këtë fjali, në të vërtetë, shikojmë një argument për atë çka u tha në fjalinë e mëparshme. A mos vallë, për qenien e pastër të All'llahut gjendet i ngjashëm me të, që të shtrijë duart drejt Tij dhe ta adhurojnë?!

Fjala “*semie*”, edhe pse ka kuptimin “*me të njëjtin emër*”, në këtë rast, nuk flet vetëm për kuptimin e emrit, por si shembull është cituar emri. Kuptimi i saj është: A gjendet dhe a ka tjetër kënd që është krijues, dhurues i riskut, jetëdhënës, që merr jetë, i ditur, i fuqishëm për të kryer çdo gjë mbi gjithçka?

Ajetet 66 - 70

وَيَقُولُ الْإِنْسَانُ أَإِذَا مَاتَ لَسَوْفَ أَخْرَجَ حَيًّا ﴿٦٦﴾ أَوَلَا يَذْكُرُ
 الْإِنْسَانُ أَنَّا خَلَقْنَاهُ مِنْ قَبْلُ وَلَمْ يَكُ شَيْئًا ﴿٦٧﴾ فَوَرَبِّكَ لَنَحْشُرَنَّهُمْ
 وَالشَّيَاطِينَ ثُمَّ لَنُحْضِرَنَّهُمْ حَوْلَ جَهَنَّمَ جِثِيًّا ﴿٦٨﴾ ثُمَّ لَنَنْزِعَنَّ مِنْ كُلِّ
 شِيعَةٍ أَيُّهُمْ أَشَدُّ عَلَى الرَّحْمَنِ عِتِيًّا ﴿٦٩﴾ ثُمَّ لَنَحْنُ أَعْلَمُ بِالَّذِينَ هُمْ أَوْلَىٰ
 بِهَا صِلًىٰ ﴿٧٠﴾

“Njeriu thotë: ‘Vallë, pasi të vdes, a do të ringjallem përsëri?’

“A nuk e mban mend njeriu se Ne e kemi krijuar atë, kur ende nuk ishte asgjë?!”

“Për Zotin tënd! Ne do t’i tubojmë ata dhe djajtë, pastaj do t’i sjellim ata të gjunjzuar rreth Xhehennemit!”

“Pastaj do të ndajmë prej çdo grupi atë që ka qenë më kokëfortë ndaj të Gjithëmëshirshmit.”

“Ne pastaj e dimë më së miri se kush prej tyre e ka merituar të digjet në të.”

Shkaku i zbritjes

Ajetet 66-67, sipas asaj që kanë komentuar dhe kanë thënë shumica e komentuesve, flasin për Ubei bin Helef ose për Velid bin Mugire, i cili kishte marrë në dorë kocka të kalbura, të cilat, pasi i pluhurosi, i hidhte nëpër vende të ndryshme, duke u kërkuar të tjerëve të thërrisin Muhammedin, që t'i shikojë këto kocka të kalbura dhe t'i ringjallë ato, sepse, sipas Muhammedit, Zoti do të na ringjallë ne, pasi të vdesim dhe pasi kockat tona të bëhen pluhur. Një gjë e tillë sigurisht që nuk është e mundur.

Këto ajete kanë zbritur dhe u kthejnë përgjigje atyre, në çdo periudhe kohore, në shekuj me radhë.

Komentimi

Në ajetet e kaluara, u diskutua dhe u fol për Ringjalljen, Xhennetin dhe Xhehennemin. Edhe këto ajete flasin po për këtë fushë. Në ajetin 66 flet për mohuesit e Ringjalljes, duke e shpjeguar shumë qartë dhe mirë mendimin e njeriut, mëdyshjen e tij: “A do të ringjallem unë, edhe pasi të vdes, do të dal nga varri?!”.

“Njeriu thotë: ‘Vallë, pasi të vdes, a do të ringjallem përsëri?’”

Në të vërtetë, kjo tregon mohimin, që do të thotë se një gjë e tillë është e pamundur. Ndërsa interpretimi i fjalës “*insan*” -

“njeri”, në këtë rast, do ishte më mirë të merrej me kuptimin jobesimtar. Ndoshta për këtë shkak te secili njeri është e fshehur kjo pyetje, e cila lind, pasi dëgjon për Jetën e Përtejme.

Kështu që shumë shpejt, me po të njëjtin ritëm dhe melodi, atyre do t’u kthehet përgjigje, duke u thënë: “A mos vallë njeriu këtë të vërtetë nuk e kujton që u krijua edhe më parë, sepse ai më parë nuk ishte asgjë?!”.

“A nuk e mban mend njeriu se Ne e kemi krijuar atë, kur ende nuk ishte asgjë?!”

Interpretimi i termit “*insan*”, në këtë rast, mund t’i referohet çështjes së talentit të njeriut, si dhe forcës së të menduarit. Duke ditur që njeriu ka talent dhe mendje të dhuruar nga Zoti, si mund të qëndrojë i heshtur përballë një pyetjeje të tillë? Njeriu duhet t’i rikujtojë vetes krijimin, t’i kthejë përgjigje. Nëse kjo nuk ndodh, njeriu nuk e ka marrë seriozisht të vërtetën e të qenit “njeri”.

Këto ajete, ashtu sikurse edhe shumë ajete të tjera që flasin për krijimin, janë mbështetur mbi ringjalljen trupore. Në të kundërt, nëse do të bëhej fjalë që vetëm shpirti do të mbetet dhe rikthimi i trupit në jetë të mos trajtohet, atëherë as pyetja dhe as përgjigja nuk kanë vend.

Sidoqoftë, kjo logjikë, e cila është përdorur për të vërtetuar Ringjalljen, në këtë rast, është përdorur edhe në raste të tjera të Kur’anit Famëlartë, si për shembull, surja “Jasin” e ka trajtuar këtë çështje, me po këtë emër.

“A nuk sheh njeriu se si Ne e krijuam atë prej pikës së farës, e megjithatë ai bëhet kundërshtar i hapët?!”

“Ai na sjell shembull, duke harruar krijimin e vet dhe thotë: ‘Kush do t’i ngjallë eshtrat kur të kalben?’”

“Thuaj: ‘Do t’i ngjallë Ai që i krijoi ato për herë të parë; Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë.’”

Disa komentues, për këtë rast, shtruan një pyetje: “Nëse ky argument është i drejtë, që çdokush që kryen një punë, ka fuqi ta kryejë atë si më parë, përse ne kryejmë punë të cilat nuk mund t’i kryejmë si më parë, ose nuk kemi fuqinë që t’i përsërisim ato? Për shembull, ndonjëherë ne shkruajmë poezi shumë të bukura, ose ndonjëherë shkruajmë me një shkrim shumë të bukur dhe, kur duam t’i përsërisim këto një herë tjetër, nuk mund t’i bëjmë si më parë.

Përgjigja që në kemi zgjedhur për këtë pyetje, është: Është e vërtetë që ne, punët tona i kryejmë sipas vullnetit tonë, por ndonjëherë vullnetit tonë i bashkëngjiten një sërë çështjesh të tjera, të cilat nuk janë në dorën tonë, por që ndikojnë te punët dhe te veprat tona. Një lëvizje jo e dëshiruar nga ne bëhet shkak që shkrimi ynë të prishet dhe kështu nuk e realizojmë atë si më parë. Po ashtu, ndonjëherë ndodh që të gjitha forcat tona i vendosim në lëvizje dhe ne i kryejmë të gjitha detyrat tona. Por ndonjëherë ndodh që ne të kemi një gjendje jo të mirë dhe forcat tona nuk vihen në lëvizje dhe punët që do të kryenim, nuk janë si ato të radhës së parë.

Po, All’llahu që ka fuqi absolute dhe të pakufizuar, nuk i ka këto probleme. Çdo gjë që e kryen, e kryen me saktësi dhe të njëjtë me atë që ka kryer më parë.

Në ajetin tjetër kërcënohen mohuesit e Ringjalljes.

“Për Zotin tënd! Ne do t’i tubojmë ata dhe djajtë, pastaj do t’i sjellim ata të gjunjëzuar rreth Xhehennemit!”

Ky ajet tregon se gjykimi i personave pa besim dhe mëkatarë është pranë Xhehennemit.

Fjala “*xhithian*” është shumësi i fjalës “*xhathi*” dhe ka kuptimin, “*person i ulur në gjunjë*”. Ndoshta tregon dobësinë, pamundësinë, etj. A thua nuk kanë fuqi që të qëndrojnë në këmbë?! Faktikisht, kjo fjalë ka edhe kuptim tjetër, si për shembull, grupe-grupe.

Disa e kanë komentuar grumbuj-grumbuj, të dherave apo të gurëve. Komentimi i parë është më i përshtatshëm dhe më i njohur, sepse parimi kryesor në atë gjykim është drejtësia.

Ajeti tjetër thotë se Zoti, së pari, do të gjykojë njerëzit më të pabindur. Do t’i ndajë njerëzit që nuk iu bindën Zotit Mëshirëplotë.

“Pastaj do të ndajmë prej çdo grupi atë që ka qenë më kokëfortë ndaj të Gjithëmëshirshmit.”

Përsëri, duke u bazuar tek ky kuptim, thotë se është në dijeni për personat që duhet të digjen të parët në zjarr.

“Ne pastaj e dimë më së miri se kush prej tyre e ka merituar të digjet në të.”

Fjala “*silije*” është paskajore, e cila mund të marrë kuptimin “*për të ndezur zjarrin*”, gjithashtu merr kuptimin “*gjëra që digjen me zjarr*”.

Ajetet 71 - 72

وَإِنْ مِنْكُمْ إِلَّا وَارِدُهَا كَانَ عَلَى رَبِّكَ حَتْمًا مَقْضِيًّا ﴿٧١﴾ ثُمَّ نُنَجِّي
الَّذِينَ اتَّقَوْا وَنَذَرُ الظَّالِمِينَ فِيهَا جِثًّا ﴿٧٢﴾

“Dhe nuk ka asnjë prej jush që të mos arrijë tek ai (Xhehennemi). Kjo është vendosur prerazi nga Zoti yt.”

“Pastaj do t’i shpëtojmë ata që kanë qenë besimtarë dhe do t’i lëmë keqbërësit të gjunjëzuar në të.”

Komentimi

Ajetet e mësipërme flasin përsëri për vazhdimësinë e cilësive të Ringjalljes, si dhe për shpërblimin dhe dënimin.

Së pari, do të flasim për një çështje, që, për shumicën e njerëzve, është shumë e habitshme: Të gjithë ju, pa dallim do të hyni në Xhehennem.

“Dhe nuk ka asnjë prej jush që të mos arrijë tek ai (Xhehennemi). Kjo është vendosur prerazi nga Zoti yt.”

Më pas, ata që janë ruajtur nga mëkatet, si dhe janë të devotshëm, do të shpëtojnë. Ndërsa zullumqarët dhe punëkëqijtë do të hidhen në Xhehennem, edhe pse do të bien në gjunjë.

“Pastaj do t’i shpëtojmë ata që kanë qenë besimtarë dhe do t’i lëmë keqbërësit të gjunjëzuar në të.”

Në komentim të këtyre dy ajeteve, midis komentuesve ka diskutim. Ata, duke u bazuar në qëllimin e fjalës **“hyrje”**, thanë: Fjala **“hyrje”**, në këtë rast, ka kuptimin të afrohesh afër dhe të jesh fisnik, i afërm.

Kjo do të thotë se të gjithë njerëzit, të mirë e të këqij, pa asnjë dallim, për dhënie llogarie, ose për të parë të ardhmen përfundimtare të punëkëqijve, do të qëndrojnë pranë Xhehennemit. Më pas All’llahu, punëmirët i liron dhe punëkëqijtë i hedh në Xhehennem.

Ata, për të komentuar këtë ajet, janë bazuar në ajetin 23 të sures **“Kasas”**.

“Kur arriti tek pusi i Medjenit, ndeshi rreth tij shumë njerëz që u jepnin ujë kafshëve. Përveç tyre, ai vuri re dy vasha që po mbanin kafshët e veta. Ai tha: ‘Si e keni hallin ju?’ Ato thanë: ‘Ne nuk u japim ujë, pa u larguar barinjtë. Babai ynë është shumë plak.’”

Edhe në këtë ajet, është përdorur fjala “*verede*” - “*arriti*”, e cila është përdorur edhe në ajetin për të cilin po flisnim.

Ndërsa komentimi i dytë, të cilin e kanë përzgjedhur shumica e komentuesve, është: Fjala “*verede*”, në këtë rast, është marrë me kuptimin “*do të hyjnë*”. Pra, në këtë mënyrë, të gjithë, pa përjashtim, do të hyjnë në Xhehennem, por zjarri i Xhehennemit për punëmirët do të jetë i ftohtë, ashtu sikurse ishte zjarri i Nemrudit për Profetin Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në ajetin 69 të sures “El Enbija” lexojmë: **“Ne thamë: ‘O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!’”**.

Zjarri nuk afrohet te besimtarët. Ai qëndron larg prej tyre. Kudo që ata të qëndrojnë, zjarri fiket. Ndërsa për sa u përket banorëve të Xhehennemit, atyre zjarri u ngjitet nga pas dhe marrin menjëherë flakë.

Filozofinë e kësaj çështjeje, do ta shikojmë në vazhdim, në dashtë All’lëhu. Padyshim që pamja e jashtme e ajetit të mësipërm, me komentimin e dytë, është në përputhje me thelbin e ajetit, sepse kuptimi kryesor i fjalës “*hyrje*” është fjala “*futen*”. Nëse do të ishte ndryshe, do të kishte nevojë për shoqërues apo shembull për ta qartësuar atë që thamë në komentim të ajetit.

Përveç kësaj, fjalia: **“Dhe nuk ka asnjë prej jush që të mos arrijë tek ai (Xhehennemi). Kjo është vendosur prerazi nga Zoti yt.”**.

Më pas thotë se punëmirët do t'i shpëtojmë dhe punëkëqijtë do të qëndrojnë në zjarr. Të gjitha këto janë dëshmi për atë që u tha më lart.

Përveç transmetimeve të shumta që na kanë arritur për komentimin e këtij ajeti, ky kuptim është përfundimisht i plotësuar dhe i forcuar. Në një hadith të transmetuar nga Xhabir bin Abdullah Ensari thuhet: *"Një person pyeti për këtë ajet. Xhabiri, me dy gishtat, bëri me shenjë te dy cepat dhe tha: 'Këtë çështje e kam dëgjuar me këta dy veshë nga vetë Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Nëse gënjej, m'u shurdhofshin të dy veshët'.*

Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: *'Fjala vurud, në këtë rast, ka kuptimin futen. Asnjë punëmirë dhe punëkeq nuk do të qëndrojë pa u futur në Xhehennem. Zjarri, për besimtarët, do të jetë i ftohtë, ashtu sikurse ishte për Profetin Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!). Freskia e tij do të jetë shumë e madhe, saqë do të thërrasë me zë të lartë nga freskia e madhe që ka. Më pas, All'llahu do t'i ledhatojë dhe do t'i falë punëmirët, ndërsa zullumqarët e punëkëqijtë do t'i lërë aty.'"*¹

Në një hadith tjetër të Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), lexojmë: *"Zjarri, në Ditën e Kiametit, u thotë personave besimtarë: 'Largohuni nga unë sa më parë, sepse drita juaj më fik flakët.'"*²

Po ky kuptim është përdorur edhe te disa transmetime të tjera. Një tjetër interpretim me shumë kuptim, është përdorur për Urën e Siratit, e cila qëndron mbi Xhehennem dhe është më e hollë

¹ "Nuruth Thekalejn", vëll. 3, f. 353 – 354.

² "Nuruth Thekalejn", vëll. 3, f. 353, 354.

se një fije floku dhe më e mprehtë se shpata. Edhe kjo është një tjetër dëshmi dhe shenjë tjetër, për sa i përket këtij komentimi.¹

Ndërsa, për sa i përket faktit që thonë disa, se ajeti 101 i sures “El Enbija”: **“Ndërsa ata të cilëve u ka prirë mirësia Jonë qysh më parë, do të jenë larg nga Xhehennemi.”**, është argument për komentimin e parë, nuk është i drejtë, sepse ky ajet ka të bëjë me vendndodhjen e përhershme dhe qëndrimin e përhershëm të besimtarëve. Po ashtu, edhe në ajetin tjetër pas këtij, lexojmë: **“Ata nuk do të dëgjojnë fërshëllimën e tij dhe do të qëndrojnë përherë në atë që u ka dëshiruar shpirti i tyre.”**.

Nëse në ajetin e parë, fjala *“vurud”* - *“hy”*, do të kishte kuptimin *“të afrohesh”*, atëherë kjo fjalë nuk është në përputhje as me fjalën *“mubderun”* e as me fjalinë *“la jesmeune hesiseha”*.

E vetmja pyetje që lind në këtë rast, është: Si është filozofia e kësaj pune për nga ana e Urtësisë së All’liahut? Përveç kësaj, a nuk heqin keq dhe a nuk dënohen besimtarët në këtë rast?

Përgjigje: Për të dyja këto që thamë, kemi përgjigje nga hadithet dhe nga transmetimet islame. Me pak vëmendje qartësohet se Xhehennemi dhe dënimet e tij janë parahyrje për besimtarët, për të vlerësuar mirësitë që All’llahu na ka dhuruar në Xhennet, sepse mirësinë e shëndetit e di ai që është shëndetlig.

Në këtë rast, besimtarët nuk janë në siklet e as në vështirësi, por ata vetëm shikojnë skenën e vështirësisë. Ashtu sikurse edhe e pamë më lart, zjarri ata nuk i djeg, sepse drita e tyre e shuan flakën e zjarrit.

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 5, f. 572, në vazhdim të ajetit 14 të sures “El Fexhr”.

Përveç kësaj, ata kalojnë aq shpejt nga zjarri, saqë atyre nuk u dëmtohet as gjëja më e vogël.

Në një hadith të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: "Njerëzit të gjithë do të hyjnë në zjarrin e Xhehennemit dhe më pas, sipas veprave të tyre dhe llogarisë, dalin jashtë. Disa prej tyre kalojnë shpejt sikur energjia, disa sikur shpejtësia e vrapimit të kuajve, disa sikur janë duke ecur mbi kuaj që ecin normalisht e të tjerë sikur ecin në këmbë, por me shpejtësi, ndërsa të tjerët do të dalin nga zjarri sikur po ecin në këmbë në mënyrë normale."¹

Banorët e Xhehennemit, kur shikojnë këto skena nga banorët e Xhennetit, që e kalojnë zjarrin me lehtësi dhe me shpejtësi, ndërsa vetë ata qëndrojnë aty për t'u dënuar, vuajnë edhe më tepër.

Kështu, pra, u dhamë përgjigje të dyjave pyetjeve.

¹ "Nuruth Thekalejn", vëll. 3, f. 353

Ajetet 73 - 76

وَإِذَا تُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ آيَاتُنَا بَيِّنَاتٍ قَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لِلَّذِينَ ءَامَنُوا أَيُّ
 الْفَرِيقَيْنِ خَيْرٌ مَّقَامًا وَأَحْسَنُ نَدِيًّا ﴿٧٣﴾ وَكَمْ أَهْلَكْنَا قَبْلَهُم مِّن قَرْنٍ هُمْ
 أَحْسَنُ أَثْنًا وَرِئًا ﴿٧٤﴾ قُلْ مَن كَانَ فِي الضَّلَالَةِ فَلْيَمْدُدْ لَهُ الرَّحْمَنُ مَدًّا
 حَتَّىٰ إِذَا رَأَوْا مَا يُوعَدُونَ إِمَّا الْعَذَابَ وَإِمَّا السَّاعَةَ فَسَيَعْلَمُونَ مَنْ هُوَ
 شَرُّ مَّكَانًا وَأَضْعَفُ جُندًا ﴿٧٥﴾ وَيَزِيدُ اللَّهُ الَّذِينَ اهْتَدَوْا هُدًى
 وَالْبَاقِيَتُ الصَّلَاحُ خَيْرٌ عِنْدَ رَبِّكَ ثَوَابًا وَخَيْرٌ مَّرَدًّا ﴿٧٦﴾

“Kur u lexohen vargjet Tona të qarta, jobesimtarët u thonë atyre që kanë besuar: ‘Cili grup ka pozitë më të mirë dhe rreth më të mirë?’”

“Por sa e sa brezni, që kanë qenë më të begatshëm dhe më të pashëm, Ne i kemi shkatërruar para tyre!”

“Thuaj (o Muhammed): ‘Atyre që janë të humbur, i Gjithëmëshirshmi u dhëntë jetë’, në mënyrë që, kur të shohin atë që u është premtuar: ose dënimin (në këtë jetë) ose Orën (e

Kiametit), atëherë ta marrin vesh se kush ka pozitë më të keqe dhe rreth më të dobët.”

“All’llahu ua shton udhëzimin atyre, që janë në rrugë të drejtë. Veprat e mira që mbessin, janë të shpërblyera më mirë te Zoti yt dhe kanë përfundim më të mirë.”

Komentimi

Në ndjekje të ajeteve që diskutuam më lart, për sa u përket zullumqarëve të pafe, do të diskutojmë për logjiken dhe fatin e tyre.

Ne e dimë që grupi i parë që besoi Profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishin të pastër në zemër dhe duart e tyre nuk ishin të përziera me mallrat e kësaj bote. Ata ishin një prej grupeve të dhunuara, që feja e All’llahut kishte zbritur që ata t’i shpëtojë nga kthetrat e dhunuesve dhe të zullumqarëve. Burra dhe gra të tillë, si: Bilali, Selmani, Amari, Hebabi, Semije, etj.

Vlerat dhe kriteri vlerësues në atë shoqëri injorante, si në të gjitha shoqëritë e tjera injorante, ishte floriri, pasuria dhe pozita e jashtme. Pasanikë punëkeq, si Nadher bin Harith dhe të tjerë si lloji i tij, dhunonin besimtarët e varfër, si dhe mburreshin para tyre, duke u thënë se një prej shenjave të personalitetit të tyre ishte me ta dhe mospasja personalitet ishte me të varfrit. Kjo, në

vetvete, ishte argument se ata ishin të drejtë e të vërtetë, ndërsa të tjerët, populli i thjeshtë, jo i drejtë.

Ajeti 73 thotë: **“Kur u lexohen vargjet Tona të qarta, jobesimtarët u thonë atyre që kanë besuar: ‘Cili grup ka pozitë më të mirë dhe rreth më të mirë?’”**.

Për sa u përket këtyre personave që mburren dhe mendojnë se janë më me pozitë vetëm se janë të pasur dhe vishen bukur, i hasim shumë në transmetimet islame. Ata ecnin pranë shokëve të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i shikonin ata me përulje dhe tallje, sepse vetë visheshin bukur. Po, këta janë të tillë njerëz, që në çdo kohë janë të tillë.

Fjala “*nedie*”, në origjinë është “*nedej*” dhe ka marrë kuptimin “*gjë e lagët*”. Më pas është përdorur për personat që flasin qartë e bukur.

Një nga kushtet e fuqisë së të folurit, ishte të kishe pështymë të mjaftueshme. Më pas, fjala “*neda*” u përdor me kuptimin “*takim*” dhe “*të flasësh*”.

Po ashtu, edhe në takimet që bëheshin në rrethet e ngushta apo për t’u këshilluar, personat i quanin “*nadi*” ose “*darul nadvi*”, i cili ishte vend në Mekë. Të mëdhenjtë e vendit grumbulloheshin aty dhe këshilloheshin me njëri-tjetrin. Nga kjo ka marrë edhe emrin.

Po ashtu, ndonjëherë, për shkak të bujarisë, ata i quanin *“nedeje”*.¹

Ajeti i mësipërm mund të flasë për këta tipa, që duan të tregojnë se takimet dhe bisedat e tyre këshilluese ishin më të bukura dhe më mbresëlënëse se sa takimet e të tjerëve. Paratë dhe pasuria, floriri dhe rrobat e tyre ishin më interesante se sa të të tjerëve. Jo vetëm kaq, por edhe e folura e tyre ishte më elokuede dhe më e mirë se sa e të tjerëve.

Por Kur'ani i Shenjtë, me një shprehje plotësisht të arsyeshme dhe në të njëjtën kohë të prerë dhe plotësisht të vendosur, u kthen atyre përgjigje: A thua ata e kanë harruar historinë e të kaluarve? Popujt të panumërt kanë jetuar para tyre, që jo vetëm pasurinë dhe mjetet e tyre të jetesës i kishin më të mira se këta, por edhe pamja e tyre e jashtme ishte më e mirë se e këtyre. Këta popuj u zhdukën dhe u larguan, sepse ishin zullumqarë.

“Por sa e sa brezni, që kanë qenë më të begatshëm dhe më të pashëm, Ne i kemi shkatërruar para tyre!”

A mos vallë, paratë dhe bukuria e tyre, rrobat e bukura do të pengonin dënimin e All'lahut?

Nëse këto do të ishin argumente për të arritur pozitën te All'lahu i Madhëruar, përse patën këtë fat?!

Floriri, paratë e pasuria e kësaj bote është aq e paqëndrueshme, saqë me një fllad të lehtë gjithçka zhduket.

¹ Ragib “Mufredat”, kapitulli i fjalës *“Nedeje”*.

Fjala “kern”, ashtu siç e thamë edhe më parë, ka kuptimin “një kohë e gjatë”. Por për shkak se vjen nga origjina e fjalës “ikteran”, ka kuptimin “për së afërmi”. Një populli dhe një grumbulli njerëzish, që në një kohë janë të grumbulluar, u thuhet “ikteran”.

Më pas ata i paralajmëron, duke u thënë: U thuaj atyre, punëkëqijve, të mos hamendësojnë apo të mos mendojnë se pasuria dhe paraja e tyre do të jetë burim mëshire. Por mund të jetë argument për të marrë dënimin e Zotit. Ai që është në rrugë të keqe dhe këmbëngul për ta vazhduar këtë rrugë, Zoti i jep afat dhe kjo jetë e pasur do të vazhdojë.

“Thuaj (o Muhammed): ‘Atyre që janë të humbur, i Gjithëmëshirshmi u dhëntë jetë’, në mënyrë që, kur të shohin atë që u është premtuar; ose dënimin (në këtë jetë) ose Orën (e Kiametit), atëherë ta marrin vesh se kush ka pozitë më të keqe dhe rreth më të dobët.”

Në të vërtetë, për të tillë njerëz të dalë nga rruga e Zotit, të cilët nuk e kanë kapacitetin e të udhëzuarit, Kur’ani thotë: **“Men kane fil dhelal”**. E ka fjalën për zullumqarët, të cilët vazhdimisht ecin në rrugë të keqe dhe e kanë humbur rrugën e drejtë. Ndonjëherë Zoti i zhyt ata në mirësi, sa që ajo mirësi bëhet burim i mendjemadhësisë dhe i mospërfilljes. Dënimi i Zotit bëhet shkak i heqjeve të mirësive. Kjo është ajo gjë që është cituar në ajetet kur’anore, si dënim për të tërhequr vëmendjen.

Ndërsa fjalia: **“i Gjithëmëshirshmi u dhëntë jetë...”**, edhe pse ka ardhur në formën urdhërore, kuptimin e ka si fjali lajmëruese. Kuptimi i saj është: All’llahu u jep atyre afat dhe vazhdimësi të mirësisë.

Disa komentues, këtë fjali e kanë marrë me kuptimin *“mallkim”*, ose Zoti është i detyruar që të sillet në këtë mënyrë. Komentimi i parë duket më i drejtë.

Fjala *“dënim”*, në ajetin e mësipërm, e cila është e vendosur në simetri përballë fjalës *“esaeh”*, tregon për dënimin e All'Ilahut në këtë botë, si: tufani i Profetit Nuh, tërmeti dhe gurët qiellorë që ranë mbi popullin e Profetit Lut, apo dënime që vijnë nga ana e besimtarëve. Këtë e lexojmë në ajetin 14, të sures *“Et Teube”*.

“Luftoni kundër tyre, që All'Ilahu t'i dënojë ata me duart tuaja, t'i poshtërojë, t'ju ndihmojë juve kundër tyre, t'i shërojë shpirtrat e besimtarëve...”

Në këtë rast, fjala *“esaeh”* ka kuptimin *“fundi i kësaj bote”*, ose *“dënimi i All'Ilahut në Ditën e Kiametit”*. Kuptimi i dytë është më i përshtatshëm. Ky, pra, është fati i tiranëve dhe i shtypësve të mashtruar dhe të magjepsur nga kënaqësitë e kësaj bote. Por ata që hodhën hapa në rrugën e udhëzimit, atyre u shtohet udhëzimi.

“All'Ilahu ua shton udhëzimin atyre, që janë në rrugë të drejtë.”

Natyrisht që udhëzimi ka arritjet e tij. Në kohën kur gradat dhe arritjet e tij të para nëpërmjet njeriut të bashkëngjiten, Zoti e merr përdore dhe e ngjit në grada më të larta. Njerëzit e udhëzuar janë sikurse pemët e sapombjella, që çdo ditë kalojnë një stad dhe zhvillim të ri. Ky udhëzim, po ashtu, në bazë të veprave dhe të besimit, hedh hapat për më lart.

Në fund të ajetit, ata që janë mbështetur te imazhi kalimtar i kësaj bote dhe atë e kanë si mjet krenarie për të tjerët, u jepet

përgjigjja se ajo që mbetet nga veprat dhe punët e njeriut, është më me vlerë pranë Zotit, ka mirësi më të mëdha, si dhe e ardhmja e tij do të jetë më me vlerë.

“Veprat e mira që mbessin, janë të shpërblyera më mirë te Zoti yt dhe kanë përfundim më të mirë.”

Ajetet 77 - 82

أَفَرَأَيْتَ الَّذِي كَفَرَ بِآيَاتِنَا وَقَالَ لَأُوتِيَنَّ مَالًا وَوَلَدًا ﴿٧٧﴾ أَطَّلَعَ
 الْغَيْبَ أَمْ اِتَّخَذَ عِنْدَ الرَّحْمَنِ عَهْدًا ﴿٧٨﴾ كَلَّا ۚ سَنَكْتُبُ مَا يَقُولُ
 وَنَمُدُّ لَهُ مِنَ الْعَذَابِ مَدًّا ﴿٧٩﴾ وَنَزِثُهَا مَا يَقُولُ وَيَأْتِينَا فَرْدًا ﴿٨٠﴾
 وَاتَّخَذُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ آلِهَةً لِّيَكُونُوا لَهُمْ عِزًّا ﴿٨١﴾ كَلَّا ۚ سَيَكْفُرُونَ
 بِعِبَادَتِهِمْ وَيَكُونُونَ عَلَيْهِمْ ضِدًّا ﴿٨٢﴾

“Vallë, a e ke parë atë që nuk beson në shenjat Tona dhe thotë:
 ‘Mua do të më jepet (Ditën e Kiametit) edhe pasuria, edhe
 fëmijët?!’”

“A mos ndoshta ai e di të padukshmen apo ka marrë ndonjë
 premtim nga i Gjithëmëshirshmi?”

“Kurrsesi! Ne do ta shënojmë atë që flet dhe do t’ia zgjasim
 vuajtjen.”

“Ne do t’ia marrim atij gjithçka për të cilat flet e ai te Ne do të
 vijë i vetëm.”

“Ata kanë marrë zota, në vend të All’llahut, për t’i pasur
 ndihmës.”

“Por jo! Ata do ta mohojnë adhurimin e tyre dhe do të bëhen armiqtë e tyre.”

Komentimi

Disa njerëz besojnë se besimi, devotshmëria nuk është aspak e përshtatshme për ta. Me fjalë të tjera, nuk u shkon atyre. Dhe kështu bëhet shkak që kjo botë t’u kthejë kurrizin. Ndërkohë që, duke u larguar nga mjedisi i besimit dhe i devotshmërisë, bota do të vijë pas tyre, kështu që edhe pasuria e tyre do të shtohet shumë.

Kjo mënyrë e të menduarit, si të jetë për shkak të ndjekjes së besëtytnive, si për të mbuluar largimin e tyre për të mos iu nënshtruar përgjegjësive dhe premtimeve të Zotit, apo çdo gjëje tjetër, është e rrezikshme.

Ndonjëherë kemi parë që adhurimi fiktiv, pasuria e njerëzve pa besim, si dhe varfëria dhe përjashtimi i grupit të besimtarëve është një pretekst për të vërtetuar të tilla besëtytni dhe paragjykime. Ndërkohë që ne e dimë se as pasuria e fituar nëpërmjet dhunës e as të qenit jobesimtar, e as braktisja e rregullave të devotshmërisë, nuk janë burim krenarie për njeriun. Po ashtu, as besimi dhe as largimi nga të ligat nuk është digë që pengon aktivitetin e lejueshëm.

Sidoqoftë, në periudhën e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sikurse edhe në epokën tonë, gjenden persona të paditur, të cilët kanë të tilla mendime, ose të paktën shtiren si të tillë.

Kur'ani i Shenjtë, në ajetet për të cilat po diskutojmë, në përputhje me diskutimin që patëm më parë, rreth fatit të qafirëve dhe të dhunuesve, flet për mënyrën e të menduarit të tyre dhe për fatin e tyre.

Në ajetin 77, All'llahu thotë: **“Vallë, a e ke parë atë që nuk beson në shenjat Tona dhe thotë: ‘Mua do të më jepet (Ditën e Kiametit) edhe pasuria, edhe fëmijët?!’”**.¹

Më pas, Kur'ani u përgjigjet atyre në këtë mënyrë: **“A mos ndoshta ai e di të padukshmen apo ka marrë ndonjë premtim nga i Gjithëmëshirshmi?”**.

Dikush mund të paramendojë kështu dhe ta besojë apo të pretendojë se marrëdhënia midis ateizmit, pra, kufrit dhe të pasurit fëmijë, është gjë e mundshme. Si mund të kenë dijeni për të fshehtën? Ne nuk shikojmë asnjë lidhje apo ngjashmëri midis

¹ Disa komentues, për sa i përket shkakut të zbritjes së këtij ajeti, thonë: *“Një besimtar, me emrin Hebab, i kishte borxh një jobesimtari, me emrin As bin Vail. Personi borxhli, për t'u tallur me të, i tha: ‘Në Botën Tjetër, kur të gjej pasurinë dhe fëmijët, do të ta shlyej borxhin.’”*.

Sipas mendimit tonë, ky shkak nuk ka asnjë përputhje me ajetin që po diskutojmë, sepse në e dimë se në Botën Tjetër nuk flitet për fëmijët. Po ashtu, ajeti tjetër, në mënyrë të qartë, thotë: **“Këtë pasuri për të cilën ai flet, e trashëgojmë”**.

Nga ky interpretim qartësohet më së miri se bëhet fjalë për pasurinë e kësaj bote dhe jo të Botës së Përtejme. Po ashtu, një grup komentuesish, në përputhje me shkakun e zbritjes, mendojnë se ajeti flet për Botën e Përtejme. Por e drejta është ajo që thamë më lart.

këtyre të dyjave. Nuk shikojmë asnjë premtim të Zotit, që të jetë marrë. Një fjalë e tillë është pa kuptim.

Ajeti tjetër në një mënyrë shumë të prerë shton: **“Kurrresi! Ne do ta shënojmë atë që flet dhe do t’ia zgjasim vuajtjen.”**.

Po, një fjalë e tillë, e pabazuar, mund të largojë nga rruga e drejtë disa prej atyre që janë të padjallëzuar. Të gjitha veprat e tyre do të regjistrohen në dosjen e veprave.

“...do t’ia zgjasim vuajtjen.”. Kjo fjali mund të tregojë dënimin, vuajtjen e zgjatur dhe të përjetshme të Botës së Përtejme.

Po ashtu, kjo fjali mund të flasë për vuajtjet dhe dënimet që vijnë për shkak të mosbesimit dhe mund t’i vuajnë në këtë botë. Një tjetër mundësi është se kjo pasuri dhe fëmijët që ata kanë, janë burim i mendjemadhësisë dhe i daljes nga rruga e drejtë, e cila është dënim i vazhdueshëm.

“Ne do t’ia marrim atij gjithçka (prej pasurisë dhe fëmijëve) për të cilat flet e ai te Ne do të vijë i vetëm.”

Përfundimi i të gjitha këtyre mundësive materiale do të jetë i kotë, sepse të gjitha do të largohen dhe në atë Ditë do të kthehet me duar bosh para drejtësisë së Zotit Fuqiptotë. Ndërkohë që libri i veprave do të jetë bërë sterrë dhe do të jetë boshatisur nga mirësitë. Atje do të shikojnë se si do të jetë rezultati i thënieve të pa baza në këtë botë.

Ajeti tjetër flet për një tjetër dëshirë prej dëshirave të këtyre personave, që është adhurimi i idhujve. Ata adhurojnë idhuj, që t’i kenë burim pasurie dhe nderi.

“Ata kanë marrë zota, në vend të All’llahut, për t’i pasur ndihmës.”

Arsyeja e marrjes së idhujve është se ata shpresojnë që këta idhuj të ndërmjetësojnë e të bëjnë shefaet (ndërmjetësim) te Zoti, si dhe t’i ndihmojnë ata për problemet që kanë. Por sa mendim i padrejtë dhe i gabuar, si dhe sa imagjinatë boshe kanë!

Nuk është ashtu sikurse ata menduan, jo vetëm që idhujt nuk do t’i ndihmojnë, por as do t’i pasurojnë e as do t’i nderojnë ata. Ata do të mësojnë se burimi i dënimit dhe i çnderimit do të jetë ky adhurim i padrejtë ndaj idhujve. Për këtë shkak, shumë shpejt, në Ditën e Ringjalljes, adhuruesit, të cilët janë bërë mohues, do t’i shikojnë, ata nuk do t’i duan aspak dhe do të jenë kundër tyre.

“Por jo! Ata¹ do ta mohojnë adhurimin e tyre² dhe do të bëhen armiqtë e tyre.”

Kjo fjali flet për çështjen që do ta lexojmë edhe në ajetet 13–14 të sures “El Fatir”.

“Ai e bën natën të kalojë në ditë dhe ditën të kalojë në natë. Ai i ka nënshtruar Diellin dhe Hënën, kështu që secili lëviz për një kohë të caktuar. Ky është All’llahu, Zoti juaj. Pushteti është i Tij! Kurse ata që ju i adhuronin krahas Tij, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës.”

“Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t’ju përgjigjeshin. Në Ditën e

¹ Zotat e remë.

² Idhujtarëve.

Kiametit, ata do ta mohojnë adhurimin që u bënit atyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (o Muhammed) ashtu si Ai që është i Gjithëdijshëm."

Personat që duan të tjerë në vend të Zotit, nuk do jenë pronarë të asgjëje. Nëse ata do t'i thërrisni, ata nuk do ta dëgjojnë fjalën tuaj... Në Ditën e Kiametit do të jenë mohues të shirkut tuaj.

Në ajetin 6 të sures "El Ahkaf" lexojmë: **"Kur të tubohen njerëzit (në Ditën e Gjykimit), idhujt do të jenë armiq të tyre dhe do ta mohojnë adhurimin e tyre."**

Këtë mundësi e kanë dhënë edhe disa prej komentuesve të mëdhenj, të cilët thonë se qëllimi i ajetit është të tregojë se adhuresit e idhujve, në Ditën e Kiametit, kur gjithçka të jetë e qartë dhe e vërteta të dalë në pah, do të turpërohen duke parë veten e tyre. Po ashtu, do të jenë edhe mohues të adhurimit të idhujve, si dhe do të flasin kundër tyre. Këtë gjë e tregon edhe ajeti 23 i sures "El En'am".

"Ata nuk do të mund të shfajësohen ndryshe, veçse duke thënë: 'Betohemi në All'llahun, Zotin tonë, nuk kemi qenë idhujtarë!'"

Komentimi i parë është më i përshtatshëm, sipas këndvështrimit të parë (pamjen e jashtme), sepse adhuresit dëshironin që idhujt të ishin nderi i tyre. Por si përfundim, ata do të jenë kundër tyre.

Por idhujt, si engjëjt apo shejtanët dhe xhindet, të cilët kanë mendje, gjendja e tyre është e qartë. Por për idhujt, që nuk kanë

shpirt, atë Ditë mund të flasin me urdhër të Zotit, për të treguar mërzinë e tyre ndaj adhuruesve.

Në një hadith të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet: *“Në Ditën e Kiametit adhuruesit që kanë zgjedhur idhujt në vend të Zotit, idhujt do t’u kthehen kundër tyre, duke qenë kundër tyre dhe adhurimit të tyre.”.*

Është për t’u habitur se si një fjali e shkurtër, në vazhdim të hadithit, flet për adhurimin dhe të vërtetën e tij.

*“Adhurim nuk është vetëm të biesh në sexhde dhe ruku. E vërteta e adhurimit është bindja ndaj sexhdes dhe rukusë. Çdokush që adhuron një krijesë, është futur në gjynah dhe e ardhmja e tij është si ajo e jobesimtarëve.”.*¹

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 357.

Ajetet 83 - 87

أَلَمْ تَرَ أَنَّا أَرْسَلْنَا الشَّيَاطِينَ عَلَى الْكَافِرِينَ تُوْزُهُمْ أَزًّا ﴿٨٣﴾ فَلَا تَعْجَلْ عَلَيْهِمْ ۖ إِنَّمَا نَعُدُّ لَهُمْ عَدًّا ﴿٨٤﴾ يَوْمَ نَخْشِرُ الْمُتَّقِينَ إِلَى الرَّحْمَنِ وَفْدًا ﴿٨٥﴾ وَنُسْوَاقُ الْمُجْرِمِينَ إِلَى جَهَنَّمَ وَرْدًا ﴿٨٦﴾ لَا يَمْلِكُونَ الشَّفْعَةَ إِلَّا مَنِ اتَّخَذَ عِنْدَ الرَّحْمَنِ عَهْدًا ﴿٨٧﴾

“A nuk e sheh se Ne i kemi dërguar djajtë te mohuesit, për t’i yshtur ata me forcë?”

“Andaj, mos kërko shkatërrimin e tyre të shpejtë, se, me të vërtetë, Ne ua numërojmë ditët e caktuara.”

“Ditën, kur do t’i tubojmë besimtarët te i Gjithëmëshirshmi, si të ftuar”,

“ e do t’i shtyjmë të ligjtë në Xhehennem, si tufë e etur”,

“askush nuk do të mund të ndërhyjë, përveç atij që ka marrë lejen dhe premtimin e të Gjithëmëshirshmit.”

Komentimi

Kush janë ata që e meritojnë shefaetin?

Duke u bazuar në diskutimin që u bë në ajetet e mësipërme, për sa u përket jobesimtarëve dhe idhujtarëve, ajetet 83-87 flasin për disa shkaqe të paudhësisë së tyre, si dhe për përfundimin e tyre. Kjo e vërtetë të çon drejt qëndresës së ekuilibrit, ndërsa idhujt, jo vetëm që nuk janë burim krenarie për ta, por janë burim i fatkeqësisë.

Që në fillim të ajetit 83 All'Ilau u drejtohet me një pyetje: A nuk keni parë që ne i kemi nisur shejtanët drejt qafirëve (mohuesve)?

“A nuk e sheh se Ne i kemi dërguar djajtë te mohuesit, për t'i yshtur ata me forcë?”

Termi *“aza”*, ashtu si thotë Ragibi, në librin e tij *“Mufredat”*, ka kuptimin *“valë të tjera”*, *“të kthehesh me kokë poshtë”*. Kuptimi i saj është *“vlon”*. Në këtë rast, është ironi për ata që i dominon shejtani. Çdo rrugë që ata marrin, i largon dhe i lëviz nga të dojë vetë, duke i sorollatur nga lart e poshtë.

Natyrisht që e kemi thënë shumë herë që dominimi i shejtanit kundrejt njeriut nuk është një dominim i detyruar dhe i pavetëdijshëm. Por ky njeri, me veprat e tij, ia mundëson shejtanit hyrjen në zemrën e tij, bëhet prej ushtrisë së shejtanit dhe i bindet atij.

Në lidhje me këtë çështje, All'Ilahu i Madhëruar e Fuqiplotë, në ajetin 100 të sures "En Nahl", thotë: **"Pushteti i djallit është vetëm mbi ata, që i binden atij dhe adhurojnë zotë të tjerë veç All'Ilahut."**

Zoti i Madhëruar i drejtohet Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke i thënë: "Mos u nxito për ata, sepse Ne i kemi llogaritur me saktësi të gjitha veprat e tyre."

"Andaj, mos kërko shkatërrimin e tyre të shpejtë, se, me të vërtetë, Ne ua numërojmë ditët e caktuara."

Të gjitha veprat e tyre do të regjistrohen dhe në Ditën e Kiametit, në Ditën e drejtësisë, ato do të dalin në shesh. Duke vazhduar komentimin e këtij ajeti, mund të thuhet se qëllimi i numërimit të ditëve, është numërimi i jetës, i frymëmarrjes së tyre, që do të thotë se periudha e jetës së tyre apo çka ka mbetur nga jeta e tyre, është shumë e shkurtër, aq sa numërohet.

Në një transmetim të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), për komentimin e këtij ajeti, thuhet: Një prej shokëve e pyet Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*): "Sipas besimit tënd, cili është qëllimi i përdorimit të fjalës 'numërim' në këtë ajet?"

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: "Numërimi i ditëve. Baballarët dhe nënat janë në dijeni të moshës së fëmijëve të tyre, por qëllimi i numërimit, në këtë rast, është i frymëmarrjes."¹

Ky interpretim i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) mund të flasë për komentimin e parë, ose për të dytin, ose për të dy

¹ "Nuruth Thekalejn", vëll. 3, f. 357.

komentimet. Sidoqoftë, vëmendja dhe saktësia e përmbajtjes së këtij ajeti, bën që njeriu të vihet në lëvizje, për shkak se vërteton çdo gjë. Edhe frymëmarrja jonë është e llogaritur dhe një ditë do të japim llogari për të gjitha këto.

Pas kësaj flitet për rrugën e drejtë, rrugën e fundit *“Muttekin”* - *“të të devotshmëve”* dhe *“Muxhrimin”* - *“të punëkëqijve”*, të cilët i përshkruan në një paragraf të shkurtër, duke thënë: *“Të gjitha këto vepra i kemi ruajtur për një ditë, që punëmirët të respektohen në Ditën kur do të tubohen drejt Zotit Mëshirues.”*.

“Ditën, kur do t’i tubojmë besimtarët te i Gjithëmëshirshmi, si të ftuar.”

Termi *“vefed”* ka kuptimin *“grup”*, të cilët shkojnë te të mëdhenjtë e tyre për të zgjidhur problemet që kanë. Ata respektohen dhe nderohen. Për këtë shkak ka marrë edhe kuptimin të ftuar, të nderuar. Po ashtu, në disa prej haditheve dhe transmetimeve, shikojmë se punëmirët janë të nderuar dhe të respektuar, kur shkojnë drejt Xhenetit.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: *“Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e pyeti Profetin Muhammed (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për komentimin e këtij ajeti. Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: ‘O Ali! Vefed janë ata që punojnë mirë, ruhen nga e keqja, janë të devotshëm. Zoti i do ata, është i kënaqur*

nga veprat dhe punët e tyre dhe atyre u ka vënë emrin ‘Muttekin’ – ‘të devotshmit’”.¹

Në ajetin e mësipërm lexojmë se punëmirët dërgohen drejt Zotit Mëshirëplotë, ndërkohë që në ajetin tjetër flet për punëkëqijtë, të cilët i hedh në Xhehennem. A nuk do të ishte më mirë, që në këtë rast, të mos përdorej fjala “Mëshirëplotë”, sepse në ajetin tjetër flet për hedhjen e punëkëqijve në Xhehennem? A nuk do ishte më e përshtatshme që të përdorej fjala “Xhennet” në vend të fjalës “*Rrahman*” - “*i Mëshirshëm*”?

Ky interpretim flet për një pikë të rëndësishme: Zoti është më lart se Xhenneti. Ata, në këtë mënyrë, i afrohen pozitës së lartë dhe të veçantë të Zotit. Ata marrin kënaqësinë e Zotit, e cila është më e mirë se sa Xhenneti. Interpretimi që u bë për hadithin e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), gjithashtu, fliste për këto kuptime.

Më pas ajeti flet për punëkëqijtë, të cilët po presin. Ata i hedhin në Xhehennem si një grup i etur.

“...e do t’i shtyjmë të ligjtë në Xhehennem, si tufë e etur...”

Ashtu sikurse devetë e etura i ndjekin që t’i nisin drejt vendit ku ka ujë, në këtë rast, i ndjekin për t’i hedhur në Xhehennem, sepse ujë nuk ka, por ka zjarr.

Fjala “*vird*” ka kuptimin “*grup njerëzish ose kafshësh, të cilët hyjnë në vendin ku ka ujë*”, kur ky grup është i etur. Këtë shprehje, komentuesit e kanë marrë me kuptimin i të qenit i etur.

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3. f. 359.

Sa ndryshim ka midis njerëzve që i dërgojnë drejt All'llahut me respekt e nderim, si dhe engjëjt që u dalin përpara për t'i pritur dhe për t'i respektuar. Ata i përshëndesin me selam. Ndërsa grupet që janë të etur e që shohin Xhehennemin, janë të turpëruar. Nëse do të imagjinonit se atje, nëpërmjet shefaetit do të arrijnë diku, duhet të dinë që në fillim, se ata nuk do të arrijnë të jenë pronarë të shefaetit.

Asnjë prej tyre nuk bën shefaet e as nuk është i aftë që t'i bëjë dikujt shefaet.

Ata që janë posedues të shefaetit, pranë Zotit të Madhëruar, kanë lidhur besën, premtimin.

“Askush nuk do të mund të ndërhyjë, përveç atij që ka marrë lejen dhe premtimin e të Gjithëmëshirshmit.”

Vetëm një grup do të jetë përfitues i shefaetit, ose pozita e tyre do të jetë më lart se kaq. Ata do të kenë mundësi t'u bëjnë shefaet atyre që e meritojnë atë.

Ç'kuptim ka fjala “ahd”?

Për qëllimin e përdorimit të fjalës “ahd”, në ajetin më lart, ku thuhet **“Askush nuk do të mund të ndërhyjë, përveç atij që ka marrë lejen dhe premtimin e të Gjithëmëshirshmit.”**, është diskutuar midis komentuesve të Kur'anit të Shenjtë. Disa prej tyre janë të mendimit se fjala “ahd” - “marrëveshje” është besimi në Zot, që ne e shprehim atë me njëshmërinë e Zotit dhe me vërtetimin e Profetit të Zotit.

Disa të tjerë thanë se fjala “ahd” - “marrëveshje”, në këtë rast, ka kuptimin “dëshmi në njeshmërinë e Zotit. Nuk shpresojnë tek tjetërkund vetëm tek All’llahu. Neveri ndaj atyre që përballë Zotit kanë vendosur mburojat dhe besojnë se kanë fuqi vetë”.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), në përgjigje të disa prej shokëve, të cilët e pyetën për komentimin e ajetit në fjalë, ka thënë: “Ata që besojnë te vilajeti i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) dhe te Imamët e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) kanë lidhur marrëveshje me Zotin.”.¹

Në një tjetër transmetim nga Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), lexojmë: “Ata që gëzojnë zemrat e besimtarëve, më kanë gëzuar mua dhe, çdokush që më gëzon mua, ka një marrëveshje pranë Zotit.”.²

Në një tjetër hadith të Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) lexojmë: “Besëlidhja e marrëveshjes është po ajo besëlidhje ndaj faljes së namazeve (pesë vaktet e namazit).”.³

Duke u mbështetur te transmetimet dhe studimi i bërë ndaj tyre, në burime të ndryshme islame, si dhe duke u mbështetur te fjalët e komentuesve, arrijmë në përfundim: Marrëveshja me Zotin, ashtu siç kuptojmë çdo lloj pune tjetër të mirë. Të gjitha këto i përmbledh fjala marrëveshje, edhe pse në çdo transmetim

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 362.

² “Derrul Menthur” (sipas transmetimit të “El Mizan”, në vazhdim të ajetit për të cilin folëm.

³ “Derrul Menthur” (sipas transmetimit të “El Mizan”, në vazhdim të ajetit për të cilin folëm.

dhe hadith flitet për një pjesë prej saj ose për një ngjashmëri të qartë të saj.

Ndaj, në një tjetër hadith, ku flitet për lënien e testamentit (vesijet) nga Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) transmetohet: *"Myslimanët duhet të lënë një testament të tillë, kur janë pranë vdekjes. Ata duhet të thonë: 'O Zot! Ti që je Krijuesi i qiejve dhe i tokës, Ti di të fshehtën dhe të qartën, Ti je Mëshirues e Mëshirëplotë, unë në këtë botë lidh marrëveshje me Ty dhe dëshmoj se nuk ka të adhuruar përveç Teje dhe se Muhammedi (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është robi dhe i dërguari Yt. Xhenneti është i vërtetë, Xhehennemi është i vërtetë, Ringjallja dhe Llogaria janë të vërteta, ndryshimi dhe dhënia llogari e veprave tona janë të vërteta.*

Feja është po ajo që Ti ke shpjeguar. Islami është po ai që Ti ke përhapur. Fjala është po ajo që Ti ke thënë dhe Kur'ani është ashtu sikurse Ti e ke zbritur. Ti je Zoti i Vërtetë dhe i Qartë.

O Zot, na e dhuro Muhammedin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) si dhuratën më të mirë, dërgo selame mbi të dhe mbi familjen e tij!

O Zot! Ti je pasuria ime në vështirësi dhe Mik i imi në probleme, Ti je pronar i mirësive të mia, Ti je i adhuruari im dhe i të parëve të mi. Me një vështrim mbi mua, më bëj të rri te e mira dhe t'i largohem të ligës.

O Zoti im! Ti ji mbrojtësi im në varr! Lidh me mua një marrëveshje, që të dal faqebardhë në Ditën e Kiametit'.

Më tej tha: 'Pasi i përmendi të gjitha këto të vërteta, atë çka e quajti të nevojshme, e la amanet. Vërtetësinë e këtij amaneti e

përputhi me ajetin 87 të sures 'Merjem' dhe tha: 'Askush nuk do të mund të ndërhyjë, përveç atij që ka marrë lejen dhe premtimin e të Gjithëmëshirshmit.'. Kjo është marrëveshja dhe testamenti...''¹

¹ "Mexhmaul Bejan" në vazhdimësi të këtij ajeti.

Ajetet 88 - 95

وَقَالُوا اتَّخَذَ الرَّحْمَنُ وَلَدًا ﴿٨٨﴾ لَقَدْ جِئْتُمْ شَيْئًا إِدًّا ﴿٨٩﴾ تَكَادُ
 السَّمَوَاتُ يَتَفَطَّرْنَ مِنْهُ وَتَنْشَقُّ الْأَرْضُ وَتَخِرُّ الْجِبَالُ هَدًّا ﴿٩٠﴾ أَنْ دَعَوْا
 لِلرَّحْمَنِ وَلَدًا ﴿٩١﴾ وَمَا يَنْبَغِي لِلرَّحْمَنِ أَنْ يَتَّخِذَ وَلَدًا ﴿٩٢﴾ إِنْ كُلُّ مَنْ
 فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ إِلَّا آتَى الرَّحْمَنِ عَبْدًا ﴿٩٣﴾ لَقَدْ أَحْصَاهُمْ
 وَعَدَّهُمْ عَدًّا ﴿٩٤﴾ وَكُلُّهُمْ آتِيهِ يَوْمَ الْقِيَمَةِ فَرْدًا ﴿٩٥﴾

“Ata thonë: ‘I Gjithëmëshirshmi ka një bir.’”

“Keni thënë diçka vërtet të tmerrshme!”

“Qiejt gati sa nuk copëtohen prej kësaj; Toka gati sa s’çahet e malet sa s’rrëzohen të thërrmuar”,

“nga që ata i veshin një bir të Gjithëmëshirshmit.”

“Kurrë nuk i shkon (Madhërisë së) të Gjithëmëshirshmit të ketë një bir.”

“S’ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob para të Gjithëmëshirshmit.”

“Sigurisht që Ai e njeh mirë gjithsecilin prej tyre dhe i ka numëruar të gjithë saktësisht”

“Çdonjëri prej tyre, në Ditën e Kiametit, do të dalë fill i vetëm para Tij.”

Komentimi

Zoti dhe të pasurit fëmijë?!

Në ajetet e mësipërme u fol për shirkun dhe përfundimin e punëve të jobesimtarëve. Në fund të diskutimit u fol pak për një nga degët e shirkut, besimi se Zoti ka fëmijë. Gjithashtu, u fol edhe për të keqen që rrjedh prej këtij besimi. Kur’ani e tregon në mënyrë të prerë: **“Ata thonë: ‘I Gjithëmëshirshmi ka një bir.’”**.

Jo vetëm që të krishterët besonin se Profeti Isa është bir i Zotit, por edhe jehuditët kishin të njëjtin mendim për Uzejrin. Edhe idhujtarët, të njëjtën gjë mendonin për engjëjt, duke i konsideruar ato si vajzat e Zotit.¹

Më pas thotë: **“Sa fjalë të turpshme dhe të madhe sollët”**.

“Keni thënë diçka vërtet të tmerrshme!”

¹ Për Uzejrin është folur në ajetin 30 të sures “Et Teube”, ndërsa për engjëjt është folur në ajetin 19 të sures “Zuhruf”.

Fjala “ide” ka kuptimin “zë i shpifur”. Kur deveja ecën shumë, si pasojë e ecjes, në grykën e saj dëgjohen zëra. Këto zëra janë konsideruar si të shëmtuara. Kur kryhet një punë shumë e keqe dhe e tmerrshme, i është vendosur i njëjti epitë si i zërit të devesë, kur ajo është e lodhur.

Një raport dhe krahasim i tillë, i padëshiruar dhe ofendues, është kundërshtim i hapur i njëshmërisë së Zotit të Madhëruar, sepse Zoti nuk është i ngjashëm me askënd. Nuk ka nevojë për fëmijë e as për fizik (trup), thuaj se i gjithë universi i cili është ndërtuar mbi bazat e Teuhidit gjendet i tmerruar përpara kësaj veshjeje të padëshiruar dhe ofenduese.

Ndaj në ajetin e mëposhtëm shton se qiejt, për shkak të këtyre fjalëve të tmerrshme, copëtohen, Toka çahet dhe malet thërrmohen.

“Qiejt gati sa nuk copëtohen prej kësaj; Toka gati sa s’çahet e malet sa s’rrëzohen të thërrmuar...”

Përsëri, për të theksuar faktin dhe për të treguar rëndësinë e kësaj çështjeje, thotë se e gjitha kjo ndodhi, sepse ata thanë se All’llahu i Madhëruar ka fëmijë.

“...nga që ata i veshin një bir të Gjithëmëshirshmit.”

Këta, në të vërtetë, nuk e kanë njohur Zotin, përndryshe do ta dinin se Zotit Mëshirëplotë nuk i vishet kjo cilësi (e të pasurit fëmijë).

“Kurrë nuk i shkon (Madhërisë së) të Gjithëmëshirshmit të ketë një bir.”

Njeriu e do fëmijën për disa arsye:

- Jeta e tij ka fund, për të pasur vazhdimësi.
- Për ta pasur si ndihmës, sepse forcat e tij janë të kufizuara.
- Ka frikë nga vetmia dhe kërkon të këtë dikë për shoqëri.
- Në kohën që është i plakur dhe i pafuqishëm, kërkon ndihmën nga më i riu.

Asnjë nga këto kuptime nuk ka kuptim për Zotin, sepse as fuqia e Tij nuk është e kufizuar e as ekzistenca e Tij nuk ka fund. Zoti nuk është as i dobët e as nuk është i pafuqishëm. Në qenien e Tij nuk ekziston ndjesia e të qenit vetëm, që të kërkojë fëmijë. Të pasurit fëmijë kërkon të kesh bashkëshorte dhe të kesh trup fizik, të cilat nuk i qasen Madhështisë së All'llahut. Ai është i pastër nga të gjitha këto.

Për këtë shkak, në ajetin tjetër, thotë se të gjithë ata që janë në tokë e në qiej janë rob të Tij.

“S’ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob para të Gjithëmëshirshmit.”

Zoti nuk ka nevojë për njerëzit, por janë njerëzit ata që kanë nevojë për Zotin, sepse shpirti i tyre është në dorën e Zotit.

Zoti i di të gjitha, i ka numëruar të gjithë dhe e di me saktësi numrin e tyre.

“Sigurisht që Ai e njeh mirë gjithsecilin prej tyre dhe i ka numëruar të gjithë saktësisht.”

Kuptimi i këtij ajeti është: Kurrë mos mendoni apo imagjinoni se Zoti nuk mund t'ju llogarisë, sado që të jeni. Dija e All'llahut është aq e gjerë, saqë jo vetëm e di me saktësi se sa njerëz jemi, por i di me saktësi edhe cilësitë e secilit prej nesh. Asgjë nuk është e pamundur për madhështinë e All'llahut. Në Ditën e Kiametit secili nga ne do të paraqitet i vetëm në praninë e All'llahut.

“Çdonjëri prej tyre, në Ditën e Kiametit, do të dalë fill i vetëm para Tij.”

Për këtë shkak, edhe Profeti Isa, edhe Uzejri, edhe engjëjt, edhe të gjithë njerëzit janë të përfshirë në këtë urdhër të përgjithshëm. Kështu që nuk mund të mendojmë e të pretendojmë se Zoti ka fëmijë, sepse mohojmë madhështinë dhe cilësitë e All'llahut.¹

Hulumtime

Nga diskutimi dhe nga komentimi që iu bë këtyre ajeteve, u pa toni i ashpër, fjalët e prera dhe të sakta që kundërshtojnë ekzistencën e fëmijës së Zotit të Madhëruar.

¹ Për informacion më të gjerë, për kundërshtimin që i bëhet idesë së ekzistencës së fëmijës së Zotit, mund të shikoni vëllimin e parë, vazhdimin e ajetit 116, të sures “El Bekare” dhe ajetin 68 të sures “Junus”.

Këto ajete kanë të bëjnë me periudhën e 14 shekujsh më parë, ndërkohë që në ditët e sotme janë të shumtë personat që mendojnë se Profeti Isa është fëmija i Zotit.

Kjo gjë nuk ka të bëjë se Profeti Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) është fëmijë i Zotit, por ka lidhje me çështjen e trinitetit, që ata e kanë si besimin e tyre.

Nëse këtë gjë e dëgjojnë myslimanët, ata e konsiderojnë si shirk dhe tmerrohen prej kësaj fjale.

Por ata, në vendet islame përdorin një taktikë tjetër, duke e konsideruar Profetin Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) si birin jo real të Zotit.

Si mund të copëtohen qiejt nga njëri-tjetri?

Dukuritë që ndodhin nga dëgjimi i fjalëve se Zoti ka fëmijë, si: copëtimi i qiejve, çarja e tokës, thërrmimi i maleve, ose për sa i përket çështjes së universit, e cila ka një lloj jete dhe një lloj të kuptuari, përshkruhen edhe në ajete të tjera. Po përmendim disa prej këtyre ajeteve.

Ajeti 74 i sures “El Bekare” thotë: **“Por, pas kësaj, zemrat tuaja u forcuan e u bënë si guri, madje edhe më të forta. Në të vërtetë, ka gurë nga të cilët burojnë lumenj, ka të atillë që çahen e nga të cilët rrjedh uji, madje ka edhe syresh që rrëzohen nga frika e All’llahut. All’llahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja.”.**

Ajeti 21 i sures "Hashr" thotë: **"Sikur këtë Kur'an t'ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë (mal) të përulur dhe të copëtuar nga frika e All'llahut. Shembuj të tillë Ne ua japim njerëzve, që ata të meditojnë."**

Kjo veshje e turpshme dhe tmerrësisht ofenduese ndaj All'llahut (çështjes së të pasurit fëmijë), të tmerron. Në gjuhën arabe ky është një ofendim shumë i rëndë. Gjithashtu, në gjuhën perse, kur duam të krahasojmë një gjë, e cila na ka lënduar jashtëzakonisht, themi: "Ke bërë një punë, a thua më ra qielli mbi kokë."

Në dashtë All'llahu, për sa i përket kësaj çështjeje, do të flasim në ajetet në vazhdim.

Ajetet 96 - 98

إِنَّ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ سَيَجْعَلُ لَهُمُ الرَّحْمَنُ وُدًّا
 فَإِنَّمَا يَسَّرْنَاهُ بِلِسَانِكَ لِتُبَشِّرَ بِهِ الْمُتَّقِينَ وَتُنذِرَ بِهِ قَوْمًا
 لُّدًّا ۖ وَكَمْ أَهْلَكْنَا قَبْلَهُم مِّن قَرْنٍ هَلْ تُحِسُّ مِنْهُمْ مِّنْ أَحَدٍ أَوْ
 تَسْمَعُ لَهُمْ رِكْرًا

“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t’u dhurojë dashuri.”

“Ne e kemi bërë atë (Kur’anin) të lehtë, në gjuhën tënde, vetëm që, nëpërmjet tij, ti t’u japësh lajmin e mirë besimtarëve të devotshëm dhe të paralajmërosh njerëzit kokëfortë (në mosbesimin e tyre).”

“Sa e sa brezni kemi shkatërruar Ne para tyre! Vallë, a po sheh ndonjërin prej tyre dhe a po dëgjon pëshpëritjen më të vogël të tyre?!”

Komentimi

Besimi është burim dashurie!

Në tri ajetet e mësipërme, 96-98, të cilat janë edhe ajetet e fundit të sures “Merjem”, përsëri flitet për besimin e besimtarëve, për zullumqarët dhe punëkëqijtë pa besim. Gjithashtu, flitet për Kur'anin, për mirësitë dhe për këshillat e tij. Po ashtu flet për të shkuarën.

Në fillim thekson se ata që kanë besuar dhe kanë kryer vepra të mira, në zemrat e tyre, Zoti i Madhëruar, ka vendosur dashurinë.

“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t’u dhurojë dashuri.”

Disa komentues janë të mendimit se ky ajet është për Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), ndërsa disa të tjerë janë të mendimit se përfshin të gjithë besimtarët.

Disa janë të mendimit se ka për qëllim të tregojë dashurinë e besimtarëve midis njëri-tjetrit, e cila është edhe shkak i fuqisë dhe i unitetit.

Disa të tjerë janë të mendimit se flet për miqësinë e besimtarëve midis njëri-tjetrit në Botën e Përtejme. Ata thonë se besimtarët e duan aq shumë njëri-tjetrin, saqë, kur shikohen, gëzohen. Ky gëzim është i dukshëm në fytyrat e tyre.

Por nëse do ta shikojmë këtë ajet në një këndvështrim më të gjerë dhe të mendojmë për të, do të shikojmë se të gjitha këto tefsire janë të përmbledhura në kuptimin e ajetit, duke mos pasur asnjë mosmarrëveshje midis tyre.

Pika më kryesore është “Besimi dhe veprat e mira”, e cila ka një tërheqje të jashtëzakonshme. Të besosh në njëshmërinë e Zotit dhe në ftesën e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që reflektimi shfaqet në shpirt, në mendje, në mënyrën e të folurit dhe të sjelljes, si dhe të njeriu duhet të ketë moral të shkëlqyer. Devotshmëria dhe pastërtia, shoqëria dhe amaneti, trimëria dhe falja, shfaqen sikur forcat e mëdha të magnetit, të cilat tërheqin dhe shtyjnë njëra-tjetrën.

Po ashtu edhe personat e papastër kënaqen nga të pastrit dhe u vjen ndot nga ata që janë të papastër sikurse vetja. Për këtë arsye, kur themi se duam të zgjedhim bashkëshortin apo bashkëshorten, theksohet fakti që të përzgjedhim një person të pastër dhe të besuar.

Kjo gjë është e natyrshme dhe është shpërblimi i parë që Zoti i Madhëruar u jep besimtarëve të pastër. Më pas mirësitë zgjerohen edhe më tutje.

Kemi parë se njerëz të tillë, të pastër, kur largohen nga kjo botë, sytë e tyre janë të mbushur me lot. Edhe pse ata nuk kanë pozitë në shoqëri, në mesin e njerëzve ndihet mungesa e tyre.

Jo vetëm disa komentues, por dhe në shumë transmetime është cituar se ky ajet ka zbritur për Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*). Padyshim që pozita e lartë e tij i përmbledh këto cilësi. (Për

këtë transmetim do të diskutojmë gjatë). Por kjo nuk pengon që stade të tjera t'i shijojnë edhe besimtarët, edhe punëmirët. Kjo dashuri do të shijohet nga të gjithë besimtarët dhe punëmirët. Po ashtu, nuk do të këtë asnjë pengesë që edhe armiqtë, po ashtu, në zemrën e tyre të ndiejnë dashuri dhe respekt për besimtarët.

Në një hadith të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexojmë: “Në kohën kur Zoti i Madhëruar e do ndonjë prej robve të Tij, i thotë engjëllit Xhebrail: ‘Unë e dua këtë krijesë dhe ti dua je atë’. Engjëlli Xhebrail do ta dojë atë. Më pas, me zë të lartë thërret në qiej: ‘O ju të qiejve! Zoti e do filan person, dua jeni edhe ju atë’! Kështu që të gjithë banorët e qiejve e duan atë. Më pas, këtë dashuri e pranojnë edhe banorët e tokës.

Kur Zoti e ka armik një person, i thotë Xhebrailit se i vjen ndot prej filan personi dhe e konsideron armik. Si rrjedhim, edhe Xhebraili e konsideron armik dhe thërret te banorët e qiejve, duke u thënë se Zoti i Madhëruar është armik me këtë person, kështu që edhe ju konsiderojeni armik atë. Banorët e qiejve e konsiderojnë atë armik. Më pas edhe banorët e tokës bëhen armik më të.”¹

Ky hadith tregon se besimi dhe veprat e mira reflektojnë edhe në univers. Parulla e dashurisë përfshin të gjithë universin. Këta persona Zoti i do dhe, po ashtu, janë të dashur në qiej e në tokë.

E ç’kënaqësi më të madhe se kjo dëshiron njeriu, i cili është i rrethuar nga dashuria e All'lahut në qiej dhe në tokë?!

¹ Ky hadith është transmetuar në shumë burime të njohura dhe në shumë libra tefsiri. Ne kemi përzgjedhur hadithin që është transmetuar në tefsirin “Fi Dhelala”, në vëllimin 5, në faqen 454. Po ashtu është transmetuar nga Ahmed, Muslimi dhe Buhariu.

Sa e dhimbshme është që të të marrë neveri Krijuesi dhe po ashtu banorët e qiejve dhe të tokës!

Pas kësaj, flet për Kur'anin, që është burimi i edukimit dhe i veprave të mira, duke thënë se Kur'anin e bënë të lehtë dhe e sollën në gjuhën tonë, që nëpërmjet tij, të udhëzohen punëmirët, ndërsa armiqtë e vështirë t'i këshillojë.

“Ne e kemi bërë atë (Kur'anin) të lehtë, në gjuhën tënde, vetëm që, nëpërmjet tij, ti t'u japësh lajmin e mirë besimtarëve të devotshëm dhe të paralajmërosh njerëzit kokëfortë (në mosbesimin e tyre).”

Shumësi i fjalës *“lude”* është *“elede”* dhe ka kuptimin *“armik i vështirë”*, *“kokëfortë që nuk ka logjikë”*.

Ajeti i fundit, për t'i dhënë kurajë Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe besimtarëve (duke ditur se kjo sure ka zbritur në Mekë dhe në atë periudhë myslimanët ishin në vështirësi), si dhe për të zgjuar dhe për t'u rikujtuar armiqve, të cilët ishin kokëfortë, thotë se janë zhdukur shumë popuj, të cilët ishin mohues, pa besim dhe prej tyre nuk ka mbetur asgjë, as zëri më i vogël, as pëshpërimita më e lehtë.

“Sa e sa brezni kemi shkatërruar Ne para tyre! Vallë, a po sheh ndonjërin prej tyre dhe a po dëgjon pëshpëritjen më të vogël të tyre?!”

Fjala *“rikz”* ka kuptimin *“pëshpëritje”* (zë i ulët). Gjërat që fshihen në tokë u thuhën *“rikza”* - *“pëshpëritje”*. Këta popuj

kokëfortë të së vërtetës janë zhytur aq shumë, saqë nuk dëgjohet prej tyre as edhe pëshpërima më e vogël.

Hulumtime

Dashuria për Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*)

Në shumë prej librave të tefsireve, si të Ehli Synetit, si dhe të Shi'ave janë transmetuar hadithe të shumta, për sa i përket shkakut të zbritjes së këtij ajeti.

“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t’u dhurojë dashuri.”

Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për sa i përket shkakut të zbritjes së këtij ajeti, transmeton se ajeti, për herë të parë ka zbritur për Imam Aliun. Këtë e shikojmë në librin “Keshaf” të Zemeksherit, në librin “Ibn Xhevazi” të Tezkires, në librin “Genxhi Shafei” të Kurtubiut, në tefsirin e njohur “Muhibu Din Teberi”, të Zehairi Akebit, Nishaburi, në tefsirin e njohur, “Ibn Sebagh” Maleki, në “Fusul El Mehme”, Sujuti, në “Darul Menthur”, Hishemi në “Sevaikul Mehreke” dhe Alusi në “Ruhul Meanij”. Në të gjitha këta libra tefsiri është folur për shkakun e zbritjes së këtij ajeti.

Po ashtu edhe Thelebi, në komentimin e tij, transmeton nga Bera’e bin Azeb se i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e*

All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i tha Aliut (*Paqja qoftë mbi të!)*: “*Thuaj o All'lah! Dua të lidh besën me Ty! Në zemrat e besimtarëve të jem i dashur.*”.

Në këto çaste, zbret ky ajet: **“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t'u dhurojë dashuri.”**¹

I njëjti paragraf, me pak ndryshim, është cituar në shumë libra të tjerë.

Në shumë prej librave islame i njëjti transmetim është transmetuar nga Ibn Abasi. Midis të tjerash, për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, ai thotë se ka zbritur për Ali ibn Ebu Talibin. Kuptimi i tij është i tillë: “Në zemrat e besimtarëve, All'llahu ka vendosur dashuri.”

Po ashtu, në librin “Sevaik”, transmetuar nga Muhammed bin Hanife, në komentim të këtij ajeti shprehet: “Nuk gjendet njeri besimtar, që në zemrën e tij nuk ka dashuri për Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!)* dhe familjen e tij.”²

Ndoshta për këtë arsye, në transmetimet sahih dhe të besueshëm, është transmetuar nga vetë Ali ibn Ebu Talibi (*Paqja qoftë mbi të!)* të këtë thënë: “Nëse do të qëllojë një besimtar me këtë shpatë me qëllim, që ai të më bëjë armik, kurrë nuk do më bëjë armik dhe, nëse do të jepja gjithë mirësitë e kësaj bote, që një jobesimtar të më dojë, kurrë nuk do të më dojë. Kjo ndodh, sepse Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* më ka thënë:

¹ Sipas transmetimit, “Ehkakul Hak”, vëll. 3, f. 83- 86.

² Sipas transmetimit, “Ehkakul Hak”, vëll. 3, f. 83- 86.

*'O Ali! Asnjë besimtar nuk do të jetë armik me ty e asnjë jobesimtar nuk do të ketë në zemrën e tij dashuri për ty.'"*¹

Në një hadith të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë:
"Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) në fund të namazit të tij thoshte me zë të lartë për Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!): 'O Zot! Në zemrat e besimtarëve lësho dashuri për Aliun dhe në zemrat e jobesimtarëve të këtë zotësi mbresëlënëse.'"

Në këtë moment zbret ajeti i mësipërm.

Sidoqoftë, ashtu sikurse thamë në ajetet e mësipërme, zbritja e këtij ajeti është shembull dhe përsosmëri për Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe nuk është pengesë për zgjerimin e kuptimit të tij për të gjithë besimtarët.

Fjala "*jesarnahu*" vjen nga rrënja e fjalës "*tesir*" dhe ka kuptimin "*tes'hil*" - "*lehtësim*". All'llahu, në këtë fjali, thotë: **"Ne e bëmë të lehtë për gjuhën tënde Kur'anin, që punëmirët t'i përgëzojmë dhe armiqtë kokëfortë t'i mundojmë."**

Ky lehtësim mund të jetë i gjithanshëm për disa arsye:

Për faktin se Kur'ani është në gjuhën letrare arabe, në gjuhë të rrjedhshme. Melodia e tij është tërheqëse, recitimi i tij është i lehtë për gjuhët e tyre.

¹ "*Ruhul Meanij*", vëll. 16, f. 130, "*Mexhmaul Bejan*", vëll. 6, f. 533 dhe "*Nahxhul Belaga*", kalamatul kesa, 45.

All'llahu i Madhëruar bëri që Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ta përvetësojë Kur'anin në mënyrë të tillë që ta përdorte atë me lehtësi në çdo vend dhe për çdo problem. Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e recitonte atë vazhdimisht për besimtarët.

Përmbajtja e Kur'anit, edhe pse në të njëjtën kohë është e thellë dhe me shumë kuptim, të kuptuarit e tij është i lehtë. Parimisht, të gjitha ato të vërteta të mëdha dhe të përzgjedhura, të cilat janë vendosur në brendësi të këtyre fjalëve të kufizuara, kuptohen më lehtësi. Ky lehtësim është tregues i ajeteve që lexuam më lart.

Në suren "Kamer" në ajete të ndryshme, është përsëritur kjo fjali: **"Ne e sollëm Kur'anin si këshillë dhe përkujtim, e bëmë të lehtë atë. A nuk merr shembull?"**.

O Zot! Ndriçoi zemrat tona me dritën e besimit dhe të gjithë qenien tonë ndriçoje me dritën e veprave të mira! Ne na bëj që të jemi të dashur me besimtarët dhe punëmirët, në veçanti me Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*)! Zemrat e besimtarëve mbushi me dashurin tonë!

O Zot i Madhëruar! Bashkoje shoqërinë e madhe islame, e cila ndodhet nën kthetrat e armiqve, edhe pse i ka të gjitha mundësitë, si materiale ashtu edhe shpirtërore, por për shkak të përçarjes, është bërë e dobët.

O Zot! Ashtu sikurse shkatërrove dhunuesit e kohëve të kaluara, po ashtu shkatërro edhe fuqitë e mëdha dhunuese të ditëve të sotme! Largoje nga ne dhe nga të gjithë të pamundurit

sherrin e tyre, kryengritjen e besimtarëve kundër këtyre dhunuesve dhe zullumqarë!

Amin Ya Rabbil Alemin

Fundi i sures “Merjem”

Surja “Ta Ha”

Kjo sure ka zbritur në Mekë dhe ka 135 ajete.

Përmbajtja e sures "Ta Ha"

Sipas gjithë komentuesve të Kur'anit sureja "Ta Ha" ka zbritur në Mekë. Edhe në këtë sure, si në suret e tjera mekase, flitet më shumë rreth "zanafillës" dhe "Ringjalljes", theksohen dobittë e monoteizmit dhe fatkeqësitë që sjellë me vete politeizmi.

Pjesa e parë:

Në këtë pjesë tregohet shkurtimisht për madhështinë e Kur'anit dhe një pjesë e cilësive të bukura dhe të hijshme të Zotit.

Pjesa e dytë:

Pjesa e dytë ka më shumë se tetëdhjetë ajete. Në këto ajete flitet për Hazreti Musain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Këto ajete tregojnë jetën e tij që kur u zgjodh si Pejgamber, tregojnë përballjen se tij me Faraonin tiran. Më pas tregojnë luftimet të shumta që bëri me pushtetin e Faraonit, luftërat me magjistarët dhe pranimin e besimit nga ana e tyre. Në këto ajete tregohet mrekullia që bëri Zoti i Madhëruar kur zhyti në det Faraonin dhe ndjekësit e tij, kurse Hazreti Musanë (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe njerëzit besimtarë i shpëtoi.

Më pas, tregohet për viçin që adhuronin Beni Izrailët dhe për përleshjen e Harunit dhe Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) me ata.

Pjesa e tretë:

Në këtë pjesë flitet për Ringjalljen dhe një pjesë e karakteristikave të saj.

Pjesa e katërt:

Në pjesën e katërt flitet për Kur'anin dhe Madhështinë e Tij.

Pjesa e pestë:

Në këtë pjesë përshkruhet historia e Hazreti Ademit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe Havasë në Xhennet. Flitet edhe për nxitjet që u bëri shejtani dhe për daljen e tyre nga Xhenneti dhe ardhjen në Tokë.

Në përfundim, shpalosen disa këshilla dhe paralajmërime të rëndësishme për të gjithë besimtarët, por theksi i tyre më shumë bie mbi Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Mirësitë e leximit të kësaj sureje

Në burimet islame hasim transmetime të shumta në lidhje me madhështinë dhe rëndësinë e kësaj sureje.

Profeti i Islamit ka thënë: *“Zoti i Madhëruar suren ‘Ta Ha’ dhe ‘Jasin’ ua ka treguar engjëjve, para dy mijë viteve, përpara se ta krijonte Hazreti Ademin (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!). Kur engjëjt i dëgjuan vargjet e këtyre dy sureve, thanë: ‘Lum ai komb për të cilin do të zbresin këto dy sure! Qofshin të bekuara ato zemra që i mbartin këto dy sure! Qofshin të bekuara ato gjuhë që i këndojnë këto dy sure.’”*¹

¹ “Mexhmaul Bejjan”, vëll, 7, fq 1.

Në një hadith tjetër të transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) lexojmë: “Mos hiqni dorë nga këndimi i sures “Ta ha”, sepse Zoti e do atë. Zoti i Madhëruar i do dhe ata njerëz që e këndojnë këtë sure! Çdo kujt që e vazhdon këndimin e kësaj sureje, Zoti i Madhëruar në Ditën e Gjykimit, librin e veprave të tij do t’ia japë në dorën e djathtë dhe nuk do t’i kërkojnë llogari për çfarë ka kryer në rrugën e Islamit, (përkundrazi) në Ahiret do ta shpërblejë aq shumë sa që do të mbetet i kënaqur.”.¹

Në një hadith tjetër të transmetuar nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexojmë: “Ai që e lexon suren “Ta Ha”, në Ditën e Ringjalljes do të shpërblehet me shpërblimin e muhaxhirëve dhe të ensarëve.”.²

E shohim të nevojshme të përsërisim faktin se këto shpërblime të mëdha që fitohen nga leximi i sureve të Kur'anit Famëlartë, të cilat na janë transmetuar nga i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamët, nuk meritohen vetëm nga leximi fiktiv i tyre, por nga një lexim i cili shoqërohet me meditim dhe me sjellje konform asaj që përcjellin ajetet kur'anore.

Nëse i kushtojmë rëndësi përmbajtjes së kësaj sureje do të vërejmë që transmetimet e lartpërmendura kanë një përputhshmëri të plotë me përmbajtjen e saj.

¹ “Nuruth Thekalejn”, vëll, 3, fq 366.

² “Mexhmaul Bejjan”, vëll, 7, fq. 1.

Ajetet 1- 8

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

طه ﴿١﴾ مَا أُنزِلْنَا عَلَيْكَ الْقُرْآنَ لِتَشْقَى ﴿٢﴾ إِلَّا تَذَكُّرٌ لِّمَن تَخْشَى ﴿٣﴾
 ﴿٤﴾ تَنْزِيلًا مِّمَّنْ خَلَقَ الْأَرْضَ وَالسَّمَوَاتِ الْعُلَى ﴿٥﴾ الرَّحْمَنُ عَلَى
 الْعَرْشِ أَسْتَوَى ﴿٦﴾ لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا وَمَا
 تَحْتَ الثَّرَى ﴿٧﴾ وَإِنْ تَجَهَّرَ بِالْقَوْلِ فَإِنَّهُ يَعْلَمُ السِّرَّ وَأَخْفَى ﴿٨﴾ اللَّهُ لَا
 إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۖ لَهُ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَى ﴿٩﴾

Me emrin e All'Ilahut, Mëshiruesit, Mëshirëbësit!

“Ta Ha.”

“Ne nuk ta shpallëm Kur'anin për të munduar ty.”

“Ta shpallëm vetëm këshillë, (përkujtimit) për atë që frikësohet.”

“(kjo është) Shpallje nga Ai që krijoi tokën dhe qiejt e lartë.”

“(E Ai është) Mëshiruesi që krijoi tokën dhe qiejt e lartë.”

“E Tij është çdo gjë që ekziston në qiej e në tokë dhe çdo gjë që gjendet në mes tyre, edhe ç'ka nën dhe.”

“Prandaj, edhe nëse bën lutjen haptazi, Ai e di të fshehtë, madje edhe më shumë se kjo.”

“Ai është All’llahu! Nuk ka Zot përveç Tij. Atij i takojnë emrat më të bukur!”

Shkaku i zbritjes

Shumë hadithe janë transmetuar në lidhje me shkaku të zbritjes të ajeteve të lartpërmendur. Pas zbritjes së shpalljes së Kur'anit, i Dërguari i Zotit bënte shumë lutje. Gjatë lutjes zakonisht qëndronte në këmbë. Ai lutej aq shumë, sa që këmbët i ënjteshin nga që qëndronte shumë kohë në këmbë. Kishte raste që për të vazhduar lutjen, herë qëndronte në njërin këmbë, herë në tjetrën. Ndodhte që ndonjëherë të mbështetej te thembra e këmbës dhe ndonjëherë në majë të gishtërinjve”.¹

Ndërkohë, zbritën ajetet e lartpërmendura, të cilat e këshilluan Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të mos ia imponte vetes gjitha këto vuajtje, mundime dhe shqetësime.

¹ Për më shumë informacion në lidhje me këtë transmetim shih komentimin e “Nuruth Thekalejn” dhe “Derrul Menthur” fillimi i sures “Ta Ha”.

Komentimi

Mos e stërmundo veten tënde

Në fillim të kësaj sureje përballemi me shkronja të ndërprera “Ta Ha”. Kjo zgjedhje stilistikore bëhej me qëllim që të zgjonte ndjenjën e kureshtjes së njeriut.

Për përdorimin e shkronjave të ndërprera në Kur’an në fillim të tri sureve kemi dhënë shpjegim të mjaftueshëm.¹

Por këtu e shohim të nevojshme të theksojmë se ka mundësi që të gjitha këto shkronja, apo disa prej tyre, të përdoren me kuptim të veçantë, siç ndodh me fjalët, të cilat përdoren me disa kuptime.

Në pjesën dërmuese të transmetimeve dhe komentimeve të Kur’anit është pranuar se në fillim të kësaj sureje dhe sures “Jasin” fjala “Ta Ha” është përdorë me kuptimin: “o burrë”. Këtë përdorim e hasim edhe në disa poema arabe. (Disa prej këtyre poemave ka gjasa që t’i përkasin kohës para Islamit apo pas Islamit.)²

Një prej dijetarëve na informoi që disa nga orienlatistët perëndimorë të cilët studionin rreth çështjeve islame, këtë çështje e kanë përgjithësuar për të gjitha fjalët e ndara që gjenden në Kur’an. Ata janë të mendimit se fjalët e ndara në fillim të çdo

¹ Shih suret: “El Bekare”, vëllimi i parë; “Ali Imran”, vëllimi i dytë; “El A’raf”, vëllimi i gjashtë; tefsiri “Namune”.

² Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në fjalë.

sureje posedojnë një domethënie të veçantë. Një pjesë e tyre janë lënë në harresë me kalimin e kohës, kurse disa të tjera kanë arritur deri tek ne. Përndryshe, duket e pamundur që idhujtarët arabë të dëgjonin shkronjat e ndara dhe të mos konceptonin ndonjë kuptim apo domethënie prej tyre, të mos e merrnin si objekt talljeje dhe përqeshjeje. Duhet theksuar se në asnjë libër historie nuk tregohet që njerëz injorantë dhe mendjelehtë t'i kenë paraqitur shkronjat e ndara si argumente për një reagim të tillë.

Natyrisht, është e vështirë për ta pranuar këtë ide, qoftë në përgjithësi, qoftë për të gjitha shkronjat e ndara në Kur'an. Kjo ide është pranuar për një pjesë prej tyre. Në burimet islame është diskutuar për këtë çështje.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) lexojmë: “Ta Ha” është një prej emrave të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). kuptimi i së cilës është: “O ti që je në kërkim të të vërtetës dhe je i udhëzuar në drejtim të tij...”.

Nga hadithi i lartpërmendur qartësohet se “Ta ha” është i përbërë nga dy shkronja të koduara. Shkronja “Ta” shenjon “kërkuesin e së vërtetës”, kurse shkronja “Ha” nënkupton “i udhëzuar drejt tij.”

Dihet që shkronjat e koduara dhe shkurtesat në gjuhë janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren.

Nga përdorimi i gjatë i lidhur me të njëjtin person , kuptimi i fjalës “Ta Ha” ka marrë vlerë personifikuese, ka marrë kuptimin e një emri të përveçëm, saqë familjen e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e quajnë edhe familja

e “Taha-së”. Edhe Imam Mehdiu (*All’llahu e shpejtoftë ardhjen e tij!*) në lutjen “Nudbe” është quajtur si “ja ibn ‘Ta ha’”.

Ajeti thotë: **“Ne nuk ta shpallëm Kur’anin për të munduar ty”**.

Adhurimi dhe kërkimi i afrimit me Zotin e Madhëruar me anë të lutjes, konsiderohet prej veprave më të mira, por secila vepër ka për vete një llogari. Edhe adhurimi ka një limit. Nuk duhet të lodhesh e mundohesh aq shumë me adhurim e me përpjekje për përhapjen e fesë, sa të të humbë fuqia e të dëmtohet shëndeti.

Fjala “*teshka*” përdoret për të treguar mundimin dhe lodhjen e skajshme, si lodhja e treguar në ajetin e lartpërmendur, e cila u bë shkak i zbritjes së tij.

Në ajetin vijues, qëllimin e zbritjes së Kur’anit e përshkruan në këtë mënyrë: **“Ta shpallëm vetëm këshillë, (përkujtim) për atë që frikësohet”**.

Përdorimi i fjalës “*tedhkir*” - “*këshillë, përkujtim*” nga njëra anë dhe “*men jekhsha*” - “*për atë që frikësohet*” nga ana tjetër, tregon se thelbi i të gjitha mësimëve hyjnore, ekziston brenda shpirtit të njeriut, në natyrën e tij dhe mësimet e të Dërguarve të Zotit e bën atë që të lulëzojë, ashtu si Kur’ani na kujton një çështje të harruar.

Nuk themi që në të kaluarën njeriu ka pasur dituri për të gjitha dijet dhe shkencat dhe më pas t’i ketë harruar ato. Nuk themi që roli i mësimit dhe i nxënies në këtë botë është vetëm rikujtimi (ashtu siç transmetojnë nga Platoni). Përkundrazi, po

themi që brumi kryesor i tyre është i fshehur në natyrën e njeriut. (Kini kujdes!)

Fjala “*men jekhsha*” – “*ai që frikësohet*”, tregon se te njeriu nuk ekziston një ndjenjë përgjegjësie, të cilën Kur’ani e përmend si “frikë dhe druajtje për të pranuar të vërtetat”. Kjo fjalë kuptimisht ngjan me fjalën “*huden lil mutekkin*” të përmendur në fillim të sures “El Bekare” që ka kuptimin: “**Kur’ani është udhëzues për të devotshmit**”.

Ajeti më pas prezanton Zotin e Madhëruar, Zbritësin e Kur’anit me qëllim që të njihet madhështia e tij (Kur’anit). Ajeti thotë: “(kjo është) **Shpallje nga Ai që krijoi tokën dhe qiejt e lartë**”.

Ky përshkrim tregon pikënisjen dhe fundin e zbritjes së Kur’anit. Fundi i tij është toka dhe pikënisja e tij janë qiejt me kuptimin e plotë të fjalës. Duhet qartësuar se fjalja: “*dhe ajo që është midis tyre*” nuk është e shtuar, ashtu siç e vërejmë në disa ajete të tjera në Kur’an, sepse këtu synohet deklarimi i pikënisjes dhe i fundit.

Zoti i Madhëruar me fuqinë, urtësinë dhe mençurinë e Tij ka përfshirë qiejt dhe tokën. Prandaj, nëse zbret ndonjë Libër, është mëse e qartë sa i pasur dhe i plotë do të jetë ai libër.

Ajeti vazhdon me prezantimin e Zotit të Madhëruar, zbritësin e Kur’anit Famëlartë dhe thotë: “(E Ai është) **Mëshiruesi që krijoi tokën dhe qiejt e lartë**”.

Ashtu siç e kemi diskutuar edhe më parë, në komentimin sures “El A’raf”, në ajetin 45 të saj, fjala “*arsh*” tregon diçka me

tavan. Ndonjëherë fjala “*arsh*” përdoret edhe në kuptimin e vetë tavanit, apo të froneve këmbëgjatë, ngjashëm me fronet e mbretërve.

Në tregimin e Hazreti Sulejmanit lexojmë: **“Cili prej jush do të më sjellë fronin e saj...”**¹

Është mëse e qartë që Zoti i Madhëruar nuk posedon ndonjë fron e as ndonjë pushtet si sunduesit e kësaj bote. Përkundrazi kuptimi i fjalës “arshi i Zotit” është tërësia e botës, e cila konsiderohet si fronti i sundimit të Tij.

Si rrjedhojë, fjalia “*esteua al el arsh*” - **“që krijoi tokën dhe qiejt e lartë”**, (fjalë për fjalë ka kuptimin “*u ul mbi fronin*”), nënkupton dominimin e Zotit dhe sundimin e plotë të Tij mbi universin, nënkupton pushtetin e urdhrit të Tij, komandimin dhe menaxhimin e Tij në të gjithë botën.

Parimisht, fjala “*arsh*” në gjuhën shqipe pëkthehet “*fron*” dhe përcjell konotacionin kuptimor të fuqisë. Për shembull, themi se filanin e zbritën nga fronti, nënkuptojmë se e kanë ulur nga pozita dhe pushteti, apo, siç thuhet në arabisht: “*I është shembur fronti*”.

Sidoqoftë, do të ishte e paimagjinueshme nëse dikush të personifikonte Zotin me anë të kësaj shprehjeje.

Pasi në ajet sqarohet “sundimi” i Zotit mbi univers, ai (ajeti) flet për “posedimin” e Tij. Ajeti thotë: **“E Tij është çdo gjë që ekziston në qiej e në tokë dhe çdo gjë që gjendet në mes tyre, edhe ç’ka nën dhe”**.

¹ Sure “En Naml”, ajeti 38.

Fjala *"thera"* përdoret për të treguar *"tokën e lagur"*. Nga era dhe rrezet e diellit thahet vetëm shtresa e tokës, kurse shtresa e poshtme zakonisht mbetet e lagur. Kjo shtresë e lagur e tokës quhet *"thera"*. Kështu që fjalia: *"ma tehte thera"* - **"edhe ç'ka nën dhe"** nënkupton thellësinë, brendësinë e tokës. Pra, kështu plotësohet cilësimmi: *"çdo gjë që gjendet mes tyre është e Tij, pra e Krijuesit të Gjithësisë."*

Deri këtu kemi përmendur tri shtylla prej shtyllave të attributeve të Zotit. Shtylla e parë është *"krijimi"*, shtylla e dytë *"sundimi"* dhe shtylla e tretë *"posedimi"* i gjithçkaje që ekziston në qiej e në tokë.

Në ajetin vijues, përmendet shtylla e katërt, *"dija"* e Tij. Ajeti thotë: **"Prandaj, edhe nëse e bën lutjen haptazi, Ai e di të fshehtën, madje edhe më shumë se kjo."**

Për kuptimin e fjalisë: **"Ai e di të fshehtën, madje edhe më shumë se kjo"**, ka shumë diskutime mes komentuesve të Kur'anit.

Disa kanë pohuar se fjala *"sirr"* - *"e fshehta"*, tregon një person që bashkëbisedon fshehtas me një person tjetër, kurse fjala *"ekhfa"* - *"madje edhe më shumë se kjo"*, tregon atë që e ruan në zemër diçka dhe nuk ia tregon askujt tjetër.

Disa të tjerë kanë pohuar se fjala *"sirr"* - *"e fshehta"*, nënkupton fjalët që njeriu i ruan në zemër, kurse fjala *"ekhfa"* - *"madje edhe më shumë se kjo"* nënkupton fjalën që nuk e ka dëgjuar askush tjetër, por që Zoti i Madhëruar është në dijeni për atë.

Disa të tjerë kanë deklaruar se me fjalën “sirr” nënkuptojmë veprimin, i cili kryhet fshehurazi, kurse me fjalën “ekhfa” nënkuptojmë nijetin apo qëllimin që ka në zemër njeriu.

Ka edhe komentues të tjerë që me fjalën “sirr” – “e fshehta”, nënkuptojnë të fshehtat e njerëzve, kurse me fjalën “ekhfa” – “madje edhe më shumë se kjo”, nënkuptojnë sekretet që ekzistojnë në Qenien e Zotit.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri dhe Imam Sadiku (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) lexojmë: “Fjala ‘sirr’ - ‘e fshehta’, përdoret me kuptimin që e ke mbajtur të fshehtë në zemër, kurse ‘ekhfa’ - ‘madje edhe më shumë se kjo’, me kuptimin që e ke pasur në mendje, por nuk të kujtohet”.¹

Hadithi i lartpërmendur mund të aludojë për diçka që njeriu mëson dhe e ruan në kujtesën e tij, por nganjëherë njeriu harron. Sapo e kujton nëpërmjet diçkaje, ai informacion është një çështje e njohur plotësisht.

Prandaj edhe thuhet se çështjet që ka harruar njeriu, konsiderohen sekretet më të fshehta të tij. Ato janë të fshehura në këndet e kujtesës, por lidhja me ato është ndërprerë, qoftë përgjithnjë apo përkohësisht.

Sidoqoftë, nuk paraqet asnjë pengesë nëse të gjitha komentimet apo interpretimet e lartpërmendura në kuptimin e plotë të fjalës “e fshehta” dhe të fjalës “madje edhe më shumë se kjo” të pranohen si të vërteta.

¹ “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në fjalë.

Nga sa u diskutua qartësohet dija e pafund te Zotit të Madhëruar. Nga ajetet e lartpërmendura mësohet zbritësi i Kur'anit Famëlartë në katër dimensionet: “krijim”, “sundim”, “posedim” dhe “dije”.

Kjo mund të jetë edhe arsyeja që në ajetin në vijim thuhet: **“Ai është All’llahu, nuk ka Zot, përveç Tij. Atij i takojnë emrat më të bukur.”**

Ashtu siç u shprehëm dhe në komentin e ajetit 80 të sures “El A’raf”, shprehja “*esmaul husna*” është përdorë gjithnjë si në ajetet kur’anore, ashtu edhe në librat e haditheve.

Ky grup emëror nënkupton emrat e bukur. Sigurisht që kjo shprehje përfshin të gjithë emrat e bukur të Zotit. Disa prej këtyre emrave të bukur të Zotit, kanë një rëndësi më të madhe, prandaj janë quajtur “*esmaul husna*” – “*emrat më të bukur*”.

Në shumë prej haditheve të transmetuara nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), apo nga Imamët, lexojmë: “Zoti i Madhëruar ka 99 emra. Çdo kush që e thërret All’llahun e Madhëruar me këta emra, i pranohet lutja. Çdo kush që i lexon ato është prej banorëve të Xhenetit”. Të njëjtën gjë e hasim dhe në burimet e njohura të haditheve të Ehli Syneetit.

Duhet që të paisemi me moralin e këtyre emrave dhe jo të mjaftohemi me shqiptimin e tyre. S’ka dyshim se të paisurit me cilësi të tilla: si i ditur, i fuqishëm, i mëshirshëm dhe ngjashëm me to dhe në qenien e tij të ndriçojë një rreze nga këto cilësi, ai person do të jetë prej banorëve të Xhenetit dhe do t’i pranohet lutja. (Për më shumë informacion shih komentimin e ajetit 180 të sures “A’raf” në këtë tefsir).

Ajetet 9 - 16

وَهَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ مُوسَى ﴿٩﴾ إِذْ رَأَى نَارًا فَقَالَ لِأَهْلِهِ امْكُثُوا إِنِّي
 آنَسْتُ نَارًا لَّعَلِّي آتِيكُم مِّنْهَا بِقَبَسٍ أَوْ أَجْدُ عَلَى النَّارِ هُدًى ﴿١٠﴾ فَلَمَّا
 أَتَاهَا نُودِيَ يَمْوَسَى ﴿١١﴾ إِنِّي أَنَا رَبُّكَ فَاخْلَعْ نَعْلَيْكَ إِنَّكَ بِالْوَادِ
 الْمُقَدَّسِ طُوًى ﴿١٢﴾ وَأَنَا آخَرْتُكَ فَاسْتَمِعْ لِمَا يُوحَى ﴿١٣﴾ إِنَّنِي أَنَا اللَّهُ
 لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدْنِي وَأَقِمِ الصَّلَاةَ لِذِكْرِي ﴿١٤﴾ إِنَّ السَّاعَةَ آتِيَةٌ
 أَكَادُ أُخْفِيهَا لِتُجْزَىٰ كُلُّ نَفْسٍ بِمَا تَسْعَىٰ ﴿١٥﴾ فَلَا يَصُدُّكَ عَنْهَا مَن لَّا
 يُؤْمِنُ بِهَا وَاتَّبَعَ هَوَاهُ فَتَرْدَىٰ ﴿١٦﴾

“A të ka ardhur ty njohuri për ndodhinë e Musait?”

“Kur ai pa një zjarr dhe i tha familjes së vet: ‘Rrini ku jeni, se pashë një zjarr, e unë ndoshta do t’ju sjell ndonjë gacë prej tij, ose do të gjejë te zjarri ndonjë udhërrëfyes.’”

“E kur shkoi tek ai, (zjarri), një zë i thirrë: ‘O Musa!’”

“Vërtet Unë jam Zoti yt! Prandaj hiq atë që ke mbathur, (opingat), se je në luginën e shenjtë, Tuva.”

“Unë të zgjodha ty (për Pejgamber). Prandaj dëgjo mirë se ç’po të shpallet!”

“Vërtet, vetëm Unë jam All’llahu, nuk ka zot tjetër, përveç Meje. Pra Mua më adhuro dhe fal namazin për të më kujtuar Mua.”

“S’ka dyshim se momenti, (Kiameti), do të vijë patjetër, Unë gati e kam fsheh atë, por ai (do të vijë) për t’u shpërblyer secili njeri për atë që ka bërë.”

“Prandaj, mos e lër atë që nuk beson në të (Ditën e Kiametit) dhe që jepet pas epsheve të veta, të të nxjerrë (nga rruga e drejtë), përndryshe do të humbisje.”

Komentimi

Një zjarr në anën tjetër të shkretëtirës

Këtu fillon tregimi i Hazreti Musasë (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*), Pejgamberit të madh të Zotit. Më shumë se tetëdhjetë ajete përshkruajnë skena nga e kaluara e tij. Këto rrëfime sjellin qetësi dhe ngushëllim për Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe besimtarët, të cilët në atë kohë ishin nën një tension të madh nga armiq të tyre.

Këta skena do të rrëfohen një nga një me qëllim që të kuptojmë se fuqitë djallëzore nuk i rezistojnë fuqisë së Zotit.

Nga historia e jetës së Musait, si dhe të gjitha mësimet e vyera që nxjerrim nga ajo, njerëzit mund të arrijnë të gjejnë rrugën e vet në raport me monoteizmin, adhurimin e Zotit, luftën me faraonët dhe demagogët në çdo epokë dhe në çdo kohë. Këto mësimet të orientojnë edhe në përballjen me devijimet e brendshme dhe tendencat devijuese. Këto mësimet mund të jenë ndihmesë dhe udhëzim përgjatë gjithë revolucionit islamik.

Ajetet e kësaj sureje që flasin për Hazreti Musain (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*), për Faraonin dhe Beni Izrailët, mund t'i ndajmë në katër grupe:

Ajetet e grupit të parë diskutojnë për fillimet e misionit dhe profetësisë së Hazreti Musait (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*). Thënë ndryshe, këto ajete përbëjnë një shkollë afatshkurtër, por plot domethënie. Ata tregojnë se si Hazreti Musa (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) kaloi në "Luginën e shenjtë", në atë vend të errët dhe të qetë.

Ajetet e grupit të dytë flasin rreth ftesës që Hazreti Musait (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) dhe vëllai i tij, Haruni, i bënë Faraonit dhe pasuesve të tij në lidhje me fenë monoteiste. Më pas tregojnë konfliktet e tyre me armiqtë.

Në grupin e tretë ajetet diskutojnë për largimin e Hazreti Musait (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) dhe Beni Israilëve nga Egjipti dhe mënyrën e shpëtimit të tyre nga kthetrat e Faraonit dhe ndjekësve të tij, për përmbytjen dhe shkatërrimin e tyre.

Ajetet e grupit të katërt diskutojnë për prirjen e madhe drejt devijimit të Beni Israilëve nga feja e pastër monoteiste drejt politeizmit, për pranimin e cytjeteve të Samiriut dhe të luftimit

vendimtar të Hazreti Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me këtë devijim.

Tani le t'u rikthehemi ajeteve të grupit të parë. Në këto ajete thuhet: **"A të ka ardhur ty njohuri për ndodhinë e Musait?"**.

Pikëpyetja në këto ajete nuk është në kuptimin e pritjes së përgjigjes, sepse Zoti është në dijeni për të gjitha të fshehtat. Përkundrazi pikëpyetja këtu është si një nxitje për atë që do të thuhet më tej.

Më pas ajeti thotë: **"Kur ai e pa një zjarr, e i tha familjes së vet: 'Rrini ku jeni, se pashë një zjarr, e unë ndoshta do t'ju sjell ndonjë gacë prej tij, ose do të gjejë te zjarri ndonjë udhërrëfyes.'"**.

Fjala *"kabes"* - *"gacë"*, përdoret për të treguar një grimcë që shképutet nga tërësia e një zjarri, të cilin mund ta kenë ndezur disa njerëz që mbliidhen rreth tij të ngrohen, apo të orientohen që të mos humbasin rrugën gjatë natës.

Fjala *"umkuthu"* tregon një ndalim të shkurtër. Këto ajete tregojnë që Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) së bashku me bashkëshorten dhe djalin e tij të kenë udhëtuar gjatë asaj nate të ftohtë dhe tejet të errët. Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) mendohet ta ketë humbur rrugën, por një flakë zjarri e madhe nga larg ia tërhoqi vëmendjen. Sapo e pa këtë zjarr, ai iu drejtua familjes së vet me këto fjalë: **"Ndaloni për pak çaste këtu se unë kam parë një zjarr. Do të shkoj dhe t'ju sjell diçka nga ai zjarr, ose nëpërmjet zjarrit apo njerëzve që gjenden aty, do të mësoj rrugën."**

Edhe në histori lexojmë se kur Hazreti Musait (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) i përfundoi kontrata me Shuajbin në Medjen, ai së bashku me bashkëshorten, djalin dhe delet e veta u nis nga Medjeni drejt Egjiptit. Një natë kishte humbur rrugën. Delet e tij u shpërndanë. Ai donte që të ndizte një zjarr në mënyrë që të ngrohte veten dhe familjen atë natë të ftohtë dhe të errët, por nuk arriti ta ndezë zjarrin. Në këto kushte bashkëshortes së tij shtatzënë i filluan dhimbjet e lindjes. Filloi edhe një stuhi e fuqishme. Pikërisht në këtë çast ai pa diku larg një flakë. Ky nuk ishte zjarr, por drita e All'Ilahut. Hazreti Musai (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) duke pandehur që është zjarr, u nis drejt tij që të merrte zjarr, apo të gjente rrugën.¹

Tani do të ndjekim ngjarjen sipas Kur'anit: **“E kur shkoi tek ai, (zjarri), një zë e thirri: ‘O Musa! Vërtet Unë jam Zoti yt! Prandaj, hiqi ato që ke mbathur, (opingat), se je në luginën e shenjtë, Tuva.’”**.

Në ajetin 30 të sures “Kasas” tregohet se Hazreti Musai (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) këtë zë e dëgjoi nga një pemë që ishte atje: **“Dhe kur arriti tek ai, (zjarr), nga ana e djathtë e luginës së atij vendi të bekuar me pemë, u thirr: ‘O Musa, s’ka dyshim se Unë jam All’Ilahu, Zoti i botëve!’”**.

Nga këto dy ajete kuptojmë se kur Hazreti Musai (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) shkoi pranë zjarrit pa se zjarri ishte brenda një peme. Komentuesit e Kur'anit kanë deklaruar se ka qenë pema e Hides. Edhe kjo ishte një dëshmi e qartë që ky zjarr nuk ishte një zjarr i zakonshëm, por ishte drita Hyjnore e cila nuk e digjte pemën, sepse është drita e jetës!

¹ “Mexhmaul Bejjan”, ajeti në fjalë.

Sapo Hazreti Musai (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) dëgjoi thirrjen: **“Unë jam Zoti yt”**, u emocionua. Gjithë qënien e tij e kaploi një kënaqësi e papërshkueshme. Kush po e thërriste?! Ah, Ky është Zoti im, i Cili me fjalët: **“Unë jam Zoti yt!”** më ka nderuar mua dhe më ka bërë mua që nga fillimi i fëmijërisë e deri më tani të rritem dhe edukohem me hijen e mëshirës së Tij dhe të jem i gatshëm për një mision të madh.

Hazreti Musai (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) u urdhërua që të hiqte opingat nga këmbët, sepse ishte futur në një tokë të shenjtë, në një tokë që ndriçohet me një dritë Hyjnore, në atë tokë që dëgjon mesazhin e Zotit dhe kështu bëhesh pranues i misionit të madh të profetësisë. Atij i duhej të shkelte në këtë tokë me përulësinë dhe modestinë më të madhe. Kjo është dhe arsyeja e heqjes së opingave.

Për heqjen e opingave që bëri Hazreti Musai (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) kur shkeli në Luginën e shenjtë komentuesit e Kur'anit kanë bërë diskutime të hollësishme, prandaj thënie të që kanë transmetuar një grup komentuesish duken të tepërta. Janë transmetuar disa hadithe në lidhje me interpretimin e ajetit në fjalë. Ata do t'i trajtojmë në vijim.

Fjala *“Tuva”* mendohet se është përdorë ose se ajo tokë quhej *“Tuva”* ashtu siç kanë deklaruar edhe pjesa dërmuese e komentuesve, ose se fjala *“Tuva”*, e cila, në thelb është në kuptimin e mbështjelljes, këtu aludon se kjo tokë ishte tërësisht e rrethuar nga begati shpirtërore. Pikërisht për këtë arsye në ajetin 30 të sures *“Kasas”* ajo tokë është cilësohet: **“... nga ana e djathtë e luginës së atij vendi të bekuar me pemë.”**

Më pas, po nga i njëjti thirrës, dëgjoi këto fjalë: **“Unë të zgjedha ty (për Pejgamber). Prandaj dëgjo mirë se ç’po të shpallet!”**.

Fjalja e parë e shpalljes që dëgjoi Hazreti Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ishte: **“Vërtet, vetëm Unë jam All’llahu! Nuk ka zot tjetër, përveç Meje! Pra, Mua më adhuro dhe fal namazin për të më kujtuar Mua!”**.

Ky ajet shpreh parimin kryesor të ftesës, (thirrjes) së të Dërguarve. Parimi kryesor i thirrjes përfshin çështjen e monoteizmit, adhurimin e Zotit, Një dhe të Vetëm, si dhe urdhrin e namazit, i cili do të thotë adhurimi më i madh dhe bashkimi më i rëndësishëm i Krijuesit me krijesen dhe rruga më e efektshme për të mos e harruar Qenien e Tij.

Këto tre urdhra, apo obligime janë : Urdhri i përzgjedhjes si Pejgamber, i cili u sqarua në ajetin paraprak dhe çështja e Ringjalljes do të diskutohet në ajetin në vijim. Këto ajete plotësohen me urdhrin e qëndrueshmërisë, për të cilin do të flasim në ajetet e fundit të diskutimit.

Pas përmendjes së monoteizmit dhe degëve të tij, ajeti trajton parimin e dytë themelor që është çështja e Ringjalljes, kurse në ajetin vijues thotë: **“S’ka dyshim, se momenti, (Kiameti), do të vijë patjetër. Unë gati e kam fshehë atë, (do të vijë) për t’u shpërblyer secili njeri për atë që ka bërë.”**.

Në këtë ajet janë dy pika të cilave duhet t’u kushtojmë rëndësi. Së pari është fjalja: **“Unë gati e kam fshehë atë”**. Kjo fjali tregon se Kiameti është afër, por Zoti e ka mbajtur të fshehtë kohën kur do të ndodhë. Kjo fjali nënkupton edhe faktin që

ndodhjen e Kiametit Zoti nuk e ka mbajtur të fshehtë, sepse përmes shumë ajeteve na janë treguar informacione për këtë çështje. Njëri nga këto është ajeti i 187 i sures “El A’raf” ku thuhet: **“Të pyesin ty, (Muhammed) për çastin, (Kiametin) se kur do të ndodhë ai. Thuaj: ‘Atë e di vetëm Zoti im, kohën e tij nuk mund ta zbulojë kush, përveç Tij...’”**.

Komentuesit kanë diskutuar shumë për përgjigjen e kësaj pyetjeje. Shumë nga komentuesit janë të mendimit se fjalia e lartpërmendur është një lloj hiperbolizimi. Ajo na tregon se fillimi i Kiametit është i fshehtë dhe i panjohur. Madje për atë nuk ka dijeni askush, përveç Zotit, Një dhe të Vetëm! Në lidhje me këtë, gjithashtu janë transmetuar edhe disa hadithe. Megjithatë, ka mundësi që ky grup komentuesish transmetimet e veta t’i kenë huazuar nga ai hadith.

Pika tjetër që meriton vëmendje është arsyeja e mbajtjes fshehtë të çastit të fillimit të Kiametit. Thelbi i ajetit të lartpërmendur, i cili flet për domosdoshmërinë e ndodhjes së Kiametit është: **“... për t’u shpërblyer secili njeri për atë që ka bërë.”**. Shprehur ndryshe, mbajtja e fshehtë e Kiametit krijon për të gjithë një lloj lirie në veprimet e tyre. Nga ana tjetër, meqenëse koha e tij nuk është e përcaktuar, pra, ai mund të ndodhë në çdo kohë, nënkupton që çdo njeri duhet të jetë gjithnjë i përgatitur. Edhe mbajtja fshehtë e Natës së Kadrit është deklaruar se kjo është bërë që njerëzit t’i respektojnë dhe t’i vlerësojnë të gjitha netët e muajt të Ramazanit dhe t’i drejtohen njësoj Zotit të Madhëruar.

Ajeti i fundit i diskutimit tonë, aludon një parim themelor që është garantues për zbatimin e të gjitha programeve ideologjike dhe edukative të lartpërmendura. Ajeti thotë. **“Prandaj, mos e lër**

atë që nuk beson në të (Ditën e Kiametit) dhe që jepet pas epsheve të veta, të të nxjerrë (nga rruga e drejtë), përndryshe do të humbisje.”. Kundrejt njerëzve jo besimtarë, cytjeve dhe veprave të tyre të paligjshme tregohu i fortë dhe i qëndrueshëm. As mos u frikëso nga numri i madh i tyre, as mos u frikëso nga komplotet e tyre! Asnjëherë mos dysho në vërtetësinë e thirrjes, (ftesës) dhe origjinalitetin e shkollës nga këto trazira!

Interesant është fakti që këtu Fjala “*la ju’minu*” - “**që nuk beson**” tregon se mungesa e besimit lind nga dhënia pas dëshirave, duke abuzuar me të drejtën e të qenit i lirë, pra, “njeriu është i lirë të bëjë ç’të dojë”. Pra, ata mendojnë se është më mirë ta mohojnë Kiametin, në mënyrë që asnjë femohues të mos pësojë asnjë dënim!

Hulumtime

1- Cili është synimi i shprehjes “*fekhla’ na’lejke*” ?

Siç e kemi diskutuar edhe më lart, ajeti duket sikur është përdorë me kuptimin që Hazreti Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) u urdhërua që të hiqte opingat për hir të respektit të asaj Lugine të shenjtë dhe të ecë në të me përlulesi dhe modesti, të dëgjojë fjalën e të Vërtetit dhe të marrë urdhrin e profetësisë.

Por disa komentus të Kur'anit në disa prej transmetimeve shprehen se ai u urdhërua t'i heqë opingat sepse lëkura e tyre ishte prej kafshëve të ngordhura!

Ky mendim duket një mendim i pamundur, sepse Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) nuk ka pasur ndonjë arsye që të përdorte opinga prej një lëkure të tillë, të pisët dhe të ndyrë. Ky mendim është mohuar nga disa prej transmetimeve të tjera. Këto hadithe janë transmetuar nga Imam Mehdiu, (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Ai e kundërshton fuqishëm këtë interpretim.¹

Po ashtu në Teuratin e sotëm, në kapitullin e tretë është përdorur po e njëjta shprehje që është përdorur dhe në Kur'an.

Një nga transmetimet tjera që aludojnë për interpretimin dhe kuptimin e ajetit, thotë: "Shprehja '*fekhla' na'lejke'* synon që të largojë nga vetja dy frikëra dhe dy zemërime. Frikën nga rreziku i zhdukjes së familjes tënde dhe frikën nga Faraoni".²

Në një hadith tjetër të transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) shohim se për atë moment të jetës së Hazreti Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) thuhet : "Shpreso më shumë tek ato gjëra për të cilat i ke humbur shpresat, sesa te ato gjëra, te të cilat keni shpresa akoma!" Sepse Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) shkoi pas një flake zjarri, por u kthye si i Dërguari i All'llahut të Madhëruar!³

Ndodh shpesh që njeriu shpreson tek një gjë, por nuk ia arrin qëllimit, por ndodh edhe që të arrijë pikërisht ato gjëra për të

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn" vëll 3 fq 373.

² Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll, 3, fq 374.

³ Tefsiri "Nuruth Thekalejn, vëll 3, fq 374

cilat nuk kishte asnjë shpresë. Ato i arrin me ndihmën e Zotit! E njëjta domethënie është transmetuar edhe nga Imam Aliu (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).¹

2- Përgjigjja ndaj një kritike

Disa nga komentuesit e Kur'anit kanë parashtruar një pyetje. Ajo është: Si dhe në ç'mënyrë e kuptoi Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) këtë zë, (thirrjen) që ishte nga Zoti i Madhëruar?! Si arriti që të besonte se Zoti është duke i dhuruar atij një mision?!

Kësaj pyetjeje e cila është parashtruar edhe për të Dërguarit e tjerë mund t'i përgjigjemi në dy mënyra:

Së pari: Të Dërguarit ndiejnë një lloj zbulese dhe përndritjeje të brendshme që e çon njeiun drejt bindjes dhe sigurisë së plotë dhe eliminon çdo lloj dyshimi dhe pasigurie te ai.

Së dyti: Ka gjasa që Shpallja Hyjnore në fillim të shoqërohet me vepra të jashtëzakonshme, të cilat janë të pamundura pa fuqinë e Zotit. I tillë është rasti i Hazreti Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i cili e pa zjarrin në brendësi të pemës dhe nga kjo e kuptoi që bëhej fjalë për një çështje Hyjnore dhe mrekulli më vete!

Është e nevojshme që të theksohet se kur themi se dëgjoji fjalën e Zotit nuk duhet kuptuar që Zoti i Madhëruar ka një fyt dhe një zë. All'llahu i Madhëruar me fuqinë e vet të përsosur

¹ "Sefinetul Bihar", vëll 1, fq 513.

krijon valët e zërit, i shpërndan në hapësirë dhe nëpërmjet këtyre valëve bisedon me të Dërguarit e vet. Meqenëse edhe fillimi i profetësisë së Hazreti Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) përfundoi në këtë mënyrë, ai mori llagapin “*kelimullah*”.

3- Namazi, mjete më i mirë i përkujtimit të Zotit

Në ajetet e lartpërmendura është sqaruar një nga filozofitë e rëndësishme të namazit. Meqenëse njeriu në jetën e kësaj bote është i rrethuar nga rrethana dhe faktorë shpërqendruar, ai ka nevojë për rikujtim dhe rizgjim. Ky rikujtim mundësohet nga disa mënyra dhe mjete, por namazi luan një rol të rëndësishëm te njeriu që ai të kujtojë Zotin, Kiametin, thirrjen e të Dërguarve dhe qëllimin e krijimit si dhe ta mbrojë veten nga neglizhenca dhe injoranca.

Sapo njeriu ngrihet nga gjumi dëshiron që të fillojë aktivitetin e vet ditor. Para se gjithash ai fal namazin, qetëson zemrën e shpirtin e vet duke kujtuar dhe përmendur Zotin, nga i Cili merr fuqi dhe ndihmë dhe është i gatshëm që të nisë aktivitetet të shoqëruara me ndershmëri dhe pastërti.

Edhe kur kanë kaluar disa orë dhe njeriu është angazhuar plotësisht në programet dhe aktivitetet e veta ditore dhe mbase mes tij dhe Zotit është krijuar një ndarje, vjen koha e drekës dhe dëgjon zërin e myezinit që thërret ezanin për faljen e namazit. Fillon të përgatitet për faljen e namazit, qëndron përballë adhuruesit të vet me përulësi dhe modesti dhe, nëse zemrën e tij e ka mbuluar pluhuri i neglizhencës, e pasttron atë. Është Zoti që në rekomandimet e para në fillim të Shpalljes, i drejtohet Hazreti

Musasë (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe i thotë: **“Fale namazin që të më kujtosh Mua!”**

Interesant është fakti që ky ajet thotë: **“Fale namazin që të më kujtosh Mua!”** Por në ajetin 28 të sures “Rra’d” thuhet: **“Ata që besuan dhe me të përmendur All'llahun, zemrat e tyre qetësohen, pra, ta dini se me të përmendur All'llahun zemrat stabilizohen”**.

Kurse në ajetet 27–30 të sures “El Fexhr” thuhet: **“O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt i vetëkënaqur dhe i pranuar! Hyn në turmën e robve të Mi! Dhe hyn në Xhenetin Tim!”**.

Renditja e këtyre ajeteve njëri pas tjetrit, na tregon se namazi bëhet shkak që njeriu ta kujtojë Zotin, ta përmendë Zotin, i Cili i jep atij shpirt të bindur plotësisht dhe shpirti i bindur e bën atë prej robërve të Tij dhe e çon në Xhennet.

Ajetet 17 - 23

وَمَا تِلْكَ بِيَمِينِكَ يَمُوسَى ﴿١٧﴾ قَالَ هِيَ عَصَايَ أَتَوَكَّؤُا عَلَيَّهَا
وَأَهْشُرُ بِهَا عَلَى غَنَمِي وَلِي فِيهَا مَنَازِلُ أُخْرَى ﴿١٨﴾ قَالَ أَلْقَهَا يَمُوسَى
﴿١٩﴾ فَأَلْقَاهَا فَإِذَا هِيَ حَيَّةٌ تَسْعَى ﴿٢٠﴾ قَالَ خُذْهَا وَلَا تَخَفْ سَعِيدُهَا
سِرَّتَهَا ۚ أَلَّا وَلِيَ ﴿٢١﴾ وَأَضْمَمْ يَدَكَ إِلَى جَنَاحِكَ تَخْرُجَ بَيْضَاءَ مِنْ غَيْرِ
سُوءٍ ؕ آيَةً أُخْرَى ﴿٢٢﴾ لِنُرِيَكَ مِنْ ءَايَاتِنَا الْكُبْرَى ﴿٢٣﴾

“O Musa, ç’është ajo që e ke në të djathtën tënde?”

“Ai, (Musai), tha: Ai është shkopi im që mbahem në të dhe me të u shkund (gjethe nga drunjtë) dhenve të mia dhe me të kryej edhe nevoja të tjera.”

“Ai, (All’Ilahu), i tha: ‘Hidhe atë, O Musa!’”

“Ai e hodhi atë, kur pa se shkopi u shndërrua në një gjarpër të madh që lëvizte me shpejtësi.”

“(All’Ilahu) i tha: ‘Kape atë, e mos u frikëso, se Ne do ta kthejmë atë përsëri në gjendjen e mëparshme.’”

“Dhe, fute dorën tënde nën sqetullën tënde e do ta nxjerrësh atë të bardhë pa asnjë të metë. Kjo është një mrekulli tjetër.”

“(këtë e bëmë) në mënyrë që të mundësojmë të shohësh disa nga argumentet Tona të mëdha.”

Komentimi

Shkopi i Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) **dhe dora e bardhë**

Për të vërtetuar marrëdhënien e tyre me Zotin, të Dërguarit kanë nevojë për mrekulli, përndryshe çdo kush mund të pretendojë ta konsiderojë veten si i dërguar. Si rrjedhojë, njohja dhe dallimi i të Dërguarve të vërtetë nga ato të rremë është e mundur vetëm me anë të mrekullisë.

Kjo mrekulli ka gjasa që të ketë lidhje me përmbytjen e ftesës së Profetit dhe me Librin Qiellor. Ajo gjithashtu ka gjasa që të ketë lidhje edhe me mrekullitë shqisore dhe sensuale. Përveç këtyre, mrekullia ndikon dhe në qenien e të Dërguarit. Ia bën zemrën më të fortë, i përforcon besimin dhe qëndrueshmërinë.

Pasi e pranoi urdhërin e profetësisë, Hazreti Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i duhej që të pranonte edhe dëshminë apo argumentin që e shoqëronte, prandaj atë natë të mbushur plot me

kujtime, Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) pranoi nga Zoti i Madhëruar dy mrekulli të mëdha.

Këtë ngjarje Kur'ani Fisnik e shpreh kështu: Zoti i Madhëruar e pyeti Hazreti Musanë (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*): **“O Musa, ç’është ajo që e ke në të djathtën tënde?”**.

Kjo pyetje e thjeshtë e qetësoi Hazreti Musanë (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), i cili në atë kohë ishte në një gjendje të trazuar shpirtërore. Ajo ishte një premisë për t’i ritreguar një të vërtetë të madhe.

Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në përgjigje tha: **“Ai është shkopi im ...”**.

Ishte hera e parë që Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ia kishte hapur derën dhe dëshironte që të vazhdonte edhe më tej bisedën me adhuruesin e vet. Ai mendoi se nuk do të ishte i mjaftueshëm vetëm pohimi se ai ishte shkopi i tij, por duhej treguar edhe pse e mbante, prandaj shtoi: **“... që mbahem në të dhe me të u shkund (gjethe nga drunjtë) dhenve të mia...”¹ ‘Dhe me të kryej edhe nevoja të tjera’”²**.

Dihet se shkopi mbahet për t’u mbrojtur nga kafshët e egra, për t’u mbrojtur nga armiqtë, por edhe për nevoja praktike të tjera.

Sidoqoftë, Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u befasua nga fakti se Zoti i Madhëruar iu drejtua me pyetje. Ashtu,

¹ Fjala “shushu” - “shkund” rrjedh nga rrënja “hesh” dhe është në kuptimin e shkundjes së pemëve.

² Fjala “maarib” është shumësi i fjalës “mearube” dhe që është në kuptimin e “nevojës, kërkesës dhe qëllimit”.

i befashuar, ai mendonte se ç'përgjigje do t'i jepte, se ç'farë ishin ato urdhrat e lartpërmendur? Për ç'farë është kjo pyetje?

Papritur, ai u urdhërua: **"Ai, (All'llahu) i tha: 'Hidhe atë, O Musa!'"**.

Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) menjëherë e hodhi shkopin: **"Ai e hodhi atë, kur pa, se shkopi u shndërrua në një gjarpër të madh që lëvizte me shpejtësi"**.

Fjala *"tesaa"* tregon ecjen e shpejtë, por që nuk arrin në fazën e vrapimit.

All'llahu iu drejtua Hazreti Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe i tha: **"Kape atë, e mos u frikëso, se Ne do ta kthejmë atë përsëri në gjendjen e mëparshme"**.¹

Në ajetin 31 të sures "El Kasas" lexojmë: **"... e kur e pa Musai se po lëviz si të ishte gjarpër i shpejtë, ktheu të ikë e nuk vështroi prapa. O Musa, kthehu ku ishe e mos u frikëso se me të vërtetë ti je i sigurtë"**.

Çështja e kësaj "frike" të Hazreti Musasit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) për disa komentues të Kur'anit është e diskutueshme. Ata shtrojnë pyetjen se si mundet të ketë frikë Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), kur dihet trimëria e tij?! Trimërinë dhe guximin e tij ai e ka vërtetuar në luftërat me Faraonin dhe pasuesit e tij. Përveç kësaj, trimëria dhe guximi janë karakteristika e të gjithë të Dërguarve të Zotit.

¹ Fjala *"sire"* ashtu siç është shprehur dhe Ragibi në "El Mufredat" nënkupton gjendjen e brendshme instiktive qoftë apo jo e përvetësuar, disa të tjerë gjithashtu këtu e kanë interpretuar në kuptimin e pamjes dhe formës.

Përgjigjja e kësaj pyetjeje sqaron se gjendjet emocionale të lidhura me situata të caktuara, përjetohen në mënyrë individuale nga çdo kush. Edhe njeriu më i guximshëm do të frikësohej po të shikonte se një copë dru shndërrohet papritur në një gjarpër të madh, i cili fillon të lëvizë me shpejtësi. Prandaj ky frikësim i këtij lloji nuk bie në kundërshtim me ajetin 39 të sures “El Ahzab” ku thuhet: **“Ata që i kumtojnë Shpalljet e All’llahut, i frikësohen vetëm All’llahut e askujt tjetër, përveç Atij, e All’llahu është i mjaftueshëm të jetë llogaritës”**. Kjo është një frikë e natyrshme kalimtare dhe e përkohshme e shkaktuar nga një ndodhi e papritur dhe e jashtëzakonshme.

Më pas Hazreti Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ftohet në mrekullinë e dytë, kur urdhërohet: **“Dhe, fute dorën tënde nën sqetullën tënde e do ta nxjerrësh atë të bardhë pa asnjë të metë. Kjo është një mrekulli tjetër.”**

Për komentin e fjalisë: **“Dhe, fute dorën tënde nën sqetullën tënde...”** komentuesit e Kur'anit kanë shprehur interpretime të ndryshme, por duke patur parasysh ajetin 32 të sures “El Kasas” ku thuhet: **“... fute dorën në xhep e ajo do të dalë e bardhë pa ndonjë të metë”** dhe ajetin 12 të surres “En Naml” ku thuhet: **“... fute dorën tënde në xhep e ajo do të dalë e bardhë pa kurrfarë të mete....”** përftohet më së miri se Hazreti Musai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ishte i urdhëruar që ta fuste dorën në qafë dhe ta tërhiqte deri nën sqetull (fjala “*xhenah*” aludon për nën sqetull).

Fjala “*bejdha*” nënkupton “*bardhësinë*”, kurse fjalia “*min gejri suu*” nënkupton **“pa kurrfarë të mete”**. Ajo nënkupton se bardhësia e dorës tënde nuk është si rezultat i një sëmundjeje

ngjitëse, nga e cila duart shkëlqejnë për një çast dhe më pas shkëlqimi zhduket.

Nga disa transmetime përftohet që dora e Hazreti Musait (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) kishte marrë një dritë të jashtëzakonshme. Në qoftë se ka qenë kështu, duhet pranuar që fjalia “*min gejri suu*” - “**pa kurrfarë të mete**” përveç domethënies së lartpërmendur, do të ketë dhe një domethënie tjetër, pra, që do të thotë se posedon një dritë, e cila as nuk e dëmton syrin e as nuk ka ndonjë të metë tjetër.

Në ajetin e fundit të diskutimit tonë, si një konkluzion i asaj që u tha në ajetet paraprake, thuhet: “(këtë e bëmë) **në mënyrë që të mundësojmë të shohësh disa nga argumentet Tona të mëdha**”.

Është e qartë që me shprehjen “*ajate kubra*” - “**argumentet Tona të mëdha**”, bëhet fjalë për ato dy mrekulli të rëndësishme të cilat i përmendëm më lart. Kurse mendimi i disa komentuesve të Kur’anit që aludojnë për një mrekulli tjetër, të cilën më pas ia dhuroi Zoti Hazreti Musait (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*), duket plotësisht e pamundur.

Hulumtime

1- Dy mrekulli të mëdha

Më lart diskutuam lidhur me shndërrimin e shkopit të Musait (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) në një gjarpër të madh. Kjo ngjarje është përmendur edhe në suren “El A’rafë”, në ajetin 107

ku thuhet se shkopi i tij është përmendur si *“thuban”* - *“dragonj”*. Edhe ndriçimi i veçantë i dorës së tij për një çast të vetëm dhe më pas rikthimi i saj në gjendjen e mëparshme, nuk janë një çështje normale apo e rrallë. Përkundrazi që të dyja konsiderohen vepra të jashtëzakonshme, të cilat nuk mund të realizohen pa u mbështetur tek një fuqi mbi njerëzore, që do të thotë te fuqia e Zotit të Madhëruar.

Ata që besojnë në Zotin e Madhëruar janë në dijeni për dijen dhe fuqinë e Tij të pafundme, prandaj asnjëherë nuk mund t'i mohojnë këto çështje, apo t'ua atribuojnë bestytnive, siç veprojnë materialistët.

E rëndësishme në mrekulli është se ajo që ndodh nuk është larg arsyes dhe nuk është e pamundur. Sipas këtij shpjegimi, kjo çështje është plotësisht e drejtë dhe e vërtetë, sepse asnjë argument racional nuk argumenton dot mohimin e mundësisë së shndërrimit të shkopit në një gjarpër të madh.

A nuk janë marrë nga dheu në të kaluarën e largët gjarpri dhe shkopi? Mbase ka zgjatur me mijëra apo miliona vite që nga dheu të jenë krijuar krijesa të tilla. (edhe pse ne nuk besojmë në evoluimin, provimin apo dëshminë e llojeve, themi se edhe drurët, edhe pemët, edhe kafshët janë të krijuara nga dheu, po ashtu).

Por ky rast ka të bëjë me mrekullinë. Mrekullia i kapërcen ato faza që do të duhej t'i kalonte për vite të tëra dhe i kreu për një çast. Vallë, një veprim i tillë duket i pamundur?!

Ndodh që një person gjatë një viti të shkruajë me dorë një libër të trashë, por nëse gjendet një person tjetër, i cili duke u mbështetur në një mrekulli, e shkruan të gjithë librin për një orë

ose më pak se një orë, kjo nuk do të ishte një akt i pamundur. Por kjo do të ishte një vepër e jashtëzakonshme. (Kini kujdes!)

Gjykimi i nxituar në lidhje me mrekullitë, përshkrimi apo atribumi i tyre bestytnive, janë larg logjikës. E vetmja gjë që ndonjëherë të vjen në mendje është se ne jemi mësuar me ndodhi normale, të zakonshme dhe çdo gjë tjetër që është kundër tyre, e shohim si kundërshtim të domosdoshmërisë.

2- Talentet e jashtëzakonshme të gjërave

Atë ditë që Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) kishte zgjedhur për vete shkopin, nuk e besonte që ky shkop i thjeshtë, me urdhrin e Zotit, të ishte në gjendje që të përballonte një vepër kaq madhështore, e cila prishi fuqinë e faraonëve. Por Zoti i tregoi Hazreti Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) se nëpërmjet kësaj krijese të thjeshtë, mund të krijojë një vepër të jashtëzakonshme.

Ky është një mësim për të gjithë njerëzimin: Në këtë botë të mos nënvleftësojmë asgjë! Shumë prej krijesave apo njerëzve që i shohim me syrin e nënçmimit, apo nuk i vlerësojmë, mund të ndodhë që ata të mbartin në zemrat e tyre fuqi dhe forcë të madhe, për të cilën ne nuk kemi asnjë dijeni.

3- Ç'farë thotë Teurati në lidhje me këtë çështje?

Në ajetet e lartpërmendura lexuam që në kohën kur Hazreti Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e nxori dorën nga sqetulla,

dora e tij ishte e bardhë, ndriçonte dhe nuk kishte asnjë të metë. Ka mundësi që kjo fjali të jetë mohim për një fjali tjetër, të cilën në Teurat e vërejmë të deformuar dhe të shtrembëruar, ndërsa ajeti thotë: **“Dhe, fute dorën tënde nën sqetullën tënde e do ta nxjerrësh atë të bardhë pa asnjë të metë. Kjo është një mrekulli tjetër”**.¹

Fjala *“mbrus”* përdoret me kuptimin e *një pislleku, një lloj sëmundjeje*. Prandaj përdorimi i kësaj shprehjeje në këtë rast është i pa vend dhe gabim.

¹ Teurati, “libri i Eksodit” kapitulli i katërt, fjalë 6.

Ajetet 24 - 36

أَذْهَبَ إِلَىٰ فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَىٰ ﴿٢٤﴾ قَالَ رَبِّ اشْرَحْ لِي صَدْرِي ﴿٢٥﴾ وَيَسِّرْ لِي أَمْرِي ﴿٢٦﴾ وَأَحْلِلْ عُقْدَةً مِن لِّسَانِي ﴿٢٧﴾ يَفْقَهُوا قَوْلِي ﴿٢٨﴾ وَاجْعَل لِّي وَزِيرًا مِّنْ أَهْلِي ﴿٢٩﴾ هَارُونَ أَخِي ﴿٣٠﴾ اشْدُدْ بِهِ أَزْرِي ﴿٣١﴾ وَاشْرِكْهُ فِي أَمْرِي ﴿٣٢﴾ كَيْ نُسَبِّحَكَ كَثِيرًا ﴿٣٣﴾ وَنَذْكُرَكَ كَثِيرًا ﴿٣٤﴾ إِنَّكَ كُنْتَ بِنَا بَصِيرًا ﴿٣٥﴾ قَالَ قَدْ أُوتِيتَ سُؤْلَكَ يَمُوسَىٰ ﴿٣٦﴾

“Shko te Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë.”

“(Musai) tha: ‘O Zoti im, zgjeroma kraharorin tim.’”

“Lehtësoma punën time.”

“Dhe zgjidhma nyjën e gjuhës sime.”

“Që ata të kuptojnë fjalën time!”

“Më jep një ndihmës nga familja ime.”

“Harunin, vëllanë tim!”

“Ma rrit fuqinë nëpërmjet atij.”

“Dhe bëma ortak në punën time.”

“që të thurim shumë lavde për Ty.”

“e të Të përmendim Ty vazhdimisht!”

“Vërtet, Ti do të jesh gjithnjë Mbikëqyrësi ynë.”

“(All’llahu) tha: ‘Kërkesa jote u plotësua, o Musa!’”

Komentimi

Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe kërkesat e tij

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) e kishte arritur pozitën e profetësisë. Ai ishte pajisur me shumë aftësi, me shumë mrekulli të konsiderueshme. Por tani ai vihet përpara një detyre edhe më të vështirë. I jepet urdhri për kryerjen e një misioni shumë të madh dhe të vështirë. Ai do t’i komunikonte urdhrin e All’llahut njeriut më të fuqishëm dhe më të rrezikshëm në atë kohë. Ajeti thotë: **“Shko te Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë.”**.

Për të kryer një reformim të thellë në një mjedis të korruptuar dhe për të ndezur një lëvizje të gjithanëshme duhet filluar me udhëheqësit e korruptuar dhe me prijësit, sepse ata kanë ndikim në të gjithë shoqërinë. Vetë ata, mendimet, idetë, përkrahësit apo mbështetësit e tyre janë të pranishëm kudo. Ata kanë në dorë të gjitha institucionet, kanë në dorë propagandën, ekonominë dhe politikën. Nëse arrihet reformimi i tyre, ose, së

paku, të bëhet një katarsis i thellë, mund të shpresohet për përmirësim të shoqërisë. Në të kundërt, çdo lloj reformimi që mund të kryhet do jetë sipërfaqësor, i përkohshëm dhe kalimtar.

Arsyeja e fillimit të reformimit me Faraonin është shprehur në mënyrë tepër lakonike, *"in'nehu tega"*: **"...Ai me të vërtetë i ka shkelur të gjithë kufijtë."** Në fjalën *"tug'jan"* përmbliiden të gjitha gjërat. Përfshihet edhe shkelja dhe tejkalimi i kufijve në të gjitha aspektet e jetës. Pikërisht për këtë arsye, njerëzit e tillë i quajnë *"tagut"* (shkelës të kufijve).

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) u ndie i kënaqur dhe i gëzuar nga një mision i tillë dhe e mirëpriti atë me krahë të hapur. Por për të arritur sukses në këtë mision i kërkoi ndihmë Zotit të Madhëruar.

I pari faktor për të arritur suksesin e dëshiruar është shpirti i madh, është mendja largpamëse dhe intelekti i fuqishëm, apo thënë ndryshe kapaciteti i madh. Prandaj Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) shtoi: **"O Zoti im, zgjeroma krahërorin tim ..."**.

Por kapaciteti i madh, durimi i tepërt, qëndresa, guximi, trimëria si dhe përballja e vështirësive janë faktorë shumë të rëndësishëm për një udhëheqës revolucionar. Për këtë arsye, në një hadith të transmetuar nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: *"Zemërgjerësia, (kapaciteti i nevojshëm) është mjet i udhëheqjes dhe i administrimit"*¹

Kjo rrugë kërkon sakrifica të shumta. Përballja me ta' nuk është as e lehtë dhe as e mundur pa patur mirësinë e Zotit.

¹ "Nehxhul Belaga", Fjala e urtë, numër 176. Në lidhje me zgjerimin e krahërorit dhe konceptin e tij gjithashtu kemi diskutuar edhe në vëllimin e pestë të po këtij tefisiri, ajeti 125 i sure "El En'am".

Prandaj Hazreti Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) për herë të dytë kërkoi nga Zoti i Madhëruar : **“O Zoti im, lehtësoma punën time...”**.

Më pas kërkoi t'i jepet aftësia e të shprehurit sa më mirë: **“...dhe zgjidhja njëjën e gjuhës sime...”**.

Zotërimi i një kraharori të gjerë është kapitali më i çmueshëm. Por efekti dhe vlera e këtij kapitali shtohen më shumë kur shoqërohet me aftësinë për ta prezantuar sa më mirë problemin. Për këtë arsye Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*), pas kërkesës për zgjerimin e kraharorit dhe eliminimin e pengesave, bëri kërkesën për zgjidhjen e njëjës së gjuhës.

Arsyen e kësaj kërkesë e shprehu në këtë mënyrë: **“...që ata të kuptojnë fjalën time...”**.

Komentimi i kësaj fjalie bën të qartë se kërkesa për zgjidhjen e njëjës së gjuhës nuk ishte për shkak se gjuha e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte ndonjë të metë, ndonjë dëmtim apo nga ndonjë fatkeqësi tjetër. Por kjo kërkesë është bërë vetëm për t'iu shtuar aftësia ligjërimore, oratoria e tij (Musait) që çdo dëgjues ta kuptojë qartë atë që diskutohet.

Këtë komentim e dëshmon edhe ajeti 34 i sures “El Kasas” ku thuhet: **“E vëllai im, Haruni, është më orator se unë, andaj dërgoje atë me mua ndihmë, që të vërtetojë fjalët e mia...”**.

Fjala “*efsah*” vjen nga “*fesih*”. Këtu është përdorë në kuptimin “*një gjë e pastër nga teprica dhe shtesa*”. Por është përdorur edhe për të treguar fjalën e qartë, elokumente, të saktë dhe pa nuanca të tepërta.

Një udhëheqësi të suksesshëm nuk do t'i mjaftonte vetëm logjika, largpamësia, intuïta etj, por do t'i duhej edhe një e folur e qartë, e bukur dhe e pangarkuar me paqartësi, të cilat edhe mund të çojnë në dykuptimësi.

Kryerja e këtij misioni, e misionit të Zotit për të udhëhequr njerëzit në luftën kundër shtypësve dhe tiranëve është një detyrë e rëndë. Ajo kërkon baskëpunim dhe mbështetje. Për këtë arsye Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) paraqiti kërkesën e katërt drejtuar Zotit: **“O Zot, më jep një ndihmës nga familja ime.”**.

Fjala “vezir” rrjedh nga rrënja “vizr”. Në thelb shpreh kuptimin e barrës së rëndë, e cila lidhet me përgjegjësinë para popujve të tyre për qeverisjen sa më mirë të vendit. Por fjala “vezir” përdoret edhe për të emërtuar zëvendësin ose ndihmësin.

Hazreti Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) kërkoi nga Zoti që ndihmësi që mund t'i jepej të ishte nga familja e tij, sepse kështu do të kishte pranë tij dhe më shumë njohuri dhe më tepër dhembshuri. Sa mirë është kur njeriu bashkëpunon me njerëz me të cilët ka lidhje gjaku, shpirtërore e fizike. Kërkesa e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) konkretizohet. Ai kërkon si ndihmës vëllain e vet, kur thotë: **“Harunin, vëllanë tim.”**.

Sipas disa transmetimeve të disa komentuesve të Kur'anit, Haruni ishte tre vjet më i madh në moshë se Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*). Ai ishte shtatgjatë, fliste pastër dhe me elokuencë si dhe kishte një përceptim të shkëlqyer.

Ai ishte prej Profetëve të dërguar (me mision), siç thuhet edhe në ajetin 45 të sures “Mu'minun”: **“Më pas Ne dërguam**

Musain dhe vëllanë e tij Harunin me mrekullitë dhe argumentet tona të qarta ...”.

Gjithashtu Haruni rezatonte dritë dhe shkëlqim së brendshmi. Ai dallonte lehtë të vërtetën nga e pavërteta, siç thuhet në ajetin 48 të sures “El Enbija”: **“Ne i patëm dhënë Musait e Harunit Furkanin** (dalluesin mes të vërtetës e të kotës – Teuratin), **që ishte dritë e këshillë për të devotshmit.”**.

Si përfundim, Haruni ishte një Pejgamber që iu dhurua Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) nga ana e mëshirës së Zotit: **“Nga mëshira Jonë i dhamë vëllain e tij Harunin, Pejgamber.”**¹

Në kryerjen e këtij misioni të rëndë ai qëndroi krah për krah me vëllanë e vet, Hazreti Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*).

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) e mori urdhërin për misionin Hyjnor më shumë se dhjetë vjet pasi ia kishte bërë kërkesën Zotit të Lartësuar. Por gjatë kësaj kohe ai nuk i kishte ndërprerë marrëdhëniet me vëllanë e vet. Me vëllanë e vet ai vijonte t’i diskutonte gjërat haptazi, prandaj kërkoi nga Zoti që t’ia jepte ndihmës dhe përkrahës pikërisht të vëllanë në misionin e ngarkuar.

Më pas, Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) emërimin e të vëllait, Harunit, si ministër dhe zëvendës të tij e shpjegon në këtë mënyrë: **“Ma rrit fuqinë nëpërmjet atij.”**

Fjala “*uzr*” në thelb rrjedh nga rrënja “*izar*” dhe është përdorë me kuptimin e rrobës. Ky kuptim përdoret më së shumti

¹ Sure “Merjem”, ajeti 54.

për rroba që lidhen për beli. Prandaj kjo fjalë përdoret edhe në lidhje me belin, forcën apo fuqinë.

Në vijim të plotësimit të këtij qëllimi ai kërkon sërish nga Zoti: **“...dhe bëma ortak në punën time...”**.

Vëllai i Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), Haruni, ishte ortak me Hazreti Musanë edhe në pozitën e profecisë, edhe në realizimin e këtij projekti të madh. Por në të gjitha aktivitetet ai ishte pasues dhe ndjekës i Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), kurse vetë Hazreti Musai ishte udhëheqës dhe prijës i tij.

Si përfundim, gjithë sukseset që synonte të arrinte, gjithë rezultatet e kërkesave të veta i bënte që: **“...që të thurim shumë lavde për Ty, e të të përmendim Ty vazhdimisht!”**.

Sepse: **“Vërtet, Ti do të jesh gjithnjë Mbikëqyrësi ynë.”**.

Ti je plotësisht në dijeni për nevojat tona, Je më i informuar se kushdo tjetër për vështirësitë e këtij misioni. Ne nga Ti kërkojmë që të na dhurosh forcë në bindjen ndaj urdhrave të Tua, të na bësh të suksesshëm dhe triumfues në kryerjen e përgjegjësive, obligimeve dhe premtimeve tona.

Hazreti Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) me kërkesat e tij të singerta kishte vetëm një qëllim. T’i shërbente sa më mirë dhe plotësisht Atij, Zotit të Madhëruar që ia pranoi lutjen dhe kërkesën. Kjo duket në thënien e Hazreti Musait: **“(All’llahu) tha: ‘Kërkesa jote u plotësua, o Musa!’”**.

Ishin çastet më të gëzueshme kur Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) u ul për të parën herë në tryezën e të ftuarve të Zotit. Hazreti Musai në atë tryezë i kërkoi çdo gjë për të cilën pati

nevojë. Zoti i Madhëruar e nderoi shumë të ftuarin e vet dhe ia pranoi atij të gjitha kërkesat duke iu përgjigjur me një fjali të shkurtër e duke ia përsëritur emrin e tij. Plotësimi i menjëhershëm i të gjitha kërkesave, për më shumë edhe duke ia përsëritur emrin Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) largoi çdo lloj paqartësie dhe i dha edhe më shumë forcë e besim në kryerjen e misionit fisnik.

Hulumtime

1- Kushtet e udhëheqësit të revolucionit

Transformimet rrënjësore në një shoqëri njerëzore dhe shndërrimi i vlerave materiale dhe politeistike në vlera shpirtërore dhe njerëzore nuk është aspak e lehtë. Kjo detyrë bëhet edhe më e vështirë në shoqëritë ku sundojnë faraonë dhe diktatorë, në shoqëritë ku ka më shumë nevojë për parapërgatitje shpirtërore dhe fizike, për fuqi të menduari dhe aftësi për t'u shprehur. Të gjitha këto bëhen që të ndriçohet gjithnjë e më shumë rruga e tyre nga drita Hyjnore.

Këto janë çështjet që Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) ia kërkoj Zotit të Madhërueshëm që në fillim të misionit të tij të madh. Kjo dëshmon se Hazreti Musai, edhe para profetësisë, kishte aftësi dhe një shpirt të zgjuar, se ishte plotësisht i vetëdijshëm për dimensionet e përgjegjësisë së tij, se ai e dinte se në ç'kushte të veçanta dhe me ç'mjete duhej të dilte në luftë ku do të përballej me fuqinë e faraonistëve .

Ky shembull mbetet me vlerë për të gjithë udhëheqësit Hyjnorë në çdo kohë dhe në çdo epokë, si dhe për të gjithë ndjekësit e kësaj rruge.

2- Luftimi me rebelët

Faraoni ishte politeist, idhujtar, shtypës, diktator dhe i padrejtë ..., por Kur'ani është ndalur vetëm në tiraninë e tij dhe thotë: "*in'nehu taga*". Ky togfjalësh përdoret me kuptimin se Faraoni karakterizohet nga shpirti tiran dhe rebel karshi urdhrit të All'Ilahut. Kjo është përmbledhja e të gjithë devijimeve të tij.

Prandaj, qëllimi i parë i të Dërguarve është luftimi me tiranët dhe arrogantët. Ky shpjegim është i nevojshëm, sepse marksistët me teoritë dhe opinionet e tyre rreth religjioneve e konsiderojnë fenë si shërbëtor të despotëve dhe kolonialistëve.

Në të vërtetë, disa teori të tyre në lidhje me fetë e rreme devijante të jenë të drejta dhe të sakta, prandaj historia e të Dërguarve të drejtë ka shpjeguar qartë dhe në mënyrë të prerë se këto iluzione të tyre janë të pabaza. Ky shpjegim ilustron sidomos me kryengritjen e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), e cila është një dëshmi e gjallë dhe e qartë e pavërtetësisë së teorisë të tyre.

3- Për çdo vepër nevojiten programet dhe mjetet e duhura.

Nga jeta e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) marrim edhe një mësim tjetër. Ky mësim është pikërisht fakti që edhe Hazreti

Musai, edhe të Dërguar të tjerë, të cilët zotëronin gjithë ato mrekulli, për të plotësuar më së miri detyrat e ngarkuara kërkojnë ndihmë te oratoria, tek forca ndikuese e fjalës, te aftësitë mendore dhe fizike e përkrahësve etj, sepse nuk është e thënë që në jetë të jemi të gjithë të plotësuar me të gjitha aftësitë intelektuale, argumentuese, oratorike, fizike etj. Njeriu nuk duhet të qëndrojë në pritje të mrekullive. Ai duhet të hartojë programe, duhet të sigurojë mjetet e nevojshme të punës, të kërkojë aleatë, dhe kur punët bllokohen, duhet kërkuar dhe qëndruar në pritje të mëshirës së All'llahut.

4- Lartësimi dhe përmendja (e Zotit)

Në ajetet e lartpërmendura Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) qëllimin përfundimtar të kërkesave të veta e përcakton në këtë mënyrë: **“Që të thurim shumë lavde për Ty”**.

Fjala “*tesbih*” është përdorë në kuptimin e lartësimit të Zotit nga shpifja për “politeizëm dhe mangësi të qenieve të rastësishme”. Hazreti Musai, fjalën “*subhanAll'llah*” nuk e përsëriste vazhdimisht. Ai synonte vetëm realizimin e të vërtetës në atë shoqëri të korruptuar dhe të shthurur. Ai synonte të zhdukte idhujt, të shkatërronte tempujt e idhujtarisë, të pastronte trurin nga idetë e përlyera me politeizëm dhe idhujtari dhe të eliminonte mangësitë materiale dhe shpirtërore, të ngjallte tek zemrat përmendjen e Zotit, përmendjen e atributive të Tij si dhe të bënte që cilësitë e Tij të shfaqeshin qartë në mbarë shoqërinë e kohës.

Referimi te fjala “kethiran”, (shumë), tregon se dëshironte ta bënte publike atë duke e nxjerrë nga ai rreth i kufizuar.

5- Profeti i Islamit dhe përsëritja e kërkesave të Hazreti Musait (Paqja qoftë mbi të!)

Nga hadithet që janë transmetuar në librat e dijetarëve të Ehli Syneetit dhe burimet shi'ite mësohet se edhe Profeti i Islamit kishte kërkuar nga Zoti të njëjtat gjëra që kishte kërkuar edhe Hazreti Musai (Paqja qoftë mbi të!), për çuarjen përpara dhe realizimin e detyrave të ngarkuara. I vetmi dallim ishte se në vend të emrit të “Harunit” Profeti Muhammed ka përmendur emrin “Ali” dhe i ishte drejtuar Zotit në këtë mënyrë: “O Zoti Im! Unë po kërkoj nga Ti të njëjtën gjë që të ka kërkuar dhe vëllai im, Hazreti Musai. Prej Teje kërkoj që të më zgjerosh kraharorin, të m'i lehtësosh punët, të më zgjidhësh njëjën e gjuhës në mënyrë që njerëzit të jenë në gjendje që të perceptojnë fjalët e mia, të më japësh një vezir nga familja ime, pra, vëllanë tim, Aliun. O Zot më forco pushtetin me ndihmën e tij, dhe ma bëj ortak në punën time, në mënyrë që Ty shumë të të lavdërojmë, Ty shumë të të kujtojmë, dhe Ti gjithnjë do të jesh Mbikëqyrësi ynë.”.

Këtë hadith e ka transmetuar Sujutiu në tefsirin e tij “Durr'rrul Menthur”, dhe Tabersiu në “Mexhmaul Bejjan”. Këtë hadith e kanë transmetuar edhe shumë prej dijetarëve të tjerë të Ehli Syneetit dhe shijave, por me disa ndryshime në tekst.¹

Me këtë hadith ngjan edhe hadithi që njihet si hadithi “Menzile” i pozitës, në të cilin Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut

¹ Në komentimin e ajetit “innema uelikumullah ...” (Sure “El Maide”, ajeti 55).

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) iu drejtua Imam Aliut me fjalët: “Vallë, a nuk je i kënaqur që edhe ti ndaj meje të jesh në pozitën e Harunit me Musanë, me përjashtim që pas meje nuk do të ketë të dërguar tjetër”!?

Ky hadith përmendet në burimet parësore të Ehli Synetit. Sipas Muhaddith Bahrani (në bazë të transmetimit të tefsirit “El Mizan”) në librin me titull “Gajetul Meram” është transmetuar me njëqind zinxhir transmetimesh nga Ehli Syneti dhe shtatëdhjetë zinxhir transmetimesh nga dijetarët shi’itë, dhe është aq i saktë saqë nuk ka vend për asnjë lloj mohimi apo refuzimi.

Për hadithin “Menzile” kemi diskutuar në mënyrë të mjaftueshme në vëllimin e gjashtë të po këtij tefsiri, në ajetin 132 të sures “El A’raf”.

Por duhet sqaruar se disa nga komentuesit (si për shembull Alusiu në “Ruhul Meani”) me gjithë pranimin e tekstit të hadithit, kanë shfaqur rezerva në lidhje me konotacionin e tij. Ky komentues ka shkruar: “Fjalja: ‘Bëje atë ortak në punën time’, nuk aprovon dhe nuk vërteton gjë tjetër, përveç ortakërinë në çështjen e udhëzimit dhe të thirrjes së njerëzve drejt Zotit të Madhëruar”.

Por çështja e ortakërisë në udhëzim, apo çështja e udhëzimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja si dhe përhapja e thirrjes së të Vërtetës është përgjegjësi e çdo individi që është besimtar. Kjo nuk ishte diçka që Profeti ta kërkonte vetëm për Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo çështje nuk ka nevojë për sqarim të mëtejshëm.

Lutjen e Profetit në asnjë mënyrë nuk mund ta interpretojmë siç e paraqet nga ky dijetar.

Dihet mirë se synimi nuk ishte ortakëria në çështjen e profetësisë. Bazuar në këtë konkludojmë se kërkesa ishte për një pozitë të veçantë dhe jo për profetësinë. Ajo pozitë është pozita e udhëheqësisë pas Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Thënë me fjalë të tjera, ekzistojnë përgjegjësi që nuk janë attribute të të gjithë njerëzve. Disa prej të cilave po i përmendim këtu: Ruajtja e fesë së Profetit nga çdo lloj shmangie dhe devijimi, interpretimi i çdo paqartësie që mund të shfaqet në përmbajtjen e fesë, udhëheqja dhe drejtimi i popullit në mungesë të Profetit dhe pas tij, ndihmësi efektiv në realizimin dhe çuarjen përpara të objektivave të përbashkëta, etj.

Të gjitha këto Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i kërkoi nga Zoti për Aliun me anë të shprehjes “*eshrikhu fi emri*”.

Ajetet 37 - 41

وَلَقَدْ مَنَّا عَلَيْكَ مَرَّةً أُخْرَى ﴿٣٧﴾ إِذْ أَوْحَيْنَا إِلَىٰ أُمِّكَ مَا يُوحَىٰ ﴿٣٨﴾ أَنْ
 أَقْذِفِيهِ فِي التَّابُوتِ فَاقْذِفِيهِ فِي الْيَمِّ فَلْيُلْقِهِ الْيَمُّ بِالسَّاحِلِ يَأْخُذْهُ عَدُوٌّ
 لِّي وَعَدُوٌّ لَهُ ۚ وَأَلْقَيْتُ عَلَيْكَ مَحَبَّةً مِّنِّي وَلِتُصْنَعَ عَلَىٰ عَيْنِي ﴿٣٩﴾ إِذْ تَمْشِي
 أُخْتُكَ فَتَقُولُ هَلْ أَدُلُّكُمْ عَلَىٰ مَن يَكْفُلُهُ ۖ فَرَجَعْنَاكَ إِلَىٰ أُمِّكَ كَيْ تَقَرَّ
 عَيْنُهَا وَلَا تَحْزَنَ ۚ وَكَلَّمْتَ نَفْسًا فَتَجِدَنَّكَ مِنَ الْغَمِّ وَفَتَنَّاكَ فُتُونًا ۚ فَلَبِثْتَ
 سِنِينَ فِي أَهْلِ مَدْيَنَ ثُمَّ جِئْتَ عَلَىٰ قَدَرٍ يَمْوَسَىٰ ﴿٤٠﴾ وَأَصْطَبَعْتُكَ
 لِنَفْسِي ﴿٤١﴾

“Edhe më parë, Ne të kemi bërë mirë ty.”

“Kur i frymëzuam nënës tënde atë që iu frymëzua.”

“Vëre atë (foshnjën) në një sënduk e hidhe në lumë! Lumi do ta nxjerrë në breg e atë do ta marrë një armiku Im dhe armiku i tij.’ Unë kam hedhur në ty dashurinë Time, që të rritesh nën Syrin (kujdesin) Tim.”

“Kur shkoi motra jote e tha: ‘A doni t’ju tregoj dikë që do të kujdeset për atë?’, Ne të kthyem te nëna jote, që ajo të gëzohej dhe të mos pikëlllohej më. Pastaj ti vrave një njeri, por Ne të shpëtuam nga brenga dhe të vumë në sprova të shumta. Ti qëndrove me vite të tëra midis banorëve të Medjenit, pastaj erdhe sipas porosisë së caktuar, o Musa!”

“Unë të kam zgjedhur ty për Vete.”

Komentimi

Zoti Mëshirëplotë

Në këto ajete Zoti i Madhëruar ka rrëfyer pjesë tjetër nga jeta e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo histori i përket periudhës së fëmijërisë së Hazreti Musait kur shpëtoi nga zemërimi i Faraonit. Kjo periudhë ishte para periudhës së profetësisë dhe misionit. Megjithatë ajo është vlerësuar si dëshmi për begatitë e Zotit në lidhje me Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ajeti thotë në fillim: **“Edhe më parë, Ne të kemi bërë mirë ty”,** dhe ty të kemi përfshirë në begatitë Tona.¹

¹ Ashtu siç e kemi cekur edhe më parë, fjala “*min’net*” në thelb, rrjedh nga fjala “*men’n*” që është në kuptimin e një matësi të veçantë që peshojnë me anë të saj, për këtë arsye “*min’net*” e quajnë dhurimin e çdo lloj begatie të madhe dhe të çmueshme, dhe në ajetin e lartpërmendur shënon po këtë kuptim dhe kjo është një domethënie e bukur dhe pozitive, por nëse ndonjëri punën e vet të vogël e

Allahu i Madhëruar pasi bën këtë vlerësim të përgjithshëm në ajetin 37, vijon me përshkrimin e detajuar të historisë në ajetin tjetër ku thotë: **“Kur i frymëzuam nënës tënde atë që iu frymëzua.”**.

Me këtë citim aludohej se të gjitha “linjat” që çonin në shpëtimin e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) nga Faraoni ne ia mësuam nënës sate.

Edhe nga ajete të tjera kur'anore mësohet se Faraoni e kishte vënë në presion të ashpër popullin e Beni Israilitëve. Ai kërkonte pengimin e fuqizimit të israilitëve, pengimin e revoltave të mundshme të tyre. Faraoni kishte kërkuar që të parandalonte lindjen e një fëmije për të cilën kishin parashikuar se do të jetë nga Beni Israilët dhe do të ngrihet e do të shpartallojë pushtetin e tij. Prandaj, Faraoni kishte urdhëruar që t'i vrisnin djemtë që do të lindnin nga populli i Beni Israilit, kurse vajzat e tyre t'i mbanin të gjalla si robëresha apo shërbëtoresha.

Spiunët e Faraonit mbikëqyrnin të gjitha lagjet dhe shtëpitë e israilitëve. Ata denonconin tek pushtetarët lindjen e çdo djali dhe viheshin menjëherë në veprim për eliminimin dhe vrasjen e çdo foshnje të porsalindur.

Disa nga komentuesit kanë thënë: Faraoni, nga njëra anë dëshironte që të thyente forcën e Beni Israilit, kurse nga ana tjetër, nuk donte që brezi i tyre të zhdukej plotësisht. Faraoni popullin e Beni Israilit dhe fëmijët që lindnin i konsideronte si skllevër dhe shërbëtorë të nënshtruar. Për këtë arsye, ai kishte urdhëruar që një

“zmadhon” me anë të fjalës dhe ia thotë në fytyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë është një vepër e shëmtuar dhe shembull negativ të “min’netit”, pra, vetekspozimit me bamirësi.

vit të mos ua vrisnin foshnjat e tyre dhe vitin tjetër t'i mbysnin të gjithë foshnjat meshkuj. Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) lindi në vitin e vrasjes masive të fëmijëve meshkuj.

Thonë se nëna e ndjen kur jeta e foshnjës së saj është në rrezik. Përpjekjet për ta fshehur, nuk do ishin zgjidhja më e mirë e problemit. Zoti i Madhëruar do ta ruante atë fëmijë. Ai e kishte përzgjedhur këtë foshnje, Hazreti Musain (*Paqja qoftë mbi të!*) për një kryengritje të madhe, prandaj shpalli në zemrën e kësaj nëne: **"... tani tutje lëre në dorën Tonë dhe do të shikosh se si do ta ruajmë atë dhe do të ta rikthejmë ty."**

Zoti i Madhëruar e solli këtë frymëzim në zemrën e nënës së Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*): **"Vëre atë (foshnjën) në një sënduk e hidhe në lumë!"**.

Fjala "*jem'm*" është përdorë me kuptimin e lumit të Nilit, i cili për shkak të shtrirjes së madhe dhe ujit të shumtë, ndonjëherë quhet edhe det.

Përdorimi i shprehjes "*ikdhiflihi fit'tabut*" (vëre në një sënduk) ka mundësi të ketë këtë kontekst: të heqë dorë prej tij pa asnjë hezitim dhe druajtje në zemër, ta vëre atë me guxim në një sënduk dhe ta hedhë në lumin Nil dhe të mos ketë frikë fare.

Fjala "*tabut*" tregon një sënduk prej druri. Nuk korespondon me kuptimin e sëndukut në të cilën vendosin trupin e xhenazes. Përkundrazi, ka një kuptim të gjerë. Ndonjëherë përdoret edhe për sëndukët e tjerë, ashtu siç e lexuam edhe në tregimin e "Talutit dhe Xhalutit" në suren "El Bekare", ajeti 248.¹

¹ Shih vëllimin e dytë të po këtij tefsiri faqe 173.

Më pas po shton: **“Lumi do ta nxjerrë në breg e atë do ta marrë një armiku Im dhe armiku i tij.”**.

Fjala *“aduun”* është përsëritur. Ky theksim bëhet për të treguar se armiqësia e Faraonit është shumë e madhe ndaj Zotit, ndaj Musasë (*Paqja qoftë mbi të!*), edhe ndaj Beni Israilitëve. Gjithashtu, ajo fjalë tregon se ai njeri (Faraoni) i zhytur në atë armiqësi, në fund do të përkujdeset dhe do ta edukojë vetë Hazreti Musain (*Paqja qoftë mbi të!*).

Gjithashtu, kur Zoti i Madhëruar dëshiron asgjësimin e shtypësve dhe të të padrejtëve, i shfaros me duart e tyre dhe i djeg me zjarrin që e kanë ndezur vetë. Sa fuqi të mahnitshme që ka Zoti i Lartësuar!

Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) do i duhej një mbrojtje në këtë rrugë plot peripeci. Zoti i Madhëruar nga dashuria e Vet lëshoi mbi të një dritë që mahniste këdo që e shikonte. Kjo tregonte se Ai, Zoti i Madhëruar, nuk ishte dakord me vrasjen e tij, por madje nuk pranonte as t'i prekej një fije floku! Në vazhdimësi të këtyre ajeteve Kur'ani thotë: **“...Unë kam hedhur në ty dashurinë Time ...”**.

Çfarë mburoje e çuditshme! Vërtet e padukshme, por më e fortë se çeliku dhe hekuri!

Dadoja e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte nga populli i Faraonit. Ajo kishte vendosur që të informonte organet e shtetit (të Faraonit) për lindjen e djalit. Por me shikimin e parë që i hodhi dados ajo foshnjë e porsalindur, ia ndriçoi shpirtin. Ajo largoi nga mendja e saj të gjithë mendimet ogurzeza.

Lidhur me këtë detaj, në një hadith nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të*), lexojmë:

“Kur lindi Hazreti Musai (Paqja qoftë mbi të!) dhe kur nëna e tij e pa që foshnja e porsalindur ishte djalë, fytyra iu zbeh”. Dadoja e pyeti përse ishte aq e zbehtë në fytyrë.

Ajo i tha: “Kam frikë që djalit tim do ta therin”. Dadoja i tha: *“Asnjëherë mos ia lejo vetes një frikë të tillë.”*¹ Hazreti Musai ishte i tillë që çdo kush që e shihte e donte atë”.

Ishte kjo parzmore dashurie që e mbrojti Hazreti Musain nga Faraoni.

Ajeti, në fund thotë: “ **... që të rritesh nën Syrin** (kujdesin) **Tim** ”.

Disa nga komentuesit fjalinë: “ **... që të rritesh nën Syrin** (kujdesin) **Tim**”, në komentet e tyre e kanë konsideruar se kjo periudhë kohore i korespondon periudhës së ushqyerjes së fëmijës me gjí. Por, kjo fjali ka një kuptim të gjerë dhe përfshin gjithë edukimin, rritjen dhe formimin e plotë të Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*).

Gjithçka që është thënë në Kur'anin Fisnik dhe që është përmendur edhe në histori, tregon se nëna e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) e vuri të birin në një sënduk dhe, me dhimbje të thellë, e hodhi në lumin Nil. Valët e tij e morën me vete, kurse e ëma mbeti me sytë e përlotur duke parë si e morën me vete ujërat e shumta të Nilit. Ajo u zhyt në dëshpërim të thellë, por, Zoti i Madhëruar e frymëzoi atë: **“Mos u hidhëro e as mos u dëshpëro,**

¹ Nuruth Thekalejn, vëllimi 3, faqe 378.

më në fund Ne do të ta kthejmë ty shëndoshë dhe në gjendje të mirë”.

Kështjella e Faraonit ishte e ndërtuar në një cep të lumit Nil dhe një degëzim nga ky lum i madh kalonte përmes kështjellës së tij. Valët e ujit e kishin tërhequr sëndukun e Hazreti Musait dhe e kishin çuar në këtë degë të lumit. Faraoni dhe bashkëshortja e tij ndodheshin në breg të lumit duke soditur valët e trazuara të ujit. Papritur ua tërhoqi vëmendjen një sënduk i çuditshëm. Ai i urdhëroi shërbëtorët që ta nxirrnin sëndukun nga uji dhe kur u hap dera e sëndukut, për çudinë e tyre, panë një foshnje të bukur. Një gjë të tillë as që e kishin menduar ndonjëherë.

Faraoni e kuptoi. Kjo foshnje duhet të jetë nga Beni Israilët, të cilët, të frikësuar nga ushtarët e Faraonit që kishin marrë urdhër për të vrarë çdo djalë që lindte, e paskëshin hedhur në lum, me shpresën se mund ta shpëtonte dikush. E shoqja e Faraonit u gëzua pa masë. Ajo, duke qenë sterile, iu lut Faraonit që jo vetëm të mos e mbyste foshnjën, por ta adaptonin për vete, ta rrisnin si simbol të shpresës së tyre. Faraoni u prek nga fjalët e së shoqes dhe e pranoi kërkesën e saj. Foshnja, me atë shikimin plot dashuri dhe mister, e tërhoqi dhe e bëri për vete në çast. Ajo u lidh shumë me këtë foshnjë.

Foshnja e sapolindur ishte e uritur, qante dhe përlotej. Kjo e qarë e tronditi zemrën e bashkëshortes së Faraonit. Nuk mbeti alternativë tjetër përveç se ta merrnin me vete. Kërkuan ngado dado për t’u kujdesur për mirërritjen e kësaj foshnjeje, por foshnja nuk pranoi mëkimin nga asnjëra prej dadove që kishin sjellë, sepse Zoti e kishte caktuar që t’i rikthehej vetëm nënës së vet.

Nëpunësit e Faraonit sërish u vunë në kërkim të një dadoje tjetër.

Sipas ajeteve kur'anore me fjalë përmbledhëse kjo histori vazhdon kështu:

“Po, o Musa! Ne e kishim përcaktuar që të rriteshe dhe të edukoheshe nën Syrin (kujdesin) Tim”. Motra e kësaj foshnjeje, pra, motra e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) banonte në afërsi të kështjellës së Faraonit. Ajo ishte porositur që të shëtiste pranë ndërtesës së Faraonit dhe të bënte çmos që të ishte e vëmendshme ndaj çdo gjëje që lidhej me të vëllanë. Një ditë ajo u afrua dhe u tha përgjegjësve të Faraonit: A dëshironi t’iu prezantoj një grua që di të kujdeset për foshnje: **“A doni t’ju tregoj dikë që do të kujdeset për atë?”**, dhe shtoi se kjo grua, e cila do t’i japë gji foshnjës, është një grua e ndershme dhe besnike dhe jam plotësisht e bindur që foshnja nuk do ta refuzojë atë.

Nëpunësit e Faraonit u gëzuan se ndoshta, kjo grua do të dinte si mëkohej një fëmijë. Me anë të kësaj do ta gjenin atë çfarë kërkonin. Nëpunësit e Faraonit u nisën së bashku me atë grua, pra me motrën e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), e cila sillej si një e huaj dhe e panjohur. Ajo e vuri në dijeni nënën për rrjedhjen e ngjarjes. Edhe nëna, gjithashtu, sillej me gjakftohtësi dhe pa e humbur kontrollin, edhe pse zemrën e saj e kishte kapluar stuhia e dashurisë dhe shpresës. Ajo erdhi në oborrin mbretëror të Faraonit dhe ia sollën foshnjën e ia lëshuan në prehër. Foshnja, sapo nuhati erën e nënës, një erë të njohur, papritur filloi që të mëkonte gjirin e saj si një shpirt i ëmbël i mbushur me plot dashuri dhe dëshirë. Nga të pranishmit u dëgjuan britmat e

gëzimit dhe në sytë e bashkëshortes së Faraonit u shfaqën shenjat e lumturisë dhe të kënaqësisë.

Disa pohojnë se Faraoni u mahnit nga kjo ngjarje dhe tha: Kush je ti që foshnja e pranoi gjirin tuaj, ndërkohë që gratë e tjera i ka refuzuar?

Nëna tha: Unë jam një grua e pastër dhe e ndershme dhe asnjë fëmijë nuk ka refuzuar gjirin tim.

Sidoqoftë, Faraoni ia besoi asaj foshnjën dhe bashkëshortja e tij e këshilloi që të tregohej tepër e kujdesshme për ruajtjen e rritjen e djalit. Ajo kujdesej shumë mirë për foshnjën dhe herë pas here ia sillte foshnjën bashkëshortes së Faraonit.

Pas kësaj Kur'ani shton: **“Ne të kthjem te nëna jote, që ajo të gëzohej dhe të mos pikëlllohej më”**.

Kjo foshnje duhej të rritej me besim dhe siguri të plotë. Foshnja duhej të ishte e mbrojtur nga çdo rrezik që mund të vinte nga ana e njerëzve të Faraonit.

Nga fjalia e lartpërmendur kuptojmë se Faraoni ia besoi foshnjën nënës, (pra, nënës së vërtetë të foshnjës) që ta çonte në shtëpinë e vet. Por ajo foshnje tashmë ishte adoptuar nga familja e Faraonit dhe gëzonte dashurinë e madhe të bashkëshortes së tij, prandaj duhet ta shpinin rregullisht tek oborri mbretëror i Faraonit.

Kaluan vite, dhe Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) u rrit në një atmosferë të mbushur me dashuri dhe mirësi të Zotit dhe në një mjedis të sigurtë dhe të mbrojtur. Pak nga pak arriti në moshën e adoleshencës.

Një ditë pa dy persona që po ziheshin dhe grindeshin me njëri-tjetrin. Njëri ishte nga Izrailitët dhe tjetri nga Koptët (Egjiptianët dhe mbështetësit e Faraonit). Duke u nisur nga fakti që Beni Israilët gjithnjë ishin nën presionin, keqtrajtimin dhe persekutimin e Koptëve, Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) i erdhi në ndihmë të shtypurit, i cili ishte nga Beni Israilët. Për ta shpëtuar atë, ai i dha një goditje të fuqishme personit që i përkiste koptëve. Por ngjarja u thellua dhe arriti në një pikë pa kthesë, sepse njeriu që goditi Hazreti Musai vdiq.

Hazreti Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) u brengos nga kjo ngjarje. Njerëzit e Faraonit e mësuan se kush e kishte kryer vrasjen dhe menjëherë u vunë në ndjekje të tij.

Por Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) (edhe sipas rekomandimit të disa prej shokëve të tij) u largua fshehurazi nga Egjipti dhe u drejtua në drejtim të Medjenit. Atje u vendos në një mjedis të sigurtë dhe të besueshëm pranë të dërguarit Shuajb (*Paqja qoftë mbi të!*), për të cilin, me lejen e Zotit, do të flasim më gjerësisht në të ardhmen, në komentimin e sures "El Kasas".

Lidhur më këtë çështje Kur'ani shton: **"Pastaj ti vrave një njeri, por Ne të shpëtuam nga brenga dhe të vumë në sprova të shumta. Ti qëndrove me vite të tëra midis banorëve të Medjenit..."**.

Pasi e kalove këtë rrugë të gjatë dhe u përgatite nga ana shpirtërore, nga ana trupore dhe nga sprovat e rënda dole fagebardhë dhe krenar. All'llahu thotë: **"...pastaj erdhe sipas porosisë së caktuar, o Musa!"**.

Fjala “*kader*”, sipas disa prej komentuesve të Kur'anit, është përdorur për të treguar kohën që ishte përcaktuar për Hazretin Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) që të zgjidhej si i dërguar. Por disa të tjerë këtë fjalë e kanë konsideruar në kuptimin e “sasisë”. Me këtë kuptim është përdorë edhe në vende të tjera në Kur'an.¹

Sipas këtij komenti, kuptimi i fjalisë është i tillë: O Musa! Pas këtyre peripecive u rrite dhe vazhdove të jetoje në afërsi të një të Dërguari të madh, siç është Hazreti Shuajbi (*Paqja qoftë mbi të!*) duke kaluar sprova të ndryshme dhe të shumta. Më në fund ke fituar pozitë, vlerë dhe personalitet dhe je i gatshëm që të pranosh shpalljen e All'Ilahut.

Më pas shton: **“Unë të kam zgjedhur ty për Vete”.**

Ty të kam edukuar për përgjegjësinë e rëndë të pranimit të Shpalljes, për pranimin e misionit, për udhëzimin dhe drejtimin e robve të Mi, të kam vënë në sprovë nëpërmjet ngjarjeve të ashpra, të kam dhënë forcë dhe fuqi dhe tani që të jepet kjo përgjegjësi e madhe, je i përgatitur për nga çdo pikëpamje.

Fjala “*istina*” rrjedh nga fjala “*sana'a*”. Këtu është përdorë me kuptimin e “këmbënguljes dhe veprimin këmbëngulës për korrigjimin dhe përmirësimin e një gjëje”. (siç është shprehur Ragibi në El Mufredat). Kjo do të thotë: Ty të kam formuar nga çdo pikëpamje, thuajse të dua për veten Time. Kjo është fjala më e dashur që Zoti i Madhëruar ka thënë rreth këtij Profeti të madh. Kështu kanë pohuar disa nga dijetarët dhe të urtët: Në kohën që Zoti i Madhëruar e do një njeri, tregohet tepër i kujdesshëm ndaj tij, siç bën miku i dashur në lidhje me mikun e vet.

¹ Sure “El Hixhr”, ajeti 21.

Hulumtime

Vallë, a i shpallet njerëzve të tjerë përpos të Dërguarve?

Pa dyshim, që shpallja (vahj) në Kur'anin Fisnik ka kuptime të ndryshme:

Ndonjëherë është në kuptimin e një zëri të mekur, ose shqiptimit të ngadaltë të diçkaje, (ky është kuptimi thelbësorë në fjalorin arab).

Ndonjëherë është në kuptimin e tregimit me shenjë të një gjëje, si për shembull: **“Dhe ai doli prej faltores para popullit të vet dhe u dha shenjë adhuroni (All’llahun) mëngjes e mbrëmje”**.

¹

Ndonjëherë është në kuptimin e frymëzimit instinktiv, si për shembull: **“Zoti yt i dha instinkt bletës:”**. ²

Ndonjëherë është në kuptimin e urdhrit të krijimit, si për shembull: **“Atë ditë ajo i rrëfen tregimet veta, ngase Zoti yt e ka urdhëruar atë”**. ³

Dhe ndonjëherë është në kuptimin e frymëzimit që u dërgohet njerëzve besimtarë edhe pse nuk janë të Dërguar dhe Imamë, si për shembull: **“Atëherë kur nënën tënde e frymëzuam**

¹ Sure “El Merjem”, ajeti 11.

² Sure “En Nahl”, ajeti 68.

³ Sure “Ez Zelzele”, ajetet 4-5.

me atë që nuk kuptohet ndryshe, pos me inspirim (me frymëzim, me shpallje)."¹

Një prej rasteve më të rëndësishme të përdorimit të saj gjendet në Kur'anin Fisnik. Këto janë mesazhet që u përkasin vetëm të Dërguarve, si për shembull: **"Ne të frymëzuam ty me shpallje, sikurse e patëm frymëzuar Nuhun dhe Pejgamberet pas tij ...".**²

Si përfundim, fjala "*vahjun*", ka një përdorim kuptimor të gjerë dhe gjithëpërfshirës. Ajo përfshin të gjitha këto raste dhe përdorime. Ky kuptim gjithëpërfshirës i fjalës "shpallje" është përdorur edhe në lidhje me nënën e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*).

¹ Sure "Ta Ha", ajeti 38.

² Sure "En Nisa", ajeti 163.

Ajetet 42 - 48

أَذْهَبَ أَنْتَ وَأَخُوكَ بِآيَاتِي وَلَا تَنِيَا فِي ذِكْرِي ﴿٤٢﴾ أَذْهَبَا إِلَىٰ فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَىٰ ﴿٤٣﴾ فَقُولَا لَهُ قَوْلًا لَّيِّنًا لَّعَلَّهُ يَتَذَكَّرُ أَوْ يَخْشَىٰ ﴿٤٤﴾ قَالَا رَبَّنَا إِنَّنَا نَخَافُ أَنْ يَفْرُطَ عَلَيْنَا أَوْ أَنْ يَطْغَىٰ ﴿٤٥﴾ قَالَ لَا تَخَافَا إِنِّي مَعَكُمَا أَسْمَعُ وَأَرَىٰ ﴿٤٦﴾ فَأَتِيَاهُ فَقُولَا إِنَّا رَسُولَا رَبِّكَ فَأَرْسِلْ مَعَنَا بَنِي إِسْرَءِيلَ وَلَا تَعْذِِبْهُمْ ۖ قَدْ جِئْنَاكَ بِآيَةٍ مِّن رَّبِّكَ ۖ وَالسَّلَامُ عَلَيَّ مَنِ اتَّبَعَ ۖ أَهْدَىٰ ﴿٤٧﴾ إِنَّا قَدْ أُوحِيَ إِلَيْنَا أَنَّ الْعَذَابَ عَلَىٰ مَن كَذَبَ وَتَوَلَّىٰ



“Shkoni ti dhe vëllai yt me mrekullitë e Mia dhe mos reshtni së përmenduri Mua!”

“Shkoni te Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë!”

“Flitini atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet!”

“Ata thanë: O Zoti ynë! Ne kemi frikë se ai do të na dënojë menjëherë ose do të ndërkrehet më tepër”.

“(All’llahu) tha: ‘Mos u frikësoni! Në të vërtetë, Unë jam me ju, dëgjoj dhe shoh.’”

“Shkoni tek ai dhe i thoni: ‘Ne të dy jemi të Dërguarit e Zotit tënd, lëshoji të bijtë e Izrailit që të vijnë me ne dhe mos i mundo! Ne të kemi sjellë ty një shenjë nga Zoti yt. Paqe mbi atë që ndjek rrugën e drejtë!’”

“Vërtet, neve na është shpallur se dënimi do të godasë këdo, që (i) mohon (shenjat e All’llahut) dhe (u) kthen shpinën (të Dërguarve të Tij)”.

Komentimi

Përballja e parë me Faraonin tiran

Çdo gjë po shkonte siç duhej dhe Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) zotëronte të gjithë mjetet që i duheshin. Zoti i drejtohet atij dhe vëllait të tij, Harunit (*Paqja qoftë mbi të dy!*) dhe u thotë: **“Shkoni ti dhe vëllai yt me mrekullitë e Mia...”**.

Këto mrekulli përfshijnë edhe dy mrekullitë e mëdha të Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*). Ato përfshijnë edhe shenjat e tjera të Zotit. Ndër shenjat e tjera të Zotit janë përmendur mësimet dhe programet që dëshmojnë për vërtetësinë e thirrjes së tij. Kjo qartësohet edhe më shumë po të kemi parasysh faktin që këto

mësimë (rekomandime) të çmuara vijnë nga një njeri, i cili pjesën më të madhe të jetës së tij e kishte kaluar si bari.

Dhe në përforcim të këtij mendimi shton: **“...dhe mos reshtni së përmenduri Mua ...!”**.

Heqja dorë nga vendosmëria dëmton të gjitha përpjekjet, prandaj njeriu duhet të jetë i vendosur në udhën e tij. Nuk duhet të frikësoheni nga asgjë dhe mos u tregoni të dobët dhe të plogësht para asgjëje.

Më pas, përcaktohet qëllimi kryesor i kësaj lëvizjeje dhe pika nga duhet orientuar dhe thotë: **“Shkoni te Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë!”**.

Ai është burimi i të gjitha fatkeqësive të kësaj toke të gjerë. Deri sa ai nuk do të ndryshojë, asgjë nuk do të rregullohet, sepse faktori i përparimit apo prapambetjes, i lumturisë apo i fatkeqësisë së një populli, para së gjithash, janë udhëheqësit dhe drejtuesit e tij, prandaj, pikësëpari ata duhen vënë në shënjestër e më pas të tjerët.

Haruni në atë kohë nuk ishte i pranishëm në atë fushë, por, siç janë shprehur edhe komentuesit e Kur'anit, Zoti i Madhëruar e vuri në dijeni për këtë ngjarje dhe për kryerjen e këtij misioni. Ai u largua nga Egjipti në pritje të vëllait të vet, Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*).

Nuk përbënte asnjë problem nëse kryerja e një misioni t'u ngarkohej dy personave, kur njëri prej tyre të mos ishte i pranishëm. Kjo është e zakonshme në përditshmërinë tonë.

Shpesh ne dëgjojmë të thuhet: Ti dhe vëllai yt të vini menjëherë tek unë, sapo vëllai yt të kthehet nga udhëtimi.

Më pas, përballallet me Faraonin në fillim të misionit me qëllim që të ndikojë te ai. Këtë pëballje e shpreh kështu: **“Flitini atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet!”**.

Fjalët *“jetedhek’keru”* dhe *“jakhsha”* tregojnë se po të tregohemi të qetë dhe të flasim me fjalë të buta dhe, ndërkohë, të tregohemi të vendosur dhe të qartë, do të ishte një mundësi që bashkëbiseduesi ynë t’i pranojë argumentet logjike dhe mund të bëhet besimtar. Mundet që edhe nga frika e ndëshkimeve të Zotit në këtë botë apo në Botën Tjetër të jenë ndikuese dhe personi të mos ju kundërshtojë.

Por ekziston edhe një mundësi e tretë. Ai as të mos kujtohet për Zotin e as të mos e ketë frikë Atë, por të zgjedhë rrugën e kundërshtimit dhe të luftimit.

Fjala *“leal’le”* (mbase) na krijon idenë se argumentimet mund të mos jenë kurdoherë të plota, prandaj mund të mungojë pranimi nga dëgjuesi dhe detyra e folësit të mos ketë sukses.

Zoti i Madhëruar ishte në dijeni se në fund ku do të përfundonte puna e tij. Por shprehjet e lartpërmendura janë mësim për Hazreti Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Harunin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe për të gjithë udhëheqësit e rrugës së All’Ilahut.¹

¹ Në lidhje me kuptimin e fjalës *“leal’le”* dhe se në çfarë kuptimi është përdorur në Kur’an në mënyrë të detajuar e kemi diskutuar në vëllimin e katërt të po këtij tefsiri ajeti 84 i sures “En Nisa”.

Pavarësisht kësaj, Hazreti Musa dhe Haruni (*Paqja qoftë mbi ta!*) ishin të brengosur nga frika se Faraoni mund të jepte urdhër për t'i ekzekutuar para se Hazreti Musai dhe Haruni t'ia komunikonin shpalljen, prandaj ata thanë: **“O Zoti ynë! Ne kemi frikë se ai do të na dënojë menjëherë ose do të ndërkrehet më tepër.”**.

Fjala “*jefrut*” përdoret me kuptimin e “hedhjes përpara”, kurse fjala “*farit*” tregon atë që hyn i pari në një pus uji. Me këto kontekste duhen lexuar fjalët e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) që ka thënë te varrezat jashtë Kufës: “*O banorë të shtëpive të vetmuara, vendeve të rrënuara dhe varreve të errëta! O banorë të pluhurit! O banorë të vendit të huaj! O banorë të vetmisë! O banorë të vetmuar! Ju shkoni përpara dhe na paraprini neve gjersa ju ndjekim, e ne do t’iu arrijmë...*”.¹

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe vëllai i tij u frikësoheshin dy gjërave:

Së pari, se Faraoni mund t’i asgjësonte para se të dëgjonte fjalët e tyre.

Së dyti, se Faraoni mund t’i asgjësonte menjëherë pasi që të dëgjonte fjalët e tyre. Në të dy rastet misioni i tyre rrezikonte të mbetej i papërfunduar.

Por Zoti i Madhëruar u drejtohet atyre me këto fjalë: **“Mos u frikësoni! Në të vërtetë, Unë jam me ju, dëgjoj dhe shoh.”**.

Si përfundim, kur njeriu e di se ka Zotin e Madhëruar pranë, kudo e kurdo, që dëgjon e shikon gjithçka, që është

¹ Nehxhul Belaga, urtësi të shkurtra, urtësia 130.

mbështetja e vetme e sigurtë, nuk duhet të ketë asnjë hezitim dhe asnjë frikë.

Më pas, me pesë fjali të shkurtëra tregon mënyrën se si duhet ta realizojnë programin e tyre në prani të Faraonit. Fjalia e parë tregon thelbin e misionit, fjalia e dytë tregon përmbajtjen e misionit, fjalia e tretë tregon arsyen e kryerjes së misionit, e katërta stimulimin e atyre që kanë pranuar besimin dhe fjalia e fundit flet për kërcënimin e kundërshtarëve.

Në fillim thotë: **“Shkoni tek ai dhe i thoni: Ne të dy jemi të dërguarit e Zotit tënd ...”**.

Në fjalinë e mësipërme vihet re përdorimi **“Zoti yt”** në vend që të thotë **“Zoti ynë”**. Kjo mënyrë komunikimi synon që t'i zgjojnë ndjenjat Faraonit dhe ta ndërgjegjësojë që ai ka një Zot dhe këta janë përfaqësuesit e Zotit të tij. Ndërkaq, me mjaft elokuencë ia bëjnë të qartë se ai, Faraoni, nuk mundet të bëhet hyjni, sepse Zoti është vetëm Një.

Fjalia: **“...lëshoji të bijtë e Izrailit që të vijnë me ne dhe mos i mundo...”** është thirrja që lëshoi Musai (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo thirrje nuk ishte vetëm për shpëtimin e Beni Israilëve nga kthetrat e Faraonit dhe të parisë së tij, por ishte thirrje edhe për shpëtimin e vetë Faraonit dhe ndjekësve të tij nga gjëma e idhujtarisë dhe politeizmit.

Më pas i kujton Faraonit argumentin dhe dëshminë e vet dhe thotë: **“Ne të kemi sjellë ty një shenjë nga Zoti yt...”**.

Ne nuk flasim kot dhe pa ndonjë arsye, prandaj, në bazë të arsyes, është e nevojshme, që së paku, të mendosh dhe të reflektosh mbi fjalët tona dhe, nëse kemi të drejtë, t'i pranosh ato.

Kurse për stimulimin e besimtarëve thotë: **“Paqe mbi atë që ndjek rrugën e drejtë!”**.

Kjo fjali ka gjasa që të jetë aludim edhe për një kuptim tjetër. Prehja në këtë botë dhe në Botën Tjetër (dhe shpëtimi) nga brengat, vuajtjet dhe dënimet e dhimbshme Hyjnore, nga problemet e jetës individuale dhe shoqërore është për ata që pasojnë dhe ndjekin udhëzimin e All'llahut.

Në fakt, ky është rezultati përfundimtar i thirrjes së Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*).

Më në fund, bëjani me dije atij edhe fundin edhe të ardhmen e tij të zezë në rast se do ta refuzojë këtë thirrje. Për ta bëra më të qartë këtë thotë: **“Vërtet, neve na është shpallur se dënimi do të godasë këdo, që (i) mohon (shenjat e All'llahut) dhe (i) kthen shpinën (të dërguarve të Tij)”**.

Mund të supozohet se kjo fjali nuk përshtatet me porosinë që kishin marrë që në fillim për të komunikuar me gjuhë të butë. Si shembulli i mjekut që i duhet t'i thotë të sëmurit që të përdorë këtë ilaç të hidhur, në qoftë se do të shërohet.

Ky shpjegim përcjell ndonjë kërcënim të veçantë, kanosje personale apo sjellje të dhunshme. Ky shpjegim ia bënte të qartë Faraonit gjithçka duhej dhe drejt për së drejti.

Hulumtime

1- Fuqia madhështore dhe e çuditshme e Zotit

Historia na ka treguar për shumë njerëz të fuqishëm dhe të pushtetshëm që janë ngritur për të luftuar kundër fuqisë së të Vërtetës. Historia, gjithashtu, na ka treguar se Zoti i Madhëruar në asnjë rast nuk i ka mobilizuar ushtritë e tokës dhe të qiellit për goditjen e tyre. Zoti i Madhëruar, kur ka dashur, i ka shtypur në një mënyrë të lehtë, të thjeshtë dhe të paimagjinueshme për disa.

Shpesh herë i ka çuar ata drejt vdekjes së tyre dhe ka bërë që vdekja e tyre t'ju vijë nga duart e tyre.

Në këtë historinë e Faraonit shohim se armikun kryesor të tij, Faraoni e edukohen në prehrin e tij dhe vetë e fut në rrethin e mbrojtur të tij. Dhe më i çuditshëm është fakti që sipas transmetimeve të historianëve tregohet se dadoja e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte nga Koptët. Gjithashtu, edhe marangozi që ndërtoi arkën (sëndukun) ku e vunë foshnjen, ishte nga Koptët.

Ata që e nxorën sëndukun nga lumi ishin ushtarët e Faraonit. Ai që e hapi sëndukun ishte vetë bashkëshortja e tij. Pikërisht nëna e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) u thirr si gjdhënësja e foshnjës nga nëpunësit e Faraonit.

Përndjekja e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) pas së vrasjes së burrit nga Koptët nga ushtria e Faraonit, u bë shkak i shpërnguljes së tij dhe t'i krijohej mundësia të edukohej në shkollën e Profetit Shuajb.

Si përfundim, kurdo që Zoti i Madhëruar do që të tregojë fuqinë e vet vepron në atë mënyrë që të gjithë kryeneçët ta kuptojnë se sa të vegjël janë para fuqisë së Tij dhe para vullnetit të Tij.

2- Ballafaqimi me butësi dhe me dashamirësi me armikun

I pari urdhër kur'anor që krijon mundësinë e ndikimit në zemrat e njerëzve (edhe nëse janë njerëz të devijuar dhe të shthurur moralisht) është afrimi dhe përballja me butësi me ta'dhe gjithmonë e shoqëruar me dashuri dhe emocione njerëzore. Komunikimi me zemërim u përket fazave kur përballjet miqësore nuk japin efektin e tyre.

Synimi është që të ftojme sa më shumë njerëz që të reflektojnë dhe të gjejnë rrugën e drejtë ose të frikësohen nga e ardhmja ogurzezë e tyre si pasojë e veprave që kanë kryer: **“...se ndoshta kujtohet a frikësohet...”**.

Çdo doktrinë duhet që të ketë si synim ftimin e njerëzve, jo largimin e tyre.

Historia e të Dërguarve dhe Imamëve na e bën të qartë se ata gjatë gjithë jetës së tyre, nuk devijuan nga ky parim.

Por mundet që te disa njerëz zemërgurë sjellja e butë dhe emocionale të mos ndikojë. Atëhere e vetmja rrugë e mbetur është mbështetja tek zemërimi. Kjo është e pranueshme në raste të veçanta, por jo si parim i përgjithshëm.

Në fillim të çdo pune, rekomandimi i parë është dashuria dhe butësia. Ky është mësimi që ajetet e lartpërmendura na e bëjnë të qartë më së miri.

Për t'u nënvizuar është fakti që në disa transmetime lexojmë: Madje edhe vetë Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte i obliguar që Faraonin ta thërriste me emrin e tij më të mirë duke shpresuar që ky gjest të ndikonte në zemrën e tij të ngurtësuar.

3- Përgjigjja ndaj një pyetjeje

Duke studiuar ajetet e lartpërmendura lind pyetja: Përse Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*), me gjithë premtimet e All'llahut që kishte, sërish ndihej në ankth, i shqetësuar dhe i frikësuar? Ky shqetësim i tij bëri që Zoti i Madhëruar të flasë qartazi dhe të thotë: **“Shkoni! Unë kudo dhe në çdo vend jam me ju, dëgjoj të gjitha fjalët tuaja, shoh çdo gjë dhe nuk ka vend për t'u shqetësuar.”**.

Kjo është përgjia më e qartë për këtë pyetje. Ky mision vërtetë që ishte një mision shumë i rëndë. Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte një bari që dëshironte të shkonte vetëm me vëllanë e vet të luftonte me një pushtetar të plotfuqishëm, despot, tiran dhe mburravec, i cili kishte përqendruar në duart e vet pushtetin dhe fuqitë më të mëdha të asaj kohe. Pikërisht, misionin e parë në rrugën e së Vërtetës duhet ta fillonte me Faraonin. Ky ishte një mision jashtëzakonisht i ndërlikuar dhe i vështirë.

Duhet thënë që njohja dhe dija kanë faza të ndryshme. Ndodh që njeriu të jetë plotësisht në dijeni për një gjë, por vonon

që të sigurohet dhe të bindet. Kështu ndodhi me Hazreti Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!), me besimin e tij të sigurtë në lidhje me Ringjalljen. Ai kërkoi nga Zoti i Madhëruar që të shohë me sytë e tij skena konkrete nga ringjallja e të vdekurve që kur ishte në këtë botë në mënyrë që të fitonte më shumë siguri dhe besim.

Ajetet 49 - 55

خَلَقَهُ شَيْءٌ كُلٌّ أَعْطَى الَّذِي رَبُّنَا قَالَ ﴿٤٩﴾ يَمُوسَىٰ رَبُّكُمَا فَمَنْ قَالَ
 فِي رَبِّي عِنْدَ عِلْمُهَا قَالَ ﴿٥١﴾ الْأُولَىٰ الْقُرُونِ بَالُ فَمَا قَالَ ﴿٥٢﴾ هَدَىٰ ثُمَّ
 مَهْدًا الْأَرْضَ لَكُمْ جَعَلَ الَّذِي ﴿٥٣﴾ يَنْسَىٰ وَلَا رَبِّي يَضِلُّ لَا كِتَابٍ
 مِّنْ أَزْوَاجًا بِهِ فَأَخْرَجْنَا مَاءَ السَّمَاءِ مِنْ وَأَنْزَلَ سُبُلًا فِيهَا لَكُمْ وَسَلَكَ
 الْأُنْهَىٰ لِلْأُولَىٰ لَا يَتَذَكَّرُ فِي إِنَّ أَنْعَمَكُمْ وَأَرْعَوْا كُلُّوا ﴿٥٤﴾ شَتَّىٰ نَبَاتٍ
 أُخْرَىٰ تَارَةً نُخْرِجُكُمْ وَمِنْهَا نُعِيدُكُمْ وَفِيهَا خَلَقْنَاكُمْ مِنْهَا ﴿٥٥﴾

“Faraoni tha: E, kush është Zoti juaj, o Musa?”

“Musai tha: Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar.”

“Faraoni tha: Si është gjendja e brezave të mëparshëm?”

“Musai tha: Dijenia lidhur me ta gjendet te Zoti im, në Libër. Zoti im nuk gabon dhe nuk harron!”

“Është Ai që Tokën e ka bërë shtrat për ju, që ju ka shtruar rrugët nëpër të dhe që lëshon ujë nga qielli, me qëllim që, nëpërmjet tij, të rriten shumë lloje bimësh të ndryshme.”

“Hani dhe kullotni bagëtinë tuaj! Këto, me të vërtetë, janë shenja për ata që janë mendarë.”

“Ne ju kemi krijuar prej tokës, aty do t’ju kthejmë dhe nga ajo do t’ju nxjerrim edhe një herë tjetër.”

Komentimi

Kush është Zoti i juaj?!

Këtu, Kur’ani fisnik nuk i përmend disa kërkesa të cilat mund të kuptohen duke u mbështetur në hulumtimet që do të vijnë. Ajetet në fjalë fillojnë me bashkëbisedimin e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Harunit me Faraonin.

Në realitet çështja vijon kështu:

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*), pasi mori urdhrin e misionit dhe udhëzimin e plotë, gjithëpërfshirës dhe të gjithanshëm rreth mënyrës së ballafaqimit me Faraonin, niset nga toka e shenjtë dhe bashkohet me të vëllanë, Harunin në afërsi të Egjiptit dhe nisen në drejtim të Faraonit. Pas shumë vështirësish arrijnë të futen në pallatin legjendar të Faraonit, në të cilin ishte tejet e vështirë të futeshe.

Kur Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) u ndodh përballë me Faraonin filloi të flasë duke llogaritur çdo fjalë dhe faktet e tyre, siç ia kishte mësuar Zoti i Madhëruar në momentin e zbritjes së urdhrit për misionin. Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: Ne jemi të Dërguarit e Zotit tuaj! Lejoi Beni Israilët që të vijnë me ne, mos i torturo dhe mos abuzo me ata! Ne, nga ana e Zotit kemi sjellë me vete një argument dhe mrekulli të qartë!

Paqja qoftë mbi atë njeri që e ndjek udhëzimin!

Dije dhe këtë që ne na është shpallur se dënimi është në pritje të atyre personave që përgënjeshtrojnë dhe ia kthejnë kurrizin urdhrit të Zotit!

Faraoni, pasi dëgjoi këto fjalë kërkoi të dinte se kush ishte Zoti i Musait (*Paqja qoftë mbi të!*). Faraoni tha: **“E, kush është Zoti juaj, o Musa?”**.

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) nxitoi dhe bëri një përshkrim të plotë dhe të shkurtër të Zotit të Madhëruar. Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: **“Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar”**.

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) me këtë përgjigje thekson dy parime thelbësore të krijimit dhe të universit. Secili prej tyre është një argument më vete për njohjen e Zotit. Parimi i parë tregon se Zoti i Madhëruar secilës krijesë i ka dhuruar atë që është e nevojshme për të. Për këtë çështje janë shkruar shumë libra.

Nëse do të mendonim dhe meditonim për bimët dhe gjallesat që jetojnë në çdo zonë, për shpendët, për kafshët ujore, për insektet dhe zvarranikët etj, do të shohim se secila nga këto

është në harmoni të plotë me mjedisin e saj dhe gjithë çfarë u nevojitet është në dispozicion të tyre.

Trupi i tyre, struktura, forma, pesha, shqisat ua mundësojnë atyre jetesën dhe përshtatjen me mjedisin ku jetojnë: në tokë, në ajër apo në det.

Diskutimi në lidhje me këto nuk mund të përfundojë në shkrim.

Parimi i dytë është parimi i udhëzimit dhe drejtimit të krijesave. Kur'ani për të dhënë këtë kuptim ka përdorur fjalën *"thum'me"*, të cilën, më pas atë e ka zhvendos në plan të dytë, pas sigurimit të nevojave.

Ndodh që një njeri të ketë në dispozicion një mjet për jetesë, por mos të dijë si ta përdorë atë. Është e domosdoshme që të njihet me mënyrën e përdorimit. Këtë ne e shohim edhe në ekzistencën e krijesave të ndryshme. Secila nga ato krijesa përdor në mënyrë të saktë forcat e veta në përshtatjen dhe mbijetesën me mjedisin ku jetojnë.

Nevojat më imediate janë: Si të ndërtojnë fole? Si të bëjnë riprodhimin? Si të edukojnë fëmijët e tyre? Si të mbrohen nga dora e armikut? Si të ngrihen dhe të luftojnë kundër armikut?

Po kështu, edhe njerëzit gëzojnë këtë udhëzim natyror (të krijimit), por, duke u nisur nga fakti që njeriu është një krijesë që zotëron dije dhe intelekt, Zoti i Madhëruar udhëzimin e tij natyror e ka shoqëruar dhe harmonizuar me udhëzimin sheriatik (legjislativ) dhe, nëpërmjet të Dërguarve, do t'ia arrijnë synimit, nëse nuk devijojnë nga kjo rrugë.

Pra, njeriu për shkak të njohjes dhe diturive të tij, për shkak të të arsyetuarit dhe logjikës, për shkak të lirisë së zgjedhjes, të detyrave dhe përgjegjësisë, si rrjedhojë e tyre, ndërton programe për përsosmërinë që shtazët nuk i kanë. Prandaj njeriu, përveç udhëzimeve të caktuara në natyrën e tij ka nevojë edhe për udhëzimin legjislativ.

Thënë shkurt, Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) dëshironte që t'ia bënte me dije Faraonit që ky univers nuk kufizohet as me ty, as me tokën e Egjiptit, nuk i përket as të sotmes as të kaluarës, se kjo botë e madhe ka një të kaluar dhe një të ardhme që as unë nuk kam qenë në atë e as ti nuk ke qenë aty dhe atje. Në këtë botë janë të rëndësishme dy çështje kryesore:

Sigurimi i plotë i nevojave dhe vënia e forcave në shërbim të përparimit dhe zhvillimit të krijesave. Kuptimi i këtyre parimeve bën të mundur që ti të njohësh Zotin tonë dhe, sa më shumë që të meditosh dhe reflektosh në lidhje me këtë, do të vëresh dhe do të zbulosh më shumë argumente nga madhështia dhe fuqia e Tij.

Faraoni, pasi dëgjoji këto fjalë gjithëpërfshirëse dhe interesante, bëri pyetjen tjetër: **“Si është gjendja e brezave të mëparshëm?”**. Ç’synim kishte Faraoni kur bëri këtë pyetje? Komentuesit e Kur'anit kanë paraqitur opinione të ndryshme:

1- Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) kundërshtarët e monoteizmit i konsideroi të përfshirë në dënimin e All'llahut. Disa komentues thonë se Faraoni duke shfrytëzuar këtë fakt pyeti: Atëherë përse të gjithë ato popuj politeistë, që kishin jetuar në të kaluarën, nuk i ka kapluar një dënim i tillë?!

2- Disa të tjerë kanë thënë: Meqenëse Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) Zotin e Madhëruar e prezantoi si Krijuesin e të gjithëve, Faraoni pyeti: Atëherë, përse paraardhësit tanë dhe të gjithë këta popuj të kaluar ishin politeistë? Kjo tregon që shirku dhe idhujtaria nuk është një vepër e padrejtë!

3- Kurse disa të tjerë deklarojnë se meqenëse kuptimi i fjalimit të Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) theksonte se të gjithë do të korrin rezultatin e veprave të veta dhe ata që nuk tregohen të bindur ndaj urdhrit të All'llahut, do të dënohen dhe do të ndëshkohen. Faraoni tha: Atëherë, cila do të jetë përgjegjësia dhe detyra e atyre që kanë vdekur dhe nuk kanë mundësi që të rikthehen në këtë botë? Hazreti Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: **“Dijenja lidhur me ta gjendet te Zoti im, në Libër. Zoti im nuk gabon dhe nuk harron!”**¹

Si rrjedhojë, llogaria e tyre është e ruajtur dhe në përfundim ato do të ndëshkohen apo do të shpërblehen, sipas veprave të tyre. Ruajtësi i kësaj llogarie është Zoti i Madhëruar, i Cili as nuk gabon kurrë e as nuk harron kurrë.

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) tregoi parimin e monoteizemit. Ai e prezantoi Zotin si ruajtës të kësaj llogarie për çdo njeri që ia ka plotësuar nevojat në mënyrë rigoroze e më pas e ka udhëzuar atë.

¹ Këtu termi “*kitab*” është përmendur në formën e pashquar dhe aludon për madhësitinë e një libri në të cilin janë të ruajtur veprat e njerëzve ashtu sikur që në një ajet tjetër lexojmë: “...të mjerët ne, ç’është puna e këtij libri që nuk ka lënë as (mëkat) të vogël e as të madh pa e përfshirë – prezente....”. (Sure “El Kehf” ajeti 49).

Ka një dallim mes fjalës “la jedhil’lu” me fjalën “la jensa”. Dallimi është ky: fjala “la jedhil’lu” tregon se Zoti i Madhëruar nuk gabon kurrë, kurse fjala “la jensa” tregon se Ai nuk harron kurrë në mbajten e llogarive të njerëzve.

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) vë në dukje se dituria e Zotit të Madhëruar përfshin çdo gjë me qëllim që Faraoni ta kuptojë as një koke gjilpërë nga veprat e tij nuk do të mbetet e fshehur nga dija e Zotit dhe do të kthehet në shpërblim apo në ndëshkim.

Siç thamë më parë, një pjesë e fjalimit të Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte rreth monoteizmit dhe njohjes së Zotit të Madhëruar. Kur’ani në lidhje me këtë çështje thotë: **“Është Ai që Tokën e ka bërë shtrat për ju, që ju ka shtruar rrugët nëpër të dhe që lëshon ujë nga qielli, me qëllim që, nëpërmjet tij, të rriten shumë lloje bimësh të ndryshme.**

Në tërësi, ky ajet, tregon katër begati nga begatitë e shumta të Zotit të Madhëruar:

1- Toka është djepi i qetësisë dhe i rehatisë të njeriut. Në sajë të ligjit të gravitetit dhe të shtresës së madhe të ajrit që e ka rrethuar atë, njeriu mundet që të jetojë në të në mënyrë të rehatshme dhe të sigurtë.

2- Rrugët dhe rrugicat i ka krijuar Zoti në tokë. Ato lidhin me njëra-tjetrën të gjitha zonat e saj. Njeriu mund të kalojë përmes tyre për të arritur te destinacioni.

3- Nga qielli ka zbritur uji. Ai është arsyeja e jetës dhe burimi i të gjitha begative.

4- Bimët dhe shumëllojshmëria e tyre mbijnë nga toka. Nëpërmjet këtij uji një pjesë e tyre formojnë lëndët ushqimore të njeriut, një pjesë tjetër lëndët farmaceutike, pjesën tjetër njeriu e përdor për thurjen e rrobave dhe një pjesë tjetër për mjetet e tjera të jetesës (si për shembull: shtëpitë prej druri, anijet dhe shumë mjete të tjera të transportit).

Mund të themi se këto katër begati të mëdha, sipas radhës së përmendur në ajetin e mësipërm shprehin prioritetet e jetës së njeriut. Ndër nevojat e para për njeriun janë vendstrehimi dhe qetësia. Më pas vijon me rrugët e qarkullimit, më pas me ujin si dhe me produktet bujqësore.

Në fund përmend begatinë e pestë prej këtyre begative Hyjnore dhe shton: **“Hani dhe kullotni bagëtinë tuaj!”**. Me këtë duhet nënkuptuar se prodhimet tuaja shtazore, lëndët ushqimore, veshmbathja dhe mjetet e tjera, gjithashtu janë begati e po kësaj toke dhe të atij uji që zbret nga qielli.

Në fund, duke iu referuar këtyre begative, ajeti thotë: **“Këto, me të vërtetë, janë shenja për ata që janë mendarë.”**.

Duhet të kemi parasysh faktin që fjala “neha” është shumësi i fjalës “nehjun” dhe vjen nga rrënja “nehj”. Kjo fjalë përdoret për të treguar se njeriu që ka dituri di si t’i parandalojë të këqijat.

Ajeti, në fund trajton edhe çështjen e Ringjalljes. Për këtë ajeti thotë: **“Ne ju kemi krijuar prej tokës, aty do t’ju kthejmë dhe nga ajo do t’ju nxjerrim edhe një herë tjetër.”**.

Pra, theksohet edhe një herë se të gjithë jemi krijuar nga toka, të gjithë do të kthehemi në tokë dhe që të gjithë një herë tjetër do të dalim, do të Ringjallemi nga toka.

Rikthimi i të gjithëve në tokë, ose thënë ndryshe, Ringjallja është plotësisht e qartë. Edhe për këtë çështje ekzistojnë dy komente:

Së pari, ne, që të gjithë jemi nga Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Ademi është krijuar nga toka.

Së dyti, edhe ne vetë personalisht, gjithashtu, rrjedhim nga dheu, nga toka, sepse të gjitha lëndët ushqimore që kanë formuar trupin tonë, të baballarëve dhe të nënave tona, që të gjitha burojnë nga toka.

Ky është një paralajmërim për të gjithë despotët, tiranët dhe njerëzit me cilësi si të Faraonit me qëllim që të mos harrojnë se nga kanë ardhur dhe ku do të shkojnë. Atëherë, përse e gjithë kjo arrogancë, mburrje, despotizëm dhe tirani nga një krijesë që deri dje ishte dhe' dhe nesër, gjithashtu, dhe' do të bëhet prapë?

Hulumtime

1- Fjalët "*mehd*" dhe "*mihad*" kuptimisht tregojnë një vend që është i përgatitur për ulje, për fjetje dhe për pushim. Në thelb, fjala "*mehd*" emërton vendin ku e vënë foshnjën e vogël që të flejë gjumë (djep ose ngjashëm me atë).

2- Fjala “ezuaxha” vjen nga fjala “zeuxh”. Mund të jetë përdorë për të treguar varietetet dhe llojet e bimëve, apo edhe mund të përdoret për të treguar përkatësinë gjinore (mashku apo femër) në botën e bimëve. Për këtë çështje, me lejen e Zotit të Madhëruar, do të flasim në ajetet përkatëse.

3- Në një hadith të transmetuar në “Usulul Kafi” nga Profeti i Islamit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), lidhur me fjalën “ulu nuha” lexojmë: “Më të mirët ndër ju janë “ulu nuha” **“ata që janë mendarë”**. Të Dërguarin e pyetën: Kush janë “ulu nuha”? Profeti u përgjigj: “Ata të cilët kanë sjellje të mirë dhe mendje që peshon shumë, që i kanë ruajtur lidhjet farefisnore, që janë treguar të sjellshëm me prindërit e tyre, që janë kujdesur për të varfrit, për fqinjët nevojtarë dhe jetimët, janë ata që ushqejnë të uriturit, që përhapin paqen në botë, ata që falin namazin, kur njerëzit janë në gjumë dhe të pavetëdijshëm.”.¹

Në një hadith tjetër i transmetuar nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: Një person e pyeti Imam Aliun lidhur me kuptimin e dy sexhdeve të secilit rekat të namazit. Imami u përgjigj: Kuptimi i sexhdes së parë është: “O Zoti im! Ti nga ajo (nga Toka) më krijove. Ngritja kokën nga sexhdja tregon se më ke nxjerrë nga kjo tokë. Kurse kuptimi i sexhdes së dytë tregon se do të më rikthesh në këtë tokë, dhe ngritja e kokës nga sexhdja e dytë është me kuptimin që Ti sërish do të më rikthesh nga kjo tokë.”²

¹ “Usulel Kafi”, vëllimi 2, kapitulli “el mumin ue elamatihi ue sifatihi” faqe 240, hadithi 32.

² “Biharul Enuar”, vëllimi 85, faqe 132, (botim i ri).

Ajetet 56 - 64

وَلَقَدْ أَرَيْنَاهُ آيَاتِنَا كُلَّهَا فَكَذَّبَ وَأَبَى ﴿٥٦﴾ قَالَ أَجِئْتَنَا لِتُخْرِجَنَا مِنْ أَرْضِنَا بِسِحْرِكَ يَمُوسَى ﴿٥٧﴾ فَلَنَأْتِيَنَّكَ بِسِحْرٍ مِثْلِهِ ۖ فَاجْعَلْ بَيْنَنَا وَبَيْنَكَ مَوْعِدًا لَا نُخْلِفُهُ نَحْنُ وَلَا أَنْتَ مَكَانًا سُوًى ﴿٥٨﴾ قَالَ مَوْعِدُكُمْ يَوْمَ الزَّيْنَةِ وَأَنْ تُحْشَرَ النَّاسُ ضُحًى ﴿٥٩﴾ فَتَوَلَّى فِرْعَوْنُ فَجَمَعَ كَيْدَهُ ثُمَّ أَتَى ﴿٦٠﴾ قَالَ لَهُمْ مُوسَى وَيْلَكُمْ لَا تَفْتَرُوا عَلَى اللَّهِ كَذِبًا فَيُسْحِتَكُمْ بِعَذَابٍ ۖ وَقَدْ خَابَ مَنْ افْتَرَى ﴿٦١﴾ فَتَنَزَّعُوا أَمْرَهُم بَيْنَهُمْ وَأَسْرُوا النَّجْوَى ﴿٦٢﴾ قَالُوا إِنَّ هَٰذَا لَسِحْرَانِ يُرِيدَانِ أَنْ يُخْرِجَاكُم مِّنْ أَرْضِكُمْ بِسِحْرِهِمَا وَيَذْهَبَا بِطَرِيقَتِكُمُ الْمُثُلَى ﴿٦٣﴾ فَاجْمِعُوا كَيْدَكُمْ ثُمَّ آتُوا صَفًّا ۖ وَقَدْ أَفْلَحَ الْيَوْمَ مَنْ اسْتَعْلَى ﴿٦٤﴾

“Ne ia treguam atij (Faraonit) të gjitha shenjat Tona, por ai i mohoi, nuk pranoi (të besonte).”

“Dhe tha: O Musa, a ke ardhur që të na nxjerrësh nga toka jonë me magjinë tënde?!”

“Ne do të të sjellim ty një magji të ngjashme. Cakto, midis nesh dhe teje, një takim në një vend të sheshtë, ku nuk do të mungojmë as ne, as ti!”

“Ai (Musai) tha: Takimi me ju është në ditën e kremtës dhe njerëzia le të tubohen paradite.”

“Faraoni u largua, i mbledhi magjistarët e vet e pastaj erdhi.”

“Musai u tha atyre: ‘Të mjerët ju! Mos trilloni gënjeshtër për All’llahun, duke bërë që Ai t’ju shkatërrojë me dënim. Do të dështojnë me siguri, ata që trillojnë gënjeshtër!’”

“Ata diskutuan me njëri-tjetrin për punën e tyre, duke pëshpëritur fshehurazi.”

“Njëri prej tyre tha: Në të vërtetë, këta (Musai dhe Haruni), janë dy magjistarë, që duan t’ju shporrin nga toka juaj me magjitë e tyre dhe të shkatërrojnë fenë tuaj tejet të mirë.”

“Prandaj, bashkojini magjitë tuaja dhe ejani me radhë. Do të fitojë sot ai që ka epërsi!”

Komentimi

Faraoni përgatitet për luftën përfundimtare

Në këtë seri ajetesh tregohet një fazë tjetër nga përballja e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) me Faraonin. Kur’ani Fisnik

këtë përballje e fillon me këtë fjali: **“Ne ia treguam atij (Faraonit) të gjitha shenjat Tona, por ai i mohoi, nuk pranoi (të besonte).”**.

Fjala **“shenjat”** nuk përmbledh të gjitha mrekullitë që shfaqti Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) gjatë gjithë jetës së tij dhe gjatë kohës që kaloi në Egjipt. Ajo tregon një mrekulli, të cilën ia ofroi Faraonit në fillim të thirrjes së tij, pra, mrekullinë **“e shkopit”**.

Fjala **“jedun bejdha”** që është përdorë me kuptimin **“dora shndritëse”**, si dhe kumti që përcjell grupi emëror: **“përmbajtja e thirrjes gjithëpërfshirëse qiellore të tij”** ishin në vetvete një argument i gjallë për vërtetësinë e mrekullisë së tij.

Pas kësaj ngjarjeje, do të flitet edhe për çështjen e luftimit të magjistarëve me Hazreti Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe me mrekullitë e reja të tij.

Tani le të shohim se cila ishte përgjigjja e Faraonit tiran, arrogant dhe kokëfortë ndaj mrekullive të Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*). Ashtu siç ndodh zakonisht me të gjithë sundimtarët zullumqar, edhe Faraoni e akuzoi atë duke i thënë: **“O Musa, a ke ardhur që të na nxjerrësh nga toka jonë me magjinë tënde?!”**.

Faraoni vijon të parafranojë: ne e dimë se çështja e profetësisë, thirrja në monoteizëm dhe paraqitja e këtyre mrekullive janë një komplot nga ana juaj për të ardhur në pushtet, për të na përzënë ne dhe Koptët nga tokat e stërgjyshërve tanë. Ju nuk keni synim as thirrjen në monoteizëm e as shpëtimin e Israilitëve. Synimi dhe qëllimi juaj është qeverisja dhe sundimi mbi këtë tokë dhe dëbimi i kundërshtarëve!

Kjo akuzë është e njëjta armë që e kanë shfrytëzuar gjatë historisë të gjithë shtypësit dhe kolonizatorët, sa herë që e shihnin veten në rrezik. Këtë e bënin për t'i stimuluar dhe nxitur njerëzit e tyre duke sajuar diçka të rrezikshme që po e kërcënon vendin. Kjo sajësë nga ana e tyre ishte për të mbrojtur pushtetin dhe ekzistencën e tyre.

Disa nga komentuesit janë të mendimit se parimisht sjellja e Beni Israilëve në Egjipt dhe mbajtja e tyre në këtë tokë, nuk ishte vetëm për t'i shfrytëzuar si robër, por dëshironin që ata të mos të gjenin forcë e mbështetje, sepse kishin frikë që do të shndërroheshin në një vatër të rrezikshme. Urdhri për vrasjen e fëmijëve të tyre meshkuj, nuk ishte vetëm për hir të lindjes së Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), por për të parandaluar fuqizimin dhe forcimin e tyre. Kjo është një vepër të cilën e kryejnë të gjithë pushtetarët mburravecë. Si rrjedhim, nxjerrja e Beni Israilëve, bazuar në kërkesën e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) do të thoshte ardhje në pushtet e këtij populli që do të rezikonte fronin e faraonëve.

Një çështje tjetër është edhe akuza që Faraoni i bëri Hazreti Musasë (*Paqja qoftë mbi të!*) se ishte magjistar. Me të njëjtën akuzë që janë akuzuar të gjithë Pejgamberet, (Profetët) e tjerë sa herë që bënin mrekullitë e tyre të qarta.

Në ajetet 52 dhe 55 të sures "Edh Dharijat" lexojmë: **"Ja, ashtu, pra, edhe atyre që ishin më parë si të Dërguar u thanë: 'Është magjistar ose është i çmendur!' A mos e porositën njëri-tjetrin për këtë? Jo, por ata janë popull renegat. Andaj ti largohu prej tyre, ti nuk je i qortuar. Vazhdo me këshillë, sepse këshilla besimtarëve u bën dobi."**

Gjithashtu, nuk do të lemë pa përmendur edhe faktin se nxitja e ndjenjave të patriotizmit në të tilla raste ka qenë plotësisht e mirëlllogaritur, sepse pjesa dërmuese e njerëzve atdheun dhe vatanin e tyre e duan si shpirtin e tyre. Prandaj në të njëjtin ajet kur'anor këto të dyja janë të renditura njëra pas tjetrës: **“Sikur, t’i kishim obliguar ata: Mbytni vetveten tuaj, apo: dilni prej atdheut tuaj, atë (obligim) nuk do ta zbatonin, me përjashtim të një pakice prej tyre. ...”**.¹

Faraoni më pas thotë: Mos hamendëso që ne nuk jemi të aftë që të sjellim magji të ngjashme me këto magjitë e tua: **“Ne do të të sjellim ty një magji të ngjashme...”**.

Duke treguar vendosmëri më të madhe tha: **“...Cakto, midis nesh dhe teje, një takim në një vend të sheshtë, ku nuk do të mungojmë as ne, as ti!”**.

Në komentimin e togfjalëshit “mekanin su’uan”, disa komentues supozonin se bëhej fjalë për distancë të barabartë mes tij dhe Hazreti Musasë e Harunit. Disa të tjerë kanë supozuar se kuptimi i këtij togfjalëshi tregon se distanca mes të gjithë njerëzve të qytetit të jetë e njëjtë, ose thënë ngryshe, takimi i tyre të bëhej në një vend mu në mes të qytetit.

Disa të tjerë kanë shtuar se kuptimi i togfjalëshit “mekanin su’uan”, synon të tregojë një tokë të sheshtë që të jetë e ekspozuar për të gjithë: edhe për të gjatët dhe për të shkurtërit. Njësoj ta shohin atë. Ka mundësi që të jetë synuar diçka që tregohet edhe diçka nga bashkimi i të dy këtyre kuptimeve.

¹ Sure “En Nisa”, ajeti 66.

Duhet të kemi parasysh edhe faktin se udhëheqësit arrogantë dhe tiranë synojnë që ta nxjerrin kundërshtarin e vet jashtë loje. Ata synojnë që t'u jepnin kurajë edhe të afërmit të vet, të cilët, ndonjëherë mund të ndikoheshin nga mrekullitë e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*)

Por, Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*), duke mos e humbur vetëkontrollin dhe duke mos ia vërë veshin zhurmës së shkaktuar nga Faraoni, qartazi dhe në mënyrë të vendosur tha: Edhe unë jam i gatshëm që tani ta përcaktoj ditën dhe orën e takimit. Takimi me ju është në ditën e kremtes, (ditë feste), me këtë kusht që të gjithë njerëzit të mblidhen në një vend në kohën e mëngjesit. Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: **“Takimi me ju është në ditën e kremtës¹ dhe njerëzia le të tubohen paradite.”**²

Përdorimi i shprehjes “*jeumu zineti*” pa dyshim që aludonte për një ditë feste, por që ne nuk mundemi ta përcaktojmë atë saktësisht. E rëndësishme është se njerëzit në atë ditë të hiqnin dorë nga puna dhe nga fitimi dhe të ishin pushim e të ishin të gatshëm që të merrnin pjesë në një tubim të tillë.

Faraoni, pasi pa mrekullitë mahnitëse të Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe pasi vërejti efektin e këtyre mrekullive tek njerëzit përreth, vendosi që të përballej me atë me anë të magjistarëve të vet. Pas vendimit që mori me Hazreti Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*), Faraoni u largua nga tubimi: **“Faraoni u largua, i mblodhi magjistarët e vet e pastaj erdhi.”**

¹ Sipas transmetimeve, bëhet fjalë për një festë të përvitshme të lumit Nil.

² Fjala “*ed duha*” nga ana leksikore është në kuptimin e shtimit të rrezeve të diellit ose piku i diellit.

Në këtë fjali të shkurtër janë përmbledhur shumë detaje dhe ngjarje të cilat janë përmendur hollësisht në suret “El Araf” dhe “Shuara”. Faraoni sapo u largua nga tubimi dhe u nda nga Hazreti Musai dhe Haruni, mbajti takime të ndryshme me këshilltarët e kualifikuar dhe oborrtarët e tij arrogantë. Më pas thirri nga të gjitha anët e Egjiptit magjistarët e të gjitha krahinave në kryeqytet dhe, nëpërmjet stimulimeve të ndryshme, i ftoi që të merrnin pjesë në këtë betejë vendimtare me Hazreti Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*). Ai shqyrtoi edhe çështje të tjera që këtu nuk është vendi t’i shpjegojmë, por Kur’ani të gjitha këto i ka përmbledhur në këto tre pjesë të kësaj fjalie: Faraoni u largua nga Hazreti Musai, i mblodhi të gjithë magjistarët e vet, e më pas sërish erdhi.¹

Në fund erdhi dita e premtuar. Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) ndodhej përpara një turme të madhe njerëzish. Para një turme në të cilën kishte disa magjistarë. Numri i tyre, sipas konstatimit të disa komentuesve, arrinte në 72 persona, disa të tjerë kanë thënë se numri i tyre arrinte në katërqind veta dhe disa të tjerë kanë deklaruar numër edhe më të madh.

Grupin tjetër të kësaj turme e përbënin Faraoni me ithtarët e vet. Grupi i tretë, që përbënte shumicën e kësaj turme, ishte masa e gjerë e njerëzve spektatorë.

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) u kthye nga Faraoni dhe magjistarëve iu tha: **“Të mjerët ju! Mos trilloni gënjeshtër për**

¹ Edhe pse fjala “*teuel’la*” këtu në këtë ajet është komentuar në kuptimin e ndarjes apo largimit nga Hazreti Musa ose nga ai tubim, por duke pasur parasysh kuptimin leksikor të kësaj fjale gjithashtu ka gjasa që të pasqyrojë edhe gjendjen e kundërshtimit dhe të shqetësimit të faraonit dhe qëndrimit i tij armiqësor kundrejt Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*)

All'Ilahun, duke bërë që Ai t'ju shkatërrojë me dënim. Do të dështojnë me siguri, ata që trillojnë gënjeshtria!"

Synimi i Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte që të demaskonte trillimet e Faraonit dhe mbështetësve të tij rreth Zotit, rreth konsiderimit të dikujt apo të diçkaje si ortak të Zotit, Faraonin ta quanin perëndi dhe Zot të vetin, kurse mrekullitë e dërguara nga ana e Zotit t'i quanin magji.

Pa dyshim, ai që bën trillime të tilla ndaj Zotit dhe që përpiket me të gjithë potencialin të shuajë dritën e së Vërtetës, do të marrë ndëshkimin e merituar nga Zoti i Madhëruar.

Kjo fjali e prerë e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), e cila nuk kishte asnjë lloj ngjashmërie me fjalët e magjistarëve, por që ishte në sintoni të plotë me thirrjen e të gjithë Profetëve të drejtë dhe dilte nga zemra e pastër e Hazreti Musait, ndikoi tek zemrat e shumë njerëzve. Në mesin e turmës u shfaqën trazira dhe kundërshtime.

Disa anonin nga dhuna, disa ishin në mëdyshje dhe hamendësonin që Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) mund të jetë i dërguari i madh i Zotit dhe kërcënimet e tij të jenë efektive dhe funksionale. U kishte bërë përshtypje sidomos veshja dhe paraqitja e jashtme e tij dhe e vëllait të tij Harunit, që ishte veshje e thjeshtë e një bariu, u kishte tërhequr vëmendjen edhe fytyra e tyre e vendosur, pavarësisht faktit se ishin vetëm. U kishte tërhequr vëmendjen se ata nuk shfaqin asnjë shenjë lodhjeje dhe dobësie etj. Të gjitha këto konsiderohen një argument tjetër për vërtetësinë dhe origjinalitetin e thënieve të tyre.

Prandaj Kur'ani thotë: **“Ata diskutuan me njëri-tjetrin për punën e tyre, duke pëshpëritur fshehurazi.”**

Ka gjasa që ky diskutim dhe kjo pëshpëritje fshehurazi të ketë qenë në lidhje me Hazreti Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*). Gjithashtu ekziston edhe mundësia që hamendësimet të kenë qenë në lidhje me Faraonin.

Mundësia tjetër është kjo: regjisorët dhe orkestruesit e kësaj skene në mënyrë të fshehtë nga masa e njerëzve, të kenë ndërmarrë një bisedë dhe pëshpëritje të tillë.

Si përfundim, përkrahësit e vazhdimet të luftës dhe të dhunës fituan, ndërmorën sulm verbal dhe, nëpërmjet mënyrave të ndryshme, filluan nxitjen e atyre që kundërshtonin Hazreti Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në fillim, njëri prej tyre tha: **“Në të vërtetë, këta (Musai dhe Haruni), janë dy magjistarë...”**.

Si rrjedhojë, nuk duhet frikësuar nga luftimi me ta, sepse ju jeni paria dhe mjeshtrit e magjisë në këtë shtet të madh dhe fuqia dhe aftësia e juaj është më e madhe se e atyre!

Së dyti, ata dëshirojnë që t'u dëbojnë nga atdheu juaj së bashku me magjitë tuaja, nga atdheu juaj që është i dashur për ju sa shpirti dhe sa jeta juaj. Ju i takoni atij, ashtu siç ai ju takon juve. **“... që duan t'ju shporrin nga toka juaj me magjitë e tyre...”**

Ata, nuk mjaftohen vetëm më dëbimin tuaj nga atdheu i juaj i dashur, por duan që të shkatërrojnë dhe të nëpërkëmbnin edhe fenë tuaj: **“... dhe të shkatërrojnë fenë tuaj tejet të mirë.”**¹

Atëherë, në asnjë mënyrë mos ia lejoni vetes frikën, mbliidhni të gjitha aftësitë, forcat, planet dhe fuqitë tuaja dhe vini ato në punë: **“Prandaj, bashkojini magjitë tuaja...”**.

Më pas, të gjithë së bashku, të mobilizuar, paraqituni në sheshin e luftës në një rresht: **“...dhe ejani me radhë...”**. Mobilizimi dhe uniteti është përcaktues për fatin dhe fitoren tuaj në këtë luftë.

Si përfundim, fitorja dhe triumfi i sotshëm është në anën e atij njeriu që mund të dëshmojë epërsinë ndaj armikut të vet. **“... Do të fitojë sot ai që ka epërsi!”**.

¹ Fjala “*tarikaton*” në kuptimin e traditës dhe metodës. Këtu kjo fjalë është në synimin e “medh’hebit”. Kurse fjala “*muthla*” rrjedh nga rrënja “*mithl*” dhe këtu është në kuptimin e lartësimit dhe më të mirës.

Ajetet 65 - 69

قَالُوا يَمُوسَىٰ إِمَّا أَنْ تُلْقَىٰ وَإِمَّا أَنْ نَكُونَ أَوَّلَ مَنْ أَلْقَىٰ ﴿٦٥﴾ قَالَ بَلْ أَلْقُوا ۖ فَإِذَا حِبَالُهُمْ وَعِصِيُّهُمْ يُخَيَّلُ إِلَيْهِ مِنْ سِحْرِهِمْ أَنَّهَا تَسْعَىٰ ﴿٦٦﴾ فَأَوْجَسَ فِي نَفْسِهِ خِيفَةً مُوسَىٰ ﴿٦٧﴾ قُلْنَا لَا تَخَفْ إِنَّكَ أَنْتَ الْأَعْلَىٰ ۚ وَأَلْقِ مَا فِي يَمِينِكَ تَلْقَفْ مَا صَنَعُوا ۖ إِنَّمَا صَنَعُوا كَيْدٌ سَحِرٌ ۖ وَلَا يُفْلِحُ السَّاحِرُ حَيْثُ أَتَىٰ ﴿٦٨﴾

“Ata thanë: ‘O Musa, ose hidh ti, ose të hedhim ne të parët.’”

“Ai tha: ‘Jo, hidhni ju!’ Dhe ja tek i dukeshin atij litarët dhe shkopinjtë e tyre se po rendnin vërtet, për shkak të magjisë së tyre.”

“Atëherë Musai ndjeu frikë në vetvete.”

“Ne i thamë: ‘Mos u frikëso, se, në të vërtetë, ti do të fitosh!’”

“Hidhe atë që mban në dorën e djathtë: do të gëlltisë gjithçka që kanë bërë ata, sepse ajo që kanë bërë ata, është vetëm një mashtrim i magjistarëve; e, magjistari nuk do të ketë sukses kudo që të gjendet.”

Komentimi

Edhe Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) del në shesh

Magjistarët, në dukje të bashkuar, kishin vendosur që të sfidonin Hazreti Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*). Në kohën që dolën në shesh thanë: **“O Musa, ose hidh ti, ose të hedhim ne të parët”**.

Disa nga komentuesit e Kur'anit kanë deklaruar: Ky propozim i magjistarëve rreth zgjedhjes së Hazreti Musait se kush të fillojë dyluftimin, ai apo ata, ishte një lloj shenje respekti nga ana e tyre në raport me Hazreti Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*). Mbase kjo sjellje e tyre u bë shkak për përgatitjen e rrethanave që ata pas kësaj ngjarjeje të bëheshin besimtarë.

Por kjo çështje duket e papranueshme, sepse ata me gjithë fuqinë dhe forcën e tyre përpiqeshin që Hazreti Musai dhe mrekullia e tij të pësonin humbje. Prandaj, shprehja e lartpërmendur mbase mund të ketë qëllimin e shfaqjes së vetëbesimit të tyre para masës së gjerë të njerëzve.

Por, Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*), pa u nxituar, sepse ishte plotësisht i sigurtë në fitoren e vet kategorike, madje duke ditur se në të tilla përballje, zakonisht fituesi është ai i cili nuk paraprin, u tha atyre: **“Jo, hidhni ju!”**.

Pa dyshim, kjo ftesë e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) drejtuar atyre, në realitet ishte një premisë për shfaqjen e së Vërtetës dhe, nga pikëpamja e Hazreti Musait, jo vetëm që nuk ishte një vepër e keqe dhe e shëmtuar, por, përkundrazi, konsiderohej premisë e obligueshme.

Magjistarët e pranuan kërkesën e tij. Ata kishin sjellë me vete për të bërë magji shkopinj dhe litar të cilët i hodhën në mes të sheshit. Për këtë, në një hadith thuhet: *“Ata ishin me mijëra veta”*. Kjo nënkuptonte që për një çast hodhën në mes të sheshit me mijëra shkopinj dhe litar. Në brendësi të tyre kishin hedhur lëndë të veçantë kimike. Ky veprim i tyre shkaktoi frikë dhe emocione.

Për shkak të magjisë së tyre, litarët dhe shkopinjt e tyre dukeshin sikur me të vërtetë janë duke lëvizur. **“...ja tek i dukeshin atij litarët dhe shkopinjtë e tyre se po rendnin vërtet, për shkak të magjisë së tyre.”**

Ato u shndërruan në formën e gjarpërinjve të vegjël dhe të mëdhenj, ngjyra-ngjyra dhe në forma të ndryshme, sikur të ishin të gjallë.

Ajete të tjera kur'anore në lidhje me këtë pohojnë se ai, Musai tha: **“‘Hidhni ju!’ e kur hodhën ata (shkopinj e litarë), magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe sollën një magji të madhe.”**¹

Kurse në ajetin 44 të sures “Shuara” lexojmë: **“Ata hodhën litarët dhe shkopinjtë e tyre dhe thanë: ‘Për madhërinë e Faraonit, me të vërtetë, Ne do të jemi fitues patjetër.’”**

Shumë nga komentuesit e Kur'anit kanë deklaruar: Ata kishin hedhur në brendësi të tyre element kimikë, si: zhivë (mërkur), e cila, nën rrezatimin e diellit dhe të ngrohjes së kësaj lënde jashtëzakonisht të paqëndrueshme, shkaktonte lëvizje të ndryshme dhe të shpejta.

¹ Sure “El A’raf” ajeti 116.

Sigurisht, këto lëvizje nuk ishin ecje, por me sugjectionimet që kishin bërë magjistarët ndaj njerëzve dhe skena e veçantë që ishte krijuar atje, bënte që tek sytë e njerëzve të imagjinohej sikur këto krijesa kanë përfutur shpirt dhe janë në lëvizje! Përdorimi i shprehjes “magjepsën sytë e njerëzve”, gjithashtu, aludon po për këtë çështje. Edhe shprehja “juhej’jelu ilehji”, (atij iu duk se nga ajo magji e tyre litarët dhe shkopinjtë lëvizin) do të thotë që tek mendja e Hazreti Musait kështu u reflektua gjithashtu, ka gjasa që të jetë po me këtë kuptim.

Sidoqoftë, u krijua një skenë shumë e çuditshme dhe mahnitëse. Magjistarët, të cilët ishin të shumtë në numër, ishin të mirëinformuar dhe të shkathët në këtë teknikë dhe në mënyrën e përdorimit të efekteve misterioze fizike dhe kimike të trupave, prandaj arritën të ndikojnë në atë mënyrë tek mendimet e të pranishmëve dhe bënë që ata ta besonin këtë fakt, të besonin se të gjitha këto krijesa jofrymore janë shndërruar në frymore.

Nga një grup i njerëzve të Faraonit u dëgjuan britma gëzimi, nga një grup tjetër u dëgjuan ulërime frike dhe ankthi dhe u tërhoqën prapa.

“Atëherë Musai ndjeu frikë në vetvete.”

Fjala “*euxhese*” rrjedh nga rrënja “*ixhas*”, madje, në thelb rrjedh nga rrënja “*uexhs*” dhe është përdorë në kuptimin e një zëri misterioz dhe të fshehur. Kurse fjala “*ixhas*” është përdorë në kuptimin e një ndjenje të brendshme dhe të fshehur. Kjo shprehje tregon se frika që ndjeu Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) në vetvete ishte një frikë sipërfaqësore dhe e lehtë, madje kjo nuk ishte për shkak të asaj që i kushtonte ndonjë rëndësi skenës tronditëse, e cila ishte krijuar nën ndikimin e magjisë së

magjistarëve, por frikësohej se mos vallë, nga kjo njerëzit do të mashtroheshin dhe do të ndikoheshin nga ky veprim i tyre (magjistarëve) në mënyrë që “rikthimi” i tyre nga rruga e gabuar të vështirësohej.

Ose, mos vallë, Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) frikësohej se mos ndodhte që, para se ai të shfaqte mrekullinë e vet, një pjesë e tyre ta linin skenën ose t'i përzinin dhe të mos shfaqej e vërteta.

Në fjalimin e 4-ët në Nehxhul Belaga lexojmë: “...Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ka pasur frikë për vete, por është frikuar të mos e mposhtin të paditurit dhe udhëheqësit e humbjes”.¹

Duke pasur parasysh çfarë u tha gjer këtu, e shohim të panevojshme të japim ndonjë përgjigje tjetër në lidhje me frikën e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*).

Sidoqoftë, në këtë kohë Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) i erdhi lajmi i fitores dhe i ndihmës së Zotit të Madhëruar. Kështu që urdhri i shpalljes ia përcaktoi përgjegjësinë atij. Për këtë Kur'ani thotë: **“Ne i thamë: ‘Mos u frikëso, se, në të vërtetë, ti do të fitosh!’”**.

Kjo fjali e inkurajon Hazreti Musain në korrijen e fitores.

Pjesëza “in’ne” dhe përsëritja e përemrit janë theksim për këtë domethënie. Edhe fjalia emërore tregon se Hazreti Musait

¹ Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) këtë shprehje e kanë thënë në kohën kur ndihej i brengosur nga devijimi i njerëzve dhe aludon në këtë të vërtetë që shqetësimi dhe brengosja ime nuk është për shkak të asaj që kam frikë apo dyshim në vetveten time, unë që nga ajo atë ditë që kam njohë të Vërtetën nuk kam dyshuar aspak tek ajo, por brengosem për hir të devijimit të njerëzve!.

(*Paqja qoftë mbi të!*) iu kthye sërish fuqia e zemrës e cila ishte e tronditur për pak çaste.

Sërish, nga ana e Zotit të Madhëruar, Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) iu komunikua: **“Hidhe atë që mban në dorën e djathtë, do të gëlltisë gjithçka që kanë bërë ata, sepse ajo që kanë bërë ata, është vetëm një mashtrim i magjistarëve; e, magjistari nuk do të ketë sukses kudo që të gjendet.”**

Fjala “*telkef*” rrjedh nga rrënja “*lekf*” dhe përdoret me kuptimin e gëlltitjes, por ashtu siç është shprehur Ragibi në “El Mufredat”, kjo fjalë, në thelb është përdorë në kuptimin e marrjes së një gjëje me aftësi, qoftë nëpërmjet gjuhës qoftë nëpërmjet dorës. Kurse disa nga dijetarët leksikorë atë e kanë konsideruar në kuptimin e “marrjes me nxitim”.

Interesant është fakti që në atë që iu komunikua Hazreti Musait nuk thuhet: “hidhe shkopin”, por thuhet “hidhe atë që ke në dorë të djathtë”. Kjo shprehje mund të jetë shpërfillje ndaj shkopit dhe aludim që shkopi nuk është një mjet i rëndësishëm. E rëndësishme është Vullneti dhe Urdhri i Zotit të Lartësuar që, nëse Ai dëshiron, jo vetëm shkopi, madje edhe diçka më të vogël se ai, mundet që të prodhojë një fuqi të tillë!

Gjithashtu, është e nevojshme që të përmendim edhe faktin se fjala “magjistar” në ajetin e lartpërmendur në rastin e parë është përdorur në trajtë të pashquar dhe më pas në trajtë të shquar. Është përmendur me “*elif lam-in*” e llojit.

Ky dallim mund të jetë për arsye se në rastin e parë synohet të tregohet se ndaj magjistarëve është treguar mospërfillje dhe pakujdesi. Kuptimi i fjalisë në këtë rast do të theksonte se ata nuk

kanë gjë tjetër, veçse një mashtrim e iluzion. Kuptimi i rastit të dytë kërkon të qartësojë faktin se jo vetëm këta magjistarë, por çdo magjistar, në çdo kohë dhe në çdo vend qoftë, kurrë nuk do të ngadhënjejë dhe nuk do të fitojë.

Hulumtime

1- Cila është e vërteta e “magjisë”?

Edhe pse në të kaluarën kemi diskutuar gjerësisht në lidhje me këtë temë, e shohim të arsyeshme që të bëjmë sërish një shpjegim të shkurtër në lidhje me këtë:

Në thelb, magjia është çdo lloj pune dhe çdo lloj gjëje, baza e së cilës është diçka sekrete dhe e fshehur. Në gjuhën e përditshme magji konsiderohen veprat e jashtëzakonshme të cilat kryhen me përdorimin e mjeteve të ndryshme.

Ndonjëherë ka vetëm aspektin e mashtrimit, të iluzionit, të gënjeshtërsisë dhe të marifetit.

Ndonjëherë në të’ përdoren faktorë sugestionues.

Ndonjëherë vihen në përdorim cilësitë dhe efektet e panjohura fizike dhe kimike të disa elementeve dhe lëndëve.

Ndonjëherë nëpërmjet asistimit të djajve.

Të gjitha këto mblidhen në konceptin gjithëpërfshirës leksikor që listuam.

Gjatë historisë hasim ndodhi dhe ngjarje të shumta në lidhje me magjinë dhe magjistarët. Edhe në kohën e sotme nuk janë të pakët ata të cilët merren me magji dhe kryejnë punë të këtij lloji. Shumë prej efekteve të këtyre lëndëve kimike të ndryshme në të kaluarën ishin të pazbuluara dhe të fshehura për masën e gjerë të njerëzve. Në kohën tonë janë zbuluar dhe janë bërë të qarta të gjitha cilësitë dhe efektet e këtyre lëndëve kimike, madje janë përpiluar edhe libra që tregojnë hollësisht ndikimet mahnitëse të këtyre lëndëve të ndryshme.

Për shembull, në kiminë e kohës së sotme njohim shumë trupa, pesha e të cilëve është më e lehtë se ajri. Nëse këto trupa vihen brenda një trupi tjetër mund të ndodhë që trupi i dytë të vihet në lëvizje. Nga ky veprim askush nuk mbetet i mahnitur, madje sot, në ditët tona, shumë prej lodrave të fëmijëve janë ndërtuar mbi këto efekte, në të kaluarën mund të imagjinoheshin dhe konsideroheshin si një lloj magjie.

Sot, nëpër cirqe bëhen shfaqje që ngjasojnë me magjinë e magjistarëve të kohëve të kaluara.

Me përdorimet e ndriçimit të dritës, të pasqyrave, vetitë fizike dhe kimike të trupave krijojnë skena të çuditshme që ndonjëherë i lënë gojëhapur shikuesit.

Sidoqoftë, magjitë kanë egzistuar dhe egzistojnë. Nuk mund të mohohet ekzistenca e tyre ose ato t'u atribuohen besëtytnive, qoftë në të kaluarën, qoftë në kohën e sotme.

I rëndësishëm është fakti që **në islam magjia është e ndaluar** dhe është prej mëkateve të mëdha, sepse në shumë raste bëhet shkak i devijimit të njerëzve, bëhet shkak i shtrembërimit të së Vërtetës dhe tronditjes së themeleve ideologjike të njerëzve mendjelehtë. Sigurisht, ky urdhër Islam ashtu si shumë prej urdhërave të tjerë, ka dhe raste përjashtimi, si për shembull kryerja e magjisë për të prishur pretendimet e pretenduesve përgënjeshtres të profetësisë ose për të eliminuar efektin e tyre në lidhje me ata njerëz të cilët janë dëmtuar nga ajo.

Më gjerësisht në lidhje me këtë fushë kemi diskutuar në ajetet 102-103 të sures “El Bekare”.

2- Magjistari asnjëherë nuk fiton?

Shumë njerëz pyesin nëse magjistarët mundën që të kryejnë veprime të jashtëzakonshme që të ngjasojnë me mrekullinë. Si është e mundur dallimi në mes magjisë dhe mrekullisë? Dhe si është e mundur që magjia të mos shoqërohet me mrekullinë?!

Përgjigjja e kësaj pyetjeje bëhet e qartë duke pasur parasysh se puna e magjistarit mbështetet në një forcë të kufizuar njerëzore, kurse mrekullia buron nga fuqia e pafund dhe pa shtershme e All'Ilahut.

Prandaj çdo magjistar edhe mundet që të kryejë gjëra të limituara, por, nëse kërkon përtej tyre, nuk do ishte i paaftë për to. Magjistari është në gjendje që të kryejë vetëm punë të tilla për të cilat ka bërë prova dhe është ushtruar për ato, si dhe ka përfituar aftësi të caktuara prej tyre, është në dijeni për gjërat që

mund t'i pengojnë ata, por në gjëra të tjera është plotësisht i paaftë dhe i pafuqishëm.

Ndërkohë që të Dërguarit, meqenëse ndihmoheshin nga fuqia e pashtershme e All'Ilahut, ishin të aftë për çdo lloj veprë mbinatyrore në tokë dhe në qiell, pavarësisht llojit dhe drejtimit.

Magjistari asnjëherë nuk mundet që të kryejë një gjë të mbinatyrshme, sipas propozimit të njerëzve, përveçse ato që përputhen rastësisht me punën e tij. (Ndonjëherë ndodh që miqtë ta mësojnë mikun e tyre të panjohur që të ngrihet nga mesi i njerëzve dhe gjoja të propozojë diçka të përcaktuar paraprakisht dhe këtë ta "shesin" si magji.)

Kurse të Dërguarit mjaft herë kanë kryer mrekulli të rëndësishme që njerëzit kërkuar të së Vërtetës, i kërkonin si dëshmi për profetësi. Këtë do ta vërejmë edhe në të ardhmen, në historinë e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*).

Përveç kësaj, magjia duke qenë se është një vepër e devijuar dhe një lloj mashtrimi dhe hileje, natyrisht që kërkon shpirta që përngjasojnë dhe përputhen me atë. Prandaj magjistarët, pa përjashtim, janë njerëz mashtrues dhe hileqarë, që me anë të studimit dhe hulumtimit rreth tyre mund t'i njohim shumë shpejt shpirtrat dhe veprat e tyre të liga, ndërkohë që sinqeriteti, pastërtia dhe e vërteta e të Dërguarve është një fakt i mbështetur me mrekullitë që i kryejnë dhe ua shton dhe dyfishon efektin e tyre.

Mbase është kjo arsyeja që ajetet e lartpërmendura pohojnë: **"... e, magjistari nuk do të ketë sukses kudo që të gjendet ..."**.

Kjo çështje nuk i përket vetëm magjistarëve, të cilët janë ngritur përkundër të Dërguarve, por vlen për të gjithë magjistarët në përgjithësi, veprimtaria e të cilëve duhet të njihet sa më shpejt që ata të mos kenë sukses.

Ajetet 70 - 76

فَأُلْقِيَ السَّحَرَةُ سُجَّدًا قَالُوا ءَامَنَّا بِرَبِّ هَارُونَ وَمُوسَى ﴿٧٠﴾ قَالَ ءَامَنْتُمْ
لَهُ قَبْلَ أَنْ ءَاذَنَ لَكُمْ إِنَّهُ لَكَبِيرُكُمُ الَّذِي عَلَّمَكُمُ السِّحْرَ فَلَأُقَطِّعَنَّ
أَيْدِيَكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ مِّنْ خَلْفٍ وَلَأُصَلِّبَنَّكُمْ فِي جُذُوعِ النَّخْلِ وَلَتَعْلَمَنَّ أَيْنَا
أَشَدُّ عَذَابًا وَأَبْقَى ﴿٧١﴾ قَالُوا لَنْ نُؤْثِرَكَ عَلَىٰ مَا جَاءَنَا مِنَ الْبَيِّنَاتِ
وَالَّذِي فَطَرْنَا فَاقْضِ مَا أَنْتَ قَاضٍ إِنَّمَا تَقْضِي هَذِهِ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا ﴿٧٢﴾
إِنَّا ءَامَنَّا بِرَبِّنَا لِيَغْفِرَ لَنَا خَطِيئَتَنَا وَمَا أَكْرَهْتَنَا عَلَيْهِ مِنَ السِّحْرِ وَاللَّهُ خَبِيرٌ
وَأَبْقَى ﴿٧٣﴾ إِنَّهُ مَن يَأْتِ رَبَّهُ مُجْرِمًا فَإِنَّ لَهُ جَهَنَّمَ لَا يَمُوتُ فِيهَا وَلَا
يَحْيَىٰ ﴿٧٤﴾ وَمَنْ يَأْتِهِ مُؤْمِنًا قَدْ عَمِلَ الصَّالِحَاتِ فَأُولَٰئِكَ لَهُمُ الدَّرَجَاتُ
الْعُلَىٰ ﴿٧٥﴾ جَنَّاتٌ عِدْنُ تَجْرَىٰ مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا ۚ وَذَٰلِكَ
جَزَاءُ مَن تَزَكَّىٰ ﴿٧٦﴾

“Atëherë magjistarët ranë në sexhde dhe thanë: ‘Ne besojmë në Zotin e Harunit dhe Musait.’”

“(Faraoni) tha: ‘Çfarë?! Ju e besuat atë, para se t’ju jap leje unë?! Në të vërtetë, ai është mjeshtri juaj, që ju ka mësuar magjitë. Unë do t’jua këpus duart dhe këmbët tuaja të këmbëra dhe do t’ju var në trungjet e hurmave. Ju do ta merrni vesh, me siguri, se cili prej nesh është më i ashpër dhe më ngulmues në ndëshkim.’”

“(Magjistarët) u përgjigjën: ‘Ne kurrë nuk do të të japim ty përparësi ndaj provave që na kanë ardhur neve dhe ndaj Atij që na ka krijuar ne. Prandaj, gjyko si të duash; ti gjykon vetëm në jetën e kësaj bote!’”

“Ne besojmë në Zotin tonë, që të na i falë gabimet dhe magjitë, për të cilat na ke detyruar ti. All’llahu është më i Miri dhe i Përjetshmi.’”

“Atë që i paraqitet Zotit të vet si keqbërës, sigurisht që e pret Xhehennemi, ku as nuk do të vdesë e as nuk do të jetojë.”

“Ndërsa kush paraqitet tek Ai si besimtar e që ka bërë vepra të mira, do të ngrihet në shkallë të larta.”

“Në kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ata do të qëndrojnë aty përjetësisht. Ky është shpërblimi për atë që është i dëlirë (nga mosbesimi).”

“Ne i thamë Musait: ‘Udhëto natën me robërit e Mi, hapu atyre një rrugë të tharë nëpër det dhe mos u frikëso se do të të kapë ndokush e as se do të mbyteni!’”

Komentimi

Fitorja madhështore e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*)

Në ajetet e kaluara arritëm deri atje kur Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) u urdhërua që të hidhte shkopin e vet që t'i asgjësonte pajisjet e magjisë së magjistarëve.

Në ajetet që po diskutojmë është ndjekur po kjo çështje, por duke hequr fjalitë të cilat janë të qarta (Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) e hodhi shkopin, shkopi u shndërrua në një gjarpër të madh dhe i gëlltiti të gjitha mjetet dhe pajisjet e magjisë së magjistarëve, në mesin e turmës prej njerëzve u dëgjua një britmë dhe jehonë, Faraoni u frikësua shumë, kurse njerëzit përreth mbetën gojëhapur. Magjistarët, që deri në atë kohë nuk ishin përballur me një skenë të tillë dhe ngaqë e dallonin më së miri magjinë nga jomagjia, besuan që kjo vepër, nuk është gjë tjetër, përveçse një mrekulli Hyjnore dhe ky njeri, Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*)) është i Dërguar i Zotit, i cili i fton ata në rrugën e Drejtë dhe drejt Zotit, stuhia i kaploi zemrat e tyre dhe në shpirtrat e tyre u bë një revolucion i madh...etj, të gjitha këto fjali janë hequr.).

Tani, vazhdimin e ngjarjes do ta dëgjojmë nga vetë ajetet:

“Atëherë magjistarët ranë në sexhde dhe thanë: ‘Ne besojmë në Zotin e Harunit dhe Musait.’”

Fjala “*ulkije*” përdoret për të treguar se ata u ndikuan kaq shumë dhe u magjepsën pas mrekullisë së Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), saqë ranë menjëherë në sexhde.

Gjithashtu, është e nevojshme që të përmendet se ata nuk u mjaftuan vetëm me pranimin e besimit, por e panë si të arsyeshme dhe si përgjegjësi ndaj vetes që besimin e tyre ndaj Musait dhe Harunit (*Paqja qoftë mbi ta!*), ta shfaqin qartazi me anë të fjalive të shkurtra, në të cilat të mos vërehej asnjë lloj dyshimi. Prandaj përdorën fjalitë e shkurtëra dhe theksimin e fortë me qëllim që ata që kishin devijuar nën efektin e veprimeve të tyre, të riktheheshin dhe mbi supet e tyre të mos mbetej ndonjë faj dhe përgjegjësi.

Ky reagim i magjistarëve i dha një goditje të fortë Faraonit, qeverisë despote, shtypëse dhe të padrejtë të tij si dhe i tronditi të gjitha shtyllat e tyre. Mbi këtë çështje ishte bërë një propogandë e gjatë anembanë Egjiptit. Magjistarë nga të gjitha anët dhe krahinat ishin mbledhur aty dhe, në rast fitoreje, si shpërblim do të merrnin gjëra tejet të vyera dhe të shtrenjta.

Por tani vërejnë që po ata të cilët ishin renditur në rreshtin e parë të luftimit, iu dorëzuan menjëherë armikut. Jo vetëm u dorëzuan, por u kthyen në mbrojtës të flaktë të tij. Kjo ishte një çështje krejtësisht e paparashikueshme për Faraonin, sepse një grup nga njerëzit që kishin pasuar magjistarët, ndien simpati për Hazreti Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe fenë e tij. Faraoni pa që nuk kishte asnjë alternativë tjetër, përveç britmës, ulërimës, kërcënimeve të ashpra dhe të rënda. Që të ruante disi grimcat e fundit të dinjitetit, që realisht nuk e kishte më, u kthye nga magjistarët dhe u tha: **“Çfarë?! Ju e besuat atë, para se t’ju jap leje unë?!”**.

Ky tiran arrogant, jo vetëm që pretendonte se qeveriste mbi trupin dhe shpirtin e njerëzve, por dëshironte që të thoshte se edhe zemra juaj është në dorën time dhe më përket mua. Ju duhet

që të merrni vendime me lejen time. Kjo është po ajo gjë dhe e njëjta vepër që në çdo kohë dhe në çdo epokë të gjithë faraonat e kanë metodologji.

Ashtu si Faraoni i Egjiptit, edhe disa të tjerë shfaqin haptazi në mënyrë diletante dhe naive, shpesh duke u ndier në siklet, apo edhe në mënyrë tinëzare, se duke përdorur mjetet e komunikimit, të propagandës dhe llojet e censurave, praktikisht ia japin këtë të drejtë vetes dhe janë të mendimit se nuk u duhet dhënë e drejta njerëzve që të mendojnë në mënyrë të pavarur, në emër të mendimit të lirë. Duhet imponuar mbi njerëzit ky privim i lirisë.

Faraoni nuk u mjaftua me kaq. Ai menjëherë filloi të trillojë për të fajësuar magjistarët dhe arriti t'i akuzojë ata: **"...Në të vërtetë, ai është mjeshtri juaj, që ju ka mësuar magjitë ..."**.

Pa dyshim që Faraoni ishte në dijeni dhe besonte se kjo që po thoshte ishte gënjeshtër. Prandaj, nuk kishte se si një komplot i tillë të përhapej anembanë Egjiptit dhe spiunët e tij të mbeteshin të painformuar.

E dimë se Faraoni e kishte rritur dhe edukuar në krahët e vet Hazreti Musain (*Paqja qoftë mbi të!*), ndaj dhe mungesa e tij në Egjipt tregonte se, nëse ai do të ishte mjeshtri i madh i magjistarëve të Egjiptit, do të njihej kudo me këtë epitet dhe nuk ishte e mundur që të fshihej.

Por shtypësit dhe maskarenjtë, kur e shohin veten në rrezik, nuk ngurrojnë para asnjë lloj gënjeshtre apo shpifjeje.

Madje, Faraoni nuk u mjaftua as me kaq. Ai i kërcënoi aq shumë magjistarët me tonin tejet të ashpër, duke iu thënë: **"...Unë**

do t'jua këpus duart dhe këmbët tuaja të këmbyera dhe do t'ju var në trungjet e hurmave. Ju do ta merrni vesh, me siguri, se cili prej nesh është më i ashpër dhe më ngulmues në ndëshkim."

Në të vërtetë, fjalia **"... se cili prej nesh është më i ashpër dhe më ngulmues ..."**, tregon për një kërcënim që Hazreti Musai (Paqja qoftë mbi të!) ia kishte bërë Faraonit edhe më herët. Gjithashtu kërcënimin e tij Hazreti Musai ua kishte drejtuar edhe magjistarëve para kësaj ngjarjeje duke u thënë: **"Musai u tha atyre: 'Të mjerët ju! Mos trilloni gënjeshtër për All'llahun, duke bërë që Ai t'ju shkatërrojë me dënim.'"**

Përdorimi i shprehjes *"min khilaf"* synon të përcjellë mesazhin se që do t'jua këpuste dorën e djathtë me këmbën e majtë. Mundet që përzgjedhja e këtij dënimi dhe e kësaj torture për magjistarët të jetë bërë për arsye se pas këtyre gjymtimeve këtë gjendje njeriu vdes me vonesë, që do të thotë se do të ketë gjakderdhje të ngadalshme dhe do të përjetohen më shumë tortura. Përveç kësaj dëshiron që të thotë edhe se do t'ua dëmtoj dhe gjymtyrët në të dy anët e trupit tuaj.

Kërcënimi që u bëhej magjistarëve se do i varte në trungjet e hurmave mund të jetë bërë për arsye se këto pemë ishin nga pemët më të larta dhe çdokush që do të kalonte andej, qoftë edhe nga larg, që t'i shihte njerëzit që ishin të varur në ato pemë.

Gjithashtu, është i rëndësishëm të përmendet fakti, se kryqëzimi në atë kohë ishte ndryshe nga kryqëzimi në kohët e sotme. Ata nuk ia vinin litarin në qafë personit që do ta kryqëzonin, por i lidhnin duart, krahët ose shpatullat derisa të vdiste duke vuajtur.

Tani le të shohim se cili ishte reagimi i magjistarëve karshi këtyre kërcënimeve të ashpra të Faraonit.

Magjistarët, jo vetëm që nuk u trembën, nuk lëvizën dhe nuk dolën jashtë, por e vërtetuan edhe më me vendosmëri praninë e tyre në atë skenë dhe thanë: **“Ne kurrë nuk do të të japim ty përparësi ndaj provave që na kanë ardhur neve dhe ndaj Atij që na ka krijuar ne. Prandaj, gjyko si të duash, ti gjykon vetëm në jetën e kësaj bote!”**.

Përgjigjen e tyre dhënë Faraonit, magjistarët e shprehën me tri fjali shumë të goditura dhe tepër të qëlluara:

Së pari, është sigurtë se ne atë udhëzim që e kemi gjetur nuk do ta ndërrojmë me asnjë gjë.

Së dyti, asnjëherë nuk do të frikësohemi nga kërcënimet e tua!

Së treti, përpjekjet e tua dhe qeverisja jote janë vetëm disa ditë të kësaj bote.

Më pas shtuan: **“Ne besojmë në Zotin tonë, që të na i falë gabimet ... dhe magjitë, për të cilat na ke detyruar ti. All’lillahu është më i Miri dhe i Përjetshmi.”**.

Thënë shkurt, qëllimi ynë është spastrimi nga mëkatet tona të kaluara, si për shembull luftimi me të Dërguarin e drejtë të Zotit të Lartësuar. Ne dëshirojmë që me anë të këtij pastrimi të fitojmë lumturinë e përhershme, kurse ti na kërcënon me vdekje në këtë botë. Ne pranojmë këtë dëm të vogël dhe të pavlerë karshi asaj dobie madhështore!

Këtu lind pyetja se si është e mundur, që në ajetin e lartpërmendur është përdorur shprehja “*ikrah*” (na ke detyruar), ndërkohë që magjistarët thanë se ata erdhën vetë, me dëshirën e tyre dhe u mblodhën në këtë shesh, edhe pse Faraoni atyre u kishte bërë premtime të shumta?

Si përgjigje mund të themi se nuk kemi asnjë argument në dorë që magjistarët nuk kanë qenë të detyruar që në fillim. Nuk mund të themi se nuk qenë të detyruar që të pranonin këtë ftesë nga ana e Faraonit, madje në paraqitje të parë fjalia “je’tuke bi kul’li sahir alim” (të sjellësh çdo magjistar të dijshtëm)¹ kumton që magjistarët e vetëdijshtëm e kishin të obliguar që të pranonin kërkesën e Faraonit. Sigurisht, kjo është plotësisht e kuptueshme në kushtet e një qeverisje autokratike dhe tiranike si ajo e Faraonit, ku njerëzit detyrohen të veprojnë konform qëllimeve të tij, kurse caktimi i shpërblimeve dhe dhuratave dhe gjërave të tjera të ngjashme me to për stimulimin e tyre nuk ka asnjë kundërshti me këtë domethënie, sepse kemi parë shpesh që qeveritë diktatoriale dhe shtypëse, krahas përdorimit të forcës dhe dhunës, shfrytëzojnë edhe stimulimet materiale.

Po ashtu, është supozuar se në përballjen e parë të magjistarëve me Hazreti Musain (*Paqja qoftë mbi të!*) ata spikatën disa dëshmi dhe prova që Hazreti Musai është me të vërtetën, ose, së paku, filluan të dyshojnë dhe të hamendësojnë se ishte në udhën e të Vërtetës, prandaj midis tyre u krijua një atmosferë diskutimi dhe bisede, ashtu siç e lexuam edhe në ajetin 62 në po këtë sure: “**Ata diskutuan me njëri-tjetrin për punën e tyre ...**”.

¹ Sure “El A’raf”, ajeti 112.

Faraoni dhe agjentët e tij u vunë në dijeni për këtë ngjarje dhe i detyruan që të vazhdojnë me dyluftimin.

Magjistarët, më pas vazhduan bisedën e tyre në këtë mënyrë: nëse ne kemi besuar, kjo ka ndodhur për arsye se na është dukur e drejtë, sepse: **“Atë që i paraqitet Zotit të vet si keqbërës, sigurisht që e pret Xhehennemi, ku as nuk do të vdesë e as nuk do të jetojë ...”**. Por që gjithnjë është në rrokullisje në mes vdekjes dhe jetës, një jetë që është më e hidhur dhe më e vështirë se sa vdekja.

“Ndërsa kush paraqitet tek Ai si besimtar e që ka bërë vepra të mira, do të ngrihet në shkallë të larta’. ‘Në kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ata do të qëndrojnë aty përjetësisht. Ky është shpërblimi për atë që është i dëlirë (nga mosbesimi).”

E vërteta nëse tre ajetet e fundit janë vazhdim i fjalëve të magjistarëve karshi Faraonit, apo janë fjali të pavarura nga ana e Zotit, e këtu janë përmendur si plotësuese ndaj fjalëve të tyre në mesin e komentuesve të Kur’anit, është çështje diskutimi:

Një grup prej komentuesve këto tre ajete (të lartpërmendura) i konsiderojnë vazhdimësi të fjalëve të magjistarëve dhe, ka gjasa, që fillimi me pjesëzën *“in’ne”* që në fakt shpreh shkakun, të konfirmojë dhe të argumentojë këtë opinion.

Por përshkrimi dhe sqarimi që është bërë në këto tre ajete rreth fatit të besimtarëve të drejtë dhe jobesimtarëve kriminelë mbaron me fjalinë: **“Ky është shpërblimi për atë që është i dëlirë (nga mosbesimi)”** e po ashtu, tiparet dhe cilësitë që janë

përmendur në to' për Xhennetin dhe Xhehennemin e afirmojnë opinionin e dytë, pra, që këto (fjali) janë nga ana e Zotit. Ndryshe duhet që magjistarët gjatë një periudhë tepër të shkurtër kohore të kenë përfituar shumë informacione dhe dije Hyjnore për të gjykuar me kaq bindshmëri dhe qartësi rreth Xhennetit dhe Xhehennemit, si dhe fatit të besimtarëve dhe të kriminelëve.

Vetëm nëse themi: Zoti i Madhëruar këto fjale kuptimplota dhe domethënëse, për shkak të besimit të tyre, i bëri që të rrjedhin nga gojët e tyre, edhe pse për nga pikëpamja e edukimit Hyjnor dhe rezultatit, për ne nuk përbën aspak dallim nëse Zoti i Madhëruar i ka thënë këto fjali ose i kanë thënë besimtarët që janë mësuar nga ana e Zotit. Sepse Zoti i Lartësuar, çdo gjë që thotë, e transmeton me ton pozitiv dhe aprovues.

Hulumtime

1- Dituria është burim i besimit dhe revolucionit

Çështja më e rëndësishme që e hasim në ajetet e lartpërmendura është ndryshimi i thellë dhe i shpejtë i magjistarëve kundrejt Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*). Ata, në kohën që u vunë përballë Hazreti Musait ishin armiq të më të flaktë të tij, por, sapo panë mrekullinë e parë nga ana e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) u tronditën aq shumë, sa që u zgjuan

dhe ndryshuan qëndrim. Të gjithë mbeten të çuditur nga sjellja e tyre.

Ky kalim i shpejtë dhe i menjëhershëm nga mosbesimi në besim, nga devijimi në Udhë të Drejtë dhe të qëndrueshme, nga degradimi në integritet, nga errësira në dritë, i habiti aq shumë që të gjithë, mbase edhe për vetë Faraonin. Gjithçka ishte e pabesueshme, prandaj Faraoni u orvat që atë ta quante një komplot paraprak të qëllimshëm, ndërkohë që edhe vetë ishte i vetëdijshëm që kjo përpjekje e tij ishte e pavërtetë.

Cili faktor u bë shkaku i këtij transformimi të thellë dhe të shpejtë? Cili faktor e forcoi aq shumë dritën e besimit në zemrat e tyre, saqë madje ishin të gatshëm që të flijonin të gjithë ekzistencën dhe qenien e vet në këtë rrugë (dhe siç e dëshmon edhe historia) madje e flijuan atë, sepse Faraoni kërcënimin e vet e vuri në zbatim dhe në këtë mënyrë i vrau ata në mënyrë mizore dhe të pamëshirshme.

Vallë, a ka këtu ndonjë faktor tjetër përveç dijes dhe informimit? Ata, duke qenë se kishin njohuri për teknikat dhe sekretet e magjisë dhe qartazi e kuptuan që vepra e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ishte magji, ndryshuan drejtimin dhe rrugën me guxim dhe vendosmëri të pashembullt. Prej këtej përftohet më së miri që për transformimin dhe ndryshimin e njerëzve ose shoqërive të devijuara dhe krijimin e një revolucioni të shpejtë dhe të drejtë, para se gjithash njerëzve u duhet dhënë njohuri.¹

¹ Në lidhje me këtë për më shumë shih vëllimin e gjashtë, faqe 305, ajetet 123-126 sure "El A'raf".

2- Ne nuk do të japim ty përparësi ndaj “provave të qarta”

Interesant është fakti që ata kundrejt Faraonit të palogjikshëm përzgjedhën shprehjet më të logjikshme.

Në fillim thanë: Ne kemi gjetur argumente të qarta që tregojnë vërtetësinë e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe thirrjes së tij. Ne asnjë gjë nuk do ta konsiderojmë paraprijëse ndaj këtyre argumenteve dhe provave të qarta.

Së dyti, me anë të fjalisë: **“uel’ledhi fetarana” - “dhe ndaj Atij që na ka krijuar ne...”**, (e nënvizuan më tej këtë çështje, sepse vetë kjo shprehje, duke pasur parasysh fjalën “fetarana”), aludohet për natyrën e tyre monoteiste, që do të thoshte se edhe ne e shohim dritën e monoteizmit si nga brendësia e shpirtit, ashtu edhe nga argumenti dhe prova e arsyes. Me këto prova të qarta, si është e mundur që të braktisim këtë rrugë të drejtë dhe të ndërmarrim rrugën e gabuar?!

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh edhe këtë gjë, që një grup nga komentuesit e Kur'anit fjalinë: **“...uel ledhi fetarana ...”** nuk e kanë konsideruar si betim, por e kanë quajtur si referim ndaj fjalës **“ma xhaen’na fil bej’jinat”**. Si rrjedhim, kuptimi i përgjithshëm i fjalisë do të ishte në këtë mënyrë: **“... ne ty asnjëherë nuk do të të japim përparësi ndaj këtyre provave të qarta dhe ndaj Zotit, i cili na ka krijuar neve ...”**.

Por komentimi i parë duket më i përshtatshëm, sepse lidhja e këtyre të dyjave me njëra-tjetrën nuk duket dhe aq e përshtatshme (kini kujdes).

3- Kush quhet kriminel?

Duke pasur parasysh se ajetet e lartpërmendura pohojnë: **“çdo kush që del përpara Zotit si jobesimtar dhe kriminel do të futet në zjarr”** kuptohet se dënimi është i përhershëm, por lind edhe kjo pyetje: Vallë, a e pret një fat i tillë secilin kriminel?

Në ajetin vijues, që në realitet shpalos pikën e kundërt të kësaj, është përmendur fjala “mu’min” (besimtar). Kjo e bën të qartë që fjala “muxhrim” – “kriminel”, këtu emërtohet jobesimtari. Përveç kësaj, përdorimin e kësaj fjale në kuptimin e politeistit, e hasim edhe në shumë ajete të tjera kur’anore.

Për shembull, në lidhje me popullin e Lutit, që asnjëherë nuk i besuan të Dërguarit të vet, lexojmë: **“Ne lëshuam mbi ata një lloj shiu (me gurë). E shiko se si ishte fundi i kriminelëve!”**.¹

Kurse në suren “Furkan”, në ajetin 31 lexojmë: **“...Ne, çdo Profeti i kemi kundërvënë një armik nga keqbërësit. Por ty të mjafton Zoti yt si udhërrëfyes dhe ndihmës!”**.

4- A është fatalizmi mjedisor një mit?

Historia e magjistarëve në ajetet e lartpërmendura tregon se fatalizmi mjedisor nuk është gjë tjetër, veçse një gënjeshtër. Njeriu është i lirë në përzgjedhjet e tij dhe posedon vullnet të lirë. Njeriu, kur dëshiron diçka dhe vendos që ta arrijë atë, mundet që të ndryshojë rrugën e vet nga e shtrembra në të drejtë, edhe në qoftë se të gjithë njerëzit përreth tij që jetojnë në të njëjtin mjedis, janë

¹ Sure “El A’rafë”, ajeti 84.

zhytur në mëkate, ose janë të devijuar. Magjistarët kishin jetuar për vite të tëra në atë mjedis të përlyer me politeizëm. Ata edhe vetë ishin përlyer në veprat më të shëmtuara dhe politeistike, por vendosën të pranojnë të vërtetën dhe të qëndrojnë në rrugën e të vërtetës me pasion dhe dashuri të zjarrtë. Ata nuk u frikësuan më nga asnjë kërcënim dhe e arritën qëllimin e tyre. Për këtë çështje komentuesi i njohur, Tabarsij është shprehur: *“Në mëngjes ishin politeistë, kurse në mbrëmje dëshmorë mirëbërës të rrugës së drejtë!”*¹

Nga këto diskutime bëhet e qartë se mitet materialiste, sidomos ata të marksistëve, lidhur me burimin e shfaqjes së religjionit, janë të dobëta dhe të pabaza dhe çështjet ekonomike ata i konsiderojnë shkaqe të çdo lëvizjeje. Por, në të vërtetë, është plotësisht e kundërta. Magjistarët në fillim, për shkak të presionit nga paria e Faraonit si dhe e stimulimeve ekonomike të tij, u hodhën në sheshin e betejës me të vërtetën. Por, pas pak, besimi në Zot i asgjësoi këto shkaqe. Edhe pasurinë dhe pozitën që Faraoni ua kishte premtuar e sakrifikuan për besimin, kurse shpirtin e tyre të dashur e dhanë në rrugën e kësaj dashurie!

¹ Mexhmaul Bejjan, vëllimi 4, faqe 464. (Ajeti 126, sure “El Arafë”).

Ajetet 77 - 79

وَلَقَدْ أَوْحَيْنَا إِلَى مُوسَى أَنْ أَسْرِ بِعِبَادِي فَاصْرَبْ لَهُمْ طَرِيقًا فِي الْبَحْرِ
يَبْسًا لَا تَخَفُ دَرَكًا وَلَا تَخْشَى ﴿٧٧﴾ فَاتَّبَعَهُمْ فِرْعَوْنُ بِجُنُودِهِ ۖ فَغَشِيَهُمْ مِّنَ
الْإِيمِّ مَا غَشِيَهُمْ ﴿٧٨﴾ وَأَضَلَّ فِرْعَوْنُ قَوْمَهُ وَمَا هَدَىٰ ﴿٧٩﴾

“Ne i thamë Musait: ‘Udhëto natën me robtë e Mi, hapu atyre një rrugë të tharë nëpër det dhe mos u frikëso se do të të kapë ndokush e as se do të mbyteni!’”

“Faraoni i ndoqi ata (bijtë e Izrailit) me ushtrinë e tij, por deti i mbuloi ata me dallgë të mëdha.”

“Faraoni i solli humbje popullit të vet dhe nuk e çoi në rrugë të drejtë.”

Komentimi

Shpëtimi i izrailitëve dhe përmytja e faraonëve

Pas përballjes së Hazreti Musait (Paqja qoftë mbi të!) me magjistarët dhe pas fitores shembullore dhe mahnitëse të tij mbi

ata, si dhe pas pranimit të besimit të drejtë prej një pjese të turmës së madhe njerëzore, Musai dhe feja e tij u fut zyrtarisht në mendjet e njerëzve të Egjiptit.

Edhe pse shumica e Koptëve nuk e pranuan atë, pranimi i fesë së Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte gjithnjë një çështje intriguese për ata. Izrailitët nën udhëheqjen e Hazreti Musait së bashku me një pakicë egjiptiane, vazhdimisht i kundërviheshin mbështetësve të Faraonit.

Kjo vazhdoi për vite tëra. Gjatë kësaj periudhe ndodhën ngjarje të hidhura dhe të ëmbla dhe Kur'ani një pjesë të tyre e ka përmendur në suren "El Araf", në ajetin 127 e në vijim.

Ajetet që po diskutojmë flasin për pjesën e fundit të këtyre ngjarjeve, pra, për kohën kur nisin të largohen Izrailitët nga Egjipti. Në ato tregohet se Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) i thanë: **"Udhëto natën me robtë e Mi ..."**.

Izrailitët ishin të gatshëm që të udhëtonin drejt tokës së premtuar, (Palestinë), por në kohën që kishin arritur në brigjet e lumit Nil, Faraoni u vu në dijeni dhe i ndoqi ata nga pas me një ushtri të madhe. Ata e panë veten të rrethuar nga lumi dhe nga armiku. Pra, nga njëra anë ishte lumi Nil dhe nga ana tjetër ishte armiku i fortë, gjakpirës dhe i zemëruar!

Por Zoti i Madhëruar dëshironte që ta çlironte këtë shoqëri të shtypur prej besimtarësh të vobektë dhe shtypësit t'i asgjësojë. Prandaj e urdhëroi Hazreti Musain: **"...hapu atyre një rrugë të tharë nëpër det..."**. Ajo rrugë ishte e mbrojtur nga Zoti i Madhëruar.

Nëpër atë rrugë do të kalonte Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe njerëzit e tij të pafrikësuar dhe të parrezikuar as nga mbytja e as nga ndjekja e Faraonit:

“...dhe mos u frikëso se do të të kapë ndokush e as se do të mbyteni!”

Interesant është fakti se jo vetëm që u hap rruga, por ajo rrugë, me urdhrin e Zotit, ishte një rrugë e tharë. Zakonisht ndodh që nëse ujërat e liqeneve apo lumenjve largohen, mund të thahet një pjesë e tyre, por sërish, për një periudhë të gjatë kohe është e pamundur të kalohet nëpër të.

Ragibi në librin “El Mufredat” thekson se fjala “*derk*” tregon thellësinë më të madhe të detit. Edhe litarin të cilin e lidhin me një litar tjetër që t’ia arrijë fundin e ujit e quajnë “*derek*”. Gjithashtu, edhe dëmet që i ndodhin njeriut i quajnë “*derek*”, kurse shprehja “*nivelet e Xhehennemit*” karshi “*gradave të Xhennetit*” tregon fazat e niveleve të ulëta të Xhehennemit.

Ajeti 61 i sures “Shuara” tregon kohën që Izrailitët u vunë në dijeni për ardhjen e ushtrisë së Faraonit që u drejtua nga Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i thanë: **“...me siguri ushtria e Faraonit na zunë...”**

Fjala “*derk*” në ajetin që po diskutojmë ka kuptimin se ushtria e Faraonit kurëe nuk do të mbërrijë te ju. Kurse fjala “*la tekhsa*” ka kuptimin se juve nuk ju kërcënon asnjë rrezik nga ana e detit.

Në këtë mënyrë, Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Izrailitët hynë në rrugët që u hapën në mes të detit. Në këtë kohë

Faraoni, së bashku me ushtrinë e tij, arriti në breg të lumit dhe papritur u gjend përpara një pamjeje të mahnitshme dhe befasuese: **“Faraoni i ndoqi ata (bijtë e Izrailit) me ushtrinë e tij...”**.

Në fillim ushtria e Faraonit hezitoi që të futej në atë shteg të rrezikshëm dhe të panjohur që të ndiqte Izrailitët. Vetë ajo mrekulli mahnitëse ishte e mjaftueshme që të ndalonte ndjekjen e asaj rruge.

Por Faraoni, i cili ishte i mbërthyer nga arroganca dhe mburrja, ishte i zhytur në kokëfortësi dhe topitje, u tregua mospërfillës ndaj kësaj mrekullie të madhe dhe ushtrinë e vet e stimuloi dhe e nxiti që të hynte në ato shtigje detare të panjohura!

Kështu, kur ushtria e Faraonit hyri në Nil, në anën tjetër të Nilit dilte personi i fundit prej Izrailitëve.

Në këtë kohë dallgët e detit u urdhëruan që të ktheheshin si në fillim.

Dallgët e detit ranë menjëherë, siç bie një godinë e vjetër kur ia prishin themelet. **“...por deti i mbuloi ata me dallgë të mëdha ...”**.

Në këtë mënyrë, një pushtet mizor dhe tiran me një ushtri të fortë dhe të fuqishme u zhytën në valët e detit dhe u bënë ushqim i gatshëm për peshqit!

Po, Faraoni e devijoi popullin e vet dhe asnjëherë nuk i udhëzoi në rrugë të drejtë: **“Faraoni i solli humbje popullit të vet dhe nuk e çoi në rrugë të drejtë...”**.

Fjala “*edhel’le*” dhe fjala “*ma heda*” pothuajse kanë të njëjtin kuptim, prandaj disa nga komentuesit i kanë konsideruar si sinonime. Por, në dukje këto dy fjalë kanë një dallim nga njëra-tjetra. Kështu fjala “*edhel’le*” aludon në humbje dhe devijim, kurse fjala “*ma heda*” aludon mosudhëzimin pas qartësimit të devijimit.

Shpjegimi është ky: Një udhëheqës, ndonjëherë edhe mund të gabojë dhe i drejton pasuesit e vet në rrugën e devijimit, por në kohën që bëhet i vetëdijshëm për gabimin e vet, menjëherë i rikthen ata në rrugën e drejtë. Por Faraoni kishte aq shumë kokëfortësi saqë, edhe pas vrojtimit të devijimit, sërish nuk ia tregoi të vërtetën popullit të vet dhe i tërhoqi në rrugë pa krye, derisa ai së bashku me ushtrinë e vet u asgjësuan dhe humbën.

Kjo fjali, në fakt e mohon fjalën e Faraonit që është deklaruar në suren “Gafir” në ajetin 29 ku tregohet se Faraoni thotë: **“...Unë ju tregoj vetëm atë që shoh dhe ju udhëzoj në rrugën e drejtë!”**.

Ngjarjet kanë treguar që kjo fjali ishte një gënjeshtër e madhe, ashtu si gënjeshttrat e tjera të tij.

Ajetet 80 - 82

يَبْنِي إِسْرَءِيلَ قَدْ أَنجَيْنَاكَ مِنْ عَدُوِّكَمَّ وَوَعَدْنَاكَمَّ جَانِبَ الطُّورِ
 الْأَيْمَنِ وَنَزَّلْنَا عَلَيْكَمَّ الْآمَنَ وَالسَّلَوى ﴿٨٠﴾ كُلُوا مِنْ طَيِّبَاتِ مَا رَزَقْنَاكُمْ
 وَلَا تَطْغَوْا فِيهِ فَيَحِلَّ عَلَيْكُمْ غَضَبِي ۖ وَمَنْ يَحِلَّ عَلَيْهِ غَضَبِي فَقَدْ هَوَىٰ
 ۖ وَإِنِّي لَغَفَّارٌ لِّمَنْ تَابَ وَءَامَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا ثُمَّ اهْتَدَىٰ ﴿٨١﴾

“O bijtë e Izrailit, Ne ju shpëtuam nga armiku juaj, bëmë besëlidhje me ju në anën e djathtë të Turit dhe ju zbritëm manë dhe thëllëza.”

“Hani nga ushqimet e shijshme e të lejuara me të cilat ju kemi furnizuar dhe mos e kapërceni kufirin, përndryshe do t’ju zërë zemërimi Im. Ai, të cilin e zë zemërimi Im, është i humbur!”

“Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.”

Komentimi

E vetmja rrugë e shpëtimit

Në diskutimet e mëparshme u tregua se shpëtimi i Izrailitëve nga kthetrat e Faraonit u bë i mundur nga mrekullia e madhe e All'llahut. Në tre ajetet e lartpërmendura Kur'ani është fokusuar tek Izrailitët, por vlerat e këtij mesazhi janë përgjithësuese dhe vlejné në çdo epokë dhe në çdo kohë. Përmes asaj mrekullie tregohet se Zoti i Madhëruar u sjell begati të shumta atyre që futen në Rrugën e Drejtë të Tij dhe ecin me vendosmëri në atë rrugë që Ai ua mësoi.

Për këtë thuhet në Kur'an: **“O bijtë e Izrailit, Ne ju shpëtuam nga armiku juaj ...”**.

Është më se e qartë se baza e çdo veprimtarie të suksesshme dhe pozitive është liria. Në këtë kontekst, shpëtimi nga kthetrat e faktorëve dhunues, dominues, agresivë dhe ftimi i pavarësisë dhe lirisë është kusht i parë dhe i domosdoshëm. Pikërisht, për këtë arsye Kur'ani i kushton një rëndësi të madhe këtij faktori.

Më pas, përmend një prej begative të rëndësishme shpirtërore dhe thotë: **“...bëmë besëlidhje me ju në anën e djathtë të Turit ...”**.

Kjo i referohet lëvizjes së Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të përfaqësuesve të Izrailitëve në anën e djathtë të Turit, në atë vend që Zoti i Madhëruar ia zbriti Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi*

të!) fletët e Teuratit, bisedoi me të (Hazreti Musanë) dhe të gjithë dëshmuan fuqinë absolute të All'llahut.¹

Më në fund, Kur'ani tregon një begati të rëndësishëm materiale e cila buron nga mirësia e veçantë e Zotit për Izrailitët: **"...dhe ju zbritëm manë dhe thëllëza."**

Në atë shkretëtirë ku ishit të përhumbur dhe nuk kishit ushqim të përshtatshëm ju përfshiu mirësia e Zotit të Madhëruar dhe ju dhuroi ushqim të shijshëm dhe të ëmbël, në atë masë që kishit nevojë.

Le të sqarojmë se me ç'kuptim janë përdorë fjalët "*el men'n*" dhe "*sel'ua*". Komentuesit e Kur'anit kanë bërë diskutime të shumta rreth kësaj çështjeje. Këto diskutime i kemi trajtuar në vëllimin e parë të po këtij tefsiri (në ajetin 57 të sures "El Bekare"). Pasi u diskutua rreth opinioneve të komentuesve të tjerë, u shpreh edhe mendimi që "*el men'n*" të ishte emërtimi i një lloj mjaliti natyror që gjendej në malet përreth asaj shkretëtire, ose të jetë emërtimi i lëngjeve, ekstrakteve me plot energjie dhe fuqিদhënëse të veçanta bimore.

Kurse fjala "*sel'ua*" ishte emri i një lloj zogu, mishi i të cilit ishte hallall dhe i lejuar. Ai ngjasonte me pëllumbin.

Për më shumë informacion, shih vëllimin e parë të këtij tefsiri, në të cilin është bërë komentimi i ajetit të lartpërmendur.

Në ajetin vijues, duke patuar parasysh kontekstin e këtyre tre ajteve me vlera, Kur'ani u drejtohet sërish atyre në këtë

¹ Për më shumë në lidhje me këtë shih ajetet 155 dhe 156 të sures "El A'raf".

mënyrë: **“Hani nga ushqimet e shijshme e të lejuara me të cilat ju kemi furnizuar dhe mos e kapërceni kufirin...”**.

Kapërcimi i kufirit (tek begatitë dhe ushqimet) kërkon të sqarojë që njeriu ato duhet t’i shfrytëzojë dhe t’i përdorë në rrugën e nënshtrimit ndaj Zotit dhe në rrugën e lumturisë së vet. Të mos i përdorë ato si mjet për kryerjen e mëkatit, mosmirënjohjes, politeizmit, kundërshtimit dhe shpërdorimit, siç vepruan edhe Izrailitët, fatkeqësisht, të cilët, dikur i kishin përftuar të gjitha këto begati të All’llahut, por ndërmorën rrugën e politeizmit, rebelimit dhe mëkatimit.

Prandaj vjen paralajmërimi për ata: **“...përndryshe do t’ju zërë zemërimi Im. Ai, të cilin e zë zemërimi Im, është i humbur...”**!

Fjala *“heua”* përdoret me kuptimin e rënies poshtë nga lartësia. Këtu tregon shembjen, asgjësimin dhe rënien nga pozita, largimin nga afërsia me Zotin e Madhëruar dhe dëbimin nga prania e Tij.

Duke u nisur nga fakti që paralajmërimi dhe kërcënimi gjithnjë duhen të shoqërohen me stimulim dhe përgëzim, në mënyrë që të ngjallen njësoj edhe frika edhe shpresa, të cilat janë faktorë kryesorë që ndikojnë në përsosmërinë e njeriut, njëherësh, që të hapë dyert e rikthimit dhe të pendimit për mëkatarët. Për këtë, Kur’ani, në ajetin vijues thotë: **“Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.”**.

Fjala *“gaffar”* përdoret për të treguar diçka të zmadhuar, ka vlerat e një hiperbole. Ajo tregon që Zoti i Madhëruar, jo një

herë, por shumë herë do t'i falë mëkatarët që pendohen dhe do të tregohet i mëshirshëm ndaj tyre.

Por, kushti i parë i pendimit është heqja dorë nga mëkati. Pasi shpirtit i njeriut të jetë larë dhe pastruar nga ato papastërti, vjen kushti i dytë. Ky kusht kërkon që mëkatarët e penduar, të përqafojnë besimin në Zotin e Madhëruar dhe të ecin me bindje dhe vendosmëri në rrugën e Tij.

Kushti i tretë është që mëkatarët e penduar të tregojnë me vepra besimin në monoteizëm.

Këto ajete dhe ajete të tjera kur'anore flasin vetëm për pendimin, për besimin dhe veprën e mirë. Por as kaq nuk mjafton. Është shtuar edhe kushti i katërt që është *"thum'me ihteda"*.

Komentuesit e Kur'anit për kuptimin e kushtit të katërt kanë sugjerime të shumta. Midis tyre po veçojmë dy komentime që duken më interesante:

Së pari, kërkohet që të vazhdohet rruga e besimit, e devotshmërisë dhe e veprës së mirë. Kjo do të thotë që pendimi e pastron të kaluarën dhe është shkak i shpëtimit. Me këtë kusht njeriu mëkatar udhëzohet që të mos bjerë sërish në kurthin e mëkatisë dhe të politeizmit dhe gjithnjë të jetë i kujdesshëm nga nxitjet djallëzore dhe nga egoja e shpirtit të tij të mos të kthejë sërish në rrugën e kaluar.

Së dyti, kjo fjali është aludim për domosdoshmërinë e pranimit të vilajetit dhe udhëheqësinë e një udhëheqësi prej udhëheqësve të caktuar nga All'illahu. Kjo do të thotë që pendimi, besimi dhe vepra e mirë vetëm atëherë bëhen shkak për shpëtimin

e njeriut, që vihet nën ombrellën e drejtimit të udhëheqësve të caktuar nga All'illahu. Një kohë udhëheqësi i caktuar nga All'illahu ishte Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*), në një kohë tjetër ishte Profeti i Islamit, në një kohë tjetër ishte Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe më pas do jetë Imam Mehdiu.

Një prej shtyllave të fesë është pranimi i thirrjes së Profetëve dhe udhëheqja e tyre. Më pas vjen pranimi i udhëheqjes së pasardhësve të tyre.

I ndjeri Tabersiu në lidhje me këtë ajet nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka transmetuar se synimi i fjalës “*thum'me ihteda*” është “*udhëzimi në vilajetin tonë të Ehli Bejtit*”. Më pas shtoi: “*Betohem në Zot, nëse ndonjëri do të kalonte të gjithë jetën e tij në ruku dhe në adhurim në afërsi të shtëpisë së Zotit, më pas, kur të largohet nga kjo botë duke mos e pranuar vilajetin tonë, Zoti i Madhëruar atë do ta hedhë në Xhehennem me fytyrë përpara*”.

Këtë hadith, gjithashtu, e ka transmetuar edhe hadithologu i njohur i Ehli Syneetit, Hakim Ebul Kasim Haskani.¹

Në lidhje me këtë temë janë transmetuar edhe hadithe të tjera nga Imam Zejnul Abidini dhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi ta!*) si dhe nga vetë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'illahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në mënyrë që të kuptojmë plotësisht se deri në ç'masë heqja dorë nga ky parim është vdekjeprurëse mjafton që t'i shqyrtojmë ajetet vijuese ku tregohet se si Izrailitët hoqën dorë nga vilajeti dhe iu shmangën ndjekjes së Hazreti Musait (*Paqja qoftë*

¹ Mexhmaul Bejjan, ajeti në fjalë.

mbi të!) dhe zëvendësit të tij, Harunit, dhe shkuan pas adhurimit të politeizmit dhe mosbesimit.

Kjo qartësohet edhe më tej me komentimin nga ana e Alusiut të “Ruhul Meani”. Pas përmendjes së njërit prej pjesëve të këtyre transmetimeve, ai ka deklaruar: “Nuk kemi asnjë dyshim për domosdoshmërinë e dashurisë së Ehli Bejtit. Por kjo nuk ka lidhje me Bijtë e Izrailit dhe as me kohën e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo është thënie e kotë dhe e pabazë. Sepse, së pari këtu nuk flitet në lidhje me dashurinë, por flitet për pranimin e një udhëheqësi.

Së dyti, këtu nuk synohet ekskluziviteti i udhëheqjes për Ehli Bejtin (*Paqja qoftë mi ta!*). Por në kohën e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), vetë ai, së bashku me të vëllanë, Harunin, ishin udhëheqës dhe ishte e nevojshme pranimi i vilajetit të tyre. Në kohën e Profetit të Islamit kërkohej pranimi i vilajetit të tij dhe në kohën e Imamëve të Ehli Bejtit, kërkohej pranimi i vilajetit të tyre.

Po ashtu është e qartë edhe kjo që edhe pse në këtë ajet objekt i diskutimit janë Izrailitët, vlera e këtyre mësimave të All'llahut është për çdo individ e për çdo grup shoqëror e në çdo kohë, të cilët i realizojnë kushtet e lartpërmendura me synimin që të përfshihen nga falja dhe mëshira e Zotit të Madhëruar.

Ajetet 83 - 91

وَمَا أَعْجَلَكَ عَنْ قَوْمِكَ يَمُوسَى ﴿٨٣﴾ قَالَ هُمْ أَوْلَاءِ عَلَى أَثَرِي
 وَعَجِلْتُ إِلَيْكَ رَبِّ لِتَرْضَى ﴿٨٤﴾ قَالَ فَإِنَّا قَدْ فَتَنَّا قَوْمَكَ مِنْ بَعْدِكَ
 وَأَضَلَّهُمُ السَّامِرِيُّ ﴿٨٥﴾ فَرَجَعَ مُوسَى إِلَى قَوْمِهِ غَضْبَانَ أَسِفًا قَالَ
 يَقَوْمِ أَلَمْ يَعِدْكُمْ رَبُّكُمْ وَعَدًّا حَسَنًا أَفَطَالَ عَلَيْكُمُ الْعَهْدُ أَمْ أَرَدْتُمْ
 أَنْ يَخِلَّ عَلَيْكُمْ غَضْبٌ مِنْ رَبِّكُمْ فَأَخْلَفْتُم مَوْعِدِي ﴿٨٦﴾ قَالُوا مَا أَخْلَفْنَا
 مَوْعِدَكَ بِمَلِكِنَا وَلَكِنَّا حُمِلْنَا أَوْزَارًا مِنْ زِينَةِ الْقَوْمِ فَقَذَفْنَاهَا فَكَذَلِكَ
 أَلْقَى السَّامِرِيُّ ﴿٨٧﴾ فَأَخْرَجَ لَهُمْ عِجْلًا جَسَدًا لَهُ خُورٌ فَقَالُوا هَذَا
 إِلَهُكُمْ وَإِلَهُ مُوسَى فَنَسِيَ ﴿٨٨﴾ أَفَلَا يَرَوْنَ أَلَّا يَرْجِعُ إِلَيْهِمْ قَوْلًا وَلَا
 يَمْلِكُ لَهُمْ ضَرًّا وَلَا نَفْعًا ﴿٨٩﴾ وَلَقَدْ قَالَ لَهُمْ هَارُونُ مِنْ قَبْلُ يَقَوْمِ إِنَّمَا
 فُتِنْتُمْ بِهِ ^ط وَإِنَّ رَبَّكُمُ الرَّحْمَنُ فَاتَّبِعُونِي وَأَطِيعُوا أَمْرِي ﴿٩٠﴾ قَالُوا لَنْ
 نَبْرَحَ عَلَيْهِ عَاكِفِينَ حَتَّى يَرْجِعَ إِلَيْنَا مُوسَى ﴿٩١﴾

“Përse nxitove para popullit tënd, o Musa?”

“(Musai) tha: ‘Ja, ata, shkojnë pas gjurmëve të mia e unë nxitova te Ti, o Zoti im, për të fituar kënaqësinë Tënde.’”

“(All’Ilahu) tha: ‘Ne e vumë në provë popullin tënd gjatë mungesës tënde, e Samiriu i nxori ata nga rruga e drejtë.’”

“Musai u kthye te populli i vet i zemëruar dhe i pikëlluar. Tha: ‘O populli im, vallë, a nuk ju dha Zoti juaj një premtim të mirë? A mos ju duk e gjatë koha (e përmbushjes së premtimit) apo dëshironi që t’ju godasë zemërimi i Zotit tuaj?! Prandaj nuk i jeni përmbajtur premtimit që më dhatë?!”

“Ata u përgjigjën: ‘Ne nuk e kemi thyer premtimin që të patëm dhënë me vullnetin tonë, por qemë të ngarkuar rëndë me stolitë e popullit (të Faraonit), andaj i hodhëm ato (në zjarr për t’u lehtësuar). Po kështu i hodhi edhe Samiriu.’”

“Dhe nga këto ai bëri një trup viçi që pëlliste. Atëherë tha: ‘Ky është zoti juaj dhe zoti i Musait. Ai (Musai) ka harruar (t’ju tregojë për të)!”

“Vallë, a nuk e shihnin ata, se (viçi) nuk u drejtonte atyre asnjë fjalë dhe nuk ishte në gjendje t’u sillte kurrfarë dëmi apo dobie?”

“Ndërkohë, Haruni u kishte thënë atyre qysh më parë: ‘O populli im! Kjo është vetëm një provë për ju! Zoti juaj është i Gjithëmëshirshmi, andaj ndiqmëni mua dhe dëgjoni urdhrin tim!’”

“Ata u përgjigjën: ‘Ne do t’i lutemi atij, derisa të na kthehet Musai.’”

Komentimi

Kokëforcia e Samiriut

Në këto ajete është pasqyruar një moment tjetër i rëndësishëm nga jeta e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e Izrailitëve. Ky moment lidhet me shkuarjen e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) në vendin e caktuar, në Tur, së bashku me përfaqësuesit e Izrailitëve dhe më pas lidhet me adhurimin e viçit nga bijtë Izrailitë.

Sipas programit, Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) do të shkonte në malin e Turit që të merrte dispozitat, ligjet e “Teuratit”. Në këtë udhëtim duhej ta shoqëronte edhe një grup nga Izrailitët në mënyrë që ata të njiheshin me fakte dhe të vërteta të reja rreth njohjes së Zotit të Madhëruar, të teologjisë dhe të shpalljes së All’llahut.

Në zemrën e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) ekzistonte një dëshirë e madhe për t’iu lutur Zotit të Madhëruar dhe për të dëgjuar melodinë e shpalljes nga ana e Tij. Kjo dëshirë e madhe kishte bërë që Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) të harronte çdo gjë. Ai nuk kujtohej as për të ngrënë ushqim, as për të pirë ujë, as për të pushuar. Ai vetëm ecte shumë shpejt nëpër atë udhë dhe i la pas të tjerët. Arriti i vetëm në vendin e caktuar të Turit.

Këtu atij i zbriti shpallja: **“Përse nxitove para popullit tënd, o Musa?”**.

Hazreti Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) menjëherë u përgjigj: **“Ja, ata, shkojnë pas gjurmëve të mia e unë nxitova te Ti, o Zoti im, për të fituar kënaqësinë Tënde.”**

Jo vetëm dashuria për të t'u lutur Ty dhe për të dëgjuar fjalët e Tua më bënë mua të mos duroj, por isha shumë i entuziazmuar dhe doja që sa më shpejt të merrja dispozitat dhe ligjet e Tua dhe t'ua komunikoja robëve të Tu. Kjo ishte arsyeja që më bëri të nxitoj dhe të përfitoja sa më shumë nga kënaqësia Jote! Po, unë jam i dashuruar pas kënaqësisë Tënde dhe jam i etur që të dëgjoj urdhrin Tënd.

Si përfundim, manifestimet shpirtërore të Zotit të Madhëruar që duhej të zgjatnin tridhjetë netë, u zgjatën në dyzet netë. Rrethanat e ndryshme që ekzistonin paraprakisht për devijim e Izrailitëve e kryen punën e tyre. Samiriu, ky burrë vigjilent dhe i devijuar, nxitoi dhe duke përdorë disa mjete, për të cilat do të flasim më gjerësisht në të ardhmen, bëri skulpturën e një viçi dhe i ftoi njerëzit ta adhuronin atë.

S'ka dyshim se disa faktorë ndihmues si: adhurimi i viçit nga egjiptianët, shikimi i skenës së idhujtarisë (së adhurimit të viçit), kërkesa për krijimin e një idhulli të ngjashëm me të pas kalimit nga lumi i Nilit, zgjatja e kohës së caktuar për kthimin e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), përhapja e thashethemeve për vdekjen e tij nga ana e hipokritëve dhe padituritë e kësaj shoqërie. Të gjitha këto rrethana ndikuan në shfaqjen e kësaj ngjarjeje dhe të devijimit të madh nga monoteizmi në politeizëm. Ngjarjet shoqërore, zakonisht, nuk shfaqen pa një premisë dhe pa një faktor e rrethana paraprake. Mund të ndodhë ndonjëherë, që këto

rrethana të jenë të dukshme dhe ndonjëherë të jenë të fshehura dhe pa ndikim të madh.

Sidoqoftë, politeizmi ishte përhapur në mesin e Izrailitëve në formën më të keqe të mundshme. Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) shkoi në vendin e caktuar të Turit dhe Haruni ishte i vetmi udhëheqës i popullit që e shoqëronte. Nuk kishin përreth asnjë ndihmës të fortë dhe ndikues.

Por aty, pikërisht në vendin që iu caktua Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte Zoti i Madhëruar dhe iu drejtua Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) duke i thënë: **“Ne e vumë në provë popullin tënd gjatë mungesës tënde, e Samiriu i nxori ata nga rruga e drejtë.”**

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) sapo dëgjoi këtë bisedë, u zemërua shumë dhe vetëm pëshpëriste me vete: “Për vite të tëra jam munduar dhe kam duruar shumë, jam përballur me çdo lloj problemi dhe rreziku me qëllim që këtë popull ta njoh me monoteizmin dhe ta nxjerr në rrugë të drejtë, por sa keq! Njëqind herë keqardhje! Vetëm për disa ditë që mungova unë, u prish gjithçka, të gjitha mundimet e mia u hodhën në erë!”.

Prandaj, menjëherë Hazreti **“Musai u kthye te populli i vet i zemëruar dhe i pikëlluar.”**

Në kohën që ai pa skenën tepër tronditëse të adhurimit të viçit thirri: **“O populli im, vallë, a nuk ju dha Zoti juaj një premtim të mirë...”?**

Ose ky premtim i mirë ishte një premtim që iu ishte dhënë Izrailitëve rreth zbritjes së “Teuratit”, ishte shpjegimi i dispozitave

dhe normave qiellore, ose ishte premtimi i shpëtimit dhe fitores ndaj faraonëve dhe bërja trashëgimtar i qeverisë të kësaj bote, ose ishte premtimi i faljes dhe i ndjesës për ata të cilët pendohen, që besojnë dhe që kryejnë vepra të mira, ose të gjitha këto së bashku. Më pas shtoi: **“...A mos ju duk e gjatë koha...”**.

Po të supozojmë se zgjatja e kohës së rikthimit të Hazreti Muasit (*Paqja qoftë mbi të!*) nga 30 ditë në 40 ditë nuk është një zgjatje e gjatë, atëhere lind pyetja: Vallë, a nuk duhej që ta mbroni veten tuaj përgjatë kësaj periudhe të shkurtër kohe? Madje, edhe nëse do të kisha qëndruar me vite të tëra larg jush, sërish feja e Zotit të Madhëruar që jua kam mësuar dhe mrekullitë të cilat i keni parë me sytë tuaj duhet që të dominonin mbi ju.

Me këtë vepër tuaj të shëmtuar keni dashur që të zbriste mbi ju zemërimi dhe hidhërimi i Zotit të Lartësuar, prandaj nuk i jeni përmbajtur premtimit tim. **“...apo dëshironi që t’ju godasë zemërimi i Zotit tuaj?! Prandaj nuk i jeni përmbajtur premtimit që më dhatë?!”**

Unë kisha lidhë besën me ju që të qëndroni në rrugën e monoteizmit dhe në rrugën e bindjes së sinqertë ndaj Zotit të Madhëruar dhe të mos shmangeni e as të mos devijoni aspak nga kjo rrugë. Por duket se gjatë mungesës sime i kishit harruar të gjitha fjalët dhe këshillat e mia, kundërshtuat dhe iu kundërvutë me bindje urdhrit të vëllait tim, Harunit.

Izrailitët, kur u gjendën përballë kërcënimeve të ashpra të Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), u ndërgjegjësuan që me të vërtetë kishin kryer një vepër shumë të shëmtuar dhe të keqe. Ata

nxituan për të gjetur justifikime: **“Ne nuk e kemi thyer premtimin që të patëm dhënë me vullnetin tonë...”**.¹

Në realitet ne nuk kishim dëshirë për të adhuruar viçi: **“...por qemë të ngarkuar rëndë me stolitë e popullit (të Faraonit), prandaj i hodhëm ato (në zjarr për t’u lehtësuar). Po kështu i hodhi edhe Samiriut...”**.

Po si vepruan Izrailitët? Si veproi Samiriu? Cili është kuptimi i saktë i fjalëve të ajetit të lartpërmendur?

Komentuesit e Kur’anit kanë bërë diskutime të shumta në lidhje me këtë, por nuk kanë gjetur ndonjë dallim të madh në thelb.

Disa kanë thënë se termi *“kedhefnaha”*, pra, stolitë të cilat i kishim marrë nga faraonitët para se të niseshim nga Egjipti, i kemi hedhur në zjarr. Samiriu, gjithashtu, gjithë çfarë kishte i hodhi në zjarr, derisa u shkrinë dhe nga ato formësoi një viç.

Disa të tjerë kanë deklaruar se kuptimi i fjalisë është i tillë: Ne i flakëm tutje stolitë kur Samiriu i mbodhi ato dhe i hodhi në zjarr dhe nga ato krijoi viçin.

¹ Fjala *“mulk”* dhe fjala *“mulk”* që të dyja janë në kuptimin e pronësisë së një gjëje dhe synimi i Izrailitëve ishte ky që ne nuk ishim pretendues dhe pronarë të kësaj vepre por ne ishim ndikuar aq shumë sa që zemrën dhe fenë tonë na e rrëmbyen nga duart.

Disa nga komentuesit e Kur’anit këtë fjali ia atribuojnë një pakice nga populli i Izrailit të cilët nuk ishin adhures të viçit (kanë deklaruar; gjashtëqind mijë persona prej tyre ishin adhures të viçit dhe vetëm dymbëdhjetë mijë persona kishin mbetur në monoteizëm dhe nuk kishin hequr dorë nga feja) por komentimin të cilin e cekëm më lart duket më i saktë.

Gjithashtu, ekziston edhe kjo mundësi që fjalia: **“Po kështu i hodhi edhe Samiriu ...”** të jetë aludim për tërësinë e planit dhe programit që Samiriu e realizoi.

Zakonisht ndodh që kur drejtuesi ose udhëheqësi i qorton vartësit e vet rreth një mëkati, të cilin e kanë kryer, ata orvaten që ta mohojnë mëkatin e vet dhe ta fajësojnë tjetrin për një gjë të tillë. Adhuresit Izrailitë të viçit, të cilët me dëshirën dhe vullnetin e vet kishin kaluar nga monoteizmi në politeizëm, dëshironin që të gjithë fajin dhe mëkatin t’ia hidhnin Samiriut.

Të gjitha stolitë e ithtarëve të Faraonit që ata dhe Samiriu i kishin përfituar nëpërmjet dhunës dhe mëkatit, nuk kishin ndonjë vlerë tjetër, përveçse t’i harxhonin dhe konsumonin për një vepër të tillë, të ndaluar e haram. Nga të gjitha këto stoli, ata përgatitën një statujë viçi, një trup pa shpirt që kishte një zë ngjashëm me të viçit. **“...dhe nga këto ai bëri një trup viçi që pëlliste....”**.¹

Sapo e pane këtë skenë Izrailitët, hoqën dorë nga të gjitha mësimet monoteistike të Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i thanë njëri-tjetrit: **“Ky është zoti juaj dhe zoti i Musait. Ai (Musai) ka harruar t’ju tregojë për të.”**

Gjithashtu, ekziston mundësia që këtë bisedë ta ketë bërë Samiriu me përkrahësit dhe dishepujt e parë të tij.

Kështu, Samiriu harroi besëlidhjen e vet, jo vetëm me Hazreti Musain (*Paqja qoftë mbi të!*), por edhe me Zotin e Hazreti Musait dhe njerëzit i çoi në devijim: **“ka harruar”**.

¹ Fjala *“khauaar”* është në kuptimin e zërit të lopës dhe të viçit dhe ndonjëherë gjithashtu është përdorur edhe në kuptimin e devesë.

Disa nga komentuesit “harresën” e kanë komentuar si devijim dhe nisjen e një rruge pa krye. Disa të tjerë e kanë konsideruar si “harrues” Hazreti Musanë (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe kanë deklaruar se kjo është fjalë e Samiriut, i cili dëshiron të thotë se Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) ka harruar që (t’ju thotë) se ky viç është Zoti i juaj. Të gjitha këto bien në kundërshtim me përmbajtjen e ajetit, me kuptimin e qartë të tij, kuptimi i të cilit është po ajo që theksuam më lart, pra, që Samiriu harroi premtimin e vet ndaj Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Zotit të Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ndërmori rrugën e idhujtarisë.

Në këtë kohë, Zoti i Madhëruar, në shenjë qortimi dhe fajësimi, u drejtohet idhujtarëve: **“Vallë, a nuk e shihnin ata, se (viçi) nuk u drejtonte atyre asnjë fjalë dhe nuk ishte në gjendje t’u sillte kurrfarë dëmi apo dobie?”**

Një hyjni e vërtetë, së paku, duhet të jetë në gjendje që t’u përgjigjet kërkesave të robërve të tij. Vallë, a mund të merret si argument për adhurim vetëm dëgjimi i zërit të viçit, të kësaj statuje prej floriri, një zë në të cilin nuk ndihet asnjë vullnet apo liri veprimi.

Edhe nëse supozojmë që hyjnia (viçi) mund t’u përgjigjet pyetjeve dhe kërkesave të tyre, sërish do të jetë një gjallesë që ngjason me një diçka të pafuqishme dhe të paafte, e cila nuk është e denjë që të sjellë dobi dhe dëm të tjerëve, madje as ndaj vetes. Vallë, kështu mund të jetë një hyjni e adhuruar?!

Cila arsye lejon që njeriu të adhurojë një skulpturë të pashpirt nga e cila ndonjëherë mund të dalë apo del një zë i pakuptimtë? Dhe mundet që t'i përulemi asaj?!

Pa dyshim, në këtë përleshje Haruni, pasuesi i Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i Dërguari i madh i Zotit, nuk hoqi dorë nga misioni i tij. Ai, me gjithë potencialin dhe fuqinë që kishte, iu kundërvu devijimit dhe korrupsionit. Për këtë është shprehur edhe Kur'ani. Ndërkohë, Haruni u kishte thënë atyre qysh më parë: **“O populli im! Kjo është vetëm një provë për ju!”**.

Më pas shtoi: **“Zoti juaj është i Gjithëmëshirshmi.”**.

Ishit zënë rob dhe Ai ju shpëtoi.

Ishit të burgosur dhe ju liroi.

Ishit të devijuar dhe ju udhëzoi.

Ishit të shpërndarë dhe ju bashkoi nën hijen e udhëheqjes së një burri të caktuar nga All'Ilahu.

Ishit injorantë dhe të devijuar. Ai hodhi mbi ju dritën e dijes dhe ju udhëzoi në rrugën e drejtë të monoteizmit: **“...prandaj ndiqmëni mua dhe dëgjoni urdhrin tim!”**.

A e keni harruar vëllanë tim Hazreti Musain (*Paqja qoftë mbi të!*) që mua më ka përcaktuar si zëvendës të vetin dhe juve ju ka obliguar që të më bindeni mua? Përse nuk e mbani premtimin dhe përse e shkelni besën? Përse e çoni veten në “luginën” e përhumbe?

Por Izrailitët këmbëngulnin me aq kokëfortësi në adhurimin e këtij viçi sa as logjika e fortë dhe argumentet e qarta

të këtij burri të caktuar nga All'illahu dhe udhëheqësi të dhembshur nuk ndikuan aspak në zemrat e tyre. Por ata shpallën qartaz kundërshtimin e tyre me Harunin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i thanë: **“Ne do t’i lutemi atij, derisa të na kthehet Musai.”**

Thënë shkurt idhujtarët thanë se kështu do të jetë, siç themi ne. Ne do të vijojmë me veprën e adhurimit të viçit deri në kthimin e Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe do të kërkojmë gjykimin e tij.

Mbase edhe vetë ai do të bjerë në sexhde së bashku me ne! Prandaj mos e mundo shumë veten dhe hiq dorë nga ne!

Në këtë mënyrë idhujtarët nëpërkëmbën edhe urdhrin e qartë të arsyes, edhe urdhrin e mëkëmbësit të udhëheqësit të tyre.

Por, siç janë shprehur komentuesit, në kohën që Hazreti Haruni (*Paqja qoftë mbi të!*) e kreu misionin e vet në këtë dyluftim dhe shumica nuk e pranuan, ai, së bashku me një pakicë të vogël pasues të tij, u nda nga turma. Mos vallë, përzierja me ta të konsiderohej një argument për nënshtrimin dhe pranimin e programeve të tyre devijuese?!

I çuditshëm është fakti që disa nga komentuesit e Kur'anit kanë transmetuar se këto transformime të devijuara tek Beni Izrailitët ndodhën brenda një periudhe të shkurtër. Vetëm pasi kishin kaluar 35 ditë nga largimi i Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) për në vendin e caktuar, Samiriu ia nisi punës dhe kërkoi që Izrailitët të grumbullonin të gjitha stolitë që i kishin huazuar nga faraonët dhe stolitë që kishin marrë pas pas mbytjes së tyre. Në ditën e tridhjetë e gjashtë, tridhjetë e shtatë dhe tridhjetë e tetë që të gjitha ato stoli i hodhi në një shkurre, i shkriu dhe formoi një

skulpturë prej viçi. Ditën e tridhjetë e nëntë i ftoi ata në adhurimin e tij. Një grup i madh (sipas disa transmetimeve gjashtëqind mijë persona) e pranuan atë. Ditën tjetër, pra, me përfundimin e dyzet ditëve, Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*), u kthye.¹

Por sidoqoftë, Haruni (*Paqja qoftë mbi të!*) me një pakicë të vogël, afro dymbëdhjetë mijë persona besimtarë, treguan qëndrueshmëri. U ndanë nga popullsia, megjithëse shumica injorante dhe kokëforte që ndodheshin rreth tyre ishin të gatshëm që t'i mbysnin.

Hulumtime

1- Kënaqësia e takimit

Për ata të cilët nuk janë në dijeni për euforinë dhe dashurinë ndaj Zotit të Madhëruar, ka mundësi që thënia e Hazreti Musait, në përgjigje të pyetjes së Zotit të Madhëruar në lidhje me nxitimin e tij drejt vendit të caktuar të jetë e çuditshme. Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: “...e unë nxitova te Ti, o Zoti im, për të fituar kënaqësinë Tënde.”.

Është e habitshme për disa që nuk e njohin gravitetin e dashurisë së All'Ilahut. Ndërsa ata të cilët e perceptojnë këtë realitet me gjithë qenien e tyre dhe që u afrohet koha e takimit me

¹ Mexhmaul Bejjan, ajeti në fjalë.

All'llahun, zjarri i dashurisë ndizet edhe më shumë në zemrat e tyre. Pikërisht, ata e dinë më së miri se çfarë force misterioze e tërhoqi Hazreti Musain (*Paqja qoftë mbi të!*) drejt vendit të caktuar të Zotit të Madhëruar dhe pse ai nxitonte aq shumë, saqë edhe njerëzit që ishin bashkudhëtarë me të mbeten mbrapa.

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) edhe para kësaj e kishte shijuar disa herë shijen e lutjes dhe të bashkimit me Zotin e Madhëruar. Ai e dinte që vlera e gjithë botës nuk është e barabartë me një moment të kësaj lutjeje.

Po, e tillë është rruga dhe tradita e atyre që e kanë tejkaluar dashurinë virtuale, dashurinë imagjinare dhe kanë arritur në gradën e dashurisë së vërtetë, kanë hedhur hapa në dashurinë e një të adhuruari të përhershëm, kanë pëqafuar dashurinë e Një Zoti të vetëm. Ai, Zoti i Madhëruar posedon të gjithë të mirët së bashku, Ai i posedon i vetëm, madje mirësia e të gjithë të mirëve është një dritë e vogël përballë mirësisë së Tij të përhershme. Prandaj, o Zoti ynë! Të lutem na bëj ne të shijojmë një grimcë nga kjo dashuri e shenjtë!

Në një transmetim Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të*) thotë: “Dashuruesi i flakët dhe i pasionuar as nuk ka dëshirë për t’u ushqyer, as nuk ndien kënaqësi nga konsumimi i pijeve të shijshme, as nuk ka gjumë të lehtë, as nuk lidh miqësi me ndonjë shok të ngushtë, as nuk ndihet i qetë në shtëpi ..., ai adhuron Zotin natë e ditë me shpresën që do të arrijë te Ai që ka mall, siç thotë Zoti i Madhëruar në lidhje me Hazreti Musain në vendin e

caktuar: “ ... e unë nxitova te Ti, o Zoti im, për të fituar kënaqësinë Tënde”.¹

2- Lëvizjet antirevolucionare kundrejt revolucionit të Profetëve

Zakonisht, kundrejt çdo revolucionit ekziston një lëvizje antirevolucionare, e cila orvatet të prishë dhe të rrënojë arritjet e revolucionit dhe kthimin e shoqërisë në periudhën e pararevolucionit. Arsyeja e kësaj nuk është edhe aq e ndërlikuar, sepse me realizimin e një revolucionit, të gjithë elementët e korruptuar të së kaluarës nuk zhduken menjëherë. Si rregull, nga ajo kohë mbeten “llume” dhe “ndyrësira” që ngrihen në këmbë për të mbrojtur ekzistencën e tyre dhe, në varësi të kushteve, të cilësisë dhe të sasisë së tyre, kryejnë akte antirevolucionare, qoftë fshehurazi, qoftë haptazi e në mënyrë të vazhdueshme.

Në revolucionin e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) drejt monoteizmit, drejt pavarësisë dhe lirisë së Izrailitëve, Samiriu ishte lideri i kësaj lëvizjeje reaksionare.

Ai, ashtu si të gjithë udhëheqësit dhe liderët e lëvizjeve reaksionare, edhe ai i njihte më së miri pikat e dobëta të popullit të vet. Ai e dinte që, po të shfrytëzoheshin këto pika të dobëta, mund të krijoheshin trazira. Prandaj u përpoq që nga stolitë e tyre, që idhujtarët i çmonin shumë, si të ishin hyjnitë e adhuruesve të kësaj bote, të krijonte një viç, që të ishte tërheqës për njerëzit e thjeshtë. Me një marifet të veçantë e pozicionoi në drejtim të erës që frynte,

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëllimi 3, faqe 388.

në mënyrë që nga ai të dëgjohej një zë. Më pas, duke shfrytëzuar mungesën disa ditore të Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe duke pasur parasysh faktin që Izrailitët pas shpëtimit nga deti dhe kalimit pranë një populli idhujtarë, kërkuar një idhull nga Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*).

Thënë shkurt, me përdorimin e të gjitha pikave të dobëta psikike dhe duke shfrytëzuar mundësitë e përshtatshme kohore dhe hapësinore ai e filloi programin e vet anti monoteistik. Ai vuri në zbatim me zell dhe përpikëri të gjithë elementët e programit brenda një kohe të shkurtër. Pjesën dërmuese të popullsisë injorante të Izrailitëve e devijoi dhe e shmangu nga rruga e drejtë dhe monoteiste dhe e çoi drejt politeizmit.

Ky komplot u neutralizua me rikthimin e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*). Ai, me fuqinë e besimit dhe të logjikës së tij, nën ndriçimin e dritës së shpalljes së All'llahut, arriti t'i mposhtë armiqtë. Por ç' do të ndodhte sikur Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) të mos ishte rikthyer? Sigurisht, vëllanë e tij, Harunin (*Paqja qoftë mbi të!*) ose do ta kishin vlarë, ose do ta kishin izoluar në mënyrë të atillë që zëri i tij të mos dëgjohej nga askush!

Çdo revolucion në fillim është i brishtë dhe i thyeshëm. Duhet një vigjilencë e plotë për ta mbrojtur atë, sepse edhe lëvizjet më të vogla reaksionare dhe politike duhen mbajtur nën vëzhgim dhe komplotet e armikut duhen asgjësuar që në rrënjë.

Duhet të kemi parasysh se shumë prej revolucioneve të drejta, për arsye nga më të ndryshmet, kanë dështuar. Prandaj duhet që të zbatohen egzakhtësisht dhe me rreptësi ligjet dhe rregullat përkatëse, pa asnjë lëkundje.

Shprehur ndryshe, kjo është një prej përgjegjësive të udhëheqësve dhe liderëve të drejtë. Kriteret me të cilat janë të pajisur vetë t'ia kalojnë edhe shoqërisë. Sigurisht që kjo kërkon një farë kohe, por duhet të përpiqemi që kjo periudhë të shkurtohet sa më shumë që të jetë e mundur.

Kush ishte Samiriu? Cili ishte fati i tij? Me vullnetin e Zotit të Madhëruar këto do t'i diskutojmë në ajetet në vijim.

3- Nivelet e udhëheqjes

Haruni (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk tregoi asnjë shenjë dobësie edhe pse mungonte Hazreti Musai (*Paqja qoftë mbi të!*), por injoranca e njerëzve nga njëra anë, llumi dhe fundërrinat e periudhës së robërisë e skllavërisë dhe idhujtarisë në Egjipt nga ana tjetër, i neutralizuan orvatjet e tij.

Në ajetet e lartpërmendura tregohet se ai e kreu misionin e vet në katër nivele dhe faza.

Së pari, ai ua bëri të qartë idhujtarëve se lëvizja e tyre ndjek një drejtim të devijuar dhe është një fushë e rrezikshme për të gjithë ata. Këtë sqarim ai e bëri që të zgjonte mendjet e njerëzve nga gjumi, të meditojnë dhe të reflektojnë mbi këto çështje. Kjo ishte shumë e rëndësishme: **“O populli im! Kjo është vetëm një provë për ju!”**.

Së dyti, në fazën tjetër ai u rikujtoi atyre begatitë e shumëllojshme të Zotit të Madhëruar. Ato begati i kishin shoqëruar ata që nga fillimi i kryengritjes së Hazreti Musait

(*Paqja qoftë mbi të!*) deri në kohën e shpëtimit nga kthetrat e Faraonit.

Haruni (*Paqja qoftë mbi të!*) ua përshkroi Zotin e Madhëruar me atributin e Mëshirës së Tij gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të ndikonte sa më shumë tek ata si dhe t'u ngjallte shpresat për faljen e tyre nga ato mëkate të mëdha: **"...Zoti juaj është i Gjithëmëshirshmi..."**.

Së treti, Haruni (*Paqja qoftë mbi të!*) ua bëri të qartë edhe pozitën e vet të profetësisë dhe të mëkëmbësisë së vëllait të tij, Hazretit Musa (*Paqja qoftë mbi të!*): **"...prandaj ndiqmëni mua..."**.

Në fazën e fundit, së katërti, në këtë fazë, Haruni (*Paqja qoftë mbi të!*) i njohu ata me përgjegjësitë e tyre para Zotit: **"...dhe dëgjoni urdhrin tim ..."**.

4- Përgjigja ndaj një kritike

Komentuesi i njohur i Kur'anit, Fakhri Razi, ka paraqitur një kritikë, për të cilën nuk ka ditur të gjejë përgjigje. Ai është shprehur në këtë mënyrë: "Ti ndaj meje je si Haruni ndaj Hazreti Musait".¹ Kjo i atribuohet vilajetit të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Përballë masës së madhe të idhujtarëve, Haruni asnjëherë nuk ia lejoi vetes "takijen" (maskimi). Ai qartazi i ftoi njerëzit që ta ndiqnin, ta pasonin dhe të hiqnin dorë nga ndjekja e të tjerëve.

Nëse ymeti i Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mi të dhe mbi familjen e tij!*) pas vdekjes së Tij, ndërmoi

¹ "Usulul Kafi", vëllimi 8, faqe 106.

rrugën e gabuar, për Imam Aliun ishte e obligueshme që të vepronte në të njëjtën mënyrë si Haruni (*Paqja qoftë mbi të!*), të hipte mbi minber dhe, pa asnjë lloj frike dhe shtirje, të pohonte: “Ndiqmëni mua dhe dëgjoni urdhrin tim”. Meqenëse nuk veproi në këtë mënyrë, për ne është e qartë që rruga dhe tradita e popullit në atë kohë ishte e drejtë dhe e saktë.

Por duket që Fakhri Raziu ka lënë pas dore dhe është treguar neglizhent ndaj dy çështjeve kryesore:

1- Së pari, ai ka thënë se Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka gabuar që nuk ka deklaruar ndonjë gjë në lidhje me hilafetin e tij të menjëhershëm. Ne disponojmë dëshmi të shumta që Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka folur për këtë çështje në raste të ndryshme. Ai ka folur ndonjëherë qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ndonjëherë në mënyrë të tërthortë dhe fshehurazi. Në librin “Nehxhul Belaga” gjejmë fjali të ndryshme (si për shembull fjalimi “Shekshekije” fjalimi i tretë, si dhe fjalimi 87, fjalimi 92, fjalimi 94, fjalimi 153, fjalimi 147), të cilat flasin në lidhje me këtë temë.

Në vëllimin e pestë të këtij tefsiri, ajeti 67, i sures “El Maide”, pas shpjegimit të ndodhisë së Gadirrit transmeton hadithe të shumta, të cilave, vetë Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), në mënyrë të përsëritshme, u është referuar, siç i është referuar edhe hadithit të Gadirrit për vërtetimin dhe aprovimin e pozitës dhe të kalifatit të tij të menjëhershëm.¹

2- Pas vdekjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), u krijuan kushte të favorshme

¹ Për më shumë informacion shih vëllimin e pestë faqe 19, e tutje.

për hipokritët. Ata kishin qenë në pritje të vdekjes së tij dhe numëronin ditët. Ata e kishin përgatitur veten për t'i dhënë Islamit të sapolindur goditjen përfundimtare. Prandaj, shohim se si “*As’habe redde*” (një grup kundër revolucionit islamik) në kohën e kalifatit të Ebu Bekrit u ngritën menjëherë në këmbë. Nëse nuk do të ishte uniteti, konsolidimi dhe zgjuarsia e myslimanëve, Islamit do t'i ishte dhënë një goditje e parikuperueshme. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), edhe për këtë shkak, u prapësua në mënyrë që armiku të mos abuzojë.

Hazreti Haruni (*Paqja qoftë mbi të!*), edhe pse Hazreti Musai ishte i gjallë dhe e kritikoi vëllain e tij, ai iu përgjigj qartë kritikës së tij duke i thënë: **“Unë kisha frikë se do të thojë: Ke mbjellë përçarje midis bijve të Izrailit e nuk i ke mbajtur porositë e mia.”**¹ Kjo tregon që edhe ai (Haruni) u tërhoq nga frika e përçarjes.

¹ Sure “Ta Ha”, ajeti 94.

Ajetet 92 - 98

قَالَ يَهْرُونَ مَا مَنَعَكَ إِذْ رَأَيْتَهُمْ ضَلُّوا ۖ أَفَلَا تَتَّبِعُنَّ ۚ أَفَعَصَيْتَ
 أَمْرِي ۚ قَالَ يَبْنَؤُمْ لَا تَأْخُذْ بِلِحْيَتِي وَلَا بِرَأْسِي ۚ إِنِّي خَشِيتُ أَنْ تَقُولَ
 فَرَّقْتَ بَيْنَ بَنِي إِسْرَءِيلَ وَلَمْ تَرْقُبْ قَوْلِي ۚ قَالَ فَمَا خَطْبُكَ
 يَاسْمُرِي ۚ قَالَ بَصُرْتُ بِمَا لَمْ يَبْصُرُوا بِهِ ۚ فَقَبَضْتُ قَبْضَةً مِّنْ أَثَرِ
 الرَّسُولِ فَنَبَذْتُهَا وَكَذَلِكَ سَوَّلَتْ لِي نَفْسِي ۚ قَالَ فَادْهَبْ
 فَإِنَّ لَكَ فِي الْحَيَوةِ أَنْ تَقُولَ لَا مِسَاسَ ۚ وَإِنَّ لَكَ مَوْعِدًا لَّنْ تُخْلَفَهُ ۚ
 وَانْظُرْ إِلَى إِلَهِكَ الَّذِي ظَلْتَ عَلَيْهِ عَاكِفًا لَّنُحَرِّقَنَّهُ ثُمَّ لَنَنْسِفَنَّهُ فِي الْيَمِّ
 نَسْفًا ۚ إِنَّمَا إِلَهُكُمُ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۚ وَسِعَ كُلَّ شَيْءٍ عِلْمًا



“(Musai) tha: ‘O Harun, ç’të pengoi ty, kur i pe ata se kishin humbur,’”

“që të vije tek unë?! A mos e kundërshtove urdhrin tim?”

“(Haruni) tha: ‘O biri i nënës sime, mos më kap për mjekre e as për koke! Unë kisha frikë se do të thoje: Ke mbjellë përçarje midis bijve të Izrailit e nuk i ke mbajtur porositë e mia.’”

“(Musai) tha: ‘Si është puna jote, o Samiri?’”

“(Samiriu) u përgjigj: ‘Unë pashë atë, që ata nuk e panë. Mora një grusht nga gjurmët e të Dërguarit dhe atë e hodha mbi viçin dhe kështu më nxiti vetja (e keqja) ime.’”

“(Musai) tha: ‘Atëherë ik!’ Tërë jetën do të të duhet të thuash: ‘Mos më prekni’. Por të është caktuar një premtim, i cili doemos do të zbatohet. Shikoje zotin tënd që ti e ke adhuruar vazhdimisht: Ne do ta djegim e pastaj do ta hedhim në det hirin e tij.”

“Në të vërtetë, Zoti juaj është vetëm All’llahu; s’ka zot tjetër përveç Tij; dituria e Tij përfshin çdo gjë”.

Komentimi

Fati i hidhur i Samiriut

Në ajetet që po diskutojmë në fillim do të flasim për bashkëbisedimin e Hazreti Musait me vëllanë, Harunin dhe më pas me Samirinë.

Ai në fillim u kthye nga vëllai i vet, Haruni dhe i tha: **“O Harun, ç’të pengoi ty, kur i pe ata se kishin humbur, që të vije tek unë?!”**.

Kur u nisa për tek vendi i caktuar a nuk të thashë: **“Më zëvendëso mua, drejto mirë popullin tim dhe mos e paso rrugën e të devijuarve dhe të këqijve?”**.¹

Përse, vallë, nuk e kundërshtove këtë idhujtari?

Shprehja *“en la tettebieni”* është përdorë me kuptimin: Përse nuk e pasove rrugën dhe metodën time në përballjen e ashpër me idhujtarinë?

Por, disa komentues të tjerë kanë pohuar se kuptimi i kësaj shprehjeje është ky: Përse nuk më shoqërove mua në malin Tur së bashku me pakicën e vogël, e cila kishte treguar devocion ndaj monoteizmit? Ky mendim është i papranueshëm dhe nuk përputhet me përgjigjen e Harunit (që jepet në ajetet vijuese).

Më pas shton: **“...a mos e kundërshtove urdhrin tim...?”**.

Hazreti Musai (*Paqja qoftë mi të!*) po bashkëbisedonte me të vëllanë, Harunin. Ishte shumë i nervozuar dhe i acaruar dhe i fliste me zë të lartë ndërkohë që e kishte kapur për koke dhe mjekre.

Haruni (*Paqja qoftë mi të!*), pa zemërimin e ashpër të të vëllait të vet, Hazreti Musait (*Paqja qoftë mi të!*). Për ta qetësuar atë, për t’ia shuar zemërimin si dhe për të shprehë justifikimin e vet në lidhje me këtë ngjarje, ndër të tjera tha: **“O biri i nënës sime, mos**

¹ Sure “El Araf”, ajeti 142 (Më zëvendëso mua te populli im dhe rregullo, e mos shko rrugës së të këqijve.)

më kap për mjekre e as për koke! Unë kisha frikë se do të thoje: Ke mbjellë përçarje midis bijve të Izrailit e nuk i ke mbajtur porositë e mia.”.

Në realitet, qëndrimi i Harunit përputhej plotësisht me porosinë e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mi të!*), që ia kishte thënë vëllait të vet para se të nisej për tek vendi i caktuar (në mal). Përmbajtja e saj ishte thirrja në rregullimin dhe administrimin e shoqërisë (sure “El Araf”, ajeti 142).

Ai dëshironte që të thoshte: Nëse unë do të përleshesha me ta, një gjest i tillë do të binte ndesh me urdhrin tënd dhe ti do të kishe të drejtë që të më fajësoje dhe të më qortoje!

Në këtë mënyrë Haruni (*Paqja qoftë mi të!*) e argumentoi pafajësinë e vet, sidomos duke patur parasysh shprehjen tjetër që është thënë në suren “El Araf”, ajeti 150, ku thuhet: **“... o bir i nënës sime, populli më mundi dhe gati më mbyti. Mos më konsidero mua me njerëzit mizorë.”.**

Hazreti Musa dhe Haruni (*Paqja qoftë mi të!*) ishin të dy Pejgamberë dhe të pagabueshëm. Atëherë lind pyetja: Si ka mundësi që Musai ta qortoje me fjalë të ashpra vëllanë e tij? Si të shpjegohet vetmbrojtja e Harunit?

Si përgjigje mund të themi: Hazreti Musa (*Paqja qoftë mi të!*) ishte plotësisht i vetëdijshtë për pafajësinë dhe pagabueshmërinë e vëllait të vet, Harunit (*Paqja qoftë mi të!*), por me anë të këtij veprimi donte që të argumentonte dy çështje:

Së pari, Izrailitëve t’ua bënte të qartë se janë përfshirë në një mëkat shumë të madh, në një mëkat i cili e kishte vënë para

gjykatës. Do të gjykohej një i dërguar me pozitë të lartë, si vëllai i tij, Haruni. Ky gjykim do të bëhej me një përballje tepër të ashpër me të. Pra, nuk është një çështje shumë e thjeshtë, siç mendonin Beni Izrailitët. Devijimi nga monoteizmi dhe rikthimi në politeizëm pas gjithë atyre mësimëve dhe njohurive si dhe pas vrojtimit të të gjithë atyre mrekullive dhe efekteve të madhështisë së Zotit është diçka e pabesueshme. Prandaj duhej treguar rezistencë karshi saj e bërë ballë me të, me një vendosmëri sa më të madhe.

Ndonjëherë ndodh që përballë një ngjarjeje të rëndë njeriu e kap jakën e vet dhe e godet kokën me duar. Kjo gjendje është më e vështirë kur i drejtohet vëllait të vet me aq shumë zemërim. Gjithçka bëhej për ruajtjen e qëllimit dhe për të ndikuar psikologjikisht tek njerëzit e devijuar, për t'u treguar atyre madhështinë e mëkatit. Për t'u treguar se sjellje të tilla janë me ndikim të madh. Nuk ka dyshim që dhe Haruni (*Paqja qoftë mi të!*) ishte dakord me këtë ngjarje. Sjellja e Musait e kishte pëlqimin e plotë të tij.

Së dyti, pafajësia e Harunit u bë e qartë për të gjithë që më vonë të mos e akuzojnë atë për neglizhencë dhe pakujdesi në kryerjen e misionit të vet.

Pas përfundimit të bashkëbisedimit me vëllanë e vet, Harunin (*Paqja qoftë mi të!*) dhe pas shfajësimit të tij, Musai filloi me gjykimin e Samirit. Musai (*Paqja qoftë mi të!*) tha: **“Si është puna jote, o Samiri?”**.

Ai në përgjigje tha: **“Unë pashë atë, që ata nuk e panë. Mora një grusht nga gjurmët e të Dërguarit dhe atë e hodha mbi vijn dhe kështu më nxiti vetja (e keqja) ime.”**.

Po çfarë synonte “Samiri” me këto fjalë?

Në mesin e komentuesve të Kur’anit spikasin dy komentime:

Së pari, kuptimi i fjalëve të tij është ky: Samiri thotë se në kohën e dislokimit të ushtrisë së Faraonit në afërsi të lumit Nil unë e pashë Xhebrailin të hipur mbi një mjet. Xhebraili i paraprinte ata për t’i stimuluar që të hynin në rrugët e thara të lumit. Unë mora një copë dhe’ prej këmbëve të tij apo të mjetit që e mbartte atë. Atë dhe’ e hodha në brendësi të viçit prej floriri. Zhurma që nxjerr viçi është efekt i atij dheu!

Komentimi tjetër është ky: që unë në fillim besova në një pjesë prej rekomandimeve të këtij të Dërguari të Zotit (Hazreti Musait). Më pas dyshova në të. Si rrjedhim, anova nga idhujtaria, se kjo më dukej më interesante dhe më tërheqëse!

Në komentimin e parë, fjala “*Rresul*” është në kuptimin e “Xhebrailit”, kurse në komentimin e dytë, termi “*Rresul*” është në kuptimin e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*).

Fjala “*el ether*” në komentimin e parë është në kuptimin e “dheut poshtë këmbëve”, kurse në komentimin e dytë është në kuptimin e “një pjesë e njohurive”.

Termi “*nebedhtuha*” në komentimin e parë është në kuptimin e hedhjes së dheut përbrenda viçit, kurse në komentimin e dytë është në kuptimin e heqjes dorë nga mësimet e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mi të!*).

Si përfundim, fjalia “**basartu bima lem jebsuru**” në komentimin e parë është aludim për Xhebrailin, i cili ishte shfaq

në formën e një kalorësi (ndoshta e panë dhe të tjerë, por nuk e njohën). Në komentin e dytë, aludon në njohuritë e veçanta rreth fesë së Hazreti Musait (*Paqja qoftë mi të!*).

Sidoqoftë, secili nga këto dy komentime ka ithtarët dhe përkrahësit e vet, të cilët kanë pika të qarta ose të paqarta. Por, në tërësi, komentimi i dytë nga njëra anë duket më i përshtatshëm dhe më i preferuar, sidomos nëse kemi parasysh hadithin, që është transmetuar në librin me titull “Ihtixhaxh” i Tabersiut, ku, ndër të tjera, thuhet: “Në kohën që Imam Aliu (*Paqja qoftë mi të!*) e pushtoi Basrën, njerëzit e rrethuan atë dhe në mesin e turmës ndodhej edhe Hasan Basriu, i cili kishte sjellë me vete disa pllaka, në të cilat shënonte çdo thënie dhe fjalë të Imam Aliut që i dëgjonte nga goja e tij. Imam Aliu e thirri atë me zë të lartë që të dilte përpara turmës së njerëzve dhe i tha: “Çfarë po bën”?!

Ai u përgjigj: “Po shkruaj dhe mbaj shënim punën dhe fjalët tuaja në mënyrë që t’ua ritregoj brezave të ardhshëm”. Imam Ali u tha: “Dijeni se çdo popull dhe çdo shoqëri ka një Samiri dhe ky burrë (duke bërë me shenjë nga Hasan Basri) është Samiriu i këtij populli! Dhe i vetmi dallim që e ka me Samiriun e kohës së Hazreti Musait është ky: Çdo kush që i afrohej Samiriut, ai i thoshte: “Mua askush të mos më prekë”, kurse ky i thotë popullit: “Nuk duhet luftuar...” (madje as me të devijuarit, është aludim për propagandën që Hasan Basri bënte kundër luftës së Xhemelit”).¹

Nga ky hadith kuptojmë që edhe Samiriu ishte një burrë hipokrit. Ai, me vënien në shfrytëzim të një pjese prej dijeve, të

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëllimi 3, faqe 392.

cilat e paraqisnin si njeri i drejtë, orvatej të devijojë njerëzit. Ky kuptim përputhet më shumë me komentimin e dytë.

Është e qartë që përgjigja dhe justifikimi i Samiriut kundrejt pyetjes së Hazreti Musait (*Paqja qoftë mi të!*) në asnjë mënyrë nuk ishte e pranueshme, prandaj Hazreti Musai e dënoi atë në këtë gjyq dhe ndaj tij dhe vërit të tij lëshoi tre urdhra:

Në fillim Musai (*Paqja qoftë mi të!*) e urdhëroi: **“Atëherë ik! Tërë jetën do të të duhet të thuash: ‘Mos më prekni.’”**.

Në këtë mënyrë, me anë të një urdhri të prerë, Samiriun e dëboi, e përjashtoi nga shoqëria dhe e çoi në izolim absolut.

Disa nga komentuesit e Kur'anit kanë thënë: Fjala **“la misas”** (mos më prekni) nënkupton një prej ligjeve penale të fesë së Hazreti Musait (*Paqja qoftë mi të!*) në lidhje me një pjesë të njerëzve, të cilët kishin kryer mëkat të rëndë. Një person i tillë ishte si një krijesë e cila ishte e papastër dhe e përlyer nga çdo pikëpamje. Asnjë nuk donte të kontaktonte me të dhe ai gjithashtu nuk kishte të drejtë që të kontaktonte me të tjerët.¹

Pas kësaj ngjarjeje, Samiriu u detyrua që të largohej nga mesi i popullit të Beni Izrailit. U detyrua të linte qytetin dhe vatanin e vet dhe të ikte në shkretëtirë. Ky është “shpërblimi” për njeriun me ambicie të sëmure, i cili, me anë të risive në fe, dëshironte që të devijonte dhe mblidhte rreth vetes një pjesë të gjerë të popullatës. Ai duhej që të dështonte. Duhej që askush të mos mbante kontakt me të. Për të tillë persona ky largim, ky dëbim absolut dhe izolim i plotë është më i dhimbshëm se sa

¹ Tefsiri “Fi Dhilalil Kur’an” vëllimi 5 faqe 494.

vdekja dhe ekzekutimi, sepse të gjithë e njohin si një krijesë të përljer, të papastër dhe të pisët nga çdo pikëpamje.

Disa komentues të tjerë gjithashtu kanë pohuar se: Pas qartësimit të krimit dhe gabimit të madh të Samiriut, Hazreti Musai (*Paqja qoftë mi të!*) e mallkoi atë. Zoti i Madhëruar e ndëshkoi atë me një sëmundje misterioze në mënyrë që derisa ishte gjallë askush nuk ishte në gjendje që ta prekte atë. Nëse ndokush kontaktonte me atë, infektohej nga sëmundja e tij.

Komentues të tjerë kanë thënë: Samiriun e preku një lloj sëmundjeje psikike në formë manie të ashpër dhe paranoje. Çdokujt që i afrohej atij, i bërtiste “mos më prekni”!¹

Penaliteti dhe dënimi i dytë i Samiriut ishte që Hazreti Musai (*Paqja qoftë mi të!*) ia përmendi ndëshkimin e tij në Kiamet duke i thënë: **“Ty të pret një cak i premtuar”**, premtimi i dënimit të dhimbshëm Hyjnor që asnjëherë nuk do të anulohet: **“Por të është caktuar një premtim, i cili doemos do të zbatohet.”**.

Penaliteti i tretë ishte që Hazreti Musai (*Paqja qoftë mi të!*) i tha Samiriut: **“Shikoje zotin tënd që ti e ke adhuruar vazhdimisht: Ne do ta djegim e pastaj do ta hedhim në det hirin e tij.”**.

Këtu lindin dy pyetje:

Së pari, fjalia **“Ienuhar’rikan’nehu”**, (Ne me patjetër atë do ta djegim), është argument që vërtetonte që viçi kishte një trup që digjej. Kjo vërteton bindjen e atyre njerëzve të cilët shpreheshin: viçi nuk ishte prej floriri, përkundrazi për shkak të dheut të

¹ Tefsiri “El Kurtubij”, vëllimi 6, faqe 4281.

këmbës së Xhebrailit ishte shndërruar në një krijesë të gjallë. Në përgjigje themi se kuptimi i fjalisë “**xheseden lehu khuarun**” është i qartë. Viçi ishte një skulpturë jo frymore që kishte një zë të ngjashëm me atë të viçit (ashtu siç e cekëm edhe më lart). Kurse djegia mund të ketë ndodhur nga njëri prej shkaqeve të mëposhtme:

Ose për shkak se kjo skulpturë nuk ishte vetëm prej floriri dhe ishte ndërtuar edhe prej lënde druri dhe floriri ishte thjesht si mbështjellje për të.

Së dyti, nëse imagjinojmë që i gjithë viçi ishte prej floriri, djegia e tij ishte për poshtërim, për fyerje dhe për t’ia zhdukur formën dhe pamjen e tij.

Si rrjedhojë, pas djegies, atë e copëtuan me anë të mjeteve prerëse dhe më pas, grimcat e tij i hodhën në det.

Pyetja tjetër që lind është kjo: Vallë, a lejohej hedhja e gjithë këtij floriri në det? A nuk konsiderohej shpërdorim?

Në përgjigje mund të themi se ndonjëherë ndodh që për një qëllim më të madh dhe më të rëndësishëm, (si për shembull eliminimi i idhujtarisë) është e nevojshme që me një idhull të veprohet në mënyrën e mësipërme. Por, mos vallë, mjetet e devijimit të mbeten në mesin e popullit dhe sërish të bëhen objekt i joshjes për një grup të caktuar njerëzish?

Shprehur më qartë, nëse Hazreti Musai (*Paqja qoftë mi të!*) nuk do të prekte floririn që ishte përdorur në krijimin e viçit ose ta ndante atë në mes njerëzve, sërish do të ishte e mundur, që një ditë, njerëz injorantë dhe të paditur, ta shihnin atë si diçka të

shenjtë. Në këtë mënyrë, në mendjet e tyre të ringjallej përsëri kujtesa e viçit.

Prandaj ishte e nevojshme që këtë lëndë të çmueshme ta sakrifikonin për të ruajtur besimin dhe fenë e njerëzve. Nuk kishte mënyrë tjetër, përveç kësaj. Hazreti Musai (*Paqja qoftë mi të!*), me një metodë të jashtëzakonshme dhe me vendosmërinë e lartë që tregoi, qoftë në lidhje me Samiriun, qoftë në lidhje me viçin e tij, ia doli që të zgjidhte problemin e adhurimit të viçit si dhe të fshijë nga mendjet e njerëzve ndikimet psikike të tij.

Me një sjellje të tillë vendimtare ndaj adhuruesve të viçit, ai ndikoi aq shumë në mendjet e Izrailitëve, të cilët, në të ardhmen, të mos ndjekin më këtë rrugë të gabuar dhe të devijuar.¹

Kurse në fjalinë e fundit Hazreti Musai (*Paqja qoftë mi të!*), me një theksim këmbëngulës lidhur me çështjen e monoteizmit, duke zbatuar udhën e Zotit të Madhëruar, u shpreh: **“Në të vërtetë, Zoti juaj është vetëm All’l-lahu, s’ka zot tjetër përveç Tij, dituria e Tij përfshin çdo gjë.”**

Zoti i Madhëruar nuk është si idhujt tuaj të rremë të cilët as nuk ju dëgjojnë e as nuk ju përgjigjen nevojave dhe kërkesave tuaja, as nuk zgjidhin ndonjë problem e as nuk ju mbrojnë nga ndonjë dëm.

¹ Ngjashëm me këtë ballafaqim vendimtar për të çrrënjosur mendimet devijuese në lidhje me xhaminë “*Dirar*” e vërejmë edhe në Kur’an dhe në transmetimet përkatëse në mënyrë më të detajuar, ku ndër të tjera lexojmë: Profeti urdhëroi që në fillim të digjnin xhaminë “*D’irar*” dhe pjesën e mbetur të saj ta rrënonin dhe vendndodhjen e saj ta shndërronin në vendgrumbullim të mbeturinave të njerëzve (për më shumë informacion shih në fund ajetet 107 -110 sure “Et Teube” në këtë komentim).

Fjalja: “...dituria e Tij përfshin çdo gjë...”, sqaron më së miri gjithçka u tha më sipër në disa ajete, në lidhje me viçin, me injorancën dhe pafuqinë e tij.

Hulumtime

1- Karshi ngjarjeve tronditëse duhet treguar rezistencë

Qëndrimi i Hazreti Musait (*Paqja qoftë mi të!*) kundrejt një devijimi të tillë si adhurimi i viçit nga ana e Izrailitëve, është një qëndrim që përshtatet për çdo kohë dhe çdo vend, në raste përballjesh me devijime të sofistikuara dhe të ndërlikuara.

Për të parandaluar qindra e mijëra idhujtarë të viçit Hazreti Musait (*Paqja qoftë mi të!*) nuk i mjaftonin vetëm këshillat dhe predikimi i mbështetur në disa argumente. Atij patjetër që i duhej të përballej me vendosmëri dhe rreptësi me këto tre probleme:

Me vëllain e vet,

Me Samiriun,

Me adhuruesit e viçit.

Përballjen e filloi me vëllanë e vet, Harunin (*Paqja qoftë mi të!*). Atë e tërhoqi për mjekre dhe koke dhe i fliste me zë të lartë. Në fakt, ngriti gjyq për të (edhe pse si përfundim pafajësia e tij u argumentua nga njerëzit) në mënyrë që të tjerët të marrin mësim.

Së dyti, gjeti faktorin kryesor të komplotit, pra, Samiriun. Atë e dënoi me dënime aq të rënda që ishin më të dhimbshme se sa mbytja.

Ata dënime ishin:

Dëbimi nga shoqëria.

Izolimi i tij.

Shndërrimi i tij në një krijesë aq të papastër dhe të ndyrë sa të gjithë duhet të mbanin distancë nga ai.

Kërcënimi me dënimet tronditëse të Zotit të Madhëruar.

Më pas, shkoi pas adhuruesve të viçit, pra, të Beni Izrailitëve dhe u tha: Ky mëkati i juaj është shumë i rëndë. E vetmja rrugë për t'u falur dhe për t'u penduar është që të nxirrni shpatat e të luftoni me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë një grup të vritet nga dora e grupit tjetër dhe këto gjakra të papastra të derdhen jashtë këtij komuniteti. Pra, një grup prej mëkatarëve të ekzekutohen me vetë duart e tyre, në mënyrë që ky mendim i devijuar dhe i rrezikshëm të fshihet përgjithnjë nga mendjet e tyre. Për më shumë në lidhje me këtë ngjarje kemi diskutuar në vëllimin e parë, në ajetet 51-54 të sures "El Bekare" me titull "Një pendim i pashembullt".

Pra, Hazreti Musai (*Paqja qoftë mi të!*), së pari shkoi pas udhëheqësit të popullit në mënyrë që të kuptojë a kishte faj dhe neglizhencë nga ana e tij karshi detyrës, apo jo. Pasi e vërtetoi pafajësinë e tij, shkoi pas faktorit të korrupsionit, dhe më në fund shkoi pas pasuesve dhe mbështetësve të korrupsionit.

2- Kush ishte Samiriu?

Thelbi i fjalës “Samirij” në gjuhën hebraike është “shimrij”. (është një traditë shkrimore, që, kur fjalët hebraike shkruhen në arabisht, mbaresa “-shin” shndërrohet në “-sin”, siç ka ndodhur me fjalën “Musha” që është shndërruar në “Musa”, ose fjala “Jeshu” në “Jesu”.

Samiriu i atribuohet Shemrunit dhe Shemruni është djali i Jeshakirit, brezi i katërt i Jakubit (*Paqja qoftë mi të!*).

Kjo dëshmon se **kritika** e disa të krishterëve ndaj Kur’anit Fisnik që thonin: Kur’ani e ka quajtur Samirij njeriun që e shpiku adhurimin e vëçit në kohën e Hazreti Musait (*Paqja qoftë mi të!*), Samirij i atribuohet qytetit “Es Samiretu”, **është e pabazë**. Ndërkohë nuk egzistonte një qytet me emrin “Es Samiretu”. Siç e trajtuam edhe më sipër, Samirij i atribuohet “Shemrunit” dhe jo “Es Samiretu”. ¹

Sidoqoftë, Samirij ishte një burrë egoist, i devijuar, dhe i zgjuar. Ai ishte i pajisur me një kurajë dhe marifet të veçantë. Kishte aftësinë që të përdorë me efikasitet pikat e dobëta të Izrailitëve. Me këtë mjeshtëri ai arriti që të krijonte një intrigë aq të madhe, sa që u bë shkak i prirjes së shumicës dërmuese drejt idhujtarisë dhe, ashtu siç e trajtuam, edhe u ndëshkua për shkak të këtij egoizmi dhe të thurjes së kësaj intrige.

¹ “A’lamul Kur’an”, faqe 359.

Ajetet 99 - 104

كَذَٰلِكَ نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ مَا قَدْ سَبَقَ وَقَدْ آتَيْنَاكَ مِنْ لَدُنَّا ذِكْرًا

﴿٩٩﴾ مَنْ أَعْرَضَ عَنْهُ فَإِنَّهُ يَحْمِلُ يَوْمَ الْقِيَمَةِ وِزْرًا ﴿١٠٠﴾ خَلِيدٍ فِيهِ

وَسَاءَ لَهُمْ يَوْمَ الْقِيَمَةِ حِمْلًا ﴿١٠١﴾ يَوْمَ يُنْفَخُ فِي الصُّورِ وَنَحْشُرُ الْمُجْرِمِينَ

يَوْمَئِذٍ زُرْقًا ﴿١٠٢﴾ يَتَخَفَتُونَ بَيْنَهُمْ إِنْ لَبِثْتُمْ إِلَّا عَشْرًا ﴿١٠٣﴾ هُنَّ أَعْلَمُ

بِمَا يَقُولُونَ إِذْ يَقُولُ أَمْثَلُهُمْ طَرِيقَةً إِنْ لَبِثْتُمْ إِلَّا يَوْمًا ﴿١٠٤﴾

“Kështu pra, Ne po të të tregojmë ty (o Muhammed) disa histori të së kaluarës. Ky (Kur'an) që të kemi dhënë, është një Këshillë nga ana Jonë.”

“Kush shmanget nga ai, në Ditën e Kiametit do të mbartë ngarkesë të rëndë.”

“Që do t’u mbetet përherë. Sa barrë e keqe që do të jetë ajo në Ditën e Kiametit!”

“Ditën, kur do të fryhet në Sur, pikërisht atë Ditë do t’i tubojmë të ligjtë me sy të zgurdulluar.”

“Duke i pëshpëritur njëri-tjetrit: ‘Ju keni qëndruar (në dynja) vetëm dhjetë ditë.’”

“Ne e dimë më mirë se ç’do të thonë ata (në Ditën e Kiametit), kur më i mençuri prej tyre do të thotë: ‘Ju keni qëndruar vetëm një ditë.’”

Komentimi

Ngarkesa më e keqe që do të mbartin mbi supe

Në ajetet e kaluara, u diskutua për historinë plot peripeci dhe aventura të Hazreti Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), të Izrailitëve, të Faraonit dhe të Samiriut. Në ato ajete u shtjelluan çështje të ndryshme, të cilat u sqaruan me anë të ajeteve kur’anore. Megjithatë, pas përfundimit të këtyre diskutimeve, Kur’ani i Madhërishëm nxori edhe një konkluzion të përgjithshëm ku thotë: **“Kështu pra, Ne po të të tregojmë ty, (o Muhammed) disa histori të së kaluarës...”**.

Më pas shton: **“Ky (Kur’ani) që të kemi dhënë, është një Këshillë nga ana Jonë.”**. Një Kur’an që është plot me mësimë këshillëdhënëse, plot me argumente racionale, me histori përvojash të popujve të kaluar dhe me çështje sensibilizuese për brezat e ardhshëm.

Parimisht, një pjesë e konsiderueshme e Kur’anit Fisnik është në lidhje me historitë e popujve të kaluar. Përmendja e gjithë këtyre historive të së kaluarës në Kur’an, i cili është një libër për vetrealizimin e njeriut, nuk është pa argument dhe pa ndonjë

arsye. Arsyeja e saj është përfitimi prej aspekteve të ndryshme të këtyre historive, të këtyre faktorëve të fitoreve dhe të humbjeve, të shkaqeve të lumturisë dhe fatkeqësisë si dhe përdorimi dhe shfrytëzimi i eksperiencave, përvojave të shumta, të cilat gjenden nëpër faqet e historive që i përcjell Kur'ani Famëlartë.

Është pranuar në tërësi se shkencat eksperimentale konsiderohen ndër shkencat më të besueshme, sepse rezultatet konkrete të tyre provohen në laboratorë dhe atëhere quhen të vërteta.

Historia është një laborator i madh i jetës njerëzore. Në këtë laborator çdo gjë vihet në provë, duke përfshirë këtu edhe ngritjet edhe rëniet e popujve, edhe sukseset edhe dështimet, edhe lumturitë edhe fatkeqësië, dhe rezultatet konkrete, përvojat e tyre fituese apo humbëse qëndrojnë para syve tanë.

Kështu që ne mundemi të njohim, të provojmë dhe të sigurojmë pjesën më të besueshme të diturive tona në lidhje me çështjet e jetës.

Shprehur ndryshe, esenca e jetës së njeriut nuk është gjë tjetër vetëm se eksperiencë e përvojë. Historia nëse në të është ruajtur e vërteta, është esenca e jetës së mijëra viteve të jetës së njerëzimit, e cila vihet në dispozicion të studiuesve.

Pikërisht për këtë arsye, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), në këshillat e urta të tij dhënë Imam Hasanit (*Paqja qoftë mbi të!*) është mbështetur në këtë çështje dhe thotë: *“Biri im, edhe nëse nuk arrita në moshën që e arritën ata para meje, i kam shqyrtuar veprat e tyre dhe kam menduar mbi ngjarjet nga jeta e tyre. Kam ndjekur gjurmët e tyre, ashtu që jam bërë si ata; në realitet, përmes asaj që kam mësuar nga ata më ngjan sikur kam jetuar me ta prej fillimit gjër në fund. Prandaj kam*

qenë në gjendje të dalloj atë që është e pastër nga ajo që është e fëlliqur dhe atë që është e dobishme nga ajo që është e dëmshme”.¹

Si rrjedhojë, historia është një pasqyrë e cila e tregon të kaluarën si dhe është një urë lidhëse e cila e bashkon të kaluarën me të sotshmen dhe jetën e njeriut e mat me kriterin e të vërtetës.

Historia është një mësues që e tregon dhe nxjerr në pah sekretin, ngritjen dhe rënien, humbjen e kombeve, i paralajmëron të padrejtët dhe shtypësit, personifikon fatin e hidhur të zullumqarëve të së kaluarës, të cilët kanë qenë më të fortë dhe më të fuqishëm se vetë ata, i përgëzon njerëzit e drejtë, fton në qëndrueshmëri dhe rezistencë, si dhe i inkurajon ata në rrugën e tyre.

Historia është një pishtar që e ndriçon rrugën e jetës së njerëzimit, i hap dhe i shtron rrugët për të lëvizur njerëzit e sotëm.

Historia është edukator për njerëzit e sotëm, kurse njerëzit e sotëm janë formues të historisë së të nesërmes.

Thënë shkurt, historia është një prej mjeteve të udhëzimit të All’l’lahut.

Por mos të ngatërrohemi. Shpesh, në shoqërinë njerëzore ka ndodhur që të jetë falsifikuar historia dhe këto shtrembërime janë paraqitur si vetë e vërteta e historisë me qëllim që të mashtrojnë njerëzit dhe t’i shmangin nga udha e Zotit të Madhëruar. Prandaj, nuk duhet të harrojmë se edhe në histori ekzistojnë shumë devijime.²

Gjithashtu është e nevojshme që të përmendim edhe faktin që fjala “*dhikr*” këtu dhe në shumë vende të tjera në Kur’an është

¹ “Nehxhul Belaga”, letra 31.

² Në lidhje me historinë dhe rëndësinë e saj kemi diskutuar më gjerësisht në fillim të sures “Jusuf” dhe në fund të saj. Po ashtu në ajetin 120 të sures “Hud”.

aludim për vetë Kur'anin, sepse ajetet e tij janë shkak i rikujtimit, i zgjimit dhe i vigjilencës.

Prandaj ajeti në vijim diskuton rreth atyre personave që lënë në harresë të vërtetat e Kur'anit dhe mësimet këshillëdhënëse të historisë. Ajeti thotë: **“Kush shmanget nga ai, në Ditën e Kiametit do të mbartë ngarkesë të rëndë...”**.

Është krejtësisht e vërtetë se mohimi dhe kundërshtimi i Zotit të Madhëruar e çon njeriun në rrugë pa krye dhe mbi supet e tij vë një ngarkesë të rëndë plot mëkate, plot devijime ideore dhe ideologjike. (vetë fjala “uizr” është përdorë në kuptimin e ngarkesës së rëndë dhe është një theksim edhe më i madh.)

Më pas shton se ata gjithnjë do të jenë midis veprave të tyre: **“...që do t’u mbetet përherë. Sa barrë e keqe që do të jetë ajo në Ditën e Kiametit!”**.

Duhet të kemi parasysh faktin që përemri “fijhi” në këtë ajet i referohet fjalës “uizr” që do të thotë “ata do të mbesin përgjithnjë në atë gjendje të ngarkuar me barrë dhe përgjegjësi të rëndë”. (nuk e shohim të nevojshme që edhe këtu të perifrazojmë dhe të themi se ata do të mbeten në dënime apo në Xhehennem.) Kjo tregon se njeriu në Ditën e Kiametit do të ndëshkohet apo do të shpërblehet sipas veprave dhe sjelljeve të veta që ka kryer në këtë botë.

Më pas, Kur'ani bën një përshkrim në lidhje me Ditën e Kiametit, me fillimin e saj dhe thotë: **“Ditën, kur do të fryhet në Sur, pikërisht atë Ditë do t’i tubojmë të ligjtë me sy të zgurdulluar...”**.

Ashtu siç e kemi trajtuar edhe më herët, nga ajetet kur'anore mësojmë se fundi i kësaj bote dhe fillimi i Botës Tjetër do të ndodhë me anë të dy lëvizjeve transformuese dhe befasuese. Për secilën prej tyre është përdorur shprehja **“kur të fryhet Suri”**.

Me dëshirën e Zotit të Madhëruar do të flasim më gjerësisht në suren **“Ez Zumer”**, në ajetin 68.

Fjala **“zurk”** është shumësi i fjalës **“ezrek”**. Kjo fjalë zakonisht përdoret me kuptimin e zgurdullimit të syrit. Por ndonjëherë është përdorur edhe në lidhje me personin, gjymtyrët e të cilit janë dëmtuar si pasojë e dhimbjes dhe vuajtjes së madhe, sepse trupi i njeriut përgjatë durimit të dhimbjes dhe vuajtjes bëhet i brishtë dhe i dobët si dhe e humbet freskinë dhe ujin e vet dhe duket i lig.

Disa të tjerë këtë fjalë e kanë pranuar me kuptimin e **“të qenët të verbër”**, sepse ndonjëherë ndodh që njerëzit me sy të zgurdulluar kanë dobësim shikimi të jashtëzakonshëm. Dobësimi i shikimit zakonisht shoqërohet edhe me thinjen e flokëve të tyre. Por ajo që e thamë më lart duket më e pranueshme, më e përshtatshme se të gjithë të tjerat.

Ndërkaq, tregohet se kriminelët diskutonin në lidhje me qëndrimin e tyre në botën e Barzakhut duke i pëshpëritur njëri-tjetrit: **“Ju keni qëndruar (në dynja) vetëm dhjetë ditë.”**.

Koha e qëndrimit të tyre në botën e Barzaxhat ka qenë një periudhë e gjatë, por kundrejt amshimit të Kiametit duket një periudhë shumë e shkurtër.

Fakti se kriminelët diskutojnë me zë të ulët mes tyre tregon se ata ose kishin shumë frikës nga Dita e Kiametit, ose ndjeheshin shumë të dobët dhe të pafuqishëm.

Disa komentues të tjerë kanë supozuar që kjo fjali mund të jetë aludim për qëndrimin e tyre në këtë botë. Koha e qëndrimit në këtë botë në krahasim me Kiametin dhe ngjarjet e tij tronditëse, konsiderohet sa disa ditë të shkurtëra të kësaj bote.

Më pas shton: **“Ne e dimë më mirë se ç’do të thonë ata (në Ditën e Kiametit)”,** qoftë duke pëshpëritur me zë të ulët, apo me zë të lartë. Nga mesi i tyre do të ngrihet njëri që konsiderohet si më i mençuri dhe më i zgjuari dhe do të thotë: **“Ju keni qëndruar vetëm një ditë...”**.

Pa dyshim, as një ditë dhe as dhjetë ditë nuk konsiderohen një periudhë e gjatë kohore. Në diskutimin e tyre bie në sy fakti që një aludon për numrin më të vogël prej njësheve, pra, përmendet “një ditë”, kurse në rastin tjetër përmendet numri më i vogël i dhjetësheve, pra, përmendet “dhjetë ditë”. Të dy rastet përmendin periudha shumë të shkurtëra kohore. Qoftë **“një ditë”**, apo qoftë **“dhjetë ditë”** është kohë shumë e shkurtër. Për ta sqaruar më mirë këtë çështje Kur’ani ka përdorë epitelin **“emthelehum tarikatun”**, sepse periudha e shkurtër e kësaj bote ose Barzakh, karahasuar me kohën e jetës së Ahiretit është shumë e vogël. Edhe ligësia e jetës së tyre në këtë botë kundrejt cilësisë së saj në Botën Tjetër shprehet me numrin më të vogël.

Ajetet 105 - 112

وَدَسَّٰلُونَاكَ عَنِ الْجِبَالِ فَقُلْ يَنْسِفُهَا رَبِّي نَسْفًا ﴿١٠٥﴾ فَيَذَرُهَا قَاعًا
 صَفْصَفًا ﴿١٠٦﴾ لَا تَرَىٰ فِيهَا عِوَجًا وَلَا أَمْتًا ﴿١٠٧﴾ يَوْمَئِذٍ يَتَّبِعُونَ
 الدَّاعِيَ لَا عِوَجَ لَهُ ۖ وَخَشَعَتِ الْأَصْوَاتُ لِلرَّحْمَنِ فَلَا تَسْمَعُ إِلَّا هَمْسًا
 ﴿١٠٨﴾ يَوْمَئِذٍ لَا تَنْفَعُ الشَّفَعَةُ إِلَّا مَنْ أَذِنَ لَهُ الرَّحْمَنُ وَرَضِيَ لَهُ قَوْلًا
 ﴿١٠٩﴾ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِهِ ۖ عِلْمًا ﴿١١٠﴾
 وَعَنْتِ الْوُجُوهُ لِلْحَيِّ الْقَيُّومِ ۖ وَقَدْ خَابَ مَنْ حَمَلَ ظُلْمًا ﴿١١١﴾ وَمَنْ
 يَعْمَلْ مِنَ الصَّالِحَاتِ وَهُوَ مُؤْمِنٌ ۖ فَلَا يَخَافُ ظُلْمًا وَلَا هَضْمًا ﴿١١٢﴾

“Kur të të pyesin ty (o Muhammed) për malet, thuaj: ‘Ato do t’i bëjë hi e pluhur Zoti im.”

“Ndërsa toka do të bëhet fushë e shkretë.”

“Nuk do të shohësh në të as lugina, as brigje.”

“Atë ditë, ata do të shkojnë pas thirrësit, pa iu shmangur dot atij dhe do t’i ulin zërat para të Gjithëmëshirshmit. Ti nuk do të dëgjosh tjetër, veç pëshpëritjes.”

“Atë ditë nuk do të bëjë dobi ndërmjetësimi i askujt, përveç ndërmjetësimit të atij, që i jep leje i Gjithëmëshirshmi dhe që i është pranuar fjala.”

“Ai e di ç’ka para tyre dhe ç’ka pas tyre, kurse ata nuk mund ta ngërthejnë dijeninë e All’liahut.”

“Fytyrat do t’i përulen të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të çdo gjëje dhe, sigurisht, do të humbë ai që do të mbartë padrejtësi.”

“Ndërsa ai që bën vepra të mira dhe është besimtar, nuk do të druajë nga padrejtësia, as nga pakësimi i asaj që i përket.”

Komentimi

Skenat tronditëse të Kiametit

Në ajetet e kaluara u diskutua për ngjarjet që shoqërojnë fundin e kësaj bote dhe fillimin e Kiametit. Edhe ajetet në vazhdim do të trajtojnë po këtë çështje.

Nga ajeti i parë prej ajeteve në fjalë, mësojmë se njerëzit e kishin pyetur Profetin në lidhje me fatin e maleve në momentet e fundit të botës. Ata e bënë këtë pyetje ngaqë nuk arrinin të besonin se krijesat madhështore, siç janë malet, rrënjët e të cilëve janë të ngulura në thellësi të Tokës dhe janë të drejtuara kah qielli mund të pësojnë dridhje dhe tronditje. Cila do të ishte ajo stuhi apo furtunë që mund të ketë aq fuqi sa për t’i lëvizur ato nga

vendi? Prandaj në ajet thuhet: **“Kur të të pyesin ty (o Muhammed) për malet, thuaj se ato do t’i bëjë hi e pluhur Zoti im.”**.

Nga tërësia e ajeteve kur’anore rreth fatit të maleve mësohet se ato, në prag të Ringjalljes, do të kalojnë nëpër faza të ndryshme:

Në fillim do të dridhen: **“Atë ditë kur toka e kodrat të dridhen, e kodrat bëhen rërë rrëshqitëse.”**¹

Në fazën tjetër do të fillojnë të lëvizin: **“Dhe kodrat të shkulen nga vendi e të ecin.”**²

Në fazën e tretë malet prishen dhe shndërrohen në një grumbull prej rërë: **“Atë ditë kur toka e kodrat të dridhen, e kodrat bëhen rërë rrëshqitëse.”**³

Në fazën e fundit stuhia dhe furtuna i vë ato në lëvizje dhe i shpërndan në ajër, në mënyrë të atillë që ngjasojnë me leshin e shprishur: **“Dhe kodrat bëhen si lesh i shprishur.”**⁴

Ajeti, në vijim, thotë: **“...ndërsa toka do të bëhet fushë e shkretë...”**⁵

¹ Sure “El Muzzemil”, ajeti 14.

² Sure “Et Tur”, ajeti 10.

³ Sure “El Muzzemil” ajeti 14.

⁴ Sure “El Karia”, ajeti 4.

⁵ Fjala “*El ka’au*” është në kuptimin e tokës së sheshtë dhe të rrafshët (pa mal dhe pyll) dhe disa atë e kanë komentuar si vendin në të cilin grumbullohet uji. Kurse në lidhje me fjalën “*safsafa*” është në kuptimin e tokës së sheshtë dhe nga këto dy përkthime përfitohet që në atë Ditë, malet dhe bimët, që të gjitha do të zhduken nga faqja e dheut dhe do të mbetet një tokë e sheshtë dhe e rrafshët.

Atë ditë nuk do të shohësh asgjë, as brigje, sa male as lugina: **“...nuk do të shohësh në të as lugina, as brigje.”**¹

Në këtë kohë thirrësi Hyjnor (engjëlli Israfil që i fryn bririt të Ringjalljes) do t'i ftojë të gjithë njerëzit në ringjallje. Të gjithë njerëzit do të mblidhen përpara Zotit dhe që të gjithë, në mënyrë të pashmangshme, do t'i përgjigjen Atij dhe do të pajtohen me thirrjen e Tij dhe do ta pasojnë Atë. **“Atë ditë, ata do të shkojnë pas thirrësit, pa iu shmangur dot atij...”**

Vallë, ky thirrës, a është Israfili apo një engjëll tjetër prej engjëjve të mëdhenj të Zotit? Kjo çështje nuk është përcaktuar qartë në Kur'an, por cilido qoftë ai, urdhri i tij është aq i vlefshëm saqë askush nuk ka të drejtë që ta kundërshtojë.

Fjala: *“la 'iuxhe”* ka gjasa që të jetë përshkrim për ftesën e këtij thirrësi, ose të jetë një përshkrim për nënshtrimin e të ftuarve, apo mund të përfshijë të dy kuptimet.

Interesant është fakti se ashtu sikur që sipërfaqja e tokës do të sheshohet dhe rrafshohet, po ashtu nuk do të mbetet asnjë gjë e shtrembërt. Edhe urdhri i All'Ilahut, edhe thirrësi do të jetë aq i drejtë, edhe pasimi, edhe ndjekja e tij do të aq e qartë, saqë në to nuk do të ketë asnjë lloj shtrembërimi. Në këtë kohë zërat do të përulen përpara madhësisë së Zotit të Mëshirshëm dhe përveç pëshpëritjeve, nuk do të dëgjohet zë tjetër: **“...dhe do t'i ulin zërat**

¹ Fjala *“'iuxh”* është në kuptimin e shtrembërimit, kurse fjala *“el emtu”* është në kuptimin e tokës së lartë dhe kodrës; si rrjedhojë, ajeti në tërësi mbart këtë kuptim dhe domethënie: në atë Ditë në tokë nuk do të shihet asnjë lloj lugine apo bregu.

para të Gjithëmëshirshmit. Ti nuk do të dëgjosh tjetër, veç pëshpëritjes.”¹

Kjo shuarje zërash ndodh ose për shkak të dominancës absolute të All’llahut në skenën e Ringjalljes, ose në mënyrë që të gjithë të përulen para Tij, ose për shkak të frikës së llogaridhënies dhe rezultatit të punëve që kanë kryer, ose apo që të gjitha së bashku.

Dihet se disa njerëz përpiqen ta mashtrojnë veten edhe pse janë të zhytur në mëkate. Ata përpiqen të gjejnë shpëtim me anë të ndërmjetësuesve. Ajeti menjëherë shton: **“Atë ditë nuk do të bëjë dobi ndërmjetësimi i askujt, përveç ndërmjetësimit të atij, që i jep leje i Gjithëmëshirshmi dhe që i është pranuar fjala.”.**

Me këtë nënkuptohet se ndërmjetësimi në Ditën e Kiametit nuk është pa rregulla. Përkundrazi, ka rregulla të përpiktë dhe të saktë, qoftë për ndërmjetësuesin, qoftë për personin që përfiton nga ndërmjetësimi derisa tek njerëzit nuk ekzistojnë merita dhe parakushte për ndërmjetësim. Në këtë rast ndërmjetësimi nuk ka kuptim.

E vërteta është se një grup njerëzish kanë mendime dhe nocione të gabuara në lidhje me ndërmjetësimin. Atë e konsiderojnë si nepotizmat e kësaj bote, ndërkohë që ndërmjetësimi, sipas logjikës islame, është një shkollë e lartë edukimi, është si një klasë provimi për ata që e tejkalojnë rrugën e drejtë me mundime dhe përpjekje. Këtë provë mund ta kalojnë

¹ Fjala “*el hemsu*” ashtu siç është shprehur edhe Ragibi në “El Mufredat” është në kuptimin e pëshpëritjes dhe bisedës së fshehur.

edhe ato që janë prekur nga mëkatet dhe gabimet, por këto gabime i kapërcejnë dhe i harrojnë.

Ndërmjetësimi shërben për ata si një forcë nxitëse dhe u thotë të mos dëshpërohen dhe të mos i humbin shpresat, por të vazhdojnë në rrugën e tyre që kanë nis, të mos heqin dorë nga përpjekjet dhe orvatjet në atë udhë. Dhe, nëse kryejnë ndonjë mëkat, ekzistojnë ndërmjetësues, që me lejen e Zotit të Mëshirshëm, mëshira e të Cilit është gjithëpërfshirëse dhe i përfshin të gjithë, do të ndërmjetësojnë për ju.

Ndërmjetësimi nuk është thirrje për dembelizëm, nuk është thirrje për t'u shmangur nga përgjegjësitë, nuk është as dritë jeshile për mëkatet. Ndërmjetësimi është thirrja në qëndrueshmëri, thirrje në rrugën e drejtë dhe në zvogëlimin e mëkatit, aq sa të jetë e mundshme.

Për këtë çështje kemi diskutuar në mënyrë të detajuar në vëllimin e parë, në ajetet 47-48 të sures "El Bekare". Kemi diskutuar edhe në vëllimin e dytë, në ajetin 255 të sures "El Bekare". Përsëri, gjykojmë se nuk është e tepërt që të rrëfejmë dhe një histori interesante:

Gjykimi i njerëzve në skenën e Kiametit bëhet sipas informacioneve të Zotit të Madhëruar lidhur me veprat dhe sjelljet e tyre. Për ta qartësuar më tej këtë çështje, në ajetin vijues thotë: **"Ai e di ç'ka para tyre dhe ç'ka pas tyre, kurse ata nuk mund ta ngërthejnë dijeninë e All'Ilahut."**

Përfshirja e dijes së Zotit është si në raport me veprat e tyre dhe me shpërblimin e tyre, sepse këto të dyja janë dy shtyllat e gjykimit objektiv dhe të drejtë. Gjykuesi ka dijeni të plotë si për

ngjarjet që kanë ndodhur në të kaluarën, ashtu edhe për penalizimin dhe shpërblimin e tyre.

Ditën e Kiametit të gjithë njerëzit do t'i përulen plotësisht të Përjetshmit: **"Fytyrat do t'i përulen të Gjallit, të Përjetshmit..."**.

Fjala *"el ant"* vjen nga rrënja *"an'uetu"* dhe është përdorë me kuptimin e përuljes dhe të poshtërimit. Prandaj edhe robin e quajnë *"a'ni"*, kur gjendet i përulur dhe i poshtëruar në dorën e armikut.

Nëse "përulja" është përshkrim për "vuxhuh", (fytyrat), ky kuptim është bërë për shkak se të gjitha fenomenet psikike, manifestohen më së pari, në fytyrën e njeriut.

Disa komentues të Kur'anit gjithashtu kanë supozuar, që termi "vuxhuh" është përdorë edhe në kuptimin e *"rua'sa"* (udhëheqësit dhe paria) të cilët, atë Ditë, do të përulen dhe poshtërohen si të gjithë, përpara Zotit të Lartësuar, por komentimi i parë duket më i përshtatshëm.

Përzgjedhja e attributeve *"el hajju uel kajjum"* prej attributeve të tjera të Zotit është bërë për shkak të përshtatshmërisë së këtyre dy attributeve me Ringjalljen, që është dita e jetës dhe ringjalljes për të gjithë.

Në fund të ajetit thuhet: **"...sigurisht, do të humbë ai që do të mbartë padrejtësi..."**.

Dhuna dhe padrejtësia janë një barrë e rëndë që rëndon mbi supet e njeriut dhe pengon ecjen e tij drejt begatave të përhershme të Zotit. Shtypësit dhe të padrejtët, që i shkaktojnë dhunë vetes së tyre dhe të tjerëve, shohin me sytë e tyre atë Ditë se

gjenden të privuar nga Xhenneti. Ata rrinë të gjunjësuar në afërsi të Xhennetit, të dëshpëruar dhe me një ndjenjë të thellë keqardhjeje.

Metoda e Kur'anit zakonisht është krahasimi i çështjeve. Atë Ditë përshkruhet fati i shtypësve dhe i zullumqarëve. Po Atë Ditë paraqitet edhe gjendja e besimtarëve. Për këtë çast ajeti thotë: **“Ndërsa ai që bën vepra të mira dhe është besimtar, nuk do të druajë nga padrejtësia, as nga pakësimi i asaj që i përket...”**¹

Shprehja *“mines salihat”* nënkupton se ata që nuk mundën të kryejnë të gjitha veprat e mira, së paku një pjesë prej veprave të tyre të jenë të mira. Besimi pa vepra të mira ngjason me një pemë pa fruta, ashtu siç vepra e mirë pa besim, ngjason me një pemë pa rrënjë, e cila edhe mund të mbijetojë për disa ditë, por në fund do të thahet. Për këtë arsye, pas veprës së mirë, është përmendur kushtëzimi i të qenit besimtar, *“ue hu'uel mu'min”* (dhe është besimtar).

Vepra e mirë nuk mundet të ekzistojë pa besim. Mund të ndodhë që ndonjëherë njerëz jobesimtarë të kryejnë vepra të mira. Kjo, pa dyshim, që do të jetë rast i kufizuar. Në mënyrë që vepra e mirë vazhdimisht të jetë e rrënjosur dhe e thellë duhet që të shoqërohet me bindje të pastër dhe besim të drejtë e të plotë.

¹ Fjala *“hadhmun”* nga ana leksikore është në kuptimin e “pakësimit”. Nëse tretjen e ushqimit në trup e konsiderojnë *“hadhmun”*, është për arsye se ushqimi pakësohet dhe mbeten mbeturinat e tij.

Hulumtime

1- Dallimi në mes “padrejtësisë” dhe “pakësimit”

Në fjalinë e fundit të ajeve të lartpërmendura lexuam se në Ditën e Kiametit besimtarët e drejtë nuk kanë frikë nga padrejtësia dhe as nga pakësimi.

Disa nga komentuesit e Kur’anit kanë deklaruar që me “padrejtësi” duhet të kuptohet që ata, Ditën e Gjykimit, njerëzit e drejtë asnjëherë nuk duhet të kenë frikë. Atyre nuk do t’u bëhet ndonjë padrejtësi, as nuk do të dënohen për ndonjë mëkat që nuk e kanë kryer.

Kurse me termin “pakësimi” këtu, ajeti nënkupton që besimtarët gjithashtu nuk kanë frikë as nga pakësimi i shpërblimeve të tyre, sepse e dinë që shpërblimi i tyre do t’iu jepet i plotë dhe pa ndonjë mangësi.

Disa komentues të tjerë kanë supozuar se në rastin e parë nënkuptohet se besimtarët nuk kanë frikë nga asgjësimi i të gjithë të mirave të tyre, në rastin e dytë nënkupton se ata, madje, nuk i frikësohen as pakësimit për nga sasia të të mirave të tyre, sepse llogaria e Zotit të Lartësuar është e saktë dhe e përpiktë.

Gjithashtu, ekziston edhe mundësia që këta besimtarë të drejtë, të cilët mund të kenë kryer edhe mëkate, besojnë se edhe këto mëkate janë të shënuara në mënyrë të saktë, pa i ekzagjeruar ato. Gjithashtu, edhe nga shpërblimi i veprave të tyre të mira nuk do t’u hiqet dhe as nuk do t’u pakësohet ndonjë gjë.

Komentimet e lartpërmendura nuk bien ndesh dhe nuk kundërshtojnë njëra-tjetrën. Ka mundësi që kuptimi i fjalisë së lartpërmendur të jetë gjithpërfshirës dhe përmbledhje e të gjitha këtyre kuptimeve.

2- Fazat e Ringjalljes

Në ajetet e lartpërmendura u diskutua në lidhje me një seri ngjarjesh të cilat do të shfaqen dhe realizohen në prag të Ringjalljes dhe pas saj:

1- Do të ringjallen të vdekurit: **“Ditën, kur do të fryhet në Sur...”**.

2- Do të tubohen dhe do të ringjallen mëkatarët dhe kriminelët: **“...pikërisht atë Ditë do t'i tubojmë të ligjtë...”**.

3- Do të rrafshohen malet dhe kodrat e më pas do të zvarriten kudo dhe faja e tokës do të bëhet e sheshtë dhe e rrafshët: **“Ato do t'i bëjë hi e pluhur Zoti im...”**.

4- Që të gjithë do të dëgjojnë thirrësin Hyjnor, do të shuhën të gjitha zërat dhe vetëm do të pëshpërisin mes tyre: **“Atë ditë, ata do të shkojnë pas thirrësit, pa iu shmangur dot atij dhe do t'i ulin zërat para të Gjithëmëshirshmit...”**.

5- Atë Ditë, ndërmjetësimi pa lejen e Zotit nuk do të ketë efekt: **“Atë ditë nuk do të bëjë dobi ndërmjetësimi i askujt, përveç ndërmjetësimit të atij, që i jep leje i Gjithëmëshirshmi...”**.

6- Zoti i Madhëruar me dijen e Tij të pafundme është në dijeni për çdo gjë rreth tyre: **“Ai e di ç’ka para tyre dhe ç’ka pas tyre...”**.

7- Që të gjithë do t’i dorëzohen dhe t’i përulen përpara gjykimit të Tij: **“Fytyrat do t’i përulen të Gjallit, të Përjetshmit...”**.

8- Të padrejtët do të humbin: **“...do të humbë ai që do të mbartë padrejtësi...”**.

9- Kurse besimtarët nuk do t’i humbin shpresat tek Zoti i tyre: **“...ai që bën vepra të mira dhe është besimtar, nuk do të druajë nga padrejtësia...”**.

Ajetet 113 - 114

وَكَذَلِكَ أَنْزَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا وَصَرَّفْنَا فِيهِ مِنَ الْوَعِيدِ لَعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ أَوْ
تُحَدِّثُ لَهُمْ ذِكْرًا ﴿١١٣﴾ فَتَعَالَى اللَّهُ الْمَلِكُ الْحَقُّ وَلَا تَعْجَلْ بِالْقُرْآنِ مِنْ
قَبْلِ أَنْ يُقْضَىٰ إِلَيْكَ وَحْيُهُ ۚ وَقُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا ﴿١١٤﴾

“Dhe kështu, Ne e kemi zbritur Kur'anin në gjuhën arabe dhe i kemi shpjeguar paralajmërimet, që ata t'ua vënë veshin.”

“I Lartësuar qoftë All'Ilahu, Sunduesi i Vërtetë! Mos nxito për ta lexuar Kur'anin para se të përfundojë shpallja e tij dhe thuaj: ‘O Zoti im, shtoma dijeninë!’”

Komentimi

Thuaj: O Zoti im, shtoma diturinë!

Ajetet e lartpërmendura në fakt janë një përmbledhje që nënkupton tërësinë e atyre që u thanë në ajetet paraprake lidhur

me vlerat edukative të Ditës së Kiametit dhe të premtimeve e paralajmërimeve të All'llahut.

Ajeti i parë thotë: **“Dhe kështu, Ne e kemi zbritur Kur'anin në gjuhën arabe dhe i kemi shpjeguar paralajmërimet, që ata t'ua vënë veshin.”**.

Fjala *“kedhalike”* përdoret për të treguar temat që janë trajtuar para këtij ajeti. Është njësoj sikur njeriu t'i tregojë një personi tjetër një udhëzim sipas të cilit duhet të veprojë dhe më pas të shtojë: *“kështu duhet vepruar”*. Në këtë rast nuk është e nevojshme të ketë interpretime të tjera, (siç kanë bërë disa nga komentuesit këtu dhe që komentet e tyre mbeten larg kuptimit të ajetit).

Fjala *“arabij”* përdoret me kutpimin e elokuencës, të rrjedhshmërisë dhe të qartësisë së kuptimeve kur'anore:

Së pari, në parim, sipas gjuhëtarëve të botës, gjuha arabe konsiderohet si një prej gjuhëve më elokuente, më shprehëse dhe letërsia e saj konsiderohet si letërsi mjaft e pasur dhe me shumë mundësi ndërtimesh stilistikore, plot ngarkesa emocionale etj.

Së dyti, fraza *“sarafna”* përdoret për shpjegimet e ndryshme që Kur'ani shpalos lidhur me një realitet të caktuar, si për shembull, lidhur me çështjen e ndëshkimit dhe të dënimit të kriminelëve, etj. Ndonjëherë shpjegimet i shoqëron me nënkuptime, i vesh me petkun e tregimeve të historisë së popujve të kaluar, ndonjëherë duke iu drejtuar të pranishmëve, ndonjëherë në formën e përshkrimit të gjendjes së tyre në skenën e Kiametit dhe ndonjëherë në forma të tjera.

Fjala *“leal’lehum jet’tekun”* dhe fjalia *“juhdithu lehum dhikra”* kanë dallime kuptimore. Fjalia e parë synon të tregojë se qëllimi kyesor i saj është formimi i devotshmërisë në mënyrë të plotë. Fjalia e dytë qartëson se nëse nuk realizoni devotshmërinë e plotë, së paku të krijoni një ndërgjegjësim dhe zgjim të vetëdijes, e cila në të ardhmen të shndërrohet në burim të emancipimit dhe lëvizjes (drejt së Vërtetës).

Gjithashtu, ekziston edhe kjo mundësi që fjalia e parë të jetë aludim për realizimin e devotshmërisë për njerëzit jo të devotshëm, kurse fjalia e dytë të jetë aludim për përmendje dhe vigjilim për të devotshmit, ashtu sikur thuhet në ajetin e 2-të të sures “El Enfal” ku lexojmë: **“E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur përmendet All’l-lahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre.”**.

Ajeti i lartpërmendur përmban dy prej parimeve kryesore të të mësuarit dhe të të edukuarit:

Parimi i parë është të folurit qartë dhe rrjedhshëm, leximi i këndshëm, bukur dhe plot hijeshi i shprehjeve kur’anore.

Parimi i dytë është përdorimi i larmishëm i shprehjeve të fjalëve me qëllim që ato të mos bëhen monotone, të përsëritshme dhe të lodhshme, por të depërtojnë dhe të ndikojnë te zemra e njeriut.

Në ajetin vijues thuhet: **“I Lartësuar qoftë All’l-lahu, Sunduesi i Vërtetë!”**.

Ka gjasa që përmendja e fjalës “*hakk*” pas fjalës “*el melik*” të jetë për arsye se njerëzit zakonisht kanë një ndjeshmëri jo të mirë në lidhje me fjalën “*melik*”, (sulltan), e cila në mendjen e tyre ka mbetur si personifikim i padrejtësisë, i dhunës dhe i tiranisë, prandaj menjëherë shton: **“All’Ilahu, Sunduesi i Vërtetë!”**.

Siç dihet, Profeti i Islamit nga dashuria e zjarrtë që kishte për nxënien e Kur’anit dhe përcjelljes së Tij te njerëzit, nxitonte në kohën e shpalljes dhe nuk lejonte që Xhebraili të përfundonte artikulin e ajeteve në mënyrë të plotë. Por vazhdimi i këtij ajeti këshillon: **“Mos nxito për ta lexuar Kur’anin para se të përfundojë shpallja e tij dhe thuaj: ‘O Zoti im, shtoma dijeninë!’”**.¹

Edhe nga disa ajete të tjera kur’anore gjithashtu tregohet se Profeti i Islamit, në momentin e shpalljes së Kur’anit, donte të nxitonte në pranimin e shpalljes. Por ajeti thotë: **“Ti (Muhammed) mos e shqipto atë (Kur’anin) me gjuhën tënde për ta nxënë atë më shpejtë! Sepse Ne e kemi për detyrë tubimin dhe leximin e tij! e kur ta lexojmë atë ty, ti përcille me të dëgjuar leximin e tij.”**.²

¹ Zoti ka urdhëruar kërkimin dhe përvetësimin e diturisë, sepse dituria është një det i pafund. Ai na ka këshilluar për ta marrë diturinë në baza të shëndosha dhe na ka dërguar Profetë, për të na dhënë dituri të saktë e të qartë. Po ashtu, Ai na ka këshilluar që të mos flasim pa argumente dhe pa baza të shëndosha. Andaj, dituria me hamendje nuk mund të pranohet (shënim i përkthyesit).

² Sure “El Kijame”, ajetet 16-18.

Hulumtime

1- Mos u nxito as në pranimin e Shpalljes

Fjalitë e fundit përmbajnë mësimet të vëra. Mes tyre shquhet ndalimi i nxitimit në momentin e mësimin dhe të marrjes të shpalljes.

Shpesh është vërejtur që disa njerëz, akoma pa mbaruar fjalën ligjëruesi, fillojnë me përsëritjen apo plotësimin e saj. Kjo, nganjëherë buron nga mungesa e durimit, ndonjëherë nga mburrja dhe shprehja e egos. Por ndonjëherë buron nga dashuria e madhe dhe e zjarrtë për nxënien e një çështjeje ose kryerjen e një misioni të shenjtë, i cili e motivon njeriun në kryerjen e veprave të mira.

Por, “nxitimi” shpesh krijon probleme. Prandaj në ajetet e lartpërmendura nxitimi është i ndaluar, edhe kur është me qëllim të drejtë. Ky është parim që veprat të mos kryhen nxitimthi, sepse do të shoqëroheshin me të meta dhe mangësi. Puna e Profetit duhet të jetë e ruajtur nga mangësitë dhe gabimet. Ai duhet të jetë model dhe shembull për njerëzit, në çdo aspekt, në mënyrë që njerëzit të kuptojnë qartazi se nuk duhet nxituar për asnjë çështje. Kur nuk duhet të nxitohemi për pranimin e shpalljes, atëherë përgjegjësia jonë karshi punëve të tjera (për nga pikëpamja e nxitimit) është më se e qartë.

Sigurisht, nuk duhen ngatërruar termit “nxitim” dhe “shpejtësi”. Shpejtësia do të ishte e pranuar kur të kishim një program të përpiluar me përpikëri dhe në mënyrë të plotë, ku të

gjithë çështjet të jenë marrë në konsideratë e do ta zbatonim pa humbur kohë. Kurse nxitim do të ishte, kur programin akoma të pa shqyrtuar dhe të pa përpiluar në mënyrë të plotë, të pa plotësuar me kujdes të nxitonim për ta vënë në jetë.

Për këtë arsye shpejtësia është e dëshirueshme, kurse nxitimi është i padëshirueshëm.

Në komentimin e këtij ajeti ekzistojnë edhe mendime të tjera, si për shembull: Profeti, për shkak të vonesës së shpalljes, nxitonte. Ajeti e mëson atë duke i thënë: *“Mos nxito, Ne në kohën e duhur do të të shpallim ty atë që është e nevojshme.”*.

Disa të tjerë kanë deklaruar se ajetet kur'anore i zbritën Profetit dy herë. Herën e parë i zbritën brenda një nate dhe ajo natë është Nata e Kadrit. Hera e dytë përfshin zbritjen e ajeteve në mënyrë graduale përgjatë 23 viteve të thirrjes. Prandaj Profeti, në kohën e shpalljes së ajeteve në mënyrë graduale, ndonjëherë nxitonte dhe e paraprinte Xhebrailin. Por Kur'ani e urdhëron atë që mos të nxitonte dhe të linte që secila zbritje të përfundojë në kohën e vet (në mënyrë graduale).

Por komentimi i parë duket më i përshtatshëm.

2- Të jesh insistues në shtimin e diturisë

Ndalimi i nxitimit në pranimi e Shpalljes mund të krijojë iluzionin se është ndaluar përfitimi i diturisë së tepërt. Zoti me anë të fjalisë: **“O Zoti im, shtoma dijeninë!”** ka hedhur anash këtë iluzion dhe këtë mendim. Kjo lë të nënkuptohet se nxitimi nuk

është i lejuar, kurse përpjekjet për të shtuar dituritë është e nevojshme.

Disa nga komentuesit e Kur'anit kanë supozuar që në fjalinë e parë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është urdhëruar që të mos nxitonte në kuptimin e gjithanshëm të ajeteve kur'anore, para shpjegimit të tyre me ajetet e tjera, kurse në fjalinë e dytë është urdhëruar që të kërkonte nga Zoti i Lartësuar më shumë njohuri në lidhje me dimensionet e ndryshme të ajeteve kur'anore.

Kur Profeti, që zotëronte dituritë të bollshme, ishte i obliguar që deri në fund të jetës të kërkojë nga Zoti shtimin e dijes, obligimi i njerëzve të tjerëve në këtë drejtim është plotësisht i qartë. Sipas doktrinë së Islamit, dija nuk njihet asnjë lloj limiti dhe kufizimi. Por kjo nuk do të thotë që të mos kërkojë shtimin e saj në vijimësi për shumë çështje tjera.

Dija nuk ka kufi hapësinorë. Ajo duhet kërkuar në tokë dhe në qiell, kudo dhe kurdo.

Dija nuk ka një kufi kohor, vazhdon nga djepi gjer në varr.

Edhe për mësuesit dija nuk ka kufij. Dijen e mëson nga çdo njeri që e mbart atë. Edhe nga një gojë e papasstër po të binte një perlë, pranoje atë.

Dija gjithashtu nuk njihet asnjë kufij as nga përpjekjet e shumta për të. Njeriu hyn në thellësi të detit për ta kërkuar dhe për ta fituar atë, madje mund edhe të sakrifikojë edhe jetën në emër të dijes.

Në këtë mënyrë, në logjikën islame, termi “diplomim” është një koncept i pakuptimtë. Për një mysliman të vërtetë, nxënia e dijes asnjëherë nuk përfundon. Ai mbetet gjithë jetën student dhe në kërkim të dijes, madje edhe në qoftë se është profesori më i mirë.

Sërish në një hadith tjetër, po nga Profeti, lexojmë: “Njeriu më i ditur prej njerëzve është ai i cili ia shton dijen e të tjerëve dijes së vet. Njeriu më i çmueshëm është ai i cili është më i dijsmi nga të tjerët, kurse njeriu më i pavlerë është ai dija e të cilit është më e paktë se e gjithë të tjerëve.”¹

Kjo është vlera e dijes sipas pikëpamjes dhe këndvështrimit të mësimave islame.

¹ “Sefinetul Bihar”, vëllimi 2, faqe 219. (kapitulli i dijes).

Ajetet 115 -122

وَلَقَدْ عَهِدْنَا إِلَىٰ آدَمَ مِن قَبْلُ فَنَسَىٰ وَلَمْ نُحِذِّ لَهُ عَزْمًا ﴿١١٥﴾ وَإِذْ قُلْنَا
 لِلْمَلَكِيَّةِ اسْجُدُوا لآدَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ أَبَىٰ ﴿١١٦﴾ فَقُلْنَا يَنَادِمُ
 إِنَّ هَذَا عَدُوٌّ لَّكَ وَلِزَوْجِكَ فَلَا يُخْرِجَنَّكَ مِنَ الْجَنَّةِ فَتَشْقَىٰ ﴿١١٧﴾ إِنَّ
 لَكَ إِلَّا جُوعَ فِيهَا وَلَا تَعْرَىٰ ﴿١١٨﴾ وَأَنَّكَ لَا تَظْمَأُ فِيهَا وَلَا تَصْحَىٰ ﴿١١٩﴾
 فَوَسَّسَ إِلَيْهِ الشَّيْطَانُ قَالَ يَنَادِمُ هَلْ أَذْلَكَ عَلَىٰ شَجَرَةِ الْخُلْدِ وَمُلْكٍ
 لَا يَبْلَىٰ ﴿١٢٠﴾ فَأَكَلَا مِنْهَا فَبَدَتْ لَهُمَا سَوْآتُهُمَا وَطَفِقَا مَخْصِفَانِ
 عَلَيْهِمَا مِن وَرَقِ الْجَنَّةِ ۚ وَعَصَىٰ آدَمُ رَبَّهُ فَغَوَىٰ ﴿١٢١﴾ ثُمَّ أَجْتَبَاهُ رَبُّهُ
 فَتَابَ عَلَيْهِ وَهَدَىٰ ﴿١٢٢﴾

“Ne bëmë besëlidhje edhe me Ademin më parë, por ai harroi, sepse nuk ishte i vendosur.”

“Kur u thamë engjëjve: ‘Përluni në sexhde para Ademit’, të gjithë u përlën, përveç Iblisit, i cili nuk pranoi.”

“Pastaj thamë: ‘O Adem, me të vërtetë që ky është armiku yt dhe i gruas sate, prandaj mos e lini t’ju nxjerrë kurrresi nga Xhenneti, se pastaj do të vuani në mjerim!’”

“Këtu nuk do të mbetesh kurrë as i uritur e as i zhveshur.”

“Dhe nuk do të kesh as etje, as vapë.”

“Por djalli e cyti: ‘O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?’”

“Kështu, ata të dy, (Ademi dhe Havaja), hëngrën nga ajo pemë e u ndërgjegjësuat për lakuriqësinë e tyre, prandaj nisën të mbulohen me gjethe të Xhennetit. Ademi nuk e zbatoi urdhrin e Zotit të vet, kështu që devijoi (nga rruga e drejtë).”

Komentimi

Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe mashtrimi i djallit

Pjesa kryesore e kësaj sureje i është kushtuar historisë së Hazreti Musasit dhe Beni Izrailitëve dhe luftës së tyre me Faraonin dhe ndjekësit e tij.

Në ajetet e lartpërmendura dhe ajetet që do të vijnë më pas do të flitet për historinë e Hazreti Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të Havasë dhe armiqësinë e djallit me ta.

Lufta mes të drejtës dhe të padrejtës, apo falsitetit nuk i përket vetëm luftës së Musait me Faraonin. Kjo luftë ka egzistuar që në fillim të krijimit të Hazreti Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe vazhdon dhe më tej.

Ngjarja e Hazreti Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe djallit, Iblisit, është përmendur shumë herë në Kur'an. Por çdo herë është ndërthurur edhe me çështje të reja. Ngjarja në fillim flet për besëlidhjen e Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) me Zotin e Madhëruar: **“Ne bëmë besëlidhje edhe me Ademin më parë, por ai harroi, sepse nuk ishte i vendosur...”**.

Cili ishte synimi i kësaj besëlidhjeje? Disa kanë deklaruar se synon të tregojë urdhërin e Zotit të Lartësuar për të mos iu afruar pemës së ndaluar. Këtë interpretim e konfirmojnë edhe transmetime të tjera të shumta.

Komentues të tjerë kanë paraqitur dhe mundësi të tjera, të cilat mund t'i konsiderojmë si rrjedhime të këtij kuptimi. Ata janë paralajmërimi që Zoti i Madhëruar i bëri Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) se djalli është armiku i tij i përbetuar dhe kurrë nuk duhet ta ndjekë, ta pasojë atë.

Fjala “*nisjan*” është pëdorë në kuptimin e harresës absolute. Kur ndodh që një njeri harron krejtësisht për diçka, ai nuk duhet të fajsohet apo qortohet. Por, atij, sigurisht që i themi: Sikur paske harruar premtimin e dhënë. Pra, vetëm ia kujtojmë. Në këto raste, shkelja e premtimit i ndodh nga harresa, ndaj nuk duhet gjykuar.

Harresa mund të ndodhë edhe për shkaqe të tjera, si: mungesa e vëmendjes së mjaftueshme, neglizhenca, pakujdesia etj.

Fjala “*azm*” shpreh një vendim dhe vullnet të fortë që e mbron njeriun kundrejt nxitjes së fuqishme djallëzore.

Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ishte i përlyer në ndonjë mëkat. Ai kishte bërë vetëm një gabim. Kishte shkellë rekomandimin për periudhën e qëndrimit të Tij në Xhennet. Periudha e qëndrimit të Hazreti Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) në Xhennet nuk ishte periudha e përgjegjësisë, por ishte periudha e sprovimit për t’u shtruar njerëzve rrugën për jetën në këtë botë dhe pranimin e përgjegjësive të detyrave të cilat janë detyrim.

Duhet marrë parasysh fakti që ndalimi që Zoti i Madhëruar i bëri Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte aspekt udhëzues, sepse atij, (Ademit) i pati thënë: Nëse ha nga pema e ndaluar, patjetër që do të mundohesh së tepërmi.¹

Më pas rrëfen pjesën tjetër të këtij tregimi dhe thotë: **“Kur u thamë engjëjve ‘Përluni në sexhde para Ademit’, të gjithë u përlën, përveç Iblisit, i cili nuk pranoi.”**

Këto fakte e bëjnë të qartë më së miri pozitën madhështore të Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*). Atij iu përlën të gjithë engjëjt dhe respektohej nga këto krijesa madhështore të Zotit të Lartësuar. Edhe armiqësia e Iblisit me atë u qartësua që në hapin e parë. Iblisi asnjëherë nuk u përl përpara madhësisë së Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Rënia në sexhde në kuptimin e adhurimit i përket vetëm Zotit. Përveç Atij askush dhe asgjë nuk mund të jetë objekt

¹ Përshkrimin e të gjitha këtyre si dhe synimin e shprehjes “*shexheretul memnuatu*” (pema e ndaluar) dhe të ngjashme me të e kemi bërë në vëllimin e gjashtë, faqe 115 e tutje, ajetet 19 deri në 22 të sures “*El A’raf*”.

adhurimi. Prandaj, rënia në sexhde e engjëjve ishte për Zotin, për hir të krijimit të kësaj krijese madhështore. Ai e meriton lavdërimin, i cili bën një formë aq të bukur nga uji dhe balta!

Ose, sexhdja këtu është në kuptimin e përluljes dhe respektit.

Ajeti, në kohën kur paralajmëron Ademin (*Paqja qoftë mbi të!*), thotë: **“Pastaj thamë: ‘O Adem, me të vërtetë që ky është armiku yt dhe i gruas sate, prandaj mos e lini t’ju nxjerrë kurrsesi nga Xhenneti, se pastaj do të vuani në mjerim!’”**

Fjala “*Xhennet*” këtu nuk është në kuptimin e Xhennetit të përhershëm, në Botën e Përtejme. Xhenneti është një kulm përsosmërie dhe nuk ka kthim mbrapa prej atje.

Ky Xhennet ishte një kopsht në të cilin gjendeshin të gjitha frutat e kësaj bote. Në sajë të mirësisë së Zotit, në të nuk ekzistonte as shqetësimi më i vogël, prandaj Zoti i Madhëruar e paralajmëroi Hazreti Ademin (*Paqja qoftë mbi të!*) duke i thënë se, nëse dilni nga ky vend i sigurt dhe i mbrojtur, do të përballeni me vështirësi të mëdha.

Fjala “*teshka*” rrjedh nga rrënja “*shekauet*” dhe një prej kuptimeve të kësaj fjale është stërmundimi dhe vuajtja.

Këtu lind pyetja se përse Zoti i Madhëruar në fillim iu drejtua të dyve, Hazreti Ademit dhe Havasë duke u thënë: “*Jukhrixhen'nekuma minel Xhen'neti*”, **“prandaj mos e lini t’ju nxjerrë (ju të dy) kurrsesi nga Xhenneti”**, kurse për pasojën e nxjerrjes së tyre i është drejtuar Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) duke i thënë: “*feteshka*” (se pastaj do të vuash ti, o Adem).

Ky ndryshim nënkupton faktin që dhimbjet dhe vuajtjet, në radhë të parë do të binin mbi Ademin (*Paqja qoftë mbi të!*), sepse ai e kishte për detyrë që të përballte edhe problemet e bashkëshortes së vet, Havasë. Këtu e ka zanafillën përgjegjësia e burrave!

Ose aludohet për premtimin dhe besëlidhjen që kishte dhënë Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*). Ndryshimi ishte si rrjedhim i sjelljes së tij. Rezultati do të binte mbi atë.

Më pas, Zoti i Madhëruar komfortin dhe qetësinë që kishte shijuar në Xhennet dhe dhimbjen dhe mundimin jashtë tij për Hazreti Ademin (*Paqja qoftë mbi të!*), e përshkruan në këtë mënyrë: **“Këtu nuk do të mbetesh kurrë as i uritur e as i zhveshur, dhe nuk do të kesh as etje, as vapë.”**

Për komentuesit e Kur’anit ka lindur një pyetje: Përse në këto ajete është përmendur etja, vapa dhe uria me zhveshjen, ndërkohë që zakonisht etja shoqërohet me urinë?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje kanë thënë: Në mes “etjes” dhe “rrezatimi i diellit” ekziston një lidhje e pamohueshme.¹

Lidhja mes “urisë” dhe “zhveshjes” ka mundësi të jetë për këtë shkak se edhe uria është një lloj zhveshjeje, zhveshje e stomakut nga ushqimi! (më e preferuar do të ishte që të thuhej zhveshja dhe uria janë dy shenja të dukshme dhe specifike të varfërisë, të cilat zakonisht përmenden krahas njëra-tjetrës).

¹ Fjala “*tedh’ha*” rrjedh nga rrënja “*dhuha*” dhe është në kuptimin e rrezatimit të diellit që nuk pengohet prej reve dhe të ngjashme me to.

Në këto dy ajete janë përmendur katër nevojat kryesore dhe themelore të njeriut: nevoja për ushqim, nevoja për ujë, për veshmbathje dhe për strehim, (mbulesa karshi vapës).

Në Xhennet këto nevoja janë me bollëk. Përmendja e këtyre çështjeve është një shpjegim për atë që u tha edhe në lidhje me fjalën "*feteshka*" (do të vuash në mjerim).

Por megjithëkëtë, Iblisi ishte i vendosur në armiqësinë dhe urrejtjen e tij ndaj Hazreti Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*). Për këtë arsye nuk qëndroi duarkryq dhe filloi me nxitjen e Ademit: **"Por djalli e cyti: 'O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?'"**

Fjala "*vesvese*" është përdorur në kuptimin e një zëri shumë të ulët. Më pas është përdorur edhe në lidhje me depërtimin e përfytyrimeve të liga dhe të mendimeve të pabaza në mendje, qofshin ato që burojnë nga mendja e vet njeriut, qofshin ato që vijnë nga një person i huaj.

Në fakt, Iblisi e vuri re se cila është prirja e Hazreti Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe arriti në përfundimin se ai ishte i dhënë pas Jetës së Përherëshme, arritjes tek fuqia e përherëshme. Prandaj, për ta tërhequr atë drejt kundërshtimit të urdhrit të Zotit të Madhëruar, i shfrytëzoi këto dy faktorë.

Shprehur ndryshe, ashtu siç Zoti i pat premtuar Hazreti Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) që, nëse Iblisin e largon nga vetja, gjithnjë do të jesh në Xhennetin plot rehati dhe i rrethuar nga begatitë e Zotit tuaj. Edhe Iblisi, në nxitjet e tij u fokusua pikërisht në këtë çështje. Po, djajtë gjithnjë, programet e veta i fillojnë nga ato pika me të cilat fillojnë edhe udhëheqësit e rrugës së drejtë.

Pastaj, pa kaluar shumë kohë, i tërheqin njerëzit në rrugën e devijimit dhe të mashtrimit. Djajtë, për t'ia arritur më lehtë kësaj, dëshirën e njerëzve për të ecur në rrugë të drejtë e shfrytëzojnë si mjet për t'i çuar njerëzit në rrugë pa krye.

Si përfundim, ndodhi ajo që nuk duhej të ndodhte dhe: **“Kështu, ata të dy, (Ademi dhe Havaja), hëngrën nga ajo pemë e u ndërgjegjësuan për lakuriqësinë e tyre...”**.

Kur Hazreti Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Havaja u gjenden në një situatë të tillë, menjëherë filluan të përpiqeshin të mbuloheshin me gjethe. Për këtë çast thuhet: **“...pranda nisën të mbulohen me gjethet e Xhennetit.”**¹

Prandaj, meqenëse **“...Ademi nuk e zbatoi urdhrin e Zotit të vet, kështu që devijoi (nga rruga e drejtë).”**.

Fjala “*gaua*” rrjedh nga rrënja “*gaj*”. Këtu është përdorë me kuptimin e një veprimi të padrejtë, i cili buron nga një bindje e gabuar. Hazreti Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*) e bëri atë veprim të padrejtë për arsye se fjalët e Iblisit krijuan një përshtypje të gabuar. I nisur nga kjo pandehmë e gabuar, Hazreti Ademi hëngri nga pema e ndaluar. Për këtë rast u përdor shprehja “*gaua*”.

Disa komentues të Kur'anit fjalën “*gaua*” e kanë komentuar në kuptimin e injorancës dhe të mosdijes, e cila buron nga neglizhenca. Disa komentues të tjerë e kanë pranuar kuptimin e privimit dhe disa të tjerë në kuptimin e korrupsionit në jetë.

¹ Fjala “*jekhsifan*” rrjedh nga rrënja “*khesfun*” këtu është në kuptimin e qepjes së rrobave.

Sidoqoftë, fjala “*gaj*” (devijimi) është pika e kundërt e “*rushdit*” (udhëzimit). Udhëzim do të thotë që njeriu të ndjekë një rrugë sipas porosive të caktuara, pa i shtrembëruar ato dhe t’ia arrijë qëllimit final. Kurse “*gaj*” do të thotë të gabosh në zbatimin e udhëzimeve dhe, për këtë arsye, të mos arrish në destinacionin e caktuar.

Hazreti Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*), në thelb ishte besimtar dhe i pastër. Ai ecte me vendosmëri në rrugën e kënaqësisë së Zotit të Lartësuar. Ky gabim që ndodhi si pasojë e një keqkuptimi nën efektin e nxitjeve të djallit përbënte një përjashtim. Prandaj Zoti i Madhëruar nuk e privoi atë përgjithnjë nga mëshira e vet. Pas kësaj ngjarjeje Zoti i Madhëruar ia pranoi pendimin dhe e udhëzoi: “**...Pastaj, Zoti i tij e zgjodhi atë, ia pranoi pendimin, e udhëzoi...**”.

Hulumtime

Vallë, a mëkatoi Hazreti Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*)?

Si rregull, rebelimi pranohet si formë e mëkatit. Por, nuancat kuptimore leksikore i japin fjalës edhe kuptimin e cënimit (mosrespektimit) të urdhrit, apo të nënshtrimit (qoftë ky një urdhër i detyrueshëm apo i pëlqyeshëm).

Si rrjedhim, përdorimi i fjalës “rebelim”, jo domosdoshmërisht është në kuptimin e heqjes dorë nga kryerja e

një obligimi ose kryerja e një mëkati, por mund të jetë edhe moszbatimi i një urdhri të rekomandueshëm, (i cili nuk arrin në nivelin e obligimit), ose kryerja e një veprimi të pa pëlqyeshëm.

Ndonjëherë “urdhri dhe ndalimi” kanë kuptimin e udhëzimit. Për shembull, urdhri dhe rekomandimi që mjeku i bën pacientit për ta përdorur apo për të mos e përdorur këtë apo atë ilaç, për të ngrënë këto ushqime dhe për të mos ngrënë ushqime të tjera, duhen marrë si udhëzime që lidhen me shëndetin e të sëmurit. Në qoftë se i sëmuri nuk i zbaton porositë e mjekut, ai i bën dëm vetes së vet.

Në këtë kontekst mund të kuptohet edhe situata me Hazreti Ademin (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilin Zoti i Madhëruar e pat urdhëruar që të mos hante nga pema e ndaluar, sepse, në të kundërt, do të privohej nga Xhenneti dhe do të vuante mjerimin në tokë. Hatreti Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*) e kundërshtoi këtë urdhër- udhëzues dhe për pasojë u përball me rezultatin dhe pasojat e tij.

Në qoftë se kemi parasysh faktin se periudha e qëndrimit të Hazreti Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) në Xhennet ishte periudhë testimi e jo periudhë e përgjegjësisë, kjo situatë qartësohet më së miri.

Rebelimi dhe ndalimi, në kuptimin absolut, quhen mëkate për të gjithë, pa përjashtim. Quhen mëkate njësoj si gënjeshtra, dhuna dhe zaptimi i pasurisë në mënyrë të paligjshme etj. Ndonjëherë, rebelimi dhe ndalimi kanë karakter relativ. Kjo duhet kuptuar se këto vepra nëse i kryen një person në emër të një të mire, jo vetëm që nuk konsiderohen mëkat, por konsiderohen vepra të mira dhe të pëlqyeshme, por nëse kryhen nga një person

tjetër, pa ndonjë synim pozitiv, krahasuar me pozitën dhe dinjitetin e tij, janë vepra të papëlqyeshme dhe të papërshtatshme.

Për shembull për ndërtimin e një qendre spitalore kërkohet nga njerëzit ndihmë dhe përkrahje. Një nëpunës ofron si ndihmë shpërblimin e një dite të tij. Ky veprim i tij është një sakrificë, por njëherazi është një e mirë dhe plotësisht e dëshiruar. Por, nëse një i pasur ofron fitimin e një dite të tij, kjo vepër jo vetëm që nuk konsiderohet si e pëlqyeshme nga ana e tij, por ndonjëherë mund të shoqërohet edhe me qortime, me fajësime dhe me kritikë, edhe pse në parim ai nuk ka kryer një vepër të ndaluar, por vetëm pse ka ofruar një ndihmë të vogël për të bërë një vepër të dobishme.

Të heqësh dorë nga vepra të rekomandueshme, do të quhej “mëkat relativ”, që në thelb nuk është as mëkat, as në kundërshti me pozitën e pagabueshmërisë.

Edhe në transmetimet islame, nganjëherë cënimi i Urdhrit Hyjnor është përdorur në kuptimin e kundërshtimit ndaj rekomandimeve të pëlqyeshme.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të*), lexojmë se lidhje me namazet e përditshme vullnetare, (Nafile) ka thënë: “Këto që të gjitha janë të pëlqyeshme dhe nuk janë të obligueshme. Çdo kush që heq dorë prej tyre ka kryer mëkat, sepse është e pëlqyeshme për njeriun që kryen një vepër të mirë, që puna e tij të ketë vazhdimësi.”.¹

¹ Në lidhje me këtë çështje dhe çështje të tjera rreth Ademit (*Paqja qoftë mbi të*!) dhe dëbimit të tij nga Xhenneti për më shumë kemi folur në vëllimin e gjashtë sure “El A’raf”, ajeti 19 e tutje, dhe vëllimin e parë ajetet 30-38.

Ajetet 123 - 127

أَهْبِطًا مِنْهَا جَمِيعًا ۖ بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ ۖ فَأِمَّا يَأْتِيَنَّكُمْ مِنِّي هُدًى
فَمَنِ اتَّبَعَ هُدَايَ فَلَا يَضِلُّ وَلَا يَشْقَى ﴿١٢٣﴾ وَمَنْ أَعْرَضَ عَن ذِكْرِي
فَإِنَّ لَهُ مَعِيشَةً ضَنْكًا وَنَحْشُرُهُ يَوْمَ الْقِيَمَةِ أَعْمَى ﴿١٢٤﴾ قَالَ رَبِّ لِمَ
حَشَرْتَنِي أَعْمَى وَقَدْ كُنْتُ بَصِيرًا ﴿١٢٥﴾ قَالَ كَذَلِكَ أَتَتْكَ آيَاتُنَا فَنَسِيتَهَا
وَكَذَلِكَ الْيَوْمَ تُنسى ﴿١٢٦﴾ وَكَذَلِكَ نَجْزِي مَنْ أَسْرَفَ وَلَمْ يُؤْمِنْ بِآيَاتِ
رَبِّهِ ۚ وَلَعَذَابُ الْآخِرَةِ أَشَدُّ وَأَبْقَى ﴿١٢٧﴾

“Dhe tha: ‘Zbritni prej Xhennetit që të dy (Ademi dhe djalli)! Do të jeni armiq të njëri-tjetrit. Kur t’ju vijë udhëzim nga ana Ime, kush do ta pasojë udhëzimin Tim, as nuk do të humbë, as nuk do të bjerë në mjerim.”

“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.”

“Ai do të thotë: ‘O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë kisha shikuar më parë?’”

“(All’Ilahu) do t’i thotë: ‘Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e po kështu sot do të jesh i harruar.”

“Kështu e ndëshkojmë Ne atë që e tepron (me gjynahe) dhe nuk beson shenjat e Zotit të tij; e dënimi në Jetën Tjetër, në të vërtetë, është më i ashpër dhe më i qëndrueshëm.”

Komentimi

Jetë të mjeruar

Pendimi i Hazreti Ademit (*Paqja qoftëmbi të!*) u pranua nga ana e Zotit të Madhëruar. Meqenëse kishte kryer një vepër që pamundësonte rikthimin në gjendjen e mëparshme, Zoti i Madhëruar Hazreti Ademin dhe Havanë si dhe djallin i urdhëroi dhe tha: **“Zbritni prej Xhennetit që të dy (Ademin dhe djallin)! Do të jeni armiq të njëri-tjetrit.”**

Gjithashtu, i paralajmëroi se rruga e lumturisë dhe e shpëtimit për ato është e hapur: **“Kur t’ju vijë udhëzim nga ana Ime, kush do ta pasojë udhëzimin Tim, as nuk do të humbë, as nuk do të bjerë në mjerim.”**

Me qëllim që përgjegjësia e tyre të bëhet e qartë dhe të mos harrojnë urdhrin e Zotit të Madhëruar, shton: **“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër. Ai do të thotë: ‘O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë kisha shikuar më parë?’”**

All'Ilahu i Madhëruar do t'i thotë: 'Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e po kështu sot do të jesh i harruar.'" Edhe syri yt do të verbohet. Ai nuk do të shikojë dot begatitë e Zotit të Lartësuar dhe pozitën e afrisë së Tij.

Si konkluzion, në ajetin e fundit që po diskutojmë, thotë: **"Kështu e ndëshkojmë Ne atë që e tepron (me gjynahe) dhe nuk beson shenjat e Zotit të tij, e dënimi në Jetën Tjetër, në të vërtetë, është më i ashpër dhe më i qëndrueshëm."**

Hulumtime

1- Harresa e përkujtimit të Zotit dhe pasojat e saj

Mund të ndodhë që njeriut t'i mbyllen të gjitha dyert e jetës. Në çdo punë që nis vihet përballë vështirësive të panumërta. Atij i duket sikur i janë mbyllur të gjitha dyert. Ndonjëherë ndodh e kundërta. Ngado që të kthehet i hapen të gjitha dyert, i krijohen rrethana lehtësuese dhe nuk e pengon asnjë vështirësi. Kur njeriu ka ndërtuar një mënyrë jetese të mirë, thuhet se ai jeton "në mënyrë komode", kurse kur jeton i rrethuar me vështirësi dhe mungesa përdoret shprehja "*maishetun dank*", e cila përdoret me

kuptimin “jetë e mjeruar”. Kjo gjendje është përmendur në ajetet e mësipërme me këto konotacione kuptimore.¹

Ndonjëherë jeta bëhet e vështirë dhe e mjeruar jo për shkak të varfërisë dhe të ardhurave të pakta. Ndodh që njeriu të ketë të ardhura shumë të larta, por zilia, koprracia dhe lakmia ia vështirësojnë jetën. Ndodh që njeriu të arrijë në një stad kur nuk ka dëshirë që dera e tij të jetë e hapur për të ndihmuar të tjerët që edhe ata të përfitojnë nga jeta e tij. Disa herë ai thujasë as vetes së vet nuk do që t’ia hapi derën. Si ilustrim për këtë rast shërben shprehja e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë për kopracin: “*Jeton si të varfrit dhe jep llogari si të kamurit dhe pasanikët.*”.

Po, përse njeriu vuan nga shqetësime të tilla, pra, rron në mjerim, kur ka mundësi të bëjë një jetë më të mirë? Për këtë Kur’ani Fisnik thotë se shkakun kryesor është ikja nga përmendja e Zotit.

Përmendja e Zotit të Madhëruar është burimi i qetësisë së shpirtit, burimi i devotshmërisë dhe i guximit, kurse harresa e përmendjes së Tij është burim i ankthit, i frikës dhe i shqetësimit.

Në kohën që njeriu i lë në harresë përgjegjësitë e tij si rrjedhojë e harresës së kujtimit të Zotit, zhytet në epsh, në lakmi dhe degjenerim. Është e qartë që rezultati i saj do të jetë një jetë e mjeruar, e pamjaftueshme që nuk ia mbush zemrën dhe nuk e mbron atë nga rebelimet shpirtërore dhe pasionet.

¹ Fjala “*ed danku*” është në kuptimin e vështirësisë dhe mjerimit. Kjo fjalë gjithnjë përdoret në trajtën njëjës dhe nuk ka trajtë shumës dhe as të vetës së dytë.

Në shumicën e rasteve jeta e njeriut mund të bëhet e mjerë për shkak të mungesës së theksuar të vlerave shpirtërore, për shkak të pasigurisë për të ardhmen, për shkak të frikës nga humbja e të mirave ekzistuese, si dhe nga varësia e tepruar ndaj kësaj bote materiale. Njeriu që beson në një Zot dhe i është dorëzuar plotësisht Atij, është i siguruar nga të gjitha këto shqetësime.

Të gjitha këto diskutime janë për individin që mund të harrojë përmendjen e Zotit të Madhëruar. Por duhet të theksojmë se jo vetëm individi, por e gjithë shoqëria e sotme pothuajse ia ka kthyer shpinën përmedjes së Zotit. Pra, çështja sa vjen e thellohet. Shoqëria njerëzore, me gjithë progresin e mahnitshëm në industri e teknologji, përballet me ankthe dhe shqetësime të mëdha. Ajo është e zhytur në depresion dhe ndjehet si e burgosur.

Që të gjithë i frikësohen njëri-tjetrit. Askush nuk i beson më tjetrit. Lidhjet dhe marrëdhëniet mes njerëzve ndërtohen në bazë të interesave personale. Bëhen harxhime marramendëse për armatime të rënda, nga frika e luftës etj.

Burgjet janë të mbushur plot me kriminelë. Në bazë të statistikave, në çdo orë dhe çdo sekondë ndodhin vrasje dhe krime të rrezikshme dhe të trishtueshme. Njerëzimi ka varësi ndaj lëndëve narkotike dhe prostitucioni i ka robëruar ata. Në ambientet e tyre familjare as që ekziston dritë dashurie, a dashamirësie. Kjo është jeta e tyre e vështirë dhe e mjerë.

Niksoni, ish-presidenti i Amerikës, në fjalimin e parë të tij presidencial pohoi këtë fakt: “Ne shohim rreth vetes jetë të zbrazëta, nihiliste. Ne dëshirojmë që të kënaqemi, të arrijmë

prehjen, por asnjëherë nuk arrijmë që të kemi një jetë të këtillë të kënaqur (në prehje)!.

Një tjetër personalitet i njohur i tyre, që kishte për detyrë të sjellë lumturinë në shoqëri, shprehet: “Unë vërej që njerëzimi po vrapon në një rrugë të errët në fund të së cilës ka vetëm një ankth absolut”!¹

Në transmetimet islame lexojmë: E pyetën Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) se cili është interpretimi i ajetit. Ai tha: **“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar...”**. Imami u përgjigj: Interpretimi i ajetit është kthimi i shpinës vilajetit (prijësisë) së Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).²

Ai që merr si shembull jetën e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), të atij supernjeriu, pas Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për të cilin gjithë bota materiale ishte më pak e vlefshme se sa një gjethe peme, që e lidh shpirtin e vet me Zotin e Madhëruar, që bota në sytë e tij duket diçka shumë e vogël dhe e pavlerë, ai person, cilido qoftë ai, do të ketë një jetë të rehatshme, të pasikletshme dhe të lumtur. Por ata që harrojnë këto shembuj, do të kenë një jetë të mjeruar dhe të shtrënguar.

Në hadithe të shumta tregohet se ikja nga përmendja e Zotit, është komentuar si “heqja dorë nga kryerja e ritualit të Haxhit” nga personat të cilët kanë kushtet për kryerjen e pelegrinazhit. Ky krahasim bëhet për shkak se ceremonia mbresëlënëse e Haxhit krijon rilidhje dhe ribashkim me Zotin e

¹ “Muamaje hasti”, faqet 50 - 51.

² Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëllimi 3, faqe 405.

Madhëruar. Kjo lidhje dhe ky bashkim mundëson një mënyrë jetese komode, ndërkohë që varësia e madhe nga gjërat materiale, është burim i jetës së mjeruar.

2- Verbëria e brendshme dhe e jashtme

Personat që ia kthejnë shpinën përmendjes së Zotit të Madhëruar marrin dy dënime që përcaktohen në ajetet e lartpërmendura: njëri dënim është jeta e mjeruar dhe e sikletshme që bëjnë në këtë botë, kurse dënimi tjetër është verbimi në Botën Tjetër.

Shumë herë kemi cekur se Bota e Përtejme është personifikim në përmasa më të gjera dhe më të mëdha se jeta e kësaj bote. Atje të gjitha realitetet e kësaj bote personifikohen në formë të përshtatshme. Sytë e shpirtit të atyre që në këtë botë nuk arrijnë të shohin dot të mirat e saj, janë më të verbër se ato që i kanë të verbër sytë e trupit dhe në atë botë sytë e trupit të tyre gjithashtu do të jenë të verbër, prandaj në ajet thuhet: *“Ne që në këtë botë nuk ishim të verbër, përse jemi ringjallur të verbër? Këtyre personave do t’iu thuhet: kjo është për shkak se shenjat dhe argumentet e All’llahut i latë në harresë.”*.

Këtu lindin disa pyetje: Pse në disa ajete kur’anore argumentohet fakti që në Kiamet të gjithë njerëzit do të kenë sy për të parë? Pse atyre do t’u thuhet që të lexojnë librin e veprave të veta: **“...ikra kitabeke...”**?¹ Pse thuhet se mëkatarët do të jenë në gjendje që të shohin zjarrin e Xhehennemit me sytë e tyre; kurse,

¹ Sure “El Isra”, ajet 14.

në anën tjetër thuhet se mëkatarët do të dënohen me verbim?¹
Këto shprehje nuk janë koherente as në anën kuptimore.

Disa nga komentuesit e njohur të Kur'anit kanë pohuar që gjendja e asaj Bote ndryshon me gjendjen e kësaj bote. Ndodh që disa njerëz janë në gjendje që të shohin një pjesë të gjërave dhe nuk do të jenë në gjendje të shohin disa gjëra të tjera.

Komentues të njohur të Kur'anit, mes tyre edhe dijetari i njohur, Tabersiu, është shprehur: “Ai karshi lumturisë, begatisë dhe dobisë është i verbër, kurse karshi dënimit, smirës dhe asaj që është burim i fajësimit dhe i fatkeqësisë nuk është i verbër, sepse rendi i asaj Bote ndryshon me rendin ekzistues në këtë botë.”.

Gjithashtu, ekziston edhe mundësia që në Botën Tjetër, të njëjtët persona, për disa gjëra do t'u privohet shikimi, kurse për disa gjëra të tjera nuk do të jenë të verbër.

Lidhur me harresën e kriminelëve nga Zoti i Madhërruar problemi qëndron kështu: Zoti i Madhërruar nuk i ka harruar ata, por mban një qëndrim indiferent ndaj tyre, duke i injoruar ato.

3- Teprimi në mëkat

Në ajetet e lartpërmendura këto dënime të rënda janë përmendur për njerëz që e teprojnë me mëkatim dhe nuk besojnë në shenjat e Zotit të Lartësuar.

Fjala “*israf*”, (teprim), këtu është përdorë për të treguar se disa njerëz begatitë e dhëna nga Zoti, siç janë: syri, veshi dhe

¹ Sure “Kehf” ajeti 53.

mendja i kanë përdorë dhe shfrytëzuar në rrugë të gabuar. Këtu, kuptimi i teprimit lidhet me faktin se njeriu e shpërdoron vlerën e këtyre begative Hyjnore dhe abuzon me to.

Kjo fjalë mund të jetë përdorë edhe si aludim për mëkatarët, të cilët i ndanë në dy grupe: në njërën grup futen ata që kanë kryer mëkate të kufizuara dhe ndjejnë në zemër një frikë nga Zoti i Madhëruar. Kjo do të thotë se ata nuk i kanë shkëputur plotësisht marrëdhëniet e tyre me Zotin. Për shembull, nuk do ta pranonin të kryejnë dhunë ose padrejtësi ndaj një të verbri apo jetimi. Nëse e kanë kryer, e konsiderojnë veten fajtor dhe përpara Zotit kërkojnë falje.

Personat e tillë janë mëkatarë dhe dënimi për ata është i merituar, por ky lloj mëkati ka dallim të madh me mëkatin që kryejnë persona të tjerë dhe që, më pas, krenohen me mëkatin e kryer. Grupi i parë i mëkatarëve edhe mund të pendohet dhe të përpiqet t'i shlyejë mëkatet, kurse grupi i dytë, të cilët e teprojnë me kryerjen e mëkatetve dhe krenohen me to nuk tolerohene as nuk falen.

4- Ç'farë do të thotë termi “el hubútu”?

Fjala “*el hubútu*” nga ana leksikore përcjell kuptimin e zbritjes së detyrueshme, si për shembull, rënia e gurit nga lart. Në rastin që kjo fjalë përdoret në lidhje me njeriun merr kuptimin e zbritjes poshtë si dënim.

Kjo fjalë kur përdoret në lidhje me Hazreti Ademin (*Paqja qoftë mbi të!*), tregon se zbritja e Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) është

në kuptimin e zbritjes së pozitës, jo zbritje hapësinore. Kjo do të thotë se Zoti i Madhëruar e uli atë në pozitë për shkak të mosrespektimit të rekomandimit dhe e privoi nga e gjithë ajo begati e Xhennetit dhe i shkaktoi një jetë të mjeruar në këtë botë.

Duhet të kemi parasysh faktin që audicienti këtu është përdorimi i vetës së dytë, *"ihbita"*, ka kuptimin që do të dilnin të dy, edhe Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Havaja.

Edhe në raste të tjera fjala *"ihbitu"* është përmendur në trajtën e shumësit në Kur'an. Kjo për arsye se në këtë kuptim shumësi përfshihet edhe djalli, i cili gjithashtu u nxor nga Xhenneti.

Egziston edhe mundësia që forma e shumësit të jetë përdorur për Ademin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe për djallin, sepse në vazhdim të fjalisë thuhet: **"...Do të jeni armiq të njëri-tjetrit..."**.

Disa komentues të Kur'anit kanë deklaruar se fjalia: **"...Do të jeni armiq të njëri-tjetrit ..."**, në formën e shumësit tregon që në mes Ademit dhe Havasë nga njëra anë dhe djallit nga ana tjetër ekziston një armiqësi. Ose, në mes Ademit dhe fëmijëve të tij nga njëra anë dhe djallit e pasardhësve të tij nga ana tjetër ekziston një armiqësi.

Kurse fjalia: **"...Kur t'ju vijë udhëzim nga ana Ime..."**, nënkupton se bëhet fjalë për fëmijët e Hazreti Ademit dhe Havasë, sepse udhëzimi i All'llahut u përket vetëm atyre, kurse djalli dhe pasardhësit e tij nuk përfshihen në udhëzimin e Zotit të Madhëruar.

Ajetet 128 - 130

قَالَ أَفَلَمْ يَهْدِ لَهُمْ كَمْ أَهْلَكْنَا قَبْلَهُمْ مِنَ الْقُرُونِ يَمْشُونَ فِي مَسْجِدِهِمْ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِّأُولِي النُّهَى ﴿١٢٨﴾ وَلَوْلَا كَلِمَةٌ سَبَقَتْ مِنْ رَبِّكَ لَكَانَ لِزَامًا وَأَجَلٌ مُّسَمًّى ﴿١٢٩﴾ فَاصْبِرْ عَلَىٰ مَا يَقُولُونَ وَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ قَبْلَ طُلُوعِ الشَّمْسِ وَقَبْلَ غُرُوبِهَا ۖ وَمِنْ أَانَايِ الْإِيلِ فَسَبِّحْ وَأَطْرَافَ النَّهَارِ لَعَلَّكَ تَرْضَىٰ ﴿١٣٠﴾

“A nuk e kanë marrë vesh ata se sa e sa brezni Ne i kemi zhdukur para atyre, aty ku ecin nëpër vendet e tyre sot? Me të vërtetë, në këtë ka tregues për njerëzit e mençur.”

“Sikur të mos ishte një fjalë e mëparshme nga Zoti yt dhe një afat tashmë i caktuar, dënimi i tyre do të ishte shpejtuar.”

“Prandaj duroje (o Muhammed) atë që thonë ata dhe lavdëroje me falënderim Zotin tënd para lindjes së Diellit dhe para perëndimit të tij! Lavdëroje Atë edhe në orët e natës, edhe në skajet e ditës, që të mund të kënaqesh.”

Komentimi

Merrni mësim nga historia e popujve të kaluar

Në ajetet e kaluara u trajtuan çështje të shumta në lidhje me kriminelët. Në ajetin e parë të ajeteve që po diskutojmë tregohet një prej rrugëve më të mira që ndikon në rizgjimin dhe ndërgjegjësimin e nevojës së studimit të historisë së popujve të kaluar. Ajeti thotë: **“A nuk e kanë marrë vesh ata se sa e sa brezni Ne i kemi zhdukur para atyre...”**¹ (ata të cilët ishin të përfshirë në dënime të rënda dhe të dhimbshme të All'Ilahut), **“...aty ku ecin nëpër vendet e tyre sot...”**?

Këta breza njerëzorë kudo që kalojnë, nëpër vendet e tyre: në shtëpitë e popullit të Adit (në udhëtimet e Jemenit), në vendet e shkatërruara dhe të rrënuara të popullit të Themudit (në udhëtimin drejt Shamit), në shtëpitë e shkatërruara të popullit të Lutit (në udhëtimin e Palestinës), i shohin gjurmët e atyre popujve që kanë egzistuar para tyre, por nuk marrin mësim nga ata. Shkatërime të tilla që pësuan ata popuj as që mund të përshkruhen me gojë. Ato shkatërime janë dëshmi për ngjarjet e dhimbshme që pësuan popujt e kaluar. Ato, njëherazi, janë dhe paralajmërime për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, u tregojnë dhe u shpjegojnë atyre rezultatet dhe përfundimin e dhunës, për arsye të korrupsionit dhe të politeizmit.

¹ Ashtu siç e kemi cekur edhe në të kaluarën fjala “*kurun*” është shumësi i fjalës “*karnun*” dhe është në kuptimin e një populli që jetojnë në një epoke dhe ndonjëherë madje edhe vetë atë kohë gjithashtu e quajnë “*kern*”.

Po, “...Me të vërtetë, në këtë ka tregues për njerëzit e mençur...”¹

Të nxjerrësh mësim nga historia e popujve të kaluar është një prej çështjeve së cilës Kur’ani dhe hadithet islame i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë. Kjo çështje realisht është një përvojë që të fton për t’u zgjuar dhe për të reflektuar. Ndodh shpesh që persona të shumtë nuk marrin mësim nga asnjë këshillë, apo përvojë e mëparshme. Por kur shikojnë skena të tilla nga historitë që u kanë ndodhur popujve të kaluar i bën ata që të reflektojnë, të ndërgjegjësohen dhe të sensibilizohen. Ka ndodhur shpesh dhe ndodh shpesh që edhe të kenë ndryshuar dhe të ndryshojnë rrugën e jetës së tyre.

Në një hadith të transmetuar nga Profeti i Islamit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexojmë: “Populli më neglizhent është ai i cili nuk merr këshillë dhe mësim nga transformimi që pëson bota nga një gjendje në një tjetër”² (si dhe nuk merr mësim nga alternimi i natës dhe ditës).

Ky ajet në fakt është përgjigje për pyetjen: Pse Zoti i Madhëruar për këtë grup njerëzish nuk ka caktuar një program ngjashëm me fatin që ka shkruar për kriminelët në ajetet pararendëse? Kur’ani jep këtë përgjigje: “**Sikur të mos ishte një fjalë e mëparshme nga Zoti yt dhe një afat tashmë i caktuar, dënimi i tyre do të ishte shpejtuar.**”.

¹ Termi “*en nuha*” rrjedh nga rrënja “*nehjun*” dhe këtu është në kuptimin e “intelektit” sepse intelektu e parandalon njeriun nga gjërat e shëmtuara dhe të këqija.

² “Sefinetul Bihar” vëllimi 2, faqe 146.

Ky ligj i All'llahut është përmendur në shumë raste në Kur'an me termin "*kelime*" dhe bën fjalë për lirinë dhe të drejtat e njerëzve. Nëse secili kriminel do të dënohej menjëherë, pa i dhënë asnjë mundësi reflektimi, do të komentohej si dënim për shkak të frikës, për shkak të trishtimit prej dënimeve dhe jo si mjeti i përsosmërisë, që është qëllimi kryesor.

Përveç kësaj, nëse gjykohet që të gjithë kriminelët të dënohen menjëherë, nuk do të mbetej asnjë njeri mbi faqen e dheut: **"Sikur All'llahu t'i dënonte njerëzit (zullumqarë) për shkak të mizorisë së tyre, nuk do të linte mbi tokë asnjë gjallesë..."**.¹

Duhet të ekzistojë një afat i caktuar kohor që mëkatarët të ndërgjegjësohen dhe të nisin të vetëkorrigjohen edhe të ecin në rrugën e drejtë.

Në shumë ajete kur'anore përdoret shprehja "*exhelun musem'ma*", e cila konsiderohet si aludim për kohën e patjetërsueshme në fund të jetës së njeriut.²

Sidoqoftë, shtypësit, zullumqarët jobesimtarë dhe kriminelët guximtarë në mëkate nuk duhet që të mburren nga vonesa e dënimit të All'llahut dhe ta shpërfillin e injorojnë këtë fakt, se kjo e mirë e Zotit të Madhëruar, ky ligj Tij dhe kjo dispozitë e përsosmërisë, është që ua ka hapur dhe ua ka lënë të lirë atyre rrugën.

¹ Sure "En Nahl" ajeti 61.

² Për më shumë informacion shih ajetet 1 dhe 2 të sures "El En'am". Ndërkohë për nga pikëpamje e sintaksës fjala "*exhelun musem'ma*" i kthehet fjalës "*kelime*".

Më pas i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thotë: **“Prandaj duroje (o Muhammed) atë që thonë ata dhe lavdëroje me falënderim Zotin tënd para lindjes së Diellit dhe para perëndimit të tij! Lavdëroje Atë edhe në orët e natës, edhe në skajet e ditës, që të mund të kënaqesh.”**

Ky falënderim dhe lavdërim drejtuar Zotit të Madhëruar, njëherazi është edhe një luftë e hapur me politeizmin dhe me idhujtarinë, krahas durimit dhe qëndresës karshi fjalëve të ndyra dhe të vrazhda.

Por a synohet që lavdërimi dhe falënderimi absolut të jetë aludim për pesë kohët e namazit? Për komentuesit e Kur'anit kjo është çështje diskutimi.

Një grup i komentuesve janë të mendimit se duhet që shprehjet t'i përdorim me kuptimin e përgjithshëm. Ky do të ishte lavdërimi dhe falënderimi absolut. Ndërkohë që një grup tjetër janë të mendimit se ajeti është aludim për pesë kohët e namazeve ditore. Në këtë mënyrë shprehja **“para lindjes së diellit”** është aludim për namazin e sabahut, kurse shprehja **“para perëndimit të tij”** është aludim për namazin e ikindisë, (ose është aludim për faljet e drekës dhe të ikindisë, që koha e të dyjave vazhdon gjer në perëndim të diellit). Shprehja **“në orët e natës”** është aludim për namazet e akshamit dhe të jacisë si dhe për namazin e natës.

Shprehja **“edhe në skajet e ditës”** është aludim për namazin e drekës. Fjala *“etraf”* është shumësi i fjalës *“taraf”* dhe është në kuptimin e *“skajit”* dhe, nëse ditën e ndajmë në dy pjesë, namazi i drekës bie në pjesën e dytë të ditës.

Në disa ajete kur'anore përdoret fjalia *"etrafë nehari"* me të cilën aludohet për namazet e pëlqyeshme që njeriu mund t'i kryejë në pjesë të ndryshme të ditës. Shprehja *"etrafen nehar"* këtu ndodhet karshi shprehjes *"anāul lejl"* dhe përfshin në vete të gjithë ditën (sidomos nëse kemi parasysh faktin që fjala *"etraf"* është përdorur në formën e shumësit, ndërkohë që dita nuk ka më shumë se dy anë dhe skaje, prandaj duhet të qartësohet fjala *"skajet"*). Këtu kuptimi është më i gjerë i cili përfshin në vetvete orët e ndryshme të ditës.

Në komentimin e ajetit ekziston edhe një variant tjetër që tregon për dhikret e veçanta, për të cilat, në transmetimet islame, janë caktuar për ta orë të veçanta. Për shembull, në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku, (*Paqja qoftë mbi të*), lexojmë se në komentimin e ajetit të lartpërmendur deklarohet: *"Për çdo mysliman është e nevojshme që para perëndimit të diellit dhe para lindjes së tij ta shqiptojë dhjetë herë këtë dhikër: "La il'lahe il'lall'llah uahdehu la sherike lehu, lehul mulku ue lehul hamdu, juhji ue jumitu, ue jumitu ue juhji ue hue haj'jun la jemut, bijedihil khajru ue hue ala kul'li shej'in kadir"(Allahu është një i Vetëm dhe i Pashoq. Ai nuk ka otak. Atij i përket sundimi dhe falenderimi. Ai jep jetë dhe vdekje. Ai është që i vdes dhe i ringjall. Ai është i Përvetshëm dhe kurrë nuk vdes. Në dorën e Tij është mirësia dhe Ai është i Plotfuqishëm mbi gjithçka.)"*¹

Por këto komentime nuk kundërshtojnë njëri-tjetrin. Ka mundësi që ajeti të nënkuptojë edhe lavdërimin, edhe falënderimin kur i kryen namazet e obligueshme dhe të pëlqyeshme gjatë natës dhe ditës. Në këtë kontekst, midis transmetimeve të ndryshme në lidhje me këtë ajet, nuk ekziston

¹ "Usulul Kafi", vëllimi 2, faqe 518.

ndonjë kundërshti apo mospajtim, sepse në disa transmetime janë komentuar si lutje apo dhikre të veçanta edhe në disa të tjera, si namazi.

Është e nevojshme edhe përmendja e çështjes sipas së cilës fjalia *“leal’leke terda”* është treguese e lavdërimit dhe e falënderimit të Zotit dhe e durimit ndaj thënieve të kundërshtarëve. Ky lavdërim dhe falënderim për namazet e ditës dhe të natës e përforcon aq shumë lidhjen e njeriut me Zotin sa, njeriu, përveç Tij nuk mendon për asnjë gjë tjetër, nuk frikësohet nga ngjarjet e vështira dhe tronditëse, sepse ka të sigurtë një mbështetje të fortë dhe të fuqishme. Kështu ka siguruar qetësinë dhe sigurinë në shpirtin dhe qenien e tij.

Përdorimi i fjalës *“leal’le”* (ndoshta) ka mundësi që të jetë aludim për argumentin që trajtuam më sipër. Sipas komentuesve, kjo fjalë, *“leal’le”* përdoret zakonisht për të treguar kushtet që janë të nevojshme për të arritur një rezultat të caktuar. Për shembull, namazi dhe përmendja e Zotit të Madhëruar janë kusht, janë burim i qetësisë dhe i prehjes.

Ajetet 131 - 135

وَلَا تُمَدِّنْ عَيْنَكَ إِلَىٰ مَا مَتَّعْنَا بِهِ أَزْوَاجًا مِنْهُمْ زَهْرَةَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا
لِنَفْتِنَهُمْ فِيهِ ۚ وَرِزْقُ رَبِّكَ خَيْرٌ وَأَبْقَىٰ ﴿١٣١﴾ وَأْمُرْ أَهْلَكَ بِالصَّلَاةِ وَاصْطَبِرْ
عَلَيْهَا لَا نَسْأَلُكَ رِزْقًا ۖ لَّحْنُ نَرْزُقُكَ ۗ وَالْعِيقَبَةُ لِلتَّقْوَىٰ ﴿١٣٢﴾ وَقَالُوا لَوْلَا
يَأْتِينَا بَيِّنَاتٌ مِنْ رَبِّهِ ۚ أَوَلَمْ تَأْتِهِمْ بَيِّنَةٌ مَا فِي الصُّحُفِ الْأُولَىٰ ﴿١٣٣﴾ وَلَوْ أَنَّا
أَهْلَكْنَاهُمْ بِعَذَابٍ مِنْ قَبْلِهِ لَقَالُوا رَبَّنَا لَوْلَا أَرْسَلْتَ إِلَيْنَا رَسُولًا فَنَتَّبِعَ
آيَاتِكَ مِنْ قَبْلِ أَنْ نَذِلَّ وَنَخْزَىٰ ﴿١٣٤﴾ قُلْ كُلُّ مُتَرَبِّصٍ فَتَرَبَّصُوا ۖ
فَسَتَعْلَمُونَ مَنْ أَصْحَابُ الصِّرَاطِ السَّوِيِّ وَمَنِ اهْتَدَىٰ ﴿١٣٥﴾

“Mos e hidh shikimin në të mirat kalimtare, që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre, si stoli të jetës së kësaj bote, për t’i vënë ata në provë! Shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe më i qëndrueshëm.”

“Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë! Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë ushqim: jemi Ne që të ushqejmë! Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj All’llahut.”

“Ata thonë: ‘Përse të mos na sjellë ai ndonjë shenjë nga Zoti i tij’? A nuk u erdhi atyre sqarimi për atë që gjendej në shkrimet e lashta?”

“Sikur Ne t’i kishim shkatërruar ata para kësaj, ata, me siguri, do të thoshin: ‘O Zoti ynë! Sikur të na kishe sjellë një të Dërguar, vërtet që do të kishim ndjekur Shpalljet Tuaja, para se të poshtëroheshim dhe turpëroheshim!”

“Thuaju (o Muhammed): ‘Të gjithë presin, prandaj prisni edhe ju, dhe do ta kuptoni se kush janë ithtarët e rrugës së drejtë dhe kush është i udhëzuar drejt.’”

Komentimi

Në këto ajete janë dhënë disa urdhra për Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Por përmes tyre synohet që të gjithë myslimanët t’i mbajnë parasysh këto urdhëra në të gjithë veprimtarinë e tyre, duke qenë të duruar.

Në fillim ajeti thotë: **“Mos e hidh shikimin në të mirat kalimtare, që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre.”**

Po, këto begati të përkohëshme, janë lulëzim i jetës së kësaj bote **“...si stoli të jetës së kësaj bote...”**.

Këto begati duhen konsideruar si lule që çelin shpejt dhe vyshken shpejt, që dekompozohen e prishen. Ato kanë aromë vetëm për disa ditë.

Ndërkohë, që me të gjitha këto Ne i sprovojmë ato: **"...për t'i vënë ata në prove..."!**

"Shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe më i qëndrueshëm."

Zoti i Madhëruar ty të ka dhuruar lloj-lloj begatish dhe mirësish. Të ka dhuruar besimin dhe Islamin, të ka dhuruar Kur'anin, shenjat në veten tënde dhe në horizonte, furnizimin hallall dhe të pastër dhe begatitë e përhershme të Ahiretit. Begatitë e Ahiretit janë begati të qëndrueshme dhe të përhershme.

Për të qetësuar shpirtin e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për ta përforcuar zemrën e tij ajeti thotë: **"Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë!"**.

Falja e namazit nga ana e çdo personi dhe e familjes së tij është burim i pastërtisë së zemrës, është burim i forcimit të shpirtit si dhe vazhdimësi e kujtimit të Zotit të Madhëruar.

Fjala "*ehl*" përdoret për familjen e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në tërësi. Por, duhe të kemi parasysh faktin që kjo sure ka zbritur në Mekë. Në Mekë, në atë kohë, me termin "*ehl*" nënkuptohej Hatixheja dhe Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), prandaj dhe ka mundësi që shtrirja kuptimore e saj të përfshijë edhe disa të tjerë nga të afërmit e

Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse me kalimin e kohës gjiri i familjes së Profetit, u zgjerua.

Ajeti më pas shton: **"...nëse ty dhe familjen tënde u kemi urdhëruar për namaz, dobitë dhe përfitimet e tij janë në favorin tuaj. Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë ushqim. Jemi Ne që të ushqejmë!"**.

Falja e namazit prej teje dhe familjes tënde nuk i shton ndonjë gjë madhështisë së Zotit të Lartësuar, përkundrazi është tregues i madh i përsosmërisë suaj, o njerëz. Është një shkollë e lartë edukimi.

E thënë me fjalë të tjera, Zoti i Madhëruar nuk ngjason me mbretërit dhe princat të cilët merrnin shpërblim nga populli i tyre dhe kështu e sigurojnë jetën e vet dhe të të afërmeve të tyre. Zoti i Madhëruar nuk ka asnjë nevojë nga askush. Por që të gjithë kanë nevojë për Atë.

Kjo shprehje është e ngjashme me atë që është thënë në suren "Edh Dharijat" në ajetet 56-58: **"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, përveçse që të më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre ndonjë furnizim e as dëshiroj të më ushqejnë ata. All'llahu është furnizues i madh, Ai Fuqiforti."**

Në këtë mënyrë, rezultati dhe dobia e adhurimeve u kthehet vetë adhuruesve.

Në përfundim ajeti shton: **"Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj All'llahut."**

Si përfundim, mund të themi se të devotshmit, janë fitimtarët. Kurse të padevotshmit dhe mëkatarër janë të dënuar me dështim.

Komentimi i këtij ajeti pranon që duhet të theksohet mirë devotshmëria dhe singëriteti në adhurim, sepse këto janë thelbi i adhurimit. Kjo theksohet në ajetin 37 të sures “El Haxh” ku lexojmë: **“Tek All’llahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre, por te Ai arrin bindja e juaj...”**.

Ajo që arrin nga veprat tuaja të Ai janë thelbi, janë esenca e besimit dhe e devotshmërisë së singërtë, jo dukja e forma e tyre.

Ajeti i tretë i diskutimit tonë sqaron një prej justifikimeve të politeistëve. Në ajet thuhet: **“Ata thonë: ‘Përse të mos na sjellë ai ndonjë shenjë nga Zoti i tij?’”**.

Kur’ani aty për aty u kthen përgjigjen (në lidhje me popujt e kaluar, që sa here iu jepej rasti thurnin alibi për të kërkuar mrekullira dhe pas vërtetimit të mrekullive prapë e vazhdonin rrugën e politeizmit dhe mohimit, derisa binin pre e dënimit të ashpër Hyjnor. A nuk kuptojnë se nëse vazhdojnë ta ndjekin të njëjtën rrugë ato i pret i njëjti fat): **“A nuk u erdhi atyre sqarimi për atë që gjendej në shkrimet e lashta?”**.

Në komentimin e këtij ajeti pranohet që synimi i fjalës *“bej’jine”* të jetë vetë Kur’ani që shpreh të vërtetat e librave të kaluar qiellor në një nivel më të lartë. Për këtë, ajeti i lartpërmendur, thotë: Përse ata kërkojnë mrekulli dhe shfajësohen me arsye të kota e të pabaza? A nuk u mjafton atyre ky Kur’an, i cili flet për të vërtetat e Librave të mëparshëm qiellorë?

Ka edhe një interpretim tjetër lidhur me këtë ajet. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), edhe pse nuk kishte mësuar shkrim dhe lexim, solli një Libër kaq të qartë. Ai libër përputhej plotësisht me atë që ekzistonte në tekstet e Librave Qiellorë dhe kjo është një dëshmi e gjallë për mrekullinë e Tij.

Përveç kësaj, atributet e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Libri i Tij përputhen plotësisht me përshkrimet që janë dhënë në Librat e mëparshëm qiellorë. E kjo është argument i vërtetësisë së tij.¹

Sidoqoftë, këta justifikues që thurin alibira, nuk janë njerëz që kërkojnë të vërtetën. Përkundrazi, ata gjithnjë janë në orvatje të sjelljes së arsyetimeve të reja, madje: **“Sikur Ne t’i kishim shkatërruar ata para kësaj, ata, me siguri, do të thoshin: ‘O Zoti ynë! Sikur të na kishe sjellë një të Dërguar, vërtet që do të kishim ndjekur shpalljet Tuaja, para se të poshtëroheshim dhe turpëroheshim’”!**

Ndërsa tani që iu erdhi ky Profet i madhëruar me këtë Libër madhështor, çdo ditë thonin një fjalë dhe sillnin një justifikim.

Ajeti paralajmëron duke iu thënë: **“Thuaju (o Muhammed): ‘Të gjithë presin, prandaj prisni edhe ju, dhe do ta kuptoni se kush janë ithtarët e rrugës së drejtë dhe kush është i udhëzuar drejt.’”**.

¹ Tefsiri i parë është cituar në *“Mexhmaul Bejjan”*, tefsiri i dytë në *“Fi dhilalil Kur’an”* dhe tefsiri i tretë nga Fekhrü Razi në tefisirin *“El Kebir”* edhe pse këto tefsire janë ndryshe nga njëri-tjetri por nuk bien ndesh, sidomos tefsiri i dytë dhe i tretë.

Me këtë fjali vendimtare mbyllet dialogu me mohuesit kokëfortë dhe justifikues.

Thënë shkurt, duke pasur parasysh faktin që kjo sure ka zbritur në “Mekë” dhe në këtë periudhë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanët ishin nën presione të ashpra nga armiqtë e tyre, Zoti i Madhëruar në fund të kësaj sureje i ngushëllon ata. Ndonjëherë Ai i ndalon ata që të mos mashtrohen nga pasuritë e përkohshme të mohuesve, sepse ato janë sprovë për ata. Herë tjetër i urdhëron besimtarët për namaz dhe të jenë të palëkundur në mënyrë që fuqia e tyre shpirtërore të përforcohet përballë armiqve të shumtë në numër.

Në fund, All'llahu i Madhëruar i përgëzon myslimanët. I Madhërishmi tregon se ata që nuk besojnë do të kenë një fund të hidhur dhe të zymtë. Ata duhet të qëndrojnë në pritje të fundit të hidhur të tyre.

O Zot! Të lutemi, na udhëzo ne dhe na bëj nga ndjekësit e Rrugës së Drejtë!

O Zot! Të lutemi, na dhuro atë trimëri dhe guxim që mos të frikësohemi as nga numri i madh i armiqve e as nga ngjarjet e rënda dhe problemet.

O Zot! Të lutemi, largoje nga ne shpirtin e kokëfortësisë dhe të justifikimit dhe na mundëso suksesin e pranimit të së vërtetës!

Amin, ja rabbil alemin!

Fundi i sures “Ta Ha”

Përmbajtja

Sure “El Kehf”	5
Ajetet 75 - 78	5
Komentimi.....	6
Ajetet 79 - 82	12
Komentimi.....	13
Sekretet e brendshme të atyre ngjarjeve.....	13
Hulumtime.....	19
1- Misioni i Hidrit ishte në kuadrin e sistemit ligjor apo në kuadrin e sistemit struktural?.....	19
2- Kush është Hidri?.....	26
3- Legjendat e sajuara.....	30
4- A mund të preken Profetët nga harresa?.....	31
5- Përse shkoi Mùsai të takohej me Hidrin?.....	32
6- Ç’ishte thesari?.....	35
7- Mësimet e këtij tregimi.....	37
Ajetet 83 - 91	45
Komentimi.....	46
Tregimi i çuditshëm i Dhulkarnejnit.....	46
Ajetet 92 - 98	53
Komentimi.....	54
Si u ndërtua diga e Dhulkarnejnit?.....	54
Hulumtime.....	60
1- Konstatime edukative në këtë tregim historic.....	60
2- Kush është Dhulkarnejni?.....	66
3) Ku gjendet diga e Dhulkarnejnit?.....	76

4) Kush janë je'xhùxhë e me'xhùxhët?.....	77
Ajetet 99 – 102	80
Komentimi.....	81
Përfundimi i jobesimtarëve.....	81
Ajetet 103 – 108	85
Komentimi.....	86
Njerëzit që pësojnë humbjen më të madhe.....	86
Hulumtime.....	91
1- Cilët janë më të humburit në punët e tyre?.....	91
2- Çfarë do të thotë takimi me All'llahun?.....	94
3- Peshimi i punëve.....	96
4- Komentimi i fjalës së të Lartit: " <i>là jebgùne anhà hivelen</i> " - "dhe nuk do të kërkojnë që të largohen prej aty".....	97
5- Për cilin është Firdeusi?.....	98
Ajetet 109 – 110	100
Shkaku i zbritjes.....	101
Komentimi.....	102
Ata që shpresojnë takimin me All'llahun.....	102
Sqarimi i konceptit të pafundësisë.....	105
Sinqeriteti ose shpirti i punës së mire.....	111
Sure "Merjem"	114
Përmbajtja e sures "Merjem".....	115
Mirësitë e leximit të sures.....	115
Ajetet 1 – 6	117
Komentimi.....	118
Lutja bindëse e Zekerijas (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	118
Hulumtime.....	122
1- Cili është qëllimi i përdorimit të fjalës "irth" - "trashëgimi", në këtë rast?.....	122
2- Ndërsa fjalia: "Idhnada Rrabbehu Nidaen Khafijja" është trajtuar nga komentuesit.	127
Ajetet 7 – 11	129

Komentimi.....	130
Zekerijas iu plotësua dëshira.....	130
Hulumtime.....	134
Jahja, Profeti i devotshëm i All'Ilahut.....	134
1- Faltorja ishte një vend i veçantë, që i takonte Imamit dhe personave të zgjedhur. Fjala “ <i>faltore</i> ” ka dy kuptime.....	137
Ajetet 12 – 15	138
Komentimi.....	139
Cilësitë e shquara të Profetit Jahja (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	139
Hulumtime.....	141
1- “Librin qiellor rroke fort!”.....	141
2- Tre ditë të vështira në të ardhmen e njeriut.....	142
3- Profetësia në moshë të vogël.....	144
4- Martirizimi i Profetit Jahja (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	146
Ajetet 16 – 21	148
Komentimi.....	149
Fillimi i lindjes së Profetit Isa (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	149
Hulumtime.....	153
Cili është përdorimi i fjalës “Shpirt i Zotit”?.....	153
Ajetet 22 – 26	156
Komentimi.....	157
Hazreti Merjemja (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) në vështirsinë më të madhe të jetës.....	157
Hulumtime.....	162
Ditët e agjërimit me heshtje.....	165
Ajetet 27 – 33	168
Komentimi.....	169
Isai flet në djep.....	169
Hulumtime.....	175
Pasqyrimi më i mirë i lindjes së Profetit Isa (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	175
Pozita e nënës.....	176
Si mund të flasë një i sapolindur?.....	180

Ajetet 34 – 36	181
Komentimi.....	181
A është e mundur të ketë fëmijë Zoti?!.....	181
Hulumtime.....	184
Mohimi i të pasurit fëmijë, është mohim për çfarëdolloj nevojë nga Zoti.....	184
Një shënim i rëndësishëm historik.....	185
Ajetet 37 – 39	189
Komentimi.....	190
Ringjallja, Dita kur do të ndihet keqardhje.....	190
Ajetet 40 – 45	196
Komentimi.....	197
Hulumtime.....	202
Mënyra e ndikimit tek të tjerët.....	202
Arsyeja e ndjekjes së kësaj bote.....	203
Surja e mëshirës dhe e rikujtesës.....	203
Ajetet 46 – 50	205
Komentimi.....	206
Rezultati i largimit nga shirku.....	206
Ajetet 51 – 53	214
Komentimi.....	214
Profeti Musa (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>), Profet i singertë dhe i përzgjedhur.....	214
Hulumtime.....	217
Kush është i singertë?.....	217
Ndryshimi midis Resulit dhe Nebiut.....	217
Ajetet 54 – 55	220
Komentimi.....	220
Profeti Ismail, Profeti i singertë në premtimet e tij.....	220
Ajetet 56 – 60	224
Komentimi.....	225
Hulumtime.....	231

1- Kush është Idrizi?.....	231
Ajetet 61 – 63	233
Komentimi.....	233
Përshkrim i Xhenetit.....	233
Ajetet 64 – 65	240
Shkaku i zbritjes.....	240
Komentimi.....	241
Ajetet 66 – 70	244
Shkaku i zbritjes.....	245
Komentimi.....	245
Ajetet 71 – 72	249
Komentimi.....	249
Ajetet 73 – 76	255
Komentimi.....	256
Ajetet 77 – 82	262
Komentimi.....	263
Ajetet 83 – 87	269
Komentimi.....	270
Kush janë ata që e meritojnë shefaetin?.....	270
Ç’kuptim ka fjala “ahd”?.....	274
Ajetet 88 – 95	278
Komentimi.....	279
Zoti dhe të pasurit fëmijë?!.....	279
Hulumtime.....	282
Si mund të copëtohen qiejt nga njëri-tjetri?.....	283
Ajetet 96 – 98	285
Komentimi.....	286
Besimi është burim dashurie!.....	286
Hulumtime.....	290
Dashuria për Imam Aliun (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	290
Surja “Ta Ha”	295
Përmbajtja e sures “Ta Ha”	296

Mirësitë e leximit të kësaj sureje.....	297
Ajetet 1- 8	299
Shkaku i zbritjes.....	300
Komentimi.....	301
Mos e stërmundo veten tënde.....	301
Ajetet 9 - 16	309
Komentimi.....	310
Një zjarr në anën tjetër të shkretëtirës.....	310
Hulumtime.....	317
1- Cili është synimi i shprehjes “ <i>fekhla’ na’lejke</i> ”?.....	317
2- Përgjigjja ndaj një kritike.....	319
3- Namazi, mjeti më i mirë i përkujtimit të Zotit.....	320
Ajetet 17 - 23	322
Komentimi.....	323
Shkopi i Musait (<i>Paqja e All’llahut qoftë mbi të!</i>) dhe dora e bardhë.....	323
Hulumtime.....	327
1- Dy mrekulli të mëdha.....	327
2- Talentet e jashtëzakonshme të gjërave.....	329
3- Ç’farë thotë Teurati në lidhje me këtë çështje?.....	329
Ajetet 24 - 36	331
Komentimi.....	332
Musai (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) dhe kërkesat e tij.....	332
Hulumtime.....	338
1- Kushtet e udhëheqësit të revolucionit.....	338
2- Luftimi me rebelët.....	339
3- Për çdo vepër nevojiten programet dhe mjetet e duhura.....	339
4- Lartësimi dhe përmendja (e Zotit).....	340
5- Profeti i Islamit dhe përsëritja e kërkesave të Hazreti Musait (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	341
Ajetet 37 - 41	344
Komentimi.....	345
Zoti Mëshirëplotë.....	345

Hulumtime.....	355
Vallë, a i shpallet njerëzve të tjerë përpos të Dërguarve?.....	355
Ajetet 42 - 48	357
Komentimi.....	358
Përballja e parë me Faraonin tiran.....	358
Hulumtime.....	364
1- Fuqia madhështore dhe e çuditshme e Zotit.....	364
2- Ballafaqimi me butësi dhe me dashamirësi me armikun.....	365
3- Përgjigjja ndaj një pyetjeje.....	366
Ajetet 49 - 55	368
Komentimi.....	369
Kush është Zoti i juaj?!.....	369
Hulumtime.....	376
Ajetet 56 - 64	378
Komentimi.....	379
Faraoni përgatitet për luftën përfundimtare.....	379
Ajetet 65 - 69	388
Komentimi.....	389
Edhe Musai (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) del në shesh.....	389
Hulumtime.....	394
1- Cila është e vërteta e “magjisë”?.....	394
2- Magjistari asnjëherë nuk fiton?.....	396
Ajetet 70 - 76	399
Komentimi.....	401
Fitorja madhështore e Hazreti Musait (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	401
Hulumtime.....	408
1- Dituria është burim i besimit dhe revolucionit.....	408
3- Kush quhet kriminel?.....	410
4- A është fatalizmi mjedisor një mit?.....	411
Ajetet 77 - 79	413
Komentimi.....	413
Shpëtimi i izraelitëve dhe përmbytja e faraonëve.....	413

Ajetet 80 – 82	418
Komentimi.....	419
E vetmja rrugë e shpëtimit.....	419
Ajetet 83 – 91	425
Komentimi.....	427
Kokëforcia e Samiriut.....	427
Hulumtime.....	436
1- Kënaqësia e takimit.....	436
2- Lëvizjet antirevolucionare kundrejt revolucionit të Profetëve.....	438
3- Nivelet e udhëheqjes.....	440
4- Përgjigja ndaj një kritike.....	441
Ajetet 92 – 98	444
Komentimi.....	445
Fati i hidhur i Samiriut.....	445
Hulumtime.....	455
1- Karshi ngjarjeve tronditëse duhet treguar rezistencë.....	455
2- Kush ishte Samiriu?.....	457
Ajetet 99 – 104	458
Komentimi.....	459
Ngarkesa më e keqe që do të mbartin mbi supe.....	459
Ajetet 105 – 112	465
Komentimi.....	466
Skenat tronditëse të Kiametit.....	466
Hulumtime.....	473
1- Dallimi në mes “padrejtësisë” dhe “pakësimit”	473
2- Fazat e Ringjalljes.....	474
Ajetet 113 – 114	476
Komentimi.....	476
Thuaj: O Zoti im, shtoma diturinë!.....	480
Hulumtime.....	480
1- Mos u nxito as në pranimin e Shpalljes.....	480

2- Të jesh insistues në shtimin e diturisë.....	481
Ajetet 115 -122	484
Komentimi.....	485
Ademi (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) dhe mashtrimi i djallit.....	485
Hulumtime.....	492
Vallë, a mëkatoi Hazreti Ademi (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>)?.....	492
Ajetet 123 - 127	495
Komentimi.....	496
Jetë të mjeruar.....	496
Hulumtime.....	497
1- Harresa e përkujtimit të Zotit dhe pasojat e saj.....	497
2- Verbëria e brendshme dhe e jashtme.....	501
3- Teprimi në mëkat.....	502
4- Ç'farë do të thotë termi “el hubútu”?.....	503
Ajetet 128 - 130	505
Komentimi.....	506
Merrni mësim nga historia e popujve të kaluar.....	506
Ajetet 131 - 135	512
Komentimi.....	513

أالمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء السادس عشر

الترجمة الى اللغة الألبانية:

الحاج

سليم اصطفى (ره)، رايوندا فزا و والبونا هروزووا

تيرانا: 2018

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء شانزده هم)

نویسنده: فقیه مفسر حضرت آية الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: حاجی سلیم اصطفی (ره)، رایموند فزا و والبونا هرزوزوا

زیر نظر: وُلْنَتْ مَرَّتًا

ویرایش: دورینا باشا، یریدا کولا و اسعد بونغوری

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2018